
F.M.DOSTOJEVSKI

KRIM DHE NDËSHKIM



Roman

VEPRA E ZGJEDHURA III

UEGEN

Fjodor Mihajlloviç Dostojevski

KRIM DHE NDËSHKIM

Roman

E përktheu nga origjinali:
Jorgji Doksani

SHTEPIA BOTUESE
UEGEN

3rj0n1xx

Pjesa e parë

I

Në fillim të korrikut, buzë një mbrëmjeje të nxehtë, një djalosh doli nga dhomëza e zënë me qira në rrugën S. dhe mori për nga ura K. Ecte ngadalë dhe i pasigurt.

Te shkallët arriti t'i shmangej takimit me pronaren e shtëpisë. Dhomëza e tij ishte në papafingo mbi katin e pestë dhe ngjante më shumë me një musëndër. Pronarja banonte në apartamentin e katit më poshtë e kur ky dilte, patjetër që do të kalonte para kuzhinës së saj, që thuajse kurdoherë rrinte derëhapur. Pikërisht para asaj dere, djaloshi ndjente një si frikë, më tepër ndrojtje; i vinte turp dhe ndrydhej i pakënaqur. Ishte i kredhur gjer në fyt te qiramarrësja, ndaj dhe i shmangej.

Nuk ishte frikaman e as humbameno, përkundrazi, prej disa kohësh endej me nerva të ngritura, të acaruara, nxehej e merrte flakë për hiçmosgjë, dukej si i çartur. Ndërkohë po i pëlqente vetmia dhe i druhej takimit me këdo, jo vetëm me pronaren e shtëpisë. E kishte vënë përfund papasja dhe aq ligsht saqë jeta në atë musëndër nuk po i rëndej më. Kishte hequr dorë nga çdo lloj pune, madje edhe nga ajo që i nevojitet njeriut për të mbijetuar.

Për hir të së vërtetës duhet thënë se i shmangej takimit me të zonjën e shtëpisë jo ngaqë ia kishte frikën, as që i bënte tërt syri nga prapësitë dhe paudhësitë që kjo kurdiste, por të qëndronte si guhak para saj, të dëgjonte i topitur dërdëllitjet e mbushura me dokrra, për të cilat as që donte të dinte, të duronte hakërrimën dhe kërcënimet për qiranë e papaguar, të spërdridhej e të ngërdheshej mosmëkeq para saj e t'i kërkonte kokulur të falur, jo, nuk ia kishte fare ënda ta bënte, ndaj dhe i shmangej takimit në shkallë, rrëshqiste ashtu pa u ndier.

Erjonixx

Mirëpo këtë herë, duke dalë në rrugë, madje edhe vetë i habitur nga lemeria që po e mbante mbërthyer, ndërsa ecte para derës së qiramarrëses.

"Për çfarë po e përgatis veten dhe ç'gjepurave u druhem! - tha me vete me një buzagaz të çuditshëm. - Hm!... Njeriu e ka vetë në dorë çdo gjë, por i rrëshqet ngaqe s'e lë frika... Kështu është... Po ç'gjëje, vallë, i trembet më fort njeriu? Hapit të parë, apo fjalës së parë? Po ç'është kështu me mua? Jam duke llapur ca si shumë, më duket! Ndaj dhe nuk jam duke bërë gjë, sepse vetëm po i jap gojës. E po, prandaj dhe flas, sepse rri duarkryq. Dhe këtë huq e mora muajin e fundit, duke qëndruar i strukur në qoshen e kësaj kuvlie dhe duke menduar... për car Bizelen... Ja, tani për ku po shkoj? Pse, a mundem vallë, ta bëj diçka të atillë? Pse, punë që bëhet është? Aspak! Kot e kam, vetëm për t'u qetësuar po shkoj... Një lodër është kjo, lodër e fantazisë sime, asgjë tjetër!".

Zagushia të merrte frymën, njerëzit çapisnin të shastisur, të mbyste pluhuri, era e gëlqeres të ngacmonte fytin, era e tullave të çponte hundët, s'të shqitej kutërbimi karakteristik i zhegut petërburgas, aq mirë i njohur nga vendalinjtë që s'ua mban xhepi të zënë ndonjë daçë me qira jashtë qytetit. Iu gërricën edhe më nervat edhe kështu të acaruara. Po duhma e pijetoreve durohej? E pra, ato s'kishin të numëruar në këtë anë. Dhe sa të dehur që shihje, ndonëse ishte ditë pune. I ndillnin krupë e neveri këtij djaloshi buzëhollë. Ishte sy e vetullzi, shtatderdhur lastar, me trupin pak mbi mesataren. Pështirosja, s'i zgjati shumë, u zhyt në të thella, madje ra si në kllapi dhe vazhdoi rrugën pa i vënë re kalimtarët, ngaqë dhe nuk dëshironte t'i vinte re. Në të rrallë diç mërmëriste, kohët e fundit i qe bërë zakon të folurit me vete. E ndiente që mendimet po i kokolepseshin dhe po i pritej fuqia; ishte dita e dytë që s'kishte vënë gjë në gojë. Ishte veshur aq keq, saqë edhe një varfanjak i rëndomtë nuk do të kishte guxuar të dilte ashtu në rrugë. Por një e tillë lagje ishte kjo, që s'të zinte kërkund syri ndonjë të veshur për të qenë. Fqinjësia me portin lumor dhe me shtëpitë publike, gumëzhima e zanatçinjve të strukur në kthinat mesjetare i jepnin rrugëve të kësaj ane një pamje aq laragane, saqë zor se habiste ndokënd një figurë njeriu si kjo e djaloshit. Nga zemra i buiste një neveri që ogurzezë, sa, edhe pse e kishte në gjak krekosjen,

s'po e çante fare kokën për zhelet dhe rreckurinat që kishte veshur. Ndryshonte puna po t'i duhej të takohej me shokët apo me të njohurit, por me ta s'ia kishte qejfi të shihej...

Në këtë kohë një i dehur, që se për ku e çonin në një karro të terhequr nga një dori katana, i thirri: "Hej, gjerman kapelebërës!" Djaloshi pa nga vinte zëri dhe e rrasi më me inat kapelen mbi kokë. Ishte një kapelë e madhe, e rrumbullaktë cimermani, por shumë e përdorur, fare e ronitur, tërë vrima dhe njolla, me anë të dëmtuara dhe të përkulura. Nuk ishte ndjenja e turpit, por një ndjenjë tjetër që ngjante me frikën ajo që e pushtoi sakaq.

- E dija këtë! - mërmëriti sedërsëmbuar. - E dija! Më keq nuk ka ku vete! Një vogëlsirë si kjo, një gjë e kotë mund ta hedh në erë tërë planin! Po, kjo kapele bie shumë në sy... S'rri dot pa qeshur kur e sheh, ndaj dhe bie në sy! Për këto zhele, me të cilat jam veshur, do shkonte më mirë një kasketë, makar edhe ndonjë beretë e vjetër, por jo kjo. S'mban kush të tillë kapele, bie menjëherë në sy; ka për t'u marrë si shenjë e veçantë... Një vogëlimë është, por edhe për to duhet patur kujdes! Ato të marrin në qafë...

Nuk kishte shumë për të ecur, e dinte saktë, gjithë-gjithë shtatëqind e tridhjetë hapa. Në një nga ditët, dhënë pas ëndërrimesh, i pat numëruar. Atë kohë nuk i zinte fare besë asaj fantazie të çmendur, madje e nervozonte edhe kuturisja nxitëse, ishte një ngasje e shëmtuar, po joshëse ama. Tani që kishte kaluar një muaj, po fillonte t'i shihte ndryshe punët, edhe pse vazhdonin t'ia cingrisnin për dreq nervat monologjet e pafund për pavendosmërinë që tregonte, për pafuqinë që e kaplonte. Ëndrrën "e shëmtuar" si padashje zuri ta mbante si veprim të kryer, ndonëse hëpërhë as vetë s'e besonte. Po shkonte të bënte një provë të kësaj vepre dhe pas çdo hapi që hidhte, emocionet i rriteshin.

Me zemër të ngrirë dhe me dridhma frenetike iu afrua ngrehinës kaba me një faqe muri nga kanali, kurse me tjetrën nga rruga. Kishte shumë apartamente të banuar nga rrobaqepës, marangozë, kuzhinierë, vasha të përdala, nëpunës të vegjël, etj. Ditë e natë hynin e dilnin njerëz në të dyja portat. Shërbenin tre a katër roje shtëpie. Djaloshi u gëzua që nuk ndeshi asnjërin prej tyre dhe nxitimthi hyri në portën djathtas. Shkallët qenë të errëta, të ngushta, por i njihte mirë dhe një

mjedis si ky i pëlqente: as edhe syri më kurreshtar nuk paraqiste rrezik. "Në po më dridhen leqet e këmbëve tani, ç'do të më ndodhte sikur vërtet ta kisha bërë *atë punë*", - mendoi duke ngjitur shkallët për në katin e katërt. I zunë rrugën ca hamenj, ushtarë në lirim, që po nxirrnin mobiljet nga një apartament. E dinte që aty banonte një nëpunës gjerman me të shoqen e fëmijët. "Domethënë po u largoka, dhe në katin e katërt të kësaj shkalle mbetet i banuar për një kohë vetëm apartamenti i plakës. Mirë... Kjo duhet patur parasysh.." - mendoi dhe i ra ziles se apartamentit të plakës. U dëgjua një tringëllimë e lehtë, drithëruese dhe e mbytur. Të tilla ishin zilet e këtyre apartamenteve të vegjël. Ndonëse e harruar, tani kjo tringëllimë e veçantë diç i kujtoi, ia ngacmoi përfytyrimin, që filloi t'i punonte ethshëm...

U rrëqeth i tëri, nervat i kishte fare të dobësuara. Dera u hap vetëm një bërxhik: banorja po e shihte me dyshim e frikë, i rrezëllinin në errësirë dy sy zhbirues. Kur pa që në shkallë kishte shumë njerëz, mori zemër dhe e hapi fare derën. Djaloshi kapërceu pragun dhe u gjend në një korridor të errët, të ndarë në mes me dërrasa, matanë ishte kuzhina. Plaka qëndronte e heshtur dhe s'ia ndante shikimin pyetës. Ishte një plakaruqe kërcure gjashtëdhjetëvjeçare, e rrëgjuar, me ca sy shpues e të liq, me hundë të vogël shpatuke, me flokë të drejtë të lyer me vaj. Qafën të thatë dhe të hollë si këmbë pule e kishte të mbështjellë me një rreckë fanellate, krahëve kishte hedhur një jelek të strepëcuar, gëzof i dalëboje, që i lëkundej sa andej-këndej, ndonëse bënte shumë vapë. Tërë kohën kollitej e rënkonte. Dukej sheshit që djaloshi po e shihte në një mënyrë të pazakontë, ndaj dhe në sytë e plakës u shfaqën shenja mosbesimi.

- Jam Raskolnikovi, student; kam qenë këtu te ju para një muaji, - nëpërdhëmbi ngutshëm me një përkulje të lehtë, pasi i thirri mendjes që duhej të tregohej më i sjellshëm.

- Më kujtoheni, more djalë, më kujtoheni mirë, keni qenë, - belbëzoi shkoqur plaka, pa ia shqitur shikimin pyetës fytyrës së tij.

- Po ja... erdha për atë punën... - vazhdoi Raskolnikovi disi i turbulluar dhe i çuditur nga ky mosbesim i plakës.

"Po kjo ndoshta e tillë është gjithmonë, veç unë atëherë s'e paskam parë mirë", - tha me vete me një ndjenjë të pakëndshme.

Plaka heshti e menduar, pastaj u tërhoq mënjanë dhe, duke treguar për nga dera që të çonte në dhomë, i tha:

- Hyni, mor djalë.

Dhoma e vogël, ku shkeli djaloshi, me mure të veshur prej letre të verdhë, me perde kariçi dhe me saksi hidërshaje, ndriçohej fort nga dielli. "Pra, edhe *atëherë* do të ndriçoka dielli, ja, si tani!" - i vezulloi në mendje si vetvetiu Raskolnikovit, që s'iu durua sa ta përfshinte me një shikim të shpejtë tërë dhomën, me qëllim që ta nguliste sa më mirë në kujtesë vendosjen e sendeve. Po në të s'kishte asgjë të veçantë: mobiljet qenë të vjetra, prej druri të verdhë, kishte një divan të madh me shpinë prej druri, një tryezë ovale para divanit, një tryezë tualeti me pasqyrë të ngulur në mur, disa karrike në anët e murit dhe dy a tri tablo pa ndonjë vlerë në korniza po të verdha, ishin pikturuar disa gjermanka me zogj ndër duar. Asgjë më tepër! Në qoshe të dhomës, para ikonës, qe ndezur llamba. Binte sidomos në sy pastërtia e madhe: mobiljet dhe dyshemeja shkëlqenin, gjithçka llamburinte. "Duart e Elizavetës e mbajnë këtë pastërti", - tha me vete djaloshi. "Vetëm te vejushat plaka dhe të liga e gjen këso pastërtie", - vazhdoi të thotë dhe pa me bisht të syrit perden prej basme në derën që të çonte në një dhomë fare të vogël ku ndodhej shtrati i plakës dhe komoja, aty nuk kishte hyrë ndonjëherë. Pra, kishte vetëm dy dhoma.

- Përse urdhëruat? - shqiptoi rreptë plaka, pasi hyri në dhomë dhe qëndroi mu përpara tij që ta shihte mirë në fytyrë.

- Ju solla pengun! - Nxori nga xhepi një orë të vjetër petashuqe prej argjendi. Në faqen e pasme qe gdhendur një glob. Qosteku ishte prej çeliku.

- E ka mbushur afatin edhe pengu i mëparshëm. Ka tre muaj që i ka kaluar.

- Do ju lë edhe përqindjen e muajit, kini durim.

- Po ja, ç'më mbetet, more djalë: ose të pres me durim e dashamirësi, ose të shes pengun.

- Për orën sa do të më jepni, Alena Ivanovna?

- Me vogëlsira merreni, djalo, nuk ka ndonjë vleftë. Për unazën radhën që shkoi ju dhashë dy rubla, te kuinxhiu e ble për një rubël e gjysmë.

- Do më jepni katër rubla? Është e babait, nuk kam si jua lë

përgjithmonë, do gjej ca para këto ditë dhe do t'jua marr.

- Një rubël e gjysmë dhe përqindjen parapagim; në doni lëreni, në doni merreni.

- Një e gjysmë? - thirri i tmerruar djaloshi.

- Punë për ju! - Plaka i zgjati orën. Djaloshi e mori i sëkëlldisur aq shumë, saqë deshi të largohej, por aty për aty ndërroi mendje sepse nuk kishte nga ia mbante, pastaj kishte ardhur edhe për një punë tjetër.

- M'i jepni, - i tha prerë.

Plaka futi dorën në xhep për të nxjerrë çelësat dhe shkoi në dhomën tjetër prapa perdes. Djaloshi, që qëndronte në mes të dhomës, shihte dhe dëgjonte tërë sy e veshë si e hapi komonë. "Paratë i mbaka në sirtarin e parë, çelësat i mbaka në xhepin e djathtë... Në një vend i paska lidhur, në unazën prej çeliku... Njëri çelës qënka më i madh se të tjerët, ai me anë të dhëmbëzuara qenka çelësi i komosë... Duhet të ketë në sirtar ndonjë kuti ose... sënduk të vogël... çelësi i dytë për të është... Por ç'jam duke bërë? Sa punë e ndyrë është kjo që po mendoj...".

Plaka u kthye.

- Ja, mor djalë: nga dhjetë kopejka për çdo rubël në muaj, për një rubël e gjysmë do më jepni parapagim pesëmbëdhjetë kopejka. Keni edhe nga muajt e kaluar, bëhen tridhjetë e pesë kopejka gjithsej. Tani ju takon të merrni për orën një rubël e pesëmbëdhjetë kopejka. Ja ku i keni.

- Pse, kaq do marrkam?

- Po, kaq.

Djaloshi s'e zgjati, i mori paratë. E mati plakën me sy dhe s'po ngutej të dilte, si të dëshironte diç të thoshte apo të bënte, por që as vetë nuk e dinte se çfarë.

- Këto ditë do ju sjell edhe një plaçkë tjetër, Alena Ivanovna... të argjendtë... të çmuar... kuti duhani... Do ta marr të një mik... - tha kështu dhe u turbullua aq shumë, sa s'mundi të vazhdonte më tej.

- Atëherë flasim.

- Lamtumirë... Po ju si, vetëm rroni. S'keni njeri tjetër këtu, ndonjë motër?... - e pyeti sa më shkujdesshëm që mundi, kur doli në koridor.

- Po juve ç'ju duhet si rroj?

- Jo, ashtu kot pyeta! Domethënë tani... Lamtumirë, Alena Ivanovna!

Raskolnikovi doli shumë i tronditur. Kur po zbriste shkallët, ndaloi disa herë, pa përreth si i fandaksur. Doli në rrugë dhe nga kraharori që i ngulçonte i dolën këto fjalë: "O Zot! Ç'poshtërsi! Mos unë... Jo, jo, e pamundur. Si më erdhi në mendje një tmerr i tillë? Me ç'fëlliqësi po u pajtoka zemra ime! E poshtër është, e ndyrë, e ulët... Dhe kam një muaj plot që...".

S'gjente fjalë dhe pasthirrma për të shprehur lemerinë që e kishte pushtuar. Pështirosja dhe neveria, që po ia ndrydhnin fort zemrën, dhe e kishin bërë t'i përzihej që nga çasti kur ishte nisur për te plaka, përftonin tani të tilla përmasa të cilat po e mundonin aq fort, saqë nuk dinte ku të futej prej ankthit. I merreshin këmbët si i dehur, përplasej me kalimtarët pas çdo hapi që hidhte dhe mezi e mblodhi veten kur doli në rrugën tjetër. Ngriti kryet dhe pa se ndodhej përpara një pijetoreje, aty hyhej nga trotuari nëpër ca shkallë që zbrisnin poshtë, në tavernë. Që andej po dilnin dy të dehur që mbaheshin pas njëri-tjetrit dhe shaheshin. Raskolnikovi nuk e zgjati shumë, zbriti shkallët. Nuk kishte qenë ndonjëherë në kësi pijetoresh, por i vinte koka vërdallë dhe kishte etje të padurueshme. Ia kishte ënda të pinte një birrë të ftohtë, për më tepër dobësia që ndiente mund të shpjegohej me pangrënien. Qoshja ku u ul, një vend me shumë igrasi, tryezën e kishte të fëlliqur dhe të mbuluar me një si jargë; porositi birrë dhe e piu me ashk gotën e parë. Befas u ndie i lehtësuar dhe koka iu kthjellua koka. "Gjepura janë të tëra, - u mundua të qetësonte veten. - S'kisha pse e humbja ashtu toruan! M'u prenë fare fuqitë, por ama mjaftoi kjo gotë birrë dhe një peksimadhe e më erdhi në vend shpirti. Edhe pikësynimet m'u qartësuan! Ptu, ç'poshtërsi!... " Edhe pse i doli ashtu vetiu ajo pështymë neverie, gjërat zuri t'i shihte i çliruar nga një brengë dhe leqendisje e madhe. Tani të pranishmit në atë tavernë po i shihte më gëzueshëm e më dashamirësi. Veç, prapëseprapë ishte i vetëdijshëm që edhe ky shikim dashamiri nuk qe diçka e natyrshme.

Në pijetore nuk kishte shumë njerëz. Pas dy të dehurve të parë, doli një grumbull prej pesë vetësh, me një vashë në mes dhe me fizarmonikë. Pasi u larguan dhe këta, ra qetësi. Kishte mbetur te banaku një i dehur me gotën e birrës përpara, pranë tij qëndronte i

Erjonixx

mbështetur fort pas banakut shoku i tij trashaluq, trupmadh, me mjekër të thinjur, i dehur tapë, që dremiste me kokën mbështetur në banak dhe, ashtu i përgjumur, herë pas here drejtonte trupin, kërciste gishtat dhe diç mërmëriste duke zvarritur ca vargje:

Kam një vit që jam martuar,
Një vit plot dhe i gëzuar.

Bënte pak pushim, zgjohej përsëri dhe vazhdonte:

Shkova mbrëmë për gosti
Në të parën-o shtëpi.

Por askush nuk i shkote pas, miku që kishte pranë, madje, e pa me dashakeqësi. Ishte edhe një tjetër, me ç'dukej, një nëpunës i pushuar nga puna. Rrinte mënjanë të tjerëve, pinte nga pak dhe shihte rreth e rrotull. Dukej që e mundonte një brengë e madhe.

II

Raskolnikovit nuk i pëlqente as gjindja e as rrëmuja, kurse kohët e fundit, siç e vumë në dukje, përpiqej t'i shmangej çdo lloj takimi me njerëzit. Befas tani ndjeu nevojë të brendshme ai vetë për t'u afruar me ta. Ishte diçka e re në sjelljen e tij. Qe lodhur e drobitur nga trishtimi dhe përqendrimi i vazhdueshëm i vëmendjes, nga ajo tendosje e zymtë që s'po i ndahej kohët e fundit. Ndjeu një dëshirë për të marrë frymë lirisht në një mjedis tjetër, cilido që të ishte, ndaj u shtrua me kënaqësi edhe pse mejhaneja ishte për ibret.

Pronari zakonisht rrinte në një dhomë tjetër, por vinte herë pas here, duke zbritur disa shkallë të ngushta: në fillim i dukeshin çizmet e lustruara për bukuri, pastaj jeleku prej akllazi i zhyer e i lerosur për tmerr, këmisha pa kollaro, fytyra si një dryn i lyer me vaj. Në banak shërbente një djalë katërmbëdhjetëvjeçar, kurse një tjetër qëndronte i gatshëm për të bërë çfarë t'i kërkohej. Kishte tranguj të prerë copa-copa, peksimadhe të zeza dhe copa peshku të skuqur, që kutërbonin

një erë të padurueshme. Të merrej fryma deri në asfiksi, të mbyste era e vodkës aq shumë sa të dukej që do ta ndieje veten të dehur pas pak.

Rastis që të del përpara një i panjohur dhe ende pa shqiptuar mirë fjalët e njohjes hyn me të në bashkëbisedim të beftë. I tillë qe takimi i Raskolnikovit me nëpunësin e pushuar nga puna që rrinte në mejhane. Djaloshi e ndërmendi jo një herë më pas këtë takim dhe kurdoherë e lidhte me parandjenjat që kishte provuar. Ia nguli shikimin atij njeriu, sigurisht, ngaqë edhe ky nuk po ia shqiste; dukej i ndezur nga ëndja për t'i hapur muhabet. Të tjerëve, duke përfshirë edhe pronarin e mejhanes, ky as që ia varte trastën, madje në rastet kur ishte i detyruar, i shihte me kryelartësi të pafshehur, e përbuzje këta njerëz jo të sërës së tij, me të cilët as ia vlente të merrte e të jepte. Ishte rreth të pesëdhjetave, me shtat mesatar, truplidhur, me flokë të rrallë që i thinjeshin, me fytyrë mullace e të zbehtë nga dehja e përhershme, kapakët e syve i kishte të ënjtur, brenda tyre lëvrinin si tehe brisku dy sy të kuq plot gjallëri. Seç kishte diçka të çuditshme në këtë njeri: fytyra dhe sytë i shprehnin entuziazëm, por dukej njëherazi dhe shumë i menduar, në sytë hera-herës s'ishte zor t'i diktoje shënja çmendurie. Kishte veshur frak të perdorur, fare të rrënuar dhe të grisur, me komça të rëna. Vetëm njëra mezi mbahej dhe me të e kishte mbërthyer, për të ruajtur sadopak pamjen e duhur. Prapa jelekut prej cohe kërpi të zverdhur i dukej këmisha e mbledhur shuka-shuka, e fëlliqur dhe e lagur. Fytyrërruajtur siç e kanë nëpunësit, por ama të lënë pas dore, tani e mbulonin qime të thinjura. Edhe lëvizjet, edhe sjelljen i kishte tipike nëpunësish, të përmbajtura dhe të kujdesshme. Dukej shumë i shqetësuar, rrinte-rrinte dhe u jepte lart flokëve, e mbështeste kokën në pëllëmbët e duarve, duke i vënë bërrylat e grisur mbi tryezën e ndotur dhe të jargavitur, dhe qëndronte ashtu i trishtuar. Më në fund e pa Raskolnikovin drejt në sy dhe i foli me zë të lartë, të sigurt.

- A mundem, zotëri mëshirëplotë, t'u drejtohem me një bisedë njerëzish të fismë? Se, ndoshta, pamjen nuk e keni kushedi çfarë, por përvoja më jep të drejtën t'u quaj njeri me shkollë dhe të pa mësuar në punë pijesh. E kam respektuar kurdoherë arsimin të shoqëruar nga mirësjellja dhe përzemërsia se dhe vetë jam këshilltar i titulluar.

Më quajnë Marmelladov. Marr guximin t'u pyes: shërbeni kund?

- Jo, jam student... - iu përgjegj djaloshi, i habitur edhe nga gjuha plot spërdredhje, me të cilën i qe drejtuar, por edhe nga mënyra si e shihte. Para pak kohësh kishte dashur të fliste me ndokënd, pavarësisht se kush ishte, por kur kjo ndodhi, në çast ndjeu tjetërsimin dhe nervozizmin që orvateshin të hynin me të në marrëdhënie. Kjo ndjenjë s'po i ndahej kohët e fundit.

- Domethënë student, apo më mirë ish-student! - thirri nëpunësi. - I paskam rënë pikës! Përvoja, i nderuar zotëri, përvoja e madhe! - tha kështu dhe ngriti lart me mburrje gishtin tregues. - Keni qenë student apo njeri i dhënë pas studimeve shkencore! Më lejoni... - U çua, iu morën këmbët, rrëmbeu shishen e pijes, gotën dhe iu ul pranë djaloshit, por jo përballë, në brinjë. Kishte pirë, por fliste rrjedhshëm dhe shpejt, vetëm në të rrallë ngecte dhe i zvarriste fjalët. E vërshoi Raskolnikovin me një lumë fjalësh, si të mos kishte folur edhe ai muaj të tërë me njeri.

- Zotëri mëshirëplotë, - filloi thuajse solemnisht. - Vobekësia nuk është mëkat, kjo është e vërtetë. E di që edhe dehja nuk është virtyt, aq më keq. Kurse varfëria, i plotmëshirshmi zotëri, varfëria është ves. I vobegtë mund ta ruash fisnikërinë e lindur, i varfër jo! Të varfërin as me shkop s'e dëbojnë, atë e fshijnë me fshesë, nuk duan as bojën t'ia shohin në shoqërinë e njerëzve, kënaqen kur e fyejnë. E pret dehja! I nderuar zotëri, muajin që shkoi time shoqe e rrahu zoti Lebezjatnikov dhe ajo, kuptohet, nuk është unë. E qartë? Më lejoni t'u bëj një pyetje, qoftë nisur vetëm nga kureshtja: a keni fjetur ndonjëherë në Nevë, në barkat e atjeshme?

- Jo, s'më ka rastisur, - iu përgjigj Raskolnikovi. - Pse si është puna?

- Unë aty fle, është nata e pestë që fle...

E mbushi gotën, e ktheu dhe ra në mendime. Vërtet që në rrobat dhe në flokët i kishin ngecur fije bari. Kishte të ngjarë që pesë ditë as nuk ishte larë e as nuk i kishte zhveshur rrobat. Sidomos duart i kishte zhul i gjallë, tërë palavi, me thonj të pistë.

Biseda e tyre, me sa dukej, tërhoqi vëmendjen e të tjerëve, ndonëse reagimi nuk ishte kushedi sa i ndjeshëm. Vetëm djelmoshat zgërdhiheshin, qeshnin nën hundë, kurse pronari i tavernës, që ishte ulur pak më tutje, gogësinte heshturazi. Tani ia vuri veshin "ojnatarit".

Dukej që Marmelladovin e njihnin, ia dinin dobësinë që kishte për t'u spërdredhur kur fliste. S'ishte hera e parë që e dëgjonin të fliste me myshterinjtë e tavernës. Te pijanecët ky ves shndërrohet në kërkesë, sidomos kur të afërmit dhe njerëzit e shtëpisë s'i lënë të hapin gojën në rrethin e tyre. Në mjediset e pijanikëve këta tipa orvaten të përligjin veprimet gjithfarëshe dhe paudhësitë, në u shkoftë, sigurojnë ndopak respekt për personin e tyre.

- Ojnatar është! - tha me zë të lartë pronari i tavernës. - E pse nuk punon. Përse nuk shërben kund, në qënke nëpunës?

- Përse nuk shërbej, thoni, zotëri i plotmëshirshëm? - u kap pas fjalës Marmelladovi, duke iu drejtuar vetëm Raskolnikovit, si të kishte qenë ky ai që ia bënte pyetjen. - Përse nuk shërbej? E si pandehni ju, a nuk më dhemb zemra që e kaloj kohën arut? Kur zoti Lebezjatnikov muajin që shkoi ngriti dorën kundër time shoqeje dhe e rrahu paq, isha i dehur tap. E si s'më dhimbte zemra? Më falni, djalosh, a ju ka ndodhur që... po ja, të kërkoni para hua pa shpresën më të vogël se do t'ju japin?

- Më ka ndodhur... po ç'domethënë pa shpresën më të vogël që s'do t'ju japin?

- Po ja, pa shpresën me të vogël! Duke e ditur që më parë se nuk kanë për t'ju dhënë. Fare mirë e di që filan qytetar, njeri shpirtmirë dhe mëshirëplotë, në asnjë mënyrë nuk do t'ju japë asnjë kopejkë! Se ju pyes, përse t'u japë juve? E di që nuk keni për t'ia kthyer kurrë! Nga mëshira? Po zoti Lebezjatnikov, që rendet pas mendimeve të reja, më ka thënë një herë që mëshira në kohën tonë qënka e ndaluar, madje dhe nga shkenca, kështu qënka në Angli ku veproń ekonomia politike. Pra, ju pyes, përse të të japë? E, duke e ditur fort mirë këtë, ju prapëseprapë niseni për rrugë...

- Po përse duhet vajtur? - e pyeti Raskolnikovi.

- Nëse nuk ke ku të përplasësh kokën, si t'ia bësh? Se i shkreti njeri s'bën dot pa u mbështetur diku, ka raste kur patjetër i duhet drejtuar dikujt! Se ja, kur ime bijë, e kam të vetme, doli në rrugë të madhe, unë i shkova pas... (ajo edhe tani ashtu rron), - shtoi, duke e parë i merakosur djaloshin. - Por s'ka gjë, mor zotëri i mirë, s'ka gjë! - nxitoi të shpjegohej me gjakftohtësi të shtirë, sepse i pa si shtrembëruan turiçkat djelmoshat dhe i zoti i tavernës qeshi nën

hundë. - S'ka gjë! Që zgërdhiheni asisoj, s'prish punë, e fshehta nuk është më e fshehtë, njerëzia e dinë; sa për mua, të tëra i shoh me përbuzje, me çdo gjë jam pajtuar. Le të bëjnë si t'u vijë! Djalosh, më lejoni t'ju pyes: a mundeni vallë... Por jo, më e goditur dhe më e efektshme do të ishte t'u pyesja: jo *a mundeni*, por a *guxoni*, duke më parë, ja, kështu, të thoni me plot gojën që nuk qënkam derr?

Raskolnikovi nuk shqiptoi as edhe një fjalë.

- E po, - vazhdoi oratori me një dinjitet tanimë të përforcuar, pasi priti fundin e së qeshurës së përgjithshme. - Kështu, pra, qofsha derr, por ama ajo është zonjë! Unë turinj egërsire kam, ndërsa ajo, Katerina Ivanovna, ime shoqe, është me shkollë, është bijë oficeri shtabi. Qofsha maskara, ajo është njeri me zemër të madhe, me ndjenja fisnike, me edukatë e kulturë. Ndërkaq... Ah! sikur të kishte patur një çikë mëshirë për mua! Zotëri mëshirëplotë, i nderuar zotëri, por duhet të gjendet për njeriun makar edhe një qoshe ku ta mëshirojnë! Kurse Katerina Ivanovna, ndonëse zonjë me shpirt të madh, është e padrejtë... E kuptoj që edhe kur zë e më shkul flokët, e bën nga keqardhja, (jua përsëris pa m'u skuqur fare faqja, djalosh, se ajo m'i shkul flokët, - e përforcoi me një dinjitet të fryrë pasi kishte pritur të rreshteshin të qeshurat), por çdo të ndodhte sikur qoftë edhe një herë... Po, jo! Jo! Kot e kam që ankohem: jo një herë e kam patur të dëshiruarën, jo një herë më kanë mëshiruar, por s'ke ç'bën.... i tillë qënkam prerë; një dele që ka lindur e zezë, e zezë do ngordhë!

- Domosdo! - ia përforcoi mendimin që shprehu i zoti i mejhanesë dhe gogësiu.

Marmelladovi i ra me grusht tryezës.

- I tillë qenkam prerë! Por a e dini, mor zotëri, që deri çorapet ia kam pas shitur dhe paratë i piva? Këpucët hajde de, gjëra që kanë ndodhur, por çorapet ia shita! Një shall të mirë prej leshi keci që e kishte dhuratë, edhe atë ia shita! Banojmë në një vrimë të ftohtë, mori plevitin dimrin që shkoi, nuk iu nda kolla, pështyu dhe gjak. Kemi dhe tre fëmijë të vegjël. Katerina Ivanovnës i bie bretku në punë nga mëngjesi gjer në darkë, vjen merret edhe me kalamajtë, i lan dhe i ushqen, që e vogël ka qenë mësuar me pastërti e rregull. E shoh çdo ditë po e lënë fuqitë, është goxha e sëmurë. Si nuk e ditkam? Dhe sa më shumë që pi, aq më tepër në zemër më pikon. Si nuk e

ndjekam? Po unë ndaj dhe pi, sepse me anë të dehjes kërkoj të gjej mëshirë dhe ndjenjë... Pi se dua të vuaj me tamam! - Si në makth e përkuli kokën mbi tryezë.

- Djalosh, - vazhdoi, duke e çuar përsëri. - Në fytyrën tuaj shoh të përqendruar një trishtim. Me të hyrë e vura re, ndaj dhe ju drejtova. Edhe historinë e jetës ndaj dhe jua kallëzova, jo për t'u bërë me turp përpara këtyre të paudhëve që vetëm dinë të zbardhin dhëmbët, ndonëse të tëra këto kanë kohë që i kanë dëgjuar. Unë para njeriut me shkollë dhe me zemër vendosa të rrëfehem, kam kohë që e kërkoj një të tillë. E dini që ime shoqe, Katerina Ivanovna, ka marrë edukatë në institucion fisnikësh të gubernës dhe mori pjesë në shfaqjen që u dha para gubernatorit me rastin e përfundimit të mësimeve, me medalie ari dhe me fletë lavdërimi e mbaroi. Medalien... po doemos që e shitëm... ka kohë... hm... kurse fleta e lavdërimit edhe sot e kësaj dite ruhet në baule. E nxora dhe ia kallëzova para pak kohe pronares së shtëpisë. Shkojmë si macja me miun, po ja që ma desh qejfi të mburresha para ndokujt, t'i tregoja për ato ditë të lumtura që shkuan e vanë. Është gjëja e fundit e mirë që i ka mbetur nga kujtimet, më pas jeta i mori të tatëpjetën! Po, po, të tatëpjetën! Është grua gjaknxehtë, krenare dhe e pamposhtur. Vetë lan e shpëlan, rron me bukë e kripë, por nuk lë njeri ta fyejë, ta marrë nëpërkëmbë. Ajo dhe zotit Lebezjatnikov prandaj ia punoi, nuk donte t'ia falte harbutërinë, dhe jo aq nga rrahja sesa nga inati e fyerja zuri shtratin. E kam marrë vejushë me tre fëmijë, njërin më të vogël se tjetrin. Burrin e parë e kishte oficer këmbësorie, qenë martuar me dashuri, e kishte rrëmbyer. Duheshin shumë por qe i dhënë pas kumarit, e kishin nxjerrë edhe në bangon e të akuzuarve, s'kishte kaluar shumë dhe kishte vdekur. Kishte provuar ta qëllonte, por kjo nuk i kishte lëshuar pe, e di mirë nga burime të sigurta. Rri-rri dhe ma qok atë jetë të bukur që ka bërë, me lot në sy flet, kurse mua më bëhet zemra mal: qoftë në kujtimet ndihet e lumtur... Pas vdekjes të të shoqit, mbeti me tre camërdhokët në një qytet të largët, vend i egër; aty e njoha. Rronte në një varfëri të tillë, që s'rrëfehet dot e që s'më kanë zënë sytë ndonjëherë! Prindët e kishin bërë hasha; ajo po krenare s'ndihej përsëgjalli, nuk u çonte lajm... Edhe unë, mor zotëri i mirë, vejush isha, me gruan e parë kisha një vajzë katërmbëdhjetë vjeçe; i propozova të martoheshim, e pashë që

ashtu s'rrohej. Aq keq ishte, saqë edhe pse më shkollë dhe nga derë e mirë, pranoi të martohej me mua! Vumë kurorë. Kishte qarë sa kishte plasur, qe lebetitur e qe lemerisur sa kishte dashur, por për t'u martuar pranoi! Nuk kishte nga ia mbante. E kuptoi, mor zotëri mëshirëplotë; nuk kishte nga ia mbante! Jo! Këtë ju ende s'mund ta kuptoni... Një vit i kreva më së miri detyrimet familjare, me fisnikëri dhe me besë, s'vura në gojë as edhe një pikë nga kjo (preku me gisht shishen e vodkës). Jam njeri me ndjenjë! Kur, do ti, më nxorën nga puna, jo për ndonjë faj, por për ca ndryshime që u bënë në administratë. Atëherë dhe s'durova dot!.. Ka një vit e gjysmë që erdhëm pas sa e sa peripecive në këtë kryeqytet të mrekullueshëm, të stolisur me sa e sa monumente madhështore. Gjeta dhe punë... Por ashtu si e gjeta, e humba. E kuptoni? Dhe e humba për mendtë e kokës!... Tani rrojmë në atë vrimën që na e ka lëshuar me qira Amali Fedorovna Lipevehzel, por me se e mbajmë frymën dhe si arrijmë ta lajmë qiranë, një Zot e di. Ka dhe qiraxhinj të tjerë... Sodom i vërtetë, palavi që s'rrëfehen dot!... Vajza po m'u rrit, ajo që kam me gruan e parë; ç'ka hequr ajo çupë nga njerka, varrit do ia tregojë... Se Katerina Ivanovna vërtet është grua me shpirt të gjerë, por është nevrike e madhe, në gjaknxehtësi e sipër ç'nuk bën. Por nejse... Sonja, kuptohet, nuk mori ndonjë shkollë kushedi çfarë. U mundova, para katër vjetësh, t'i mësoja historinë dhe gjeografinë, por meqë edhe vetë s'para ia thosha, po dhe libra për të qënë nuk gjeta, në dreq vafshin dhe ato libra... hm... kështu që si nisi, bitisi ajo punë. I vumë pikë te Kiri i Persisë. Kur u bë në moshë, Sonja vetë lexoi disa libra me frymë romantike, kurse para pak kohe me ndihmën e zotit Lebezjatnikov lexoi "Fiziologjinë" e Luisit, - mos kushedi e dini? - E lexoi me qejf të madh, na lexonte edhe ne ndonjë copë; ja kjo është e gjithë shkolla që ka bërë. Tani më lejoni, zotëri mëshirëplotë, t'u drejtohem me një pyetje private: a mund të fitoj diçka një vashë e ndershme me punë të ndershme?... As pesëmbëdhjetë kopejka në ditë s'i zë dot, në qoftë e ndershme dhe pa ndonjë talent të veçantë. Edhe Kllopshtoku, Ivan Ivanoviçi, - mos e njihni gjë atë njeri? - jo vetëm që s'i pagoi paratë për këmishët e qepura, për ato holandezet, por e zboi duke e fyer, duke iu hakërruar, madje e sikterisi me fjalë rrugësh; i tha se gjoja jakat qënkan qepur të vogla dhe shtrembër. Mezi i prisnim ato para, fëmijët nuk kishin për

të ngrënë... Katerina Ivanovna vërtitet nëpër dhomë si e lojtur, vë kujën, njollat e kuqe po i mbulojnë fytyrën dhe qafën, e ka nga sëmundja, thërret me sa ka në kokë: "Po të mbajmë me bukë, po ha e po rri dhe as që e çan kokën për asgjë!". E ç'të ngrënë zeza, kur vocërrakët kishin tri ditë pa ngrënë? Isha në këtë kohë... ç'të them...i dehur fare... Dëgjoj t'i thotë Sonja ime (s'ka goje fare, edhe zëri kur flet, i del si i ngjirur... fytyrën e ka të zbehtë, flokët e verdhë, vjen e imët nga shtati), e pra, i thotë: "Po, Katerina Ivanovna, meqë shkoi puna deri këtu?". Kurse Daria Francovna, një grua shpirtkazmë, njeri i hurit dhe i litarit, që ia kanë dëgjuar kakërrimën dhe ata të policisë, u interesua dy a tri herë nëpërmjet pronares së shtëpisë. "E pse u dashka ta ruajmë, mos është ndonjë xhevahir?" - u tha Katerina Ivanovna me qesëndi. Veç nuk keni pse e bëni me faj, i nderuar zotëri. Nuk ishte në vete, kur e tha, ishte fare e çakërdisur dhe e ndërkryer, se edhe sëmundja bën të vetën, fëmija po qanin për të ngrënë; pastaj e tha më tepër për ta bërë me sedër vajzën e jo në kuptimin e keq. Katerina Ivanovna të tillë karakteri ka, merr flakë për hiçmosgjë. Edhe fëmijët kur qajnë, qoftë edhe nga uria, në vend që t'i qetësojë, zë e i rreh. Ora ishte gjashtë. Sonjeçka çohet, hedh shaminë në kokë dhe del se për ku; kthehet rreth orës nëntë. Me të hyrë, i vë mbi tryezë para Katerina Ivanovnës, të tridhjetë rublat, pa folur as dhe një fjalë, pa i hedhur as sytë; mori vetëm shallin e madh bojë bari, e hodhi në kokë, mbuloi edhe fytyrën dhe u shtri në krevat, me fytyrë nga muri, supet dhe trupi i dridheshin dhe i rrëqetheshin... Kurse unë rrija shtrirë, si dhe një ditë më parë, i dehur.. Pashë, more djalosh, sesi Katerina Ivanovna, ashtu heshturazi, iu afrua Sonjeçkës, e pushtoi fort dhe e mbajti të përqafuar disa kohë, pastaj u lëshua në gjunjë para vajzës dhe zuri t'i puthte këmbët, u çua, u platit pranë saj dhe, ashtu të mbledhura që të dyja shuk, i zuri gjumi. Po... që të dyja... kurse unë... rrija shtrirë i dehur.

Marmelladovi heshti si t'i ishte prerë zëri. Mbushi nxitimthi gotën, e ktheu, u kollit.

- Që nga ajo ditë, zotëri, - vazhdoi pas një heshtjeje të shkurtër, - në ca rrethana aspak fatlume, e spiunuar edhe nga disa keqdashës, (që dora e Daria Francovnës në atë mes), pra, që nga ajo kohë ime bijë, Sonja Semionovna, mban me përdhunë biletën e verdhë dhe nga

ky shkak nuk mund të rrojë më bashkë me ne. Se edhe pronarja, Amali Fedorovna, nuk e pranon të vijë, as zoti Lebezjatnikov... Janë lidhur me fjalë me Daria Francovnën. Edhe grindja e Katerina Ivanovnës me Lebezjatnikovin ndaj dhe ndodhi, për shkak të Sonjës. Pasi përfitoi nga ajo gjendje e Sonjës, zuri të çirret e të ngjiret se nuk mund të rronte nën një çati me të, se ishte njeri me namuz dhe me shkollë. Katerina Ivanovna i doli zot vajzës... ndodhi ajo që ndodhi... Tani Sonjeçka duket te ne vetëm në muzg, gjithë sa mbledh ia dorëzon Katerina Ivanovnës, ia lehtëson jetesën familjes. Banon në një nga apartamentet e rrobaqepësit Kapernaumov, i ka dalë nami për ters njeri, e tillë është edhe familja e tij e madhe. Sonja ka dhomën e saj... U çova të nesërmen e asaj që ndodhi, vesha këto zhele, iu fala dhe iu luta perëndisë dhe e mbajta frymën drejt e te lartëmadhëria e tij Ivan Athanasoviçi. E njihni kush është? Nuk e njihkeni! Shpirt njeriu është, i vjen keq për tjetrin! Dyllë që ruan gjurmët e bëmave të Zotit është! Sy e vesh bëhet, kur zënë e i flasin për hallet e njerëzve! U përlot kur më dëgjoi. "E po, - më thotë - Marmelladov, një herë më zhgënjeve me atë që bëre.. Po të marrë edhe kësaj here, duke e ngarkuar veten me përgjegjësi. - Kështu më tha. - Mos e harro këtë, shko tani!". I putha vendet ku shkelte këmba e tij, mendërisht, kuptohet, sepse në të vërtetë një si ai njeri me mendime të reja përparimtare dhe i veshur me pushtet të lartë shtetëror, nuk kishte për ta lejuar. E mbajta frymën drejt e në shtëpi. Kur u thashë se ma kishin kthyer përsëri vendin e punës dhe rroga do ishte rrogë, o Zot, ç'gëzim që i pushtoi të gjithë!...

Marmelladovi ndali përsëri tejet i emocionuar. Në këtë kohë ia behu nga rruga një lukuni pijanikësh dehur e bërë xurxull, u dëgjua organeti dhe zëri i një djalthi shtatë vjeç. Qetësia e tavernës u prish. Pronari dhe djelmoshat brofën t'u shërbenin klientëve. Marmelladovi pa e çarë kokën për gjithë sa ndodhte, vazhdoi tregimin. I qenë prerë fare fuqitë, por sa më shumë dehej, aq më fjalaman bëhej. Kujtimi për arritjen e vendit të punës e gjallëroi, i shfaqej edhe në fytyrën që i llamburiste. Raskolnikovi e dëgjonte me vëmendje.

- Ndodhi pesë javë të shkuara. Me ta marr vesh si Katerina Ivanovna, si Sonjeçka, Zot i madh, sikur unë nuk isha unë, por ishte një tjetër, i selitur në mbretërinë qiellore. Më parë, kur i vija i dehur, kumbisesha në ndonjë cep dhe s'ndihesha më i gjallë, vetëm sharje e

mallkime dëgjoja! Po tani? Ecnin para meje në majë të gishtave, fëmijët i qortonin që të mos bënin potere. "Semion Zahariçi ka ardhur i lodhur nga puna, duhet të pushojë, shët!". Më bënin kafe para se të dilja nga shtëpia, hidhnin brenda edhe ajkë! Kajmakun e blinin nga më i miri, kafenë nga më e shtrenjta! Çizmet po çizme, këmishët si kartë cigari, jakat të kollarisura, rrobet po shik, të kishte lezet shpirti! Kthehesha në drekë pas shërbimit, Katerina Ivanovna na gatuante të parë e të dytë, të shijshme që të lëpije gishtat, s'kisha provuar kurrë ndonjëherë gjellë aq të shijshme. Fustane për të qenë, për të bërë vizita te miqtë, ajo nuk ka patur, por ta shihje si sajonte e rregullonte veshje të bukura, bluzës së vjetër i bënte jakë të re, flokët i krihte ashtu si i shkonin më mirë, tualetin e bënte tualet, tjetër njeri dukej, e rinuar, e zbukuruar. Sonjeçka, pëllumbesha e babait, që na ndihmonte me para, tha se hë për hë nuk do vinte te ne, s'ishte mirë për ne, vetëm në të rrallë do të dukej, kur të binte muzgu, fshehurazi, vetëm sa për të na parë. Dëgjoni, dëgjoni... Desha të shtrihesha një herë pas buke, po ç'ndodhi, thoni ju? Katerina Ivanovnës nuk iu durua: me Amali Fedorovnën s'kishte një javë që ishte grindur e ishin përfolur, kur, do ti, tani e kishte thirrur për kafe. Dy orë çuçuritën ashtu kokë më kokë: Semion Zahariçi tani është rrogëtar, me lartësinë e tij e lidh puna, hyn e del në kabinetin e tij orë e çast. Semion Zahariç, i paskej thënë, i njoh mirë meritat tuaja, vetëm se ratë viktimë e dobësisë për pijen, tani që më keni dhënë fjalën, i kemi vënë pikë atij muhabeti; se dhe punët e zyrës nuk para më shkojnë si duhet, shpresat te ju i kam (po dëgjoni, de!). Tërë këto vetë i shpifi dhe jo nga mëndjemadhësia, jo, thjesht për t'u dukur! Ajo e besonte, kështu qetësonte veten, jua them unë këtë! S'ishte për t'u qortuar, jo!... Kur pas gjashtë ditësh i dorëzova rrogën e parë, njëzetë e tre rubla e dyzetë kopejkat ia numërova në dorë, më quajti buburreze. "Ah ti buburreze!" - më tha. Ishim të dy vetëm kur ma tha. E kuptoni këtë? Se nuk shquhem për nur, e ç'bashkëshort jam! Kurse ajo më zuri për faqe. "Si buburreze më je!" - më tha.

Marmelladovi ndali, u përpoq të vinte buzën në gaz, por mjekra iu drodh, ndërkohë që sforcohej ta ndalonte. Mejhaneja mosmëkeq, me pamjen mjerane të vriste, pesë netët kaluar në barkat e Nevës dhe, në të njëjtën kohë, ndjenjat e sëmura që i shfaqte për të shoqen e familjen,

Raskolnikovi nuk po mundte dot t'i trupëzonte, dukej disi i çoroditur. E dëgjonte i përqendruar, por me një hutim të dukshëm. Mallkonte veten që kishte hyrë në këtë pijetore.

- Zotëri mëshirëplotë, zotëri i plotmëshirshëm! - thirri Marmelladovi pasi e mblodhi veten. - Ah, i nderuar, mos kushedi ju duket qesharake kjo që po tregoj, siç ju duket këtyre të tjerëve? Ndoshta dhe po ju bezdis me këto cingërima të një jete mizerabël, por mua më pikon zemra gjak!... Se dhe vetë unë tërë ato ditë si në parajsë kam qenë, ato mbrëmje si në përrallë kam jetuar. Ç'ëndrra të mrekullueshme nuk thura për jetën që më priste; mendoja si t'i rregulloja sa më mirë kalamajtë, si t'i vishja e t'i ngjishja, si t'ia qetoja shpirtin gruas dhe time bijë ta ktheja përsëri në gjirin e familjes... E ku kishin të sosur ëndrrat e mia! ... Dhe me hak, zotëri! Por çfarë t'ju them, mor zotëri i nderuar! (Marmelladovi sesi u mrrudh e u mpak, i dha përpjetë kokës dhe e pa drejt në sy dëgjuesin). Jo larg, por të nesërmen e këtyre ëndërrimeve (plot pesë ditë më parë), në mbrëmje, tinëz ia mora çelësin e sëndukut Katerina Ivanovnës, mora gjithë ç'kishte mbetur nga rroga, sa nuk më kujtohet, dhe ja ku më keni, shihni e shkruani! U bënë pesë ditë që jam bërë firar nga shtëpia, të mitë më kërkojnë, shërbimi shkoi e vate, edhe kostumin e lash rehen në pijetoren te Ura Egjiptiane, ata m'i dhanë këto rrobe... Mori fund çdo gjë!

Marmelladovi i ra me grusht ballit, kërciti dhëmbët për lemeri, mbylli sytë dhe u mbështet fort me bërryla në tryezë. S'kaloi as edhe një minutë, dhe fytyra i mori një tjetër pamje, me një dhelpëri të shtirë dhe me një paturpësi të stisur ia qepi shikimin Raskonikovit, u ngërdhesh, i tha:

- Isha te Sonja sot, i kërkova të më jepte sa për një gotë! He! He! He!

- Ju dha? - thirri një nga të posaardhurit që qëndronte mënjanë; e pyeti dhe ia plasi gazit.

- Ja, këtë që shihni këtu me ato para e bleva! - iu përgjigj Marmelladovi, duke iu drejtuar vetëm Raskolnikovit. - M'i numëroi në dorë tridhjetë kopejkat e fundit që kishte, e pashë me këta sy.. Nuk më tha as dhe një fjalë, vetëm më hetoi heshturazi... Se jo këtu në tokë, por atje... merakosen dhe qederosen për njerëzit dhe nuk i qortojnë, nuk i fajësojnë! Të lëndojnë më shumë ama; po, po, më

shumë! Tridhjetë kopejkat e fundit më dha. Kurse asaj i duheshin ato? Ç'thoni ju për këtë, i nderuar zotëri? Se nuk është pa shpenzime ajo punë që bën, lipsen para, e kuptoni? Se i duhet të kujdeset për higjienën. Jo pomada, kotulla të kollarisura, këpucë lustrafine, që kur të kërcejë ndonjë pellg, t'ia tregojnë bukur këmbën, e ç'nuk i duhet asaj!... Pastërtia po që të mos ketë të sharë! Kur do ti, babai që të ka bërë kokën të vjen e të kërkon tridhjetë kopejkat e fundit për vodkë! Dhe po pi! I harxhova të tëra!... E kujt mund t'i dhimbset një si ky? Hë? Ja, juve mund t'ju shkaktojë dhimbje? Ma thoni këtë, zotëri, po apo jo!

U zgjat që ta mbushte përsëri gotën, por shishja ishte bosh.

- E pse të të vijë keq për ty? - thirri i zoti i mejhanes, që u gjend përsëri pranë tyre.

U dëgjuan të qeshura, madje dhe sharje. Qeshnin dhe shanin si ata që e kishin dëgjuar tregimin, ashtu edhe ata që nuk e kishin dëgjuar, vetëm ngaqë e shihnin se ç'markë ishte.

- Përse të të vijë keq? - ulëriti Marmelladovi, duke u çuar dorëzgjatur përpara me një frymëzim që të dukej se mezi kishte pritur të vërshonte jashtë. - "Përse të vijë keq për ty!" - më thoni. Po! Për mua s'ka përse t'i vijë keq kujt! E meritoj të më varin, të më kryqëzojnë si Krishtin! Por për ta kryqëzuar, kryqëzoje tjetrin, mor gjyqtar, veç më parë mëshiroje! Atëherë vetë unë kam për të ardhur me këmbët e mia që ti të më kryqëzosh, se s'më ha meraku për ahengje mua, por për lot e zi!.. Mos pandeh, mor mejhanexhi, që kjo shishe ma ngrohu shpitin? Zi e kuje më futi në shpirt, lot e qurre mu bë. Vetëm njërit i vjen keq për ne qyqarët, atij që për të gjithë ndien keqardhje! Ai dhe na është gjyqtari. Do të vijë në ditën e caktuar dhe do të pyes: "Ku je, moj bijë, që veten e shite për qejfin e njerkës së keqe, për vocërrakët e huaj? Që babanë, një pijanik të pandreqshëm, jo njeri, por egërsirë e shkuar egërsirës, gjete forca të mëshirosh?". Pastaj do thotë: "Eja këtu! Të kam falur... Të falen gjynahet, sepse e ke pas dashur tjetrin..." Do ta falë Sonjën time, e di që do ta falë... Sot, kur e pashë, ja këtu në zemër më pikoi, por e di që do ta falë... Ai që të gjithë do t'i gjykojë dhe që të gjithë do t'i falë, si të mirët ashtu dhe të liqtë, si të mënçurit ashtu dhe budallenjtë... Kur të ketë mbaruar me të tërë, do t'i drejtohet sërës sonë: "Pa ejani këtu, - do na thotë, - pa dilni edhe ju, o pijanikër

të zgërlaqur, dilni more të shastisur!". Do të dalim pa na u skuqur faqja do qëndrojmë para Tij. Pa do na thotë: "Derra jeni! Kafshë jeni! Po shkoni me të tjerët!". Do të pezmatohen mendtarët, do ta kundërshtojnë të tapinosurit: "Zot, po këta ç'na duhen?" - do t'i thonë. Ai do t'u përgjigjet: "Na duhen, o të mençur dhe ju o të tapinosur, sepse çdo njëri prej tyre veten kurdoherë e ka parë të poshtëruar..." Do të zgjasë krahët drejt nesh, ne do t'i biemë në gjunjë... do ta kuptojmë ç'kemi bërë, do t'i thërrasim mendjes!... Të gjithë sa jemi. Edhe Katerina Ivanovna... edhe ajo ka për ta kuptuar... O Zot, ardhtë dita e mbretërisë tënde!

U lëshua në karrige, pa ia hedhur kujt sytë, si të mos kishte njeri, si të kishte harruar ku ndodhej. Ndonjë minutë ra heshtja, por pastaj u dëgjuan të shara e të qeshura.

- I ra pikës ë?

- Broçkulla!

- Zyrtar, burri i botës!

E ç'nuk u tha!

- Shkojmë, zotëri, - foli papritur Marmelladovi, duke çuar kokën e duke iu drejtuar Raskolnikovit. - Shkomë që këtej... Më ço në shtëpi.. Te Katerina Ivanovna...

Raskolnikovi kishte kohë që donte të ikte, edhe vetë kishte menduar ta ndihmonte të porsanjohurin. Doli që Marmelladovi nuk kishte këmbë fare, mbahej fort pas djaloshit. Shtëpia nuk ishte larg, nja dyqind-treqind hapa. Sa më shumë i afroheshin shtëpisë, aq më tepër i shtohej frika dhe hutimi Marmelladovit.

- Nuk është se i trembem takimit me Katerina Ivanovnën, - belbëzoi i tronditur. - E di që do m'i shkulë fare flokët! Po ç'janë flokët?.. Një hiç janë! Është më mirë kur e fillon me ta, me të rrahurën, nuk është kjo ajo që më tremb... Unë syve të saj u trëmbem, ja çfarë!... Njollave të kuqe në fytyrë dhe në qafë... frymëmarrjes së saj i trëmbem.. Ke parë si dihasin veremlinjtë? Kur janë të tronditur? Edhe ngashërimit të vocërrakëve i trëmbem... Se në nuk pat sjellë diçka Sonja... një Zot e di ç'kanë bërë... Kurse rrahjet nuk i vë në refene... Jo dhëmbje, por kënaqësi ndiej prej tyre... Se të rreh tjetri dhe shfren... lehtësohet... Ja dhe shtëpia. Pronare është një grua e pasur, Kozel quhet!

Hynë në oborr dhe u ngjitën në katin e katërt. Shkallët ishin pa

dritë, ora ishte rreth njëmbëdhjetë. Ndonëse në këtë kohë në Petërburg nuk ka natë në kuptimin e zakonshëm të fjalës, në shkallët e katit të sipërm ishte errësirë e plotë.

Dera e tymosur, aty ku mbaronin shkallët, ishte e hapur. Një bisht qiriri ndriçonte një dhomë fare të varfër, të gjatë nja dhjetë hapa. Dukej e tërë që nga shkallët. Rrobet qenë hedhur andej-këtej, sidomos rreckat e fëmijëve. Në qoshen e mbrapme qe varur një çarçaf i grisur, aty ishte krevati. Kishte vetëm dy karrige dhe një divan të mbuluar me ingilit që ishte fare i shqyer, para tyre ishte dhe një tryezë kuzhine prej druri pishe, e palyer dhe e pambuluar. Në cep të tryezës ishte bishti i qiririt në një tavull hekuri. Marmelladovi, ta thoshte mendja, që kishte këtë dhomë, por kishte dhe një tjetër, dera e hapur, me siguri, që aty të çonte. Por jo. Nga ajo derë e hapur vinin britma dhe të qeshura, me sa dukej, luanin me letra, dhe pinin çaj. U dëgjuan dhe shprehje aspak të hijshme. Pra, nuk ishte e Marmelladovëve.

Raskolnikovi e njohu menjeherë Katerina Ivanovnën. Ishte një grua kockë e lëkurë, shtatëlartë dhe elegante; flokët i kishte të bukur, gështenjë, fytyrën të mbuluar me njolla të kuqe. Ecejakte nëpër dhomë me krahët shtrënguar pas gjoksit, me buzë të zhuritura, duke shfryrë e inatosur. Sytë i shkëlqenin si në ethe, shikimin e kishte të ngulur, të përqendruar. Tërë pamja e saj të linte përshtypjen e njeriut të sëmurë, nevrik. Raskolnikovit iu duk jo më shumë se tridhjetë vjeçe, dukej sheshit që Marmelladovi s'e kishte hak... Nuk i dëgjoi kur hynë, ishte fare e përhumbur. Dhoma ishte e paajrosur, dritaret të mbyllura; në shkallë të mbyste era e keqe, kurse dera që të çonte në shkallë ishte e hapur, ashtu si dhe dera e dhomës fqinje, nga ku hynte tymi i duhanit. Atë e mbyste kolla, por derën nuk e mbyllte. Vajza e vogël, gjashtë vjeçe flinte në dysheme, rrinte ulur me kokën mbështetur pas divanit. Djali, që ishte një vjeç më i madh, grindej në një qoshe, dridhej i lebetitur. Me sa dukej, sapo e kishin rrahur. Vajza e madhe, rreth nëntë vjeçe, shtatgjatë dhe e hollë si lastar, veshur me një këmishë të vjetër të grisur dhe me një dolloma basmaje mbi të, të cilën ia kishin qepur të paktën dy vjet më parë dhe i vinte deri te gjunjët, rrinte në qoshe pranë të vëllait, e kishte zënë për qafe dhe e mbante shtrënguar në krahët e gjatë si shkopinj. Dukej që përpiqej ta qetësonte, diç i pëshpëriste në vesh, që ky të mos ia shkrepte përsëri të qarit; ndërkaq

ndiqte me tmerr lëvizjet e së ëmës me sytë e mëdhenj të zinj që i dukeshin edhe më të mëdhenj në fytyrën thatanike e të frikësuar. Marmelladovi pa hyrë në dhomë ra në gjunjë, kurse Raskolnikovi bëri përpara. Gruaja, kur pa të panjohurin, shtangu e hutuar, si të donte të kuptonte përse kishte ardhur. Mendoi se do të shkonte në dhomat e tjera, se dhoma e tyre ishte kalimtare, ndaj dhe s'i kushtoi kurrfarë vëmendjeje, vajti të mbyllte derën e shkallës dhe sakaq bërtiti, kur pa në prag të shoqin që rrinte në gjunjë.

- Ah! - thirri e lodhur. - U ktheve, ë? E prure kokën, mor syrgjyn? Pjellë e keqe!... Po paratë ku i ke? Pa m'i trego ç'ke në xhep? Edhe rrobat i paske shitur? Paratë ku i ke? Fol!...

Ju hodh që ta kontrollonte. Marmelladovi ngriti krahët që t'ia lehtësonte veprimet, nuk nxori as edhe një fjalë. Ajo po nuk gjeti as dhe një kopejkë.

- Ç'i bëre paratë? - thirri. - Zot i madh, mos i pive të tëra? Ishin dymbëdhjetë rubla në sënduk! - Në tërbim e sipër e kapi nga flokët dhe e hoqi zvarrë që ta fuste në dhomë. Marmelladovi ia lehtësonte vetë këtë veprim pa u ndier, rrëshqiste nëpër dysheme këmbadorazi.

- Kjo mua më kënaq! Po, po, zotëri mëshirëplotë, jo dhimbje por kënaqësi më jep. Vetëm kënaqësi! - thërriste duke u tundur dhe duke u lëkundur sepse e tërhiqnin nga flokët, madje nja dy herë ia përplasën kokën në dysheme. Foshnja, që po flinte, u zgjua dhe ia dha të qarit, djali në qoshe dridhej si purtekë, ulërinte dhe ngjishej pas së motrës, tmerrësisht i trembur, thuajse i mekur. Vajza e madhe dridhej si gjethi nga era.

- I paske pirë të gjitha? Të gjitha? - ulërinte gruaja që dukej se nuk ishte fare në vete. - Po kostumin ç'e bëre? Do vdesim urie tani! Morëm fund! (Thyente duart dhe shihte e përlotur vocërrakët). O jetë qeni! Po juve nuk ju vjen turp? - iu kthye papritur Raskolnikovit. - Edhe ju nga ata të mejhaneve jeni? Bashkë paskeni pirë? Jashtë!

Djaloshi u ngut të dilte pa u ndier. Për më tepër që nga dera anësore nxorën kokën disa kurreshtarë: ishin ca fytyra harbutësh, që zgërdhiheshin me cigare o çibuk në gojë, me bereta. Disa qenë veshur me rrobëdhome, të tjerët me kostume banje, ndonjë mbante në dorë letrat. Sidomos u gajasën kur panë Marmelladovin që po e hiqnin zvarrë nga flokët, ndërsa ky thoshte: "Kjo mua më kënaq!". Pati edhe

nga ata që hynë në dhomë. Atë çast u dëgjua një piskamë rrëqethëse, ndjellakeqe; ishte Amalia Lipevehzeli, që kishte ardhur të vinte rregull për të satën herë, ta trëmbte të gjorën grua me kërcënimin që të nesërmen ta boshatisnin apartamentin. Kur po dilte, Raskolnikovi futi dorën në xhep dhe nxorri aq kopejka sa i zuri dora; të tërë reston nga rubla që pagoi për birrën që pat pirë, dhe e la në parvazin e dritares. Kur po zbriste shkallët, ndërroi mendje, donte të kthehej. "E ç'm'u desh kjo që bëra? - tha me vete. - Kanë Sonjeçkën që u ndihmon, ato para mua vetë më duhen shumë!" Por pasi e preu mendjen të mos kthehej t'i merrte se nuk ishte aspak e hijshme, tundi dorën dhe vazhdoi rrugën. "Sonjës i duhen para për pomadë, por edhe që pastërtia të mos ketë të sharë! - përsëriti ashtu vetvetiu duke dalë në rrugë dhe u ngërdhesh shpotitës. - Do para ai zanat, duhet mbajtur mirë... Hm! Se Sonja mund edhe ta pësojë po nuk i shkoi zanati, po mos i eci fati, si puna e atij gjahtarit... e kërkuesit të arit... Kështu që të nesërmen mbeten fare pa gjë... Po, duket ajo, Sonja i paska vënë gjoksin punëve! Ç'pus të thellë që paskan arritur të shpojnë! Tani po ia shohin të mirën! Po e shfrytëzojnë, thoni ju, apo nuk po e shfrytëzojnë! Dhe duket që u mësuam me gjendjen. Bënë në fillim ca gurgule, derdhën edhe ca lotë, por s'shkoi shumë dhe u mësuan. Sa i ndyrë që është njeriu, me ç'nuk u mësoka!".

- Po sikur të mos jetë kështu? - thirri pa dashur. - Po sikur të mos jetë *i ndyrë* ai, njeriu? Të mos jetë i tillë si xhins, të mos jetë ashtu njerëzimi mbarë? Del që gjithë sa lidhet me njeriun të jetë paragjykim, vetëm sa për ta trëmbur, kurse në të vërtetë nuk ekziston kurrfarë pengese për të vepruar, kështu duhet të jetë!...

III

Raskolnikovi u çua vonë në mëngjes pas një gjumi të prishur, plot me ëndrra, që nuk ia freskoi aspak forcat. U zgjua i vrerosur, i pezmatuar, i inatosur dhe pa me urrejtje strofullën e tij. Ishte si një kafaz, rreth gjashtë hapa i gjatë, me një pamje mjerane, ngaqë veshja e dikurshme e mureve ishte shqitur e ronitur dhe vende-vende kishte rënë, tavani i ulët prekej me kokë, dukej sikur po të kishte mbysnin

apo të fundoste pesha e dikujt. Edhe mobiljet s'i linin gjë mangut dhomës: gjithë-gjithë tri karrige të vjetra, të troshitura e të shtrembëruara, një tryezë të lyer me bojë vaji në një qoshe, me disa fletore dhe libra përsipër; nga shtresa e pluhurit që i mbulonte, dukej që prej kohësh nuk i kishte prekur dora e njeriut dhe, më në fund, ishte dhe një kanape e madhe, kaba, që zinte të tërë faqen e murit, ishte e veshur me basma, tanimë fare të strepëcuar dhe vende-vende të shqyer, kanapeja i shërbente si shtrat. Të shumtën e herëve binte e flinte i veshur, mbulohej vetëm me pallton e vjetër të studentit, jastëku i nënkresë ishte i vogël edhe petashuq, prandaj poshtë tij vinte ndërresa të lara dhe të palára që t'i rrinte koka më lart. Para kanapesë kishte një tryezë të vogël.

Varfëria dhe skamja ishin të bollshme, por Raskolnikovi ishte i kënaqur, sepse sipas kokës edhe festja. Qe veçuar nga njerëzit si breshka në zhgun, madje edhe prania në të rrallë e shërbëtores që vinte për të fshirë e mërziste dhe ia ngrinte nervat aq fort sa ca si ngërçe ia përshkonin trupin. Kështu u ndodh disa njerëzve të zhytur kokë e këmbë në ndonjë hall. Pronarja kishte nja dyjavë që ia kishte prerë drekat, dhe ky nuk kishte shkuar as të shpjegohej. Nastasia, kuzhiniere dhe shërbëtore në të njëjtën kohë, fërkonte duart e kënaqur që qiraxhiu nuk po ndihej, i vinte fare rrallë për të pastruar. Tani ishte ajo që po e zgjonte nga gjumi.

- Çohu, mjaft fjete! - i bërtiti. - Ora dhjetë. Të kam sjellë çaj, do ta pish? Je tharë e je bërë si cironkë!

Raskolnikovi kapsalliti sytë, u drodh i përgjumur, e njohu Nastasjen.

- Nga kush e kam, nga pronarja? - e pyeti ngadalë duke lëvizur i dërrmuar në kanape.

- E nga ç'pronare, mo?

I vuri përpara çajnikun e saj tërë gunga, dhe dy kokla sheqeri.

- Ja, merri këto, Nastasia të lutem, - i tha pasi rëmoi në xhepa (kishte rënë të flinte i veshur) dhe nxori disa kopejka. - Shko më bli pak bukë e sallam, nga ai më i liri.

- Bukë po të sjellë, po në vend të sallamit mos do çorbë? Është e mirë, e zjeva dje. Ta kam hequr pjesën, po u ktheve vonë mbrëmë. Është çorbë jo llafe!

Kur Raskolnikovi zuri të hante, Nastasia u ul në kanape dhe i hapi muhabet. Ishte nga fshati dhe i pëlqente shumë të llapte.

- Praskovia Pavllovna tha se do të ankohej në polici.

- Në polici? E përse?

- Se nuk i paguani paratë dhe rrini tërë ditën brenda.

- Edhe kjo më duhet, - mërmëriti dhe shtrëngoi dhëmbët. - E paska gjetur kohën të ankohet, budallaqja... - shtoi me zë të lartë. - Do flas vetë sot me të.

- Që është budallaqe, ajo dihet, si puna ime është, por ama që edhe ti, mor i mençur, që rri këtu brenda ditë e natë si ndonjë thes me kashtë, nuk bën mirë. Më parë sikur u jepje mësime disa femijëve, tani gjë prej gjëje nuk bën. Ç'është kështu me ty?

- Si nuk bëkam? - i foli prerë e i pakënaqur Raskolnikovi.

- E ç'po bën, hë?

- Punë po bëj...

- E ç'punë zeza, mo?

- Po ja, rri këtu dhe mendohem, - i tha seriozisht dhe heshti.

Nastasia u shkri së qeshuri. Ishte hokatare e madhe, qeshte pa u ndier, si t'i merrej fryma, duke u lëkundur e tëra dhe duke u mekur, qeshte aq shumë sa pastaj i përzihej.

- Po si, mos vure gjë parà duke u menduar? - mezi shqiptoi me zë të ngjirur nga të qeshurit.

- Çizme nuk kam, si te dal të vete të mësoj fëmijët? Prandaj hoqa dorë.

- Po bëj si të bësh e shko, je nevojtar, mor djalë.

- Nuk të paguajnë gjë për fëmijët. Çikërrima... - i tha i trishtuar, si t'u jepte me këtë rrugëzgjidhje mendimeve të zymta që e kishin dyndur kohët e fundit.

- Mos pandeh të bëhesh tyxhar me to zotrote?

Raskolnikovi e pa i habitur.

- Po, dua, - iu përgjigj prerë dhe heshti.

- Avash, mor djalë, se na trembe. Të vete të ble ndonjë gjë. Si thua?

- Bëj ç'të duash.

- U, harrova fare. Ke një letër, të erdhi dje, kur nuk ishe këtu.

- Letër! Për mua! Nga kush?

- Nuk e di. I dhashë tri kopejka postjerit nga paratë e mia. Do m'i japësh ?

- Mirë, mirë, po sille, ç'më rri ashtu! - iu hakërrua me drithmë në zemër. - O Zot!

Pas një minute letra ishte aty. E kishte nga e ëma, që banonte në gubernën R. I ra çehre e verdhë, kur e mori në dorë. Kishte kohë që nuk kishte marrë letër, por s'ishte kjo arsyeja që po i shtrëngohej dhe i rrihte aq fort zemra.

- Ik tani, Nastia, më lër vetëm, në ke perëndi! Ja ku i ke tri kopejkat, merri dhe mbylle derën!

Letrën e mbante në duart që i dridheshin, nuk donte ta hapte në prani të saj: donte të ishte *vetëm për vetëm* me këtë letër. Kur Nastasia doli, e çoi letrën te buzët dhe e puthi, pastaj ia nguli sytë shkrimit të adresës, atij shkrimi të imët, pak të pjerrët, aq mirë të njohur dhe aq shumë të dashur të nënës, që dikur e kishte mësuar të shkruante dhe të këndonte. Nuk po ngutej ta hapte, madje dukej sikur kishte frikë ta hapte. Më në fund vendosi: letra ishte e gjatë, disa fletë të mëdha të shkruara nga të dyja anët me gërma të imta të dëndura.

"Rodja, shpirti im, - i shkruante mamaja. - *Kanë kaluar më shumë se dy muaj që s'të kam shkruar, zemrën e kam të mbushur plot e përplot me mall, s'më zë gjumi natën, mendja më rri te ti. Me siguri që nuk më mban mëri, kam qenë e detyruar të hesht tërë këto kohë. Ti e di sa shumë të duam, të kemi të vetëm si unë ashtu dhe Dunja; të gjitha shpresat te ti i mbajmë, të kemi gëzimin e vetëm. Sa s'më ra pika kur mësova se paske disa javë që nuk vajtke në universitet, ngaqë nuk ke për të ngrënë dhe për të përballuar gjithë sa duhet, se dhe mësimet që jepje s'i paske më! E si të të ndihmoj me pensionin vjetor prej njëqind e njëzet rublash që marr? Pesëmbëdhjetë rublat, që të kam dërguar katër muaj të shkuar, i mora borxh te tregtari Athanas Ivanoviç Vahrushini dhe ia ktheva kur mora pensionin. Është njeri i mirë, ka qenë shok me tët atë. Vetëm tani erdhi koha të marr përsëri pensionin, ndaj dhe s'të kam ndihmuar dot. Tani, lavdi Zotit, mund të dërgoj diçka, madje i duhet të jemi falënderues fatit dhe ja përse. Po të bëj të ditur, shpiti im Rodja, që jot motër ka një muaj e gjysmë që rron këtu me mua, kështu e tutje s'na ndan më dot njeri. Lavdi Zotit, morën fund peripecitë e saj. Po më mirë po t'i tregoj me radhë të gjitha, që dhe ti ta dish si është puna dhe ç'kemi mbajtur të*

fshehur nga ti. Kur më shkruaje para dy muajsh se kishe dëgjuar që Dunjën po e merrnin nëpër këmbë në shtëpinë e zotit Svidrigajllov dhe më kërkoje shpjegime të sakta, ç'mund të shkruaja atëherë? Po të kisha thënë të vërtetën, kishte rrezik të ishe nisur edhe në këmbë dhe do kishe ardhur këtu; ta njoh mirë karakterin, ta di kokën: nuk kishe për ta lënë motrën që ta fyenin. Gjak më pikonte shpirti për çupën, por s'kisha nga ia mbaja, se dhe me tamam s'e dija si qëndronte puna. Se, që thua ti, Rodja, Dunjeçka, kur u pajtua guvernante, mori parapagim njëqind rubla, ato do t'i mbaheshin çdo muaj nga pagesa, pra s'kishte si largohej pa e larë parapagimin. Këto të holla (tani unë këtë mund ta them, i shtrenjti Rodja) i pati marrë kryesisht për të të ndihmuar ty; të dërgoi gjashtëdhjetë rubla, për të cilat ti atëherë pate aq shumë nevojë, vitin që shkoi. Të gënjyem kur të shkruam se ishin para që Dunja i paskësh kursyer, tani po të tregoj të vërtetën, pasi çdo gjë papritur mori një drejtim tjetër me vullnetin e të madhit Zot, kuptohet, më të mirë për ne. Ta them që ta dish sa shumë të do Dunja, ç'zemër flori që ka. Ashtu ka qenë: zoti Svidrigajllov në fillim u soll keq me të, e vinte në lojë dhe e bënte me turp, kur rrinin në tryezë... Po nuk dua të të merakos me ca hollësi si këto, se tani u mbyll kjo mesele. Shkurt llafet, pavarësisht nga sjellja fisnike dhe bujare e Marfa Petrovnës, të shoqes së Svidrigajllovit dhe të njerëzve të tjerë të shtëpisë, Dunja s'e pati të lehtë qëndrimin aty. Po ç'ndodhi më pas? Doli që ky horr prej kohësh i paska vënë syrin Dunjeçkës, por këtë e fshihte me sjelljen e harbutit dhe përbuzjen që tregonte. Ndoshta edhe ngaqë i skuqej faqja që në atë moshë dhe në atë gjëndje të shkonte me ca shpresa mendjelehta, pra, s'dinte si ta shfrente dufin. Por kushedi ndoshta kështu orvatej të fshihte të vërtetën nga të tjerët? Sidoqoftë, nuk duroi dot dhe i bëri Dunjës një propozim poshtërues, duke i premtuar gjithfarë dhuratash dhe, mbi të gjitha, i tha se ishte gati ta braktiste gjithçka dhe të shkonte me të në një fshat tjetër, por edhe jashtë shtetit. E merr me mendje gjendjen e vajzës! Për t'u larguar, nuk largohej dot dhe jo vetëm se kishte detyrimin për të larë, por edhe për shkak të Marfa Petrovnës, që mund ta nuhaste ç'kishte ndodhur, pra do t'i vihej flaka familjes. Por edhe për Dunjeçkën nuk ishte i mirë skandali, pa të ajo s'ndahej dot. Kishte edhe arsye të tjera, kështu që para gjashtë javësh Dunjeçka nuk kishte si kthehej. Se ti atë e njeh mirë, e di sa e mënçur është dhe sa me karakter. Ajo mund të durojë shumë, madje dhe në çastin më të fundit gjen në vetvete aq shumë

shpirtmadhësi për të mos e humbur pusullën. Ajo as mua nuk m'i shkruante të gjitha, për të mos më vënë në merak, se ne kemi patur letërkëmbim të rregullt. Çështja u zgjidh papritur e pakujtuar. Marfa Petrovna fare rastësisht dëgjoi të shoqin ta luste Dunjeçkën në kopsht dhe, meqë e kuptoi çdo gjë mbrapsht, i qe vërsulur vajzës, duke e marrë për fajtore. Marfa Petrovna në gjaknxehtësi e sipër e qëlloi Dunjën, nuk donte që ta dëgjonte, kishte ulëritur zëngjirur duke dhënë urdhër ta largonin që atë çast. E hipën në një karro fshati, aty i ngarkuan edhe plaçkat, të mbledhura shuk, pa kurrfarë kujdesi e meraku. E zuri edhe një rrebesh, dhe ashtu e poshtëruar dhe e turpëruar, Dunja u detyrua të bëjë jo pak, por njëzet kilometra rrugë në karron pa mbulesë vetëm për vetëm me një muzhik. E si mund të të shkruaja për këto? Sa s'më ra pika kur e dëgjova, kurse ty s'pata guximin të ta bëja të ditur, vetëm do të mërzisja e do të zemëroja, se për të na ndihmuar nuk bëhej fjalë. Vetëm ndonjë të pabërë mund të bëje. Pastaj Dunjeçka më porositi të mos ndihesha; ndërsa ta mbushja letrën me gjithfarë gjepurash në ato rrethana, s'më bënte zemra. Një muaj rresht u tund i madh e i vogël, as në kishë nuk shkoje dot me Dunjën, na shihnin me përçmim e përbuzje, seç përshpërisnin me zë të lartë, gjoja prapa krahëve. Të njohurit na kthenin kurrizin, kur na shihnin, ndërsa nga burime të sakta mora vesh që disa shegertë tregtarësh dhe çunakë zyrash deshën të na poshtëronin, duke na e lyer me katran portën e shtëpisë. Pronari kërkoi të largoheshim një orë e më përpara. Dhe kudo ishte dora e Marfa Petrovnës, ajo grua s'la gur pa lëvizur që të na e nxinte sa më shumë jetën. Vinte në qytet dhe e bënte veten sa t'u tregonte të njohurve për punët e shtëpisë, si llafazane grua, u ankohej për të shoqin, e kjo nuk është gjë e mirë. Unë po zura shtratin, Dunjeçka u tregua më e fortë, ta shihje si i përballonte të gjitha, më qetësonte edhe mua. Ëngjëll e shkuar ëngjëllit është! Por, lavdi Zotit, mundimet morën fund shpejt: zoti Svidrigajllov u pendua për gjithë sa kishte bërë, ia tregoi Marfa Petrovnës të vërtetën për pafajsinë e Dunjeçkës, i dorëzoi letrën që kjo i kishte dërguar para ndodhisë në kopsht, ku i shkruante ta linte në punën e saj, të mos i kërkonte shpjegime kokë më kokë dhe në fshehtësi. I shkruante me zemërim për sjelljen aspak të hijshme ndaj saj dhe ndaj Marfa Petrovnës, i vinte në dukje se ishte baba fëmijësh dhe se nuk qe aspak e hijshme nga ana e tij ta torturonte asisoj një vajzë fatkeqe, fare të pambrojtur. Ishte një letër tepër fisnike kjo e saj,

i dashur Rodja, e shkruar me shumë ndjenjë, s'më mbaheshin lotët kur ma treguan. I dolën dëshmitarë edhe shërbëtorët, që kishin parë e kishin dëgjuar shumë me tepër nga ç'kishte pandehur zoti Svidrigajllov, siç ndodh kurdoherë në kësi rastesh. Marfa Petrovna e humbi fare pusullën, "më mirë të më kishin vrarë", - qënka shprehur. U bind për pafajsinë e Dunjeçkës. Të nesërmen, ditën e diel, shkoi në kishë, u fal para Shën Mërisë në gjunjë, për t'i dhënë forcë që ta kalonte edhe këtë provë të rëndë, të qëndronte në lartësinë e detyrës. Nga kisha erdhi drejt e te ne, na e tregoi çdo gjë me gojën e saj, qau me lot të hidhur pendese, e përqafoi dhe e luti Dunjeçkën ta falte. Të nesermen shkoi vetë derë më derë dhe me fjalë nga më miklueset për vajzën, me lot në sy, u foli për pafajësinë e saj, për ndjenjat fisnike dhe për sjelljen e pashoqe. Ua lexonte me zë letrën, me të cilën Dunjeçka i ishte drejtuar zotit Svidrigajllov, madje edhe e shumëfishoi (që, për mua, ishte diçka e tepërt). Shkoi te të gjithë me radhë që të mos zemërohej kush nga pasajdia, e dinin saktë ditën kur do të vinte Marfa Petrovna dhe do t'ua lexonte letrën, mblidheshin madje edhe ata që e kishin dëgjuar njëherë. Për mendimin tim, ishin të tepërta këto që bënte, por Marfa Petrovna të tillë karakteri ka. Sidoqoftë, e vuri në vend nderin e vajzës, tërë barra e turpit rëndoi mbi të shoqin. M'u dhimbs ai njeri, sikur e tepëroi zullumin ajo grua llafazane! Dunjeçkën e thirrën të jepte mësime në disa dyer të njohura, e shohin me respekt. Me këtë lidhet edhe rasti i papritur, nga i cili do të ndryshojë kryekëput, si të thuash, fati ynë. Të bëj të ditur, i dashur Rodja, se Dunjës i ka kërkuar dorën dikush dhe ajo pranoi, po nxitoj të vë në dijeni edhe ty për këtë. Edhe pse e përfunduam pa u këshilluar me ty, ti nuk do na e marrësh për keq, sepse do bindesh që nuk priste puna sa të merrej përgjigjja jote. Pastaj ti as që kishe si gjykoje pa e parë vetë me sy. Ja si ndodhi: Pjotër Petroviç Lluzhini, këshilltar oborri, fis i largët i Marfa Petrovnës, që ndihmoi shumë në këtë punë, shprehu dëshirën për t'u njohur me ne, e pritëm siç pritet miku: të nesëmen na u drejtua me një letër, ku me shumë mirësjellje kërkonte dorën e Dunjeçkës dhe na lutej t'i përgjigjeshim sa më parë. Ishte deri në fyt me punë, ngutej për në Petërburg. Kuptohet që në fillim ne u habitëm, qe diçka fare e papritur. I peshuam mirë gjërat; është njeri me emër të mirë, i kamur, shërben në dy vende, ka tanimë një kapital. Ç'është e vërtetë, i ka mbushur dyzetë e pesë vjeç, por është i mbajtur, grave u pëlqen. Duket njeri serioz, vetëm se është pak i zymtë

dhe mendjemadh. Por kjo, ndoshta, vetëm në dukje. Kur të shihesh me të në Petërburg, i shtrenjti Rodja, dhe kjo nuk do të vonojë të ndodhë, mos gjyko me ngut e me pasion, siç e ke zakon, po qe se diç nuk të pëlqen tek ai. Ta them nga meraku, se jam e bindur që do të të pëlqejë. Se për ta vlerësuar tjetrin nuk duhet ngutur, duhet patur kujdes, nuk duhet rënë në gabime, nuk do shkelur në dërrasë të kalbur... Pjotër Petroviçi, sidoqoftë, është njeri i nderuar. Që në takimin e parë u shpreh se anonte nga e mira, se ishte pro "bindjeve të brezit tonë të ri", armik i paragjykimeve. Tha e ç'nuk tha, se është njeri sedërli dhe i pëlqen ta degjojnë më shumë se të dëgjojë, por ky nuk është ndonjë ves kushedi çfarë. Unë, kuptohet, s'i mora vesh të gjitha, Dunja më sqaroi më pas se ky, ndonëse nuk kishte ndonjë shkollë të madhe, ishte i mençur dhe, me sa dukej, edhe i mirë. Se ti e njeh mirë karakterin e Dunjeçkës, është e vendosur dhe e arsyeshme, e durueshme dhe zemërbardhë, ndonëse merr ndonjëherë flakë si kashta. Sigurisht, as ai e as ajo nuk kanë si flasin për dashurinë, por Dunja është me një okë mendje, është edhe fisnike, nuk është njeri por ëngjëll; ajo e quan për detyrë ta bëjë të lumtur bashkëshortin, i cili, nga ana e vet, do përpiqet ta bëjë atë të lumtur. Për këtë tani për tani s'kemi pse mendojmë keq, edhe pse kjo punë bitisi shpejt. Duket njeri i hesapit dhe ka për t'i rënë kalemit që lumturia e tij familjare do të jetë e siguruar, nëse Dunjeçka do të jetë e lumtur. Sa për dallimet në karaktere, për ndonjë huq, por edhe për ndonjë mospërputhje të mendimeve (që edhe në lidhjen bashkëshortore më të goditur s'ke si i shmang tërësisht), vetë Dunjeçka me siguri që ka besim te vetja, nuk kemi pse shqetësohemi, ajo do të dijë të tregohet e duruar, me kusht që marrëdhëniet të jenë të ndershme dhe mbi bazën e drejtësisë. Në fillim, Rodja, sesi m'u duk pak i prerë, por kjo mund t'i vijë ngaqë është njeri me zemër të çelur dhe kjo kështu është. Në vizitën e dytë, pasi mori pëlqimin tonë, por që martesa të bëhet pa prikë e pa nishane, në bisedë e sipër tha se edhe para se të njihej me Dunjën e kishte prerë mendjen të martohej me një vajzë të ndershme, pa pajë e pa nishane, dhe sidomos të tillë që të kishte përjetuar çaste të vështira në jetë, sepse, sqaroi ai, burri në asnjë pikë nuk duhet t'i jete borxhli gruas, është më mirë, kur gruaja e quan burrin bamirësin e saj. E tha më butë e më me ndjenjë, por i kam harruar shprehjet e sakta që përdori, më kujtohet vetëm domethënia, pastaj këtë ai nuk e tha me paramendim, e rrëmbeu fjala, më pas dhe vetë u përpoq ta zbuste; se, të thuash të drejtën, m'u

duk ca i prerë, kur foli asisoj. Kur iku, ia shpreha Dunjës ç'mendim kisha, kjo tërë nervozizëm më tha se "fjalët nuk janë ende vepra" dhe ashtu është. Natën para se të jepte fjalën Dunjeçka nuk mbylli sy; duke pandehur se po flija, u çua dhe tërë natën ecejaku nëpër dhomë, pastaj ra në gjunjë para ikonës dhe iu lut Zotit ta ndihmonte; në mëngjes më tha se kishte vendosur.

Të shkrova se Pjotër Petroviçi ngutej për në Petërburg. E prisnin punë të mëdha, donte të hapte një avokatore të madhe publike. Paska kohë që merret me punë avokatërie, para disa ditësh kishte filluar një gjyq me shumë rëndësi. Në Petërburg e priste një çështje që kishte të bënte me senatin. Them, i shtrenjti im Rodia, se edhe ty mund të të hap një derë. U gëzuam, sepse, duke filluar që sot, e ke të vënë në vijë punën e karierës, e ke të përcaktuar fatin. Ah, sikur të na printe e mbara! Është një gjë me aq leverdi kjo që bëmë, saqë fort mirë mund ta quash lëmoshë të të plotfuqishmit! Dunja ka besim se do na ecin mbarë punët. Kuturisëm dhe ia zumë ngoje Pjotër Petroviçit edhe punën tënde. U shpreh me kujdes, vetëm tha që, sigurisht, një sekretar i lypsej, është më mirë t'ia besosh punët njeriut tënd, në qoftë i përshtatshëm. (E ku vihet në dyshim aftësia jote!) Por shprehu dhe një dyshim mos studimet do të lënë pak kohë për t'u marrë me punët e zyrës. Me kaq dhe u mbyll ajo bisedë, kurse Dunja vetëm për këtë ëndërron. Në mëndje ka një plan, thotë se në të ardhmen mund të punosh si ortak me Pjotër Petroviçin, se edhe ti për jurist mëson. Unë, Rodja, jam i një mëndje me të, ka shumë të ngjarë të bëhet. Lëkundja e Pjotër Petroviçit në etapën e tanishme është e kuptueshme (ende nuk të njeh kush je), Dunja ka besim të plotë se do ia dalë mbanë asaj që mendon, do ia haj kokën me të mirë, ajo di çfarë bën. Sigurisht, Pjotër Petroviçit nuk i ramë në sy me ëndrrat tona. Është natyrë e përmbajtur dhe do ta priste ftohtë. Po ashtu nuk iu hapëm as lidhur me shpresën që kemi se s'do mënonte të ta zgjaste dorën e ndihmës si student që je dhe nuk e bëmë, sepse kjo do të ndodhë vetvetiu (nuk ka si i thotë jo Dunjeçkës), aq më tepër që ti mund të bëhesh krahu i tij i djathtë; s'ke pse e merr si lëmoshë, por si shpërblim pune. Dunjeçka kështu mendon t'i rregullojë punët dhe unë bashkohem me të. Nuk i thamë edhe për një arsye tjetër: duam që të takohesh me të si i barabarti me të barabartin. Dunja i foli për ty me entuziazëm e adhurim, ai iu përgjigj se për të gjykuar për një njeri, duhet me parë ta njohësh, tha se do t'ia shprehte mendimin

e tij vetëm pasi të të njihte. E di, shpirti im Rodja, mendoj se për disa arsye (që nuk kanë lidhje fare me Pjotër Petroviçin, janë krejt të mijat, ndoshta edhe huqet e pleqërisë nxjerrin krye në këtë mes) për mua më e mira e të mirave është të rroj veç, siç rroj tani, jo me ta. E di që ka për t'u sjellë me fisnikëri e delikatesë, e di që do të jetë ai vetë që ka për të më ftuar të rri me ta, për të mos u ndarë nga vajza, dhe, nëse nuk ma ka thënë deri më tani, është diçka që nënkuptohet vetiu, por nuk do të pranoj. E di që dhëndurët s'para i kanë për zemër vjehrrat, pastaj dua të jem fare e lirë. Mua s'më gjen gjë për deri sa ju kam ju, ty dhe Dunjeçkën! Po të duhet, do zë ndonjë dhomë sa më pranë jush. Veç, Rodja, lajmin më të këndshëm e kam ruajtur për në fund: të bëj të ditur, miku im i zemrës, se së shpejti do të jemi të tre bashkë, do të përqafohemi e do çmallemi përsëri pas kësaj ndarjeje trevjeçare. Është tanimë e vendosur që unë dhe Dunja do të nisemi për në Petërburg; se kur nuk ta them dot me saktësi, por, sidoqoftë, shpejt, ndoshta pas një jave. Varet nga fjala që do na çojë Pjotër Petroviçi. Për disa arsye i duhet të ngutet me martesën, do ta bëjnë ndoshta para kreshmëve, më e shumta fill pas pashkëve. Sa e lumtur do jem të të shtrëngoj në gji! Dunjën s'po e mban vendi, mezi pret të të shohë! Si duke qeshur më tha se qoftë edhe për këtë ia vlen të martohesh me Pjotër Petroviçin. S'është njeri, por ëngjëll ajo vajzë! Nuk po të shkruan, se ka aq shumë për të thënë, saqë më mirë s'e mori fare penën, sepse, thotë, me disa fjalë nuk i shpreh dot gjithë sa ke në zemër, vetëm se më kot e nervozon veten! Më tha se të përqafon fort me mall dhe të dërgon të puthura që s'kanë të sosur... Pavarësisht nga ardhja jonë e shpejtë, paratë po t'i nis, të gjitha sa kam. Tani që u hap lajmi i martesës së Dunjës me Pjotër Petroviçin e, na u rrit kredia, them se Athanas Ivanoviçi do na parapaguaj shtatëdhjetë rubla duke patur për peng pensionin; ty po të dërgoj njëzet, ndoshta dhe tridhjetë. Desha të dërgoja më shumë, por nuk e di sa më duhen për rrugë, Pjotër Petroviçi u tregua aq i mirë sa mori përsipër një pjesë të shpenzimeve të udhëtimit dhe pikërisht transportin e plaçkave në një sunduk të madh, por duhet menduar edhe për qëndrimin në Petërburg. I kemi përllogritur me Dunjeçkën të gjitha shpenzimet: rruga nuk ka për të na shkuar shumë shtrenjtë, deri te stacioni i trenit do na çojë një i njohuri yné me karrocë, pastaj do udhëtojmë në vagon të klasit të tretë. Pra, mund të dërgoj njëzet e pesë rubla. Po mjaft me kaq. Dy fletë të mëdha dyshe mbarë e prapë,

me shkrim të vogël i mbusha, s'ka më vend. Se gjithë ato ngjarje kemi patur këto kohë! Të përqafoj e të puth me mall, i shtrenjti im Rodja, mezi pres të shoh, më paç uratën dhe bekimin e nënës. Duaje Dunjën, tët motër; duaje siç të do edhe ajo. Ta dish që të do më shumë se veten. S'është njeri, por engjëll është; kurse ti për ne, Rodja, je gjithçka: te ti i mbajmë shpresat, ti je gëzimi ynë. Kur je ti i lumtur, jemi edhe ne! A i falesh Zotit, Rodja, siç bëje më parë? A beson si më parë më shpirtmadhësinë e tij? Më mbushet trupi me mornica kur mendoj se mos edhe ti nuk beson te Zoti, siç është tani në modë! Në qoftë kështu, jam unë që do t'i falem për ty. Të kujtohet si i belbëzoje lutjet kur ishe i vogël, kur ishte gjallë yt atë? Sa të lumtur që ishim! Lamtumirë apo më mirë, mirupafshim! Të përqafoj me mall dhe të puth fort. E jotja për jetë.

Pulheria Raskolnikova".

Tërë kohën që lexonte këtë letër, Raskolnikovit i shkonin lotët çurg, kur e mbaroi, i kishte rënë çehre e verdhë, fytyrën ia shtrembëronin ngërçe, kraharorin ia shtrëngonin spazma të forta që s'e linin të mbushej me frymë, gulçima të mbytura i dilnin nga gryka, një buzëqeshje e helmët, ndjellakeqe i gjarpëronte në buzë. Shtrëngoi fytyrën pas jastëkut hollak, gur të fortë dhe qëndroi i zhytur në mendime. Zemra i rrihte fort, mendimet i kishte të tallazitura. Po i zihej fryma në këtë vrimë, në këtë musëndër. Sytë dhe mendja i kërkonin hapësirë. Rrëmbeu kapelen dhe doli, këtë herë pa e çarë fare kokën mos e shihte kush në shkallë; kishte harruar fare për këtë. Eci në drejtim të ishullit të Vasilievskut, duke u nxituar sikur e prisnin punë të ngutshme, pa parë as majtas, as djathtas, vetëm duke pëshpëritur diçka me vete; kjo s'kishte si të mos i habiste kalimtarët. Shumëkush e mori për të dehur.

IV

Letra e nënës i ra si bombë. Por për problemin kryesor, që i bëhej e ditur, mendimin e kishte të prerë e të palëkundur: "Kjo martesë nuk do të bëhet sa të jem unë gjallë, nuk ka ç'na duhet ky Lluzhini!" - për të satën herë ia përsëriti vetes.

"Duket ajo, - mërmëriti, duke nënqeshur me ligësi e duke shijuar që më parë kënaqësinë e vendimit që kishte marrë. - Jo, moj mama, jo, moj Dunja, nuk ma shkoni dot ujtë nën rogoz. Më kërkojnë ndjesë që s'mundën të merrnin edhe pëlqimin tim dhe e vendosën pa mua. Shkruajnë si për një punë të mbaruar, por të shohim: do prishet apo nuk do prishet!... Po arsyetimi: qënka shumë i zënë me punë ky zoti Lluzhin, as për t'u marrë njerëzisht me punët e martesës nuk gjetka dot kohë, por ashtu në vrap e sipër... Unë, Dunjeçka, e kam të qartë pse ke nevojë të bisedosh mbarë e prapë me mua, e di dhe ç'mendime të roitnin atë natë pa gjumë, kur ecejakje nëpër dhomë, për çfarë iu lute dhe iu fale në gjunjë ikonës se shën Mërisë, që është në dhomën e nënës. S'është e lehtë të ngjitësh shkallët e Golgotës!... Pra, e paskeni vendosur përfundimisht: do martoheni me një tip afaristi, me një njeri të hesapit, të mbytur në punë, që shërben në dy vende njëherësh dhe i përmbahet pikëpamjeve të sotme të rinisë (kështu shkruan mamaja), por që ju "duket edhe shpirtmirë"! (siç vë në dukje vetë Dunjeçka). Mrekullia vetë!...

Por lind pyetja, përse më bëhen të ditura këto të dhëna për kunatin e ardhshëm? Ashtu thjesht, apo për të më paralajmëruar që të tregohem dashamir ndaj zotit Lluzhin? Jam kurreshtar ta di sa të sinqertë kanë qenë ndaj njëri-tjetrit në këtë lidhje martesore që selitën? Apo u pajtuan me pasinqeritetin? Dukej sheshit që tjetër thoshin dhe tjetër fshihnin në thellësi të zemrës. Them se kështu duhet të ketë qenë; duket nga letra. Mamasë i qënka dukur ca i prerë, por jo shumë; si grua naive që është, e paska bombarduar Dunjeçkën me pyetje. Kjo, sigurisht, që nuk kishte si të mos inatosej me të! Pastaj, përse m'i shkruan ato fjalët: "Duaje Dunjën, Rodja, kurse ajo ty të do më shumë se veten!". Mos vallë e vret ndërgjegja që vajzën po e sakrifikon për hir të djalit? "Te ti i kemi shpresat, ti je gëzimi ynë!" - më shkruan. Ah, moj mama!...

Zemërata i gufonte në kraharor, ta kishte patur aty atë çast zotin Lluzhin, mund edhe ta vriste! "E vërtetë është, - mendimet që i dyndeshin valë-valë, s'po e linin as të merrte frymë, mezi prisnin të shpërthenin jashtë. - Mirë e ka që thotë se në vlerësimin e tjetrit nuk duhet ngutur, para se të flasësh, duhet ta kesh njohur mirë, por nuk është këtu puna. Kryesorja përmblidhet gjetiu. "Është njeri i

përkushtuar pas punës dhe, me sa duket, shpirtmirë!" E tregoi shpirtmirësinë: mori përsipër transportin e një sënduku të madh! Kurse nusja me të ëmën zënë me qira një karro fshati të mbuluar me rrogoz! S'është ndonjë kushedi çfarë, njëqind kilometra janë deri në stacionin e trenit, pastaj "do udhëtojmë për bukuri në vagonin e klasit të tretë"... Hë, si ju duket, zoti Lluzhin? Se fjala është për nusen tuaj?... Si nuk e ditkeni që mamaja për këtë udhëtim i kërkoi parapagim pensionin Athanas Ivanoviçit? Ju, sigurisht, nuk doni të përziheni, secili të vetën, thoni. Ja ç'njeri qenka ky "tip afaristi"! Pse nuk kanë sy të shohin, apo enkas nuk duan të shohin? Dhe thonë që janë të kënaqura, sa më s'bëhet të kënaqura! S'duan ta pranojnë që këto janë vetëm lulet, kokrrat vijnë më pas! Nuk është puna vetëm te sarrafësia, ka rëndësi edhe mënyra si po bëhen punët. Ngjajnë me ca kasnecë para martesës! Po mamaja me çfarë po shkon në Petërburg, me pesë para në qese... Hm! E ka nuhatur çfarë malli është: me Dunjën nuk ka si rron, madje as kohët e para. Ky njeri, si i kalemit që është, edhe këtë e paska llogaritur. Mamaja e ka kuptuar, ndaj shkruan: "Jam unë ajo që nuk do të pranoj!" "Po a mund të rrohet me njëzet rubla pension, duke hequr dhe shlyerjen e parapagimit të Athanas Ivanoviçit? Do t'i qerrohen sytë nga puna e dorës, përfitimi një hiç! S'ka si të jetë ndryshe, shkon me shpresën te fisnikëria e zotit Lluzhin. Veç shpresat shpresa do t'i mbeten! Ka për të ndodhur si në dramat e Shilerit; do ta zbukurojnë me pendë palloi tjetrin, do shpresojnë deri në fund për të mirë, do binden që ai fund nuk ka për të ardhur kurrë, por as edhe një fjalë nuk do nxjerrin nga goja... Jam kurreshtar ta di, në ka dekorata ky njeri? Vë bast që Kryqin e Anës e ka, e vesh në drekat e darkat e tregtarëve, edhe në kostumin e dhëndërisë do ta vërë... Por në djall vaftë!

Mamaja mirë, po Dunjës, Dunjës si i bëhet halli. E njoh mirë atë shpirte! Ia di karakterin, është ashtu si shkruan mamaja: "Dunjeçka duron shumë!" E di, kam kohë që e di. Kur duroi Svidrigajllovin, çdo gjë tjetër e duron! E ka vendosur, edhe Lluzhinin do ta durojë, që i parashtroi teorinë e të mirave që u vijnë bashkëshorteve të nxjerra nga varfëria prej burrave të kamur. Dhe kur pa, thuajse në takimin e parë! Po e zëmë se i shpëtoi goja, ndonëse një hesapxhi si ai e ka thënë me tamam. Po Dunja, Dunja ç'mendim ka lidhur me këtë? Se

është ajo që ka për ta shkuar jetën me një të tillë! Bukë me kripë pranon të hajë dhe shpirtin djallit nuk ia shet! S'është nga ato që e këmben lirinë dhe dinjitetin me rrangullina! Sigurisht, ngjarja me Svidrigaillovin ka ushtruar ndikimin e vet, edhe jeta e guvernantes për dyqind rubla në vit e ku, në provincë, edhe ajo nuk është pa gjë, por e di mirë këtë: ime motër më mirë pranon të punojë si zezaku në plantacion, sesa të poshtërojë shpirtin, duke u lidhur me një që nuk e respekton, që e bën çdo gjë me hesap! Atëherë përse pranoi? Është e qartë: për hir të tjetrit! E bën për njeriun që do! Për vëllanë, për mamanë gati është ta shes veten. T'i vejë si t'i vejë jeta, vetëm të dashurit e zemrës të jenë mirë! E ka bindur fort veten që kështu duhet dhe e bëri... S'ka dyshim që është Rodion Romanoviç Raskolnikovi ai që qëndron në plan të parë. Si ta bëjmë të lumtur, ta mbajmë që të mbarojë universitetin, ta bëjmë ortak zyre me Lluzhinin, t'i qartësojmë avenirin? Që të ketë mundësi të bëhet edhe i pasur, njeri i respektuar, "ku i dihet, ndoshta edhe njeri me emër ta mbyllë jetën! Po mamaja? Kryesor është Rodja, i shtrenjti Rodja, kimetliu i shtëpisë! O zemra të dashura, por të padrejta! Me këtë mendje ne as fatin e Sonjeçkës nuk e kundërshtojmë. Sonjeçka, Sonja Marmelladova, Sonjeçka e përjetshme! Gjithmonë Sonjeçka! Po a e keni matur mirë që të dyja sakrificën që po bëni? A keni forca ta përballoni? A është e arsyeshme dhe vërtet dobiprurëse kjo që jeni duke bërë? A e di, Dunjeçka, që fati i Sonjës nuk është aspak më i keq se fati juaj me zotin Lluzhin? "Dashuri këtu nuk ka si të ketë", - shkruan mamaja. Po si bëhet në mungoftë edhe respekti, në pastë vetëm neveri, përbuzje, ndoht? Ja që dolëm tek fjalet e Marmelladovit për "higjienën që duhet mbajtur"! E ku dallohet ajo e Sonjeçkës nga kjo e Dunjeçkës? Kjo e Dunjës bile është edhe më e keqe, më e ndyrë, më e poshtër, sepse lakmohet rehatia, kurse në rastin e parë bëhet fjalë për bukën e gojës, për t'i shpëtuar kthetrave të vdekjes nga uria. Është pagesë shumë e shtrenjtë kjo, Dunjeçka! Po në t'u bëftë e padurueshme, atëherë si? Të pret pendimi. Sa shumë mallkime, lot të fshehtë, sa shumë makth e trishtim që do të ketë! Se ti nuk je Marfa Petrovna. Po me mamanë ç'do të bëhet? Ajo edhe tani është në merak, po atëherë, kur ta shoh me sytë e saj perrupinë e jetës tënde? Po me mua?... Për mua si nuk menduat? Nuk e dua këtë sakrificë! Nuk ka për t'u bërë ajo martesë sa të jem

unë gjallë! S'kam për ta lejuar!"

U përmend nga tërë kjo tollovi mendimesh dhe ndali.

"Nuk ka për t'u bërë! - i tha vetes. - Po si do ta ndalosh. Me ç'të drejtë? Ç'mund t'u ofrosh që të sundojë e drejta? T'u përkushtohesh, kur të mbarosh universitetin? Kur të rregullohesh me punë? I kemi dëgjuar, dokrra janë... Diç duhet bërë... Se deri më sot ti ç'ke berë? Vetëm i ke rjepur! Paratë që të dërgojnë i marrin duke lënë peng pensionin, apo duke shërbyer te Svidrigajllovi... Ti vetë ç'duhet të bësh, mor milioner i ardhshëm, o Zeus që ke ndër duar fatin e tyre? Do t'i begatosh pas dhjetë vjetësh? Po deri atëherë mamaja do jetë verbuar nga puna e dorës, po edhe nga lotët! Po motra? Nuk është aspak e vështirë ta përfytyrosh si do të jetë katandisur pas dhjetë vjetësh dhe gjatë këtyre dhjetë vjetëve... E qartë?"

Kështu e torturonte veten dhe i cyste nervat me gjithfarë pyetjesh dhe, për çudi, nga kjo ndjente kënaqësi. Ç'është e vërtetë, pyetje si këto nuk qenë të parat që ia bënte vetes. Prej kohe e kishte pllakosur pikëllimi, po ia merrte shpirtin leqendisja, tani po i bëheshin të padurueshme. Erdhi një çast që iu përqendruan në një pyetje të vetme, të tmerrshme, të egër, që kërkonte domosdo përgjigje. Letra e nënës e tundi fort dhe e tronditi, si gjëmimi në ditën me diell. E ç'qe kjo zgërlaqje dhe zhgërryerje mosmëkeq, duhej vepruar, të merrnin fund arsyetimet munduese dhe shastisëse, diç duhej bërë, dhe sa më shpejt, më mirë. O të ndërmerrej diçka, o...

"Duhet hequr dorë nga jeta! - nëpërdhëmbi si në makth. - T'i nënshtrohem fatit, ta mbys që në embrion çdo të drejtë për të vepruar, për të jetuar dhe për të dashuruar!...".

"Po a e kuptoni dot, mor zotëri mëshirëplotë, ç'do të thotë të mos kesh ku të përplasësh kokën? - iu kujtua pyetja e djeshme e Marmelladovit. - Se cilido njeri duhet të ketë ku ta përplasë kokën!...".

I shkuan mornica në trup: mendjen si turjelë ia çpoi po ai mendim që i vezulloi dhe dje. E dinte, e parandiente që do t'i përçohej përsëri në mendje, po e priste t'i ndodhte, por tanimë kishte marrë një tjetër pamje. Nëse deri dje qe vetëm mendim e fantazi, vetëm një gjyç, tani... po i shfaqej me forcë kërcënuese, kishte marrë pamje krejt të panjohur më parë për të... ishte bërë mendim i ndërgjegjësuar, i vetëdijshëm... Iu errën sytë si ta kishin goditur prapa kokës me një send të rëndë.

Kërkoi me sy një vend ku të ulej pak, pa një stol nja njëqind metra më tutje, nxitoi për atje, që të merrte pakëz frymë. Në këtë kohë, nja njëzet metra para tij, po ecte një grua; në fillim nuk i kushtoi aspak vëmendje; i kishte ndodhur dhe jo rrallë që të kthehej në shtepi pa e ditur fare se nëpër ç'rrugë ecte, i qe bërë zakon të çapitej si në tym. Por te kjo grua vuri re diçka të çuditshme, që ia tërhoqi vëmendjen, që të binte menjëherë në sy: e pa në fillim si pa dashje, madje me një si inat, pastaj nuk po mundte dot t'ia shqiste shikimin. U bë kurreshtar të merrte vesh ç'kishte te kjo grua të çuditshme? Ishte një vajzë fare e re, ecte kokëzbuluar në piskun e vapës, duke tundur në një mënyrë tepër qesharake krahët. Kishte veshur një fustan të lehtë prej mëndafshi, por se si i rrinte në një mënyrë allasoj, e kishte mbërthyer, kurse një goxha copë i varej. Në qafë kishte lidhur një shami të vogël, por i rrinte shtrembër, i valvitej kur ecte. Kryesorja ishte që hapin e bënte të pasigurt, i merreshin këmbët. S'kishte si të mos tërhiqte vëmendje! E arriti afër stolit, ku kjo u plandos, mbështeti kokën mbi duart që i vuri në shpinën e stolit dhe mbylli sytë; me sa dukej, nga lodhja e madhe. E kuptoi që ishte e dehur. U rrëqeth dhe u pezmatua shumë nga kjo pamje, nuk po u besonte syve. Dukej fare e vogël, rreth gjashtëmbëdhjetë vjeçe, edhe më pak, ishte flokëverdhë, fytyrën e kishte të ëmbël, por flakë të kuqe e të buhavitur. Dukej që s'ishte fare në të, njërën këmbë e hodhi mbi tjetrën, por të hapur më shumë sa duhej, dukej që nuk dinte as ku ndodhej dhe as çfarë bënte.

Raskolnikovi nuk u ul, por as të largohej nuk donte, qëndroi në këmbë pranë saj, pa e kuptuar as vetë ç'po bënte. Në rrugë nuk kishte këmbë njeriu, ishte vakt dreke. Vetëm në anën tjetër të bulevardit i zuri syri një zotëri, që, me sa dukej, dëshironte t'i afrohej vajzës për ndonjë arsye të vetën. Me sa dukej po e ndiqte, por se prania e Raskolnikovit e pengonte. E shihte me inat dhe priste me padurim që ky leckaman të largohej. Ishte rreth të tridhjetave, bullafiq e rrondokop, me buzë të fryra të kuqe dhe me mustaqe të holla si bisht miu, i veshur shik. Raskolnikovit i hipi damari kur e nuhati ç'qëllime kishte ai zarbo, ndjeu një dëshirë të papërmbajtur për ta fyer barkalecin. E la vajzën dhe iu afrua zotërisë.

- Ej, Svidrigaillov, ç'pret aty? - i thirri duke shtrëguar grushtat dhe duke u zgërdhirë me buzët e thara e të pjekura.

- Po juve ç'ju duhet, - e pyeti rreptë zotëria, duke e parë i vrenjtur dhe me përçmim.

- Mbathja sa s'është vonë!

- Kujt i flet ashtu ti, more harbut?...

Ngriti kamxhikun që t'i binte. Raskolnikovi iu turr me grushta, pa e patur fare në hesap që ky kokoroç i vinte përfund edhe nja dy si ai. Atë çast e pushtuan dy krahë të fuqishëm, në mes tyre qëndronte polici.

- Nuk lejohen zëniet në vende publike! Ç'patët kështu? Kush jeni? - Me këto pyetje iu drejtua Raskolnikovit të veshur mosmëkeq.

Ky e pa drejt në sy. Polici mbahej rëndë, kishte pamje ushtaraku të regjur, në fytyrën si të ngrirë i veçoheshin mustaqet e thinjura dhe shikimi i qetë i syve.

- Hë, ju më duheni! - thirri Raskolnikovi dhe e kapi nga duart. - Jam student, Raskolnikov më quajnë... Dëgjoni edhe ju! - iu drejtua sakaq zotërisë. - Shkojmë, t'u tregoj diçka...

E mori policin nga krahu dhe e çoi te stoli.

- Shiheni vetë, është fare e dehur, kushedi kush është, nuk duket nga ato... Ndoshta ndokush e ka dehur dhe e ka mashtruar..., e kuptoni? Pastaj e ka braktisur, e ka lënë në rrugë. Shiheni si ia kanë shqyer fustanin, shihni se ç'pamje ka, duket që nuk ka qenë në vete, e kanë veshur dosido dhe e kanë zbuar. Tani dëgjoni: ai tipi, me të cilin desha të kapem, është për mua krejt i panjohur, e shoh për herë të parë; e pa që është e dehur dhe mezi pret t'i afrohet që ta marrë me vete. Këtë as topi s'e luan! Nuk më gënjen syri mua! E pashë me sytë e mi që po e ndiqte, isha unë që e pengova, mezi pret që të largohem. Ja, tani u tërhoq pak mënjanë, bën sikur po dredh cigaren... Nuk duhet lejuar kjo! Duhet çuar në shtëpi vajza! Unë prandaj ndala pranë saj...

Polici e kuptoi si qëndronte puna. Rrondokopi dukej çfarë malli ishte, duhej menduar për vajzën. U përkul ta shihte më mirë, një keqardhje prindërore iu shfaq në fytyrë.

- Sa keq! - tha, duke tundur kryet. - Qënka fare fëmijë; e paskan mashtruar, zavallen! Dëgjoni, zonjushë, - foli. - Ku e keni shtëpinë?

Vajza mezi i hapi kapakët e rënduar, pa me sy të dehuri dhe tundi dorën.

- Dëgjoni, - i tha Raskolnikovi policit. Na (futi dorën në xhep dhe

nxori njëzet kopejka, shyqyr që iu gjendën!) merrini këto, zini një pajton dhe çojeni në shtëpi.

- Zonjushë! Zonjushë! - i thirri përsëri polici, pasi i mori paratë. - Po ju sjell një pajton dhe po ju shoqëroj vetë. Ku e keni shtëpinë? Ku banoni, ë?

- Po ç'keni me mua?... Ç'doni nga unë? - belbëzoi vajza me gjuhë të trashur dhe përsëri tundi dorën.

- Nuk është mirë kështu! Nuk bën kështu, zonjushë! Turp e faqja e zezë! - tundi kryet me hidhërim dhe keqardhje polici. - Ç'të bëjmë me këtë? - iu drejtua Raskolnikovit, duke e peshuar me sy që nga koka e deri te këmbët. Njeri i çuditshëm: vetë trokë e copë, po për tjetrin s'u kursye!

- Ju ku e patë për herë të parë? - e pyeti.

- Ju thashë: po ecte përpara meje, i merreshin këmbët, çapitej e pasigurt. Kur pa stolin, u plandos.

- Turpe, turpe janë këto! Shëtit apo nuk shëtit në mes të ditës, ë? Fare axhami dhe e dehur! E kanë mashtruar, duket ajo! Edhe fustanin ia kanë shqyer! U prish bota fare! Duket goxha e fisme, ndonëse e varfër... Ka shumë nga këto tani... Dhe sa e njomë që është? Zonjëzë e vërtetë! - u përkul përsëri për t'i thënë diçka.

Ndoshta i kishte në shtëpi të kësaj moshe vajzat, në dukje të edukuara dhe me ca sjellje të modës.

- Kryesore, - i tha i merakosur Raskolnikovi, - të mos e lëmë t'i afrohet ai maskarai! S'mjafton kjo, por duhet që edhe ai t'a përdhosë! Duket çfarë synimesh ka. Rri aty dhe nuk do që nuk do të largohet, horri!

E tha me zë të lartë, duke treguar me dorë në drejtim të tij. Ky e dëgjoi dhe i bëri ca shenja kërcënuese, por u mjaftua me kaq dhe vetëm e pa me përbuzje. U largua edhe si ndonja dhjetë hapa dhe ndali përsëri.

- Nuk do ta lëmë këtu vajzën, - tha polici mendueshëm. - Vetëm të na thotë ku ta çojmë... Zonjushë! Zonjushë! - i thirri përsëri duke u përkulur.

Atë çast vajza i hapi sytë. Pa e përqëndruar, me sa dukej, e kuptoi ç'i kishte ndodhur, u ngrit dhe eci në drejtimin që kishte ardhur.

- Të pacipët! M'u qepën! - tha dhe tundi dorën. Eci me çap të

shpejtë, duke u tundur e lëkundur si më parë. Barkaleci e ndoqi pas, por duke ecur në anën tjetër të rrugës.

- Mos ki merak, nuk do ta lëmë! - tha i vendosur polici dhe shkoi pas tyre. - Ç'poshtërsi!

Raskolnikovit diç iu kujtua, u trondit dhe u merakos sa më s'bëhet.

- Dëgjoni këtu, - i thirri policit.

Ky ktheu kokën.

- Po ju ç'punë keni? Le të gallaviten (i tregoi me dorë në drejtim të bullafiqit). Punë për të!

Polici e pa i habitur. Raskolnikovi ia plasi gazit.

- Njerëz po njerëz! - mërmëriti ruajtësi i rendit, tundi dorën dhe shkoi pas barkalecit dhe vajzës. Dukej sheshit që Raskolnikovin e kishte pandehur për të lajthitur, apo për ndonjë akoma më keq; për njeri allasoj...

"Njëzet kopejkat i futi në xhep, - nëpërdhëmbi me ligësi Raskolnikovi, kur mbeti vetëm. - Do marrë diçka edhe nga ai tjetri dhe do ta lërë të bëjë ç'të dojë.. E ç'mu desh ta ndihmoja? E kush? Unë që jam vetë trokë e copë... Kokat nuk paskan ngrënë! S'më duhet gjë! Dhe njëzet kopejkat më shkuan dëm! Nuk ishin as paratë e mia!".

Ngjarja i rëndoi plumb në zemër. U ul në stolin bosh, mendja i vinte vërdallë, mendimet njëri më i zymtë se tjetri i vinin valë-valë. Donte të prehej, të mos mendonte për asgjë, t'i harronte që të gjitha, ta fillonte jetën nga e para...

- E gjora vajzë! - tha, duke parë cepin e stolit ku qe ulur pak më parë. - Kur të vijë në vete, do qajë e do ënjtet, do ta marrin vesh prindët... do ta rrahin e mallkojnë, ndoshta mund edhe ta dëbojnë nga shtëpia. Por edhe në nuk e dëbofshin, do të gjenden ca Darje Francovna, që do ta nuhasin si qëndron puna, dhe do detyrohet të marrë rrugët, fatzeza!.. Pastaj materniteti... (kështu u ndodh gjithmonë vajzave të dyerve të mira që u dalin dore prindërve) dhe përsëri materniteti... dehjet... mejhanet... sëmundjet... gjymtimet... dhe të tëra këto pa mbushur ende të nëntëmbëdhjetat... Pse pak ka nga këto? E si u ka ndodhur? Ja, kështu u ka ndodhur!... Ptu!... Po punë për to... Thonë se kështu u dashka! Një përqindje, thonë, çdo vit duhet të shkojë... në përdorim të të tjerëve. Përqindje!... Fjalë e mrekullueshme, magjepëse! Sa qetësuese, aq dhe shkencore! Po u tha se bën pjesë në

përqindje s'ke pse merakosesh! Të kishte qenë ndonjë fjalë tjetër, edhe mund të leqendiseshe, por me këtë, jo! Vallë ç'do të bëhej sikur dhe Dunjecka të hynte në përqindje? Në qoftë se jo në këtë, në atë tjetrën!...

"Po ku po shkoj kështu? - i thirri sakaq mendjes. - Unë se për ku isha nisur? Lexova letrën dhe u nisa... Po, në ishullin Vasilevski, te Razumihini po shkoja... Po përse? Ç'më shtyu të nisesha tek ai?".

U habit vetë me veten. Razumihini ishte një shok nga të universitetit. Kur kishte qenë student, Raskolnikovi nuk para shoqërohej me njeri, nuk shkonte te ndonjë dhe as nuk priste që t'i vinte njeri. S'kaloi shumë dhe që të gjithë i kthyen krahët. Nuk merrte pjesë as në mbrëmjet studentore, as në argëtime të tjera, nuk shkonte gjëkundi. Mësonte shumë, s'e kursente veten dhe për këtë e respektonin, por për të dashur nuk e donin. Ishte shumë i varfër, por kishte krenari prej fodulli, nuk shoqërohej me njeri, dukej sikur diç fshihte brenda vetes. Ndokujt i dukej se i shihte me nënçmim të tjerët, se e mbante përpjetë hundën, se i dukej vetja njeri me bindje më të shendosha se ata, se ishte më i zhvilluar, dhe kishte interesa gjuhësore më të gjera se të tjerët.

Me Razumihinin i hahej muhabeti, por jo kushedi çfarë, sidoqoftë, i hapej më shumë se kujtdo tjetër. Ishte një djalosh i qeshur, tip i shoqëruesheëm me njerëzit, zemërmirë dhe i thjeshtë. Prapa kësaj thjeshtësie fshihej edhe thellësia e shikimit të gjërave dhe dinjiteti i tij. Shokët e donin dhe e respektonin. Ishte veç kësaj edhe djalë i pashëm: shtatlartë e truphedhur, vinte ezmer dhe i pëlqente të rrinte i parruar. I kishte qejf edhe zullumet, sepse e mbante veten për të fuqishëm dhe ia kishte ënda ta manifestonte këtë fuqi. Pinte shumë, kur i paraqitej rasti, por e mbante pijen, kurrë nuk e kishte parë të dehur, veç mund të rrinte edhe pa vënë pije në gojë. Kishte dhe një veçori tepër të çuditshme: asnjë mossukses nuk e dëshpëronte dhe nuk e thyente, asnjë rrethanë rënduese nuk ia prishte terezinë. Pranonte të flinte edhe në parafingon më të keqe, e duronte urinë mizore, të ftohtët cingërimë. Ishte i vobegtë; mezi që e mbante shpirtin me frymë. S'kishte asnjë ndihmë, vetë punonte dhe rronte. Ishte tip i shkathët dhe i njihte mirë burimet ku mund të fitohej diçka. Si Raskolnikovi, dhe ky kishte qenë i detyruar ta braktiste përkohësisht

universitetin, i ishte vënë punës për stabilizimin e gjendjes financiare, që do t'i jepte përsëri mundësi ta vazhdonte shkollën. Raskolnikovi kishte katër muaj që s'e kishte takuar, dy muaj më parë e kishte parë rastësisht në rrugë, por i kishte kthyer krahët dhe ishte larguar, nuk kishte dashur ta takonte. Razumihini këtë e kishte vënë re duke bërë sikur nuk e pa, pa dashur ta turbullonte mikun.

V

"Vërtet që pak kohë më parë desha t'i drejtohesha Razumihinit të më gjente ndonjë punë, të më rregullonte ca orë mësimi, - tha me vete, - por tani ç'ndihmë t'i kërkoj? Se ja, më gjeti ca orë, kopejkën e fundit e ndau me mua, bleva dhe një palë çizme, po pastaj? Pse shkohet jeta me kësisoj vogëlsirash? S'kanë ç'më duhen cingërima si këto! Nuk është kjo që më nevojitet në çastin e dhënë! Për të qeshur është që mora rrugën për te Razumihini!"

Ecte rrugës dhe fërkonte ballin e rënduar nga mendimet. Pyetja përse po shkonte tani te Razumihini po e brengoste më tepër nga ç'i dukej. Po kërkonte një përgjigje ogurzezë të arsyes që po e shtynte, ndonëse veprimi ishte krejt i rëndomtë. Kur krejt befas i shkrepi edhe një mendim i çuditshëm që lidhej me një vendim të formës së prerë: "Hm!... Razumihini, - përsëriti tanimë i qetë. - S'do mend që do shkoj tek ai, po jo tani. Do shkoj të nesërmen e *asaj*... pasi të ketë marrë fund gjithçka... pasi punët të marrin një rrjedhë të re".

Dhe përsëri iu kthye mendimeve të mëparshme.

"Pas *asaj*?... - thirri dhe u drodh fort. - Po pse, a do të ndodhë, vallë *ajo*? Si, do të ndodhë?".

Eci thuajse me vrap, donte të kthehej andej nga kishte ardhur, nga shtëpia, por iu rrëqeth shtati kur mendoi: pse aty, në atë vrimë, në atë strofull, ku i feksin vetëm mendime ogurzeza, aty do të kthehej? Shkoi nga sytë këmbët.

Të dridhurat nervore ia lanë vendin shkulmeve të tmerrshme, si ato të etheve të forta. U ftoh e u bë akull dhe kur pa, në një vapë si kjo. Si me përdhunë, pa qenë i vetëdijshëm për atë që po bënte, por i nxitur nga disa shtysa të brendshme, ia qepte shikimin gjithçkaje që i

dilte përpara, si duke kërkuar një gjë zbavitëse, këndellëse, por pa sukses, pas çdo hapi që bënte zhytej gjithë më tepër në një pikëllim të pushtetshëm. Kur e çonte kokën dhe shihte përreth, e harronte edhe atë që kishte menduar apo bërë pak më parë. Në atë amulli mendimesh çau mespërmës ishullin e Vasilevskut, doli në Nevën e Vogël, kaloi urën dhe ktheu në një park. Gjelbërimi dhe ajri i freskët ia gëzuan sytë e lodhur, të munduar nga pluhuri i qytetit, nga përcëllima e gëlqeres, nga zymtia e shtëpive të ngjeshura bri njëra-tjetrës. S'të merrej fryma, s'të kutërbonte era e qelbur, s'të vrisnin sytë mejhanet. Por shpejt edhe këto ndijime gëzimdhënëse iu bënë ngacmuese, po e eksitonin. Ndalonte para ndonjë vile të zhytur në gjelbërim, shihte gjerdhet, livadhet ku lodronin fëmijët, rruginat ku shëtisnin të rriturit e veshur si për festë, sidomos ia gëzonin syrin lulet, i shihte gjatë dhe me kërshëri. I kalonin përbri edhe pajtonë luksozë, kalorës e kalorëse elegantë, i shoqëronte me sy, por nuk arrinin mirë të zhdukeshin dhe ai i kishte harruar. Futi dorën në xhep dhe nxori gjithë ç'i kishte mbetur: tridhjetë kopejka. "Njëzet ia dhash policit, tri Nasties për letrën, del që Marmelladovëve i paskam lënë në parvazin e dritares dyzetë e shtatë kopejkë", - mendoi, por në çast e harroi edhe këtë. Paratë iu kujtuan përsëri, kur po kalonte pranë një qebaptoreje, e ndjeu se kishte uri. Hyri, piu një gotë vodkë, hëngri një copë byrek. Kishte kohë që nuk kishte vënë në gojë vodkë, ajo pak që piu i bëri efekt: iu rënduan duar e këmbë, po i mbylleshin kapakët e syve. Mori rrugën për në shtëpi, por s'bëri shumë dhe iu prenë këmbët, ktheu në një vend me bar, u shtri dhe e mundi sakaq gjumi...

Kur njeriu nuk ndihet mirë, ëndrrat i sheh shumë të qarta, fare konkrete, reale. I faniten ngjarje përbindshore, por mjediset, veprimet, i dalin aq të prekshme, të shoqëruara nga hollësi aq të besueshme e bindëse, por njëherazi aq të papritura, veç kurdoherë në përputhje të plotë me dukuritë reale, aspak të sajuara, të pamundshme për t'u rikrijuar makar nga të tillë artistë madhorë si Pushkini apo Turgenjevi. Janë këto ca ëndrra të dhimbshme, që mbahen mend gjatë, që e trondisin për kiamet njeriun, e lënë pa mendje.

Edhe Raskolnikovit iu fanit pikërisht një nga këto lloj ëndrrash; kishte lidhje me një ngjarje të fëmijërisë. Ishte rreth shtatë vjeç, kishte dalë shëtitje në një ditë feste, në mbrëmje, me të atin. Qielli ishte

mbuluar me re të errëta, ishte zagushi, vendi i ngjarjes ishte tamam si ai që i ndërmendej realisht, madje, në kujtesë e ruante më të zbehtë se tani në ëndërr. Qyteti iu fanit ashtu siç kishte qenë, veç tani nuk kishte as edhe një pemë për be, por ama diku në horizont nxinte pylli. Ja dhe gjerdhet e fundit, pak më tej u duk pijetorja e madhe, që kurdoherë i pat lënë mbresa të pakëndshme, madje i kallte frikën në kohën e shëtitjeve që bënte me babanë jashtë qytetit. Rrinte ngahera plot me njerëz që bërtisnin, qeshnin, shaheshin, këndonin aq shëmtuar, sa të ngrihej përpjetë leshtë e kokës, nuk ishin të rrallë rastet që rriheshin, të dehur dhe të jargavitur siç qenë... Kur i shihte, shtrëngohej pas të atit dhe dridhej nga frika. Edhe rruga për në pijetore ishte e pluhurosur, e pistë; jo larg ishin varrezat. Në mes tyre ngrihej një kishë guri me një kupolë të gjelbër, aty shkonte në të rrallë me të ëmëm dhe t'anë, kur falnin përshpirtje për gjyshen, që kurrë nuk e kishte parë. Nëna përgatiste nafrata dhe i vinte në një sahan të bakërtë. I pëlqente kjo kishë me ikonat e çuditshme, me priftin plak që i dridhej koka dhe duart. Pranë varrit të gjyshes ishte varri i vëllait të vogël, që nuk i mbushi as gjashtë muaj: nuk e mbante mend, por i kishin thënë që kishte patur një vëlla dhe sa herë që vinte aty, bënte kryqin, përkulej dhe ngashërehej nga pamja e atij kryqi të gurtë që i kishin vënë te koka.

Pa në ëndërr sikur po shkonte në varreza me babanë, rruga i çoi përpara mejhanes së madhe. E mbante babanë për dore dhe shihte me ndrojtje nga mejhaneja. I tërhoqi vëmendjen diçka e pazakontë: turma grash e burrash të veshur si për festë shëtisnin. Kishte shumë të dehur që këndonin dhe bërtisnin, në oborr qëndronte një karrocë e mbrehur me dy dorinj, mbushur me fuçi dhe gjithfarë rrangullinash. I shihte me qejf këta kuaj trupmëdhenj, jelegjatë, kofshëtrashë, që ecnin me një trok të shtruar, kurdoherë të rregullt, dhe që tërhiqnin ngarkesa të mëdha sa një mal pa u sforcuar dhe pa e prishur terezinë, madje me ngarkesë dukeshin edhe më të qetë. Tani, për çudi, në një karrocë të tillë kishin mbrehur vetëm një pelë imcake, nga ato, e dinte fort mirë këtë, të cilat i ngarkojnë me një barrë dru, a me sanë, sidomos në ato raste, kur karrocat kanë rrezik të ngecin në baltë apo kur mungojnë rrugët dhe që ngaherë i godasin me hu, ndonjëherë edhe në kokë, dhe aq fort, sa të këputet shpirti, s'i sheh dot, të vjen të qash e të ulërish, dhe mamaja kurdoherë të heq nga dritarja. Befas u dëgjua

zhurmë e potershme e britma, nga mejhaneja me të thirrura dhe këngë të shëmtuara dolën truma-truma të dehurit, ca muzhikë të bërë tapë, me këmishë të kuqe dhe blu, me kaftanë hedhur qafës. "Hipni, de, hipni! - u thoshte një muzhik në moshë të re, me qafë mishtake e me fytyrë të kuqe si karrotë. - Ju çoj ku të doni!". U dëgjuan të qeshura dhe romuze.

"Po pse, kalë për këtë karrocë është ky?"

"Mos ke lojtur, mo Mikollkë? Këtë mëz paske mbrehur?"

"E ç'thua, a derëbardhë? I ka vjeçët në lëkurë ajo!"

"Hipni, ju thashë! - thirri përsëri Mikollka dhe i pari zuri vend në karrocë, mori frerët dhe e drejtoi trupin."

"Doriun e ka Matvei, - u thotë që aty, - kurse kjo pelë, vëllezër, as dhe një lekë nuk bën, më mirë sopatën pas zverkut dhe t'i lash duart, kot e ha tagjinë! Po unë ju thashë, hipni! Me revan do ta bëj të ecë, keni për ta parë!" - Rrëmbeu kamxhikun, e tundi disa herë në ajër dhe u bë gati ta qëllonte.

"Hë, hipni! - dëgjohen të qeshura dhe qortime. - The që do e ngasësh me revan?"

"Ka nja dhjetë vjet, mos më shumë, që nuk di se ç'është revani ajo..."

"Di, ajo di, keni për ta parë! Merrni nga një hu dhe kush mundet sa t'i hajë krahu ta qëllojë..."

"Ashtu thua? Bjeri atëherë!"

Kërcyen në karrocë me ohma dhe shpoti. U bënë nja gjashtë, po nxinte edhe më. Hipën edhe një nënole bajmake e faqeplloskë, veshur me nje fustan taftaje me pala, të zbukuruar përfundi edhe me dantella; kishte mbathur këpucë të lehta lëkure; çante me dhëmbë lajthi dhe i përtypte, tërë kohën qeshte. Gjindja gajasej dhe kishte përse: një pelë ngordhalaqe do tërhiqte tërë ata diva! Dy nga djemtë rrëmbyen nga një hu që të ndihmonin Mikollkën. Dëgjohet: "Ec!". Pela u tendos, vuri të gjitha forcat, por jo me revan, as me hap nuk eci dot, rrahu tokën me thundra, u përpoq më kot ta tërhiqte nuk mundej; shtrembërohej dhe përkulej nën goditjet vdekjeprurëse, por për të lëvizur, nuk lëvizte dot nga vendi. Britmat e hareshme, gajasja, fërshëllimat, poterja mbuluan dheun; Mikollka fare i tërbuar e qëllonte dhe e qëllonte, i vendosur ta detyronte të nisej revan...

"Më bëni dhe mua pak vend, vëllezër, - tha një djalosh i ushqyer që u shkëput nga gjindja."

"Hip! Kush të dojë, le të hipë! - u tha Mikollka. - Të gjithëve u çoj ku të doni! Do ta ngordh në dru!" - vazhdonte t'i binte kafshës së gjorë. Dalldisej aq keq, sa nuk dinte me ç'tjetër ta godiste.

"Babi, babi! - bërtiti djali, duke iu drejtuar të atit. - Ç'po bëjnë ashtu? Po do ta vrasin fare kalin e shkretë!"

"Shkojmë, shkojmë! - tha babai. - Janë të dehur, e kanë si punë argëtimi. Shkojmë, hiqi sytë që aty." - Donte ta largonte, por djali u shkëput dhe e mbajti frymën te pela. Kjo mezi po mbahej në këmbë, mblidhte forcat e fundit për ta tërhequr karrocën, pushonte pak që të mbushej me frymë dhe përsëri tërhiqte, mend rrëzohej.

"Po bjeri, more bjeri! - thërriste Mikollka. - U pa puna s'e lë të gjallë!"

"Ç'bën ashtu more, por është hajvan pa gojë!" - i bërtiti një plak nga grumbulli i njerëzve.

"E ku është parë që një pelë si kjo të tërheqë një asisoj ngarkese?" - shtoi një tjetër.

"Do ta ngordhësh të mjerën kafshë!" - u ankua një i tretë.

"S'ka punë njeri! Pela ime është! Ç'më do qejfi, bëj me të! Kush të dojë le të hipë! Do ta nis revan se s'bën! O ajo, o unë këtu!"

Nga të katër anët dëgjoheshin të qeshura, pela nuk po i duronte dot më goditjet vdekjeprurëse... po i shtrembëroheshin këmbët. Edhe plakut nuk iu durua pa vënë buzën në gaz.

Dy djemtë nga grumbulli se ku gjetën nga një hu dhe zunë t'i qëllojnë brinjëve me sa u hante krahu, secili për hesap të vet.

"Turinjve bjeri! Syve veshja! Ja, ashtu!" - bërtiste njëri që kishte hipur në karrocë. Ia morën këngës; se nga u gjend dhe një def, fërshëllima, britma, gajasje... Gruaja vazhdonte të çante lajthitë me dhëmbë dhe të gajasej...

Djali i doli përpara pelës, vrapoi anës, pa se me çfarë tërbimi e qëllonin, se si e godisnin ku të mundeshin... U shkreh në vaj, zemrën ia shtrëngonin spazma aq të forta, sa s'e linin të mbushej me frymë. Njëri nga ata që i binte me hu pelës e goditi me bërryl në fytyrë, ai këtë as që e ndjeu, u end sa andej-këtej si në makth, bërtiti, iu afrua herë njërit dhe herë tjetrit, u sul për te plaku thinjosh, i cili tundte

kryet në shenjë mosmiratimi. Një grua e kapi nga dora dhe donte ta largonte, por ai u shkëput vrulltas dhe e mbajti frymën përsëri te pela. Kjo mezi po mbahej në këmbë, ishin forcat e fundit, e prapë se prapë mundohej ta tërhiqte karrocën.

"Të çaftë ujku të çaftë!" - ulëriti fare i tërbuar Mikollka. E hodhi matanë kamxhikun dhe nxorri që poshtë ndenjëses një litar të trashë me një nyje të trashë në fund, e ngriti lart me të dyja duart dhe e lëshoi me sa fuqi që kishte mbi kurrizin e peles.

"Do ta ngordhë!" - thërrisnin njerëzit.

"Mezi po mbahet!" - thanë ca të tjerë.

"Punë për mua, pela ime është!" - ua kthente Mikollka dhe vazhdonte ta godiste me nyjen e litarit.

"Bjeri, hë ashtu!" - thërrisnin nga të katër anët.

Dhe Mikollka përsëri e përsëri e godiste me sa fuqi që kishte. Kafsha u lëkund, mezi po e mbanin këmbët, dukej që ishte duke dhënë shpirt. Fare e këputur u përpoq edhe një herë ta tërhiqte, por nga të katër anët e pritën goditjet. Mikollka fare i çakërryer mblodhi të gjitha forcat që t'i jepte goditjen e fundit dhe ta linte top në vend.

"S'i dalka shpirti", - u dëgjuan zëra aty pranë.

"Prite kur të bjerë, iu sosën ditët! - tha një sehirxhi nga turma.

"Bjeri me sopatë, ç'e mundon hajvanin e gjorë!" - tha një i tretë.

"Ta tregoj unë qejfin ty tani! Largohuni!" - ulërinte fare i çakërdisur Mikollka. E vërviti matanë litarin, u përkul në karro, nxori një varré. "Largohuni!" - thirri dhe me sa fuqi që kishte e përplasi në kurrizin e kafshës. Kësaj iu përthyen gjunjët por u mbajt, varreja edhe një herë iu përplas në kurriz, kafsha u rrëzua për tokë si t'ia kishin prerë që të katra këmbët.

"Bjerini që të ngordhë!" - ulërinte Mikollka. Dukej që ishte çmendur, hidhej e spërdridhej para pelës që po jepte shpirt. Disa djemë të larë në djersë nga dehja dhe zullumi iu afruan me nga një hu në dorë dhe iu sulën për t'i dhënë goditjen e fundit. Mikollka, nga ana tjetër, vazhdonte ta qëllonte me varré. Pela zgjati kryet, u drodh në grahmat e fundit dhe s'u ndie më.

"Ngordhi!"

"E pse nuk u nis revan? Gjëja ime është, bëj me të ç'më do qejfi!" - iu drejtua të pranishmëve Mikollka, që rrinte me varré në dorë, me

fytyrën flakë të kuqe dhe me sy të përgjakur. Dukej i vinte keq që nuk kishte kë të qëllonte më.

"Njeri i pashpirt!" - thanë disa.

Kurse i gjori djalë nuk dinte çfarë të bënte: u turr me ulërimë e kuje drejt pelës, u ul më gjunjë pranë kafshës së ngordhur, të gjakosur, i puthi sytë, buzët... Pastaj u çua dhe u derdh si i tërbuar drejt Mikollkës, e goditi me grushta me sa fuqi që kishte. I ati, më në fund, arriti ta kapë dhe ta largojë s'andejmi.

"Shkojmë, shkojmë! Kthehemi në shtëpi!" - i tha.

"Babi, po ç'kishin me të... E gjora pelë... E vranë..." - shqiptoi djali me zë të ngjirrur përmes dënesash.

"Janë të dehur, s'merresh dot vesh me ta!" - i tha.

Ia shtrëngoi fort dorën të atit, spazma të forta ia ngushtonin zemrën, mezi mbushej me frymë, dridhej si në ethe... dhe u zgjua nga gjumi.

Ishte ujë në djersë, pa përreth i tmerruar.

- Lavdi Zotit që qënka ëndërr! - tha Raskolnikovi, duke ndenjur ulur nën pemë dhe duke u mbushur me frymë. - Po ç'paskam kështu? Nuk jam mirë, jo!... Sa ëndërr të keqe që pashë.

I dhimbte trupi, mendimet i kishte të trazuara. Mbështeti bërrylat mbi gjunjë dhe pushtoi kokën me të dyja duart.

- O Zot! - thirri. - Po a do kem zemër që të marrë sëpatën dhe t'i hap trutë?... Të shkel mbi gjakun e ngrohtë, të thyej drynin, të vjedh, të mos gjej vrimë ku të futem, ashtu i lyer me gjak... O Zot! Ç'do bëhet me mua!...

Nuk po i përmbante dot të dridhurat.

- Po ç'është kështu me mua? - pyeti veten i çuditur. - E di që nuk kam zemër për të tilla punë dhe përsëri e mundoj dhe e torturoj veten? Edhe mbrëmë, kur shkova për *provën*, u binda përfundimisht që nuk kam si e bëj, nuk mundem ta duroj... Dje, kur po zbrisja shkallët *e asaj*, i thashë vetes se kjo që po mendoja të bëja është makabre, e përbindshme, e pështirë... Vetëm kur e shkoj më mendje, më luan tepeleku i kokës, më ngrihen leshtrat përpjetë! Jo, nuk kam si e bëj! Hesapet, po, po, janë të sakta, vërtetë që tërë këtë muaj i rraha dhe i stërraha të gjitha, i ktheva gjërat mbarë e prapë, dhe aritmetika është aritmetikë, por, o Zot, nuk kam si vendos! Nuk e duroj dot! Po pse

atëherë s'më lë të qetë kjo mëdyshje?...

U ngrit, pa i përhumbur përreth, eci në drejtim të urës T.

Ishte krejt i sëmurë, i dhimbnin sytë, i këputeshin krahët, por kishte filluar të merrte frymë lirisht. E ndiente mirë veten pasi kishte arritur ta shkëpuste nga gjoksi atë brengë, ta shkarkonte nga supet atë barrë aq të rëndë. "Zot i madh! - tha me vete. - më ndihmo të eci në rrugën e perëndisë dhe kam për t'i flakur tej këto tundime të mallkuara!".

Kur po kalonte urën, pa i qetuar dhe i përdëllyer Nevën, perëndimin e përflakur. Ishte fare i pafuqishëm, por nuk ndjente lodhje. Çibani i qelbëzuar, që ia kishte ligështuar mosmëkeq zemrën, kishte plasur. Ndjente një lehtësim të madh në shpirt... I qe larguar magjia, truajtja, mallkimi! Më pas, duke kujtuar deri në imtësi gjithë sa kishte provuar këto ditë, deri në bestytëri e habiste një rrethanë, që në vetvete nuk ishte kushedi sa e jashtëzakonshme, por atij atëherë se përse i qe dukur si përcaktuese e fatit të tij. Ashtu i drobitur dhe i sëmurë siç ishte, përse, vallë, u kthye në shtëpi duke kaluar përmes Sheshit të Senës, kur shumë mirë mund të kthehej nëpër rrugën më të shkurtër. Laku që bëri nuk ishte kushedi sa i madh, por ama kishte qenë fare i panevojshëm. Sigurisht, sa e sa herë i kishte ndodhur të kthehej në shtëpi pa e ditur fare se në ç'rrugë po ecte, por përsëri e përsëri e pyeste veten: përse pikërisht këtë herë t'i ndodhte ai takim aq i rëndësishëm, vendimtar, dhe në të njëjtën kohë aq i rastësishëm këtu në Sheshin e Senës. (Se aty s'kishte fare pse kalonte!). Dhe pikërisht në këtë orë, në këtë minutë, kur i zjenin në kokë mendime të nxehta, në ca rrethana aq të rënduara!... Si ta kishte selitur vetë dreqi atë takim fatal!

Ora ishte dhjetë kur po kalonte sheshin. Dyqanxhinjtë ishin duke ulur qepenat ose duke futur brenda mallin. Njerëzit në këtë orë kthehen në shtëpitë e tyre. Para mejhaneve, në oborre kishte grumbuj njerëzish, kryesisht punëtorë dhe zhelanë. Raskolnikovit i pëlqenin këto vende të mbushur me leckamanë, që ashtu si dhe ai, sorollateshin ashtu kot. Këtu nuk e shihte kush shtrembër, ishte mes të vetëve. Në qoshen e rrugës K. një dyqanxhi me të shoqen ende s'kishin mbyllur, shisnin penjë, shami të lartë, lloj-lloj cingërrimash. Ishte koha që duhej të mbyllnin. Por qenë vonuar duke biseduar me të njohurën e tyre. Raskolnikovi atë e njohu: ishte Lizaveta Ivanovna, apo thjesht Lizaveta,

motra e Alena Ivanovnës, fajdexheshës, tek e cila kishte qenë dje për të lënë rehen orën dhe për të bërë *provën*... Kishte dëgjuar për Lizavetën, edhe ajo e njihte. Ishte një lëneshë shtatgjatë, e ngathët, e druajtur dhe e përkorë, pak e leshtë, nja tridhjetë e pesë vjeçe, skllave e vërtetë e së motrës; punonte ditë e natë, dridhej para saj, ia duronte huqet e panumërta, madje edhe të rrahurat. Qëndronte e menduar para dyqanxhiut, në dorë mbante një bohçe dhe dëgjonte ç'i thoshin. Këta po i flisnin me gjongël. Kur e pa, Raskolnikovi ndjeu si iu rrëkëllyen të përbrendshmet, habija dhe hutimi e pushtuan sakaq, ndonëse në këtë takim nuk kishte asgjë të veçantë.

- Vendosni vetë ju, Lizaveta Ivanovna, - i tha me zë të kumbueshëm dyqanxhiu. - Ejani rreth orës shtatë të darkës nesër, edhe ata këtu do jenë. Bisedoni goja-gojës.

- Nesër? - pyeti me zë të zvargur dhe të menduar Lizaveta.

- Ju ka bërë tutar Alena Ivanovna! - foli nguturazi e shoqja, një grua e hedhur. - Dukeni si fëmijë e trëmbur... Ju as motër me tamam s'e keni, bën me ju si i teket.

- Ju Alena Ivanovnës mos i tregoni fare! - u hodh e tha i shoqi. - Ejani pa lejen e saj dhe mbaroi puna. Ju leverdis bashkëpunimi.

- Po hë, si, të vij?

- Nesër në ora shtatë. Bisedoni dhe vendosni vetë.

- Pijmë edhe nga një çaj, - shtoi e shoqja.

- Mirë atëherë po vij, - nëpërdhëmbi Lizaveta mendueshëm dhe eci në punë të vet.

Raskolnikovi nuk e ndaloi hapin, vetëm u kaloi pranë. Nuk u kishte rënë në sy. Habija fare shpejt ia la vendin tmerrit, u drodh si t'i kishin hedhur ujë të ftohtë në shpinë. Njoftimi i beftë e kishte tronditur: *nesër në ora shtatë fajdexhesha do të ishte fillikat vetëm në shtëpinë e saj.*

Deri në musëndrën ku banonte i kishin mbetur vetëm disa hapa. Hyri siç hyn në qeli një i dënuar me vdekje. Mendimet i kishte të çakërdisura, për asgjë nuk ishte në gjendje të mendonte, por qe i vetëdijshëm se tanimë e kishte humbur logjikën, aftësinë e arsyetimit, se i kishte avulluar vullneti, pa pritur e pa kujtuar çdo gjë ishte vendosur përfundimisht.

Edhe sikur të kishte ndenjur një vit në pritje të rastit të volitshëm,

nuk kishte për të qenë kurrë më i sigurt për mbarëvajtjen e asaj që po përgatiste tërë këtë kohë. Kurrë ndonjëherë nuk do t'i jepej rasti ta merrte vesh me aq saktësi në një mënyrë aq të vetvetishme sa tani që plaka do të ishte vetëm dhe pa ngjallur dyshim tek askush me pyetjet e pashmangshme që do të kishte qenë i detyuar të bënte në raste të tjera.

VI

Më vonë e mori mësoi përse e kishin ftuar Lizavetën dyqanxhiu dhe e shoqja. Një tregtar i ardhur shiste veshje grash; të dilte vetë në pazar nuk i voliste, donte t'ia jepte Lizavetës që merrej me kësi punësh dhe gëzonte emër të mirë: ishte e ndershme, e tregtonte mallin vetëm me çmimin që i caktonin. Ishte fjalëpak, e druajtur dhe si e trëmbur...

Kohët e fundit Raskolnikovi ishte bërë bestyd dhe i tillë vazhdoi të jetë për një kohë të gjatë. Në çdo gjë që lidhej me *çështjen* doemos do të kërkonte diçka të fshehtë, misterioze, pale pastaj kur, qoftë edhe rastësisht, qëllonin koinçidenca.

Atë dimër një i njohuri i tij student, Pokorjev quhej, kur po nisej për në Harkov, në bisedë e sipër i kishte zënë ngoje edhe adresën e fajdexheshës Alena Ivanovna, le ta kishte, ndoshta ia lypte nevoja, mund t'i duhej për të lënë ndonjë peng.

Për një kohë, Raskolnikovi kishte mundur të mbante frymën gjallë me mësimet. Pas një muaj e gjysmë, iu kujtua fajdexhesha, kishte dy plaçka që donte t'i linte peng: ishte ora e argjendtë e babait dhe një unazë floriri me tri gurë të kuq, që ia kishte dhuruar motra kur ishin ndarë. Vendosi të çonte në fillim unazën. Kur e pa fajdexheshën, ndjeu neveri dhe pështirosje, ia mori ato dy rubla dhe shkoi drejt e në mejhane, porositi një gotë çaj dhe e pa veten të befasuar: një mendim i çuditshëm po ia çukiste kokën, siç bën zogu kur do të dalë nga veza. Mendimi nuk po e linte të qetë.

Në tryezë pranë ishte ulur një student, të cilin nuk e njihte, bashkë me një oficer, djalë të ri. Pasi kishin lozur bilardo, po pinin çaj. Dëgjoi studentin t'i fliste oficerit për fajdexheshën Alena Ivanovna, i tha edhe adresën. Çfarë përputhje fatale! Që andej po vinte, këtu po për atë

po flisnin. Sigurisht, rastësi, por përshtypja që i bëri ishte e madhe, sidomos pas mendimit që i çukiste kokën. Studenti po i tregonte oficerit gjithfarë hollësish për këtë Alena Ivanovnën.

- Është grua për të qenë, - i thoshte. - Kurdoherë me para e gjen. E pasur te Zoti, edhe pesë mijë ka borxh t'i numërojë në dorë, por edhe peng që çmohet një rubël pranon. Tanët e kanë provuar, po për sarrafe s'e ka shoqen, shtrigane e madhe është...

I tha se ishte njeri shpirtkazëm, e ligë, s'e njihte ç'është mëshira; sikur një ditë të vonoheshe me kthimin e pengut, ta mbante gjënë. Të jepte një të katërtën e vlerës, përqindjen ta mbante sa më të lartë. Në bisedë e sipër i tha se kishte edhe një motër, quhej Lizavetë, të cilën edhe e rrihte, ndonëse vetë ishte plakaruqe, kockë e lëkurë, kurse ajo Lizaveta është si kavak e gjatë...

- Çudi e shkuar çudisë! - i tha dhe ia plasi të qeshurit.

I tregoi shokut edhe për Lizavetën, dhe i tregoi me gjithë qejf, duke qeshur dhe duke u zgërdhirë, kurse oficeri e dëgjonte me vëmendje dhe i tha se do të bënte mirë t'ia çonte Lizavetën që t'i qepte ca ndërresa. Raskolnikovi i dëgjonte i heshtur. Sipas tregimit të studentit, Lizaveta ishte më e re në moshë, ishte motër me nënë tjetër, punonte tek Alena Ivanovna edhe si kuzhiniere, edhe si pastruese, priste e qepte rrobe, të cilat i shiste dhe paratë ia jepte që të gjitha motrës. Doli që plakaruqja tanimë e paskësh bërë testamentin, Lizavetës nuk i paskej lënë as edhe një grosh, vetëm pak rrangullina, pasurinë ia paska taksur manastirit N. që t'i prehej shpirti në parajsë. Këtë Lizaveta e ditka. Tregoi se vërtet që ishte stërhelle dhe e shëmtuar, por u mbajtka pastër, deri në mani. Çudia më e madhe, sipas studentit, ishte se Lizaveta tërë kohën rrinte me barrë...

- Po ti the që qenka e shëmtuar? - u habit oficeri.

- Ashtu është, e zeshkët dhe e rreshkur, duket si një ushtar me pajime të plota, akaret është... por fytyra i shpreh mirësi, sidomos sytë, shumëkujt i pëlqen... S'i ndihet zëri, as kullon e as turbullon, nuk di të kthejë fjalë. Buzagazin sidomos e ka të mirë...

- Me ç'po shoh, edhe ty të pëlqeka? - qeshi oficeri.

- Për çudanërinë. Dëgjo këtu: atë plakë të keqe pa m'u dridhur dora e vrisja dhe e grabisja, nuk do më vinte keq fare, - shtoi i inatosur studenti.

Oficeri qeshi me të madhe; Raskolnikovi u rrëqeth. Gjëra çmeritëse!

- Se ja ç'ndodh, mor vëlla, - vijoi me zjarr studenti. - Nga njëra anë, kjo plakaruqe shtrigane, e sëmurë, që s'i hyn askujt në punë, përkundrazi, që u bën dëm të tjerëve dhe as vetë nuk e di përse jeton e i ka të numëruara ditët, kurse nga ana tjetër, forcat e reja, të freskëta, që humbasin kot, ngaqë u mungon përkrahja. Dhe sa shumë që janë! Qindra e mijëra punë të dobishme mund të bëheshin me paratë që mban në sënduk plaka dhe që nesër do t'i shkojnë manastirit! Sa e sa familje të këputura e pa shpresë mund të kthehesin në jetën aktive me ato para, mund të shpëtoheshin nga shkatërrimi dhe perrupia, nga sëmundja dhe vdekja e sigurt! Vrite atë shtrigë, merrja paratë dhe përkushtoja veten njerëzimit, çështjeve me interes të përgjithshëm... Ti si thua, a nuk shlyet një krim aq i vockël me madhështinë e punëve që do kryhen pas tij? Një jetë e kotë zhduket, mijëra të tjera shpëtojnë nga rrënimi, zvetënimi dhe vdekja e sigurt! Aritmetikë e thjeshtë është kjo... Se çfarë çmimi të ka kjo jetë e kësaj plake të sëmurë, zemërligë dhe të fandaksur? Jo më shumë se çmimi i jetës së një morri, buburreci, madje as kaq nuk e ka, sepse plakaruqja u bën dëm njerëzve, ua merr shpirtin me fajdenë. E di, Lizavetës para disa ditësh në inat e sipër sa nuk ia paska këputur fare gishtin!

- Sigurisht nuk e meriton të jetojë, - vuri në dukje oficeri, - por natyra ka ligjet e veta.

- Po natyra duhet rregulluar, dhe ca mendje të ndritura ka kohë që merren me këtë, veç duhet bërë sa më shpejt më mirë, ndryshe do na vënë përfund paragjykimet. Ja, ata që merren me rregullimin e natyrës, për mendimin tim, janë njerëz të mëdhenj. Se dëgjojmë të flitet dhe jo pak: jo detyra, jo nderi... Unë s'jam kundër tyre, por ama si i kemi kuptuar? Ja, po ta bëj ty këtë pyetje... hë, si i kemi kuptuar?

- Prit pak, mbaje mend, në fillim po të bëj unë një pyetje.

- Hë!

- Të dëgjova ç'më fole, po a s'më thua: ti *vetë* a do ta vrisje atë plakaruqe?

- Unë jo, sigurisht! E thashë i nisur nga drejtësia... Nuk e kisha fjalën te vetja ime...

- Meqë nuk e bën dot, domethënë se mungon drejtësia! Bëjmë

edhe një lojë?

Raskolnikovin s'po e mbante vendi. Ishte shumë i tronditur. Këto që dëgjoi ishin fjalë të rëndomta, të tilla që mund t'i dëgjoje gjithkund, sidomos në rrethet studentore, por përse rastisi t'i dëgjonte pikërisht tani, kur në kokë sapo i kishin hedhur *rrënjë pikërisht të tilla mendime!* Si shumë të çuditshme po i dukeshin këto përputhje... Biseda në këtë pijetore pat ndikim jashtëzakonisht të fuqishëm në ecurinë e mëtejme të punëve: iu duk sikur çdo gjë qënkësh e paracaktuar...

Nga Sheshi Sena u kthye fare i këputur, mezi u zvarrit gjer në dhomën-musëndër dhe u lëshua fuqiprerë në divan; qëndroi pa lëvizur nja një orë. U err, qiri nuk kishte të ndizte, por as që donte të kishte dritë. Më pas kurrë nuk arriti dot ta thoshte me siguri të plotë, në kishte formuluar asokohe ndonjë mendim të qartë. Ndjeu se po i afroheshin përsëri ethet, trupi iu mbush me mornica, i tha vetes, duke u ndier i kënaqur: në këtë kanape mund të merrte një sy gjumë. E zuri një gjumë i thellë, i rëndë; iu duk sikur po e shtypte me peshën e tij.

Fjeti një kohë të gjatë, pa edhe ëndrra. Nastasia i trokiti në derë të nesërmen në ora dhjetë, mezi mundi ta zgjojë. I kishte sjellë bukë e çaj nga të sajat.

- Hajde gjumë, hajde, - i tha e pakënaqur. - Vetëm fle ky njeri.

E përmblodhi me vështirësi veten, koka sa s'po i pëlciste. U ngrit në këmbë, bëri disa hapa në atë strofullën e tij, dhe përsëri u lëshua i këputur në kanape.

- Si, mos do flesh akoma? - thirri Nastasia. - Mos je i sëmurë, more djalë?

Nuk i ktheu përgjigje.

- Do ta pish çajin?

- Pak më vonë, - nëpërdhëmbi me mundim, duke i kapsallitur me vështirësi kapakët e rënduar, pastaj u kthye nga muri. Nastasia vazhdonte të qëndronte në këmbë.

- Duket ajo që nuk është mirë ky djalë! - tha dhe doli.

Erdhi përsëri në ora dy me një tas supë. Raskolnikovin e gjeti përsëri shtrirë, çajin nuk e kishte zënë me dorë. Kjo u inatos dhe iu përvesh.

- E ç'më fle kështu? - thirri dhe e pa me përçmim.

Raskolnikovi u ngrit pak, u ul në kanape, por nuk nxori nga goja as dhe një fjalë, rrinte me sytë përdhe...

- Nuk ndihesh mirë, a si? - e pyeti për të disatën herë dhe përsëri nuk mori asnjë përgjigje. - Bëje mirë të dilje pak, - shtoi pas një pauze. - Ke nevojë për ajër të pastër. Do hash diçka?

- Më vonë, - iu përgjegj me zë të mekur. - Ik! - i tha dhe tundi dorën.

Nastasia qëndroi edhe pak, e pa me keqardhje e dhimbsuri dhe doli.

Pas disa minutash i ngriti sytë dhe e pa gjatë çajin dhe supën. Pastaj mori bukën, lugën dhe zuri të hajë.

Hëngri fare pak, pa oreks, me ca lëvizje mekanike. Koka po i dhimbte më pak. U shtri përsëri në kanape, por nuk fjeti; rrinte shtrirë përmbys, pa bërë asnjë lëvizje, me fytyrën ngjeshur pas jastëkut. Në kokë i faniteshin ca shëmbëllesa të çuditshme: sikur ishte diku larg në Afrikë, në Egjipt, buzë oazi. Karvani po pushonte, gamilet po përçapeshin nën palma, përreth kishte vetëm palma: njerëzit ishin shtruar dhe po hanin, kurse ai vetë pinte ujë, ujë të ftohtë burimi, që gurgullonte dhe lodronte aty pranë. Fresku e kënaqi dhe e qetoi, uji i kaltër si qelibar lodronte nëpër guriçkat dhe në rërën e pastër me vezullime ari... Dëgjoi fare shkoqur goditjen e një ore. U drodh, u përmend, ngriti pak kokën, pa në dritare, mori me mëndje sa mund të ishte ora dhe brofi vrullshëm, u shkëput nga kanapeja. Iu afrua derës në majë të këmbëve, e hapi pak dhe mbajti vesh. Zemra i përpëlitej si zog. Asnjë zhurmë, asnjë lëvizje nëpër shkallë nuk i zuri veshi. Bëri çudi me veten, që kishte fjetur aq kohë dhe nuk kishte marrë asnjë masë, nuk kishte përgatitur gjë prej gjëje... Ora duhej të ishte gjashtë. Përgjumja dhe kapitja e paradokohe ia la vendin hutimit dhe ngutjes marramendëse. Veç për të përgatitur nuk kishte kushedi çfarë. E detyroi veten të përqendrohej, të merrte gjithë sa i duhej, të mos harronte gjë; ndërkohë zemra vazhdonte të rrihte me forcë. Mezi mbushej me frymë. Duhej bërë laku dhe duhej qepur brenda xhaketës, punë minutash; nxori që poshtë jastëkut një këmishë të vjetër të palarë, preu një shirit pesë centimetra të gjerë dhe rreth një gjysmë metri të gjatë, e palosi më dysh, hoqi nga gozhda xhaketën verore prej cohe liri të fortë dhe nën sqetull qepi fundet e shiritit, nga brenda. I

dridheshin duart, por bëri si bëri dhe ia doli mbanë, jashtë nuk kishte asnjë gjurmë. Gjilpërën dhe peun e kishte bërë gati prej kohe, gjendeshin në tryezë të mbështjellë me letër. Laku kishte qenë shpikje e atij vetë, aty do varte sëpatën, s'kishte si e mbante në dorë duke ecur rrugës; do e varte nën xhaketë dhe do ia shtrëngonte bishtin me dorën e futur në xhep. Për fat xhaketa ishte e gjerë, si thes. Këtë shpikje e kishte bërë dy javë më parë.

Pastaj futi gishtin në të çarën e kanapesë dhe nxori "pengun" edhe atë e kishte përgatitur me kohë. Ishte një dërrasë e struguar mirë, me madhësi sa një kuti duhani. E kishte gjetur rastësisht gjatë një shëtitjeje, i bashkëngjiti edhe një pafkë metalike pak më të vogël se copa e dërrasës, pastaj të lidhur fort me spango i pat mbështjellë mirë me letër të bardhë dhe në mënyrë që të mos ishte aspak e lehtë ta hapje. E kishte bërë që plaka të rrekej e të vonohej kur të bënte ta hapte dhe, ndërkohë që kjo të jepte e të merrte me paketën, të zgjidhte çastin e volitshëm për t'i dhënë goditjen vdekjeprurëse. Pafkën e hekurt e vuri për të peshuar, që plaka të mos e kuptonte se ishte thjesht një copë dru. E kishte përgatitur dhe e kishte futur ta ruante në të çarën e kanapesë. S'kishte arritur ta nxirrte mirë pengun, kur në oborr u dëgjua një britmë:

- Shkoi ora shtatë!

- Po, po! O Zot!

Vrapoi te dera, mbajti vesh, rrëmbeu kapelen, zbriti ngadalë, pa u ndier, si mace, ato tridhjetë shkallë. Duhej t'ia dilte mbanë detyrës më të vështirë: të rrëmbente sëpatën në kuzhinë. Që për atë punë do të përdorej sëpata, këtë e pat vendosur prej kohësh. Kishte edhe një biçak të madh por me të lipsej forcë, kishte frikë mos nuk do ia arrinte, ndaj dhe e kishte prerë mëndjen: me sëpatë! Të tëra vendimet që merrte kishin një veçori të çuditshme: sa më përfundimtare bëheshin, aq më të shëmtuara i dukeshin. Në atë gjëndje të tmerrshme lufte motivesh, në të cilën ndodhej, po i lëkundej edhe besimi në mundësinë e realizimit të planit që kishte bërë.

Sikur t'i mbushej mendja që e kishte parashikuar dhe përllogaritur çdo gjë deri në pikën e fundit dhe tanimë nuk i kishte mbetur asnjë dyshim, kishte shumë të ngjarë që menjëherë të hiqte dorë nga plani si nga një absurditet i përbindshëm, i pamundur. Por kishte ende sa e

sa çështje të pazgjidhura... Ja, bie fjala, puna e sëpatës as që e pati merakosur, e kishte konsideruar vogëlsirë. E dinte që mbrëmjeve Nastasia nuk rrinte në shtëpi, shkonte te komshinjtë për një dorë muhabet apo në pazar dhe derën kurdoherë e linte hapur. Pronarja grindej me të për këtë zakon të keq që kishte. Pra, kur të vinte koha, do futej pa u ndier në kuzhinë, do merrte sëpatën dhe pas një ore (pasi të kishte mbaruar punë) do ta vinte përsëri në vend. Kurse tani i lindi ja se ç'dyshim: do vinte pas një ore që ta kthente, po sikur në këtë kohë të kishte qenë kthyer Nastia? Po mirë, do ngjitej lart dhe do priste që të dilte përsëri. Po sikur gjatë asaj kohe t'i ishte nevojitur sëpata? Do zinte ta kërkonte, nuk do ta gjente dot, do t'i lindte dyshimi; më e pakta do krijohej një rast për të dyshuar...

Por edhe t'i rrihte si duhet shkakpasojat e veprimeve nuk ishte në gjendje, ishte tejet i tendosur dhe kohën e kishte me kët. I tëri ishte i përqendruar te kryesorja, vogëlsirat i kishte lënë mënjanë, duhej marrë vendimi *përfundimtar*. Ende vazhdonte ta quante diçka të pamundur atë që po i çukiste kokën... I dukej se nuk do të vinte kurrë ai çast, kur t'i vinte pikën lëkundjeve e mëdyshjeve, kur do të mblidhte mendjen dhe do vinte... Se ai edhe *provën* ashtu kot e pati bërë. I pat thënë vetes: "Pa të vete njëherë e ta provoj, sesa rri këtu e torturoj veten me tërë këto ëndrra me sy hapur që jam duke parë".

Ndërkohë i dukej që në rrafshin moral çështja e kishte tanimë zgjidhjen përfundimtare. Vargani i rastësive e kishte bërë punën e vet dhe në thellësi të shpirtit vetëdija tanimë nuk po e kundërshtonte. Ishte ai vetë që nuk po e besonte, me një këmbëngulje të verbër kërkonte të gjente kundërshtime në çështje anësore, bënte çmos t'i krijonte vetes përshtypjen sikur dikush tjetër po e shtynte drejt kësaj. Dita e fundit, që erdhi aq e beftë dhe i rrafshoi mëdyshjet e dyshimit, nuk shënoi ndonjë ndryshim në veprimet e tij, përkundrazi, e bëri çdo gjë si ta merrnin për krahu, kurse ai verbërisht vetëm u nënshtrohej. Si t'i kishte mbetur një pjesë e xhaketës në ingranazhin që rrotullohej dhe e tërhiqte dhe atë pashmangshmërisht me vete.

Kishte qenë një kohë që e kishte munduar pyetja: përse zbuloheshin me aq lehtësi krimet, u bihej shpejt në gjurmë kriminelëve? Kishte arritur në disa përfundime vetjake: nuk ishte pamundësia materiale e fshehjes së gjurmëve, tërë puna ishte te vetë krimineli, të cilit në çastet

e kryerjes së krimit i ndodhte një si rënie vullneti, errësim arsyeje, që e çonin në veprime naive, thuajse fëmijërore, në një kohë kur lypsej logjikë e ftohtë, arsyetim esëll dhe kujdes maksimal. E platit siç e vë poshtë njeriun sëmundja, ndihet veçanërisht shumë sidomos pak kohë para kryerjes së krimit dhe pak kohë pas tij, në vartësi të njeriut; pastaj kalon, siç kalon çdo sëmundje.

Ndërsa pyetjes tjetër, në është semundja ajo që e shtyn njeriun drejt krimit apo është krimi që nga vetë natyra e tij, doemos shoqërohet nga ajo sëmundje nuk kishte qenë në gjendje t'i përgjigjej.

Për veten e vet Raskolnikovi kishte mendimin se nuk kishte përse të vuante nga një sëmundje e tillë; do t'i kishte të pacënuara si logjikën, ashtu edhe vullnetin qoftë për arsyen e vetme se kjo që kishte vendosur të bënte "nuk ishte krim...". Por t'i lëmë mënjanë arsyetimet... sa për anët konkrete të kryerjes së krimit, për masat që duheshin marrë dhe veprimet që duheshin bërë, për këto mendonte fare pak. "Mjafton të jetë në gjendje pune si logjika ashtu dhe vullneti, - arsyetonte ai, - dhe të gjithë problemet zgjidhen pa ndonjë vështirësi, ashtu si t'u vijë radha." Sidoqoftë, vendimin përfundimtar ende nuk e kishte marrë... Kur ra ora, çdo gjë u bë si padashje, madje si diçka e papritur!...

Një pengesë fare e vockël e gozhdoi në vend: kur arriti te dera e kuzhinës së pronares, që rrinte kurdoherë e hapur, pa me kujdes brenda; ishte apo nuk ishte aty pronarja me Nastasinë; në nuk ishin aty, a qenë të puthitura mirë dyert e dhomave, që të mos dukej nga brenda kur të merrte sëpatën. Shtangu nga habia kur pa Nastasinë duke nderur rrobat e lara në litar. Kjo e pa, ndaloi lëvizjet, u kthye nga ai dhe e shoqëroi me sy deri sa u largua. Raskolnikovi u largua si të mos kishte vënë re gjë. Por ama sëpatën nuk e mori! Iu prenë këmbë e duar...

"E nga e mora këtë që ajo patjetër nuk do të ishte në shtëpi? - tha me vete, duke dalë nga porta. - Pse e quajta problem të zgjidhur?". Ndihej fare i dërrmuar, madje i poshtëruar. Ndjeu një kërkesë të brendshme për ta tallur dhe sëmbuar veten, për ta përbuzuar me ligësi... Zjente nga inati.

Para se të dilte në rrugë, ndali i menduar. Nuk donte të shtirej sikur kishte dalë për shëtitje, por ama edhe të kthehej në atë birucë, nuk ia kishte enda. "Ç'rast të volitshëm që jam duke humbur!" -

mërmëriti, kur u gjend përpara kolibes së rojes; dera ishte e hapur, por ndriçim nuk kishte. U rrëqeth... Që aty ku ishte i vajti syri te tehu i sëpatës nën tryezën e rojes.. Pa përreth, asnjë njeri nuk kishte. Iu afrua pa u ndier, zbriti dy shkallina dhe i bëri zë rojes. Nuk ishte aty! "Paska dalë, do jetë në oborr, se derën e paska lënë të hapur..." - tha me vete. Hyri rrëmbimthi, mori sëpatën, që ishte ndërmjet dy çarallëkeve; pa dalë e vuri në lak, të dyja duart i futi në xhepe dhe doli, askush nuk e pa. "Në mos logjika të ndih djalli!" - tha dhe u skërmit në një mënyrë të çuditshme. Kjo rastësi i dha zemër...

Eci me hap të shtruar, duke u *krekosur*, që të mos ngjallte dyshime. S'i kthente sytë nga kalimtarët, madje përpiqej të mos ua shihte fytyrën, që dhe këta të mos ia shihnin. Iu kujtua kapelja: "O Zot! Edhe para pata, nuk bleva që nuk bleva një kasketë!" - mallkoi veten pa u ndierë.

Kur hodhi sytë si rastësisht në një dyqan, pa që ora e murit ishte gjashtë e dhjetë minuta. Duhej të ecte më shpejt, sepse duhej të bënte një goxha lak: duhej të futej në hyrjen e plakës jo ballazi, por duke i rënë përreth...

Kur e pat përpunuar në mendjen e tij këtë plan, kish pandehur se do të ishte tejet i frikësuar, tani po vinte re që nuk kishte fare frikë. Në kokë i dyndeshin ca mendime anësore, por ashtu si dukeshin dhe zhdukeshin, vetëtimthi. Kur po kalonte pranë parkut "Jusuf", se përse i shkoi ne mendje ideja e ndërtimit të ca shatrivaneve të fuqishëm, ata do ta freskonin shumë ajrin e atij vendi. Tha me vete se po të shtrihej "Parku Veror" gjatë gjithë "Fushës së Marsit", dhe po të bashkohej me parkun "Mihaillovsk", që ndodhet para Pallatit të Dimrit, do të dilte diçka e mrekullueshme, tepër dobiprurëse për kryeqytetin. Pastaj i shkrepi mendimi: përse vallë në qytetet e mëdhenj jo thjesht nga nevoja, por ashtu vetvetiu venë e popullohen pikërisht ato pjesë, ku nuk ka parqe, shatrivanë, ku të mbyt balta dhe kutërbon erë e qelbur... Iu kujtuan edhe shëtitjet në Sheshin Sena, por sakaq i thirri mendjes: "Po kjo ç'është kështu? Më mirë të mos mendoj fare!..."

"Qënka e vërtetë, pra, që në kokën e të dënuarve me vdekje gëlojnë gjithfarë mendimesh për objektet që u zë syri rrugës!" - i shkrepi rrufeshëm ky mendim, por që po aq rrufeshëm e shoi...

Po afrohej!... Ja shtëpia... Ja porta!... Dëgjoi orën që ra gjashtë e gjysmë. "Sa shpejt paska ikur?"... - tha me vete.

Te hyrja nuk kishte njeri; po i ecte. Për fat para hyrjes po kalonte një karrocë e madhe plot me sanë. Kur kaloi hyrjen, ajo e fshehu fare. Rrëshqiti pa u vënë re nga askush. Dritaret që shihnin në oborr ishin të hapura, nuk i ngriti kryet, nuk guxoi të shihte. Shkallët, që të çonin në apartamentin e plakës, ishin afër, zuri t'i ngjitte me shpejtësi... U mbush me frymë, shtrëngoi bishtin e sëpatës, e rregulloi pak, shtrëngoi me pëllëmbë zemrën që i rrihte si çekan dhe pa u ndier vazhdoi të ngjitej shkallëve, i tëri sy e veshë... Por as në shkallë nuk kishte këmbë njeriu, dyert e apartamenteve ishin të mbyllura. Në katin e dytë pa të hapur derën e një apartamenti, disa bojaxhinj po lyenin, ata nuk e panë. Ndali pak i menduar, por përsëri vazhdoi rrugën. "Sigurisht, do të kishte qenë më mirë që të mos ishin, por... apartamenti i saj ishte dy kate më sipër," - tha me vete.

Ja dhe kati i katërt, dera, apartamenti për karshi ishte bosh, ashtu siç ishte bosh edhe kati i tretë, nën atë të plakës... Mezi po mbushej me frymë. Vetëm një fraksion të sekondës i vezulloi mendimi: "Po sikur të ikte?". E la pa përgjigje. Mbajti vesh te dera e plakës: heshtje varri. Mbajti përsëri vesh në shkallët: asnjë lëvizje. Qëndroi për një kohë i përqendruar, pa përreth për herë të fundit, rregulloi veshjen, përmblodhi veten, preku për herë të fundit sëpatën... "Mos jam i zbehtë në fytyrë? Mos i bie në sy?... Mos do t'i duket që jam i tronditur?... Nuk i shpëton gjë asaj... Mos duhet pritur edhe pak... të qetësohem.. të mos më rrah kështu zemra?..".

Por zemra s'po i taraksej, përkundrazi, po i rrihte edhe më fort. Nuk po i durohej: zgjati ngadalë dorën drejt ziles dhe i ra; pas një minute e përsëriti edhe një herë, kësaj radhe më me ngulm.

Asnjë përgjigje! Nuk kishte pse ngutej, këmbëngulja mund ta dëmtonte. Që plaka ishte brenda, për këtë ishte më se i sigurt, veç ishte dyshimtare, sidomos kur ndodhej e vetme në shtëpi. Ia dinte huqet... Mbështeti veshin pas derës dhe përgjoi. A iu bë në ato çaste pritjeje të tendosur, a vërtet dëgjoi, vështirë të thuhet, por iu duk sikur një dorë fërkoi lehtë dorezën, kurse rrobat fështërinë pas derës. Dikush qëndronte i heshtur te dera, ashtu si qëndronte ai në anën e jashtme të saj dhe mbante vesh...

Që ta dëgjonin, lëvizi pak, diç bëlbëzoi me zë të lartë që të mos linte asnjë dyshim se ishte duke u fshehur. Pastaj i ra ziles për të tretën

herë, por më shtruar, më gjatë, pa shenjën më të vogël të padurimit. Më pas tërë këto ishte në gjëndje t'i riprodhonte me hollësi, i qenë ngulitur në kujtesë. As vetë nuk mundi ta kuptonte se nga i erdhi tërë kjo dinakëri, e pra, mendja i punonte me hope, aspak shtruar, ndërsa qënien fizike të vetvetes thuajse nuk e ndiente... S'kaloi shumë dhe u dëgjua që luajtën llozin...

VII

Si edhe atëherë, dera u hap fare pak dhe përsëri dy sy si tehe brisku, dyshimtarë dhe përgjues, e panë në errësirë. Raskolnikovi nuk po e përmbante dot veten, për pak sa nuk bëri një gabim fatal.

Nga frika mos plaka nuk do ta pranonte të ishin vetëm për vetëm dhe mos pamja do ta tradhëtonte, u kap pas derës që të mos mundte ta mbyllte më. Kur e pa, plaka nuk u përpoq ta mbyllte me forcë derën, por u kap fort pas dorezës dhe Raskolnikovi për pak sa nuk e tërhoqi jashtë bashkë me derën. Kur e pa që kjo i doli përpara dhe s'po e linte të hynte, iu sul pa e zgjatur. Plaka i hapi udhë e trembur, deshi diç të thoshte, por s'po mundej dhe e shihte me sy të shqyer.

- Tunjatjeta, Alena Ivanovna, - i foli sa më shpenguar, por zëri nuk iu bind, iu drodh, pastaj i ngeci në grykë. - Ju solla... diçka. Dalim pak këtu... në dritë... E la aty ku ishte dhe vetë hyri në dhomë, pa pritur ta ftonin. Plaka u turr pas tij; iu zgjidh, më në fund, gjuha.

- O Zot! Ç'bëni kështu?... Kush jeni? Ç'doni nga unë?

- Më falni, Alena Ivanovna... po ju më njihni... Raskolnikov quhem... Ju kam sjellë pengun, atë për të cilin ju fola..., - i zgjati menjëherë pengun.

Plaka e pa, por vetëm shkarazi, i ngriti sytë dhe e pa në fytyrë, drejt e në sy mysafirin e paftuar. E hetoi ngultas me ligësi dhe dyshim. Kaloi kështu nja një minutë. Raskolnikovit iu duk se në sytë e saj rrezëlliu përbuzja e tallja, si ta kishte kuptuar ç'donte të bënte. E ndjeu se po hutohej, se po lebetitej i tmerruar dhe aq shumë, saqë po të vazhdonte ta shihte asisoj qoftë edhe një minutë tjetër, do t'ia therte vrapit.

- Po ju si, nuk po më njihni? - nëpërdhëmbi thuajse i zemëruar. -

Do ta pranoni apo jo? Në nuk doni, shkoj te ndonjë tjetër, s'më pret puna!

Këtë ligjëratë nuk e kishte përgatitur, i doli vetvetiu.

Plaka e mblodhi veten, zëri i sigurt i mysafirit, me sa dukej, i dha zemër.

- Ç'thoni kështu, more djalë? Hë, ç'keni sjellë?... - tha dhe ia nguli sytë pengut.

- Një kuti cigaresh, prej argjendi. Ju fola për të herën që shkoi.

Plaka zgjati dorën.

- Po ç'ke kështu? Të ka ikur fytyra fare!... Ja edhe duart të dridhen! Mos erdhe gjë pas banjës?

- Kam ethe, - i tha Raskolnikovi me zë të dridhur. - Nga ato e kam zbehtësinë... Pastaj jam edhe i pangrënë... - shtoi, duke i shqiptuar me vështirësi fjalët. Përsëri po e linte fuqia. Veç përgjigjja që i dha tingëlloi bindëse: plaka e mori pengun.

- Ç'ke sjellë? - e pyeti përsëri, duke e parë drejtë në sy dhe duke e peshuar në dorë pengun.

- Kuti cigaresh... e argjendtë... shiheni vetë.

- S'më duket si e argjendtë kjo... E paske mbështjellë...

Duke u munduar të zgjidhte spangon, u kthye nga drita, (dritaret, me sa dukej, ishin të mbyllura, të merrej fryma nga ajri i ndenjur) dhe gjatë disa sekondave qëndroi me shpinë nga ai. Raskolnikovi zbërtheu xhaketën, çliroi sëpatën nga laku, por ende nuk e nxori, vazhdoi ta mbante nën xhaketë me dorën e djathtë. Duart i qenë dobësuar fare, po e ndjente si po i mpiheshin dhe po i bëheshin dru pas çdo çasti që kalonte. Kishte frikë mos nuk do të ishte i zoti ta mbante më sëpatën, mos e rrëzonte... po i merreshin mendtë.

- E ç'e paske mbështjellë kështu? - thirri e nervozuar, duke lëvizur paksa në drejtim të tij.

Nuk duhej lënë të kalonte çasti i volitshëm. Nxori sëpatën, e ngriti lart me të dyja duart, dhe, duke mos qenë fare në vete, në një mënyrë krejt mekanike, e lëshoi mbi kokën e saj. Fuqitë i qenë prerë fare, por pasi e lëshoi mbi të sëpatën, forcat i erdhën.

Plaka rrinte gjithmonë kokë jashtë. Flokët e verdhë, të thinjur, të lyer kurdoherë me vaj, i kishte thurur gërsheta si dy bishta miu dhe i kishte kapur me një krehër briri prapa zverkut. Spata e qëlloi në

tëmtha, ngaqë ishte shtatvogël. Lëshoi një piskamë fare të dobët, dhe u plandos si e kositur në dysheme. Vetëm mundi t'i ngrejë që të dyja duart dhe t'i vërë në kokë. Në njërën dorë vazhdonte të mbante pengun. E qëlloi edhe njëherë me sa fuqi që kishte, dhe përsëri në tëmtha. Gjaku i rrodhi si të ishte derdhur një gotë me lëng të kuq, kurse kufoma u preh sa gjatë gjerë në dysheme. Ai u zmbraps; e kishte parë si kishte rënë, si qe dridhur në grahmat e fundit, si kishte dhënë shpirt. Sytë i kishin kërcyer jashtë gropave të syrit, kurse balli dhe fytyra i qenë rrudhosur për lemeri, i qenë shtrëmbëruar nga ngërçi.

E la sëpatën në dysheme, pranë kufomës, dhe zuri të kërkojë në xhepat, duke u përpjekur të mos fëlliqej me gjak. E futi dorën në xhepin e djathtë, që andej i kishte nxjerrë çelësat radhën që shkoi. Mendja i punonte si sahat, asnjë errësim, asnjë marrje mendsh, vetëm duart i dridheshin si më parë. Më pas ndërmendi se kishte qenë dhe i kujdesshëm, përpiqej të mos zhyhej. I nxori çelësat, ishin si dhe atëherë të lidhur me unazë metalike. Me ta në dorë u turr për në dhomën e gjumit, ishte fare e vogël, i ra në sy dollapi me xhamllëk plot me ikona. Pranë murit tjetër qëndronte shtrati i madh, shumë i pastër, i mbuluar me kuvertë mëndafshi, poshtë të cilit dukej jorgani i pambuktë.

O çudi: kur futi çelësin në bravën e komosë, kur dëgjoi gërvimën e tij, i kaluan mornica në trup. Përsëri ndjeu një dëshirë ta linte çdo gjë dhe t'ia mbathte. Por vetëm për një çast; tanimë ishte vonë. Qeshi vetë me veten. Iu bë sikur plaka ishte ende gjallë, se mund të çohej. I la çelësat në bravën e komosë, vrapoi për te kufoma, rrëmbeu sëpatën dhe e ngriti për ta qëlluar edhe një herë, por nuk e bëri. Nuk kishte as më të voglin dyshim që plaka kishte vdekur. U përkul përsëri dhe pa kafkën, e kishte gojë të çarë... Donte ta prekte me gisht, por aty për aty e tërhoqi, nuk ishte nevoja, dukej ajo... Ndërkohë në dysheme qe krijuar një pellgaçe gjaku. Syri i ngeli te gjalmi që kishte në qafë, nuk e kishte prerë sëpata, e tërhoqi me forcë, por nuk e këputi dot, vetëm se u lye me gjak. Provoi t'ia hiqte nga qafa, por kishte ngecur diku, nuk dilte. I vernozuar ngriti sëpatën që të priste gjalmin, u rrek nja dy minuta, u lye e u përlye me gjak, më në fund, e preu dhe pa e cënuar fare kufomën e hoqi. Nuk ishte gabuar: në të qenë lidhur dy kryqe, një i drunjtë dhe tjetri i bakërtë, një medalion me figurën e Shën Mërisë dhe një qese e mbushur dinga; Raskolnikovi e futi në xhep pa

e parë ç'kishte brenda, kryqet ia hodhi plakës dhe me sëpatën në dorë u turr përsëri në dhomën e gjumit.

Ngutej shumë: u mundua të hapte komonë, por s'po arrinte, asnjë nga çelësat nuk i bënte. E shihte se çelësi që ishte duke provuar nuk hynte e përsëri vazhdonte. Befas iu kujtua se do të ishte ndonjë çelës i madh ky i komosë, këta që kishte ishin të vegjël, pra duheshin përdorur gjetiu, aty mund të ishin paratë. E la komonë dhe u përkul nën shtrat; gjeti një sënduk mbi një metër të gjatë me kapak të fryrë, veshur me kadife të kuqe dhe të mbërthyer me rrathë çeliku. Çelësi i dhëmbëzuar e hapi në vend. Plaçka e parë që nxorri ishte një peliçe lepuri, e mbuluar me copë të kuqe të hollë, nën peliçen ishte një fustan mëndafshi, një shall, kishte dhe plaçka të tjera. Fshiu me copën e kuqe duart e përgjakura. "Qënka e kuqe, gjaku nuk ka për t'u dukur", - tha me vete. Dhe sakaq shtoi: "O Zot! Më mba mendjen!".

I nxori dhe zuri t'i shkundte rrobat, ra në tokë një orë floriri; e vazhdoi këtë punë dhe vazhdimisht binin sende të florinjta: varëse, zinxhirë, vathë, karfica. Me sa dukej, ishin arturina të lëna peng. Disa ishin në kuti, të tjerat ishin mbështjellë thjesht me letër gazete, ishin të mbështjella me kujdes, me dy a më shumë shtresa. I mblodhi dhe i futi në xhepa, pa i hapur dhe pa parë ç'kishin, por nuk arriti t'i mblidhte të tëra...

Dëgjoi këmbë në dhomën ku ishte plaka. Ngriu në vend, mbajti vesh, asgjë, vetëm i qe dukur. U dëgjua një britmë e lehtë, një si rënkim i mbytur, pastaj përsëri heshtje varri. Rrinte galiç pranë sëndukut dhe përgjonte me zemër të ngrirë; befas brofi, rrëmbeu sepatën dhe doli nga dhoma e gjumit.

Në mes të dhomës, ku ishte kufoma e plakës, qëndronte Lizaveta me një bohçe të madhe ndër duar dhe shihte e fandaksur motrën e vrarë, krejt e bardhë në fytyrë, e pafuqishme madje as për të nxjerrë zë. Kur pa Raskolnikovin t'i derdhej me sëpatë në dorë, u drodh dhe fytyra iu shtrembërua nga tmerri dhe lemeria; ngriti dorën për të zënë me të gojën, nuk bërtiti, por ngadalë u zbyth në një qoshe, pa ia ndarë sytë e hapur dhe të ngrirë nga habija. Nuk bërtiste, dukej që nuk i mjaftonte ajri për këtë. Raskolnikovi iu vërsul me sëpatën në dorë, Lizavetës iu drodh dhe iu shtrembërua përvajshëm goja, siç u ndodh foshnjave kur trëmben dhe shohin të trëmbur atë që e frikëson, të

gatshëm për t'u shkrehur në vaj. Edhe kështu ajo fatkeqe ishte fare e shushatur, frika i kishte hyrë në palcë; ajo as dorën nuk ngriti për t'u mbrojtur, ndonëse ky është një veprim i vetvetishëm vetmbrojtjeje. Sëpata iu drejtua në fytyrë. Ngriti vetëm pak dorën e majtë, që e kishte të lirë, në drejtim të sëpatës, si të donte ta mënjanonte. Goditja i çau kafkën në pjesën e sipërme të ballit. U shtri sa gjatë gjerë në dysheme. Raskolnikovi e humbi toruan, rrëmbeu bohçen dhe e flaku matanë, doli me vërtik në korridor.

E pushtoi frika pas kësaj vrasjeje të dytë, të paparashikuar. Donte të largohej sa më parë. Sikur të mundte ta vlerësonte si duhet situatën e krijuar, sikur të kishte qenë në gjendje të gjykonte për vështirësitë e reja që i dolën, për këtë keqbërje të pashembullt që kreu por edhe për të tjera që do të ishte i detyruar të bënte për të dalë që këtu, me siguri që do parapëlqente dorëzimin në polici dhe jo nga frika, por nga tmerri dhe neveria për gjithë sa kishte bërë. Sidomos e padurueshme ishte neveria dhe pështirosja që sa vinin e rriteshin. Nuk mundej kurrsesi t'i afrohej më sëndukut, as në dhomë nuk mund të hynte.

Një hije hutimi dhe pendese e kishte rrëmbyer nga të katër anët. Kishte çaste kur nuk ishte fare në vete; linte mënjanë kryesoren dhe kapej pas dytësoreve, pas vogëlsirave. Hyri në kuzhinë, syri i shkoi te një kovë e mbushur përgjysmë me ujë; iu afrua për të larë duart e sëpatën. Zhyti në fillim sëpatën me tehun poshtë, pastaj mori sapunin nga parvazi i dritares dhe i lau me të duart brenda në kovë. Nxorri dhe sëpatën, e pastroi tehun dhe ngadalë, nja tri minuta, u mor me pastrimin e bishtit të sëpatës, madje e shkumëzoi dhe me sapun. Fshiu sëpatën dhe duart me ndërresat që ishin varur në tel, e pa i përqendruar sëpatën në dritën e dritares. Nuk kishte mbetur asnjë shenjë gjaku, vetëm se bishti ishte ende i lagur. E siguroi me kujdes sëpatën në lakun brenda xhaketës, pastaj i shkoi një sy xhaketës për ta parë në ishte pa njolla gjaku, kuptohet, sa ia lejonte këtë drita e kuzhinës, pa edhe pantallonat, çizmet. Iu duk se ishin në rregull, vetëm çizmet qenë njollosur me pak gjak. Lagu një leckë dhe i fshiu. Ishte i vetëdijshëm që pastrimi qe bërë shkel e shko, ndoshta dhe mund të kishte mbetur diçka që binte në sy dhe që ai nuk po e vinte re. Qëndroi i menduar në mes të kuzhinës. Një mendim i zymtë, plumb i rëndë e pllakosi sakaq: ishte i çmendur, e kishte humbur gjykimin, nuk ishte

në gjendje as të mbrohej më, po bënte veprime aspak të domosdoshme. "Zot i madh! Po duhet ikur, dhe sa më parë më mirë!" - belbëzoi dhe doli në korridor. Këtu u gjend përpara një të papriture që e bëri t'i ngriheshin përpjetë leshtë e kokës...

Shihte dhe nuk i besonte syve: dera e jashtme, ajo ku i kishte rënë ziles pak më parë, kishte mbetur e hapur dhe jo pak, ndonjë pëllëmbë. Kishte qenë e hapur gjatë gjithë kohës! Plaka nuk e kishte puthitur ndoshta ngaqë diç dyshonte... Po edhe Lizaveta nga ajo derë kishte hyrë!

E mbylli dhe i vuri rezenë.

- Po ç'jam duke bërë, duhet ikur!...

E hoqi rezenë, e hapi pak derën dhe mbajti vesh. Qëndroi kështu për një kohë të gjatë. Diku larg, te porta, dëgjoheshin thirrje, pastaj sharje e qortime... "Po këta?"... Priti me durim. Më në fund, ra qetësia, një qetësi e menjëhershme, qenë larguar. U bë gati të dilte, kur një kat më poshtë u hap me zhurmë një derë, dikush zbriti nxitimthi shkallët, duke kënduar një melodi. "E pse tërë këto zhurma?" - pyeti veten i shqetësuar. E mbylli përsëri derën dhe priti. Përsëri heshtje, xhanxhin njeri. Doli dhe madje zbriti një shkallinë, kur u dëgjuan disa hapa.

Ishin të largët, diku në fillim të shkallëve, por i dëgjoi shkoqur edhe sepse i lindi dyshimi që dikush ishte duke ardhur pikërisht këtu, në katin e katërt, te plaka. E pse ky dyshim? Mos kishin ndonjë gjë të veçantë ato hapa? Ishin të rëndë e të shtruar, i zoti i tyre nuk ngutej. U ngjit në katin e parë, filloi të dytin, hapat sa vinin e afroheshin: dëgjohej dhe frymëmarrja e rënduar e atij që po ngjitej. Ishte në katin e tretë... Do vinte aty! Raskolnikovi shtangu, i ngrinë duar e këmbë, njëlloj si në ëndrrat e llahtarshme, kur të bëhet se janë duke të ndjekur, duan të vrasin, ja, po të afrohen, dhe nuk ke nga ia mban...

Kur njeriu zuri të ngjisë shkallët e katit të katërt, u shkund nga kjo stepje, rrëshqiti përsëri në apartament dhe e mbylli pa u ndier derën. Shtrëngoi fort sëpatën, e rregulloi që ta kishte gati për çdo rast. Ishte instinkti ai që e ndihmoi.. Qëndroi në pritje, as frymë nuk merrte. Njeriu qëndronte pranë derës; ishin përballë njëri-tjetrit ashtu siç kishte qenë para pak kohe me plakën. I ndante vetëm dera.

I posaardhuri u mbush mirë me frymë. "Trup i madh dhe i dhjamur

duhet të jetë!" - tha me vete Raskolnikovi, duke e shtrënguar edhe më sëpatën. I dukej se ishte në ëndërr. Ky i ra ziles, i ra fort.

Nga tingulli metalik, iu duk se në dhomë lëvizën... Mbajti vesh disa sekonda. I panjohuri i ra përsëri ziles, priti pak dhe lëvizi me padurim dorezën e derës. Raskolnikovi shihte me zemër të ngrirë si tundej e shkundej rezeja, priste që nga çasti në çast të shpërthehej. Dhe dukej fare e mundshme: aq shumë ishte duke lëvizur. I shkoi mendja ta mbante me dorë, por s'e bëri: ai tjetri mund ta kuptonte që nga brenda dikush e mbante. - Ju morën mendtë. "Tani do bie!" - tha me vete, por i panjohuri foli me tërsëllimë dhe kjo e solli përsëri më vete.

- E ç'bëjnë këto? Po flenë apo mos i ka mbytur kush? Të mallkuarat! - Pastaj thirri me zë si një fuçi e troshitur: - Alena Ivanovna! Shtrigë e keqe! Lizeta Ivanovna! Moj të bukurat e dheut! Po hapeni de! I paska zënë gjumi, të mallkuarat!

Si i lojtur mendsh e tundi me sa fuqi që kishte derën, i ra fort dhe gjatë ziles. Dukej që ishte nopran njeri, por i shtëpisë.

I zuri veshi edhe disa hapa të tjerë, të lehtë, të nxituar, nuk duhet të ishin dhe aq larg këtij kati.

- Si, nuk ka njeri? - foli ky me zë të kumbueshëm dhe të gëzuar - duke iu drejtuar të parit që vazhdonte t'i binte ziles. - Si je, Koh?

- "Nga zëri u dukka djalë i ri" - tha me vete Raskolnikovi.

- Dreqi e di se ç'kanë! Plasa duke i rënë ziles, - iu përgjegj Kohu. - Po ju nga me njihkeni?

- S'ju kujtohet? Para tri ditësh tri herë rradhazi ju rraha në bilardo.

- A..a..a..

- Nuk qënkan, domethënë. Çudi! E ku të ketë shkuar, vallë, plakushja? Kisha pak punë me të.

- Po edhe unë, mor zotëri i mirë!

- E po, nuk janë, nuk janë! Mbrapa kthehu! Erdha me shpresë se do merrja një dorë pare... - shtoi djaloshi.

- S'do mend ajo që do ikim, por pse na thanë që do ishin në shtëpi? Bëra gjithë atë rrugë... E ku të kenë shkuar këto shushka? Ajo kurrë nuk del nga shtëpia, qahet nga dhëmbjet, shtrigan. Sonte i qenka tekur të dalë?

- Do pyetur roja.

- Përse?

- Po ku ka shkuar dhe kur kthehet.

- E ç'nxjerr nga kjo?.. E pyesim... E shtyu edhe një herë me sa fuqi që kishte derën, duke luajtur dhe dorezën. - S'ke ç'bën, do ikim!

- Pa dale! - thirri djaloshi. - Shihni këtu, dera nuk është e puthitur...

- Ku?

- Po ja, nuk është e mbyllur me kyç, mbahet vetëm nga rezeja! E shihni si luan rezeja?

- Pa prit...

- Duket ajo!... ka njeri brenda... Po të kishin dalë, do ta kishin mbyllur me kyç. Ç'ne rezeja! Ja si lëviz, kur e tund! Ka njeri brenda, më kuptoni? Janë brenda dhe nuk duan ta hapin!

- Ashtu është, mirë thoni! - foli i habitur Kohu. - Po ç'bëjnë këto! - thirri dhe tundi me sa fuqi që kishte derën, duke lëvizur edhe dorezën.

- Prisni! - tha djali. - Diç ka në këtë mes... Ziles ju i ratë dhe i ratë fort, domethënë o u ka rënë të fikët, o...

- Çfarë?

- Shkojmë të marrim rojen e shtëpisë. Le t'u thërrasë ai më mirë.

- S'e keni keq!

Zbritën të dy shkallët.

- Dëgjoni! Ju rrini më mirë, unë tani vij me rojen!

- Po pse u dashka ndënjur?

- Po ku i dihet?...

- Mirë thoni...

- Jam duke u diplomuar për hetues, nuk më pëlqen fare kjo heshtje e tyre! - tha djaloshi dhe zbriti me vrap shkallët.

Kohu mbeti te dera, i ra edhe njëherë ziles, pa me vëmendje dorezën, e lëvizi ngadalë, në mënyrë që të bindej përfundimisht se dera ishte e mbyllur me reze. Pastaj u ul, pa në vrimën e çelsit, por brenda ishte çelsi, ndaj nuk kishte si të shihte gjë.

Raskolnikovi qëndronte prapa derës dhe shtrëngonte fort sëpatën. Po çmendej nga tronditja dhe tmerri. Kishte vendosur të përleshej me këdo që t'i dilte përpara. Kur trokisnin dhe e shtynin me forcë derën, disa herë mendoi t'u bënte zë dhe të merrte fund kjo punë. I shkrepi në kokë dhe një mendim i çuditshëm: t'i shante e t'i sikteriste paq që aty ku ishte. "Sa më shpejt, më mirë!" - thoshte me vete.

- Po vonohet, dreqi e marrtë! - belbëzoi me padurim Kohu, e la vendin e rojes dhe iu drejtua shkallëve, zuri t'i zbres duke përplasur thundrat. Pas pak çapet e tij nuk u dëgjuan më.

- O Zot! Po tani?

E hoqi rezenë, hapi pak derën, përgjoi: asnjë zhurmë, asnjë lëvizje. Pa e bërë të gjatë, doli, e mbylli mirë derën dhe zuri të zbriste shkallët. Kishte zbritur tri shkallina kur poshtë u dëgjua potere dhe britma. Ku të futej? Nuk kishte ku të fshihej! Iu afrua me vrap derës, për të hyrë nga kishte dalë.

- Ah, mor horr i horrit! Kapeni!

Vinte nga katet e poshtme. Nga njëri prej apartamenteve dikush doli me vrap dhe u rrokullis nëpër shkallë, duke thirrur me sa fuqi kishte.

- Mitka! Mitka! Thefsh qafën! Në esfel vafsh!

Britma pastaj u fashit, ra heshtja. Por nuk zgjati shumë: poshtë u dëgjuan zëra që jepnin e merrnin. Tre a katër njerëz zunë të ngjisnin shkallët. Njohu zërin e kumbueshëm të djalit. "Ata janë!" - tha me vete Raskolnikovi.

I pushtuar nga dëshpërimi, duke mos ditur nga t'ia mbante, eci në drejtim të tyre: të dalë ku të dalë! "Në më ndalofshin, mora fund, por edhe në nuk më ndalojnë, kanë për të ma fiksuar fytyrën!" - i vegoi vetëtimthi në kokë. Po afroheshin, i ndante vetëm një kat dhe ja, shpëtimi! Mu përpara syve i doli dera e hapur e një apartamenti, ishte apartamenti bosh i katit të dytë, ku po lyenin bojaxhinjtë. Nuk kishte njeri. Me siguri që do kishin qenë ata që dolën ashtu me britma. Në mes të dhomës ishte kova me bojë, furça qe hedhur në dysheme, brenda ishte rrëmujë. Hyri dhe u fsheh prapa derës; arriti në kohë: ata që po ngjitnin shkallët i qenë afruar hyrjeve të katit të dytë, vazhdonin të ngjiteshin duke biseduar me zë të lartë. Priti sa u larguan dhe në majë të gishtave doli dhe u lëshua vetëtimthi nëpër shkallët.

Xhanxhin! As te porta nuk takoi njeri. Doli me të shpejtë dhe ktheu në rrugën majtas.

E dinte që tani ata i qenë afruar apartamentit të plakës, kishin parë të habitur që dera ishte e hapur, janë duke parë kufomat, e kuptuan që aty brenda qe fshehur vrasësi, tani ia kishte mbathur, do ta kuptonin edhe se ku kishte mundur të fshihej. Megjithë këtë nuk e

shpejtoi hapin, ndonëse deri në bërrylin e afërm i kishin mbetur disa metra. "Mos do ishte më mirë të futesha në ndonjë hyrje këtu dhe të prisja pak? Po sikur ta flakja sëpatën! Të merrja një karrocë më mirë. Bo-bo, ç'më gjeti!".

Ja dhe bërryli, ktheu gjysmë i vdekur, pjesa më e madhe e punës qe bërë, mund të shpëtonte... Tani dyshimet do të ishin më të pakta, rrugët qenë plot e përplot me njerëz. Humbi në turmën e kalimtarëve. Torturat sfilitëse që kishte hequr e kishin telikosur dhe zgërlaqur, mezi po i hiqte zvarrë këmbët. Djersët i shkonin çurg nëpër fytyrë, qafën, tëmthat i kishte qull. "Ku i ke sytë!" - i hoqi vërejtjen dikush, kur e pa që ecte kot së koti.

Ishte fare i hutuar, sa më shumë kohë kalonte, aq më keq e ndjente veten. Kishte dalë në një vend me pak njerëz, mund të binte në sy, duhej kthyer në ndonjë rrugicë. Edhe pse mezi po qëndronte, e detyroi veten të bënte një lak dhe t'i dilte shtëpisë nga ana tjetër.

Kur shkeli në pragun e hyrjes ku banonte, thuajse nuk ishte fare në vete; kishte filluar të ngjiste shkallët, kur iu kujtua sëpata. Duhej kthyer aty ku u mor, pa e vënë re kush. Mendja nuk i punonte se, kuptohet, më mirë do kishte qenë ta kishte hedhur sesa ta kthente në vendin ku e kishte marrë.

Por i eci, edhe ky veprim i doli me sukses. Dera e kolibes së rojtarit ishte mbyllur, por jo me kyç; rojtari fare mirë mund të kishte qenë brenda. Aq mëndjeprishur ishte, saqë e shtyu derën. Të kishte qenë roja, do ta kishte pyetur: "Ç'dëshironi?". Me siguri që do t'i kishte zgjatur sëpatën... Por roja nuk ishte. Raskolnikovi e vuri sëpatën aty ku e kishte marrë, madje i vuri përsipër edhe çarallaket. Asnjë të njohur nuk takoi deri sa hyri në dhomën e tij. Dera e apartamentit të pronares ishte e mbyllur. Me të hyrë, u lëshua fuqiprerë në kanape, i veshur siç kishte qenë. Nuk fjeti, por ishte në kllapi. Po të kishte ardhur tani dikush, do të kërcente i fandaksur, do vinte ulërimën! Copëra mendimesh, ndiesi të trazuara ia pështjellonin kokën, asgjë nuk ishte në gjendje të shquante e të veçonte, në asnjërën nuk mundej të ndalej. Dhe donte ta bënte, vinte të gjitha forcat për ta bërë.

Pjesa e dytë

I

As vetë nuk e dinte sa kohë ndënji ashtu. I ndodhte të zgjohej, e shihte që ishte natë dhe s'i bëhej të ngrihej. Po agonte. Rrinte shtrirë me fytyrë nga tavani, fare i përhumbur pas asaj gjendjeje jermi. Dëgjonte britma, rënkime, ofshama dëshpërimi, që, si edhe herë të tjera, vinin nga rruga, aty rreth orës tre. Ato e kishin zgjuar. "A! Janë të dehurit që i nxjerrin nga mejhanet. Qënka ora tre. - Brofi si ta kishte çpuar njeri me bodec. - Ora tre?!... ". U ul në kanape. Ngjarjet e shkuara i dolën para syve! U dukën dhe u zhdukën si një vegim...

Iu duk se po i iknin mendtë. Rrëqethje të akullta ia përshkuan trupin, i vinin edhe nga ethet që kishin kohë që po e tundnin, i pat ndier edhe në gjumë. I kërcisnin dhëmbët, nuk dinte ku të futej. Hapi derën, mbajti vesh: qetësi, të gjithë flinin. Pa veten, mjedisin e dhomës, u çudit si paska hyrë mbrëmë dhe s'e paska mbyllur derën me rezé, qënka shtrirë në kanape i veshur dhe i mbathur, pa hequr kapelen nga koka. "Po sikur të kishte hyrë kush, ç'do mendonte? Do thoshte që paskam qenë i dehur, por...". U turr te dritarja; kishte aguar, pa veten nga koka te këmbët, mos kishte ndonjë gjurmë? Por nuk ishte punë që bëhej: me duart që i dridheshin u zhvesh dhe zuri të shohë një nga një rrobet, iu kthye dhe iu rikthye disa herë kësaj pune. Nuk pa gjëkundi gjurmë gjaku, vetëm në fundin e pantallonave, në palën e brendshme, vuri re një njollë gjaku të mpiksur. Mori dhe e preu atë copë stofi. Iu kujtua qeseja dhe sendet e tjera që kishte marrë te plaka, i kishte dinga xhepet me to. Nuk kishte bërë asgjë për t'i fshehur! I kishin dalë fare nga mendja! Si i lojtur zuri t'i nxjerrë e t'i vërë në tryezë. Nxorri jashtë edhe astarin e xhepave që të bindej përfundimisht se asgjë nuk kishte lënë pa nxjerrë. Ashtu si qenë, i mblodhi dhe i vuri

në cepin ku ishte shqyer letra që mbulonte murin dhe bëri një si gropë. I rrasi, asgjë nuk dukej. "Edhe qesen e mori!" - tha me vete i gëzuar, duke parë mendueshëm vendin ku i kishte futur. Papritur u lebetit vetë me veten: "Po pse kështu fshihen plaçkat? Ç'është kjo që bëra?...".

Nuk kishte menduar se do i duhej të merrte sende, e kishte prerë mendjen se do të merrte vetëm para, ndaj nuk kishte menduar as për vendin ku duhej t'i fshihte. "U gëzova unë tutkuni! Po pse të fshehur është ky? Duket që janë duke më rrjedhur trutë!...". I mpakur u ul në kanape, të dridhurat po i merrnin frymën. Zgjati dorën, mori nga karrigia pallton e studentit, krejt zhele, por që të mbante ngrohtë, e hodhi krahëve: dremitja, por edhe kllapija e kapluan sakaq.

S'kaloi as pesë minuta dhe u gjend në këmbë. Fare i ndërkryer rrëmbeu rrobat që kishte zhveshur. "Po si guxova të dremis, kur gjë prej gjëje nuk kam bërë? As lakun nga xhaketa nuk e kam hequr! Po pse gjë e vogël është? Është provë që ç'ke me të!" E shqepi, e bëri copë-copë dhe e futi nën jastëk, aty te ndërresat. "Copërat nuk kanë si ngjallin dyshim!" - mendoi. Qëndronte si i huptë në mes të dhomës, shihte me sy të çakërryer rreth e rrotull, mos kishte harruar gjë. E mundonte shumë vetëdija se qe duke e lënë kujtesa, imagjinata... "Mos është fillimi i ndëshkimit? Ashtu duhet të jetë..." Se ja, copa që kishte prerë nga pantallonat vazhdonte të ishte në dysheme, në mes të dhomës, kushdo që të vinte do ta shihte! "Po ç'kam vallë, kështu?" - thirri fare i përhumbur.

Sakaq e shungulloi një mendim i çuditshëm; ndoshta rrobat i ka të zhyera me gjak, ndoshta është krejt i përlyer, dhe ai vetë nuk i sheh, nuk po i punojnë shqisat. I është errësuar logjika... Se ja, i kujtohet fort mirë që qesja ishte krejt e qulltë nga gjaku; ashtu si kishte qenë e kishte rrasur në xhep, pra edhe xhepi duhet të jetë me gjak. I nxorri përsëri astarët e xhepave; nuk qe gabuar, në disa vende kishte gjurmë gjaku... "Pra, del që nuk më paska lënë fiqiri, qënkam në gjendje të gjykoj dhe të kujtoj, - tha me vete i gëzuar dhe mori frymë lirisht. - Më vjen nga pafuqija, nga ethet dhe jermi, por do më kalojë!". E shqeu astarin e xhepit të lyer me gjak. Një rreze dielli kishte rënë aty ku ishin çizmet, në majën e njërës i zuri syri njolla gjaku të mpiksur. Me sa dukej, kishte shkelur padashje pellgaçen e gjakut. "Si t'ia bëj? Ku t'i fus këto plaçka të përlyera me gjak?". I grumbulloi në një vend

dhe qëndroi në mes të dhomës. "Në sobë, po nuk kam si i djeg! As shkrepse nuk kam! Më mirë po i hedh kur të dal... Çizmet po i laj... - tha kështu dhe u ul përsëri në kanape. - Sa më shpejt, më mirë!".

Koka iu var dhe i ra në jastëk: ethet po ia merrnin shpirtin, mori pallton dhe u mbulua me të përsëri. Ndënji kështu disa orë dhe si në jerm i thoshte vetes: "Tani, pa u vonuar, duhet dalë, duhen hedhur diku, sa më shpejt më mirë!". Disa herë bëri të çohej, po nuk po mundej. Përfundimisht e solli në vete një trokitje e fortë në derë.

- Po hape, de! Gjallë je? Vetëm fle, zavalli!.. - njohu zërin e Nastasisë. Ishte ajo që po i binte me grushta derës. - Ditë e natë vetëm fle! Qen e shkuar qenit! Hape! Është njëmbëdhjetë ora!

- Mos nuk është brenda? - tha një zë burri.

"Zëri i rojes... Po ky ç'do nga unë?".

U çua ulur në kanape. Zemra i rrihte aq fort, sa zuri t'i dhimbte.

- Po rezenë e derës kush ia ka vënë? - e kundërshtoi Nastasia. - Ka filluar të mbyllet brenda tani! Mos e rrëmbejnë! Hape! Shpejt!

"Ç'duan kështu? Po e hap, të dalë ku të dalë...".

U zgjat dhe hapi rezenë, aq e madhe ishte dhoma...

Nastasia po e shihte jo si ngahera. I drejtoi rojes një vështrim kuptimplotë dhe të dëshpëruar. Ky heshturazi i zgjati një letër të palosur më dysh, me vulë dylli.

- E ke nga zyra, - i tha.

- Nga ç'zyrë?...

- Nga zyrat e policisë. Nga ku tjetër...

- E policisë?... E pse?

- Po unë ku ta di? Të kërkojnë, domethënë duhet shkuar, - tha kështu dhe e pa i përqëndruar, pastaj e kaloi shikimin nëpër dhomë dhe ktheu shpinën që të dilte.

- Duket ajo, të paska vënë për fund sëmundja! - i tha Nastasia që s'ia ndante sytë. Edhe roja ktheu kryet. - Të paskan dërrmuar fare ethet.

Nuk iu përgjigj, në dorë mbante ende letrën e pa hapur.

- Po mirë, mos u ngri, - i tha Nastasia me zë të përvuajture, kur e pa që Raskolnikovi donte të çohej. - Je sëmurë, pret ajo punë. Po ato që mban në dorë, ç'i ke ashtu?

Ishin astari i xhepit dhe copa e pantallonave. E kishte mundur

gjumi me ato shtrënguar në dorë. Tani që u përmend, pas asaj gjendjeje kllapije, vazhdonte t'i mbante ende shtrënguar në dorë.

- Se nga i paske psonisur ca rreckurina dhe më fleke me to si të jenë thesar... - e qesëndisi Nastasia dhe ia plasi gazit. Ky i fshehu sakaq nën pallto dhe e pa ngultas. Nuk qe fort në gjëndje të kuptonte ç'po ndodhte, por aq arriti ta merrte vesh: po të kishin ardhur për atë çështje, nuk do silleshin kështu... "Po... policia?".

- Një gotë çaj do të lehtësonte! Të ta sjell? Tani sapo e zjeva...

- Jo, do dal... Do dal që tani... - mërmëriti duke u çuar.

- Kujdes mos bjesh nga shkallët?

- Jo, jo...

- Si të duash.

Ndënji sa iku roja. Iu afrua dritares, pa leckat që shtrëngonte në dorë: "Paskan njolla, po nuk duken; ngjajnë me tepër si zhul, sesa si gjak. Kush nuk e di ç'janë, s'e dallon dot! As Nastasia nuk kishte si i shquante!". Me duart që i dridheshin hapi letrën dhe e lexoi, e lexoi disa herë, mezi e kuptoi. Ishte një njoftim i rëndomtë, duhej të paraqitej sot në orën nëntë e gjysëm në zyrën e shefit të policisë të rajonit.

"Po ç'të jetë? Nuk di të kem ndonjë punë me policinë! Pastaj përse pikërisht sot? - vargani i ca pyetjeve si këto nuk kishte të sosur. - O Zot! Sa më shpejt më mirë!" Deshi të bjerë në gjunjë për të bërë një lutje, por qeshi: jo me lutjen, qeshi me veten. U vesh me ngut. "Si të jetë e shkruar! - tha me vete. - T'i vesh çorapet, edhe në kanë ndonjë gjurmë, nga fërkimi do shuhet". Kur i veshi, i shkuan mornica, e mbyti neveria. I zhveshi, po nuk kishte të tjera, kështu që i veshi përsëri dhe përsëri qeshi... "Gjerat si t'i vijnë i merr i gjori njeri! - mendoi. - Ja, i vesha e çfarë? Bëra si bëra dhe i vesha!" Sakaq e qeshura ia la vendin dëshpërimit. "Jo, nuk mundem të duroj... Është shumë e rëndë kjo gjëndje..." - tha me vete. I dridheshin leqet e këmbëve. "Nga frika!" - mërmëriti. I merreshin mendtë, koka i digjte prush. "Mos është ndonjë dhelpëri kjo thirrje? Mos duan të më ngatërrojnë? - vazhdoi të arsyetonte duke zbritur shkallët. - Sa keq që jam si në jerm... ka rrezik të më shpëtojë ndonjë marrëzi...".

Në shkallë iu kujtua që të gjitha sendet i kishte lënë në atë farë bire. "Po sikur të bëjnë ndonjë kontroll të beftë?" - tha dhe e ndali

hapin. E pushtoi një i tillë dëshpërim, një i tillë cinizëm, në mund të shpreheshim kështu, për fundin që e priste, saqë tundi dorën dhe vazhdoi rrugën.

"Sa më shpejt më mirë!...".

Bënte një vapë e padurueshme, asnjë pikë shiu nuk kishte rënë. Të mbyste pluhuri, të merrte frymën era e tullave dhe e gëlqeres, të përzihej nga kutërbimi i mejhaneve, në çdo qoshe të zinte syri të dehur dhe gjithfarë mileti. Dielli i vriste sytë, koka mend po i çahej: kështu e ndien veten gjithkush që është me ethe dhe del në diell.

Kur arriti te kthesa e rrugës *së djeshme*, pa përreth i tmerruar, ia nguli sytë *shtëpisë*... po vetëm për një hop.

"Në më pyetshin, mund edhe t'u tregoj", - mendoi, duke iu afruar zyrës së policisë.

Nga dhoma e vet deri te zyrat e policisë nuk kishte më shumë se pesëqind metra rrugë. Ishte një godinë e re, zyrat ndodheshin në katin e katërt. Në selinë e mëparshme i kishte rastisur të vinte, por kohe me parë. Hyri ne portë, pa shkallët djathtas, po zbriste dikush me regjistër në dorë. "Roje pallati duhet të jetë", - tha me vete. U ngjit nëpër shkallë, eci me tahminë, s'donte t'i drejtohej kujt me pyetje.

"Do hyj, do u bie në gjunjë, do jua tregoj të gjitha..." - tha me vete, kur mbërriti në katin e katërt.

Dera e zyrave të policisë ishte e hapur, kishte njerëz që qëndronin në pritje. Vapës së madhe tani iu shtua edhe era mbytëse e bojës së freskët, me të cilën sapo ishin lyer dyer e mure. Priti pak, por vendosi të bënte përpara, të hynte në ndonjërën prej dhomave, makar për të pyetur, nuk po i durohej të dinte të saktë arsyen e thirrjes. Kështu bëri. Këtu rrinin disa shkrues, që shihnin punën e tyre; nuk ishin të veshur kushedi sa më mirë se ai, kishin pamje të çuditshme. Iu drejtua njërit prej tyre.

- Ç'është?

I dëfteu letrën.

- Student jeni? - e pyeti ky, pasi pa letrën.

- Po, ish-student.

Shkruesi e pa, por pa treguar ndonjë kureshtje të veçantë. Ishte nga ata që s'para e prishin terezinë.

"Për asgjë nuk iu bëka vonë këtij, ndaj dhe nuk ke ç'të marrësh

vesh", - tha me vete.

- Shkoni tek ajo dhoma atje, - i tha, duke i treguar me gisht dhomën e fundit.

Ishte një dhomë e vogël, plot me tryeza e me njerëz të veshur disi më mirë se ata të dhomave të tjera. Në njërën rrinte një nëpunës i mbajtur mirë, që diç po i diktonte një zonje të përzishme, veshur me rrobe të zeza të fërkuara. Zonja tjetër, një femër e shëndoshë, faqekuqe, e veshur tërë salltanet, me një fustan bojë deti, të zbukuruar me dantella të bardha, me një karficë të madhe sa një pjatë çaji në kraharor, qëndronte mënjanë dhe priste radhën. Raskolnikovi i zgjati nëpunësit fletëlajmërimin. Ky e pa shkarazi dhe i tha: "Prisni!". Vazhdoi t'i diktonte zonjës me të zeza.

Mori frymë i lehtësuar: "Nuk paska lidhje me atë!". I erdhi shpirti në vend, u gjallërua, mblodhi të gjitha forcat dhe e detyroi veten të dukej i qetë, madje i gëzuar, kështu do ta kishte nën kontroll veten.

"Një pakujdesi, një marrëzi, një hap i pamenduar dhe mund të tradhëtoj veten! Hm... Sa keq që s'mjafton ajri! Të mbyt zagushia. Koka më dhëmb dhe vazhdon të më vijë vërdallë... edhe mendjen të trazuar e kam...".

Ishte krejt i çoroditur, i vinte frikë nga vetja, nuk ndihej zot i vetvetes. Bënte të kapej pas ndonjë mendimi, qoftë edhe anësor, por nuk mundte. Vetëm nëpunësi ia tërhoqi vëmendjen: po përpiqej diç të zbulonte në fytyrën e tij. Ishte një djalosh njëzet e dy vjeç, zeshkan, i gjallë, që dukej më i moshuar nga ç'ishte. Ishte veshur mirë, flokët i kishte mbledhur prapa, të lyer e të krehur me merak, thonjtë i kishte të pastruar e të rregulluar, në gishta kishte unaza, në jelek kishte një qostek ari. Ndërkohë këmbeu nja dy fjalë frëngjisht me një zotëri që erdhi atë çast.

- Luiza Ivanovna, uluni, ju lutem, - i tha si kalimthi zonjës fytyrëkuqe që vazhdonte të qëndronte në këmbë dhe s'po guxonte të ulej, ndonëse aty pranë ishte një karige bosh.

- *Ich danke!* - i tha ajo me zë të ulët dhe, pas një fëshfërime mëndafshi, u ul në karrige. Fustani kaltërosh me dantella të bardha, si një parashutë që zbret nga qielli, e pushtoi nga të katër anët karrigen dhe zuri afro gjysmën e dhomës. Ajri u mbush me aromë parfumi. Zonja, me sa dukej, ndaj dhe priste në këmbë e druajtur, ngaqë kishte

frikë se zinte gjysmën e dhomës po të ulej. Qeshi e trëmbur, por edhe mikluese, kurdoherë e shqetësuar.

Zonja me të zeza mbaroi dhe po ngrihej. Befas, tërë zhurmë e kapërdisje, duke u tundur e spërdredhur pas çdo hapi që bënte, hyri një oficer, hodhi mbi tryezë kapelen me kokardën ushtarake mbi strehë dhe u ul në kolltuk. Zonja e veshur me salltanet u hodh përpjetë, me një ceremoni të pafshehur qëndroi në pritje, por oficeri nuk i kushtoi as më të voglën vëmendje. Ishte zëvendës shefi i policisë. Kishte tipare të imta, mustaqe qimekuqe me maja si tela, që përveç paturpësisë dhe harbutërisë, nuk shprehnin asgjë tjetër. E pa me bisht të syrit Raskolnikovin: tepër të pështirë e kishte atë kostum; dukej i përulur, por në të vërtetë duhej të ishte fodull njeri. Edhe ky nuk u tregua i kujdesshëm: e pa gjatë, më tepër sa duhej, kjo e zemëroi zëvendës shefin.

- Pse ke ardhur? - i bërtiti. Ishte i habitur që një palo zhelan si ky as që kishte ndër mend të mpakej nën shikimin e syve të tij si vetëtimë.

- Më kanë thirrur.. me lajmëthirrje... - mërmëriti Raskolnikovi.

- Për punën e parave që s'i ka paguar pronares, është student, - nxitoi ta sqarojë nëpunësi, duke u shkëputur nga shkresat. - Ja! - i zgjati Raskolnikovit fletoren dhe i tregoi me gisht vendin. - Lexojeni.

"Para? Për çfarë parash? - mendoi Raskolnikovi. - Po, po! Jo për atë!..." - sa s'u hodh përpjetë nga gëzimi. E ndjeu veten shumë, po shumë të lehtësuar, nga supet sikur shkarkoi një barrë të rëndë.

- Në ç'orë është shkruar të vinit, zotëri i nderuar? - thirri oficeri që e ndjeu veten të fyer. - Është shkruar në nëntë, tani po shkon dymbëdhjetë!

- Ma sollën një çerek ore më parë, - i tha Raskolnikovi me zë të lartë dhe e pa mënjanazi. Krejt papritur se përse u zemërua dhe ndjeu nga kjo kënaqësi.- Jam me ethe dhe përsëri erdha, kjo nuk është pak!

- Kini mirësinë të mos bërtisni!

- Unë nuk po bërtas. Po flas shtruar, jeni ju ai që po bërtisni; jam student dhe s'i lejoj kujt të më bërtasë!...

Zëvendës shefi u xhindos dhe aq shumë sa në fillim nuk po mundte as të fliste dot, vetëm nga buzët e shtrembëruara i dolën ca spërkla. Brofi i ndërkryer.

- Mjaft! Jeni në zyrat e policisë këtu! Silluni si duhet, zotëri!

- Edhe ju në zyrë jeni, - ia ktheu Raskolnikovi. - Bërtisni dhe cigaren s'e hiqni nga goja! Shëmbull të mirë po jepni! - iu shkreh me mllef dhe zemra po i gufonte nga një kënaqësi e papërshkrueshme.

Nëpunësi i shihte me buzën në gaz. Oficeri gjaknxehtë dukej që kishte shkelur në dërrasë të kalbur.

- Nuk do më mësoni ju si duhet të sillem! - thirri me sa e kishte në kokë i çakërryer. - Pa ma jepni këtë fletëlajmërim! Tregojani, Aleksander Grigorjeviç, ankesën e bërë kundër tij... Nuk keni paguar qiranë! Vini këtu edhe i ngrehosur, pale!

Raskolnikovi nuk po e dëgjonte. Rrëmbeu letrën, e lexoi dy herë, por asgjë nuk po mundte të kuptonte.

- E ç'është kjo? - iu drejtua nëpunësit.

- Është shuma që detyroheni në bazë të ligjit. O duhet të paguani në vend bashkë me kamatën, o duhet të lëshoni një deklaratë me shkrim ku të zotoheni, kur do ta shlyeni. Detyroheni të mos largoheni nga kryeqyteti dhe as ta shisni apo ta fshihni pasurinë. Paditësi ka të drejtë ta përvetësojë pasurinë tuaj, në bazë të ligjit.

- Po unë nuk i kam borxh kujt!

- Këtë ne s'mund ta dimë. Te ne kanë paraqitur këtë ankesë sipas të gjitha rregullave; detyrimi përbën shumën prej njëqind e pesëdhjetë rubla, i detyroheni vejushës Zarnicina... Me kërkesen e saj dhe ju kemi thirrur.

- Po ajo është qiramarrësja ime?

- E ç'e pastaj që qenka qiramarrësja?

Nëpunësi e shihte me një buzagaz mëshirëplotë, por edhe me një ngazëllim triumfatori që e vuri me shpatulla për muri këtë axhami, të cilin sapo kanë filluar ta kafshojnë. "Po tani?" - sikur donte ta pyeste ai shikim. Ndërsa Raskolnikovi as që donte t'ia dinte për atë detyrim! A ia vlente ta përfillte, pale pastaj të merakosej nga një gjë e tillë? Dëgjonte, pyeste, lexonte, përgjigjej fare mekanikisht. Ishte i mbushur plot e përplot me ngadhnjimin e vetëmbrojtjes, të çlirimit nga makthi sfilitës i rrezikut që i kanosej. Nuk dëshironte as t'i analizonte e as t'i hamendësonte ngjarjet që e prisnin. Ishte një gëzim i drejtpërdrejtë ky i tij, një gëzim i gjithpushtetshëm, instinktiv.

Atë çast në zyrë sikur ra një rrufe e gjëmim bashkë! Zëvendës shefi, ashtu i çakërryer siç ishte, nga kjo mungesë respekti që patën

treguar, duke shfryrë e duke kërcëlluar, për t'ua treguar të gjithëve se kush ishte, dhe për të vënë në vend dinjitetin e cënuar, iu vërsul frelëshuar të gjorës zonjë të veshur serbes. E shihte dhe s'i ndahej buzagazi i idiotit nga fytyra.

- Po ti moj, që më rri kështu si zonja Shën-Mari? - i ulëriu me sa mundi. (Zonja e përzishme kishte dalë). - Ç'ju ndodhi juve atje natën që shkoi? E? Turp e faqja e zezë! E mori vesh i madh e i vogël! Përsëri orgji, të shara e të rrahura! Mos doni t'u surdisim? Se ju kemi dalë borxhit ne!... Dhjetra herë ju kemi paralajmëruar! Ç'më rri ashtu, fol!

Raskolnikovit i ra letra nga dora, pa i habitur zonjën, që ia morën erzin barbarisht, por shpejt e kuptoi si qëndronte puna dhe historia zuri ta zbaviste. Dëgjonte me qejf, ia kishte ënda të qeshte, të qeshte, të qeshte... S'e përmbante dot shkulmin nervor...

- Ilia Petroviç! - iu drejtua shkruesi me kujdes, por ndali për të pritur çastin e volitshëm: zëvendës shefi qe lëshuar revan dhe s'kishte burrë t'i dilte përpara.

Zonja e veshur me salltanet në fillim nuk po gjente dot vend ku të futej, por, o çudi, sa më të forta dhe harbute bëheshin sharjet, aq më e ëmbël i bëhej fytyra, aq më joshëse i bëheshin buzët e fryra dhe të zgjatura në drejtim të zëvendës shefit. U çua ngadalë, bëri në vend numëro dhe mezi po priste ta thoshte edhe ajo fjalën e saj. Dhe i duruari i fituari.

- As orgji, as të shara e as të rrahura nuk kemi patur, zoti shef, - i foli rrjedhshëm, qartë, por me akcent gjermaneje. - Asnjë skandal! S'kemi asnjë faj. Ata erdhën të dehur... Shtëpia jonë është nga më të fismet, zoti kapiten! Sillemi si i ka hije fisnikut! S'i lejojmë skandalet! Erdhën të dehur dhe kërkuan edhe tri shishe... pastaj njëri ngriti këmbët dhe zuri t'i bjerë pianos me to... S'bëri mirë, pse sillet kështu njeriu në një shtëpi të fisme?... E theu fare pianon, e qortova për këtë... Ky rrëmbeu shishen dhe fut e bjer, kush t'i dilte përpara. Thirra rojen, Karlin; e qëlloi me grusht në sy, edhe Henrietën e goditi, mua më ra me pëllëmbë në faqe! Pse sjellje e denjë për një shtëpi të fisme është kjo? Atëherë bërtita! Ai hapi dritaren dhe zuri të kuis si derrkuc... Turp e marre! E dëgjoi bota! Karli e kapi nga fraku që ta largonte nga dritarja, pa dashje, por ia shqeu frakun. Vuri pallmën, tha se duhej

t'ia paguanim... pesëmbëdhjetë rubla kërkoi. Ia dhashë me dorën time, zoti kapiten! Është nga fisnikët, zoti kapiten, por ja që i kishte shkrepur të bënte skandal! E paralajmërova se do ta bëja për një lek, do t'ia nxirrja emrin në gazetë...

- Mos është ndonjë nga shkrimtarët?

- Po, zoti kapiten; vetëm një njeri aspak fisnik sillet asissoj në një shtëpi fisnike!

- Mirë, tani lëri këto. Të kam thënë sa më ka rënë goja...

- Ilia Petroviç! - ndërhyri përsëri me zë paralajmërues nëpunësi. Zëvendës shefi e pa rrëshqitas, ky i tregoi me kokë.

- ... Domethënë, shumë e nderuara Luiza Ivanovna po ju paralajmëroj për të fundit herë, ta kini vath në vesh, - përsëriti zëvendes shefi. - Në ndodhtë në atë shtëpinë tënde të fisme qoftë edhe një skandal i vetëm, do ju bëj që të mos dini ku të futeni... Dëgjuat?... Kurse shkrimtari ua paska marrë pesëmbëdhjetë rublat për frakun që i shqyet. Hajde shkrimtar, hajde! - tha dhe i hodhi një vështrim përbuzës Raskolnikovit. - Para tri ditësh në një mejhane ja se ç'ndodhi: hëngri e piu burri i botës, por për të paguar nuk dëgjonte. "Në më detyrofshi, di unë se ç'kam për t'u punuar në shkrimet e mia!" - u tha. Një tjetër si ky në vapor ç'nuk i punoi një familjeje të nderuar, me fjalë rrugësh e sikterisi. Se nga na kanë dalë tani ca shkrimtarë që amam o Zot! Dhe jo vetëm ata, por edhe studentët nuk mbeten prapa! Tellallër janë jo njerëz!... Tpu!... Tani ik!...Do vij vetë aty... njërën kam për të bërë... Dëgjove?...

Luiza Ivanovna me një miresjellje të ngutur u përshëndet dhe, duke u përkulur dhe spërdredhur, zuri të zbythej për nga dera, por atje u përplas me një tjetër oficer, të mbajtur për bukuri, me një fytyrë të freskët, me flokë të krehur me merak, me baseta të dendura. Ishte Nikodhim Fomiçi dora vetë, shefi i policisë. Luiza Ivanovna shpejtoi t'i përkulet deri në dysheme dhe me ca kërcime të vockëla, të dendura, fluturoi nga zyra.

- Përsëri rrufe e bubullima, shtrëngata e furtuna! - iu drejtua tërë mirësjellje e dashamirësi Ilia Petroviçit. - Përsëri e tallazitët veten, persëri e leqendisët! Ju dëgjova kur po ngjisja shkallët.

- E po, - me një shkujdesje fisniku ia ktheu Ilia Petroviçi dhe zuri të merret me ca shkresurina në tryezën tjetër, duke bërë me supet

dhe me krahët ca figurina të çuditshme. - Ja, kini mirësinë të bindeni vetë, zoti shkrimtar, domethënë student, ish-student. Paratë nuk i paguani, dhomën nuk e mirëmbani, ankesa dhe vetëm ankesa, kurse erdhët i fryrë, më hoqet dhe vërejtjen që e mbaj cigaren në buzë. Se nga prapësitë e jo nga të mirat vini e paraqiteni këtu te ne...

- Varfëria nuk është mëkat, or mik! Po, nejse, u nxehët pak! Nuk i duruat vërejtjet që ju bënë... - ndërhyri Nikodhim Fomiçi, duke iu drejtuar me mirësjellje Raskolnikovit. - Po tërë këto i lemë mënjanë... Më dëgjoni mua... Kështu e ka i shkreti njeri: edhe nxehet, edhe ngrefoset... thua ti u përmbys bota... por s'kalon shumë dhe çdo gjë fashitet, mbetet zemra e qëruar... Këtë mikun këtu në regjiment ashtu e thërrisnin: "Kapiten baroti...".

- Dhe çfarë regjimenti që ishte! - sqaroi Ilia Petroviçi i kënaqur që e kishin gudulisur asisoj, por ende vazhdonte të ishte i ndërkryer.

Raskolnikovi ndjeu një dëshirë të madhe për t'u thënë diçka jashtëzakonisht të këndshme.

- Më falni, zoti kapiten! - nisi fare shpenguar, duke iu drejtuar Nikodhim Fomiçit. - Dua që të më kuptoni... Ju kërkoj ndjesë përulësisht në kam bërë gabim. Jam fare i këputur dhe shumë i sëmurë, jam një student në ditë të hallit (kështu i tha: "në ditë të hallit"). Jam një ish-student, ngaqë tani nuk e mbaj dot veten as me frymë, por do më vijnë ca para... Kam nënën dhe motrën në një qytet provincial... ato do më ndihmojnë... borxhin që kam do ta shlyej... Qiraxhesha është grua zemërmirë, por u nxeh ngaqë i humba mësimet që jepja dhe u bënë katër muaj që nuk po i paguaj qiranë, më ka prerë dhe drekat nga kjo... Më falni, në fillim nuk e kuptova si qëndronte puna. Më kërkon që t'i laj borxhin, do t'ia laj...

- E po, bukur fort, u morëm vesh... - i tha nëpunësi.

- E dini si qëndron puna? - vazhdoi Raskolnikovi, duke iu drejtuar jo nëpunësit, por Nikodhim Fomiçit dhe duke u munduar të tërhiqte edhe vëmendjen e Ilia Petroviçit, ndonëse ky bënte sikur rrëmonte në shkresurinat dhe s'donte t'ia dinte për atë që po tregonte. - Shkurt po ua tregoj: kam tre vjet që banoj te kjo qiramarrëse, kur erdha, s'kam si e fsheh këtë, i dhashë fjalën se do të martohesha me të bijën.. Ishte një vajzë si të gjitha vajzat, më pëlqente, por nuk e dashuroja.. Punë të rinjsh... Më bëri favore e lehtësime, po unë, axhami mendje-

lehtë siç isha...

- As që jua kërkon kush këto intimitete, zotëri mëshirëplotë... S'kemi as kohë t'ju dëgjojmë... - e ndërpreu me zë të lartë Ilia Petroviçi, por Raskolnikovi, i rrëmbyer siç ishte, vazhdoi të vetën, ndonëse fliste me vështirësi të madhe.

- Po, ju lutem, më lejoni t'u tregoj si qëndron puna... edhe pse, ndoshta, nuk lidhet drejtpërdrejt me padinë dhe mundet të jetë diçka e tepërt, ju keni të drejtë.. Para një viti vajza vdiq, nga tifoja, vazhdova të banoj në dhomën e qiramarrëses, më tha se kishte besim tek unë, se do më priste me qiranë, nuk do më padiste... Kur humba mësimet dhe mbeta fare pa një grosh, më paska paditur... Po kësaj ç'i thonë?

- Tërë këto shpjegime, i nderuar zotëri, ne as që na interesojnë, - ia preu përsëri me arrogancë Ilia Petroviçi. - Duhet të lëshoni deklaratë me zotimin për afatin e shtytjes; të tjerat as që na duhen...

- Po kështu nuk bën... si tepër prerë, egër... - belbëzoi Nikodhim Fomiçi, duke u ulur në karrige dhe duke firmosur ca shkresa. E ndjeu veten me turp.

- Shkruani atëherë, - i tha nëpunësi.

- Çfarë të shkruaj? - e pyeti i vrenjtur Raskolnikovi.

- Atë që do ju diktoj unë.

Iu duk që nëpunësi po sillej fare pa sajdi, madje se e përbuzte pas atij rrëfimi, por, çudi e madhe, se nga i erdhi një vendosmëri dhe as që donte t'ia dinte për mendimin e të tjerëve; dhe ky ndryshim i ndodhi sa hap e mbyll sytë. Po të kishte menduar pak, do qe habitur vetë me veten si kishte mundur të fliste ashtu me ta, madje kishte arritur deri aty, saqë u qe imponuar me ndjenjat e veta. Po tëre ai lumë kujtimesh ç'ishte? Se tani edhe sikur kjo dhomë të mbushej dinga jo më me policë, por me miq zemre, nuk do t'i dilte nga goja asnjë fjalë për të qenë, aq shumë të boshatisur e kishte zemrën. Ndjenja zymtake e vetmisë së ngahershme e pllakosi sakaq. Nuk i vinte ngaqë e poshtëroi Ilia Petroviçi, e ku e çante kokën tani për poshtërsinë dhe xhahilësinë e zëvendës shefit të policisë, për gjermanen, për borxhin... Edhe sikur ta kishin dënuar me djegie përsëgjalli, edhe këtë po kështu do ta kishte dëgjuar fare i çoroditur dhe i përhumbur siç ishte. Po i ndodhte diçka e re, deri më tani e paprovuar... Ishte një gjendje e tmerrshme, por edhe e çuditshme!

Nuk ishte se e kuptonte, më tepër e ndiente me tërë qënien e tij se jo më me ato shpërthime të befta, por as me një gjë s'do të mundte t'u drejtohej më njerëzve, dhe jo vetëm atyre që ishin në zyrat e policisë, por as motrave e vëllezërve; një ndijim të këtillë tepër të çuditshëm e të tmerrshëm kurrë s'e kishte provuar ndonjëherë më parë.

Dhe meqë ishte ndijim e jo vetëdije, po e mundonte shumë. Ishte më i fuqishmi që kishte provuar ndonjëherë në jetë!

Nëpunësi po i diktonte tekstin e deklaratës: tani për tani nuk mund ta paguaj, premtoj se do ta paguaj (ndonjëherë), nuk do largohem nga qyteti, nuk do ta shes pasurinë, nuk do ta dhuroj, etj.

- Po ju edhe për të shkruar nuk qënkeni në gjendje, po ju bie pena nga dora, - i tha nëpunësi, duke e parë me kërshëri. - Jeni i sëmurë...

- Po, më merren mendtë... vazhdoni!

- Kaq ishte, firmosni.

Nëpunësi ia mori deklaratën dhe u mor me punë të tjera.

Raskolnikovi i zgjati penën, por në vend që të ngrihej e të largohej, vuri bërrylat mbi tryezë, shtrëgoi fort kokën me pëllëmbë. I dukej sikur po i futnin gozhdë në tëmtha. Befas i erdhi një mendim i çuditshëm: të ngrihej, t'i afrohej Nikodhim Fomiçit dhe t'i tregonte për atë të djeshmen, t'ia thoshte që të gjitha fill e për pe, të shkonte bashkë me të në dhomë, t'i tregonte sendet që kishte fshehur, atje në birë... Tundimi ishte aq i fortë, saqë u çua ta vinte në jetë. "Mos do menduar më parë? - i vetëtiu sakaq në mendje. - Jo! më mirë kështu, pa u menduar fare; ta heq një herë këtë barrë, pastaj të dalë ku të dalë..." Ndali i gozhduar në vend: Nikodhim Fomiçi po fliste tërë pasion me Ilia Petroviçin, i zuri veshi këto fjalë:

- Nuk ka mundësi, që të dy duhen liruar. Kundërti dhe vetëm kundërti ka në këtë mes! Pse duhej të vinin të thërrisnin rojen, po ta kishin bërë ata? Që të binin me këmbët e tyre brenda? Apo ndoshta për të fshehur gjurmët? Si tepër e stërholluar më duket kjo e dyta? Ndërsa studentin Pestrjakov e kanë parë te hyrja të dy rojet edhe dyqanxhiu; kishte qenë me tre shokë, qe ndarë prej tyre, pikërisht te hyrja, i ka pyetur rojet për adresën, kur ishte bashkë me shokët. Po pse a mund të bëjë kështu një që vete për atë punë? Kurse Kohu, para se të kthente nga plaka, kishte qenë te argjendari, kishte ndenjur aty rreth një gjysëm ore, te plaka qe në ora tetë e një çerek. Tani

merreni me mend...

- Po kjo që thonë si do kuptuar? Dera paska qenë e mbyllur kur kanë trokitur, ndërsa pas tri minutash, kur erdhën bashkë me rojen, e gjetën derën të hapur...

- Këtu dhe është e tërë puna: vrasësi ka qenë brenda i mbyllur me reze; do ta kishin kapur, po të mos e kishte bërë atë që bëri Kohu, që s'duroi, po vajti për të marrë rojen. Pikërisht në këtë interval *ai* arriti të zbres shkallët dhe të largohet pa u parë prej tyre. Kohu për këtë bën be e rrufe: "Po të kisha qëndruar, thotë, do më kishte bërë fërtele me sëpatë..." Ka taksur dhe një meshë që e shpëtoi Zoti!

- Dhe vrasësin askush nuk e pa?

- Askush! Shtëpia iu bë Varka e Noes! - vuri në dukje nëpunësi që ishte duke dëgjuar që nga vendi ku rrinte.

- Po, po! E qartë! - tha tërë pasion Nikodhim Fomiçi.

- Përkundrazi, kjo punë nuk është aspak e qartë! - e kundërshtoi Ilia Petroviçi.

Raskolnikovi mori kapelen dhe donte të dilte, por nuk arriti deri te dera...

Kur erdhi në vete, e pa veten të ulur në karrige, nga krahu i djathtë e mbante një njeri, nga e majta i qëndronte një tjetër me një gotë të mbushur me një lëng të verdhë... Nikodhim Fomiçi qëndronte në këmbë para tij dhe e shihte ngultas.

- Ç'patët ashtu? Qënkeni i sëmurë? - e pyeti rreptë.

- Edhe kur po nënshkruante deklaratën i dridhej shumë dora, i shkonte pena sa andej këtej, - vuri në dukje nëpunësi, duke u ulur përsëri në vendin e vet dhe duke u marrë me shkresurinat.

- Keni kohë që jeni kështu? - i bërtiti Ilia Petroviçi që nga vendi i tij, ku gjithashtu po merrej me shkresurinat. I qe afruar, kur i ra të fikët, por u largua shpejt, kur vuri re që po vinte në vete.

- Nja dy ditë... - belbëzoi Raskolnikovi.

- Dje dolët përjashta?

- Dola.

- I sëmurë?

- I sëmurë.

- Në ç'orë?

- Rreth orës tetë të mbrëmjes.

- E ku shkuat, me lejoni t'u pyes?

- Në rrugë dola.

- Shkurt dhe qartë!

- Raskolnikovi i përgjigjej i prerë, i verdhë dyllë, pa e larguar shikimin e syve të zinj, të skuqur nga shikimi i ngulur i Ilia Petroviçit.

- Mezi po mbahet, kurse ti... - i hoqi vrejtjen Nikodhim Fomiçi.

- S'ka gjë! - shqiptoi me një theks të veçantë Ilia Petroviçi. Nikodhim Fomiçi donte të shtonte edhe diçka, por, pasi pa nga nëpunësi, që gjithashtu po e shihte i përqendruar, heshti. Heshtën që të gjithë. Çudi e madhe!

- E po, mirë, - e mbylli bisedën Ilia Petroviçi. - Nuk po ju mbajmë në arrest!...

Raskolnikovi doli. Nuk kishte si të dëgjonte ç'u tha pas largimit të tij, në zërat që i erdhën deri te veshët, shquhej ai i Nikodhim Fomiçit... Vetëm kur doli në rrugë, mundi ta përmbledhë veten.

"Do bëjnë kontroll dhe menjëherë! - përsëriste me vete, duke e nxituar hapin për të arritur sa më shpejtë në dhomë. - Të poshtrit, më dyshuan!".

Tmerri dhe lemeria e djeshme e pushtuan përsëri...

II

"Po sikur të kenë bërë kontroll? Po sikur t'i gjej atje?". Hyri në dhomë. Asgjë, asnjeri nuk kishte qenë. As Nastia nuk kishte hyrë. Po, o Zot i madh! Si i kam lënë deri më tani ato sende?"

U derdh për te cepi, futi dorën prapa letrës së murit dhe zuri të nxjerrë sendet e fshehura; i ngjeshi në xhepa. Ishin tetë copë: dy kuti të vogla, me vathë apo me diçka tjetër, nuk arriti t'i shohë mirë, katër këllefë marokini, një varëse e mbështjellë me letër gazete; ishte dhe një send tjetër po i mbështjellë me letër, një medalion...

I futi në xhepe të ndryshëm, që të binin sa më pak në sy. Mori dhe qesenë. Doli nga dhoma, derën e la të hapur.

Ecte me hap të shpejtë, të sigurt, ndonëse e ndiente që ishte i këputur, sidoqoftë, veten e kishte ndër duar. Vuante nga mania e përndjekies, i dukej sikur i qenë vënë pas, po e mbikqyrnin, ngutej t'i

zhdukte sa më parë gjurmët. Duheshin mbledhur të gjitha forcat, tërë imagjinata e mbetur... Po ku të vinte?

E kishte vendosur: "Do t'i hedh në ndonjë nga kanalet e Nevës, pas kësaj çdo gjë do të jetë në rregull". Kështu kishte menduar mbrëmë në kllapi, madje disa herë kishte dashur dhe të ngrihej. Por nuk ishte aq e lehtë.

Ecte buzë kanalit "Ekaterina", disa herë kishte dashur të zbriste shkallët poshtë, por as që mund të mendonte për hedhjen: trapet ishin plot e përplot me gra që lanin rrobet, kishte barka, kaike dhe, kryesorja, njerëz. Çdo gjë dukej si në pëllëmbë të dorës, do binte në sy kur të hidhte diçka në ujë. "Se ato as për t'u zhytur nuk kanë, do duken ç'janë!" - tha me vete. I dukej sikur që të gjithë tek ai i kishin sytë.

Mendoi se do të kishte qenë më mirë të shkonte në Nevë. Do kishte më pak njerëz, do binte më pak në sy, kryesorja, ishte më larg vendit të ngjarjes. Po shtangu sakaq: si nuk e pati kuptuar më parë që mendimi për t'i hedhur në ujë i pati lindur kur kishte qenë në kllapi! Humbi një gjysmë ore kot se koti! Hutimi dhe çoroditja e vunë për fund. Duhej nxituar!...

Duke ecur, zuri të pyes veten: "E pse në Nevë? Përse në ujë? A nuk do të ishte më mirë të shkoja diku, në ndonjë vend pa njerëz, diku në pyll dhe t'i groposja nën ndonjë gëmushë, ta fiksoja dhe vendin?". Edhe pse ishte fare i trullosur, ky mendim iu duk më i përshtatshëm.

Por as këtë nuk e bëri dot. Kur po largohej nga bregu V., sytë i vajtën te një oborr i madh, në njërën anë të të cilit ishte një mur i madh, i gjatë, i palyer i një shtëpie katërkatëshe. Nga e majta, paralel me murin, ishte një gardh dërrasash, nja njëzet hapa larg oborrit. Pak më tutje dukej një si hangar me mure të tymosur, pjesë e ndonjë punishteje hekurash. Ishte një vend i fshehur mirë, plot me rrangullina. "T'i hedh këtu dhe të iki!" - mendoi.

Pa përreth dhe po bëhej gati të nxirrte sendet, kur i vajti syri te një gur i madh, i mbështetur pas murit, jo larg hyrjes së oborrit. Në anën tjetër ishte rruga, kalonte trotuari, dëgjohej zhurmë hapash, por atë nuk e shihte njeri, vetëm po të kthente ndonje enkas, e kjo ishte diçka fare e mundshme. Duhej nxituar...

E kapi gurin, përmblodhi të gjitha forcat dhe e rrokullisi. U formua

një si thëlluge: i hodhi të gjitha ç'kishte në xhep, hodhi në fund qesenë vend kishte ende. E kapi përsëri gurin, e rrokullisi aty ku kishte qenë Zuri vend, ndonëse dukej pak më i lartë. Mblodhi pak dhé, e ngjesh me këmbë përreth gurit.

Doli dhe u drejtua për nga sheshi. Përsëri e pushtoi po ai gëzim frenetik, shungullues, i padurueshëm, si atje në zyrën e policisë. "Më në fund! E bëra! E kujt i vete mendja te ky gur? Kushedi qëkur është aty dhe kushedi sa do të jetë akoma! Po edhe në i gjetshin, kujt mund t'i vejë mendja tek unë? Çdo gjë në rregull! Asnjë gjurmë nuk ka tani!" - qeshi i kënaqur. Më vonë i kujtohej mirë ai të qeshur nevrasteniku, me ca kukurisma të dendura, qeshi tërë kohën që çante mespërmes sheshin. Kur arriti në bulevardin K., te vendi ku kishte parë vajzën e dehur, sikur ia hoqi kush me dorë të qeshurin. Kokën ia dyndën ca mendime tjetërsoj. Iu duk e padurueshme të kalonte pranë stolit, ku kishte ndenjur pasi ishte larguar vajza, i zhytur në ato mendime. Tha me vete se do ishte shumë e rëndë për të, po t'i dilte përpara polici mustaqeli, të cilit i pat dhënë njëzet kopejka për pajtonin. "Në dreq të venë!" - mërmëriti.

Ecte duke parë përreth i shpërqendruar, i inatosur. I rrinte mendja në një pikë: "Të shkuara, të harruara! - mërmëriti i mbushur me maraz. - Duhet filluar një jetë e re! Kam bërë budallallëqe me thes!... Sa shumë poshtërsi e mashtrim!... Po biseda me Ilia Petroviçin? Vafshi që të gjitha në esfel!... Nuk është kjo kryesore!".

Ndali. Një pyetje e re, e gozhdoi në vend. E çoroditi dhe e mahniti.

"Në e bëra tërë këtë me vetëdije, me një pikësynim, jo thjesht nga budallallëku, si nuk pashë makar ç'kishte në atë qese, ç'më kishte rënë për hise pas gjithë asaj torture që hoqa, pas atij veprimi mizor, të pështirë, qe ndërmora i vetëdijshëm? Po kjo ç'qe kështu?"

Edhe më parë ia kishte bërë një pyetje të tillë vetes. Atë natë që mori vendimin për zhdukjen e sendeve, nuk kishte patur asnjë lëkundje, asnjë mëdyshje, i që dukur se vetëm kështu duhej vepruar, në asnjë mënyrë jo, ndryshe...

"E kam ngaqë jam i sëmurë, - e përligji veten. - E kam telikosur dhe leqendisur aq shumë veten, sa s'di ç'bëj... Kam kohë që vetëm torturoj sa mundem e si mundem veten. Kur të shërohem, do qetësohem... Po sikur të mos shërohem dot më?... O Zot! Sa më janë

pështirosur që të gjitha..." Eci pa kthyer kokën mbrapa. Donte të largonte mendjen, por nuk dinte si. Tërë qënia i qe mbushur me neveri e pështirosje. I vinte t'u pështynte njerëzve në fytyrë, do ta kishte kafshuar të parin që do t'i hapte muhabet...

Ndali kur ishte në bregun e Nevës së Vogël, në ishullin "Vasilevsk", pranë një ure. "Ja, këtu e ka shtëpinë, - tha. - Domethënë këmbët vetë më sollën te Razumihini! Do përsëritet historia e atëhershme... S'po e marr vesh, në erdha vetë, apo më solli rruga? E ç'rëndësi ka kjo? E pata thënë që do vija pas *asaj*, ditën tjetër! Do vete, s'kam përse të mos vete..".

U ngjit në katin e pestë.

E gjeti aty, ia hapi derën; ishte duke shkruar. E po, s'i thoshin shaka, aq muaj pa akuar. Razumihini kishte veshur një rrobëdhome të vjetër, pantoflat i kishte ngjeshur në këmbët zbathur, doli i parruar dhe i pakrehur. Kur e pa, fytyra i shprehu habi.

- Ç'ke kështu? - thirri dhe e mati me shikim deri te këmbët. Nga habia s'e mbajti dot fërshëllimën. - Qënke katandisur mosmëkeq! Ulu, dukesh aq i lodhur...

Kur Raskolnikovi u lëshua fare i pafuqishëm në divanin e veshur me ingilit, edhe më të keq se i kanapesë së tij, Razumihini u bind që shoku i tij ishte shumë sëmurë.

- Nuk qenke mirë! - i tha dhe zgjati dorën t'i maste pulsin. Raskolnikovi e tërhoqi vrulltas dorën.

- Lërmë! - i tha. - Kam ardhur të më ndihmosh... Nuk kam asnjë orë mësimi... do desha... Po, nejse, i lëmë mënjanë mësimet..

- Po ti ç'ke kështu? Sesi dukesh, sikur nuk je fare në vete, sikur flet përçart, - i tha i merakosur dhe ia nguli përsëri shikimin.

- Jo, nuk jam duke folur përçart... - Raskolnikovi u ngrit. Kur ishte drejtuar për këtu, nuk e kishte menduar fare si do fliste me shokun, ç'do t'i thoshte, kur të ndodheshin sy ndër sy. Tani e kuptoi që nuk ishte aspak gati për ta bërë një gjë të tillë. Zemrën e kishte të mbushur me vrer. Sapo kishte kaluar pragun e derës së shokut, ngashërimi dhe tërbimi e kishin zënë prej gryke dhe po e mbysnin.

- Lamtumirë! - i tha dhe iu drejtua derës.

- Po ç'pate kështu? Prit!

- Jo, do iki!... - i tha dhe e shkëputi dorën nga ajo e shokut.

- Po pse erdhe, atëherë? Ke një nevojë që erdhe? S'po bën mirë që po largohesh kështu... S'të lë të ikësh, jo...

- E di, erdha te ti, sepse nuk kam tjetër të njohur, ndonjë që të më ndihmonte... të filloja... sepse ti je më zemërmiri, më i mënçuri, njeri që di t'i qash hallin tjetrit... Por tani e kuptova që nuk më lipset gjë... Nuk më duhet asnjë ndihmë... Do bëj si do bëj vetëm... Ja kjo është!... Lërmë në punën time!

- Po dale, dale njëherë! Mos paske lojtur, mos paske lajthitur? Dëgjo: orë nuk ka dhe s'kanë ç'na duhen, por në rrugën "Tollkuç" është një librar, Heruvimov quhet, vlen sa për pesë orë mësimi te tregtarët. Shet ca libra, që s'bien në tokë, i rrëmbejnë... Vetëm titujt të lënë pa mendje! Më ke thënë se jam i trashë, dije, pra, se ka edhe më të trashë se unë! Vëtë ai s'merr vesh nga librat, i rashë hiles! Kam këtu ca shkrime gjermanisht, gjepura kanë brenda, është apo nuk është njeri gruaja... Ky Heruvimovi do të shkruajë për problemin e gruas, unë i ndih me përkthime: shto ujë e shto mjell, sajohet një kaçamak, që të zësh kokën me duar... Një titull i fryrë, miklues dhe drejt e në pazar. Për përkthimin më paguan gjashtë rubla; të jep dhe parapagim! Qejf, or qejf! Nga gratë do hidhemi te balenat, pas kësaj do t'i vihemi gatimit të thashethemeve... Dikush i paska thënë Heruvimovit se Rusoi na qenka si puna e Radishevit, unë po i tunda kokën, i mbajta ison, ndryshe s'e heq dot qafe! Do dhe ti të merresh me këtë punë? Përkthe vazhdimin e shkrimit "A është njeri gruaja", të japë edhe letër e ç'të duash, se të porositësit janë, pagesa tre rubla faqja. Pas botimit do kesh pagesë tjetër. Mos e quaj se po të bëj favor, përkundrazi, bashkëpunimi edhe për mua me leverdi është. Se ti e di, s'para marr vesh nga drejtshkrimi, por edhe asaj të shkrete gjermanishteje s'para ia them: më shumë sajoj vetë sesa përkthej, por asnjë gjynah nuk bëj, del më mirë... Kështu them unë, por ku i dihet, ndoshta del më keq!... Do të bashkëpunojmë.

Raskolnikovi mori ca fletë të tekstit gjermanisht, mori parapagim tre rubla, dhe, pa thënë asnjë fjalë, doli. Razumihini i shkoi pas tejet i habitur, nga kjo sjellje e shokut. Pasi doli në rrugë, Raskolnikovi befas ndërroi mendje, u ngjit përsëri te shoku, ia la mbi tryezë fletët dhe rublat dhe, pa thënë as dhe një fjalë, doli.

- Mos qënke damllosur gjë, mor vëllaçko? - i bërtiti si i tërbuar nga

pas Razumihini. - Ç'janë këto numra që bën? S'po marr vesh gjë prej gjëje! Ç'dreqin pate që u ktheve?

- S'më duhen përkthimet... - mërmëriti Raskolnikovi, duke zbritur përsëri shkallët.

- Po ç'dashke atëherë? - s'iu durua pa i thirrur Razumihini. Ky vazhdoi të zbriste shkallët pa iu përgjigjur. - Më thuaj adresën të paktën!

Asnjë përgjigje.

- Thefsh qafën atëherë!...

Po kalonte nëpër urën "Nikollajevsk". Këtu i ndodhi diçka aq e pakëndshme, sa e bëri ta humbiste toruan fare. E goditi thekshëm një karrocier me kamxhik, ngaqë për pak sa nuk u gjend nën rrotat e karrocës. Karrocieri e kishte thirrur disa herë, ky vazhdonte të tijën. Goditja që mori e zëmëroi aq shumë, saqë, pasi kërceu te parmakët (as vetë nuk e dinte përse kishte ecur mu në mes të urës), kërciti dhëmbët dhe shtrëgoi grushtat. Kalimtarët ia shkrepën gazit.

- Sipas kokës, festen!

- Duket ai, ndonjë humbameno është!...

- Ka pirë dhe s'di ku është, drejt e nën rrotat mund të gjendej. Përgjigju pastaj për të, të kam rixha!

- Ashtu është, zotëri, ashtu...

Kur po mbahej pas parmakëve, dhe po fërkonte shpinën, duke parë me inat pajtonin që po largohej, ndjeu që dikush i futi diçka në dorë. Ishte një grua tregtari e moshuar, me skufje dhe me këpucë të lehta meshini, bashkë me të bijën, me kapele dhe me një ombrellë jeshile, ajo që i kishte futur në dorë para. "Merri, Zoti qoftë me ty!" I mori, ato u larguan. E pa, ishte një monedhë dyrubëlshe. Robat dhe pamja që kishte e tregonin për lypsar, për të tillë e kishin marrë. U qe dhimsur që e patën qëlluar me kamxhik.

E shtrëngoi monedhën në dorë, bëri nja dhjete hapa dhe u kthye me fytyrë nga Neva, andej nga ishte Pallati i Dimrit. Qielli ishte pa asnjë re, uji i lumit fare i kaltër, rrallë të rastis ta shohësh të këtillë këtu në Petërburg. Kupola e katedrales, që më mirë se nga ky vend nuk duket në asnjë pikë tjetër, llamburiste e vetëtinte, përmes ajrit të tejdukshëm shquheshin deri zbukurimet e veçanta. Dhimbja e kamxhikut po i kalonte, e kishte harruar tanimë. Tha me vete: e njihte

mirë këtë vend, kur shkonte e vinte në universitet, i pëlqente të ndalte në këtë urë e të sodiste panoramën e mrekullueshme, por që kurdoherë e pat habitur një përfytyrim jo fort i qartë për të, i cili deri sot e kësaj dite i kishte mbetur ende i pa shkoqitur. Sa herë që e shihte dhe e adhuronte atë panoramë mahnitëse, trupin ia përshkonte një drithërimë e pashpjegueshme... Kishte një shpirt shurdhmemec tërë kjo tablo madhështore.. Kurdoherë e pat habitur kjo përshtypje misterioze dhe e zymtë që i bënte, gjithmonë largohej që aty pa i dhënë shpjegim kësaj mbrese, por edhe pa besuar se do ta bënte ndonjëherë. Iu kujtuan këto përshtypje dhe pyetje të së kaluarës jo rastësisht. Edhe vetë ndalesa në këtë vend iu duk sa e çuditshme, aq dhe kuptimplote: mos duhej, vallë, të meditonte edhe tani për po ato çështje që e shqetësonin atëherë... para aq pak kohe. I erdhi për të qeshur, por edhe më fort ia shtrënguan kraharorin ca spazma pezmatimi. Diku në thellësi të shpirtit, atje thellë që sa mezi dukej, iu fanit e kaluara me vorbullën e mendimeve dhe me atë mal preokupimesh, me mbresat dhe hamendjet e atëhershme, me pamjen e kësaj panorame dhe veten e tij në mes: që të gjitha... Tani po i dukej se qëndronte pezull në ajër dhe gjithçka kishte humbur pamje.. Bëri një lëvizje të pavetëdijshme me dorë, ndjeu të shtrënguar në dorën tjetër monedhën dyrubëlshe, e vërviti në ujë dhe mori rrugën për në shtëpi. Iu duk sikur e preu veten me gërshërë nga gjithçka e kësaj bote.

Kur erdhi në dhomë, ishte errësuar, kishte ecur jo më pak se gjashtë orë. As që i kujtohej çfarë rruge kishte bërë e nëpër ç'vend kishte kaluar. Dridhej si ndër ethe, u zhvesh pa e zgjatur dhe u shtri në kanape. U mbulua me pallton e vjetër të studentit dhe humbi...

E zgjoi një britmë rrëqethëse, kur ishte fare natë. Po kjo ç'të jetë? Tinguj të tillë të panatyrshëm, ofshama dhe rënkime që të këputnin shpirtin, ulërima dhe dënesa, rrahje barbare dhe sharje aq të lemerishme s'i kishin zënë veshët kurrë ndonjëherë. As që mund ta përfytyronte dot një tmerr si ky! Si i fandaksur u çua dhe u ul në kanape. Zemra po i dridhej, gjaku i kishte ngrirë në deje. Poterja dhe ulërima sa vinin e shtoheshin. Shqeu sytë nga habia dhe i ndaloi frymëmarrja kur njohu zërin e qiramarrëses. Ishte ajo që kishte vënë kujën dhe pallte për lemeri! Fjalët nuk u kuptoheshin, por dukej që i lutej e i falej atij që e rrihte ashtu pa mëshirë. Zëri i atij që e rrihte

ndërkaq u bë aq e vrazhdë dhe kërcënues, saqë vetëm piskante dhe gjëmonte, por edhe diç thoshte, veç aq ngutshëm, aq me kërcënim e duke iu marrë fryma, saqë Raskolnikovit i shkuan mornica. Zëri që po dëgjonte ishte i Ilia Petroviçit. Ishte ky njeriu që po e kërdiste në dru qiramarrësen! E godiste me shkelma, i binte në kokë, turinjve, e përplaste nëpër shkallë në mënyrën më mizore! Tingujt që i vinin deri te veshët e vërtetonin më se miri një gjë të tillë. Po cila të ishte arsyeja? Ç'të ishte vallë, kjo katrahurë? Dëgjonte përplasje dyerësh, të bërtitura njerëzish, hyrje e dalje nga apartamentet e kateve të ndryshme, zëra. "Po pse? Ç'është kjo kështu? Pse rrihet tjetri kështu?" - përsëriste Raskolnikovi i bindur që kishte lojtur nga mendtë. Por jo, ato që po dëgjonte nuk ishin vegime, as aluçinacione, ishin realitet... Domethënë se s'do vononin të vinin edhe tek ai. "Me siguri... për.. atë punën e djeshme... për atë kanë ardhur... O Zot!". Donte ta mbyllte derën me reze, por s'po i bënin duart... ishte fare e kotë çdo përpjekje... Tmerri i kishte hyrë në palcë, nuk po gjente vend ku të futej! Befas tërë kjo katrahurë, që zgjati nja dhjetë minuta, zu të fashitej. Qiramarrësja rënkonte dhe ofshante me zë të ngjirur. Ilia Petroviçi vazhdonte ta kërcënonte dhe ta shante, por jo si më parë. Pas pak as ai nuk po dëgjohej më; ra qetësi. "O Zot! Mos u largua? Iku, më duket". Edhe zëri i qiramarrëses sa vinte e shuhej, s'dëgjoheshin më as të qara e as rënkime... Ja, u përplas dera e saj. Dëgjoheshin vetëm disa zëra që për diç diskutonin, ndonjë edhe bërtiste, zëra që thërrisnin shoshoqin, pëshpërima, hapa që largoheshin. Me sa dukej, nuk kishin qenë pak ata që ishin mbledhur te shkallët! "O Zot! Po si ka mundësi të ndodhë ky tmerr? Ç'të ketë qenë vallë?" - tha përsëri me vete Raskolnikovi.

U rrëzua si i kositur në kanape, por ndënji syhapur: as vetë nuk po arrinte ta kuptonte ç'kishte qenë tërë kjo. Kaloi nja një gjysmë ore, por ende s'po e mblidhte dot veten; kurrë ndonjëherë nuk kishte provuar një tronditje aq të madhe.

Atë çast dhoma u ndriçua nga një dritë: hyri Nastasia me një qiri në dorë dhe me një tas supë në dorën tjetër. E pa që s'po flinte, e vuri qirinë mbi tryezë dhe vuri aty edhe darkën.

- Nuk mbahet mend që kur nuk ke ngjeruar gjë prej gjëje! - i tha. - Se ku humbe tërë ditën e përëndisë! Dhe je i sëmurë, pale!

- Nastasia, pse e rrahën qiramarrësen?

Kjo e pa ngultas.

- Kush e rrahu?

- Po ja, para një gjysmë ore, Ilia Petroviçi, zëvëndës shefi i policisë, në shkallë... Dhe ç'të rrahuri... Ç'pati me të?

Nastasia e pa e habitur, e vrenjtur, e pa gjatë. Raskolnikovit nuk i pëlqeu fare ky shikim. Po i kallte datën!...

- Nastasia, po pse nuk përgjigje? - e pyeti duke u dridhur, me zë të shuar.

- E ke nga gjaku! - iu përgjigj kjo me zë të ulët, si të fliste vetë me veten.

- Gjaku?!... Ç'gjak?.. - mërmëriti i verdhë dyllë duke u zbythur për nga muri. Nastasia e shihte e heshtur.

- Nuk e ka rrahur njeri qiramarrësen, - i tha me zë të ulët por të vendosur. E shihte dhe s'i besonte syve, aq keq qe katandisur ai djalë.

- E dëgjova me vështë e mi... nuk po flija... isha ngritur, - e kundërshtoi i druajtur. - Rrija këtu ulur dhe i dëgjova të gjitha... Ishte zëvendës shefi i policisë ai që i rrihte barbarisht. Qe mbledhur gjindje e madhe në shkallë...

- Nuk ka qenë kush te ne. Të thashë është gjaku ai që të mundon... Kur nuk ka nga të dalë, hipën në kokë dhe të ngacmon trurin, nga kjo dhe zënë e shfaqen gjithfarë vegimesh... Do hash apo si?..

- Më jep pak ujë... Nastenjka.

Kjo vajti poshtë dhe u kthye pas dy minutash me një gotë porcelani të bardhë. Ç'i ndodhi më tej, nuk mbante mend. I kujtohej vetëm që kishte gjerbur pak ujë të ftohtë, që e kishte derdhur edhe në gjoks duke pirë... pastaj asgjë nuk mbante mend, ç'i kishte ndodhur.

III

Tërë këtë kohë Raskolnikovi herë binte në kllapi, herë fliste përçart dhe herë vinte në vete. Me pas do i kujtoheshin shumë nga ç'i kishte ndodhur. I dukej se ishte i rrethuar nga gjindja, se donin ta çonin diku, se grindeshin e përfliteshin për punën e tij, pastaj i bëhej se ishte vetëm në dhomë, e kishin braktisur të gjithë, siç braktisen

lebrozët, vetëm në të rrallë hapnin pak derën për ta parë, për ta kërcënuar, diç çuçurisnin me shoshoqin, e qeshnin, e ndërsenin. I kujtohej që Nastasia nuk i qe larguar që aty, kishte qenë edhe një tjetër, një i njohur, por cili, nuk mund ta thoshte dhe pikëllohej e pezmatohej shumë nga kjo, madje edhe qante. Ndonjëherë i dukej që kishte nja një muaj që rrinte shtrirë, herë tjetër i dukej që s'kishte veç një ditë. Ndërsa për *atë*, për atë kishte harruar fare; ndonëse e mundonte ligsht vetëdija që diçka ishte duke harruar. *Atë* ai nuk duhet ta harronte! Përpëlitej, fliste përçart, rënkonte, nevrikosej, s'i ndahej dëshpërimi. Hovte i çakërryer, donte t'ia mbathte, por dikush s'e linte ta bënte këtë dhe ai pajtohej, i pafuqishëm ashtu në kllapi siç ishte. Më në fund, erdhi në vete... Ishte ora dhjetë e mëngjesit. Dielli kishte hyrë në dhomë, në anën e djathë të saj. Te shtrati i rrinte Nastasia dhe dikush tjetër që po e shihte me kureshtje. Këtë nuk e njihte. Ishte i ri në moshë, kishte pak mjekër, me sa dukej, ishte ndonjë shegert. Në derën e hapur pak dukej qiramarrësja. Raskolnikovi u çua në bërryla.

- Ky kush është, Nastasia? - e pyeti, duke i treguar në drejtim të djalit.

- Hë, u përmende, më në fund! - i tha kjo.

- U përmende? - e pyeti edhe shegerti. Ndërkaq qiramarrësja mbylli derën dhe u zhduk. Ishte grua e druajtur, e mërdhihur, nuk i duronte grindjet dhe fjalët: ishte rreth të dyzetave, topolake dhe e ngjallur, syzezë e vetullzezë, babaxhane dhe e plogët.

- Ju... kush jeni? - e përsëriti pyetjen, duke iu drejtuar shegertit.

Atë çast u hap vrulltas dera dhe, pasi u përkul, sepse ishte i gjatë, hyri Razumihini.

- Jo dhomë, por kabinë vapori qënka! - thirri me të hyrë. - S'kam për t'u ndarë pa ndonjë xhungë në kokë... Dhomë i thënçin! U përmende, më në fund? Shyqyr Zotit!

- Sapo i hapi sytë! - e përforcoi Nastasia.

- Sapo u përmend! - përsëriti edhe shegerti me buzën në gaz.

- Po ju, më lejoni t'u pyes kush jeni? - iu drejtua Razumihini. - Mua më quajnë Razumihin, jam student, bir oborrtari, ky këtu është miku im. Po ju kush jeni?

- Jam shegert te tregtari Shellopajev, erdha për një punë.

- Urdhëroni, uluni këtu. - Vetë Razumihini u ul në anën tjetër të

tryezës. - Bëre mirë që u përmende, vëllaçko! - i tha Raskolnikovit. - Ke katër ditë e katër netë që s'po vë gjë në gojë. Vetëm me çaj e ke mbajtur shpirtin. Dy herë të kam sjellë Zosimovin. Të kujtohet? Të vizitoi dhe tha: asgjë me rëndësi. Vetëm se je i trullosur. Diçka nervore, dhëmbje koke, pangrënia po bën të sajën dhe, domosdo, që do të sëmuresh... Por do kalojë, Zosimovi mirë thotë. Kam filluar të marrë vesh nga mjekësia. Por, mos po ju vonoj? - iu drejtua shegertit. - Shpjegohuni, ju lutem, ç'u ka sjellë? Mos harro, Rodja, është hera e dytë që vijnë nga tregtari Shellopajev: herën që shkoi ishte një tjetër, me të u morëm vesh si s'ka më mirë. Si e ka emrin ai që erdhi para jush?

- Them se mund të ketë qenë Aleksei Semionoviçi, në një vend punojmë.

- M'u duk më hesber se ju, kështu është apo jo? Ju si thoni?

- Ashtu është, mbahet ca më mirë...

- Ju lumtë! Po vazhdoni, vazhdoni!

- Po ja, përmes Athanas Ivanoviç Vahrushinit, të cilin ju sigurisht që e njihni, me kërkesën e nënës suaj në zyrën tonë kanë ardhur ca të holla, - tha shegerti, duke iu drejtuar Raskolnikovit. - Po të ndiheni mirë, mund t'i merrni, tridhjetë e pesë rubla janë. Është porosi e Athanas Ivanoviçit që t'ua bëj të ditur...

- Po, më kujtohet... Vahrushini, - nëpërdhëmbi Raskolnikovi mendueshëm.

- E sheh, e njeh tregtarin Vahrushin! - thirri Razumihini. - Si nuk qënka në rregull? Por po vë re që dhe ju qënkeni djalë për kokën e djalit... Të bëhet zemra mal, kur dëgjon të flitet me mendje.

- Dora vetë, Vahrushini, Athanas Ivanoviçi. Edhe herë tjetër, nëpërmjet tij nëna juaj ju ka dërguar të holla. Morëm lajm se edhe këtë herë po prej saj ju vijnë tridhjetë e pesë rubla. Do zoti që më pas, më shumë do keni.

- Ja, këtë "më pas më shumë do keni" e the mirë. Edhe për nënën mirë fole. Hë, si thoni, u bindët tani që është fare në rregull?

- Them se po. Veç më duhet firma.

- Do ta vëre! Ke ndonjë regjistër me vete?

- Po, ja!

- Ma jep këtu! Rodja, çohu! Të mbaj unë, hidhe firmën, se paratë na hyjnë në punë, si me porosi kanë ardhur.

- Nuk do firmos, - tha Raskolnikovi, duke mënjanuar penën.
- Si nuk do firmoske?
- Nuk do firmos.
- Po ky nuk t'i jep pa firmosur?
- Nuk më duhen... paratë.
- Si? Nuk t'u dashkan paratë? Po na gënjen tani! E di që të duhen dhe shumë! Mos u mërzitni, ju lutem, e tha ashtu, kot... E tha pa u menduar... I ndodhin këtij ca numra të tillë... Qënkeni djalë përsëmbari, do ta merrni pak më shtruar këtë punë. Do t'ia marrim dorën dhe do ta bëjmë të nënshkruaj. Pa ngrije pak...
- Po të dëshironi, vij një ditë tjetër.
- Jo pse, nuk keni përse vini ditë tjetër. Ju dhe vetë e kuptoni... Rodia, mos e vono mikun... e sheh që ty të pret, - i tha dhe në këtë e sipër provoi t'ia merrte dorën Raskolnikovit.
- E bëj vetë... - e shtyu ky, mori penën dhe hodhi firmën në regjistrin e shegertit. Ky i dha paratë dhe u largua.
- Kështu, de! Tani merr e ha pak.
- Mirë, - i tha Raskolnikovi.
- Keni pak supë?
- Është e djeshme, - iu përgjegj Nastasia, që tërë atë kohë nuk ishte larguar as dhe një grimë.
- Me patate dhe oriz?
- Po.
- I rash në të. Sille këtu, pastaj dhe pak çaj.
- Erdha.

Raskolnikovi e ndiqte tërë sy e vesh këtë bisedë, brenga dhe marazi ia ndrysnin shpirtin. Kishte vendosur të priste në heshtje: ç'do të bëhej, vallë, me të? "Tani sikur nuk jam në jerm, - tha me vete. - Më duket se është realitet...".

Nastasia u kthye pas dy minutash me tasin e supës në duar, tha se do t'i binte çajin. Solli dhe takëmet e nevojshme: dy pjata, dy lugë, kriporen, piperonen; më parë këtë nuk e kishte bërë. Edhe sofrabrezin e solli të ri.

- S'do ishte keq të porositnim edhe nja dy shishe birrë! - tha Razumihini.
- S'ta prish unë ty, po shkoj me vrap! - mërmëriti Nastasia dhe u

nis ta çonte në vend porosinë.

Raskolnikovi i shihte si dhe me parë i ndërkryer, i dalldisur. Razumihini u ul pranë tij në kanape, dorën e majtë ia shkoi në qafë, ia ngriti pakëz kokën, ndonëse Raskolnikovi këtë fare mirë mund ta bënte edhe vetë, kurse me dorën e djathtë zuri ta konte me supë, pasi i kishte fryrë mirë e mirë lugës, mos ishte gjë e nxehtë. Supa ishte e vakët. Raskolnikovi e gëlltiste i uritur. Pas disa lugëve, e ndali kuarjen dhe i tha se për t'u kuruar duhej dëgjuar Zosimovi.

Hyri Nastasia me dy shishe ndër duar.

- Do çaj?

- Dua!

- Sille këtu edhe çajin, Nastjenka, se çaj i japim dhe pa izmën e mendtarëve të mjekësisë. Edhe birra vetëm mirë të bën. - U ul në karrige dhe zuri të hante dhe vetë me aq oreks, si të kishte patur tri ditë pa vënë gjë në gojë. - Më pëlqejnë drekat këtu te ti, Rodia, - belbëzonte me gojën plot. - Ti, Nastasia, si amvisë nuk e ke shoqen, pale pastaj që s'ta prish qejfin për asgjë. Ja dhe çaji! E shkathët, e zonja... Nastjenka do një çikë birrë?

- S'i le çapkënllëqet ti!

- Po çaj do?

- Çaj nuk them jo.

- Mbushe gotën! Po prit, ta mbush unë! Ulu këtu, në tryezë!

Razumihini i mbushi gotat me çaj, pastaj për vete mbushi edhe një të dytë dhe u ul përsëri pranë shokut në kanape. Ia ngriti përsëri kokën me dorën e majtë, dhe zuri t'i japë çaj me lugë, duke i fryrë tërë kujdes para se t'ia afronte te goja, si të kishte qenë i përqendruar tërë sekreti i shërimit në këtë fryrje të çajit. Raskolnikovi heshtte dhe bënte ç'i thoshin, ndonëse kishte forca që të ngrihej e të rrinte ulur në shtrat, ta përdorte vetë lugën, madje dhe të ecte. Një si dinakëri e çuditëshme e shtynte që tani për tani të mos i tregonte këto forca, madje, po të lypsej, të shtirej sikur nuk kuptonte gjë prej gjëje, pastaj, pasi t'i kishte peshuar mirë e mirë ngjarjet, të përcaktonte edhe mënyrën e sjelljes. Veç neverija vazhdonte ta mbante të ngërthyer në kthetrat e veta. Pasi gëlltiti nja dhjetë lugë çaj, e çliroi kokën nga krahu i shokut, tundi kryet në shenjë kundërshtimi, largoi lugën dhe e lëshoi kokën në jastëk. Nastasia i kishte sjellë jastëk të butë me

këllëf të pastër, edhe këtë e vuri re dhe e pati në konsideratë.

- Të kishim dhe pak reçel qershije, s'ishte keq, - tha Razumihini, duke u ulur përsëri në karrige dhe duke vazhduar të hante e të pinte.

- Po ku ta gjejmë pa? - pyeti Nastasia që ishte duke pirë çaj. I pëlqente ta kafshonte sheqerin kokël dhe pastaj të pinte çajin.

- Kush kërkon gjen. E di, Rodia, kur ike ashtu rrëmujshëm nga unë, më erdhi inat, sa vendosa të gjeja me çdo kusht dhe të ndëshkoja. Kam pyetur për adresën tënde, sa më ranë këmbët! E kisha harruar këtë dhomën e tanishme, po edhe e kisha harruar nuk e thua dot, nuk e kam pas ditur ndonjëherë. Atë tjetrën, po, e kam ditur. Më vinte plasje: nisem në zyrën e adresave, e di, për dy minuta e gjetën. E kishin adresën tënde.

- E paskan?

- Po. Kurse adresën e Kobelovit ç'nuk bënë ta gjenin, por nuk mundën! Erdha me një frymë, u njoha me të tutë, mësova si i ke punët, tani, or vëlla, di gjithçka për ty. Ja, Nastia më pa me sytë e saj, u njoha me Nikodhim Fomiçin, me Ilia Petroviçin, me rojet, me zotin Zametov, nëpunësin e policisë, po edhe me Pashenjkën... Fitore! Ja, le të thotë, kjo e di!...

- Urtë e butë e plot tigani! - belbëzoi Nastasia, me ca nojma tinëzareje në fytyrë.

- Po dhe ju nuk mbetët prapa, Nastasia Nikiforovna.

- S'e gjetët! - thirri Nastasia dhe ia plasi gazit. - E kam Petrovna e jo Nikiforovna, - shtoi pasi pushoi së qeshuri.

- Ju kërkoj ndjesë... Që t'i biem shkurt, or byrazer, desha t'i pushtoja me sulm të befasishëm këta të këtushmit. T'ua shkulja paragjykimet, por fitoi Pashenjka! Nuk e prisja të ishte kaq *avenante*[1]. Po ti ç'mendim ke?

Raskolnikovi heshtte, ndonëse s'ia shqiste shikimin e mbushur me shqetësim.

- Dhe shumë, bile - shtoi Razumihini, pa e prishur terezinë nga kjo heshtje e shokut. - Tani janë në rregull punët.

- Pa shih, çapkëni çamarok! - thirri Nastasia, së cilës, dukej sheshit, ky lloj kuvendimi i jepte kënaqësi të madhe.

---

[1]) *E këndshme (fr.)*

- Një gjë nuk ta fal: nuk ke ditur ta kapësh demin nga brirët qysh në fillim! Ka një karakter ajo qiramarrësja jote, që të befason e të lë gojëhapur... Po për këtë më vonë... S'do mend, që nuk ke bërë mirë që e paske çuar punën deri aty, sa paska urdhëruar t'i ndërpresin drekat! Pale pastaj padia!... Po edhe ngatërresa e martesës me të bijën, s'ishte punë që bëhej!... I di që të gjitha! Por si çështje delikate që është, po heshtim. Më fal që ta zura ngoje! Veç, më dëgjo mua, Praskovia Pavllovna nuk është grua budallaqe, siç mund të duket në fillim.

- Ke të drejtë... - nëpërdhëmbi Raskolnikovi që i ra hiles; e mira e të mirave ishte ta nxiste këtë lloj bisede.

- E pra! - thirri Razumihini, i gëzuar që po ia ngisnim muhabetin. - Por as mendtare nuk mund të thuash se është! Është tip më vete!... Dhe s'ke si të mos çuditesh: ka hyrë në të dyzetat. Kur e pyet për moshën, të thotë se është tridhjetë e gjashtë dhe ka të drejtë, se kaq duket. Ndërsa unë gjykoj, si të thuash, nisur nga shifra e fakte! Po nejse. Për mendimin tim, kur e pa që ti nuk ishe student, as orë mësimi nuk kishe, veshjen e mbathjen po prej zhelani, pastaj pas vdekjes së të bijës as që donte të ta krihte bishtin, e zuri frika. Shtoi kësaj edhe strukjen në strofull. Nuk ishe më i mëparshmi; tha me vete se do të ishte më mirë të të jepte duart... ja si rrodhën ngjarjet.

- I kam thënë se prisja para nga nëna... por e gënjeva. Nëna nuk ka nga i merr paratë. E gënjeva që të mos më nxirrte nga dhoma... të mos ma priste ushqimin, - tha Raskolnikovi me zë të lartë dhe të qartë.

- Dhe s'ke bërë keq, por nuk të eci, sepse futi hundët Çebarovi, një këshilltar oborri. Pashenka, si e drojtur që është, s'do kishte guxuar, ai ia futi fitat. Pashenka i ka treguar për mamanë, i ka thënë se e ka me pension njëqind e njëzet rubla, se vetë pa ngrënë do rrinte, por djalit do t'i dërgonte, i ka treguar edhe për motrën që lë kokën për vëllanë e dashur. Pas këtyre fakteve kapej fort... E prapseprapë shkoi e të paditi... Mos u shtrembëro ashtu, je ti ai që ia ke hapur zemrën qiramarrëses; ajo m'i tregoi me gojën e saj. Unë të dua, pa t'i them të gjitha këto. Se kështu është, i ndershmi zemrën në tepsi, i djallëzuari - rrëmbe e përpi! U bëra garant për ty, i thashë Pashenkës që do t'ia paguash borxhin. E thirrëm Çebarovin, i dhamë dhjetë rubla, ia

mbyllëm gojën, e prishëm padinë; urdhëro, kam nderin të ta jap. Fjalës sate i zënë besë. Tashti çdo gjë është në rregull.

Razumihini e vuri në tryezë aktpadinë. Raskolnikovi e pa dhe nuk tha asnjë fjalë; u kthye me kurriz nga muri. Razumihini e shigjetoi qejfprishur.

- E shoh, - mërmëriti pas një minute. - Kot qënkam munduar. Thashë të të gjallëroja pak me këtë llomotitjen time, por, më duket, se më shumë të vrerosa.

- Po si kështu, kur isha në jerm, nuk të njoha? - e pyeti Raskolnikovi, që u kthye vrulltas dhe ia nguli shikimin Razumihinit.

- E ç'pate që u trondite ashtu, kur të solla Zametovin?

- Zametovin?... Nëpunësin e policisë?... E pse? - Raskolnikovi u kthye vrulltas dhe ia qepi sytë Razumihinit.

- E ç'ishte kështu me ty?... Ç'qe tërë ajo tronditje? Donte të të njihte nga afër, pasi folëm gjatë e gjërë për ty. E nga e mësova atë që të ndodhi në polici? Është shpirt njeriu... kuptohet, në një farë kuptimi. Mbetëm miq, s'ka ditë që të mos shihemi... S'të thashë, më duket, që kam zënë një dhomë në këtë zonën tuaj. Kemi shkuar me të nja dy herë edhe te Liza. Të kujtohet Liza Ivanova?

- Mos llapa ndonjë gjë ashtu përçart?

- Fole sa deshe!

- Çfarë, për shembull?

- Fole siç flasin të gjithë, kur janë në jerm. Të mos humbasim kohë, t'u kthehemi punëve.

U çua dhe mori kapelen.

- Nuk më the çfarë fola përçart?

- E pse qederose për gjëra të kota? Mos të ha meraku se ke zbuluar ndonjë sekret? Seç bëlbëzoje për ca vathë, për ca varëse, për një qen bulldog, për një ishull, për rojet e shtëpive; edhe për Nikodhim Fomiçin e Ilia Petroviçin fole, edhe nëpunësin e policisë e përmende. Fole edhe për ca rrecka, kërkoje që t'i jepnin. Zametovi bëri si bëri dhe me gishtat e lyer me kolonjë mori ca lecka, t'i dha, u qetësove, i shtrëngoje fort në dorë tërë kohën. Edhe tani diku atje nën batanije duhet t'i kesh. Kërkove edhe një copë astar pantallonash. Të pyetën ku ndodhet? Seç bëlbëzove ca fjalë që nuk i kuptoi kush... Tani t'i vihemi punës! Ke tridhjetë e pesë rubla, do t'i marrë dhjetë dhe pas

një ore do më kesh këtu, hesapin do ta kesh hesap. Ndërkohë, ju, Nastasia, kujdesuni pak për të sëmurin, ç'të kërkojë plotësojani... Me Pashenjkën do merrem unë. Mirupafshim.

- Pashenjka i thërret! Ditka ta dredhë ky! - nëpërdhëmbi Nastasia, duke e shoqëruar me sy. Pastaj hapi derën, mbajti vesh por nuk iu durua, u lëshua poshtë nëpër shkallë. Donte të ishte në dijeni të bisedës që do bënte me qiramarrësen. Dukej që kishte ngecur si miza në mjaltë te ky Razumihini.

Me t'u mbyllur dera, i sëmuri e hodhi tutje batanijen, dhe si i fandaksur u çua nga kanapeja. Mezi kishte pritur ta linin vetëm, donte të merrej me ca punë të tijat. Po me ç'punë? Si për inat i kishin fluturuar që të gjitha nga koka. "O Zot! Vetëm një gjë dua të di: e kanë marrë vesh apo jo? Po sikur ta dinë dhe shtiren si të mos e dinë, rreken me mua, më mbajnë për të sëmurë... S'do kalojë shumë dhe do thonë: kemi kohë që e dimë, vetë nuk deshëm të të binim në sy... Si t'ia bëj?".

Qëndronte në mes të dhomës krejt i përhumbur; iu afrua derës, e hapi pak, mbajti vesh... Nuk ishte kjo ajo që duhej bërë. U sul për te qoshja e murit, futi dorën nën letrën e murit, por edhe kjo nuk ishte ajo që duhej të bënte... Shkoi te soba, hapi derën, futi dorën, trazoi hirin: copat e astarit të pantallonave ishin aty ku i kishte vënë. Pra, nuk i kishte parë kush! Kurrkush nuk kishte pse dyshonte...

"Zametovi!... Zyra e policisë... E pse po më thërresin në polici? Of! I ngatërrova gjërat: atëherë më thirrën... Tani isha i sëmurë... Po ky Zametovi pse të ketë ardhur? - Mërmëriti, duke u ulur fuqiprerë në kanape. - Mos jam përsëri në kllapi? Apo tani është çdo gjë e vertetë? Më duket se është e vërtetë... Po m'u kujtua: duhet t'ia mbath, sa më shpejt më mirë! Po për ku? Po rrobat ku janë? Çizmet? I paskan fshehur! E qartë! Pra, e ditkan!... Paratë qënkan mbi tryezë. Lavdi të madhit Zot! Do shkoj të zë një dhomë tjetër, nuk kanë për të më gjetur! Po zyra e adresave? Do më gjejnë! Razumihini do më gjejë!... Më mirë të iki larg... diku në Amerikë. Të dalë ku të dalë. Më pandehin të sëmurë, s'e dinë që jam në gjendje të eci, he, he, he! Ua lexova në sytë, i dinë të gjitha!... Sa të zbres shkallët kam keq! Po sikur të kenë vënë roje? Policë? Po ky këtu çaj është? Ja dhe birrë paska mbetur një gjysmë shisheje, qënka e ftohtë!"

E ktheu shishen, ndjeu një kënaqësi të jashtëzakonshme, iu duk se ia shoi zjarrin që i bubulonte në kraharor. Por birra i ra në kokë, nëpër shpinë i kaloi një rrëqethje e lehtë, e këndshme. U shtri dhe u mbulua me batanije. Mendimet edhe kështu të kokolepsura e të sëmura, iu trazuan edhe më, e zuri një gjumë i lehtë, përtëritës. Kërkoi me kokë një vend sa më të mirë në jastëk, u mbështoll me batanijen e lehtë që i kishte zëvendesuar pallton e vjetër të studentit, psherëtiu dhe e zuri një gjumë i thellë, balsam për shpirtin e munduar.

U zgjua kur erdhi dikush, hapi sytë, dhe pa Razumihinin: kishte hapur derën dhe po qëndronte në prag, duke mos ditur si të bënte, të hynte apo jo. Raskolnikovi u çua vrulltas e pa, duke u përpjekur diç të sillte në mendje.

- U zgjove? Erdha, Nastasia, sille këtu bohçen, - i thirri. - Do të jap llogari për punën e bërë..

- Sa është ora? - e pyeti Raskolnikovi, duke parë i merakosur përreth.

- Ke bërë gjumë për kokën e gjumit, or byrazer! Është gjashtë e mbrëmjes. Nja gjashtë orë po t'u bënë.

- O Zot! Ç'është kjo kështu?..

- E ç'të keqe paska? Shëndet është! Mos ke ngut ti! Apo u vonove në ndonjë takim? E kemi tonën kohën! Kam tri orë që po të pres, të kam hyrë nja tri herë, ti po gjumë... Shkova edhe te Zosimovi, s'e gjeta aty. Po do vijë ai. Ka patur ndonjë punë, që s'e gjeta. Sot hymë bashkë me xhaxhanë në banesën e re. Po t'i lëmë këto... Tani hesapi! Ma jep këtu bohçen, Nastenjka! Kështu... Si je tani?

- Mirë jam, nuk jam i sëmurë... Razumihin, ke kohë që rri këtu?

- Po të thashë, të prita nja tri orë.

- Po më parë?

- Si më parë.

- Gjithsej, sa kohë ke që rri këtu me mua?

- Po të tregova njëherë, e paske harruar?

Raskolnikovi ra në mendime. E djeshmja i fanitej si në ëndërr. Pa nga Razumihini si duke i kërkuar ndihmë.

- Hm! - ia bëri ky. - Paske harruar! Dje ti nuk para ke qenë në rregull... Tani ndryshon puna. Të bëri mirë gjumi. Sesi u çele! Të lumtë! Po t'i kthehemi punëve tani. Pa shih këtu!

Zuri të hapte bohçen, me të cilën pandehte se do të mrekullonte shokun.

- Të më besosh, e bëra me gjithë zemër! Dua të dukesh tamam njeri. Fillojmë: këtë kasketë e sheh? - i tha duke nxjerrë një kapele të rëndomtë, nga të lirat, por goxha të mirë, të lezetshme. - Pa vëre? Si të rri?

- Pastaj, më vonë, - nëpërdhëmbi Raskolnikovi, duke e shtyrë me dorë me një shprehje neverie në fytyrë.

- Lëri këto, mor byrazer, s'ka këtu më vonë! Po s'të bënë, nuk ka për të më zënë gjumi. Se i bleva me tahminë. Mirë të rrika! Kapelja është kryesorja! - thirri, pasi ia vuri me dorën e tij në kokë. - Ja, Nastasia, shih e shkruaj: nga njëra anë, kjo strehëgjëra, anëlëshuara, kjo palmerstone, (mori nga qoshja kapalen e vjetër që se përse e quajti palmerstone), nga ana tjetër, kjo bukuroshe këtu... Sa thua, Rodia, sa pagova për të? Po ti Nastjushka? - iu drejtua kësaj, kur e pa që Raskolnikovi as që kishte ndër mend t'i jepte përgjigje.

- Po, një dyshkë do kesh dhënë, - i tha kjo duke qeshur.

- Një dyshkë? Hajde budallaqe, hajde! - iu hakërrua i fyer. - Tetëdhjetë kopejka bëri! Dhe kaq se është pak e përdorur. Veç kushti, kusht: vitin që vjen të japin një tjetër falas. Kështu më thanë! Tani të shohim Shtetet e Bashkuara të Amerikës, siç i quanim, kur ishim gjimnazistë. Kujdes! Vëmendje! Pantallonat janë krenaria ime! - Shpalosi para Raskolnikovit pantallonat gri, prej stofi të lehtë veror. - S'gjen asnjë njollë, asnjë cen, ndonëse të mbajtura janë; edhe jeleku njëbojësh me to është, siç e do moda. Dhe që janë pak të mbajtura, kjo është më mirë, janë më të buta, më të rehatshme... Se, Rodja, që të bësh karrierë, gjë e parë është të vishesh sipas modës. Jemi në sezonin e verës, veshjen do ta kesh verore, në vjeshtë do na duhen plaçka më të rënda, këto do t'i hedhim... Se edhe pa hedhjen tonë do të dalin nga përdorimi... kaq shpirt kanë! Sa, thua, i bleva? Dy rubla e pesëdhjetë kopejka dhe po me atë kusht: do t'i mbash këto këtë vit, vitin tjetër do të marrësh të tjera falas. Tani këpucët: si të duken? Janë të përdorura, por nja dy muaj i nxjerrin. Është mall i huaj. Ia vura sytë kur i la në dyqanin me komision sekretari i ambasadës angleze. Pagova një rubël e pesëdhjetë kopejka për to. Hë, si të duken, mirë?

- Po, ndoshta, s'e keni zgjedhur me tamam kohën! - vuri në dukje

Nastasia.

- Si nuk e paskam zgjedhur me tamam kohën moj? Po pse vishen më ato zharga e ato zhele? - i tha dhe tregoi më dorë nga rrobat dhe çizmet e Raskolnikovit. - Edhe për ndërresat i kam marrë masat, për këmishët e më the të thashë... Tërë këto vajtën pesë rubla e pesëdhjetë kopejka, veshja e brendshme bëri katër rubla, gjithsej nëntë rubla e pesëdhjetë kopejka. Do dukesh njeri si të gjithë njerëzit tani, Rodia. Kurse palltoja mundet edhe për një kohë të të shërbejë, se të jep edhe një si pamje fisniku ajo ty. Sa për pagesën që i detyrohesh Pashenkës, për të mos e vrit fare mendjen, kam biseduar me qiramarrësen: kur të kesh një thes, do t'i japësh një trastë... Dhe tani, or byrazer, më lejo të ta ndryshoj në vend veshjen, se po më duket që në ato vjetërsira sikur ka bërë fole sëmundja...

- Lërmë! Nuk dua! - kundërshtoi Raskolnikovi që po e dëgjonte me neveri tërë këtë ligjëratë lozonjare të shokut dhe mezi priste që t'i jepte fund.

- S'bën mirë që sille kështu! Po unë pse u lodha? Për ty u lodha... Nastasia, mos ki turp, ndihmoje t'i veshë, ja, kështu! - dhe duke mposhtur kundërshtimin e Raskolnikovit, ia ndërroi që ia ndërroi veshjen. Ky u plandos përmbys në jastëk dhe nja dy minuta nuk u ndie.

"Nuk kanë për të m'u hequr qafe këta!" - tha me vete.

- Po me ç'para i bleve? - e pyeti, duke parë nga muri.

- Ja dhe çudia! Po me paratë e tua i bleva. E harrove shegertin që t'i solli: paratë e mamasë nëpërmjet tregtarit Vahrushin. Si harrove kështu?

- Po, vërtet... - nëpërdhëmbi Raskolnikovi, pasi u mendua gjatë. Razumihini e ndiqte i vrenjtur.

U hap dera dhe në dhomë hyri një njeri trupmadh dhe i bëshëm. Raskolnikovit iu duk si i njohur.

- Zosimov! Erdhe, më në fund? - thirri Razumihini i gëzuar.

IV

Zosimovi kishte një trup kaba, fytyrën e kishte mullace, bojë limon, të rruar me merak, flokët e verdhë, të drejtë. Mbante syze dhe

në gisht kishte një unazë të madhe floriri. Ishte rreth njëzet e shtatë vjeç. Kishte veshur një pardesy të lehtë, të gjerë, prej cope të shtrenjtë, pantallona verore të çelura dhe, në përgjithësi, çdo gjë e kishte të bollshme, por të qepur me merak dhe të re fringo. Edhe këmishën e kishte borë të bardhë, qostekun e sahatit shumë të bukur. Fliste ngadalë dhe të gjitha punët i bënte ngadalë, me një ngathtësi të pafshehur, por edhe me një shkujdesje të paramenduar, ndonëse bënte çmos që ta fshihte. E mbanin për natyrë të rëndë, por i kishte dalë edhe nami që u jepte këmbë punëve.

- Është hera e dytë që vij, tani sapo u përmend! - i tha Razumihini.

- E shoh. Si e ndieni veten? - iu drejtua Zosimovi Raskolnikovit, duke e parë me vërejtje dhe duke u ulur në kanape te këmbët.

- Mërzitia nuk i ndahet, - tha Razumihini. - Tani iu ndërruan rrobet, iu rrëmbushën sytë...

- E qartë, mund ta bënit edhe më vonë, në nuk dëshironte... Pulsi normal... Dhimbje koke vazhdoni të keni?

- Nuk kam gjë unë, jo! - foli me zë të irritur dhe të prerë Raskolnikovi, që u çua vrulltas ulur në kanape, pa përreth me sy të zgurdulluar dhe të shqyer dhe përsëri rrasi kokën në jastëk me fytyrën kthyer nga muri. Zosimovi ia ndiqte i përqendruar të gjitha lëvizjet.

- Shumë mirë... kështu dhe duhej të ishte... - shqiptoi përtueshëm.

- Ka ngrënë gjë?

I treguan dhe e pyetën ç'ushqime t'i jepnin.

- Të çdo lloji... Supë, çaj... Domosdo, këpurdha e kastraveca jo, as mish jo... Të shohim njëherë. - Këmbeu një shikim me Razumihinin.

- Tani për tani asnjë ilaç! Do vij nesër ta vizitoj...

- Nesër më darkë them ta nxjerr pak shëtitje! - i tha Razumihini. - Do ta çoj në park, do ulemi në ndonjë kafene, do rrimë pak.

- Nesër, për mua, është shpejt, por sidoqoftë... një shëtitje e vogël... Shohim e bëjmë.

- Sa keq qëlloi! Sot do hyj në apartamentin e ri, dy hapa është që këtu; do t'i bënte mirë të gjendej midis nesh. Le të rrinte shtrirë po të donte, por të ishte aty. Po ti do vish? - iu drejtua Zosimovit. - Mos harro, më ke dhënë fjalën...

- Mund të vij më pas. Po shtroke gosti kështu?

- Asgjë të veçantë: vodkë, harenga, çaj.. Diçka të thjeshtë kam

menduar, por edhe pa gjë s'do jetë. Do jenë vetëm të shtëpisë.

- Kush pikërisht?

- Po, ja, xhaxhai, dje mbërriti në Petërburg, për ca punë, një herë në pesë vjet shihemi.

- Me se merret?

- Punonjës poste ka qenë tërë jetën... Ka dalë në pension, gjashtëdhjetë e pesë vjeç është.. E dua shumë atë njëri. Do të jetë dhe Porfiri Petroviçi, hetues në hetuesi... Njeri i drejtësisë. Ti e njeh.

- Të bie gjiri, me sa di unë?

- Jemi fis i largët. Po pse u vrenjte ashtu? Ende vazhdon t'i mbash mëri për punën e asaj grindjes? E di, ti prandaj dhe nuk ke për të ardhur! E qartë!

- As që dua t'ia di për të...

- Dhe mirë bën! Pastaj do jenë edhe disa studentë, një mësues, një muzikant, një oficer, punon në polici, Zametov quhet.

- Unë një gjë nuk kuptoj: me këtë Zametovin ç'të lidhka vallë?

- Ah! S'na lënë që s'na lënë rehat këta të shkretë parime!... Na kanë zënë për fyti dhe po na marrin frymën. Për mendimin tim, duhet parë në çdo gjë njeriu: është njeri i mirë, bëje shok! Për të tjerat as që dua t'ia di! Zametovi është shpirt njeriu.

- Por edhe nga ata që di të zhvasë!

- Po, e di, e pastaj? Ç'të keqe ka kjo? - thirri Razumihini i xhindosur si rrallë herë. - Mos e lavdërova për këtë? Të thashë vetëm që është shpirt njeriu! Po t'i shohësh aq hollë gjërat, rrallë kush mbetet njeri i mirë. Ja, edhe te ti, në të pafshin me lupë, ç'nuk kanë për të gjetur...

- Unë në veten time nuk do të gjeja...

- Kurse unë do të gjeja! Provo të më gudulisësh, po deshe! Zametovi është ende axhami njeri, duhet mbajtur pranë... Në e sikterissh dikë, nuk ke si e ndihmon të gjejë rrugën e mbarë. Me njerëzit duhet qenë i kujdesshëm! Dhe na hiqen si partizanë të përparimit ca si ju! Po të jetë se të mungon respekti për tjetrin, mos prit të të nderojnë! Në je kureshtar ta dish, me të më lidh një punë...

- E ç'punë na qenka?

- Çështja e bojaxhiut... Do bëjmë si do bëjmë e do ta lirojmë. Po na ecën, ajo çështje sa vjen e po qartësohet. Ne vetëm duam ta shpejtojmë...

- Kush na qenka ky bojaxhi?

- Pse nuk të paskam treguar për këtë rast? A, po! Atëherë vetëm nisa të të tregoj... Është fjala për vrasjen e plakës, të asaj fajdexheshës... Edhe bojaxhiun e ngatërruan në atë vrasje.

- Për vrasjen kam dëgjuar, madje para teje, dhe, në do ta dish, jam i interesuar..., kam një arsyen time për këtë!... Edhe ato që kanë shkruar gazetat i kam lexuar...

- Edhe Lizavetën e vranë! - ndërhyri Nastasia, duke iu drejtuar Raskolnikovit. Kjo tërë këtë kohë kishte qenë në dhomë, rrinte e mbështetur pas derës, dëgjonte.

- Lizavetën? - mërmëriti Raskolnikovi me zë të shuar.

- Po, Lizavetën, atë që shiste veshmbathje, të kujtohet? Vinte gjithmonë këtu poshtë. Edhe ty t'i ka arnuar këmishët.

Raskolnikovi u kthye me fytyrë nga muri dhe shikimin ia nguli një luleje të letrës së murit, që shquhej mes pisllëkut të vërdhemë me vizatimin ngjyrë kafe. Po shtinte në mendje: sa petëla kishte? Si ishin dhëmbëzat e petëlave? Po i mpiheshin e po i bëheshin dru duar e këmbë, por s'guxonte t'i lëvizte, vetëm e vetëm shihte lulen.

- E si vajti puna e atij bojaxhiut? - me një pakënaqësi të dukshme e pyeti Zosimovi, duke ndërprerë llomotitjen e Nastasisë. Kjo psherëtiu dhe heshti.

- E dyshuan për vrasje! - tha me zjarr Razumihini.

- Kishin fakte?

- E ç'fakte zeza! Tërë puna është që lidhur me këtë çështje duhet vërtetuar që faktet e sjella nuk janë fakte! Kështu u veprua edhe me Kohun e Pjostrakovin. Marrëzi e shkuar marrëzisë! Të vjen plasje kur i dëgjon! Pjostrakovin e kam ftuar për darkë sonte. Se ti, Rodia, je në dijeni të asaj që ndodhi para se të sëmureshe, pikërisht atë ditë që të ra të fikët në zyrën e policisë. Atëherë për këtë rast po tregonin...

Zosimovi e pa me kërshëri Raskolnikovin; ky nuk u ndie i gjallë.

- E di Razumihin? Ke filluar të nuhasësh ca punë ti që... - vuri në dukje Zosimovi.

- Plas po nuk arrita t'i bind që ta nxjerrin... - thirri Razumihini dhe përplasi grushtin pas tryezës. - Se këta jo vetëm që gënjejnë; genjeshtrën e fal njeriu, nuk është dhe aq e keqe, të çon tek e verteta; por e bëjnë veten skllavin e saj, i bjenë në gjunjë përulësisht. Porfirin unë

e respektoj, por... E çfarë, thoni ju, i çoroditi fillimisht. Dera kishte qenë e mbyllur, erdhën aty me rojen e shtëpisë, e gjetën të hapur, pra, Kohu me Pjostrakovin janë vrasësit. Ç'logjikë!

- Po ti mos u nxeh: ata vetëm i mbajtën në arrest! E takova Kohun; doli që ia blinte plakës pengjet e djegura. Kështu?

- Po, batakçi njeri është... Merret edhe me punë të tjera të errëta... Në esfel vaftë! Unë inatosem ja me çfarë: me rutinën, me veprimet e ngathta, me mënyrat e vjetëruara të hetimit të çështjeve... Ndërsa rasti në fjalë kërkon një trajtim krejt të ri. Vetëm po të shqyrtohen me kujdes të dhënat psikologjike, mund të bihet fare lehtë në gjurmët e krimit. "Kemi fakte!" - të thonë dhe bjer e vdis. Po faktet nuk janë gjithçka, gjysma e punës është trajtimi dhe interpretimi i tyre.

- Po ti, si, di t'i trajtosh dhe t'i interpretosh faktet?

- Nuk duhet heshtur, kur e kupton që përmes hamendjeve, me anë të nuhatjes, me intuitë mund të japësh ndihmesë në mbarëvajtjen e hetimit. Po ti a je në dijeni të hollësive të çështjes?

- Do të desha më parë të mësoja atë që di ti për bojaxhiun.

- Mirë, dëgjo atëherë: ditën e tretë pas vrasjes, në mëngjes, kur ende rropateshin të nxirrnin diçka nga Kohu dhe Pjostrakovi, ndonëse këta ua kishin shkoqitur çdo gjë, dhe s'kishin më ku kapeshin, u ndeshën me një fakt të papritur: një fshatar, Dushkin quhej, që ka një pijetore pranë shtëpisë ku ndodhi vrasja, paraqitet në zyrën e policisë me një kuti arturinash ndër duar, brenda kishte vathë floriri. Pijeshitësi u tregon këtë histori të çuditshme: "Aty nga ora nëntë e mbrëmjes, një ditë pas vrasjes, (kujdes, e thotë saktë orën dhe datën), vjen tek unë një bojaxhi, që e njihja se kishte qenë dhe herë të tjera, Nikollai quhet, dhe më dorëzoi ja këtë kuti me vathë të florinjtë brenda, më thotë se ma linte peng për dy rubla. Pyetjes ku e ka marrë, m'u përgjigj shkurt: e gjeta në trotuar. Nuk e pyeta më gjatë, i dhashë dy rublat dhe ia mora kutinë. "Në mos unë, dikush tjetër do t'ia merrte pengun. Më mirë le të jetë këtu tek unë, - thashë me vete. Me pengun në dorë erdha drejtë e këtu". S'do mend, gënjen për shtatë palë qejfe, se këtë Dushkinin e njoh personalisht, është mjeshtër për allishverishe e batakçillëqe: pengun, me siguri, që e ka mbajtur jo për ta dorëzuar, por për të përfituar sa më shumë nga sarafllëku. Kësaj here u tremb, i thirri mendjes, nuk shkeli në dërrasë të kalbur... Por dëgjo më tej

tregimin e Dushkinit në zyrat e policisë. "Nikollai Demetjevin e njoh për së vogli, jemi nga Rjazani të dy, - u tha. - Nuk është pijanik, por i pëlqen të pijë. Isha në dijeni që së bashku me Mitrin, një shokun e tij, lyenin në atë shtëpi, në atë shkallë. Me paratë që i dhashë, porositi dy gota, mori reston, por te Mitri nuk u kthye. Të nesërmen dëgjuam që Alena Ivanovnën dhe të motrën, Lizateva Ivanovnën, i kishin vrarë me sëpatë; i njihnim, më lindi dyshimi për vathët, sepse e dija që e ndjera pranonte pengje. Shkova në atë shtëpi dhe pyeta me kujdes, në ishte aty Nikollai. Mitri më tha që ishte dukur vetëm për pak çaste dhe kishte ikur. Bojatisjen kishte qenë i detyruar ta bënte vetëm. E dëgjova, por e mbajta në veten time, nuk i tregova kujt. Ma treguan punën e vrasjes dhe më lindi dyshimi. Sot në mëngjes, në ora tetë (domethënë tri ditë pas ngjarjes, kupton?), më vjen Nikollai, kishte pirë, por jo shumë, ishte në gjendje të bisedonte. U ul në tryezë dhe heshti. Në pijetore ishte dhe një klient tjetër, ishin edhe çunat që shërbejnë. "E ke takuar Mitrin?" - e pyes. - "Jo", - më thotë. - S'e kam takuar". "Po pse, nuk paske qenë këtu?". - "Jo, - më thotë. - Kam tri ditë që nuk kam qenë". "- Po ku paske fjetur?". "Në Peski, - më thotë, - te disa shokë. "Po vathët ku i more?" "I gjeta në trotuar", - më thotë dhe sytë i mban ulur. "Po ç'ka ndodhur atë mbrëmje, në filan orë, në atë shkallë ku po lyenit ju, a ke dëgjuar?" "Jo", - më thotë. - Shqeu sytë, u zverdh u bë dyllë. S'e zgjati, mori kapalen dhe bëri të dilte. Vetë me vete i dhashë karar që ta ndaloja. "Po pimë nga një gotë, mor Nikollai" - i them. Ndërkaq i bëra shenjë djalit që të qëndronte te dera. Dola që nga banaku, kur ai vrap e në rrugë, pas një kthese më humbi nga sytë. Dyshimi më solli këtu: mos ka hyrë në gjynah, ku i dihet..".

- Një fshat që duket nuk do kallauz, - tha Zosimovi.

- Prit! Dëgjo fundin. U derdhën të gjenin Nikollain, Dushkinin e mbajtën në arrest, i bastisën shtëpinë, Nikollait po ashtu. S'kaloi shumë dhe e gjetën edhe Nikollain. E kishin arrestuar në një han, kishte tentuar të varej, por e kishte diktuar një grua dhe kishte vënë ulërimën. E kishin marrë dhe e kishin lidhur. "Ja ç'na qenka!" - paskan thënë. "Më çoni në ndonjë zyrë të policisë, aty do i tregoj të gjitha!" - u thotë Nikollai. E prunë këtu, e pyeten mbarë e prapë, njëzet e dy vjeç djalë qënka. "Kur punonit me Mitrin, nuk patë njeri në shkallë në filan

orë?" - kishte qenë pyetja e parë që i kishin bërë. "Hipnin dhe zbrisnin njerëzia, - u qe përgjigjur, - por ne shihnim punën". "Po ndonjë zhurmë të dyshimtë nuk ju pat zënë veshi?" "Asgjë të tillë që të na tërhiqte vëmendjen nga puna nuk dëgjuam!" - u pat thënë. "A e ke ditur që në filan ditë e në filan orë u vranë motrat?" "Jo, nuk e kam ditur. Vetëm tri ditë më vonë dëgjova nga goja e Athanas Pavllloviçit, në pijetore". "Po vathët ku i more?". "I gjeta në trotuar". "Po të nesërmen përse nuk u paraqite në punë?" "U dhashë pas dehjes". "Ku pive?". "Këtu e këtu". "Pse ike me vrap nga pijetorja e Dushkinit?" "U tremba shumë" "Nga se?" "Nga gjyqi". "Po pse kështu, kur e di që je i pafajshëm?". Edhe këtë pyetje ia kanë bërë, ma kanë treguar njerëz që i dëgjuan me veshët e tyre. Hë, ç'i thua ti kësaj?

- Rasti, sidoqoftë, do marrë në konsideratë, nuk është pa gjë.

- Nuk po të flas për rastin, por për pyetjen që i kanë drejtuar... E shtrëguan: "S'e ke gjetur në trotuar, por në dhomën ku po lyeje me Mitrin, - i thanë. - Na trego si e gjete?". "Ishim duke lyer, po shkonte ora tetë, thamë të iknim, kur Mitri merr furçën dhe ma ngjesh turinjve, turret nga dera jashtë; unë po pas tij, i zbresim shkallët me rrëmujë, sa s'thyem qafën. Te hyrja përplasemi me rojen e shtëpisë dhe me disa zotërinj, sa, nuk më kujtohen; roja na shau e na sikterisi, doli dhe e shoqja, edhe ajo s'la fjalë pa na thënë, po hynte një zotëri me zonjën, edhe ai po nuk la gur e kusur kundër nesh, i kishim zënë rrugën. E kisha kapur Mitrin nga flokët dhe po e tundja, por edhe ai s'mbeti prapa, më zuri nga flokët dhe po më tundte me sa fuqi që kishte; jo me inat, po ashtu, me shaka, si duke lozur. Mitka u lirua i pari dhe vrapoi në rrugë, unë po pas tij; nuk e arrita dot, u ktheva aty, ku po lyenim, se duheshin mbledhur veglat. I mblodha dhe isha duke pritur shokun, kur te dera, në qoshe pashë një send të mbështjellë me letër. E hoqa letrën dhe doli një kuti arturinash: e hapa shoh vathë, të veckël por aq të bukur! I nxora nga kutia dhe i ktheva e përktheva në dorë...".

- Prapa derës në qoshe?... - thirri Raskolnikovi, duke e parë Razumihinin turbull. U ngrit ngadalë në bërryla dhe e pa i trëmbur.

- Po... Ç'pate ashtu? Pse u trembe? - e pyeti Razumihini dhe u ngrit nga vendi.

- Jo, asgjë!... - me zë të mekur, fare të shuar iu përgjigj Raskolnikovi dhe u lëshua përsëri në jastëk, u kthye me fytyrë nga muri. Ra një

heshtje e përgjithshme.

- Ka qenë duke dremitur dhe u trëmb, - tha Razumihini dhe e pa në mënyrë pyetëse Zosimovin; ky i bëri me kokë shenjë mosmiratimi.

- Vazhdo, vazhdo, - i tha Zosimovi. - Po pastaj ç'kishte ndodhur?

- Kuptohet ajo, me t'i parë vathët, harroi për lyerjen dhe për apartamentin, e mbajti frymën drejt e te Dushkini dhe mori nga dorë e tij ato dy rublat, i piu. Për punën e vrasjes vazhdon të thotë vetëm një: "Asgjë nuk di, asgjë nuk kam parë, vetëm pas tri ditësh dëgjova se kishte ndodhur vrasje". "Po pse nuk u paraqite menjëherë në polici?" - e pyetën. "Nga frika!" - u qe përgjigjur. "Po pse deshe të varësh veten?" "Nga tmerri". "Po ç'tmerr na qenka ky?". "Tmerri nga gjyqi!" Ja, kjo është e tëra dhe e gjëra! E si mendon ti, në ç'përfundim arritën ata të policisë pas kësaj?

- Sidoqoftë, ka një gjurmë: gjurmë e dobët është, por gjurmë. Është një fakt. Bojaxhiun s'ke si e liron nga arresti.

- Po ata e shpallën vrasës pa! Dhe janë fare të bindur që ai e ka vrarë...

- Nuk besoj! Sa për vathët, ata sigurisht që flasin kundër tij se iu gjendën ndër duar në ditën, orën dhe në atë shkallë ku ndodhi vrasja, janë plaçkë nga sënduku i plakës; këtë s'ke si e kundërshton. Vathët në një mënyrë a tjetrën u gjendën tek ai. Është fakt i pakundërshtueshëm.

- Po si u gjendën? Si? - thirri Razumihini. - Ja, ti je mjek, ti para së gjithash duhet të studiosh natyrën e pacientit, pastaj të fillosh kurimin, dhe ke mundësi më shumë se kushdo tjetër ta bësh. Ti si thua, duke patur në dorë tërë këto të dhëna, a nuk është e qartë natyra e këtij Nikollait? Si nuk e kuptoke që ajo që tregoi është një e vërtetë e kulluar!... Gjërat kanë ndodhur ashtu siç ua tregoi ai. E gjeti kutinë dhe e mori.

- As topi s'e luan që ka thënë të vërtetën! Por, ama, herën e parë mashtroi?

- Dëgjo këtu: të gjithë dëshmitarët e pyetur, Kohu, Pjostrakovi, Krjukovi, që po hynte me zonjën, të gjithë e kishin parë si po kapeshin te hyrja Nikollai me Mitrin, i kishin sharë dhe u kishin marrë erzin, kurse këta si ca "çiliminj çapkënë" (kështu i kishte quajtur njëri nga dëshmitarët) ndryseshin e kacafyteshin, qeshnin dhe hingëllinin, nuk

donin t'ia dinin për asgjë. Edhe në rrugë kishin vazhduar për një kohë. Tani mba vesh e më dëgjo mirë: lart kufomat janë ende të ngrohta, kështu thanë, i kishin gjetur. Të ishin këta vrasësit, apo vetëm Nikollai, të kishin grabitur edhe arturinat, më lejo të të pyes, a mundet njeriu të ketë një të tillë humor pas një vrasjeje aq makabre? T'i kenë shapllanisur para dhjetë minutash, të dalin që andej duke lënë derën hapur, duke e ditur që aty fort mirë mund të hynte kush, të loznin e të hargaliseshin asisoj para shtëpisë, të tërhiqnin e jo pak vëmendjen e të tjerëve? Pse punë që bëhet është kjo?

- Çudi është! Sigurisht, nuk ka si të ndodhë, por...

- Jo, mor byrazer, jo! Nuk ka *por* këtu! Nëse vathët në duart e Nikollait në po atë ditë, në po atë orë, vërtet që përbëjnë fakt, dhe fakt të rëndësishëm kundër tyre, por që u shpjegua në mënyrë bindëse prej Nikollait, atëhere a mund të mbahet si i pakundërshtueshëm ky fakt? Nisur edhe nga pamundësia psikologjike e ekzistencës, a mund të konsiderohet si akuzë për fajtorin? Që gjeti kutinë dhe desh të varej nga frika, a mund të akuzohet në atë farë feje tjetri? Ja ç'më indinjon, m'i ngre përpjetë leshtë e kokës!

- E shoh. Po desha të të pyes: a u vërtetua që kutia me vathët ishte nga të sëndukut të plakës?

- Po, kjo u vërtetua, - iu përgjigj Razumihini tërë hundë e buzë e qejfprishur. - E njohu Kohu, përmendi edhe personin që i kishte lënë peng; ky, kur u pyet, e pranoi që ishin vathët e tij.

- Keq! Edhe një pyetje tjetër: Nikollai nuk kishte parë, ndërkohë që Kohu dhe Pjostrakovi shkuan për të marrë rojen, ndonjë njeri që të zbriste shkallët?

- Po këtu dhe has sharra në gozhdë, që askush nuk ka parë njeri, - tha i dëshpëruar Razumihini.

- Pra, për bojaxhinjtë paska një përligjje: po kacafyteshin e po hargaliseshin me shoshoqin, s'ka si i ndodh njeriut pas atij tmerri! Ta zëmë se është bindës ky faktor psikologjik, por... më lejo të të drejtohem edhe me këtë pyetje: ti vetë çfarë shpjegimi i jep këtij fakti?

- Si e shpjegoj unë? Ja si: vrasësi i vërtetë e ka humbur kutinë me vathët. Kur trokisnin në derë Kohu dhe pastaj edhe Pjostrakovi, ka qenë brenda, dera ka qenë e mbyllur me reze. Kohu prishi shumë punë që nuk duroi dot, por zbriti shkallët pas Pjostrakovit, vrasësi u

lëshua fill pas tij, s'kishte rrugëdalje tjetër. U fsheh në apartamentin që po lyhej, pikërisht atëherë, kur Mitri me Nikollain u turrën me vrap poshtë shkallëve, u fsheh prapa derës dhe priti sa kaloi Kohu, Pjostrakovi dhe roja, zbriti pastaj shkallët fare i qetë dhe doli ndërkohë që Nikollai me Mitrin ndiqnin njëri-tjetrin në rrugë, në këtë kohë te hyrja nuk kishte asnjeri. Ndokush dhe e ka parë, por s'i ka rënë në sy, pse pak njerëz hyjnë e dalin... Ndërsa kutia me vathët i ka rënë nga xhepi, kur po qëndonte prapa derës, nuk e kishte mendjen që ta vinte re diçka të tillë. Ja, kështu ka ndodhur!

- E fortë! Vërtetë e fortë! Çudi e madhe!
- E si mund të ketë ndodhur ndryshe?
- Veç si shumë i paska ecur fati, fjollë i paskan shkuar punët!
- E-eh! - thirri Razumihini, por u hap dera dhe hyri një person i panjohur.

V

Ishte një mesoburrë i mbajtur, por edhe pak fodull, me një fytyrë qaramani të përgjëruar, që ndali te pragu i derës, pa përreth me një habi njeriu të fyer, që sikur donte të pyeste: "Po ku qenkam kështu?". Dukej i trëmbur, por më tepër i prekur në sedër, dhe s'po u besonte syve, kur pa atë palo musëndër. "Si kabinë vapori", - tha me vete. Me po atë shprehje habie në fytyrë u kthye nga Raskolnikovi, që rrinte shtirë në atë palo kanape, i paveshur, mbuluar me ca vjeturina, i palarë, kockë e lëkurë, që ia kishte ngjitur shikimin e syve të ngrirë. Ngadalë, pa e ndryshuar për asnjë çast shprehjen e fytyrës, e kaloi shikimin te Razumihini, i parruar dhe i pakrehur, i cili nuk vonoi t'i përgjigjej atij shikimi me një shprehje shpërfillëse dhe arrogante të fytyrës, pa lëvizur nga vendi. Kjo heshtje e tendosur zgjati nja një minutë, pastaj, siç dhe pritej të ndodhte, situata ndryshoi. Pasi i thirri mendjes se në këto rrethana krekosja dhe kapadaillëku, me të cilën sapo u paraqit, ishin krejt pa vend, i sapoardhuri ndërroi qëndrim, e zbuti pamjen e të krekosurit fodull, u bë më i sjellshëm, ndonëse nuk hoqi dorë nga rreptësia e fillimit dhe foli, duke iu drejtuar Zosimovit dhe duke theksuar çdo fjalë të pyetjes:

- Rodion Romanoviç Raskolnikovi? Zoti student apo ish-student? Zosimovi lëvizi përtueshëm, ndoshta edhe do t'i ishte përgjigjur, por Razumihini, të cilit as që i ishin drejtuar, i doli përpara.

- Ja, ky këtu është! Ç'punë keni me të?

Kjo "ç'punë keni me të" sikur e përzhiti zotërinë fodull e të ngrehosur, siç ndodh me dikë që mbush gojën me diçka të nxehtë, të cilën nuk e kishte pritur që të ishte aq e nxehtë. Deshi t'i tregonte vendin këtij çunaku, por e përmbajti veten dhe iu drejtua Zosimovit.

- Ky këtu është Raskolnikovi! - nëpërdhëmbi Zosimovi, duke bërë me kokë nga i sëmuri, pastaj gogësiu dhe se përse e hapi jashtëzakonisht shumë gojën dhe e zgjati çuditërisht shumë gogësimën. Pastaj përtueshëm zuri të kërkonte në xhepin e jelekut, nxori prej aty një orë të madhe e buçkane prej floriri, hapi kapakun, e pa dhe përsëri po aq ngadalë e po aq përtueshëm e mbylli kapakun dhe zuri ta fuste aty nga e kishte nxjerrë.

Raskolnikovi tërë kohën rrinte shtrirë, me fytyrën lart dhe shihte ngultas, por pa ndonjë shprehje të përcaktuar, të sapoardhurin. Fytyrën e kishte dyllë të verdhë, të përvuajtur, si pas ndonjë operacioni të rëndë, apo pas ndonjë torture çnjerëzore. Zotëria, sidoqoftë, ia kishte tërhequr vëmendjen, s'kaloi shumë dhe interesimi ia lëshoi vendin moskuptimit dhe pastaj edhe mosbesimit, madje edhe frikës. Kur Zosimovi tregoi në drejtim të tij dhe tha: "Ky këtu është Raskolnikovi!" - u ngrit pak, pastaj kërceu në kanape, qëndroi ulur dhe me zë të dobët e të dridhur, por në të njëjtën kohë dhe provokues, shqiptoi:

- Po! Unë jam Raskolnikovi! Ç'dëshironi?

I sapoardhuri e peshoi për disa çaste dhe me zë njeriu hijerëndë i tha:

- Pjotër Petroviç Lluzhini. Shpresoj që emri im të mos jetë për ju i panjohur.

Raskolnikovi, që s'ishte përgatitur të dëgjonte një prezantim të këtillë, e pa si i huptë, mendueshëm, ndërsa nuk i ktheu asnjë përgjigje. Kishte pamjen e njeriut që e dëgjonte për herë të parë këtë emër.

- Si? Nuk paskeni patur mirësinë të merrni ndonjë njoftim deri më sot? - e pyeti Pjotër Petroviçi me fytyrë të shtrembëruar nga habia.

Raskolnikovi, në vend që t'i përgjigjej, u lëshua ngadalë në jastëk,

vuri pëllëmbët nën kresë, dhe ia qepi shikimin tavanit. Pikëllimi u vulos në fytyrën e Lluzhinit, Zosimovi dhe Razumihini po e vështronin me kërshëri dhe ky s'kishte si të mos hutohej.

- Mendova, - belbëzoi, - që letra e nisur para dhjetë ditëve, para dy javëve thuaj...

- Po pse qëndroni ashtu te dera? - e ndërpreu Razumihini. - Në keni ardhur për të sqaruar diçka, hyni dhe uluni. Sikur s'jeni mirë aty bashkë me Nastasinë... Nastenjka, bëj pak mënjanë, lëre mysafirin të hyjë! Urdhëroni, ja karrigia! Po hyni, de!

E largoi karrigen e vet nga tryeza, liroi pak vend ndërmjet tryezës dhe gjunjve, që mysafiri të mund të kalonte. Ky nuk kishte si ia bënte ndryshe: rrëshqiti në hapësirën e ngushtë, duke u penguar dhe përplasur. U ul në karrige dhe e pa shtrembër Razumihinin.

- S'keni pse çuditeni! - i tha ky. - Rodia ka pesë ditë që është sëmurë, tri ditët e fundit ka qenë në jerm, ka pak që u përmend dhe hëngri diçka. Edhe mjeku për ta vizituar ka ardhur. Ne jemi shokë, edhe unë student jam, kujdesem me ç'mundem. Mos ngurroni të thoni e të bëni gjithë sa keni ndërmend, se ju keni arsye që keni ardhur.

- Ju faleminderit, por druhem mos e bezdis dhe e lodh të sëmurin si me vizitën ashtu dhe bisedën që do t'i bëj? - iu drejtua Pjotër Petroviçi Zosimovit.

- Jo-o-o! - mërmëriti ky. - Ju vetëm e zbavitni, e shkriftoni ndopak... - Dhe përsëri gogësiu.

- Këtë mëngjes u përmend! - vazhdoi Razumihini fare i shpenguar në ato që thoshte dhe që bënte, madje kishte një sjellje prej babaxhani; kjo i dha zemër Pjotër Petroviçit dhe sidomos ajo që ky rreckaman llapazan atypari i kishte bërë të ditur që ishte student.

- Mamaja juaj... - filloi Lluzhini.

- Hm!... u bë gati të ndërhynte Razumihini, por Lluzhini e pa i habitur. - Jo, unë kot ashtu... vazhdoni...

Lluzhini rrudhi supet.

- Mamaja juaj, kur qesh tek ju, bëri gati një letër. Pasi mbërrita në Petërburg, enkas lash të kalonin disa ditë, erdha i sigurt që jeni në dijeni të punëve, por për habinë time të madhe, doli që...

- E di, e di! - foli mbytur Raskolnikovi i vrerosur. - Ju jeni ai, dhëndëri?... E di, e di!... Mjaft me këto!

Pjotër Petroviçi u fye sa më s'bëhet, u zu ngushtë dhe iu duk sikur po e përpinte dheu, por vendosi të duronte. E pa i hutuar, donte të kuptonte ç'do të thoshte e gjithë kjo? Heshtja zgjati ndonjë minutë.

Ndërkohë Raskolnikovi, që vetëm sa e fshiku ashtu shkarazi, kur i dha ato përgjigjie, tani kishte kthyer kokën nga ai dhe po e shihte me vëmendje, me një kërshëri të veçantë, si të donte të plotësonte vrojtimin që s'kishte arritur ta bënte pak më parë dhe po e habiste e veçanta që po vinte re në këtë njeri, madje, për ta parë sa më mirë, e mbante paksa ngritur kokën nga jastëku. Dhe vërtet, në pamjen e Pjotër Petroviçit po e habiste diçka që e përligjte atë emër "dhëndër", të cilin me aq pasajdi sapo e pat shqiptuar ai vetë. Dukej që Pjotër Petroviçi i kishte shfrytëzuar këto ditë në kryeqytet për t'u katandepsur e pispillosur në pritje të së fejuarës, diçka krejt normale, madje që e nderonte. Edhe vetëdija e vetëkënaqësisë së këtij ndryshimi të këndshëm, që spikaste në çdo veprim e qëndrim, fare mirë mund t'i falej, se helbete, njeriu njëherë bëhet dhendër. Rrobet sapo i kishte marrë te rrobaqepësi, çdo gjë dukej në rregull, përveç asaj që ato ishin si shumë të reja dhe si shumë e theksonin qëllimin për cilin ishin bërë dhe veshur. Edhe kapelja e rrumbullaktë, luksoze dhe fringo e re, po këtë donte të thoshte: Pjotër Petroviçi e trajtonte me një respekt të dukshëm, të posaçëm, e mbante me skandalí ndër duar. Edhe çifti i dorezave ngjyrë jargavani, aq i zgjedhur dhe i mrekullueshëm, po për këtë dëshmonte, madje ato as nuk visheshin, vetëm mbaheshin ndër duar, për t'u dukur. Rrobet i kishte të çelura, rinore. Xhaketa kaki ishte prej stofi të hollë, të lehtë, pantallonat bojë krem qenë të freskëta, verore, i po kësaj ngjyre ishte dhe jeleku, kollaroja ishte e vogël, simpatike, me vija bojë rozë dhe, kryesorja, i shkonte shumë Pjotër Petroviçit. Fytyra e freskët, bile e bukur, edhe kështu e tregonte më të ri se dyzetë e pesë vjeç. Basetat brune në të dyja anët e faqeve binin poshtë dhe takoheshin hijshëm te mjekra e rruar për merak. Bile edhe flokët, që aty-këtu kishin edhe ndonjë thinjë, të dredhur rica-rica në përmanent, dhe të rregulluar te berberi, nuk dukeshin kaq qesharakë, siç ndodh rëndom kur bëhen permanent flokët, sepse personi në fjalë merr pamjen e gjermanit që është duke vënë kurorë. Po qe se gjeje në këtë fytyrë aq të mbajtur dhe të bukur diçka të pakëndshme, madje të pështirë dhe të neveritshme, kjo vinte për disa

arsye të tjera.

Pasi u vel së sodituri zotin Lluzhin, Raskolnikovi shtrëmbëroi fytyrën i vrerosur, e lëshoi i pafuqishëm përsëri kokën në jastëk dhe ia qepi përsëri sytë tavanit.

Por zoti Lluzhin, që rrinte me dhëmbë të shtrënguara, kishte vendosur të mos binte në sy që po e vinte re këtë qëndrim të çuditshëm të kunatit të ardhshëm.

- Më vjen keq, më vjen shumë keq që ju gjej në këtë gjëndje, - përsëriti, duke e mposhtur bezdinë që qe i detyruar ta prishte heshtjen. - Sikur ta dija që qënkeni i sëmurë, do të kisha ardhur më parë. Po, e dini, kam qenë ca i zënë!... Kam ndër duar një çështje tepër të rëndësishme, si avokat senati. Pa zënë ngoje pastaj telashet dhe preokupimet që ju vetë i merrni me mendje. Mamanë dhe motrën tuaj i pres të vijnë nga çasti në çast.

Raskolnikovi lëvizi pak dhe diç donte të thoshte: në fytyrë iu shprehën emocionet që provonte. Pjotër Petroviçi e ndërpreu fjalën; priti një hop, por ky nuk tha asgjë, ndaj dhe vazhdoi:

- Nga çasti në çast! Zura dhe një apartament.

- Ku? - e pyeti me zë të mekur Raskolnikovi.

- Nuk është shumë larg që këtej, Shtëpia e Bakalejevit i thonë...

- Në rrugën "Voznjesenskaja", - saktësoi Razumihini. - Dy kate të asaj shtëpije lëshohen me qira, janë të tregtarit Jushin. I di ku janë dhe si janë..

- Po, aty...

- Variant më i keq s'ka ku gjëndet! Pisllëku pisllëk, kutërbimi të zë frymën, si vend aspak i përshtatshëm për familjarët; kanë ndodhur ca gjera aty që s'i merr maja e kalemit, dreqi me të birin aty e kanë strofullën! Kam qenë për një çështje që ndiqja... sa për lirë, lirë i lëshojnë...

- Domosdo, nuk ka si t'i di tërë këto hollësi, jam i papërvojë në kësi punësh, - foli i prekur në sedër Pjotër Petroviçi. - Dhomat që zura m'u dukën të pastra e të këndshme, i zura për fare pak kohë... Ia kam vënë syrin një apartamenti tjetër, aty them të rrojmë në të ardhmen, - iu drejtua Raskolnikovit. - Po e përgatis për dasmën. Se tani edhe unë ngushtë jam në shtëpi, banoj jo larg që këtej, te zonja Lipevehzel, në apartamentin e një mikut tim, Andre Semionoviç

Lebezjatnikovit. Ky ma rekomandoi edhe apartamentin në shtëpinë e Bakalejevit...

- Lebezjatnikovi?... - nëpërdhëmbi ngadalë Raskolnikovi, si duke ndërmenduar diçka.

- Po, Andra Semionoviç Lebezjatnikovi, që punon në ministri... Mos e njihni gjë?

- Po... Jo... - u ngatërrua vete me veten Raskolnikovi.

- Të me falni, por m'u duk sikur e njihni... Kam qenë kohë me parë tutor i këtij djaloshi për t'u pirë në kupë... njeri me të ardhme... Mua më pëlqen shoqërimi me të rinjtë, mëson shumë gjëra të reja prej tyre. - Pjotër Petroviçi u hodhi një shikim kuptimplotë të pranishmëve.

- Në ç'kuptim e keni? - e pyeti Razumihini.

- Në kuptimin më të mirë, më dashamirë të fjalës... - iu përgjegj vrullitas Pjotër Petroviçi, i cili u gëzua shumë nga kjo pyetje. - E dini? Kam dhjetë vjet që nuk kam qenë në Petërburg. Tërë këto transformime, reforma, ide novatore dhe në provincë ndihen, por për t'i njohur më nga afër është e domosdoshme të jetosh në Petërburg. Dhe, për mendimin tim, më mirë dhe më lehtë i arrin, duke ecur në një hap me brezin e ri... Dhe, të them të drejtën, u gëzova shumë..

- Çfarë ju paska gëzuar aq shumë?

- Është një pyetje me hapësirë tepër të madhe kjo që po më bëni. Mundem edhe të gabohem, por ajo që më gëzon më shumë është mundësia për të gjetur një këndshikim sa më të qartë, për të mbajtur qëndrim kritik, por jo vetëm kritik, edhe konstruktiv...

- Kjo që thoni është e drejtë... - i doli krahë Zosimovi.

- Gënjeni, mendime konstruktive nuk ka! - ju karfos Razumihini. - Nuk është kollaj t'i shpalosësh, nuk bien ashtu llokum nga qielli... Kemi nja dyqind vjet që jemi çmësuar të jemi konstruktivë.. Ide edhe ka, - iu drejtua Pjotër Petroviçit, - edhe dëshira për punë të mira nuk mungon, ndonëse shfaqet përmes një naiviteti të dukshëm; ka edhe qëndrime të ndershme, edhe pse dallaveraxhinjtë janë në shumicë, kurse qëndrimi konstruktiv mungon! I ka hipur breshkës!

- Nuk jam i një mendjeje me ju, - e kundërshtoi me kënaqësi të pafshehur Pjotër Petroviçi. - S'e mohoj dot, ka dhe entuziazëm, po ka dhe pasaktësi, veç duhet qenë zemërgjerë; se entuziazmi vjen nga pasioni, dhe manifestohet ngaqë punët nuk bëhen në mjedise të

përshtatshme. Në është arritur pak, edhe koha nuk ka qenë kushedi sa e gjatë. Të mos zëmë ngoje pastaj mjetet. Për mendimin tim, diçka edhe është bërë, nuk se është fare pa gjë: janë përhapur idetë e reja, janë shprehur e diskutuar mendime të vyera, kanë filluar të bëhen edhe vepra të dobishme, në literaturë gjithnjë më tepër po rrihen mendime serioze, janë duke u çrrënjosur paragjykimet e dëmshme. Shkurt fjalët, e kemi prerë me sëpatë litarin që na lidhte në të kaluarën, dhe kjo, për mendimin tim, s'është pak...

- Ja, i vuri pikat mbi i ky!... Po ngutet të na tregojë se kush është! - shqiptoi papritur Raskolnikovi.

- Si-i-i? - pyeti Pjotër Petroviçi që, me sa duket, nuk e kishte dëgjuar mirë, por nuk mori përgjigje.

- Drejt folët, - nxitoi ta mbështeste Zosimovi.

- Kështu është! - thirri Pjotër Petroviçi, duke parë me dashamirësi nga Zosimovi. - Se ja, - tha, duke iu drejtuar Razumihinit, por tanimë me disa nuancime triumfi dhe epërsie, vetëm dhëmbët ia mbajtën që t'i drejtohej me atë "mor djalosh!" - që është përparim, apo siç po bëhet zakon të thuhet tani, progres, këtë as topi se luan... qoftë mākar për faktin që mbështetet në shkencë, në të vërtetën ekonomike...

- Fjalë të përgjithshme këto...

- Jo, nuk janë fjalë të përgjithshme! Nëse deri më sot më kanë bukosur, duke më predikuar ta doja të afërmin dhe unë e kam dashur, ç'doli nga kjo? - vazhdoi Pjotër Petroviçi ngutshëm, gjë që patjetër binte në sy. - Doli që në rast se kisha dy këmishë, njërën duhej t'ia jepja tjetrit dhe që të dy mbeteshim varfanjakë. Ndërsa shkenca thotë: duaj para së gjithash dhe mbi të gjitha veten, progresi bazohet mbi përfitimin vetjak. Nëse do vetëm veten, atëherë punët të shkojnë mbroth, do t'i kesh që të dyja këmishët. E vërteta ekonomike na mëson se sa më shumë njerëz të rregulluar të ketë në jetë, sa më shumë këmishë të pandara të jenë, aq më i fortë është themeli dhe mbi të më solide ndërtohen marrëdhëniet shoqërore. Arritjet personale janë ato që çojnë përpara të përgjithshmet... Mendim i thjeshtë është, por ja që ka qenë mënjanuar kurdoherë nga ëndrra, nga entuziazmi. Mjafton të përqendrohesh pak, të mendosh esëll, dhe e ke mu në pëllëmbë të dorës të vërtetën...

- Të më falni, por ja që jam një nga ata që s'e ka atë mendimin

Erjonixx

esëll, - e ndërpreu Razumihini. - Më mirë e lëmë këtë bisedë! Kur ua nxita, pata një pikësynim tjetër, ndërsa këto fjalë të përgjithshme lidhur me interesin vetjak, më kanë ardhur në majë të hundës. T'ju them të drejtën, më skuqet faqja jo vetëm kur flas vetë, por edhe kur flasin të tjerët. Po vë re që u ngutët ca të rekomandoheshit me dijenitë tuaja, por s'ka gjë, është e falshme. Bënit mirë të na thoshit kush jeni, se kohët e fundit me këto problemet e përgjithshme kanë filluar të merren gjithfarësoj tipash dhe po e shfrytëzojnë aq keq, saqë të mbetet vetëm të vësh duart në kokë. E lëmë më mirë këtë muhabet!

- Zotëri mëshirëplotë! - foli Lluzhini, duke u ndrydhur, me një ngrehje të padurueshme. - Mos deshët të thoshit me këtë se edhe unë...

- Jo aspak, të më falni, por... Si mund t'ju shkojë në mendje?... E lëmë më mirë këtë bisedë... - foli prerë Razumihini dhe u kthye nga Zosimovi për të vazhduar biseden e ndërprerë.

Pjotër Petroviçi u tregua aq i zgjuar, sa heshti dhe i tha vetes se bënte mirë të largohej.

- Shkoj me shpresën se kjo njohje, - iu drejtua Raskolnikovit, - për arsye tanimë të qarta, pas shërimit tuaj, do kurorëzohet me afrimin tonë... Sidoqoftë, ju uroj të shëroheni sa me parë...

Raskolnikovi as kokën nuk e ktheu në drejtim të tij. Pjotër Petroviçi u ngrit.

- E ka vrarë penglënësi! - tha Zosimovi.

- Dhe vetëm penglenësi! - e përforcoi atë mendim Razumihini. - Porfiri është ujk i vjetër, për të hapur nuk hapet, por hetimet po i vazhdon...

- Po i merr në pyetje penglënësit? - pyeti me zë të lartë Raskolnikovi.

- Po. E çfarë?

- Asgjë.

- Po nga e di kush janë penglënësit? - e pyeti Zosimovi.

- Disa ia tha Kohu, disa emra janë të shkruar në letrat me të cilat janë mbështjellë pengjet, ka nga ata që janë paraqitur vetë, me të dëgjuar për vrasjen...

- Nuk i paska vajtur keq mendja! Është hetues i shkathët ai, s'ia ha qeni shkopin në kësi punësh! Kërkohet guxim dhe vendosmëri në këto raste...

- Nuk jam i një mendje me ju! - ndërhyri Razumihini. - Për mendimin tim, nga kjo do ngatërrohen keq gjurmët. Se, ja, të vjen të paraqitet ndonjë i rrahur me vaj e me uthull dhe të ngatërron aq keq, saqë hajt ta kapësh fillin pastaj. Të nxjerrë ca pengesa kjo mënyrë, që nuk ke si i kapërcen pastaj. Se ç'ka bërë vrasësi? Vetëm e ka vrarë, kurse për të vjedhur thuajse asgjë nuk ka vjedhur... Në sirtarët, nëpër plaçkat, gjithandej u gjendën para e jo pak, pale arturina. S'ia ka prekur! I është prishur mëndja, me sa duket, e ka humbur torruan! Veprimet i ka bërë të rastësishme, nuk ka parë leverdinë!

- E keni fjalën për vrasjen e fajdexheshës? - ndërhyri Pjotër Petroviçi, duke iu drejtuar Zosimovit. Qëndronte në këmbë me dorezat dhe kapelen ndër duar, para se të dilte, kishte ndierë një nevojë të brendshme për të thënë disa fjalë të mënçme. Ia donte puna të linte përshtypje sa më të mirë, sqima kishte fituar mbi arsyen.

- Po... Keni dëgjuar?

- Si jo, unë aty pranë banoj...

- Dini hollësi?

- Nuk mund të them, por më intereson një rrethanë, një çështje me rëndësi të dorës së parë. Pa zënë ngoje faktin që krimet në shtresat e ulta të shoqërisë kanë filluar të shtohen, ngado që shkon vetëm dëgjon për vjedhje e zjarre, më tmerron fakti që edhe në shtresat e larta të shoqërisë kriminaliteti është në rritje. Një ish-student vete e vjedh postën, një tjetër nga shoqëri e lartë merret me falsifikimin e monedhave; në Moskë zbulohet një grup që bën falsifikimin e letrave me vlerë të huasë shtetërore, të biletave të llotarisë dhe kokësi na qënkësh një profesor i historisë së përgjithshme; diku jashtë shtetit vrasin një sekretar ambasade për punë parash... Nëse kjo plakë fajdexheshë është vrarë nga një i shoqërisë së lartë, se muzhiku nuk lë peng arturina, atëherë pyes: si ta kuptojmë këtë shthurje edhe të pjesës së civilizuar të shoqërisë?

- Po ndodhin ndryshime të mëdha ekonomike... - i mbajti ison Zosimovi.

- Si ta shpjegojmë? - u kap pas kësaj pyetje Razumihini. - Po ja, me rutinën, me pasivitetin, me mungesën e veprimeve të mira mund ta shpjegojmë!

- Po kjo ç'na qënka?

- Po ja: ç'përgjigje i dha ai profesori i historisë pyetjes përse ishte marrë me falsifikimin e letrave me vlerë? "Të gjithë pasurohen me mënyra nga më të ndryshmet, edhe unë nuk desha të mbetesha prapa të tjerëve. Desha të qëndroja në radhën e parë." Ka ardhur një kohë që gjithsecili po e tregon veten...

- Po morali? Po rregullat e normat e shoqërisë?

- Ah, po! Ato ju merakosin më shumë se çdo gjë juve? - thirri papritur Raskolnikovi. - Po të gjitha këto në përputhje me atë teorinë tuaj po ndodhin!...

- Në përputhje me teorinë time?

- Pasoja të asaj që sapo shtjelluat janë! Po të mbështetesh në të, del që njerëzit si pa të keq mund t'i shkosh në satër...

- Ç'thoni kështu? - u indinjua Lluzhini.

- Nuk është ashtu! - ndërhyri Zosimovi.

Raskolnikovit i kishte ikur fare fytyra, ishte dyllë i verdhë, buzët i dridheshin, merrte frymë me zor.

- Çdo gjë duhet bërë me masë! - tha me ton mësimdhënës, por edhe me fudullëk Lluzhini. - Ideja ekonomike nuk është thirrje për vrasje edhe në supozofshi...

- E vërtetë është që ju, - ia ndërpreu ligjëratën Raskolnokovi me zë të dridhur, në të cilin spikaste kënaqësia që po e fyente, - i keni thënë të fejuarës suaj... pikërisht në çastin kur dëgjuat nga gojë e saj pranimin e propozimit për t'u fejuar... se ju gëzonte më shumë se çdo gjë fakti që ajo ishte varfanjake... sepse qenka me leverdi ta nxjerrësh bashkëshorten nga varfëria, për ta patur nën pushtetin tënd... dhe t'ia qokësh sa herë që ta lyp nevoja se është aty falë zemërgjerësisë suaj?...

- Zotëri mëshirëplotë! - me një ligësi dhe urrejtje të tmerrshme thirri Lluzhini, lulëkuq në fytyrë. - Zotëri mëshirëplotë!... Të shtrembërohet kësisoj mendimi!... Të më falni, por duhet t'ju bëj të ditur se njoftimet që keni marrë, më saktë do të ishte të thosha, që ju kanë dërguar janë fare të paarsyeshme!... Dyshoj te personi që jua ka bërë të ditur: është mamaja juaj!... Se m'u duk, domosdo, pa dashur të mohoj një varg cilësish të mira, disi e entuziazmuar, romantike në gjykimet që jepte... Veç nuk kisha si e merrja me mendje që do arrinte puna deri aty, sa të shtrembëronte në këtë farë feje me entuziazmin e saj të vërtetën... Dhe, më në fund... në fund...

- Dëgjoni këtu! - thirri Raskolnikovi, duke u ngritur mbi bërryla dhe duke e asgjësuar me shikimin turrjelë të syve rrezëllitës. - E dini çfarë?

- Çfarë? - Lluzhini shtangu i magjepsur nga ai shikim. E shihte kryelartë dhe provokues. Heshtja zgjati disa sekonda.

- Në guxofshi qoftë edhe një herë... me një fjalë të vetme... të përgojoni nënën time... do ju hedh nga shkallët!...

- Po kjo? Po kjo ç'është? - thirri Razumihini.

- Pa shih ç'na qënka?!... - Lluzhini i verdhë dyllë kafshoi buzën. - Më dëgjoni, zotëri! - thirri duke theksuar dhe duke u ndalur pas çdo fjale. Dukej që me vështirësi të madhe po e përmbante veten; gulçonte nga inati. - Me të hyrë, më ra në sy armiqësia juaj, ndaj qëndrova, që të shihja se ku donit të dilnit. Të sëmurit i falen nervozizmi dhe irritimi, po jo këto ama...

- Unë nuk jam i sëmurë! - thirri me sa e kishte në kokë Raskolnikovi.

- Aq më keq për ju!...

- Thyejeni qafën! Hiqmuni sysh!

Lluzhini edhe pa këtë ishte duke dalë, ashtu siç kishte hyrë ndërmjet tryezës dhe karriges së Razumihinit. Ky kësaj here nuk u ngrit që t'ia lehtësonte kalimin. As me Zosimovin nuk u përshëndet; ngriti kapelen në lartësinë e supit, kur u përkul që të dilte nga dera e ulët, dhe u gjend në shkallët. Tërë pamja e tij shprehte një fyerje të padëgjuar.

- Po kjo ç'qe kështu? Nuk bëre mirë! - i bërtiti i indinjuar Razumihini.

- Më lini rehat! Më lini vetëm! - si i çmendur thirri Raskolnikovi. - Po ma merrni shpirtin çik e nga një çikë! Nuk kam frikë nga njeri! Mos t'ju shoh më këtu, ikni! Dua të jem vetëm! Vetëm!

- Shkojmë! - tha Zosimovi, duke i bërë shenjë me kokë Razumihinit.

- Ç'thoni? Po pse lihet vetëm ky në këtë gjëndje që është?

- Shkojmë! - përsëriti edhe më i vendosur me zë të prerë Zosimovi dhe doli i pari. Razumihini, pasi u mendua një hop, u turr pas tij që ta arrinte.

- Do të ishte më keq të mos i bindeshim dëshirës së tij! - tha Zosimovi, kur po zbrisnin shkallët. - Nuk duhet irrituar më keq!

- Po ç'po ndodh kështu me këtë njeri?!

- Duhet menduar në ç'mënyrë mund ta ndihmojmë! M'u duk se

ishte gati... Diçka të tmerrshme bluan përbrenda ai njeri!... Ka një mendim që s'i shqitet nga koka. Është një mendim fiks dhe plumb i rëndë! Atij mendimi i trëmbem! Unë kështu them!

- Po ky zotëria, Pjotër Petroviçi? Nga ç'dëgjuam, del që qënka i fejuari i motrës; Rodia para se të sëmurej paska marrë një letër.

- Qoftëlargu e solli atë njeri në këto çaste, prishi shumë punë!... A vure re një indiferentizëm të përgjithshëm, për çdo gjë hesht, vetëm në një rast reagon: kur përmendet vrasja... Dhe reagon me nje nervozizëm të dukshëm!...

- Po, ashtu është! - e mbështeti Razumihini. - Si nuk e vura re? Tërë kohën dëgjon e përgjon ç'thuhet, duket që i trëmbet diçkaje... Ditën e parë të sëmundjes e trembën për vdekje në zyrat e policisë... i ra të fikët.

- Mos harro të ma tregosh me hollësi atë ngjarje, kur të jemi në darkë, edhe unë do të tregoj diçka!... Më ka ngacmuar keq rasti i tij... Do i vete për vizitë pas një gjysëm ore... Si i sëmurë ai asgjë serioze nuk ka!

- Të faleminderit. Do pres lajm te Pashenka, përmes Nasties.

Raskolnikovi me të mbetur vetëm, pa me pikëllim Nastien, mezi priste që edhe kjo të dilte.

- Po çaj nuk do pish? - e pyeti.

- Më vonë! Do fle pak! Mbylle derën...

U kthye nga muri, Nastasia doli.

VI

Me te dalë Nastasia, brofi, mbylli derën me reze, hapi bohçen me plaçkat që i kishte sjellë Razumihini dhe zuri të vishej. Çudi: përsëri po e ndiente veten të qetë, nuk po e mundonte më jermi kapitës, as tmerrin e panikun e paradokohshëm nuk e ndiente. Ishte hera e parë që ndihej aq çuditërisht i qetë. Të tëra lëvizjet që bënte ishin të sakta, të paramenduara. "Qysh sot! Që tani!" - mërmëriste. E kishte fuqiprerjen e përgjitheshme, por një shtysë e brendshme shpirtërore, që bashkëjetonte me qetësinë dhe idenë fiske, i jepte forca dhe vetëbesim. Kishte besim te vetja, thoshte mund të mbahej në këmbë, nuk do

rrëzohej kur të dilte në rrugë. Pasi u vesh, i hodhi një sy parave që ishin mbi treyzë, u mendua një hop, i mori dhe i futi në xhep. Ishin njëzet e pesë rubla, mori edhe pesëdhjetë kopejkat e restos. Hapi pa u ndier rezenë dhe doli nga dhoma, zbriti shkallët, futi vetëm pak kokën në derën e hapur të kuzhinës: Nastasia qëndronte me shpinë, ishte duke i fryrë samovarit të qiramarrëses. As dëgjoi e as pa gjë. Pse a mund t'i shkonte mendja kujt që mund t'ia mbathte në atë gjendje që ishte? Pas një minute u gjend në rrugë.

Ora po shkonte tetë, dielli ishte në të perënduar, vapa ende nuk kishte rënë, por me tërë forcën e mushkërive thithte ajrin mbrëmësor, të ngimur me pluhur dhe kutërbim. Iu morën mendtë, një dalldi prej të çarturi iu ngjit nga lukthi dhe i buisi në sytë e skuqur dhe në fytyrën e zverdhur, të dobësuar. As e dinte dhe as kishte menduar se ku do shkonte; vetëm një gjë e kishte fare të qartë: "*Kësaj* gjendjeje i duhej dhënë fund, dhe qysh sonte, që tani, ndryshe nuk kishte si kthehej në shtëpi; *nuk dëshironte të jetonte më kështu*!". Po si? Çfarë gjëje duhej t'i jepte fund? Nuk e dinte dhe as donte të mendonte për të. E terratiste me sa fuqi që kishte atë mendim, sepse ishte pikërisht ai që e torturonte. Një gjë e ndjente dhe e dinte fort mirë: gjithçka duhej të ndryshonte, në ndonjë mënyrë duhej të ndryshonte!

Si ngaherë, eci nëpër rrugën që të nxirrte në sheshin Sena. Pa dalë mirë në xhade, pa dikë që i binte organetos, shoqërohej nga një vajzë pesëmbëdhjetë vjeçare, që këndonte një romancë sentimentale. Kishte veshur një fustan krepi, doreza, në kokë kishte nje kapele kashte me një pupël të kuqe, të mbajtur dhe të dalë mode. Këndonte me zë të brishtë, por të ëmbël dhe kumbues, drithmëtar; pasi e mbaroi, qëndroi në pritje të lëmoshës. Raskolnikovi i qe afruar grupit prej dy a tre dëgjuesish, kur kjo mbaroi, i futi në dorë një pesëkopejkëshe. Vajza i bëri shenjë shoqeruesit dhe ata ecën më tej.

- Ju pëlqejnë këto lloj këngësh? - iu drejtua pastaj një burri të thyer në moshë që nuk ngutej të largohej. Ky u vrenjt dhe e pa i habitur.
- Mua më pëlqejnë, - vazhdoi me një të tillë pamje, sikur nuk ishte duke folur për këngët. - Dhe më pëlqejnë sidomos në mbrëmjet e ftohta dhe të lagështa të vjeshtës, patjetër të lagështa, kur njerëzit ecin të skrupullosur, me fytyra të murrëtyera, si prej të sëmuri; edhe më mirë akoma kur është duke rënë llohë, me copa të mëdha, pa erë,

kur ndriçimi i fenerëve zymtohet.

- Nuk e di... Më falni... - belbëzoi zotëria i trembur edhe nga pyetja, por sidomos nga pamja e atij që po pyeste dhe eci në anën tjetër të rrugës.

Raskolnikovi çapiti më tej dhe doli në vendin ku tregtonin burri dhe gruaja që biseduan atëherë me Lizavetën; këta nuk ishin aty. Ndali dhe iu drejtua një djaloshi me këmishë të kuqe që gogësinte.

- Është një që shet me të shoqen ja, këtu në qoshe, e dini?

- E ku t'i dish të tëra? - iu përgjigj djali, duke e matur me shikim Raskolnikovin.

- Po emrin si e ka, e di?

- Atë që i ka vënë prifti ka.

- Po ty nga të kemi?

- Djali ia nguli për të dytën herë sytë.

- I ardhur jam, lartmadhëri, veç nga ku... nuk e di. Ju kërkoj falje, zotëri...

- Po kjo këtu gjellëtore është?

- Jo, nuk është gjellëtore, është pijetore. Ka dhe bilardo. Po edhe ndonjë princeshë... e gjen.

Raskolnikovi çau sheshin mespërmes. Në një qoshe i ra në sy një grumbull me njerëz, ishin që të gjithë burra. Iu afrua dhe ua pa fytyrat. Ndjeu një dëshirë të madhe për të folur me të gjithë, por asnjeri nuk po ia varte, gumëzhinin dhe tundnin krahët. Qëndroi pak, u mendua dhe eci djathtas, në drejtim të V; pastaj, pasi la mënjanë sheshin, hyri në një rruginë...

Kishte kaluar jo një herë nëpër këto rrugica që prisnin shkurt. Kohët e fundit kjo i pat pëlqyer: kur e ndiente si po i përzihej, vinte në këto anë "që të villte!". Tani erdhi pa ndonjë mendim të përcaktuar. I doli përpara një godinë e madhe plot me mejhane dhe gjellëtore, pa të dilnin gra të veshura dosido, siç dalin vetëm sa për të shkuar deri te komshija. Në dy-tre vende pa grumbuj me gra pranë shkallëve që të çonin në dhomat e qejfit. Dëgjoheshin tingujt e muzikës dhe të ahengut frelëshuar, zëra e britma të hareshme. Pak më tutje ecte një ushtar me cigare në gojë e që i merreshin këmbët; dukej që donte të hynte diku, por s'po dinte ku. Një leckaman shahej e kacafytej me një tjetër si vetja, një i dehur qe shtrirë sa gjatë-gjerë në tokë. Raskolnikovi

ndali te grumbulli i grave. Këto jepnin e merrnin, duke folur me zë të ngjirur e duke e shoqëruar të folurit me gjeste, qenë të veshura me fustane basmeje, me këpucë të lehta, kokëjashtë. Kishte edhe dyzetvjeçare, por kishte edhe shtatëmbëdhjetëvjeçare, që të gjitha me gjurmë goditjesh në fytyrë.

I tërhoqi vëmendjen ahengu dhe britmat që vinin nga taverna. Dëgjoheshin jo vetëm të thirrura, këngë, tinguj kitare dhe kukurisma, por deri dhe përplasjet e këmbëve sipas ritmit të melodisë. I dëgjonte i përqendruar dhe i zymtë, pështetur pas shtalkut të derës e duke futur kryet për të parë ç'po ndodhte brenda.

Or djalosh, ore xhan vëllai
Mos më rrih se s'të kam faj!

I erdhi deri te veshi zëri i këngëtares. Ishte aq shumë i përqendruar, sa mund të thoshe se po vendosej atë çast fati i këtij njeriu!

"Të hyj? - mendoi. - Do më tallin, kur të më shohin. Janë të dehur. Po sikur edhe unë të dehesha si ata?".

- Pse s'hyni, more shpirt? - iu drejtua njëra nga gratë me një zë të kumbueshëm, të pangjirur akoma. Ishte e re dhe e mirkë.

- Sa e mirë qënke? - ia ktheu, duke e parë drejt në fytyrë.

Kjo vuri buzën në gaz, i erdhi përzemër komplimenti.

- Edhe ju i mirë jeni! - i tha.

- Kockë e lëkurë qënka! - vuri në dukje me zë të trashë një tjetër. - Mos ke ardhur drejt e nga spitali, djalosh?

- Jo çupa po kadëna janë! - u përzie në bisedë një muzhik çakërqejf, me një fytyrë të djersitur dhe të ënjtur. - Qejf, or qejf, që u bëka!...

- Pse nuk hyn?

- Po hyj. Qejf, or qejf!..

Zbriti shkallët. Raskolnikovi u largua.

- Zotëri i mirë, pse po ikni? - i thirri vajza.

- Si?

Kjo u hutua për një çast.

- Do ishte kënaqësi për mua ta kaloja kohën bashkë me ju, por edhe turp më vjen, që po ju flas kështu... Më falni gjashtë kopejka, të vete të kthej një gotë. Sa djalë i këndshëm që qënkeni!

Raskolnikovi nxori dhe ia dha sa i zuri dora: tri monedha pesëkopejkëshe.

- Sa zotëri bujar që qënkeni?

- Si e ke emrin?

- Kërkoni Duklidën, kur të vini.

- Po kjo kështu? Mos u ndërliq kjo, moj shoqeni? - pyeti njëra nga ato të grupit, duke tundur kokën qortueshëm. - Po shihni moj si i folka burrit të huaj?! As turp e as sedër nuk të ka!

Raskolnikovi e pa me kureshtje folësen: ishte një grua në të tridhjetat, me një fytyrë vrarëlije dhe blana nga goditjet, me buzën e sipërme të ënjtur. Fliste pa e prishur terezinë, dukej e bindur në ato që thoshte.

"Ku e kam lexuar, - vrau mendjen Raskolnikovi duke u larguar, - që një i dënuar me vdekje, një orë para ekzekutimit, thoshte me vete se po t'i duhej të jetonte në një lartësi të pazakontë, në majë të ndonjë shkëmbi të thepisur, ku të kishte vend vetëm sa për të vënë këmbët, ndërsa poshtë të ishte hon e greminë, oqean i tërbuar nga dallgët, furtunë e murlan i pa sosur dhe t'i duhej të jetonte kështu, në një vetmi të përjetshme, ja, në ato dy pëllëmbë toke të rronte përjetësisht, do të parapëlqente më mirë këtë jetë ferri e jo vdekjen... Një e vërtetë e madhe është kjo!... Ndryshe nuk ka si të jetë! Dikush edhe mund të jetë i poshtër, por jo më pak është ai që atë e cilëson të poshtër!" - mendoi.

U largua dhe doli në një rrugë tjetër. "Pa shih! "Pallati i Kristaltë!" Razumihini e kishte përmendur pak më parë në bisedën me Zosimovin. Po ç'pata në mendje të bëja?... Hë! Të shihja gazetat ç'shkruajnë... Zosimovi tha se kishte lexuar për rastin në gazetë. "

- Keni gazeta? - pyeti kur iu afrua një pijetoreje të madhe të mbajtur me merak, por që nuk kishte shumë klientë. Në njërën nga kthinat ishin ulur disa që pinin shampanjë. Raskolnikovit iu duk që mes tyre ishte edhe Zosimovi, por nuk mund ta shquante si duhej, sepse ishin larg.

"Qoftë!" - tha me vete.

- Ç'urdhëroni? - e pyeti kamarieri.

- Më sillni çaj. Edhe gazetat e katër-pesë ditëve të fundit mos harro të m'i sjellësh, do kesh bakshish!

- Si urdhëroni. Të sotmet ja ku i keni. Po vodkë nuk do pini?

Ia sollën gazetat dhe çajin. Zuri të kërkojë me sy: "Izler... actekët... masimo... Dreqi ju marrtë! ... Zjarr në Peski... Hë, ja!..."

E gjeti ç'ishte duke kërkuar, rreshtat i kërcenin para syve, por bëri si bëri dhe u përqendrua. I dridheshin duart. Pranë iu ul dikush. Ngriti kokën, pa Zametovin me unazën e madhe në gisht, me qostekun e bukur në jelek, me flokët e lyer me brilantinë, por me xhaketën disi të fërkuar dhe këmishën të zhubravitur. Dukej që ishte në qejf, i shkonin buzët vesh më vesh, i shkëlqente fytyra zeshkane nga shampanja e posapirë.

- S'më bënë sytë, ju qënkeni?! - e pyeti i habitur, por edhe me një familjaritet prej të njohuri. - Ndërsa Razumihini dje më tha që vazhdonit të ishit në kllapi. Çudi!... Kam qenë te ju...

Raskolnikovi e dinte që do t'i afrohej. La mënjanë gazetën dhe e ktheu fytyrën nga Zametovi. Ironia dhe padurimi s'kishin si të mos i binin në sy tjetrit.

- E di që keni qënë, - i tha. - Më keni futur në dorë ca rreckurina... Razumihini nuk ju lëshon nga goja... Më tregoi që keni shkuar edhe te Luiza Ivanovna, tek ajo, de, që e morët atëherë në mbrojtje... E po, e qartë ajo punë...

- Razumihini... është një sherrxhi ai që...

- Jetë, or jetë që bëni, zoti Zametov. Në ca vende të këndshme hyni si në shtëpinë tuaj... Po me shampanjë kush ju gostiti?

- Po... ja...hodhëm nga një gotë... Njomëm gurmazin...

- S'ka si qyli! - i tha dhe qeshi me të madhe. - Mirë bën, mor xhanan djalë! - shtoi dhe i ra supit. - S'e pata me të keq, e thashë ashtu, nga dashuria, njëlloj si kolegu që e pyeste Mitrin për çështjen e plakës...

- Po ju nga e ditkeni?

- Po unë ndoshta di më shumë nga ç'dini ju!...

- I çuditshëm jeni!... Ju vjen nga sëmundja... S'keni bërë mirë që paskeni dalë.

- Ju dukem i çuditshëm, hë?

- Po këto ç'i keni?

- Gazeta.

- Janë mbushur me njoftimet për zjarret.

- S'më interesojnë zjarret. - E pa duke i dhënë të kuptonte se ishte

duke ruajtur një të fshehtë dhe përsëri shtrembëroi buzët ironik. - Nuk më interesojnë zjarret, jo! - përsëriti dhe i shkeli syrin Zametovit. - Thoni të drejtën, jeni duke zjerë përbrenda nga kureshtja për të ditur ç'më interesonm në këto gazeta?

- Aspak. Ashtu kot ju pyeta... Pse,. ç'të keqe ka që ju pyeta? E ç'është kjo kështu me ju... që...

- Pa më dëgjoni pak: e di që jeni njeri me shkollë, që lini kokën pas letërsisë, kështu apo jo?

- Kam mbaruar gjimnazin, - iu përgjegj tërë dinjitet Zametovi.

- Ja pra! Sa mirë! Edhe flokët i lyen me brilantinë, myhyrët në gishta, qostekun e keni për merak, helbete, pasunar burri i botës! Djalë për t'u pirë në kupë! - Raskonikovi u shkreh në një të qeshur nevrasteniku mu në fytyrë të Zametovit. Ky u tërhoq pas jo ngaqë u fye, por i befasuar nga sjellja e këtij njeriu.

- Ç'njeri i çuditshëm! - përsëriti duke e parë i vrenjtur. - S'më dukeni në rregull... sesi jeni kështu...

- Si jam, hë? Dukem i çuditshëm, ë? Ju ngacmova kureshtjen!

- Po, ma ngacmuat.

- Domethënë doni të dini ç'po lexoja? Diç dyshoni, ë?

- E çë pastaj?

- I ngritët veshët i bëtë bigë?

- Jo, ç'ne?

- Më pas do ju flas për punën e veshëve, kurse tani, vëllaçko, më dëgjoni pak: "Unë do ju kallzoj, ju mbani shënim.." - kështu. Doni të dini ç'më intereson në këto gazeta? Për vrasjen e fajdexheshës interesohem, ja çfarë... - e tha me pështpërimë, duke e afruar fytyrën thuajse ngjitur me atë të bashkëfolësit. Zametovi e pa drejt në sy pa u kapsallitur dhe pa u zbythur para këtij shikimi të ngulitur... Zametovin e habiti sidomos fakti që ky shikim i ngulur dhe heshtja që e shoqëroi zgjatën jo më pak se një minutë.

- Po hë, de, ç'lexuat? - thirri kur iu sos durimi. - Mua kjo s'më hyn në qese, por sidoqoftë, tregoni.

- Po ja, fjala është për atë plakën, - vazhdoi Raskolnikovi po me pështpërimë, pa e larguar fytyrën edhe pas kësaj thirrjeje të Zametovit. - Kur dëgjova të flitej në zyrën tuaj, më ra të fikët... Hë, e kuptoni tani?

- E ç'u dashka që të kuptoj? - e pyeti Zametovi i alarmuar.

Fytyra serioze si e ngrirë e Raskolnikovit u transformua në çast dhe ai përsëri u shkreh në një të qeshur nevrasteniku, krejt i pafuqishëm për ta përmbajtur veten. Sakaq ndërmendi çastet e tmerrshme, kur qëndronte prapa derës me sëpatën në dorë, kur spërdridhej për lemeri rezeja, ndërsa ata, që qëndronin në anën tjetër, e shanin, duke e shtyrë me sa fuqi që kishin derën, dhe atij vetiu i lindi një dëshirë për t'u bërtitur, për t'i sharë e për t'i nëmur, për t'u nxjerrë gjuhën... Donte të qeshte, të qeshte, të gajasej së qeshuri!

- Ju o jeni i çmendur, o... - nëpërdhëmbi Zametovi dhe shtangu i shokuar nga mendimi që i gëloi atë çast në kokë.

- O çfarë? Hë, çfarë? Thuajeni, çfarë?

- Asgjë! - i ra shkurt Zametovi. - Gjepura janë!

Heshtën të dy. Pas atij të qeshuri histerik, Raskolnikovi qëndroi i menduar dhe i trishtuar. Vuri bërrylat mbi tryezë dhe mbështeti kokën në pëllëmbët e duarve. Dukej sikur kishte harruar që Zametovi ishte aty. Ndënji kështu një copë herë.

- Pse s'e pini çajin? U ftoh... - i foli Zametovi.

- Si? Hë po! Çaji!... Mirë... - Raskolnikovi gjerbi pak, vuri në gojë një kafshatë bukë, u sforcua ta mblidhte veten, duke e ditur që Zametovi ishte aty; fytyra i mori shprehjen e mëparshme, disi ironike dhe shpotitëse. Vazhdoi të pinte çajin.

- Dallavere e madhe ka plasur! - tha Zametovi. - Lexova para pak kohe në "Fletoren Moskovite" për një bandë batakçinjësh, falsifikues monedhash dhe obligacionesh.

- Po kjo nuk është e re! - iu përgjigj i qetë Raskolnikovi. - Si i quajtët? Batakçinj? - shtoi duke shtrembëruar buzët.

- Po ç'janë tjetër?

- Ata? Axhaminj janë, *blanc-bec*[1] janë e jo batakçinj. Bëhen si ndonja pesëdhjetë vetë, mblidhen kokë më kokë dhe, o burra! Po pse ashtu bëhen punët? Ata dhe tre veta në qofshin janë shumë, se i duhet zënë besë tjetrit njëlloj si vetes në kësi punësh. Njërit t'i shpëtojë një fjale në dehje e sipër dhe e pat! Thashë, *blanc-bec* janë! Ata edhe kalimtarit i besojnë: merr e shpërnda këto obligacione, i thonë! Po ta

[1]) *Buzëqumësht (fr.).*

zëmë se u shkoi mbarë dhe secili zuri një milion rubla. Po pastaj? Po jeta është e gjatë, asaj si i bëhet? Pse rrohet me frikën që ndonjëri mundet edhe të llapë? Më mirë litarin vetes në fyt dhe mbaron puna! Ata as për të shpëndarë nuk dinë: i japin dikujt pesë mijë, këtij duart i dridhen; numëron katër mijë rublat e para dhe i fut në xhep, të pestën e fut me ngut pa e numëruar, si t'ia mbathë sa më parë. E po, dihet ajo, një herë, dy herë dhe do lind dyshimi. U ndodhi një rrahje dhe i rrasën brenda! Punë pa mendje ajo e tyre!...

- Që u dridhen duart, kjo kuptohet, - ndërhyri Zametovi. - Se, helbete, ka edhe nga ata që s'e durojnë dot tendosjen e madhe; veç që mund të bëhet, mund të bëhet!

- Është i madh rreziku në kësi rastesh...

- Ja, ju, ndoshta, dhe e duroni tensionin, kurse unë jo! Për njëqind rubla shpërblim ta vësh kokën në trastë?! Të paraqitesh me para apo me obligacione false dhe ku pa, në bankë? Punonjësit e atjeshëm janë ujqër të vjetër në kësi punësh! Unë do ta kisha tradhëtuar veten. Po ju si?

Raskolnikovit i kaluan përsëri mornica, se përse ndjeu një dëshirë të papërmbajtur për "t'i nxjerrë gjuhën".

- Të kisha qenë unë, do bëja ndryshe, - e hodhi fjalën larg e larg. - Do ta numëroja mijëshen e parë, si jo pak por katër herë, duke e parë në dritë çdo kartëmonedhë; do hidhesha pastaj te mijëshja e dytë, do ta çoja numërimin deri në mes, do nxirrja nga tura një pesëdhjetë rubëlshe, do ta shihja mirë e mirë në dritë, kthe andej e kthe këtej, mos nuk qe në rregull. "Më ka marrë frika, - do thosha, - një fisi im i lau duart nga një njëzet e pesë rubëlshe, i doli false!" Do t'i tregoja mënge si i ndodhi. Kur t'i kthehesha mijëshes së tretë: "Të më falni, - do t'u thosha, - në mijëshen e dytë, më duket, në qindshen e shtatë, kam bërë gabim". Do t'i kthehesha asaj ture dhe kështu deri sa të mbaroja. Pasi t'i kisha numëruar mirë e bukur, do nxirrja nga mijëshja e tretë ndonjë kartëmonedhë, përsëri do ta dridhja dhe spërdridhja në dritë, plot dyshime. "Ma këmbeni, ju lutem, - do t'u thosha, - ja, këtë! "Do t'ia merrja shpirtin arkëtares, kjo do bënte çmos që të më hiqte qafe. Pasi të kisha mbaruar punë, do shkoja deri te dera, do ta hapja paksa, por do kthehesha përsëri, do pyesja për diçka, do dëgjoja me gjakftohtësi shpjegimin.. Ja, kështu do bëja!

- Gjëra të tmerrshme thoni! - i tha Zametovi me buzën në gaz. - Është kollaj me fjalë, por po ta bënit, me siguri, që do ngecnit gjëkundi. Se jo unë e ti, por edhe batakçiu më i regjur nuk ka si të jetë qindpërqind i sigurt në çdo gjë. Se, pse të shkojmë larg, të marrim këtë rastin tonë: e vranë plakën, fajdexheshën, një vrasës i çartur ka qenë, në ditën me diell e vrau, risku ka qenë i madh, vetëm për çudi ka mundur të shpëtojë, por ama duart i janë dridhur që ç'ke me të, për të vjedhur asgjë nuk ka arritur të vjedhë, i ka munguar guximi, duket ajo.

Raskolnikovi u shtir si i fyer.

- Duket ajo... thoni! Pa shko e kape, pa? - thirri jo pa ligësi e me ton ngasës ndaj Zametovit.

- Për të kapur, thoni? Patjetër që do ta kapin!

- Kush? Ju do ta kapni? Pa hë, de! Ju vetëm një gjë shihni: mos po shpenzon para ky apo ai më shumë nga mundësitë që ka? E nga i gjeti? Juve edhe foshnja ua hedh!

- Ashtu bëjnë, e vërtetë është! - tha Zametovi. - E lënë shallagan tjetrin dhe drejt e në mejhane. Si cjapi te kasapi thuaj! Se, sigurisht, nuk mund të jenë që të gjithë aq të rafinuar si ju! Ju nuk do shkonit drejt e në mejhane, duket ajo!

Raskolnikovi u vrenjt dhe e pa bashkëfolësin drejt në sy.

- M'u duk se ju pëlqeu ajo që ju tregova, ndoshta dëshironi të dini si do të veproja unë në rastin që sapo përmendët? - e pyeti, duke futur nuanca mërzitje në zë.

- Po, do ma kishte qejfi, - me zë të prerë dhe serioz iu përgjegj ky. Ia kishte ngulur shikimin hetues dhe po e zhbironte.

- Shumë?

- Shumë.

- Mirë. Ja si do kisha vepruar. - Raskolnikovi, duke e afruar, thuajse duke e ngjitur fytyrën tek ajo e tij, siç pati bërë pak më parë, e pa ngultas dhe i foli me pëshpërimë në një të tillë mënyrë, që Zametovi u rrëqeth. - Ja si do kisha vepruar: do t'i merrja edhe paratë, edhe sendet me vlerë e do të shkoja në një vend të shurdhët, ku ka vetëm gardhe e mure, dhe s'të sheh syri këmbë njeriu, do gjeja një vend të fshehtë, ndonjë gur të madh diku në ndonjë qoshe, në gropën që do formohej do i groposja ato sende... do ta vendosja përsëri në vend gurin, do ta ngjishja me këmbë dheun rreth e rrotull dhe do largohesha si të mos

kishte ndodhur gjë. Një vit, dy, nuk do t'i ngisja edhe tre vjet do duroja, shko e gjeje, të kam rixha, pas kësaj vrasësin! Asnjë gjurmë, asnjë shenjë!..

- Jeni fare i çmendur! - i foli Zametovi po me pështpërimë dhe u zbyth. Raskolnikovit i shdrinin sytë, i kishte rënë çehre e vdekjes, i dridheshin buzët. Anoi sa mundi më shumë nga Zametovi dhe lëvizi buzët pa nxjerrë kurrfarë zëri: kështu bëri nja një gjysmë minute. Ishte i vetëdijshëm për atë që po bënte, por ja që s'e përmbante dot veten. Ashtu si atëherë prapa derës, kur i ngeci në grykë fjala e tmerrshme, atëherë kur rezeja kërcente e hovte për lemeri, edhe tani i ngeci në buzë. Ja tani, do ta thoshte, s'po e mbante dot më!

- Po sikur t'i kem vrarë unë, plakën dhe Lizavetën? - shqiptoi si në makth dhe sakaq erdhi në vete.

Zametovi e pa i çmeritur, i zbehur, i shtangur. Fytyrën ia shtrembëroi një buzagaz i kithtë.

- E pamundur! - nëpërdhëmbi.

Raskolnikovi e pa me inat de ligësi.

- Më thoni të drejtën: e besuat? Hë, e besuat?...

- Aspak! Tani më fort se kurrë nuk e besoj! - foli nguturazi Zametovi.

- Pra, ju shpëtoi llafi; thatë: "Tani më fort se kurrë nuk e besoj!". Domethënë para kësaj paskeni dyshuar?...

- Unë? Kurrë! - ia ktheu i hutuar. - Se ju prandaj dhe deshët të më trembnit, për të më bërë këtë pyetje!..

- Nuk e besokeni? Po kur dola atëherë nga zyra, për çfarë biseduat? Po pyetjet e rreshter Porohut pas alivanit, ç'ishin?... Hej!... - i thirri kamerierit, duke u çuar dhe duke marrë kapalen. - Sa duhet të paguaj?

- Tridhjetë kopejka, - iu përgjigj ky.

- Njëzet kopejkat e restos mbaji për vete! E sheh sa para kam? - zgjati dorën që i dridhej me kartëmonedhat shtrënguar në drejtim të Zametovit. - Të kuqërreme, kaltëroshe, plot njëzet e pesë rubla janë. Ku i gjeta, thoni ju? Po këtë veshje nga e psonisa? Se ju e dini që jam pa një grosh! E dini nga qiramarrësja!... Po t'i lëmë këto... *Assez cause!*[1] Mirupafshim!

---

[1]) *Mjaft llapëm! (fr.)*

Doli duke u dridhur nga ca shkulme histerie, që i vinin hope-hope, të shoqëruara me doza kënaqësie të padurueshme, torturuese: doli i zymtuar, fare i kapitur, mezi po qëndronte në këmbë. Fytyra i qe shtrembëruar, siç u ndodh epileptikëve në kohë krizash. Një vrull force, që e pat vërshuar pak më parë, tani e kishte braktisur, ishte i këputur dhe sa më shumë që i dobësohej ajo ndiesi e paradokohshme, aq më tepër e linin forcat.

Ndërsa Zametovi ndenji dhe jo pak i menduar, ishte si i shokuar. Raskolnikovi ia kishte trazuar keq mendimet, por edhe ia kishte përforcuar bindjen përfundimtare: "Ilia Petroiviçi ishte një hajvan!".

Te dera e jashtme Raskolnikovi u përplas me Razumihinin. E matën shoshoqin me shikim të habiturish, por s'kaloi shumë dhe furia e tërbimit buisi ne sytë e shokut.

- Ja ku qënke! - thirri me sa i hante zëri. - Nga shtrati dhe drejt e ne rrugë! Kurse unë ku s'të kam kërkuar, edhe nën kanape pashë mos ishe futur! Sa s'e rraha Nastien për qejfin tënd... Ja ku na qenka, Rodka!... Ç'domethënë kjo, folë!

- Kjo domethënë që të gjithë ju ma sollët në majë të hundës qumështin e nënës... - fare i qetë iu përgjigj Raskolnikovi.

- Dhe paske dalë fill i vetëm, pa shoqërues? Dhe kur, në një kohë që as të ecësh nuk je në gjendje, kur fytyrën e ke si të alipsanit, kur mezi merr frymë! I çmendur je!... Po në "Pallatin e Kristaltë" ç'kërkove? Fol!...

- Lermë! - i tha Raskolnikovi duke bërë të ecte më tutje. Razumihini u tërbua fare, e përmblodhi dhe e shtrëngoi fort nga supet.

- Të lë? Lërmë, the? Si ta nxuri goja këtë? Po a e di se ç'të bëj? Të ngre hopa, ja, kështu si je dhe drejt e në shtëpi, derën me kyç!

- Dëgjo, Razumihin! - i foli me zë të mbytur, por në dukje i qetë Raskolnikovi. - Si s'e ke kuptuar që s'më lypset fare ky përkujdesi yt! E ç'kënaqësi qënka të përkujdesesh për një që, jo vetëm nuk ta di për nder, por, përkundrazi, bezdiset nga kjo... Më shumë se e bezdis, e rëndon ky pekuli yt! Ja, ç't'u desh që më kërkove ku banoja ne zyrën e adresave? Se ku e di ti, ndoshta, për mua do të kishte qenë më mirë të vdisja! Pse sot a nuk ta bëra të qartë se me këtë përkujdesjen tënde je duke ma trefishuar vuajtjen?.. Se unë ta thashë troç: nuk të duroj dot! E ç'qejf e ç'kënaqësi na qënka të torturosh tjetrin? Po ta përsëris:

kjo që po bën, është duke ma rënduar më keq gjendjen e sëmurë në të cilën ndodhem!.. Ja, Zosimovi doli që të më linte të qetë, ndiq edhe ti shembulln e tij. Se të pyes: kush ta dha këtë të drejtë të më mbash me forcë? Si s'e kupton që të kam folur dhe po të flas, duke qenë krejt i vetëdijshëm për të gjitha. Më mëso, me ç'lutje dëshiron të të drejtohem, që të më lësh të qetë në hallin tim... Në daçi, më quani bukëshkalë, të poshtër e ç'të doni tjetër, veç, paçi perëndi, hiqmuni, më lini në punën time...

Raskolnikovi e kishte nisur i qetë ligjërimin, që më parë kishte shijuar ëndjen e helmit që do derdhte, por e përfundoi fare i çartur. Dridhej si ndër ethe, mezi mbushej me frymë.

Razumihini qëndroi një hop i menduar dhe ia lëshoi dorën.

- Thyej qafën! Në esfel vafsh! - i tha ngadalë. - Prit! - ulëriti kur e pa që Raskolnikovi po largohej. - Jeni ca të pështirë, ca ligavecë ju, që aman o Zot! Sajoni ndonjë vuajtje dhe e ngrohni nën vete si pula vezët! Edhe në këtë pikë jeni duke vjedhur autorët e huaj. S'keni kurrfarë mendimi personal! S'je ti i pari që po e bën, nuk je aspak origjinal, nga të tjerët e ke mësuar! Ju s'keni gjak në deje, keni ujë në vend të gjakut! Asnjërit nga ju nuk i besoj! Se juve vetëm për një gjë ju ha meraku: si të silleni që të mos ngjani me të tjerët!... Prit! - i bërtiti me një tërbim të dyfishuar, kur e pa që Raskolnikovi s'i ktheu përgjigje, por po bëhej gati të vazhdonte rrugën. - Më dëgjo ç'do të them: ti e di që sonte kam darkë, kam lënë xhaxhanë të pres mysafirët, e pra, në s'të kanë lënë ende trutë, në s'je humbameno njeri, në s'je edhe ndonjë nga ata monstrat që vetëm sa imitojnë të huajën, vjen dhe e kalon tek unë këtë mbrëmje, është më mirë se të matësh me pëllëmbë xhadenë. Të njoh unë ty, je me një okë mendje... Dole që dole, kthe andej nga unë. Do të të ul në kolltuk, do të të qeras me çaj, të të njoh me shokët... në s'do, të shtroj jatakun dhe këputja gjumit, sidoqoftë mes njerëzish do jesh... Do jetë dhe Zosimovi... Hë, si thua, do vish? Të presim?

- Jo.

- Kot e ke! - iu hakërrua Razumihini. - Se ta shoh gjendjen, nuk mund të përgjigjesh për veten. Behot njeri je. Se edhe mua më ka rastisur të bëj kështu si bën ti, të sikteris e të nëm të tjerët, por më pas kam qenë i detyruar ta lëpij pështymën time... E pra, të mbulon turpi

dhe do s'do je i detyruar të kthehesh përsëri tek ai që e lë përsëdytur. Mendohu njëherë, adresa: Godina e Poçinkovit, apartamenti dyzet e shtatë, kati i tretë.

- Me ç'po shoh, zoti Razumihin, qënkeni gati të pranoni rrahjen, veç të mos ju heqin kënaqësinë që ju jep bamirësia!

- Si? Ti për mua e the këtë? Kur më shkrep një gjë, as dreqi nuk ma heq dot nga koka! Po ti atë shiko, mbaje mend: Godina e Poçinkovit, apartamenti dyzet e shtatë, kati i tretë..

- Nuk vij! - Raskolnikovi i ktheu krahët dhe u largua.

- Vë bast që do vish! - i thirri pas Razumihini. - Ndryshe, me mua prishe... Dëgjo, hej!... Po Zametovin ta zuri syri?

- Aty e ke.

- E takove?

- E takova.

- Fole me të?

- Fola.

- Për çfarë folët? Po, nejse, po s'deshe mos më trego. Poçinkovi, dyzet e shtatë, mos harro!

Raskolnikovi doli në sheshin Sadovaja dhe ktheu në një bërryl rruge. Razumihini e ndoqi me sy i menduar. Pastaj tundi dorën dhe hyri në pijetore, por ndaloi në mes të shkallëve.

"Dreq o punë! - belbëzoi. - Për të folur flet si të gjithë, por edhe që nuk është në terezi, duket... Sa budalla që jam! Po pse të lojturit nuk flasin si të gjithë? Ndërsa Zosimovi, m'u duk se, pikërisht kësaj i trëmbet! - I ra ballit me pëllëmbë. - Po në qoftë se... po pse lihet vetëm? Po ai edhe mund të mbytet; edhe marrëzi të tjera mund të bëjë... Mora zjarr kot së koti!... Jo, nuk lihet vetëm!" U turr me vrap pas Raskolnikovit, por s'ia zuri kund syri. Pështyu dhe me hap të shpejtë u kthye në "Pallatin e Kristaltë". Donte të pyeste Zametovin për çfarë kishin biseduar.

Raskolnikovi ndoqi rrugën për në urën N., ndali në mes të saj, u mbështet me bërryla në parmakët dhe e treti larg shikimin. Pasi qe ndarë nga Razumihini, ndjeu një pafuqi të mrekullueshme, sa mezi qe zvarritur gjer këtu. Kishte një uri të padurueshme, ishte gati të shtrihej aty ku ishte. U përkul mbi ujë, ia hodhi sytë perëndimit të diellit, grumbullit të shtëpive që mezi shquheshin në mugëtirën

mbrëmësore, shqoi një dritare papafigoje diku në bregun e majtë, që rrezëllinte si e përflakur nga zjarri, ishin rrezet e kuqe të diellit që po perëndonte ato që e përflaknin asisoj, pastaj e kaloi shikimin në rrudhat e ujit, ku lodronin rrezet e kuqërremta. Sytë iu lëbyrën, i dolën përpara ca rrathë të kuq, pirgje shtëpish, kalimtarë, karroca; gjithçka përdridhej e vërtitej si në një valle të çmendurish. U drodh, ndoshta e shpëtoi rishtas nga alivani një vegim krupndjellës, i llahtarshëm: dikush i qëndroi pranë nga e djathta; ktheu kryet, ishte një grua shtatlartë, me shami në kokë, me një fytyrë të hequr, me sy të skuqur e kapakë të rënduar. Ia kishte qepur shikimin, por, me sa dukej, asgjë nuk shquante. U mbështet me dorën e djathtë, kaloi këmbën e djathtë mbi parmak, pastaj ngriti të majtën dhe u hodh në ujë. U krijua një gjeratore e vogël që e përpiu në çast viktimën, por s'kaloi shumë dhe gruaja u duk mbi ujë, i cili po e çvendoste në rrjedhën e tij. Kokën dhe këmbët i kishte të zhytur, kurse shpina i dukej në sipërfaqe, fundi i qe fryrë si ndonjë jastëk.

- Po mbytet! Shpejt! Po mbytet! - thirrën dhjetra zëra. U mblodhën njerëz. Raskolnikovi u gjend i rrethuar nga të katër anët, zunë ta shtynin e ta ndrysnin.

- O Zot! Po qenka Afrosinjushka kjo! - u dëgjua të thotë një zë gruaje. - Ndihmë! Njerëz të mirë, shpëtojeni!

- Një varkë! Shpejt një varkë! - thirrën disa.

Por doli që varka ishte e panevojshme. Një polic zbriti shkallët e daljes në ujë, hoqi xhaketën dhe këpucët dhe u hodh. Nuk u mundua shumë: e mbytyra qe fare pranë, rrjedha po e afronte gjithë më tepër. E kapi nga rrobet me dorën e djathtë, me të majtën shtriu hurin që i zgjati një shok dhe zuri ta nxirrte të gruan. E shtrinë mbi pllloçat e shkallëve. Ajo u përmend shpejt, lëvizi, u ul ndënjur dhe zuri të tështijë, të gromësijë, të kollitet pa e kuptuar ende ç'i kishte ndodhur. Nuk nxori nga goja asnjë fjalë.

- Ja ku e çoi vodka, vëllezër! - thërriste po ai zë gruaje. - Provoi një herë të varej, e shpëtuan në çastin e fundit. Dola pak për të bërë pazar, i lashë mbesollen që të ma shihte, kurse kjo ja se ç'bëri! Jemi komshije me të...

Njerëzit zunë të shpërndaheshin. Policët dhanë e morën edhe një kohë me viktimën... Raskolnikovi e ndiqte tërë këtë skenë i pushtuar

nga ca ndjenja të çuditshme indiferentizmi dhe shpërfilljeje. Po e mbyste neveria.

"Jo, uji... të ndjell krupën... s'është gjë.. - mërmëriste. - S'kam për ta bërë.. S'kam pse rri më këtu.. Në zyrat e policisë... Zametovin atje kam për ta gjetur... Deri në ora nëntë hapur janë..." U kthye me shpinë nga parmakët dhe pa përreth.

"Ashtu po bëj... po shkoj..." - belbëzoi i vendosur dhe u çapit në drejtim të zyrave të policisë. Në zemër kishte një boshësi dhe ndiente një si shtarje. Për asgjë nuk donte të mendonte. As pikëllim nuk po kishte më, as shenjën më të vogël të energjisë dhe të vrullit nuk ndiente. E pra, nga dhoma kishte dalë me mendimin e prerë që t'i jepte fund njëherë e mirë kësaj gjendjeje. E kishte vënë përfund apatia dhe shpërfillja.

"Ka një rrugëdalje! - shtoi sakaq, duke u çapitur i kapitur nëpër bregun e lumit. - Do t'i jap fund jetës se kështu dua!... Po, vallë, kjo është rrugëdalja? Të bëhet si të bëhet! Do gjendet pesë pëllëmbë dhé edhe për mua!.. Po pse, më erdhi vërtet fundi? Të paraqitem apo të mos paraqitem?... Në djall vaftë!... S'po më mbajnë këmbët.. Të ulem pak, të shtrihem pak... Marrëzi po bëj! Po më pëlcet koka nga mendimet!... Të dalë ku të dalë...".

Për të shkuar në zyrat e policisë, duhej ecur drejt, pastaj një kthim majtas. Nuk ishte larg. Me të arritur kthesën, ndaloi, u mendua, ktheu në një rrugicë dhe u doli zyrave nga një drejtim tjetër. Ende nuk kishte një qëllim të përcaktuar qartë, e bënte, me sa dukej, për të fituar ndopak kohë. Kokën e mbante të varur në kraharor. Atë çast iu bë sikur i belbëzoi dikush në vesh. Ngriti kokën dhe pa që ishte përpara asaj shtëpije. Që nga *ajo* mbrëmje nuk kishte qenë këtu. Një dëshirë e pashpjegueshme, e papërballueshme e shtyu të kthente. Hyri në oborr, ktheu nga e djathta dhe zuri të ngjiste shkallët aq mirë të njohura. Ishte errësirë e madhe. Ndalonte në çdo kthesë të shkallëve dhe shihte i përqendruar. Dritarja e një apartamenti të katit të parë ishte e hequr fare: "Atëherë kjo ishte në vend", - tha me vete. Ja dhe apartamenti i katit të dytë, ai që po lyenin Nikollai me Mitrin: "Qënka i mbyllur, derën sapo e kanë lyer, u dhënka me qera", - mendoi. Kati i katërt... "Këtu!" - belbëzoi. Qëndroi në mëdyshje: dera e apartamentit ishte e hapur, kishte njerëz brenda, dëgjoheshin zëra; s'e priste

t'i ndodhte kështu. Pas një lëkundjeje të vogël, i ngjiti dhe dy shkallinat që i kishin mbetur, dhe hyri në apartament.

Po e meremetonin dhe po e lyenin, kjo e habiti pa masë. As vetë nuk e dinte përse pat menduar që do ta gjente ashtu si e kishte lënë atë ditë, madje edhe kufomat do të ishin në vendet e tyre. E çuditën këta mure të zhveshur, dhomat pa mobiljet. Iu afrua dritares dhe u ul në parvaz.

Po punonin dy djem të rinj, ishin duke veshur muret me letër të re, të bardhë me lule lejla. Raskolnikovit kjo s'i pëlqente fare, i pa i vrenjtur, ndjeu një keqardhje të madhe që nuk ishte më veshja e atëhershme.

Punëtorët nguteshin, ishte vonë. Edhe pse e panë të panjohurin, nuk e ndërprenë bisedën e nisur. Raskolnikovi kryqëzoi krahët në gjoks dhe po i dëgjonte.

- Më vjen, që the ti, pa gdhirë, - i tregonte më i moshuari shokut, - e veshur dhe e rregulluar! "E ç'më qënke stolisur kështu? - e pyes. - Ç'më qënke pispillosur?" "Unë, - më thotë, - Tit Vasiljeviç, të dorëzohem, ja, kështu si jam!". Hë, ç'i thua kësaj? E veshur dhe e rregulluar, që thua ti, si në kartolinë!

- Pse si qënkan në kartolinat? - e pyeti tjetri, më i riu.

- Po të lyera e të stolisura janë, si puna e atyre që venë çdo të shtunë te modhistrat. S'i ke parë? Se ti e di, ka rrobaqepësa për burra por ka edhe modhistra për gra... Pikturë janë... Se ata të burrave si njerin-tjetrin i veshin, kurse ato të grave, të tilla bukuri sajojnë or të keqen, që të luan tepeleku i kokës, kur i sheh!

- E ç'nuk ka këtu në Petërburg! - Ia ktheu i vetëkënaqur shoku. - Vetëm nënë e babë nuk ka, sa për të tjerat, të gjitha janë!

- Mirë e the, përveç tyre, të gjitha janë! - e mbështeti shoku i moshuar.

Raskolnikovi u ngrit dhe shkoi në dhomën tjetër; aty kishte qenë krevati dhe komoja; pa mobiljet dhoma iu duk tmerrësisht e vogël. Muret vazhdonin të ishin të veshur me letrën e atëhershme, binte në sy sidomos vendi me vetratën ku ishin ikonat. Pa dhomën dhe u kthye përsëri te dritarja. Njëri nga punëtorët po ia ndiqte lëvizjet me bishtin e syrit.

- Mos doni gjë? - e pyeti.

Në vend që t'i përgjigjej, Raskolnikovi lëvizi, doli në korridor dhe zuri t'i bjerë ziles. Ishte po ajo zile, u dëgjua po ajo tringëllimë metalike. I ra edhe një herë, edhe një herë tjetër, i vuri veshin atij tringëllimi, ndërmendi gjithë ç'lidhej me të. Provoi përsëri po atë makth të tmerrshëm, të llahtarshëm, si atëherë: pas çdo tringëllimi rrëqethej, zemra i bëhej akull e nga kjo gjithë më tepër ndjente kënaqësi.

- Po ç'kërkoni këtu? Kush jeni? - i thirri njëri nga punëtorët dhe iu afrua. Raskolnikovi hyri përsëri brenda.

- Dua të marr me qera këtë apartament, - i tha. - Po e shoh.

- Këto punë nuk bëhen natën, pale pastaj që duhet të vini bashkë me rojen...

- E paskeni larë dyshemenë; do ta lyeni me çerë? - vazhdoi të tijën Raskolnikovi. - S'do të ketë më gjurmë gjaku?

- Ç'gjak?

- Po këtu plakën me të motrën i vranë. Ka qenë një goxha pellgaçe gjaku këtu...

- Po zotrote kush na qënke kështu? - iu drejtua me një si shqetësim në zë punëtori.

- Unë?

- Po.

- Do ta dish?.. Shkojmë në polici, atje ke për ta dëgjuar.

Punëtori e pa i habitur.

- Dalim, Aljosha. Boll me kaq për sot... Mbylle derën, - iu drejtua shokut.

- Shkojmë! - i tha Raskolnikovi fare i qetë dhe doli i pari, po i pari zuri të zbresë shkallët. - Hej, roje! - thirri, kur doli në oborr.

Para shtëpisë qëndronin mënge disa njerëz, mes tyre edhe të dy rojet, një grua dhe një dyqanxhi. Raskolnikovi eci në drejtim të tyre.

- Ç'urdhëroni? - e pyeti njëri nga rojat.

- Ishit sot në zyrat e policisë?

- Që andej po vij. Po juve ç'ju duhet?

- Ka njerëz tani aty?

- Ka.

- Po zëvendës shefin e patë?

- E pashë. Po ju ç'punë keni?

Raskolnikovi nuk i ktheu përgjigje, qëndroi i menduar.

- Ka ardhur për të parë apartamentin, - tha duke u afruar punëtori.

- Ç'apartament?

- Atë që po meremetojmë. "E paskan larë gjakun, - më tha. - Ka ndodhur një vrasje këtu. Dua ta zë me qira këtë hyrje". I ra ziles, por jo një herë, na shurdhoi fare! Shkojmë në polici, na tha, atje do t'i them të gjitha...

Roja pa i vrenjtur dhe me dyshim nga Raskolnikovi.

- Ju kush jeni? - iu hakërrua.

- Emrin e kam Rodion Romanoviç Raskolnikov, ish-student, banoj në shtëpinë e Shilit, jo larg që këtej, apartamenti katërmbëdhjetë. Pyete rojen.... më njohin të gjithë. - Foli përtueshëm, i menduar, pa parë njeri drejt në sy, me fytyrën kthyer nga rruga që kishte filluar të sterronte.

- Po në atë apartement ç'kërkuat?

- Desha ta shihja.

- E ç'të shihnit?

- Mos e zgjatni, merreni e çojeni drejt e në polici! - ndërhyri në bisedim dyqanxhiu.

Raskolnikovi e pa që nga supi tërë inat dhe tha me zë të ulët e përtueshëm:

- Shkojmë!

- Të thashë, mos e zgjat! - përseriti dyqanxhiu. - E ç'punë e paska çuar *atje*? Diç bluan në veten e tij ky njeri!

- Se i dehur ky nuk është! Një dreq e di ç'do! - belbëzoi punëtori.

- Ju ç'kërkuat aty? - i thirri roja, që tani dukej tepër i zëmëruar. - Pse keni ardhur?

- Nuk ma mbajti të vija drejt e në polici... - nëpërdhëmbi Raskolnikovi dhe u zgërdhesh.

- S'ta mbajti?... Ç'flet kështu, more?

- Ndonjë greps është! - tha gruaja.

- E ç'e zgjatni dhe e bëni tërkuzë llafin?... - ndërhyri roja tjetër, një muzhik bojalli me kyçet në brez. - Të thyej qafën, atë të bëjë!..

E mbërtheu Raskolnikovin nga supet dhe e shtyu në drejtim të rrugës. Këtij iu morën këmbët, por u mbajt, nuk ra, pastaj drejtoi trupin, ia nguli shikimin njerëzve dhe eci më tutje.

- Njeri i çuditshëm, - mërmëriti punëtori.

- Ka shumë tani nga këta! - tha gruaja.

- Ai njeri duhej çuar në polici, - s'la pa thënë edhe një herë dyqanxhiu.

- E ç't'i hapnim punë vetes? - e kundërshtoi bojalliu. - Dukej që nga grepsit ishte! Ngatërrohesh me ca si këta, or byrazer, dhe hajt të shqitesh pastaj... Punë dreqi ajo!

"Si të bëj: të shkoj apo të mos shkoj?" - tha me vete Raskolnikovi, që kishte qëndruar në mes të xhadesë, atje ku kryqëzoheshin rrugët. Shihte rretherrotull si të priste nga dikush fjalën e fundit, por asgjë e tillë nuk po ndodhte; heshtje varri nga të katër anët... Në thellësi të rrugës, si nja dyqind metra më tutje, në errësirën që sa vinte e bëhej më e thellë, pa një grumbull njerëzish, dëgjoi britma. Që aty arriti të shquante vagull një karrocë, vezulloi edhe një dritë. "Ç'të ketë ndodhur?" - pyeti veten. Nxitoi hapin në drejtim të njerëzve. Dukej sheshit që e gëzoi rasti për t'u kapur pas diçkaje, edhe pse brenda vetes e kishte marrë vendimin, për t'u paraqitur në polici. Nënqeshi hidhur kur e kapi veten duke menduar dhe veproi ndryshe.

VII

Në mes të rrugës kishte ndaluar një pajton zotërie, tepër luksoz, i mbrehur me dy kuaj race; zotërinjtë nuk ishin, karrocieri kishte zbritur nga pupeja dhe mbante kuajt për freri. Njerëzit shtyheshin të shihnin, kishte edhe policë. Njëri prej tyre mbante në dorë një fener, me të cilin ndriçonte vendin e ngjarjes, duke kërkuar diçka nën rrotat e karrocës. Bërtisnin, çirreshin, ofshanin dhe tundnin krahët; karrocieri i shihte i trëmbur e i hutuar dhe thoshte:

- Gjynah! Gjynah nga perëndia!

Raskolnikovi u shty dhe mundi të shohë shkaktarin e kësaj kureshtje: në xhade shtrihej sa gjatë gjerë një njeri që e kishte shtypur karroca. Veshjen e kishte të fërkuar dhe të lyer krejt me gjak, por dukej që ishte "nga fisnikët". Edhe fytyrën, edhe kokën e kishte të mbuluar nga gjaku, dukej që ishte copërlyer mosmëkeq.

- O Zot! - u qahej karrocieri të pranishmëve. - E ku ta shohësh tjetrin, kur të futet si pa gjë të keq nën rrota? Thirra e thirra sa u

ngjira, edhe shpejtësi po nuk kisha, se isha pa ndonjë ngut. E panë të gjithë! Ja, ç'të thonë ata që e panë, ashtu dhe është! Mos ka qenë i dehur, se u fut vetë nën rrota! E vura re që po çante mespërmes rrugën, i merreshin këmbët, ecte si ai që tregojnë: bie këtu bie aty, i thirra që të kishte mendjen, për herë të dytë, për herë te tretë i thirra, kurse ai të tijën; i mbajta kuajt, kurse ai ashtu çalë-çalë bënte të vetën, drejt e nën rrota u hodh! Po kësaj ç't'i thuash! Dukej që e bëri me dëshirën e tij ose ngaqë ishte i dehur, nuk dinte as vetë ç'bënte... Kuajt po u trembën, janë dhe të pamësuar sa duhet, e tërhoqën zvarrë. Ja, po e shihni vet, u bë e keqja...

- Ashtu si thotë qe, - u dëgjuan zëra nga gjindja.

- I thirri e i bërtiti sa u ngjir, dhe jo një herë, por tri herë radhazi, - i doli krahë karrocierit dikush nga të pranishmit.

- Tri herë i thirri, e dëgjuam të gjithë..., - u bashkua me të parët edhe një tjetër.

Karrocieri nuk ngjante i frikësuar. Me sa dukej, karroca i përkiste ndonjë zotërie të dëgjuar, tek ai po shkonte. Edhe policët dukeshin të interesuar që ta mbyllnin një orë e më parë këtë mesele. Duhej hequr sa më parë i aksidentuari dhe duhej çuar në spital. Askush nuk e njohu. Raskolnikovi u afrua dhe u përkul që ta shihte më mirë. E njohu.

- E njoh unë! - thirri dhe doli para të gjithëve. - Marmelladov quhet, një ish-nëpunës është! Banon këtu afër, në godinën e Kozelit... Shpejt ta çojmë në shtëpi! Kush ndihmon, do të shpërblehet! Ja! - Nxori nga xhepi paratë dhe ua tregoi policëve. Këta po e shihnin të habitur. Raskolnikovi u tha kush ishte, u tregoi adresën, pa u vonuar zuri të përkujdesej si për babanë e vet; u tha ta ngrinin sa më shpejt, të njoftonin njerëzit e familjes.

- Shtëpinë e ka këtu afër, nja tri ndërtesa më tutje, - u thoshte. - Në godinën e gjermanit banon, Kozel quhet... Do ketë qenë i dehur, ka qenë duke u kthyer në shtëpi... E njoh mirë. E ka ves pijen.. ka grua dhe fëmijë, ka edhe një vajzë të rritur. Më ndihmoni, do t'ju shpërblej... Ka rrezik të vdesë, nga që i ka ikur shumë gjak... As deri në spital nuk ka për të duruar... Më mirë e çojmë në shtëpi.

Pa u vënë re nga të tjerët, i futi diçka nën dorë policit që ishte më pranë. Të aksidentuarin e ngritën, shtëpia s'ishte më shumë se pesëdhjetë hapa më tutje. Raskolnikovi shkonte mbrapa dhe i mbante

me kujdes kokën.

- Ja, këtu ktheni! Kujdes, nëpër shkallë duhet ngjitur, duke ia mbajtur kokën lart, rrotullohuni... Ja, kështu! Nuk u lë pa ju shpërblyer!

Katerina Ivanonvna, si gjithmonë kur nuk ishte e zënë me punë, ecejakte nëpër dhomë, nga dritarja te soba, nga soba te dritarja. I kryqëzonte krahët në kraharuar dhe kohë pas kohe kollitej. Të gjitha hallet dhe dertet i ndante me vajzën e madhe, Polenjkën dhjetëvjecare, e cila edhe pse s'i merrte vesh shumë gjëra, e kishte kuptuar mirë një gjë: i nevojitej shumë së ëmës, ndaj me sytë e mëdhenj, të mençur ndiqte çdo lëvizje të saj dhe arrinte ta bindte mamanë që i kishte kuptuar të gjitha. Ishte duke u përkujdesur për vëllanë e sëmurë, po e zhvishte që ta vinte në gjumë. E kishte ulur në karrige dhe ky rrinte me trupin gargi, me buzët pak të fryra, sytë e hapur e të përqendruar dhe me këmbët e shtrirë përpara. Kishte pamje fëmije të zgjuar dhe të sjellshëm. Priste që ta zhvishnin dhe ta vinin në gjumë. Ndërkohë dëgjonte i përqendruar bisedën e mamasë me motrën. Pranë tyre qëndronte vajza e vogël në pritje të radhës që ta zhvishnin dhe atë. Dera e jashtme ishte e hapur që të mund të ajrosej dhoma nga tymi i duhanit, i cili shtëllunga-shtëllunga hynte nga dera e dhomave të brendshme dhe e mundonte aq ligësht të gjorën grua! Edhe pa të e mbyste kolla si veremlije që ishte. Katerina Ivanovna dukej edhe më e dobësuar, njollat e kuqe në faqe dhe në qafë i qenë theksuar.

- Nuk ke për ta besuar jo, se ti as me mendje s'e merr dot, Polenjka, - thoshte duke ecejakur, - sa të lumtur dhe të shpenguar kemi rrojtur te babai, kurse ky pijaniku ma nxiu jetën, mua dhe juve bashkë! Babai kishte gradën e kolonelit, ishte kandidat i parë për postin e gjeneral-guvernatorit. E shihje të rrethuar nga njerëz të nderuar, e çmonin dhe e respektonin. Kur...kh...kh.. Khe-khe-kh! O jetë e mallkuar! - tha duke marrë frymë me zor. - Kur në njërën nga ballot te... kryetari i fisnikëve... më pa kontesha Bezemelnaja, e cila më pas e bekoi martesën time me babanë tënd, Polja, pyeti për mua: "Kjo këtu mos është ajo vasha që kërceu aq bukur në mbrëmjen e maturantëve?". (Duhet qepur kjo këmishë, bëje tani ashtu si të kam mësuar, se nesër...khe!... Nesër.. khe... khe... do shqyhet fare! - mezi e mbaroi porosinë nga kolla). Nga Petërburgu kishte ardhur kamer-junkeri Shegolskoi... më ftoi të kërcenim një mazurkë... të nesërmen ishte

gati të më kërkonte dorën. Unë vetëm e falënderova tërë mirësjellje edhe i bëra të ditur që zemra ime i përkiste dikujt tjetër... Dhe ky "tjetri", Polja, ishte yt atë. Babai im u mërzit shumë dhe u zemërua me mua nga kjo që bëra... Shiko, uji gati është? Bjeri këtu këmishën edhe çorapet... Lida, - i thirri më të voglës, - sonte bëj si bëj, fli pa këmishë... edhe çorapet hiqi t'i lajmë... Po ky dordoleci ynë pse nuk po vjen? Kushedi ku ka ngelur i dehur... Këmishën e paske aq të strepëcuar, sa s'duron më të lahet! .. O Zot!... Kh...kh... kh... Po kjo ç'të jetë? - tha kur pa gjindjen që ishte mbledhur te shkallët, ndërsa disa burra me diçka ndër duar iu drejtuan derës së tyre. - Ç'paska ndodhur? Ç'është kjo? O Zot!

- Ku ta vemë? - pyeti një nga policët, duke parë përreth që të gjente një vend sa më të përshtatshëm për ta shtrirë Marmelladovin.

- Në divan! Kthejeni, koka le të jetë këtej! - u tha Raskolnikovi.

- E ka shtypur karroca, ka qenë i dehur, - shpjegoi njëri te dera.

Katerina Ivanovnës s'i mbeti pikë gjaku në fytyrë, mezi mbushej me frymë. Fëmijët dukeshin të lemerisur. Lida e vogël me lebeti u derdh drejt Poljes, e pushtoi fort dhe dridhej e tëra.

Pasi e shtrin Marmelladovin, Raskolnikovi iu afrua Katerina Ivanonvnës.

- Merreni veten në dorë, qetësojini dhe kalamajtë. Tregohuni burrneshë! - i tha. - Kur po kalonte rrugën, e shtypi karroca, por do përmendet. Unë u thashë ta binin këtu... kam qenë një herë te ju... ju kujtohet? Për harxhimet përgjigjem unë.

- E pësoi! - shqiptoi kjo me dëshpërim dhe u sul për tek i shoqi.

Raskolnikovi u bind sakaq, që kjo grua nuk është nga ato që e humbasin toruan dhe e pllakos alivani. I vuri nën kresë jastëkun, askujt nuk i pati vajtur mendja për këtë, zuri ta zhvishte, t'ia shihte plagën; nuk e humbi mendjen u mbajt mirë, ndërkohë që shtrëngonte dhëmbët dhe kafshonte buzën që të mos e linte dhimbjen t'i shpërthente jashtë, të mos ulërinte e të shkrehej në dënesa.

Raskolnikovi çoi dikë të thërriste mjekun, që banonte në një shtëpi aty pranë.

- Sillni ujë dhe një pecetë të pastër, duhen pastruar plagët. Është gjallë, i duhet dhenë sa më shpejt ndihma. Tani vjen dhe mjeku, çova njeri. Për të gjitha paguaj unë, - tha.

Katerina Ivanovna shkoi te dritarja, në një karrige shtrëmbaluqe qëndronte një legen plot me ujë, që e kishte bërë gati për të larë lëveret e fëmijeve. Këtë punë ajo e bënte vetë, me dorën e saj, dy herë në javë; brenda ditës dhe natës i lante dhe i thante rrobet, në mëngjes ua vishte përsëri, ndërresa të tjera nuk kishin. Katerina Ivanovna ishte pastërtore e madhe, më mirë e mundonte kështu veten, sesa të duronte pisllëkun në shtëpi. E rrëmbeu legenin plot me ujë, por iu morën këmbët dhe për pak nuk u gremis bashkë me të. Raskolnikovi gjeti dhe një peshqir të pastër, e lagu dhe zuri t'i pastronte Marmelladovit fytyrën, që ia kishte mbuluar gjaku. Katerina Ivanovna qëndroi aty dhe me dhëmbë të shtrënguara e me pëllëmbët ngjeshur pas gjoksit ndiqte lëvizjet e Raskolnikovit. Ky qe penduar që e solli këtu viktimën, edhe polici qëndronte i hutuar, s'dinte ç'të bënte.

- Polia! Vrap te Sonja! - thirri Katerina Ivanovna. - Po nuk e gjete, thuaj atyre atje që babanë e ka shtypur karroca... Të vijë sa më parë! Merr shallin, hidhe supeve dhe nisu!

- Shkelja, Polia! - e përforcoi fjalën e të ëmës djali që vazhdonte të rrinte ulur në karrige me trupin gargi, me sytë e zgurgulluar dhe të trëmbur, me këmbët e shtrirë përpara vetes.

Ndërkohë shtëpia u mbush me njerëz. Policët u larguan, ndenji vetëm njëri, që mundohej të largonte kureshtarët. Nga dhomat e brendshme dolën qiraxhinjtë e zonjës Lipevehzel: në fillim vetëm sa nxorën kokat të shihnin, pastaj dyndën te dera dhe në dhomë. Katerina Ivanovna u gërmuq:

- Na lini makar të vdesim të qetë! - u tha. - Ç'u mblodhët kështu sikur po jepet ndonjë shfaqje! Edhe cigaret po gjyryk! Khe!... Khe!... Khe! Vetëm fraku dhe kapelet republikë u mungojnë! Pak më shumë respekt për të përvajturin duhet patur!...

E mbyti kolla, por qortimi bëri efekt. Ia kishin frikën dhe njëri pas tjetrit u fshehën pas derës. Në fytyra u ishte vulosur ajo lloj kënaqësie, që vihet re gjithmonë te secili, madje edhe te më të afërmit, kur mësojnë për fatkeqësinë që u ndodhi një njeriut të tyre, ndonëse sinqerisht janë të pikëlluar deri në thellësi të shpirtit. Dikush tha se do të kishte qenë më mirë ta çonin në spital, ndihma ndihmë dhe njerëzit nuk kishin për t'u bezdisur.

- Mirë, thoni, këtu dhe të vdesësh nuk duhet! - thirri Katerina Ivanovna dhe u turr për nga dera që ta sikteriste atë që foli, por nuk arriti, u gjend ballë për ballë me pronaren, zonjën Lipevehzel. Kjo me të dëgjuar ç'kishte ndodhur, erdhi që të mos lejonte çrregullime. Ishte një gjermane noprane dhe huqelie e madhe.

- O Zot! - thirri. - Paska qenë i dehur, e paska shtypur karroca! Në spital! Jam unë zonjë shtëpie këtu!

- Amalia Ludovigovna! Mendohuni mirë para se të flisni! - iu kthye me kryelartësi Katerina Ivanovna. (Me pronaren e kishte bërë zakon të fliste me fjalë bombastike. "Ta dinte me kë kishte të bënte". Edhe në këto çaste pikëlluese nuk hoqi dorë nga ky zakon). - Amalia Ludovigovna...

- Ju kam paralajmëruar, duhet ta mbani mend, kurrë të mos më thërrisni Amalia Ludovigovna; e kam emrin Amal-Ivan!

- Jo, ju nuk e keni emrin Amal-Ivan, ju quheni Amalia Ludovigovna, dhe meqë jam një nga lajkataret tuaja, si ata të poshtrit që të rrethojnë, përfshi këtu edhe zotin Lebezjatnikov, që është duke zbardhur dhëmbët prapa derës, (atë çast vërtet që prapa derës u dëgjuan të qeshura dhe kukurisma) do ju thërres kurdoherë Amalia Ludovigovna. Nuk arrij dot ta kuptoj: përse vallë nuk ju pëlqen ky emër? Ju e shihni fort mirë ç'i ka ndodhur Semion Zaharoviçit, është duke vdekur. Ju lutem, mbylleni këtë derë dhe mos lejoni të hyjnë e të dalin njerëz. Lëreni tjetrin makar të vdesë i qetë! Ndryshe, kjo që jeni duke bërë, do t'i vejë në vesh gjeneral-guvernatorit. Konti më njeh që kur kam qenë një pëllëmbë, e njeh personalisht edhe Semion Zahareviçin, disa herë i ka zgjatur dorën e ndihmës. Kush nuk e di sa miq dhe dashamirës që ka Semion Zahareviçi, ata ai vetë i ka braktisur nga krenaria e fisnikut që është i vetëdijshëm për dobësinë e pamposhtshme që ka ndaj pijeve alkoolike. Ja, ka ardhur të na japë një dorë ndihmë ky djalosh zemërgjerë (tregoi me dorë në drejtim të Raskolnikovit), i ka edhe mjetet edhe lidhjet e nevojshme, këtë Semion Zaharoviçi e ka njohur që kur ka qenë fëmijë, dhe ju siguroj, Amalia Ludovigovna...

Tërë kjo tiradë u zbraz me një frymë, vetëm shkulmet e kollës munduese ia ndërprenë disa herë oratorinë Katerina Ivanovnës. Ndërkaq i aksidentuari erdhi në vete dhe rënkoi, ajo u turr drejt tij. I kishte hapur sytë, por s'po kuptonte ku ndodhej, kërkënd nuk po

njihte. Sytë e ngrirë ia qepi Raskolnikovit që i qëndronte përpara, mezi merrte frymë, në çipet e buzëve iu dukën bulëza gjaku, ballin ia mbuluan djersët. Raskolnikovin nuk e njohu, ndaj tërë shqetësim e kaloi shikimin te të tjerët. Katerina Ivanovna tepër e pikëlluar, por dhe po aq e rreptë, s'ia shqiste shikimin qortues, nëpër faqe i rridhnin lot të nxehtë.

- Zot i madh! I qënka dërrmuar fare gjoksi! Sa shumë gjak i paska ikur! - foli e dëshpëruar. - Duhet zhveshur! Kthehu pak, Semion Zahareviç, në mundsh! - i thirri.

Marmelladovi e njou:

- Priftin! - mërmëriti me zë të ngjirur.

Katerina Ivanovna u largua te dritarja, mbështeti ballin në xhamin e ftohtë dhe në angështi e sipër thirri:

- O jetë e mallkuar!

- Priftin! - mërmëriti përsëri Marmelladovi pas një minutë heshtjeje.

- Kemi çuar njeri! - i bërtiti Katerina Ivanovna. Ky e ndjeu furtunën dhe e mbylli gojën! Zuri të kapsalliste sytë i frikësuar, krejt i pikëlluar. Katerina Ivanovna erdhi përsëri aty dhe i qëndroi te koka. U qetësua disi, por atë çast sytë i shkuan te Lidoçka e vogël, kanakarja e tij, që dridhej e strukej në një qoshe dhe e shihte e trëmbur, e habitur dhe e lebetitur.

- A... ah... - rënkoi dhe e pa i brengosur. Diç donte t'i thoshte, por nuk i dilnin fjalët.

- Hë! Ç'pate ashtu? - i bërtiti Katerina Ivanovna.

- Zbathur! Zbathur! - mërmëriti, duke e parë me një shprehje prej të çmenduri në sy.

- Hesht! - ia preu me nervozizëm e shoqja. - E di fort mirë përse është zbathur!

- Doktori! Erdhi doktori! - thirri i gëzuar Raskolnikovi.

Doktori ishte një plakosh i tapinosur, që e shihte çdo gjë me dyshim dhe punët i bënte me mëdyshje. Iu afrua të sëmurit, zgjati dorën që t'i maste pulsin, e ndihmoi edhe Katerina Ivanovna, i pa kokën, i zbërtheu këmishën e lyer me gjak, ia zbuloi kraharorin e copërluar dhe të shqyer mosmëkeq. Në anën e djathtë i qenë thyer disa brinjë. Te zemra kishte një plagë të madhe, e kishte shkelur kali. Mjeku u vrenjt. Polici i tregoi që karroca e kishte hequr hosh si ndonja tridhjetë hapa nëpër xhade.

- Çudi si paska mundur të përmendet? - i pështëriti mjeku Raskolnikovit.

- Çdo të bëhet me të? - e pyeti ky.

- Pas pak do të vdesë.

- Nuk ka asnjë shpresë?

- As më të voglën! Është në grahmat e fundit. Se edhe në kokë ka disa plagë vdekjeprurëse... Mund të provonim t'i fusnim gjak... por është fare e kotë. S'i kanë mbetur as dhjetë minuta jetë.

- Po t'i futim atëhere, ku i dihet!

- Mirë... por, e përsëris, është fare e kotë.

U dëgjuan hapa, njerëzit te shkallët u hapën, te pragu u duk prifti, një plak i moçëm me takëmet e ritualit ndër duar. Prapa i shkonte një polic, e kishte shoqëruar që nga rruga. Mjeku u tërhoq, duke shkëmbyer ca shikime kuptimplote me priftin. Raskolnikovi e luti mjekun të mos largohej, ky rrudhi supet dhe bëri si i thanë.

Njerëzit u zbrapsën. Lutja nuk zgjati shumë. I dëmtuari zor se kuptonte gjë, shqiptonte në të rrallë ca tinguj të paqartë, të shkëputur. Katerina Ivanovna e mori në krahë Lidoçkën, e zbriti djalin nga karrigia dhe u tërhoq në qoshe te soba, ra në gjunjë, uli edhe fëmijët në gjunjë para vetes... vajza dridhej, kurse djali ngrinte dhe ulte ngadalë dorën, duke bërë kryqin, përulej thellë aq sa i cekte balli tokën e kjo, me sa dukej, i jepte kënaqësi. Katerina Ivanovna kafshonte buzët, me vështirësi po i mbante lotët; edhe ajo falej, herë mbas here rregullonte këmishën e djalit dhe mësallën që i kishte hedhur në supe vajzës; e kishte nxjerrë nga komoja pa u ngritur dhe ia kishte hedhur krahëve vajzës që ishte lakuriq, lutjen nuk e kishte ndërprerë. Në këtë kohë dera, që çonte në dhomat e brendshme, u hap përsëri, u zgjatën disa koka kureshtarësh. Gjindja që qëndronte te shkallët qe shtuar, ishin mbledhur edhe komshinjtë që sapo kishin dëgjuar për aksidentin; kishte edhe nga ata që kishin kuturisur të futeshin në dhomë, e cila ndriçohej nga një qiri i vetëm.

U kthye Polenjka, mezi mbushej me frymë, hoqi shaminë dhe zuri të kërkojë me sy të ëmën. Kur e pa, iu afrua dhe i tha: "Po vjen! E gjeta në rrugë!". E ëma e uli edhe atë pranë vetes. Përmes grumbullit çau pa u ndier, e druajtur një vajzë; u duk diçka e çuditshme shfaqja e saj këtu, në këtë dhomë varfanjake, plot me zhele e dëshpërim, ku

qe ulur këmbëkryq vdekja dhe makthi. Rrobat që kishte veshur, edhe ato zhele ishin, plaçkë nga më e lira, por të zgjedhura sipas shijes së rrugës, sipas modës për vajzat e përdala, të tilla që të binte në sy qëllimi i turpshëm për të cilin ishin zgjedhur. Sonja qëndroi te pragu dhe pa fare e përhumbur, si të mos kuptonte ç'po ndodhte dhe ç'para-qitje kishte ajo vetë. Kishte veshur një fustan mëndafshi të stërpërdorur, që mbaronte me një si bisht të çuditshëm, veshur mbi një zhupon të fryrë që e zinte krejt derën, kishte mbathur këpucë të bardha, kapele kashte të vënë mënjanë dhe të zbukuruar me ca pupla gjak të kuqe, që i jepnin një pamje qesharake fytyrës së dobët dhe të zbehtë, aq shumë të trëmbur, me gojën e hapur nga tmerri dhe me sytë e ngrirë, të llahtarisur. Ishte një tetëmbëdhjetëvjeçare imcake, por leshverdhë e lezetshme, me sy të kaltër të mrekullueshëm. Në fillim ia nguli shikimin shtratit, pastaj priftit... Pështërimat dhe çuçurimat e të pranishmëve i kishte dëgjuar, uli sytë, bëri një hap përpara, por nga dera nuk u largua.

Lutja e priftit mbaroi. Katerina Ivanovna iu afrua shtratit të të shoqit. Prifti u zmbraps dhe bëri të thoshte nja dy fjalë ngushëllimi.

- Po këta? Me këta ç'të bëj tani? Ç'më mësoni ju, uratë? - thirri e nervozuar dhe e ndërkryer, duke treguar me dorë fëmijët.

- Zoti është mëshirëplotë! Mos e humbni besimin te ndihma e tij! - filloi ta ngushëllonte prifti.

- E-eh! Mëshirëplotë, por jo për ne!

- Është mëkat të flasësh kështu, zonjë! - i hoqi vërejtje prifti.

- Po ky këtu a nuk është mekat? - bërtiti Katerina Ivanovna, duke treguar në drejtim të të shoqit.

- Ndoshta, shkaktarët pa dashje të aksidentit do të tregohen të mëshirshëm dhe do ju dëmshpërblejnë...

- E ç'ne! - thirri me mllef Katerina Ivanovna dhe tundi dorën e pashpresë.- E përse do më shpërblekan? Ai vetë, i dehur siç ishte, vajti e u fut nën rrotat e karrocës! E ç'dëmshpërblim mund të presësh? Pijanik i regjur është, na e mori shpirtin, vetëm për mejhanet ka menduar. Na mori në qafë si mua ashtu dhe fëmijët... E kujtoi Zoti, po e mbledh në gjirin e tij! Më mirë pa të se me të!...

- Në grahmat e vdekjes duhet falur tjetri, zonjë. Këto që thoni, ju shtien në mëkat!

Katerina Ivanovna vente e vinte nëpër shtëpi, i dha të shoqit për të pirë, i fshiu gjakun dhe djersën, i rregulloi disa herë jastëkun, pa pushuar se foluri me priftin, fare e çakërdisur dhe e ndërkryer. Më në fund, s'u përmbajt më dhe iu sul priftit.

- Uratë! Vetëm fjalë janë ato që thoni! T'ia fal? Po, po të mos e kishin shtypur, do vinte i dehur, ka vetëm një këmishë dhe atë leckë e xhele e ka; rrobet po ashtu, do vinte e do zinte shtratin, gjumë, kurse unë, derisa të gdhinte, do laja e do pastroja rrobet e tij dhe të kalamajve, pa do kujdesesha të thaheshin, që, kur të ngriheshin, t'i vishnin, dhe kjo punë nuk është bërë një e dy herë... E për ç'falje mund të flitet në këtë rast? E kam falur makar, sa jam lodhur! E ç'arrita?

Një kollë e tmerrshme e tundi dhe e shkundi për tmerr. Pështyu në shami dhe ia futi në turinjtë priftit, duke shtrënguar me dorën tjetër gjoksin që i dhimbte. Shamia ishte tërë gjak...

Prifti uli kokën dhe qëndroi i nemitur, i heshtur.

Marmelladovi po jepte shpirt, sytë s'ia ndante Katerina Ivanovnës, që qe përkulur mbi të. Diç donte të thoshte, madje provoi të thoshte, duke lëvizur me mundim gjuhën dhe duke nxjerrë ca fjalë të pakuptueshme. Katerina Ivanovna e kuptoi që donte t'u kërkonte ndjesë, prandaj e urdhëroi me zë të prerë:

- Hesht! S'ke përse!... E di ç'do të thuash!

Ky heshti, po atë çast sytë i vajtën te Sonja që qëndronte te dera.

- Po ajo? Ajo kush është? - foli me zor të madh, me zë të shuar, të mbytur, tejet i dëshpëruar dhe i merakosur. Provoi të ngrihej pak.

- Rri! Rri..i..i! - iu hakërrua Katerina Ivanovna.

S'iu bind; pas një sforcimi të jashtëzakonshëm mundi të mbështetej pak në bërryl. Ia nguli shumë i pikëlluar shikimin të bijës, por mjegullimi që ia kishte turbulluar dritën, e pengonte ta shquante mirë. Asnjëherë nuk e kishte parë asisoj; e kuptoi sa shumë e poshtëruar, e fyer dhe e dërrmuar që duhet të ishte, veshur me atë stoli rruge, kur priste kokulur radhën për t'i lënë lamtumirën të atit. Një vuajtje e papërshkrueshme iu duk në fytyrë.

- Sonja! Bijë! Më fal!... - tha me mundim të jashtëzakonshëm dhe provoi të zgjaste krahët drejt saj, por nuk i arritën forcat, u rrokullis nga divani, fytyra iu përplas në dysheme. U sulën, ishte duke dhënë shpirt... Sonja gulçoi mbytur, u derdh drejt tij, e përqafoi dhe mbeti si

e pa jetë mbi trupin e tij. Vdiq në krahët e saj.

- Ja dhe fundi! - thirri Katerina Ivanovna, duke treguar kufomën e të shoqit. - Po tani si do t'ia bëj? Me se do ta varros? Po këta me se do t'i rris? Ç'do t'u jap për të ngrënë nesër?

Raskolnikovi iu afrua.

- Katerina Ivanovna, - i tha. - Javën që shkoi i ndjeri bashkëshorti juaj më tregoi për jetën e tij, për rrethanat në të cilat ju... Të më besoni, për ju më foli me një adhurim dhe entuziazëm të jashtëzakonshëm. Që nga ajo mbrëmje, kur e kuptova sa shumë që ju detyrohej dhe ju nderonte, sa shumë që ju donte dhe ju respektonte, edhe pse nuk hiqte dot dorë nga ajo dobësi e tij, e cila dhe i kushtoi jetën, që nga ajo mbrëmje mbetëm miq... Më lejoni tani... t'ju qëndroj pranë.. të shlyej detyrimin ndaj mikut... Ja, këtu janë njëzet rubla... Përdorini si të dini... Do vij t'ju shoh përsëri... Ju jap fjalën... Që nesër... do vij... Lamtumirë!

Doli nxitimthi nga dhoma, çau përmes njerëzve që rrinin te shkallët, kur befas u gjend përpara Nikodhim Fomiçit, i cili, me të dëgjuar për aksidentin, kishte ardhur që të kujdesej vetë për të aksidentuarin. Që nga skena në zyrat e policisë nuk ishin parë, por ky e njohu menjëherë.

- Qënkeni ju? - e pyeti.

- Vdiq, - iu përgjigj Raskolnikovi. - E vizitoi mjeku, ishte prifti, çdo gjë është në rregull. Mos e shqetësoni të gjorën grua, vuan nga veremi, jepini zemër, po të mundeni... Se ju jeni shpirt njeriu, e di fort mirë këtë... - shtoi, duke e parë drejt në sy me buzën në gaz.

- Po ju qenkeni kredhur në gjak! - vuri në dukje Nikodhim Fomiçi, që po e shihte me kërshëri në dritën e fenerit.

- Po, jam kredhur... tërë gjak jam! - nëpërdhëmbi në mënyrë shumë domethënëse Raskolnikovi, pastaj vuri buzën në gaz, tundi kokën dhe vazhdoi të zbresë shkallët.

I zbriti ngadalë, me dridhje dhe rrëqethje të pandërprera, por edhe i pushtuar nga ca ndjenja të reja, që nuk kishin anë e fund, ishin ndjenja jetëdashëse dhe njeridashëse, të ngjashme me ato që provon i dënuari me vdekje, kur i njoftojnë amnistinë. Në mesin e shkallëve e zuri prifti, Raskolnikovi i hapi rrugë dhe këmbeu një përkulje të heshtur. Kur ishte në fund të shkallëve, i zunë veshët hapa të nxituara. Dikush donte ta arrinte. Ishte Polenjka. Kur e pa, i thirri: "Prisni! Prisni pak!".

Bëri si i thanë. Vajza ndali një shkallare më lartë. Një dritë e mekët hynte nga oborri. Raskolnikovi ia hetoi fytyrën njomëzake, të pakët, por të mirë, që po i buzëqeshte me një çiltërsi fëmijërore. E kishin dërguar me një porosi, që me sa dukej, asaj vetë i jepte gëzim.

- Si ju quajnë? Ku e keni shtëpinë? - e pyeti me zë të shuar nga nxitimi.

Raskolnikovi ia vuri të dyja duart mbi supe dhe e pa i lumturuar. Sa shumë kënaqësi që ndiente duke e parë këtë vocërrake! As vetë nuk po e kuptonte përse.

- Kush të dërgoi?

- Motra Sonja, - iu përgjigj dhe përsëri buzëqeshi.

- E dija që ajo ju ka dërguar.

- Edhe mamaja më dërgoi. Kur më tha Sonja të vija t'u pyesja si e keni emrin, edhe mamaja më tha: "Vrap, Polenjka! Pyete!".

- E doni shumë motrën tuaj, Sonjën?

- Më shumë nga të gjithë atë dua! - tha me zë të sigurt e të vendosur vajza dhe fytyra i mori pamje serioze.

- Po mua do më duash?

Në vend të përgjigjes pa si iu afrua fytyra ëmbëloshe e vajzës dhe buzët e fryra që iu zgjatën për ta puthur. Krahët e hollë si fije shkrepse u shtrinë drejt tij dhe ia pushtuan qafën, koka e vogël iu mbështet në sup dhe të dridhura ngashërimi ia përshkuan trupin e dobët si karthi, ndërkohë fytyra e përlotur i ngjeshej gjithë më fort pas fytyrës dhe krahët e shtrëngonin fort.

- Më dhimbset babi! - tha pas një minute, duke e larguar fytyrën dhe duke i fshirë lotët me pëllëmbë. - Fatkeqësi të mëdha na presin... - shtoi befas me një pamje tepër serioze, siç ndodh me fëmijët, kur duan të flasin si të rriturit.

- Po babi ju ka dashur?

- Më shumë nga të tërë ka dashur Lidoçkën, - shqiptoi me po atë seriozitet. - Prandaj e donte, se është e vogël, pastaj është dhe e sëmurë; i sillte ëmbëlsira, kurse ne na mësonte shkrim e këndim, na mësonte gramatikën dhe mësim feje, - shtoi tërë dinjitet. - Mamaja nuk thoshte gjë, por ne e dinim që i pëlqente, edhe babai e dinte; mamaja do më mësojë frëngjisht, se jam e madhe tani, duhet të mësoj siç bëjnë nxënësit në shkollë.

- Po lutje di?

- Di dhe di shumë! Si e madhe që jam, lutjen e bëj vetë, kurse Kolja me Lidoçkën luten bashkë me mamanë; ata i thonë lutjet me zë; në fillim i luten Shën-Marisë, pastaj thonë: "O Zot! Fale dhe bekoje babanë tonë të parë!" Se babai i parë ka vdekur, ky është baba tjetër, ne edhe për këtë do t'i lutemi Zotit.

- Poleçka! Mua më quajnë Rodion: lutju Zotit ndonjëherë edhe për mua: "Fale robin tënd, Rodionin, o Zot!". Vetëm kaq thuaj!

- Kështu e tutje tërë jetën time do t'i lutem Zotit për ju, - i tha vajza me ndjenjë e seriozitet, sakaq vuri buzën në gaz, iu hodh në qafë dhe e shtrëgoi fort.

Raskolnikovi i tha emrin e plotë, i dha adresën, i dha fjalën se do vinte t'i shihte nesër. Vajza sa s'fluturonte nga gëzimi. Ishte ora njëmbëdhjetë e natës, kur doli në rrugë. Pas pesë minutash qëndronte te parmakët e urës, pikërisht në atë vend, ku para disa orësh ishte hedhur në ujë gruaja.

"Mjaft më!... Duhet jetuar jeta! Larg atij vegimi, larg tmerreve që po i nxit vetes, tutje frikën që s'po më ndahet!... Ja, kjo që sapo përjetova, a nuk është jetë? Jeta ime s'ka përse groposet bashkë me atë plakaruqe! I vaftë shpirti në parajsë! Boll jetoi, le të prehet atje tani! Duhet fluturuar në krahët e arsyes... të vullnetit... të forcës. Të shohim ç'do të ndodhë! O unë, o ata! - shtoi me kryelartësi si të grishte ca forca të errëta për t'i përballuar. - A nuk qeshë unë ai që kërkova vetëm pesë pëllëmbë tokë për të jetuar?!

... Ma mori shpirtin fare kjo pafuqi, veç gjendjen e padurueshme, lëngatën e ligë sikur ma hoqi njeri me dorë. E dija që kështu do më ndodhte, do më kalonte... Pa dale një herë, më duket se shtëpia e Peçinkovit ndodhet diku këtu afër. Duhet patjetër të shkoj te Razumihini, punë më të mirë se kjo s'kam si bëj. Le t'i forcohet besimi tek unë. Le të dalë ashtu si e pat parashikuar ai!... Lypset qenë i fortë, pa këtë nuk do t'ia dalë dot mbanë, dhe forcën duhet ta fitoj me forcë. Ja çfarë nuk dinë ata!..." - tha me vete i krekosur dhe tërë vetëbesim. U largua nga ura duke i hequr zvarrë këmbët. Krekosja dhe vetëbesimi sa vinin e i rriteshin; s'kishin kaluar veçse disa minuta, dhe po e ndiente veten tjetër njeri. Po ç'ishte vallë ajo e veçantë që e kishte trasformuar kështu? As vetë nuk e dinte; si i mbyturi që kapet edhe nga fija e

kashtës, iu duk se mund të jetonte edhe ai. Ndoshta ngutej pak me përfundimin e bërë, por për këtë as që mendonte.

"E porosita të lutej për robin e Zotit, Rodion! - tha me vete. - Mirë bëra, asgjë të keqe nuk ka!..." - shtoi duke vënë buzën në gaz nga kjo sjellje prej fëmije. I kishte ardhur në vend shpirti!

E gjeti kollaj vendbanimin e Razumihinit. Që në shkallë dëgjoi zhurmë dhe të folura njerëzish, pra ishin aty. Dera ishte e hapur, nga brenda vinin britmat dhe zërat. Dhoma që ky kishte marrë me qira, ishte e bollshme, të ftuar ishin nja pesëmbëdhjetë vetë. Raskolnikovi ndali në korridor. Dy shërbëtorë po merreshin me samovarët, me shishet e pjatat, me mezet dhe ëmbëlsirat. Raskolnikovi u tha t'i bënin zë Razumihinit. Ky sa s'fluturoi nga gëzimi, kur e pa. Dukej që kishte ardhur në qejf, ndonëse ishte nga ata që e mbante pijen.

- Dëgjo! - nxitoi t'i thotë Raskolnikovi. - Erdha të të them se bastin që vumë e fitove. Për të hyrë, nuk mund të hyj, mezi po më mbajnë këmbët. Urimet e mia, lamtumirë! Eja nesër nga unë...

- Po mirë atëherë, po të përcjell pak! Meqë thua se nuk ke fuqi fare...

- Ke mysafirët aty... Po ky kaçurelsi që nxori kokën, kush është?

- Një dreq e di! Një i njohur i xhaxhait është, ndoshta edhe për qejf të vet ka ardhur... Rri xhaxhai me ta; është xhevahir njeri, më vjen keq që po humbet rastin ta shohësh. Po nejse! Të dehur siç janë, as që kanë për ta vënë re; kurse për mua s'është keq të thith ca ajër. Erdhe si me porosi ti, vëllaçko, ndoshta deri në kacafytje mund të vinte puna... Se këpusin ca broçkulla, që të zësh kokën me duar dhe të ulërish!... E ku i gjendet fundi çudanërisë njerëzore!... Gënjejnë si derrat... Po kot i shaj, as vetë ne nuk jemi ëngjëj... Prit një minutë sa të thërres Zosimovin.

Zosimovi nuk iu afrua, por u derdh drejt Raskolnikovit, kur dëgjoi kush ishte në korridor. E shihte me kureshtje, me fytyrë të çelur.

- Drejt e në shtrat! - i tha prerë pasi e kishte hetuar mirë pacientin. - Para gjumit një qetësuese! Mirë? Ta kam bërë gati pluhurin.

- Edhe dy, po të dëshironi, - iu përgjigj Raskolnikovi.

E mori dhe e piu në vend ilaçin.

- Bën mirë që e përcjell, - i tha Razumihinit. - Nesër shohim e bëjmë, për sot punët na shkuan mirë: ndryshimi është i ndjeshëm! Sa

të rrosh do mësosh..

- E di ç'më tha Zosimovi pak më parë? - s'iu durua pa i thënë Razumihinit. - Do t'i tregoj të gjitha, çdo gjë açik... Më tha që mendon se je i çmendur... Më tha të derdëllisja me ty mbarë e prapë dhe të bëja që ti të më flisje, pastaj t'ia tregoja atij të gjitha... E merr dot me mendje? Pikësëpari, ti je tri herë më i mënçur se ai; së dyti, në mos qofsh vërtet i çmendur, aq të bën ç'mendime i gëlojnë në kokë atij; së treti, ai vetë s'është veç se një copë mishi me dy sy, specialitetin e ka për kirurg dhe një dreq e di për ç'arësye ka rënë në dashuri me psikiatrinë. Sipas tij, dyshimet që paska patur, i paska vërtetuar nga biseda që zhvillove me Zametovin.

- Domethënë ju paska treguar Zametovi?

- Po, dhe bëri shumë mirë. Edhe unë, edhe Zametovi e kemi të qartë çdo gjë.. Shkurt llafet, Rodja, puna është se... Por kam pirë ca... Puna është se ai mendimi... më kupton? E kishin atë mendim... e qartë? Askush nuk merrte guximin të ta thoshte, se ishte budallallëk me brirë, sidomos pasi u mor në pyetje bojaxhiu, gjithçka u doli bllof! Por ama për të patur e kishin... Atyre marrokëve as që kishte pse u lindte ai mendim! Zametovit ia kallëzova qejfin; ta themi këtu e ta lëmë këtu, mos i bjer në sy që e di, është tip që preket. Ishim te Liza atëherë, kurse sot çdo gjë u sqarua. Kryesorja është që Ilia Petroviçi u bind! U kap pas alivanit tënd në zyrat e policisë. Zavalli... Por ndërroi mendje, madje i erdhi turp për dyshimet që i kishin lindur. Siç e sheh, jam në dijeni të gjithçkaje...

Raskolnikovi e dëgjonte i tëri sy e vesh. Razumihini u zbërthye: ç'ka barku i nxjerr bardhaku!

- Me ra të fikët se ishte zabullimë e madhe, pastaj edhe m'u përzie nga era e bojës së vajit, me të cilën sapo i kishin lyer dyert.

- E si, mua do më bindësh tani? S'ka qenë vetëm kjo, ti tërë muajin ke qenë pa qejf. Zosimovi këtë e di. Më bëri përshtypje sa shumë që e vrau ndërgjegja atë djalosh për dyshimin që ngriti! Ti as me mendje nuk mund ta marrësh!... "As te gishti i këmbës, - thotë, - nuk i vij atij njeriu!". Ka çaste që e tregon veten vërtet njeri të mirë. Një mësim për tërë jetën iu bë sidomos takimi në "Pallatin e Kristaltë". As me porosi nuk do kishte dalë aq bukur! Se ti në fillim e kishe trembur, e kishe bërë të dridhej. E kishe bërë t'i vinte gishtin kokës dhe të hiqte

dorën nga ai mendim i shëmtuar që i kishte gëluar në kokë; pastaj i kishe nxjerrë dhe gjuhën: "ja shpërblimi, domethënë!". E përsosur! E kishe lënë me gisht në gojë burrin e botës! Mjeshtër u tregove, të lumtë! Sa keq më erdhi që s'u ndodha aty! Mezi pret që të takojë. Edhe Porfiri dëshiron të të njohë më nga afër...

- Nuk dua t'ia shoh bojën! Po të çmendur përse më paskan bërë, këtë më thuaj?

- Domethënë si të bënë? Më duket se e lëshova ca si shumë gojën... Ishin të habitur që vetëm një çështje të interesonte gjatë bisedave që bëheshin. Tani edhe kjo gjeti shpjegimin e duhur: të vinte për shkak të sëmundjes që kishe kaluar, të rrethanave të rënda në të cilat kishe jetuar kohët e fundit.... Kam pirë ca, por si ta them, ka disa mendime të vetat ai njeri. Zosimovit, të thashë, i ka shkrepur në mendje të merret me psikiatri... Por ti mos e çaj kokën.

Ndonjë minutë heshtën.

- Dëgjo, Razumihin! - i foli i pari Raskolnikovi. - Dua të jem i çiltër me ty: po vij nga një vdekje... Ua fala të gjitha sa kisha... Sapo më përqafoi dhe më puthi një qënie, që edhe në pata vrarë kënd, me këtë lahet... Pashë një njeri... me pupla gjak të kuqe në kapele... Po t'i lëmë këto... jam fare i këputur... mbamë pak... duhen ngjitur shkallët...

- Ç'ke kështu? Ç'pate? - e pyeti Razumihini i merakosur.

- Po më merren mendtë... Po s'është kjo.. Puna është që jam i trishtuar, aq i trishtuar! Pa shih atje? Ç'të jetë ajo dritë? Shih! Shih!

- Ç'ka nodhur?

- Pse ti nuk e sheh? Në dhomën time ka dritë!...

Ishin në shkallinat e fundit, para hyrjes së pronares; në dhomën e Raskolnikovit vërtetë që kishte dritë.

- Çudi! Mos është Nastasia? - tha Razumihini.

- Në këtë orë ajo nuk vjen kurrë! Fle herët, por... aq më bën! Lamtumirë!

- Ç'thua! Do të çoj brenda, do shoh edhe kush është!

- E di këtë, të dy do hyjmë, por nëma këtu dorën që ta shtrëngoj... që të ndahemi... Ma jep dorën! Lamtumirë!

- Ç'janë këto që bën, Rodja?

- Asgjë; shkojmë! Do jesh ti dëshmitari...

Ngjitën ngadalë shkallët e mbetura dhe Razumihini s'kishte si të

mos thoshte me vete, që Zosimovi, ndoshta, kishte patur të drejtë.. "Eh! Më duket se e turbullova, të gjorin, me bisedën që sapo i bëra, ia bëra mendjen çorbë!.." - e qortoi sakaq veten. Kur iu afrua derës, dëgjuan zëra në dhomë.

- Ç'është kjo? - thirri Razumihini.

Raskolnikovi i pari zgjati dorën për të hapur derën, i mëshoi fort dorezës, e shtyu dhe qëndroi si i ngrirë në prag.

Nëna dhe motra rrinin ulur në kanape dhe kishin një orë e gjysmë që e prisnin. E pse më pak se çdo kënd tjetër i priste ato? Më pak se për çdo kënd tjetër mendonte për to? Ato sot duhej të ishin këtu, ia kishin bërë të ditur që do të vinin. Gjatë asaj një ore e gjysmë e kishin pyetur dhe stërpyetur Nastasinë. Kjo ua kishte treguar gjithë sa dinte. Qenë mbledhur e qenë bërë një grusht, kur kjo i kishte thënë që "ia kishte mbathur s'di se ku", i sëmurë dhe, siç dilte nga tregimi, në gjendje jermi. "Zot i madh! Ç'të ketë djali?". E ëma kishte qarë sa ishte ënjtur, po i luante fiqiri.

Një britmë gëzimi, mallëngjimi të dalë nga shpirti e priti Raskolnikovin. Nënë e bijë iu sulën krahëhapur dhe e pushtuan, kurse ai qëndronte i vdekur i pakallur. Kjo e papritur befasuese e kishte çoroditur megjithësej. As krahët s'i ngriheshin që t'i përqafonte, nuk po mundej. Nëna dhe motra e shtrëgonin fort, e puthnin, qeshnin dhe qanin... Bëri një hap, u lëkund dhe u përplas pa ndjenja në dysheme.

Alarmi, britmat, rënkimet u ngritën në kupë të qiellit... Razumihini, që tërë këtë kohë kishte qëndruar te pragu, hyri vrulltas në dhomë, e ngriti të sëmurin dhe ky në çast u gjend në kanape.

- Nuk ka gjë, jo! - u thirri që t'i qetësonte. - Të fikët është! Do t'i kalojë! Pak më parë i bëri një vizitë doktori dhe tha që tani është fare mirë, asgjë me rëndësi nuk ka! Pak ujë! Ja, po përmendet, i hapi sytë...

E kapi Dunjeçkën nga krahu aq fort, sa mend ia shqiste, e tërhoqi vrulltas që kjo ta shihte: po i hapte sytë. Si nëna, si motra e mbanin për shpëtimtarin e të birit; në fytyrat u lexohej falënderimi i dalë nga zemra. Kishin dëgjuar Nastasinë t'u fliste për të, për marrëdhëniet që kishte me Rodien, për kujdesin dhe vëmendjen e vazhdueshme që kishte treguar në këto kohëra të vështira për djalin e tyre; u kishte thënë që është tip çapërxhiu, i shkathët dhe i gjendur. Në përgjithësi biseda, që kjo u kishte bërë, kishte qenë e çiltër dhe e përzemërt.

Pjesa e tretë

I

S'kaloi shumë dhe Raskolnikovi u çua dhe ndenji ulur në kanape.

I bëri shenjë Razumihinit që t'u jepte fund shpegimeve dhe ngushëllimeve fjalëshumë të nënës dhe motrës, u mori dorën dhe i pa ngultas si ndonjë minutë, duke e kaluar shikimin sa te njëra te tjetra. Nënës ia ngriu zemrën ky shikim i tij. Kishte në të edhe ndjenjë të fortë deri në vuajtje, por kishte edhe diçka të ngurtësuar, të palëvizshme, shenja çmendurie. Pulheria Aleksandrovna u shkreh në vaj!

Avdotia Romanovna qëndronte e verdhë dyllë, dora i dridhej në dorën e vëllait.

- Shkoni në apartamentin tuaj... me të, - u tha me zë të dridhur e të shuar, duke treguar nga Razumihini. - Deri nesër. Nesër... Keni shumë që prisni?

- Erdhëm kur ishte ngrysur, Rodia, - iu përgjigj Pulheria Aleksandrovna. - Treni mbërriti me vonesë. Rodia, unë asgjëkundi nuk iki. Do fle këtu, te këmbët e tua.

- Mos ma shtoni mundimin, - nëpërdhëmbi ky i nervozuar dhe tundi dorën.

- Do jem unë këtu! - tha Razumihini. - Nuk kam për ta lënë vetëm, në esfel vafshin mysafirët! Është xhaxhai me ta, di vetë ai si u jep këmbë punëve.

- Si t'ju falënderoj! - zuri të flasë me mirënjohje Pulheria Aleksandrovna dhe ia shtrëngoi dorën përzemërsisht, por Raskolnikovi nuk e la të vazhdonte.

- Jo! Asnjë nuk do rrijë! - tha si të mos ishte fare në vete. - U thashë, ikni tani!... Nuk mundem më!...

- Shkojmë, mama, dalim nga dhoma të paktën, - i pëshpëriti Dunja

e trembur nga fjalët dhe pamja e vëllait. - E lëmë më mirë të qetë.

- Po unë as për të parë nuk arrita ta shohë pas tre vjetësh! - tha me lot në sy Pulheria Aleksandrovna.

- Pa prisni njëherë! - i ndali befas. - Më janë trazuar keq mendimet... A u takuat me Lluzhinin?

- Jo, Rodia, por ai është në dijeni të ardhjes sonë. Na thanë, Rodia, që Pjotër Petroviçi qënka treguar aq i mirë, sa paska ardhur për një vizitë te ti sot, - i tha me gëzim në zë Pulheria Aleksandrovna.

- Po... u tregua aq i mirë... Dunja, e dëbova Lluzhinin... I thashë se do ta hidhja nga shkallët, po të mos i kthente majat andej nga kishte thembrat!

- Rodia! Ç'paske bërë? Me këtë nuk do të thuash... - pështëriti e çmeritur Pulheria Aleksandrovna, por s'vazhdoi, pa nga Dunja.

Avdotia Romanovna po e shihte vëllanë drejt në sy në pritje të shpjegimeve të mëtejshme. Ishin në dijeni të zënkës nga tregimi i Nastasisë, kuptohet, aq sa mundi dhe diti të shpjegonte kjo. Mezi prisnin të dëgjonin si qëndronte puna nga goja e tij.

- Dunja! - vazhdoi Raskolnikovi, duke mbledhur forcat e fundit që i kishin mbetur. - Jam kundër kësaj lidhjeje martesore, nesër që në takimin e parë, duhet t'ia bësh të qartë që i pret menjëherë të gjitha marrëdhëniet me atë njeri!

- O Zot! - thirri e prishur në fytyrë Pulheria Aleksandrovna.

- Vëlla, mendohu ç'je duke thënë! - i foli duke gulçuar, por e përmbajtur e motra. - Sigurisht, të vjen ngaqë je në një gjendje të tillë... je dhe shumë i lodhur... - përfundoi me zë të ulët.

- Si në jerm! Kështu do të thuash?... Ke pranuar të martohesh me Lluzhinin, për të më bërë mirë mua? Kështu është? E pra, këtë therori nuk e pranoj! Nuk e dua!... Bëji një letër dhe shpjegoja si qëndrojnë punët... Ma jep edhe mua ta lexoj!

- Këtë nuk kam si e bëj! - thirri vajza e fyer. - Me ç'të drejtë...

- Dunjeçka, edhe ti po nxehesh! Shkojmë më mirë... Pse nuk e sheh?... - i foli e trëmbur Pulheria Aleksandrovna. - Shkojmë tani... nesër bisedojmë!

- Po flet përçart! - thirri Razumihini ashtu i dehur siç ishte. - Ndryshe s'ka si të jetë! Ndryshe nuk do të guxonte!... Nesër ka për të qenë me mendje tjetër, do ta shihni. Sa për atë që e dëboi sot para dite, kjo

është e vërtetë. Ai tjetri u bë bishë! Erdhi e na mbajti leksion, na shtjelloi dijet, kurse u largua me bishtin ndër shalë...

- Del se qenka e vërtetë ajo që dëgjuam! - u merakos Pulheria Aleksadrovna.

- Shihemi nesër, vëlla, - me zë të përvuajture i tha Dunja. - Shkojmë, mama... Lamtumirë, Rodia.

- Dëgjove, motër, - i thirri nga pas, duke mbledhur edhe ato pak forca që i patën mbetur. - Nuk fola përçart, jo! Dëgjoje dhe mbaje mend këtë që po të them: kjo martesë është vetëm poshtërsi e asgjë tjetër!.. Qofsha unë i poshtër, por ti...jo! Nuk duhet!.. Njëri le të jetë. Unë edhe pse jam i poshtër, një të tillë motër nuk kam si e quaj motër! O unë, o Lluzhini! Shkoni tani...

- Mblidh more mendjen! Ç'je duke bërë? - i ulëriti Razumihini, por Raskolnikovi nuk i ktheu përgjigje, ndoshta ngaqë i kishin shteruar të gjitha forcat. U kthye me fytyrë nga muri dhe s'u ndie. Avdotia Romanovna ia drejtoi sytë kurreshtarë Razumihinit, në ta rrezëllinin xixa; djaloshit i shkuan mornica nga ai shikim. Pulheria Aleksandrovna qëndronte në këmbë si e shkalur.

- Unë nuk largohem që këtu! - i pëshpëriti Razumihinit e dëshpëruar në kulm. - Do rri këtu.. Dunjën çojeni gjëkundi.

- Do të jetë më keq! - po me pëshpërimë ia ktheu ky. - Dalim te shkallët. Nastasia, na bëj pak dritë! Ju betohem, - vazhdoi me zë të ulët. - Qëparë edhe mua, edhe mjekun sa s'na rrahu! E kuptoni? Edhe doktorit iu përvesh!... U larguam që të mos ia ngrinim më keq nervat. Ndënja poshtë dhe bëra roje, por s'e pashë kur më kishte rrëshqitur dhe ia kishte mbathur. Ju them unë, edhe tani ashtu ka për të bërë, po ta bezdisni; pale që është dhe natë, ku i dihet të keqes!...

- Ç'thoni kështu?

- Po. Pastaj edhe Avdotia Romanovna nuk lihet vetëm në atë shtëpi. Ky merhumi, Pjotër Petroviçi, si nuk zuri një apartament për të qenë!... Më falni, se kam pirë ca.. e shava... mos ma merrni për keq...

- Po shkoj t'i lutem pronares të më bëjë strehë sonte, - nguli këmbë Pulheria Aleksandrovna. - Një natë është, ne vetëm sa të futim kokën, unë dhe Dunja. Nuk e lë dot djalin në këtë gjendje! Nuk iki!

Kishin qëndruar para derës së pronares. Nastasia rrinte pranë me qiririn në dorë. Razumihini nuk dinte nga t'ia mbante. Para një gjysmë

ore, kur kishin përcjellë Raskolnikovin, ndjente një gëzim për shokun, ndaj kishte qenë dhe aq fjalëshumë. Tani po i dukej se i kishte rënë në kokë rakia, po e mundte dehja. I kishte kapur të dyja grátë nga krahu dhe u fliste me ton bindës, kohë pas kohe me duart si darë ua shtrëngonte aq fort krahun, sa mezi po e duronin dhimbjen. Kurse Avdotia Romanovnën sikur donte ta përpinte me ata sy të çuditshëm. Ishte në një të tillë euforie, që po t'i thoshin të hidhej kokëposhtë nga shkallët, do ta bënte pa më të voglën lëkundje. Pulheria Aleksandrovna, mendjeprishur nga gjendja e të birit, s'ia vinte fort veshin, ndërsa Avdotia Romanovna, që s'ishte nga ato që tremben, e shihte e habitur dhe zuri të shqetësohej nga ato shikime të çakërryera; vetëm besnikëria që kishte treguar dhe ndihma ndaj të vëllait, siç kishte treguar Nastasia, e përmbanin nga orvatja për t'ia mbathur dhe për të marrë me vete mamanë. E peshoi situatën dhe e kuptoi që edhe për të ikur nuk iknin dot, ndaj s'kaloi shumë dhe deshi s'deshi u qetësua, u pajtua me gjendjen. Ndërkohë Razumihini, që e kishte zakon t'i shfaqej tjetrit vrulltas, erdhi e u qetësua, madje po shfaqej në një dritë krejt tjetër.

- T'i lutemi pronares? Kurrën e kurrës! - thirri, duke iu drejtuar Pulheria Aleksandrovnës. - Ju vërtet që jeni nënë, por qëndrimi juaj do t'ia ngrinte edhe më keq nervat, do ta tërbonte fare! Një Zot e di ç'mund të ndodhë! Ja si do bëjmë: tani le të rrijë me të Nastasia, po ju çoj shpejt e shpejt në apartamentin tuaj, vetëm s'keni si shkoni, këtu në Petërburg ç'nuk ndodh... Pastaj po vij me një frymë këtu, s'do kenë kaluar as dhjetë minuta dhe do t'ju bie lajm për shëndetin e tij. Nga ju do kthej në shtëpinë time, kam mysafirë sonte, jam dehur; do marrë Zosimovin, mjekun që e kuron, nuk është i dehur, nuk pi kurrë! Do ta çoj te Rodia, që aty përsëri tek ju, s'do ketë kaluar as ora dhe përsëri do merrni njoftim për gjendjen e tij, ç'do thotë mjeku, pra, se ai i di këto punë! Në u keqësoftë, ju jap fjalën që do vij t'ju marrë për këtu; po qe mirë, bini e flini se dhe ju keni nevojë për çlodhje... Tërë natën pranë tij do jem, do rri te shkallët që të mos më shohë, mjekun do ta sistemoj te pronarja, po të jetë nevoja, do vete ta ngre nga gjumi. Hë, si thoni, më mirë ju këtu apo mjeku? Kështu që nisemi! Te pronarja ju nuk keni pse shkoni! Unë po, kurse ju jo! Është tarallake e madhe... Do bëhet xheloze, kur t'u shohë! Për Avdotia Romanovnën po e po, por edhe për ju... Është kokë më vete! Ja, edhe unë ashtu jam!... Po,

nejse! Shkojmë! Keni besim te fjalët e mia! Hë?

- Shkojmë, mama! - tha Avdotia Romanovna. - S'kemi pse të mos e besojmë! A nuk është ky njeriu qe e ktheu në jetë vëllanë?... Në rast se edhe mjeku pranon ta kalojë natën aty... s'ka më mirë!

- Ja, ja! Sa mirë më kuptuat! Dhe më kuptuat sepse nuk jeni njeri po ëngjëll! - thirri i entuziazmuar Razumihini. - Shkojmë atëherë! Nastasia, shpejt lart! Mos ia nda sytë! Dritën mos e shuaj! Pas një çerek ore më ke këtu.

Pulheria Aleksandrovna edhe pse nuk u bind nga gjithë ç'u tha, nuk nguli këmbë në të sajën. Razumihini, përkrahu siç i kishte, i bëri të zbrisnin shkallët. "I zellshëm, i mirë duket, po a do jetë në gjendje ta mbajë fjalën? Se kështu siç është..." - mendoi me zemër të ngrirë e gjora nënë.

- E kuptoj, ndoshta thoni me vete, se kështu siç është ky!... - Sikur ia lexoi mendimet Razumihini. Ecte nëpër trotuar me hapa metroshe, gratë mezi po e arrinin. - Gjepura! Që kam pirë, këtë s'ke si e fsheh, por ama nuk jam kështu nga pija... Kur ju pashë ju, atëherë më goditi pija në kokë... Por kini besim tek unë! E ndiej që nuk jam i denjë për shoqërinë tuaj, por, ju jap fjalën, pasi të jeni rregulluar, do ta mbaj frymën drejt e në çezmë, nja dy kova ujë në kokë dhe do ta marr veten... Sikur ta dinit sa shumë më keni hyrë në zemër! As mos qeshni e as mos m'u zemëroni!... Jini aq e mirë me mua! Jam shoku i vëllait tuaj, pra edhe për ju nuk duhet të jem i huaj... Po më duket si dhuratë nga perëndia ky takim me ju! Ju sikur ratë nga qielli!... Mjeku dje seç llomotiti për një krizë çmendurie... Prandaj dhe ngula këmbë që të mos qëndronit...

- Ç'thoni kështu! - u lebetit nëna.

- Mjeku tha kështu? - e pyeti e tmerruar Avdotia Romanovna.

- Po, mjeku, por nuk është e vërtetë! Seç i dha edhe një ilaç. Pastaj edhe kjo ardhja juaj... Eh!... Më mirë do ishte të kishit ardhur nesër! Ama që u larguat, bëtë mirë! Pas një ore Zosimovi do ju raportojë me gojën e tij për gjithçka. Ai nuk është i dehur. Pastaj edhe mua do më ketë dalë pija... Lakmova sonte, e dini pse? Sepse plasi një debat, që aman o Zot! Jam betuar të mos përzihem në debate, por, hënde de, nuk m'u durua! Se thonë ca broçkulla, që s'ka si i duron i gjori njeri! Në shtëpi lashë xhaxhanë me mysafirët... E dini, kërkojnë nga tjetri

që të mohojë vetveten, kështu do na ardhka shpëtimi! Sa më pak u dashka ngjarë me vetveten, sa më pak dashka qenë vetvetja! Dhe e dini, këtij mohimi të vetvetes i kanë vënë emrin progres... Gënjejnë dhe gënjejnë dërrçe!

- Dëgjoni pak, - ndërhyri me droje Pulheria Aleksandrovna, por me këtë vetëm se i hodhi benzinë zjarrit.

- Mos ju shkon në mendje që e miratoj gënjeshtrën e tyre? - thirri Razumihini. - Gjepura! Të thuash të drejtën, që gënjejnë s'bëjnë keq: është e vetmja mundësi për të dalë tek e vërteta. Unë ndaj dhe quhem njeri, sepse gënjej! S'arrihet e vërteta, po nuk gënjeve katërmbëdhjetë herë, ç'ne, një qind e katërmbëdhjetë herë... Dhe po ta shohësh kështu, është fisnik një veprim i tillë, por si i bëhet kur tjetrit as për të gënjyer nuk i arrin mendja? Se, domosdo, edhe gënjeshtra do marifet, duhet të jesh origjinal kur gënjen! Më mirë një gënjeshtër origjinale sesa një e vërtetë e huazuar; në rastin e parë je njeri, kurse në tjetrin s'je veçse zog! E vërteta kurrë nuk ikën, ajo aty fle, kurse jetën njeriu e sajon, pse pak raste ka? Të gjithë ne, pa përjashtim, në fushën e shkencës, të zhvillimit, të mendimit, të shpikjeve, të përvojës dhe, në përgjithësi, të gjithçkaje jemi në klasën e parë të gjimnazit. E rokanisim kokën me mendime të huaja. Mirë po flas? - thërriste sa i hante gurmazi, duke i shtrëguar dhe tundur e shkundur krahët e të dyja grave. - Kështu, apo jo!

- O Zot! Nuk di si t'ju them! - foli shpejt e shpejt Pulheria Aleksandrovna.

- Ashtu është... ndonëse nuk jam për çdo gjë e njëmendjeje me ju, - i foli me seriozitet Avdotia Romanovna. S'e mbajti dot klithmën, aq fort ia shtrëngoi këtë herë krahun kavalieri i ekzaltuar.

- Thatë, ashtu është! Pra, ju?.. - thirri si i çartur. - Ju jeni burim mirësie, pastërtie, arsyeje, jeni njeri i përsosur! Ma jepni këtu dorën! Edhe ju ma jepni! Do jua puth, ja këtu, në gjunjë do jua puth!

Ra në gjunjë para tyre në mes të trotuarit, që, për fat të mirë, ishte pa njerëz.

- Ç'janë këto! Thirri mendjes! - i tha i alarmuar sa më s'bëhet Pulheria Alesandrovna.

- Çohuni! Çohuni! - qeshi Dunja.

- Kurrën e kurrës, po nuk më dhatë duart që t'jua puth! Ja, kështu!

Tani shkojmë. Jam njeri dosido, s'ju vij as te gishti i këmbës. Jam i dehur dhe jam me turp para jush!... S'e meritoj dashurinë tuaj, vetëm t'ju përulem, kjo është detyra ime dhe e kujtdo tjetër... Ja dhe godina e apartamentit tuaj. Qoftë edhe për këtë apartament që zuri për ju, kishte të drejtë Rodioni që e përzuri dje Pjotër Petroviçin! Si guxoi ta bënte! Ju as që e merrni dot me mendje se kush banon në këtë godinë! E pra, ju jeni e fejuara! Saktë është thënë: i fejuari juaj është njeri i poshtër! Qoftë edhe pse zuri për ju këtë apartament.

- Zoti Razumihin, ju harruat... - zuri t'i thoshte Pulheria Aleksandrovna.

- Po, vërtetë, sikur u harrova ca, ju kërkoj ndjesë!... - nxitoi të përligjet Razumihini. - Por...por...s'keni si zemëroheni për atë që thashë! Fola me çiltërsi e zemër!... Nuk e bëra ngaqë... hëm! Ama, në nuk duhet, nuk flas... mirë... Sapo shkeli qëparë ai njeri, e kuptuam: nuk është i sërës sonë! Dhe jo ngaqë i kishte bërë flokët permanent në floktore, jo sepse nxitoi të na e dëftente si në tepsi mendjen, por sepse është gjakpirës, është dredharak dhe allishverishaxhi. Mos e keni pandehur të mençur? Nuk është i tillë! Është budallë e shkuar budallit! Pse si ju është ai? Ja, këtu, zonja! - ndali kur qëndronin para derës së apartamentit. - Atje tek unë ca të dehur janë mbledhur, por janë të ndershëm, ata edhe pse gënjejnë, ashtu siç gënjej dhe unë, do vijë një ditë që do ta gjejnë të vërtetën. Do ta gjejnë, sepse rruga që bëjnë është fisnike, ndërsa Pjotër Petroviçi... shkel ne ca rrugë jo fisnike. Ata atje i shava sa i kërdisa para pak kohe, por për të respektuar, i respektoj. Edhe Zametovin, që nuk e respektoj, e dua, sepse është qenush! Edhe ai kafsha, Zosimovi është si është, por sa për i ndershëm s'e ka shokun! Kështu, domethënë, i folëm e i përfolëm të gjithë, por edhe i falëm! Hë! I falëm apo nuk i falëm? Tani shkojmë!... E njoh mirë këtë koridor, në hyrjen tre dikur ka patur një skandal... Po apartamenti juaj ç'numër ka? Tetë? Ja, ky është. Mbylleni derën me kyç dhe mos ia hapni kujt. Pas një çerek ore më keni këtu, pastaj pas një gjysmë ore do vij bashkë me Zosimovin. Do ta shihni! Lamtumirë!

- O Zot! Dunjeçka, po kjo ç'qe kështu? - iu drejtua së bijës Pulheria Aleksandrovna, duke e parë e alarmuar dhe e frikësuar.

- Qetësohu, moj mama, - iu përgjigj Dunja, hoqi mantelin e saj

dhe ndihmoi edhe të ëmën ta hiqte. - Perëndia me të madh të tij na e bëri për risk këtë zotëri, qoftë edhe të dehur. Them se duhet t'i zëmë besë... se dhe ato që paska bërë për vëllanë nuk janë pak...

- Një Zot e di, Dunjeçka, në do kthehet apo nuk do kthehet! E si m'u mbush medja ta lija ashtu Rodjen!... S'e mendoja kurrë që do ta gjeja në këtë gjendje! Sa prerë që na foli, sikur nuk u gëzua që na pa...

Sytë iu rrëmbushën me lot.

- Jo, s'është ashtu, moj mama! Ngaqë ishit duke qarë, s'i vutë re të tëra. I ka aq të acaruara nervat pas gjithë asaj sëmundjeje që ka hequr, saqë s'e ka në dorë veten!

- E si do t'i vejë filli kësaj të shkrete sëmundje? Si foli ashtu me ty, moj bijë? - tha duke e parë me ndrojtje drejt në sy, për t'ia hetur mendimet që do t'i ngacmonte pyetja e bërë, por u qetësua pak, kur vuri re si po e përligjte Dunja sjelljen e të vëllait; pra, e kishte falur. - Jam e sigurt që qysh nesër do pendohet, - shtoi me synimin që ta çonte deri në fund hetimin.

- Ndërsa unë jam po aq e sigurt që nesër ai do ta përsëris po këtë qëndrim, - foli prerë Avdotia Romanovna, duke prekur kështu çështjen më delikate, pra edhe më kryesore, për të cilën kishte aq frikë Pulheria Aleksandrovna. Dunja iu afrua dhe e puthi të ëmën. Kjo e përqafoi fort heshturazi. Pastaj u ul në pritje të Razumihinit, e pushtuar nga makthi ndiqte ashtu e heshtur çdo lëvizje të së bijës, krahëkryqëzuar, duke pritur lajm nga i vëllai, ecte nëpër dhomë e menduar. Ishte një zakon i vjetër i Avdotia Romanovnës, e ëma ia dinte dhe bënte çmos për ta lënë në atë gjëndje të menduar dhe të heshtur.

Razumihini, s'do mend, që e vuri veten në pozitë qesharake, kur u soll ashtu me zonjat, edhe pse ishte pija ajo që kishte folur. Duke e sjellë në mendje gjithë ç'kishte ndodhur, Avdotia Romanovna, ashtu si do bënte shumëkush tjetër, anonte nga të falurit e këtij njeriu. I kishte rënë një nur i rrallë bukurie, që spikaste veçanërisht në harmoninë e shtatit të saj si selvi me lëvizjet e bukura dhe me vetëbesimin e sigurinë që i shoqëronin. Fytyra i ngjante me të vëllait, por këtë fare mirë mund ta quaje bukuroshe: flokët i kishte të errët, por më pak të zinj se të Rodionit; sytë i kishte të zinj, të shdritshëm, shikimin krenar, por s'qenë të rrallë rastet, kur në ta rrezatohej mirësi e dëlirësi. Vinte pak e zbehtë në fytyrë, por nuk ishte verdhacuke si njeriu pas lëngatës,

fytyra i shkëlqente nga freskia dhe shëndeti. Gojën e kishte pakëz të vockël, por buzën e poshtme e kishte kurdoherë allë të kuqe, i dilte paksa përpara bashkë me mjekrën, dhe ishte ky i vetmi defekt në këtë fytyrë të mrekullueshme, por edhe kjo çrregulli ia theksonte karakterin e qëndrueshëm dhe njëfarë kryelartësie. Fytyrën më shpesh ia shihje serioze se të qeshur, dukej e menduar, por buzagazi i shkonte shumë, e rinonte, e përtërinte.

Kuptohet përse Razumihini, impulsiv dhe i drejtpërdrejtë, njeri i ndershëm, i fuqishëm si ndonjë kreshnik dhe i dehur si rrallëherë mbeti pa mend kur e pa. Për më tepër që i rastisi ta shihte në ca çaste shpërthyese dashurie dhe gëzimi nga takimi me vëllanë, por e pa edhe kur iu drodh buza e poshtme nga indinjata dhe i dha përgjigje dinjitoze të vëllait, kur ky e urdhëroi aq egër dhe aq prapë. I pa këto dhe nuk u përmbajt dot.

Edhe kur u tha që qiramarrësja e Raskolnikovit do bëhej xheloze jo vetëm ndaj Avdotia Romanovnës, por edhe ndaj Pulheria Aleksandrovnës, u kishte thënë të vërtetën. Kjo e dyta, dyzetë vjeçare grua siç ishte, i ruante tiparet e bukurisë së dikurshme, aq më tepër që dukej shumë më e re nga ç'ishte; ndodh shpesh me gratë që s'i lënë t'u shuhen ndjenjat, që i ruajnë të freskëta mbresat dhe dinë të përkujdesen për zjarrin e pastër të zemrës. Theksojmë ndërkohë që kjo është e vetmja rrugë që të çon në ruajtjen e bukurise deri në pleqëri. Flokët vërtet po i thinjeshin, ca zhubra të vockla, dridhmëtare i dukeshin në çipet e syve, faqet i kishin rënë paksa, i ishin tharë nga hallet dhe hidhërimi, e përsëri fytyrën e kishte të mrekullueshme. Ishte tamam Dunja, por pas njëzet vjetësh, me përjashtim të buzës së poshtme që s'i dilte përpara si e së bijës. Pulheria Aleksandrovna ishte sensuale, por jo vulgare; ishte e druajtur dhe e tërhequr, por me masë: lëshonte pe dhe hapte rrugë, madje e bënte edhe kur nuk kishte bindje, veç kishte një cak ndershmërie, normë jete dhe bindje fikse, të cilin kurrsesi nuk e kapërcente, sido që të ishin rrethanat.

Plot njëzet minuta pas ikjes së Razumihinit u dëgjuan të trokitura të lehta në derë. Qe ai.

- Nuk kam kohë! Nuk do hyj! - u tha me ngut. - Po fle, është fare i qetë, do ishte mirë të flinte nja dhjetë orë. Nastasia aty ishte. E porosita të mos e linte vetëm. Po shkoj të marrë Zosimovin, do ta sjell këtu ta

dëgjoni me veshët tuaj ç'do thotë, pastaj edhe ju naninani; dukeni fare të këputura.

U largua pa vonesë.

- Sa i kujdesshëm! Merakli njeri! - tha e gëzuar Pulheria Aleksandrovna.

- Më duket njeri i mirë! - e përforcoi me ndjenjë mendimin e së ëmës Avdotia Romanovna dhe përsëri iu kthye ecejakeve.

Pas një ore u dëgjuan hapa në korridor dhe pastaj një e trokitur në derë. Gratë s'u habitën, tanimë ato nuk kishin as dyshimin më të vogël që kështu do të ndodhte. Me vete kishte sjellë Zosimovin; ky kishte pranuar me qejf t'i bënte një vizitë Raskolnikovit, por te gratë në fillim nuk ia kishte ënda të shkonte, nuk i zinte besë Razumihinit të dehur. Mbeti tejet i kënaqur nga pritja që i bënë: jo mjekun po orakullin kishin futur në derë. Nuk u pendua që kishte pranuar. Ndënji gjithsej dhjetë minuta, por arriti ta bindë dhe ta qetësojë Pulheria Aleksandrovnën. I foli me shumë ndjenjë, por përmbajtur, me seriozitet dhe kujdes, siç bëjnë gjatë konsultave të rëndësishme; foli vetëm për sëmundjen, asnjë shenjë vëmendjeje të posaçme ndaj zonjave nuk manifestoi. Që kur hodhi hapin e parë në atë apartament, i ra në sy bukuria marramendëse e Avdotia Romanovnës, por u kujdes të shtirej sikur nuk vuri re gjë, tërë kohën iu drejtua vetëm të ëmës. Kjo njohje i dha një ngazëllim të madh shpirtëror. Për të sëmurin u tha se nuk gjente asgjë alarmante, se sëmundja ishte rrjedhojë e gjendjes së rënduar materiale këta muajt e fundit, por u tha se kishte edhe disa shkaqe të natyrës morale; u foli edhe për disa hamendësime ende të pabazuara dhe e mbylli me dyshimin se ndodhej i vërshuar nga gjithfarë ide... Kur pa që Avdotia Romanovna po e dëgjonte me përqëndrim të jashtëzakonshëm, Zosimovi e ndjeu për detyrë të bëjë disa shpjegime më të hollësishme lidhur me pikën e fundit të atyreve që tha, ndërsa pyetjes shqetësuese të Pulheria Aleksandrovnës për ndonjë simptomë çmendurie, iu përgjigj i qetë dhe me një nënqeshje të çiltër, duke përfunduar se ndonjë shprehje e tij qenka marrë për kapital. U tha se të sëmurin e mundonte një ide fikse, e më kësisoj dukurish ai, Zosimovi, ishte duke u marrë kohët e fundit, por s'duhej harruar që deri më sot i sëmuri thuajse tërë kohën ka pas qenë në jerm dhe... s'ka dyshim që ardhja e prindit ka për të ndikuar për mirë,

sigurisht, pa harruar që duhen shmangur ngacmimet dhe të papriturat. Pasi e tha tërë këtë, u çua, iu përkul me mirësjellje e përzemërsi zonjave, i shoqëruar nga falënderimet dhe bekimi prindëror, madje edhe nga krahët e hapura për përqafim të Pulheria Aleksandrovnës dhe dora e zgjatur e Avdotia Romanovnës, ndërkohë që ky u mjaftua me një përkulje të sjellshme. U largua tepër i kënaqur nga kjo vizitë, sidomos për anën e tij.

- Nesër do bisedojmë, tani gjumë! - u tha miqësisht Razumihini, duke dalë bashkë me Zosimovin. - Nesër që në mëngjes më keni këtu. Do ju vë në dijeni për gjithçka.

- Ç'vajzë e mrekullueshme kjo Avdotia Romanovna! - s'u përmbajt dot pa thënë Zosimovi dhe lëpiu buzët.

- E mrekullueshme? The e mrekullueshme? - iu gërmuq Razumihini dhe sakaq i vuri duart në fyt. - As në mendje të mos shkojë... E qartë? - shtoi, duke e tundur dhe shkundur shokun nga jaka. - Dëgjove?

- Hiqmu, mor pijanec i dreqit! - i bërtiti Zosimovi dhe, kur ky e lëshoi, e pa drejt në sy dhe ia plasi gazit. Razumihini qëndronte para tij me krahët të lëshuar, i vrenjtur dhe i mendüar.

- Hajvan jam! E di këtë! - tha tërë hundë e buzë. - Por, ama, edhe ti... u shitove.

- Unë? Aspak! Nuk merrem me marrëzi si këto të tuat!

Ecën pa folur; vetëm kur po i afroheshin dhomës së Raskolnikovit, Razumihini ia tha me përgjërim në zë.

- Dëgjo këtu. Pa virtyte ti nuk je, por që të ka dalë dhjami mbi lëkurë dhe të janë squllur fare nervat, kjo është e vërtetë. Për asgjë nuk e çan kokën; tamam çun mamake je. Deri më sot s'kam mundur ta kuptoj si mund të jetë mjek i mirë një si ti, se zanati që ke zgjedhur kërkon vetmohim! Fle në dyshek me pupla, ndërsa zanati ta do të ngrihesh në mes të natës e të shkosh në urgjencë! S'kanë për të kaluar as tre vjet dhe s'ke për t'u ngritur më... Po në djall vafsh! Më dëgjo ku dua të dalë: sonte do flesh në apartamentin e pronares (mezi që ia mbusha mendjen!). Unë do fle në kuzhinë. Është rast ideal që të njiheni nga afër! Jo në atë kuptim që pandeh ti! Aspak...

- Po unë asgjë nuk pandeh.

- Rasti i saj është fare i veçantë: e turpshme, e heshtur, e ndrydhur

në vetvete, e përmbajtur deri në fanatizëm, por ama edhe psherëtimat psherëtima, shkrin si qiriri. Ma heq dot qafe, në më mban për mik?

Zosimovi u gajas së qeshuri, mend po i merrej fryma.

- Mirë, mo, mirë, po mua ç'më duhet një e tillë?

- Atëherë mos i fol fare; rri aty dhe mos u ndje. Ose foli për shëndetin, jepi ndonjë porosi; ka edhe një klavikordë, e di, ti di t'i bjesh; është partitura e një kënge të mrekullueshme: "Lotët me shkojnë çurg...". I pëlqen shumë! S'ke për t'u ndarë keq!...

- Mos i ke premtuar gjë? Mos i ke thënë se do martohesh?

- Jo, jo! Nuk është nga ato ajo! E pat provuar Çebarovi...

- Atëherë, lëre!

- Po si ta lë kështu?

- Lëre dhe ik!

- Është punë që s'bëhet! Se, që the ti, ka dhe diçka që më detyron.

- E ç't'u desh që i hyre kësaj valleje?

- Ç'm'u desh? Po dhe mua ma kishte qejfi; ndërsa për të nuk ka asnjë rëndësi, në jam unë apo je ti, kryesore për të është të ketë kujt t'i shfryjë ato ofet e ufet e saj. E di që e ke qejf matematikën, foli makar për logaritmet, e kam seriozisht; do të dëgjojë, do psherëtijë dhe kaq!... Ja, unë dy ditë rresht vetëm për kuvendin e fisknikëve prusianë i fola, ç'bënte ajo ndërkohë: psherëtinte dhe tundte kokën. Vetëm për dashurinë mos bëj gabim t'i flasësh, është kaq e turpshme, sa ka rrezik ta tundin të dridhurat. Ama duhet bërë sikur ke ngecur keq dhe s'të iket prej saj... kaq! Asnjë telash s'do kesh, ta them unë! Do ndihesh si në shtëpinë tënde, merru me ç'ta dojë zemra: lexo, shkruaj, në do rri shtrirë... Edhe për ta puthur, mund ta puthësh, veç kujdes...

- E ç'më duhet një e tillë?

- Unë nuk di si ta shkoqis më qartë! Që shkoni me shoshoqin, këtë as topi s'e luan! Kam kohë që e vras mendjen si t'u lidh! Se ti një ditë ke për t'u martuar, më mirë shpejt se vonë! E butë dhe e ëmbël është çdo gjë aty! Do rrosh në pupla rehat e pa asnjë telash! Petulla, byrekë e ëmbëlsira pa hesap; mishi po mish, si ta dojë qejfi, mbrëmjeve po samovari, psherëtimat psherëtima, qoshja e ngrohtë, shtrati me pupla! Të gjitha të mirat! Shkojmë tani, pak kohë na mbeti për të fjetur. Më del nganjëherë gjumi natën, do shkoj ta shoh atë atje, ç'është duke

bërë! Asnjë nevojë nuk ka, e di, por nga meraku do ta bëj. Ti mos e prish gjumin, vetëm në t'u mbushtë mendja çohu e shihe. Në e sheh që flet përçart, ka zjarrllëk, apo çë tjetër, më thirr edhe mua. Po jam i sigurt që asgjë të tillë nuk ka për të patur...

II

Të nesërmen rreth orës tetë, Razumihini u zgjua në merak, koka i ziente nga gjithfarë mendimesh. Ndërmendi sjelljen e djeshme dhe u bind që i kishte ndodhur diçka e pazakontë, mbresat e përftuara kishin qenë të tilla, që s'i kishte patur kurrë më parë. I vetëdijshëm për faktin që ëndrra për t'u afruar me të motrën e Raskolnikovit, s'kishte si bëhej realitet, i erdhi turp nga vetja, dhe aty për aty e kaloi mendjen te përkujdesjet e shumta dhe telashet *e mrekullueshme* që e prisnin.

E mundonte sidomos prezantimi "banal, madje poshtërues" që i kishte bërë dje vetes dhe jo vetëm nga dehja, por sidomos nga mospërmbajtja e gojës, lëshuarja pa fre, nëpërkëmbja e të fejuarit dhe xhelozia. Nuk i falej, sepse as që dinte ç'marrëdhënie kishin, pale pastaj që edhe tjetrin s'e njihte me tamam. Me ç'të drejtë kishte folur ashtu? Kush ia jepte rolin e gjyqtarit? Pse a mundej një vajzë si Avdotia Romanovna t'ia besonte fatin një të padenji? Pra, s'ka si të jetë pa merita ai njeri! Apartamenti? Po ndoshta s'ka ditur gjë për të! Për vete ishte duke përgatitur një tjetër apartament... Poshtërsi, asgjë më pak, kishte bërë! Dehja nuk e shfajësonte, vetëm ia thellonte gabimin! Pija e zbërthen njeriun, atij ia nxori në sipërfaqe palavinë e ziliqarit dhe të shpirtkazmës. Pse i lejohet atij kjo ëndërr? E ç'është ai në krahasim me këtë vashë? Një pijanik, llapazan dhe mburravec! U skuq dhe u bë flakë nga këto mendime, sidomos poshtëruese iu dukën fjalët e thëna për xhelozinë e pronares, po ta shihte me Avdotia Romanovnën. Budallallëk me thes! I ra fort me grusht sobës, e vrau dhe e dërrmoi dorën, luajti vendit edhe një tullë.

"Sigurisht, - tha me vete pas një minute me një ndjenjë poshtërimi, - këtë që bëra, s'ke si e fshin... ndaj t'u paraqitem kokulur, i heshtur dhe të bëj gjithë sa mundem... pa u kërkuar ndjesë, pa folur as dhe një fjalë për atë që ndodhi... Kuptohet, asnjë shpresë s'kam pse i nxit

vetes!".

Sidoqoftë, para se të vishej, e pa dhe e stërpa kostumin, nuk kishte tjetër, por edhe po të kishte patur; "enkas nuk kisha për ta ndërruar!". Veç edhe llosh njeri nuk ia kishte ënda të dukej, nuk duhej të fyente të tjerët, që, për më tepër, ishin në nevojë. Kostumin e fshiu mirë dhe e solli në gjendje të rregullt. Këmisha ishte e pastër, kujdesej veçanërisht për këtë.

U la e u shpëla si asnjëherë: lau kokën, qafën, fërkoi sidomos fort duart me sapunin që i dha Nastasia. Pasi i bëri vetes pyetjen, të rruhej apo të mos rruhej (pronarja kishte një brisk të mirë që i kishte mbetur pas vdekjes së të shoqit), përgjigjja ishte e prerë: "Jo! Nuk do rruhem!" Do mendojnë që u rrova taze enkas... Jo! Nuk do rruhem! "E njoh mirë veten, - vazhdonte të arsyetonte. - me të tjerët sillem me takt e me kujdes, kush më njeh, më mban për njeri të sjellshëm, s'jam i tillë, siç ju paraqita dje atyre zonjave, por pse duhet bërë në mënyrë demonstrative? Njeri si të gjithë njerëzit, nuk jam edhe pa gjynahe... E si mund të më shkoj mendja ta vë veten pranë Avdotia Romanovnës?! Po nesje! Të dalë ku të dalë! Kështu si jam do t'u paraqitem!".

Me këto mendime e mëdyshje e gjeti Zosimovi, që kishte fjetur rehat në dhomën e bollshme të Proskovia Pavllovnës.

Ngutej për diku, por sidoqoftë u ngjit për të parë të sëmurin. Razumihini i tha se ishte duke fjetur, mjeku i porositi të mos e zgjonin deri sa t'i dilte vetë gjumi. Tha se do vinte për një vizitë tjetër në ora njëmbëdhjetë.

- Në e gjetsh në shtëpi! - i tha Razumihini. - Se ti as mbi pacientin nuk ke pushtet! Nuk dimë një gjë: do shkojë ai tek ato, apo ato do vijnë tek ai. Sa për mua, unë do largohem, sepse do zënë të flasin për çështje familjare, kurse ti, si mjek që je, rri, është e drejta jote të rrish.

- Po unë pastor nuk jam; do vij dhe do largohem me të mbaruar punë. Edhe pa ta jam i zënë deri në fyt!

- Më shtie në merak vetëm një gjë, - tha Razumihini i vrenjtur. - Mbrëmë, i dehur siç isha, ç'nuk llapa dhe, ndër të tjera, u thashë që ti dyshon mos është i çmendur... E di që e shkela me të dyja këmbët, më rrih, po deshe! Tani të pyes: a e ke patur vërtet një mendim të tillë?

- E ç'më pyet, po pse ty a nuk t'u duk ashtu? Edhe ti e ke shprehur një dyshim të tillë! E tepruam ca! Po për bojaxhiun harrove ç'the?.. I

dëgjoi të gjitha në atë gjendje të tronditur! Ta kisha ditur si e kishte fyer ai hajvani, zëvendës shefi, në zyrat e policisë, nuk do t'i kisha lejuar kujt të fliste ashtu në prani të tij... në një të tillë gjendje i sëmuri dhe mizën e bën buall! Për mendimin tim, tregimi që bëri për të dje Zametovi hodhi dritë mbi më se gjysmën e çështjes. E di? Njihet një rast, kur një hipohindrik dyzetëvjeçar në tryezë i futi thikën në gurmaz një fëmije tetë vjeç, ngaqë nuk i duroi dot talljet që i bëheshin... Kurse ky, në atë gjëndje që ishte, sëmundja po në fillimet e saj, dyshimet dyshime... Shtoi kësaj edhe natyrën e sedërliut të sëmurë... Për mendimin tim, këtu e ka zanafillën sëmundja. Dëgjo këtu: Zametovi nuk është djalë i keq, por dje nuk bëri mirë që foli ashtu... mbill e mos korr! Llafazan e tregoi veten!

- E kujt ia tha, ty edhe mua!

- Edhe Porfirit!

- E çë pastaj që ia tha Porfirit?

- Nuk e di në ke ndopak kredi në sy të nënës dhe motrës së tij. Do bëje mirë t'ua ngulisje në kokë që të kishin kujdes me të...

- Do pajtohen, - foli i shkujdesur Razumihini.

- Po që iu vërsul ashtu Lluzhinit, kjo ç'domethënie ka? Është i kamur dhe më duket që të motrës i pëlqen!... Vetë këta janë pa një grosh në xhep! Kështu apo jo?

- E ç'më pyet mua për këto? - i bërtiti i nervozuar Razumihini. - Shko e pyeti!

- Fare budallë tregohesh nganjëherë! Duket ajo, që ende s'të ka dalë pija... Mirupafshim! Falënderoje Proskovie Pavllovnën për jatakun. Qe mbyllur brenda dhe përshëndetjes sime nuk iu përgjigj. U ngrit në shtatë të mëngjesit, samovarin ia çuan përmes kuzhinës, mua s'më bëri zë...

Ishte ora nëntë, kur Razumihini trokiti në derën e grave. Këto kishin kohë që ishin çuar dhe po e prisnin. Hyri i ngrysur dhe i përshëndeti si me turp, por atypëraty e qortoi veten: Pulheria Aleksandrovna i doli përpara, ia mori të dyja duart dhe ia puthi. Razumihini i hodhi një shikim të druajtur Avdotia Romanovnës, në fytyrën prej kryelarteje pa një falënderim të thellë. (Në vend të shikimit tallës dhe përbuzës që priste të shihte). E ndjeu keq veten, më keq se sikur ta shanin. U trubullua dhe u hutua. Për fat zonjat mezi prisnin që t'u

tregonte të rejat për gjendjen e Raskolnikovit. U kap pas kësaj.

Kur dëgjoi: "ende nuk është zgjuar", por "çdo gjë është si s'ka më mirë", - Pulheria Aleksandrovna u gëzua. E ftuan të pinin bashkë një çaj, enkas nuk kishin pirë, po e prisnin të vinte. Avdotia Romanovna i ra ziles, porositi çajin dhe një kamarier zhelan i serviri çajin në dy gota të pista dhe fare keq; gratë u bënë me turp. Razumihinit dhëmbët ia mbajtën sharjet për banesën, por iu kujtua Lluzhini dhe heshti, u turbullua edhe më dhe u gëzua shumë, kur Pulheria Aleksandrovna s'vonoi ta bombardonte me pyetje.

Iu përgjegj jo më pak se tre çerek ore, i ndërprerë herë mbas here nga pyetjet e saj, ia bëri të ditur aspektet kryesore të jetës së Rodionit në Petërburg dhe e mbylli tregimin e zgjatur me fjalët për sëmundjen. Kuptohet, la edhe pa thënë, kështu duhej, ndër të tjera rastin e të fiktit në zyrat e policisë. E dëgjonin me përqëndrim të jashtëzakonshëm. Kur mbaroi dhe pandehu se ua kishte shuar kureshtjen, doli që për to kishte qenë vetëm në fillim të tregimit.

- Po ju, ju vetë si mendoni? Na falni, nuk ua dimë as emrin, - nxitoi ta pyes Pulheria Aleksandrovna.

- Dimitri Prokofiç.

- Pra, Dimitri Prokofiç, do të desha shumë, po shumë të dija për sjelljen dhe mendimet e tanishme të tim biri, ç'i pëlqen e ç'nuk i pëlqen. Gjithmonë kështu është i nervozuar dhe i tendosur? Ç'dëshira ka? Ç'kërkon të arrijë?

- Mama, po a mund t'u përgjigjet tjetri këtyre pyetjeve? - ndërhyri Dunja.

- Nuk e prisja ta gjeja në këtë gjendje, Dimitri Prokofiç.

- Dhe është krejt normale ajo, që s'e prisnit, - iu përgjegj ky. - Unë vetë nuk kam nënë, por xhaxhai më vjen në të rrallë dhe thotë që s'më njeh, ndërsa ju keni tre vjet që nuk e keni parë, ndryshimet, me siguri, që janë të mëdha. Me Rodionin njihemi që prej një viti e gjysmë, kurdoherë të mërzitur e të zymtuar e sheh, kryelartë dhe, madje, edhe fodull. Kohët e fundit, por ndoshta edhe më parë, preket shpejt dhe merr flakë për hiçmosgjë. Por është zemërmirë dhe i dashur, ndonëse nuk i pëlqen t'i shfaqë ndjenjat, sillet vrazhdë me të tjerët, mirësinë që ka e struk brenda vetes. Jo rrallë tregohet shpërfëllës i ftohtë, deri zemërgur. Të duket se rrojnë dy njerëz brenda një njeriu, këta

çuditërisht këmbejnë njëri-tjetrin. Ndodh të mos flasë me orë të tëra, madje dhe të rrijë shtrirë pa bërë asgjë. Nuk i pëlqen shakaja, jo ngaqë nuk di ta bëjë, por ngaqë nuk ka kohë të merret me gjepura. Ndodh që ti i flet, kurse ai s'e ka aty mendjen. Nuk tregon interes për ato që në një kohë të caktuar janë në qendër të vëmendjes së të tjerëve. Veten e çmon lart dhe ka një farë të drejte. Çfarë t'ju them tjetër?... Shpresoj që ardhja juaj do ta shpëtojë nga e keqja që e ka pllakosur.

- Dhëntë Zoti! - foli e përgjëruar Pulheria Aleksandrovna, pikë vreri nga gjithë sa kishte dëgjuar.

Pas këtij tregimi aq të gjatë, Razumihini mori guxim të shihte pak më lirshëm nga Avdotia Romanovna. Edhe kur tregonte, i kishte hedhur ndonjë shikim, por si vjedhurazi; Avdotia Romanovna herë ulej në tryezë dhe dëgjonte e përqendruar, herë çohej dhe ecte nga qoshja në qoshe, siç e kishte zakon; krahët i mbante të kryqëzuar në kraharor, buzët të shtrënguara, pamjen e kishte të merakosur. Edhe kur bënte ndonjë pyetje, s'i ndalonte ecejaket, vazhdonte të ishte e përqendruar. E kishte dhe kjo zakonin e të vëllait: nuk e dëgjonte deri në fund ç'i thuhej. Ishte veshur me një fustan krepi të errët, në qafë kishte hedhur një shami mëndafshi. Razumihinit i ra në sy varfëria e skajme e të dyja grave. Të ishin të veshura si mbretëresha, s'do t'i trëmbej syri, tani që i vuri re sa të varfra ishin, e pushtoi tmerri, dridhej nga çdo fjalë që nxirrte, nga çdo lëvizje që bënte; kjo natyrisht e bezdiste, për më tepër që ndiente një lloj pasigurie.

- Na treguat shumë gjëra me interes për vëllanë dhe... treguat pa pasion. Gjë e mirë; pata pështypjen se e mbanit për idhull, - i tha me buzën në gaz. - Nuk do ishte keq të gjente një bashkëudhëtare jete, - shtoi mendueshëm.

- Unë nuk e thashë një gjë të tillë, por mendimi që po shprehni qëndron, vetëm...

- Vetëm çfarë?

- S'ka ndonjë që e dashuron, ndoshta dhe s'ka për ta patur, - tha prerë Razumihini.

- Del që nuk është i aftë për të dashuruar?

- Dëgjoni, Avdotia Romanovna; ju ngjani si dy pika uji me vëllanë! - i tha pa ditur as vetë ç'po thoshte. Kur i thirri mendjes që ai vetë sapo i kishte folur për vëllanë, u skuq dhe u turbullua aq keq, saqë

nuk po gjente vend ku të futej. Avdotia Romanovna s'duroi dot pa qeshur, kur e pa në atë gjëndje.

- Për Rodien ju të dy gaboheni, - ndërhyri Pulheria Aleksandrovna e prekur në sedër nga ato që u thanë. - Nuk flas dot për gjendjen e tanishme, Dunjeçka. Ato që na shkruan për të Pjotër Petroviçi... dhe ajo që menduam ne të dyja, ndoshta, s'janë të vërteta, por ju, Dimitri Prokofiç, as që mund ta merrni me mendje sa takanjoz që është, është kokë më vete ai... Kurrë nuk i kam zënë besë karakterit të tij, madje edhe kur ishte pesëmbëdhjetë vjeç. Them se tani mund të bëjë diçka të tillë që askush, kurrë s'e bën... E dini sa shumë më habiti, më tronditi, më la pa mendje dy vjet të shkuara, kur donte të martohej me të bijën e kësaj Zarnicinës, të pronares së dhomës ku banon?

- Mos dini ndonjë hollësi për këtë? - e pyeti Avdotia Romanovna.

- Kujtoni ju se kishin për ta ndaluar lotët e mia, lutjet e mia, sëmundja ime ndoshta dhe vdekja ime nga marazi, pa zënë ngoje pastaj varfërinë tonë? - shtoi me zjarr Pulheria Aleksandrovna. - Aspak. Do të bënte si i kishte shkrepur, patjetër që do të shkonte e tija. Po a mund të thuash që nuk na do?

- Kurrë nuk ma ka zënë ngoje këtë, - foli me shumë kujdes Razumihini, - por diç kam dëgjuar nga zonja Zarnicina, që edhe për të treguar si të gjithë njerëzit nuk di të tregojë, por ajo që dëgjova, më çuditi.

- Po ç'paskeni dëgjuar? - e pyetën me një zë të dyja gratë.

- Asgjë të veçantë; kam dëgjuar që ajo martesë nuk u bë, për arsyen se vdiq nusja, ndërsa zonja Zarnicina nuk e paska dëshiruar... se vajza paska qenë e sëmurë... dhe çudane... por jo pa dinjitet. Ndryshe s'kishte si të ishte! Prikë nuk paska patur dhe ajo nuk i është kërkuar... Është një nga ato çështjet që zor t'i gjykosh.

- Jam më se e sigurt që duhet të ketë qenë vajzë me dinjitet, - tha me zë të ulët Avdotia Romanovna.

- Zoti më ndieftë, por u gëzova që ajo vajzë ndërroi jetë, ndonëse nuk i dihej kush po e merrte më qafë tjetrin: ai apo ajo! - tha Pulheria Aleksandrovna. Pastaj me kujdes, duke bërë ndalesa të shpeshta dhe duke parë herëpashere nga Dunja, së cilës kësisoj shikimesh nuk i pëlqenin fare, iu kthye përsëri bisedës rreth asaj që ndodhi ndërmjet Rodies dhe Lluzhinit. Me ç'dukej ky incident e preokuponte veç të

tjerëve, dukej e tmerruar, e drithëruar. Razumihini bëri ç'bëri dhe e tregoi edhe një herë ngjarjen që nga e para, duke shtuar ndërkaq edhe këtë përfundim të vetin: Raskolnikovi e kishte fyer me paramendim, nuk kishte të bënte sëmundja në atë mes. - Dukej që e kishte paramenduar para se të sëmurej atë skenë, - përfundoi.

- Edhe unë i këtij mendimi jam, - e mbështeti Pulheria Aleksandrovna me pamje të vrarë. Veç s'i shpëtoi, madje e habiti qëndrimi tepër i kujdesshëm, i matur i Razumihinit, në ndonjë rast vuri re edhe nuanca respekti në thëniet e tij për Pjotër Petroviçin. Edhe Avdotia Romanovna u habit nga ky qëndrim.

- Pra, ky qenka mendimi juaj për Pjotër Petroviçin? - s'iu durua pa e pyetur më në fund Pulheria Aleksandrovna.

- Për bashkëshortin e ardhshëm të vajzës suaj unë nuk kam si të kem mendim tjetër, - iu përgjigj prerë dhe i vendosur Razumihini. - Dhe e them këtë jo nisur nga mirësjellja banale, por sepse... sepse... qoftë edhe ngaqë vetë Avdotia Romanovna, me vullnetin e saj, e ka zgjedhur atë njeri. Në llapa ndonjë broçkull mbrëmë, më ndodhi ngaqë isha i dehur... fola pa mendje... nuk isha në terezi... Më skuqen faqet nga gjithë sa thashë e ç'më ndodhi... - u bë lulëkuq në fytyrë dhe heshti. Avdotia Romanovna edhe ajo u skuq. Që kur kishin zënë të flisnin për Lluzhinin, nuk kishte nxjerrë as dhe një fjalë.

Tani pa përkrahjen e së bijës, Pulheria Aleksandrovna po ngurronte ta vazhdonte këtë bisedë. Më në fund, duke iu mbajtur goja dhe duke parë me ndrojtje nga e bija, vuri në dukje se në çastin e dhënë e shqetësonte vetëm një problem.

- Dimitri Prokofiç, - iu drejtua sakaq. - Dunjeçka, a t'ia them të gjitha Dimitri Prokofiçit?...

- Pse jo, moj mama, - i dha zemër e bija.

- Ja si qëndron puna, - foli me ngut, si t'i kishin hequr një mal nga supet. - Sot ndaj të gdhirë morëm një pusullë nga Pjotër Petroviçi, si përgjigje për njoftimin e mbërritjes sonë dje. Duhej të dilte të na priste, sipas premtimit, por dërgoi një shërbëtor me adresën e këtij apartamenti, i kishte thënë se do na bënte një vizitë të nesërmen. Sot në mëngjes na dërgoi këtë pusullë... lexojeni dhe na thoni ç'mendoni, Dimitri Prokofiç. Ju më mirë se kushdo tjetër e njihni natyrën e Rodjes dhe mund të na jepni një këshillë me vlerë. Se Dunjeçka e mori

vendimin menjëherë, pa u lëkundur, kurse unë ende lëkundem... Ja, ju prita ju...

Razumihini e hapi pusullën, që mbante datën e ditës së djeshme, dhe lexoi sa më poshtë:

"Mëshirëplota zonja Pulheria Aleksandrovna!

Kam nderin t'u vë në dijeni se për shkak të disa pengesave të paparashikuara, nuk munda të dilja t'ju prisja në stacion, dërgova për këtë gjë një njeri i kujdesshëm. Detyrohem t'ia privoj vetes kënaqësinë e takimit me ju dhe nesër në mëngjes, për shkak të punëve të pashmangshme, janë ca çështje të senatit që më kanë përpirë të tërin, por edhe për të mos u bërë pengesë që të takoheni me djalin tuaj, ndërsa Avdotia Romanovna me vëllanë. Do të kem nderin t'ju përshëndes përulësisht në apartamentin tuaj vetëm nesër pas orës tetë të mbrëmjes, duke bashkëngjitur sakaq lutjen këmbëngulëse që në atë takim tonin Rodion Romanoviçi të mos jetë i pranishëm, sepse më ka fyer në mënyrë të pashembullt në vizitën e djeshme që i bëra, si i sëmurë që ishte, por edhe duke u nisur nga lutja juaj për disa shpjegime kokë më kokë me të, për çka dëshiroj të dëgjoj dhe shpjegimin që ju vetë do t'i bëni asaj që ndodhi. Kam nderin t'u bëj të ditur se, nëse Rodion Romanoviçi, pavarësisht nga kjo kërkesë, do të jetë i pranishëm në këtë takim, do largohem menjëherë dhe të gjitha pasojat do rëndojnë mbi ju. E shkruaj për të mos u befasuar nga të papriturat e ardhshme, sepse Rodion Romanoviçi, që në atë vizitë dukej aq i sëmurë, jo më vonë se pas dy orësh, u ndie shëndoshë e mirë dhe, ndoshta, mund të kthejë edhe nga ju. E kam parë me sytë e mi në apartamentin e një pijaniku, të cilin e shtypi karroca; aty vajzës së përdalë të tij i dha dje njëzet e pesë rubla me pretekstin e përdorimit për varrimin e të atit, gjë që më habiti tej mase, duke e ditur se me çfarë mundimi i mblodhët ju ato para.

Më lejoni t'i shpreh respektin tim më të thellë Avdotia Romanovnës, pranoni ndjenjat e një përkushtimi të posaçëm,

Shërbëtori juaj besnik

P.Lluzhini".

- Si t'ia bëj, Dimitri Prokofiç, - e pyeti Pulheria Aleksandrovna gati për t'u shkrehur në vaj. - Si t'i them Rodies që të mos vijë? Më

kërkoi të ndërpres çdo marrëdhenie me Pjotër Petroviçin, ndërsa mua do më duhet t'i them që është i padëshirueshëm në atë takim! Po Rodia, në e marrtë vesh, ka për të ardhur enkas. Ia di kokën! Ç'do të ndodhë atëherë?

- Duhet të veproni ashtu si ka vendosur Avdotia Romanovna, - i tha fare i qetë Razumihini.

- Zot i madh! Ajo thotë... thotë dhe nuk ma shpjegon qëllimin, nuk e di se ku do të dalë! Thotë që më mirë do të ishte, domethënë jo më mirë, por është e domosdoshme që sot në ora tetë të jetë këtu edhe Rodia, duhet enkas të vijë që të takohen... Unë them të mos ia tregoj këtë pusullë Rodias dhe me ndihmën tuaj të pengojmë ardhjen e tij në këtë orë te ne... Është shumë i nervozuar dhe paqejf. S'e mora vesh se kush na qënka ky pijanik që e paska shtypur karroca, kush na qënka kjo vajzë dhe si ia paska dhënë paratë e fundit që kishte... të cilat...

- Të cilat ju i keni mbledhur si plaga qelbin, moj mama! - shtoi Avdotia Romanovna.

- Nuk ka qenë fare në vete dje, - foli mendueshëm Razumihini. - As që mund t'i merrni më mendje numrat që bëri në pijetore... Me mençuri i bëri të gjitha, por... Dje, kur po ktheheshim në shtëpi, ma zuri ngoje këtë rast, por s'mora dot vesh gjë prej gjëje... se dje edhe unë...

- Bëjmë mirë të shkojmë te Rodia që tani, moj mama! Aty dhe e vendosim çdo gjë. U bë vonë... është ora njëmbëdhjetë! - thirri, kur pa orën e mrekullueshme prej floriri, me shesh farfurie, që i varej në qafë në një zinxhir të hollë venediku dhe që nuk shkonte aspak me veshjen tjetër. "Dhuratë e të fejuarit", - tha me vete Razumihini.

- Po, po! U bë shumë vonë, Dunjeçka! - u ngrit e merakosur Pulheria Aleksandrovna. - Mos kujton që po i mbajmë mëri për atë që ndodhi... O Zot!

Hodhi me të shpejtë mantelin krahëve, vuri kapelen në kokë. Edhe Dunjeçka u bë gati shpejt e shpejt. Dorezat i kishte jo vetëm të mbajtura, por edhe pak të grisura, që i ra në sy Razumihinit. Kurse veshja varfanjake u dha grave një dinjitet të veçantë, siç ndodh kurdoherë me ata që dinë të paraqiten me rroba të vjetra.

Razumihini e pa Dunjeçkën me një nderim të thellë dhe u ndie

krenar që ishte ai që do ta shoqëronte. "Mbretëresha që arnonte çorapet në qelinë e burgut, - tha me vete, - në ato çaste dukej edhe më shumë mbretëreshë se në darkat dhe pritjet mbretërore, në daljet pompoze!".

- O Zot! - thirri Pulheria Aleksandrovna. - A mund të më shkonte ndonjëherë në mendje që do t'i trëmbesha takimit me tim bir? Me Rodien tim të dashur! Me shpirtin tim të vetëm! E pra, kam frikë!... Kam frikë, Dimitri Prokofiç! - shtoi dhe e pa e pezmatuar.

- Mos kini frikë, mama! - i tha Dunja dhe e puthi. - Do bënit mirë të kishit besim tek ai! Ja, unë kam besim!

- Ah! Zot i madh! Por edhe unë kam besim, moj bijë! Mbrëmë tërë natën nuk vura gjumë në sy! - rënkoi e mjera nënë.

Dolën në rrugë.

- E di, Dunjeçka? Ndaj të gëdhirë sikur më kishte mundur gjumi; pashë në ëndërr Marfën, Marfa Petrovnën... të veshur me të bardha... M'u afrua, më kapi nga dora, ndërkohë kryet i shkonin sa andej-këtej: më shihte qortueshëm, rreptë... Ç'thua të jetë! Ah, Dimitri Prokofiç, ju s'e dini që Marfa Petrovna vdiq!

- Kush është kjo?

- Vdiq pa pritur e pa kujtuar...

- Më vonë këto, moj mama, - ndërhyri Dunja. - E nga ta dijë kush është Marfa Petrovna?

- Ah? Pandeha se e dini. Më falni, Dimitri Prokofiç. Kam filluar të lajthis kohët e fundit. Jeni ëgjëlli shpëtimtar yni, ndaj dhe thashë se e dinit... Mos m'i merrni për keq këto fjalë. Po dora e djathtë ç'u paska? E keni vrarë?

- Po, e kam vrarë, - belbëzoi Razumihini i lumturuar.

- Nganjëherë flas shumë dhe them edhe gjëra që s'duhen thënë, por Dunjeçka më korigjon... Zot i madh! Po ajo e Rodies nuk ishte dhome, ishte musëndër!... U zgjua nga gjumi?... Kurse e zonja e shtëpisë e mban për dhomë... Thoni që s'i pëlqejnë përgjërimet, ndoshta do ta mërzis me këto psherëtimat e mia... me këto dobësi që kam... Më mësoni, Dimitri Prokofiç, si të sillem me të? E kam humbur toruan fare, s'di ç'flas e ç'bëj!..

- Mos e mundoni me pyetje, po ta shihni që rrudhos fytyrën, sidomos për shëndetin mos e pyesni; nuk ia ka qejfi!

- Ah, Dimitri Prokofiç, sa e rëndë është të jesh nënë! Ja dhe hyrja...

shkallët... ç'shkallë të tmerrshme që janë!..

- Mama, ju ka ikur fytyra fare, qetësohuni tani, shpirte! - e luti Dunja dhe e përkëdheli. - Do gëzohet shumë, kur t'ju shohë! Më kot e mundoni kështu veten! - i tha, duke rrezëllitur sytë e zinj.

- Ju prisni këtu, unë po shkoj të shoh në është zgjuar apo jo?

Gratë ndalën para derës së pronares dhe nëpër të çarën e saj panë dy sy të zinj të lëvizshëm që i shihnin nga errësira. Kur shikimet e tyre u ndeshën, dera u mbyll zhurmshëm aq fort, saqë Pulheria Aleksandrovna sa s'thirri prej befasisë.

III

- Është fare mirë! - u tha me zë të lartë, të gëzuar Zosimovi të sapoardhurve. Kishte nja dhjetë minuta që ishte aty, i strukur në qoshkun e preferuar në fund të kanapesë. Raskolnikovi rrinte ulur në anën tjetër, i veshur e i larë me kujdes, gjë që prej kohe nuk e kishte bërë. Dhoma u mbúsh plot, por Nastasia nuk u nda nga vizitorët, qëndroi mënjanë për të dëgjuar ç'do flitej.

Raskolnikovi dukej mirë, sidomos po ta krahasoje me të djeshmen, vetëm se ishte mehit në fytyrë, shihte si i shastisur dhe qëndronte i zymtë. Ngjante me një të plagosur apo me një që ka hequr dhimbje të mëdha fizike: vetullat i mbante të rrudhura, buzët të shtrënguara, shikimin e kishte të terratisur. Fliste pak dhe si me përdhunë, sikur po plotësonte një detyrim; të gjitha lëvizjet ia shoqëronte një shqetësim i pandashëm. Vetëm fashat i mungonin, që të mendoje sa shumë plagë të rënda që duhej të kishte marrë!

Veç fytyra e murrëtyer iu ndriçua nga një rreze drite, kur pa të hynin në dhomë nënën dhe motrën, por edhe në këtë rast një vuajtje e thellë ia përshkonte tërë qënien, shastisja dhe pikëllimi edhe në këto çaste nuk e braktisën. Rrezja e dritës u shua shumë shpejt, në fytyrë i mbeti vetëm vuajtja, dhe Zosimovi, që nuk linte t'i shpëtonte as luhatja më e vogël në fizionominë e të sëmurit, me pasionin e mjekut të ri kurues, vuri re jo pa habi se, në vend të gëzimit, spikati një vendosmëri e fshehur për ta duruar me dhëmbë të shtrënguara torturën e pashmangshme. Ndërkohë po vëzhgonte që çdo fjalë e bisedës sikur ia ngac-

monte plagën dhe ia keqësonte humorin edhe kështu fare përtokë, por mbeti i habitur nga zotësia e pacientit për të mos e dhënë veten, për t'i ndrydhur ndjenjat që aq bujshëm e kishin vërshuar të djeshmen.

- Po, e ndiej fare të shëruar veten, - u tha, duke i puthur me përzemërsi nënën dhe motrën. Pulheria Aleksandrovna sa s'fluturonte nga gëzimi që po i bëhej kjo pritje. - Dhe po e them këtë jo me gjuhën e djeshme, - shtoi, duke iu drejtuar Razumihinit dhe duke ia shtrënguar përzemërsisht dorën.

- Edhe unë po habitem me ndryshimin! - tha Zosimovi i gëzuar nga ky grumbullim njerëzish të këndshëm. - Edhe nja tri a katër ditë e çdo gjë do jetë si më parë, dua të them, si para një muaji... Se kjo që ndodhi, u përgatit shkallë-shkallë. Dhe, duhet ta pranoni, ju vetë nuk jeni pa faj për këtë që ndodhi... - shtoi me një buzagaz të lehtë, i ndrojtur mos e lëndonte.

- Ka shumë mundësi, - iu përgjigj ftohtë Raskolnikovi.

- Se, - vazhdoi Zosimovi, që mori zemër nga kjo përgjigje, - shërimi është kryekëput në dorën tuaj. Meqë ra fjala, do desha t'u këshilloj të mënjanoni tërë ata faktorë që ndikuan në shfaqjen e sëmundjes, vetëm kështu do të mundeni të shëndosheni përfundimisht, ndryshe ju pret keqësimi. Për mua, faktorët fillestarë janë të panjohur, por ju i dini, s'keni si të mos i dini! Për mendimin tim, shtysa e parë e keqësimit të gjendjes ishte largimi nga universiteti. Nuk keni si bëni pa mësimet; puna dhe qëllimi i qartë janë, sipas meje, ilaçi më i mirë për ju.

- Keni të drejtë...ashtu do bëj... do kthehem në universitet... Çdo gjë do më kalojë... Në rregull do jem...

Zosimovi, që e kishte nisur këtë këshillë të mençur edhe për të bërë përshtypje te gratë, u ndie disi i befasuar kur ngriti kokën dhe pa në fytyrën e pacientit një tallje të pafshehur. Por kjo zgjati vetëm një çast. Pulheria Aleksandrovna s'vonoi ta falënderonte Zosimovin sidomos për vizitën që u kishte bërë në apartament.

- Si? Paska qenë te ju mbrëmë natën? - pyeti Raskolnikovi i alarmuar. - Domethënë, nuk paskeni mbyllur sy mbrëmë, ashtu të lodhura nga rruga siç ishit?

- Rodia, po dy ishte ora. Ne me Dunjën kurrë nuk flemë në shtëpi para orës dy.

- Edhe unë s'di si ta falënderoj, - tha Raskolnikovi i vrenjtur dhe

me sytë përdhe. - Duke përjashtuar interesin material, të më falni që shprehem kështu, - iu drejtua Zosimovit, - nuk gjej dot asnjë arsye tjetër të interesimit të jashtëzakonshëm për mua, s'di përse e paskam merituar këtë vëmendjen tuaj të posaçme! S'e kuptoj e *basta*! Dhe, të them të drejtën, më rëndon ky qëndrim, më rëndon sepse nuk e kuptoj! Më besoni, jam duke u folur sinqerisht!...

- Po ju mos u nxehni, - qeshi i sforcuar Zosimovi. - Ja, merreni sikur jeni pacienti im i parë, ndërsa unë s'jam tjetër veçse një mjek fillestar, i cili është duke ushtruar profesionin e dashur dhe pacientët i do si t'i kishte fëmijët e vet; se ka mjekë që bien edhe në dashuri me ta... Pastaj unë nuk kam shumë pacientë, ju këtë e dini.

- Pale ky pastaj! - shtoi Raskolnikovi, duke treguar me kokë nga Razumihini. - Se ky, përveç fyerjeve e telasheve, asgjë tjetër s'ka parë nga unë!

- Gënjen! Të paska ardhur frymëzim i llahtarshëm, me ç'po shoh? - thirri Razumihini.

Po të kishte qenë më i thellë, do ta kishte vënë re që kurrfarë frymëzimi nuk kishte në këtë mes, përkundrazi. Ndërsa Avdotia Romanovna e pikasi. Ndiqte e përqendruar tërë shqetësim çdo lëvizje e fjalë të vëllait.

- Sa për ju, mama, s'gjej dot fjalë për t'u shprehur keqardhjen, - vazhdoi si të thoshte një mësim të mësuar përmendësh që më parë. - Vetëm sot i thirra mendjes sa shumë jeni torturuar në pritje të kthimit tim këtu mbrëmë. - Ndërkaq heshturazi, me buzën në gaz i zgjati dorën motrës. Ajo buzëqeshje shprehte ndjenjë të vërtetë, të mirëfilltë. Dunja ia rrëmbeu dhe ia shtrëngoi e gëzuar, falënderuese. Ishte hera e parë që i drejtohej pas përfoljes së djeshme. Fytyra e nënës u çel nga lumturia e ngazëllimi, kur pa këtë pajtim aq shumë të dëshiruar të motrës me vëllanë.

- Prandaj dhe e dua! - belbëzoi Razumihini entuziast dhe tepër i ndjeshëm për nga natyra. - Àtë që e ka, e ka!

"Sa mirë që vajti çdo gjë, - tha me vete Pulheria Alaksandrovna. - Me sa fisnikëri dhe zgjuarësi e mbylli mosmarrëveshjen e djeshme me të motrën: i zgjati dorën dhe e pa me mirësi.. Ç'sy të mrekullueshëm që ka, ai i tëri i mrekullueshëm është! Më i pashëm se Dunja është!.. Por sa keq është veshur... Sa shumë do dëshiroja t'i hidhesha

në qafë, ta shtrëngoja në gji dhe... të qaja... të qaja në krahët e tij, por kam frikë... sesi është kështu... Vërtet që po flet me përzemërsi, por unë ja që kam frikë!..."

- Ah, Rodia, sikur ta dije sa shumë fatkeqe që e ndiem veten mbrëmë unë dhe Dunjeçka, - nxitoi t'i përgjigjej pyetjes që i kishte bërë. - Tani na kaloi, jemi përsëri të lumtura, pra mund të të tregojmë ç'na ndodhi. Erdhëm këtu me vrap, drejt e nga treni, që të përqafonim, kurse ajo gruaja...hë, ja ku është... Tungjatjeta, Nastasia!... Na tha që ishe shumë i sëmurë, që kishe dalë pa lejen e mjekut, si në jerm, se shokët po të kërkonin. S'e merr dot me mendje ç'ndodhi me ne, si u bëmë! M'u kujtua ai qyqar kapteri, Potançikov e kishte emrin, mik i babait tënd, që doli i sëmurë dhe u gjend në pus, të nesërmen e nxorën! Na luajti mendja, ç'thagma nuk sajuam!... Deshëm të shkonim te Pjotër Petroviçi të na ndihmonte... se kë njohim tjetër këtu në Petërburg... - Këto fjalë të fundit Pulheria Aleksandrovna i tha me zë të shuar, që erdh e u ndërpre ashtu vetiu, ngaqë i thirri mendjes se për Pjotër Petroviçin nuk ishte aspak e udhës të flitej në këto çaste, kur "të gjithë ndihemi aq të lumtur!".

- Ashtu është, moj mama, edhe mua më vjen keq!... - mërmëriti Raskolnikovi me një hutim e pavëmendje aq të dukshme, saqë Dunjeçka ia nguli sytë e habitur. - Po ç'desha të them ende? - vazhdoi duke u sforcuar të ndërmendte diçka. - Hë! Po! Mama, Dunjeçka, mos kujtoni se nuk kam dashur të vija sot i pari te ju...

- Ç'thua kështu, Rodia, - thirri Pulheria Aleksandrovna, gjithashtu e habitur.

"Po ç'është kështu me të, na flet sikur është duke kryer një detyrë! - tha me vete Dunjeçka. - Edhe pajtimin, edhe tërë bisedën e mëpastajme na e bëri siç bëhet diçka e detyruar, flet siç thonë mësimet e parapërgatitura!".

- Desha të vija me t'u zgjuar, po s'kisha ç'të vishja, harrova t'i thosha mbrëmë Nastasisë të më pastronte pak kostumin nga njollat e gjakut... Vetëm tani mezi u bë gati...

- Njollat e gjakut? Ç'janë këto njolla gjaku?... - u shqetësua Pulheria Aleksandrovna.

- Mos u bëj merak, moj mama! Kur po endesha dje si në jerm, më rastisi të jem dëshmitar i një aksidenti... kishin shtypur një nëpunës.

- Në jerm the? Po ty të gjitha të kujtohen! - e ndërpreu Razumihini.

- Ashtu është, - iu përgjigj me kujdes të theksuar Raskolnikovi. - Të gjitha më kujtohen, madje me imtësi, veç përse e bëra këtë apo atë veprim, përse vajta këtu apo aty, çfarë thashë e përse e thashë, të gjitha këto nuk arrij dot t'i shpjegoj.

- Është dukuri e njohur! - u përzie në bisedë Zosimovi. - Ekzekutimi bëhet i përsosur, mjeshtëror, madje edhe me marifet; fillimi i veprimit është i çrregulluar, ai përcaktohet nga mbresa të sojsojshme, të sëmura. Ngjason me ëndrrën.

"Nuk është keq që më mban për të çmendur", - tha me vete Raskolnikovi.

- Gjëra që ndodhin, madje edhe me të shëndoshët, - vuri në dukje Dunjeçka, duke parë e shqetësuar në drejtim të Zosimovit.

- Vërejtje me vend, - iu përgjigj ky. - Në këtë kuptim ne që të gjithë jemi thuajse të çmendur, me një ndryshim të vogël: "të sëmurët" janë më tepër të çmendur se ne, këtu dhe duhet vënë sinori. Se njeri harmonik thuajse nuk gjen; në ekziston ndonjë, është një në dhjetë mijë dhe kurdoherë jo i kulluar..

Kur Zosimovi në zjarrin e gojëtarisë përmendi fjalën "të çmendurit", të gjithë u vrenjtën. Raskolnikovi ndërkohë qëndronte fare i paanshëm, pak i menduar, me një buzëqeshje të çuditshme që i kishte ngrirë në buzët e zbehta. Diç ishte duke shtirë në mendje.

- Po me të aksidentuarin ç'u bë? Se të preva fjalën? - iu rikthye përsëri bisedës Razumihini.

- Si? - e pyeti Raskolnikovi, si ai që përmendet pas humbjes së mendjes. - Aty dhe u zhyeva me gjak, kur isha duke ndihmuar që ta çonim në shtëpi... Mama, bëra diçka të pafalshme dje, nuk isha në vete, ndaj. Paratë që më dërguat, ia dhashë të shoqes... për të bërë varrimin. La vejushën e vrerosur... tre carronj varfanjakë, as për të ngrënë nuk kanë... Ka dhe një vajzë të rritur... Po t'i shihnit sa keq që janë, ndoshta, edhe ju ashtu si unë do bënit!... E di që nuk kisha asnjë të drejtë, sidomos po të kujtojmë si i bëtë hall ato para. Se, që të ndihmosh tjetrin, duhet më parë të kesh të drejtë ta bësh, ndryshe: *"Crevez, chiens, si vous n'etes pas contents!"*[1] - tha dhe ia plasi të

[1] *Ngorthni, qena, në s'bëheni dot të lumtur! (fr)*

qeshurit. - Mirë them, Dunja?

- Jo, nuk thua mirë! - iu përgjigj kjo prerë.

- Pra, edhe ti... me pikësynime qënke!... - belbëzoi, duke e parë thuajse me urrejtje dhe qeshi me sarkazëm. - Duhej të më kishte shkuar në mendje diçka e tillë, të bën nder kjo që the... Se ti ke për të ecur deri në njëfarë caku dhe pastaj asnjë hap më tutje... Fatkeqe ke për të qenë, por ama hapin më tej s'ke për ta bërë... Po nejse, gjepura janë këto që them! - ia preu vetes fjalën i xhindosur, i erdhi plasje që mori zjarr kot së koti. - Desha vetëm të them, që ju kërkoj ndjesë për gjithë ç'ka ndodhi dje, mama! - përfundoi i nervozuar dhe i kreshpëruar.

- Mjaft tani, Rodia! Nuk kam as dyshimin më të vogël që ti çdo gjë e bën si s'ka më mirë! - i tha e ëma me ton prej të ngazëllyere.

- S'keni pse jeni aq e sigurt! - ia ktheu ky dhe shtrembëroi buzët si për të qeshur. Ra heshtje. Biseda përshkohej nga një tendosje e dukshme; edhe heshtja, edhe pajtimi, edhe ndjesa e kërkuar, edhe revolta nuk ngjanin si diçka e zakonshme.

"Duken sikur kanë frikë nga unë!" - tha me vete Raskolnikovi, duke parë vëngër të ëmën dhe të motrën. Sa më shumë zgjaste heshtja, aq më shumë trëmbej Pulheria Aleksandrovna.

"Përsëlargu më është dukur se i kam dashur!" - i vetëtiu sakaq në mëndje Raskolnikovit.

- E di, Rodia, Marfa Petrovna vdiq! - tha befas Pulheria Alksandrovna.

- Kush është kjo?

- O Zot! S'të kujtohet? Marfa Petrovna Svidrigajllova! Të kam shkruar për të.

- A-a-a! Po! Më kujtohet... vdiq, the. Posi, posi! Si s'më kujtohet! - foli siç flasin të sapozgjuarit nga gjumi. - Paska vdekur, ë? E nga se?

- S'u mor vesh nga se. Vdiq pa pritur fare, - shpjegoi ngutshëm Pulheria Aleksandrovna, e gëzuar ngaqë i biri tregoi interes. - Vdiq atë ditë që të dërgova letrën. E di kush u bë shkak? I shoqi, ai xhahili! Thonë se e paska rrahur për vdekje të gjorën grua!

- Pse njerëz të tillë paskan qenë? - pyeti, duke iu drejtuar të motrës.

- Jo. Përkundrazi, me të ai sillej kurdoherë mirë, e respektonte. Madje ia duronte huqet, që nuk i kishte të pakta. Kishin shtatë vjet martuar dhe kishin kaluar jo keq... Por ja që një ditë prej ditëve atij i

paska sosur durimi.

- Del që si njeri, nuk paska qenë gjë, e paska duruar jo pak po shtatë vjet të shoqen. Më duket se ia përligjke atë që paska bërë. Kështu është, Dunjeçka?

- Jo, nuk është ashtu! Svidrigajllovi është përbindësh, nuk është njeri!

- U ndodhi në mëngjes, - vazhdoi si me ngut tregimin Pulheria Aleksandrovna. - Kishte porositur të mbrehnin kuajt, pas buke do nisej për në qytet: drekën e kishte ngrënë drekë dhe pas kësaj...

- E rrahu sa e zhdëpi?

- E kishte bërë zakon që pas drekës të merrte një banjë... Seç bënte një kurë... kanë ca burime të ftohta ata... U fut në ujë dhe s'u përmend më!

- Po e qartë! - thirri Zosimovi.

- Po për të rrahur e kishte rrahur shumë?

- E ç'rëndësi ka kjo? - ndërhyri Dunja.

- Mirë, de, mirë. Tregon edhe ti, moj mama, ca gjëra që... - iu ankua Raskolnikovi.

- Po, hë, ç'të tregoj atëherë... - tha me zë qaramaneje e ëma.

- E pse më pyet? Mos ke frikë nga unë? - e pyeti me një buzagaz të lehtë.

- Ka, si nuk ka, - ia tha troç Dunja dhe e pa drejt në sy të vëllanë. - Kur po ngjitnim shkallët, mamaja, me gjak të ngrirë, bëri kryqin. - I tha kështu dhe fytyra iu shtrembërua si në ngërç.

- Ama këput dhe ti, Dunja! Mos e dëgjo, Rodia! Kodra pas bregut po flet, - e qortoi e indinjuar Pulheria Aleksandrovna. - E di, mor bir, atje në vagon tërë kohën vetëm për takimin tonë ëndërroja: si do të të shoh e do të përqafoj, si do t'i tregoj të gjitha, e do dëgjoj të më tregosh dhe ti... Isha aq e lumtur, saqë s'e ndjeva fare rrugën!.. Po ç'po them kështu; unë edhe tani e lumtura e botës jam! Nuk bëre mirë që fole ashtu, Dunja! Mjafton që të kam pranë, Rodia, nuk ka lumturi më të madhe për mua...

- Mirë, moj mama, mirë! - belbëzoi i turpëruar Raskolnikovi, pa guxuar ta shohë drejt në sy, por duke ia shtrënguar dorën në dorën e tij. - Kemi kohë të çmallemi, të bisedojmë e t'i tregojmë njëri-tjetrit.

E tha këtë dhe u turbullua keq, u zbeh dhe u mpak: një cingërimë

e acartë ia përshkoi zemrën, ashtu si i kishte ndodhur edhe më parë, e ndjeu që tha një gënjeshtër; ai jo vetëm që nuk do ngopej së treguari, por kurrë ndonjëherë, askujt nuk do të mundej t'i hapej e t'i tregonte gjithçka kështu e tutje. Brenga që e mundonte qe aq e fortë, saqë u tulat për disa çaste, pastaj u çua pa parë kënd dhe doli nga dhoma.

- Ku shkon? - e pyeti Razumihini dhe e zuri nga krahu.

U ul, ua kaloi shikimin i heshtur, të gjithë po e shihnin të habitur.

- Po pse rrini ashtu të pezmatuar, - iu drejtua befas. - Thoni ndonjë gjë! Pse rrihet kështu? Hë de, thoni, tregoni ndonjë gjë! Hajde të bisedojmë, se njerëzit prandaj mblidhen, që të bisedojnë!...

- O Zot! Pandeha se mos i ndodhte si mbrëmë! - belbëzoi Pulheria Aleksandrovna dhe bëri kryqin.

- Ç'të erdhi ashtu, Rodia, - e pyeti dyshuese Avdotia Romanovna.

- Asgjë! M'u kujtua diçka! - iu përgjegj dhe qeshi.

- Në qoftë kjo, mirë kurse unë kujtova se... - nëpërdhëmbi Zosimovi, duke u çuar nga kanapeja. - Më duhet të dal... Do dukem përsëri.

U përshëndet dhe u largua.

- Sa njeri i mirë! - tha me çiltërsi Pulheria Aleksandrovna.

- Po, i mirë, i mrekullueshëm, me shkollë dhe i zgjuar është... - tha nxitimthi Raskolnikovi dhe me një të tillë shprehje në fytyrë, që nuk ia kishin vënë re deri tani. - Nuk e kujtoj dot se ku e kam takuar para se të sëmuresha... ashtu më duket, që e kam takur. Ja, edhe ky tjetri, njeri i mirë është! - tha dhe tregoi me kokë drejt Razumihinit. - A të pëlqen, Dunja? - e pyeti befas të motrën dhe sepërse qeshi.

- Shumë, - iu përgjegj Dunja

- Sa kaqol që je! - i tha i turbulluar dhe i skuqur nga turpi Razumihini, duke brofur nga karrigia. Pulheria Alaksandrovna vuri buzën në gaz, kurse Raskolnikovi qeshi me të madhe.

- Për ku kështu?

- Edhe mua më duhet të dal.

- Asnjë nevojë nuk ke, rri këtu! Doli Zosimovi dhe ti po si ai. Mos ik... Sa është ora? Dymbëdhjetë? Dunja, po kjo orë aq e bukur, ç'qenka? Po pse heshtni kështu? Vetëm unë jam duke folur!

- Ma ka dhuruar Marfa Petrovna, - iu përgjegj Dunja.

- Dhuratë të shtrenjtë i ka bërë, - sqaroi Pulheria Aleksandrovna.

- Qënka ca e madhe, s'para shkon për gra.

- Mua kështu më pëlqejnë, - tha Dunja.

"Pra nuk qenka dhuratë e të fejuarit", - tha me vete Razumihini dhe u gëzua pa asnjë shkak.

- Pandeha mos ta ka dhuruar Lluzhini, - nuk e la rastin t'i shpëtonte Raskolnikovi.

- Jo, ai nuk i ka dhuruar gjë Dunjashës.

- A-a-a! Të kujtohet, mama, që pata rënë në dashuri dhe desha të martohesha? - i tha dhe e pa drejt në sy. Kjo u habit nga befasia me të cilën e ndryshoi i biri temën e bisedës dhe nga toni me të cilin i tha ato fjalë.

- Posi, mor xhan! Si s'më kujtohet! - Pulheria Aleksandrovna këmbeu shikim me Dunjeçkën dhe me Razumihinin.

- Hm. Po! E ç't'u tregoj? Pak gjëra më kujtohen! Ishte e sëmurë, - tha i menduar dhe i topitur. - Ishte fare keq; i pëlqente të bënte sevape, shkonte nga një manastir në tjetrin, donte të mbyllej në manastir. Këto m'i ka treguar me lot në sy. E shëmtuar ishte, as vetë nuk e di pse u lidha me të, ndoshta, vetëm ngaqë ishte sëmurë... Po të kishte qenë çalashe apo kurrizdalë, do ta kisha dashur edhe më... (Qeshi mendueshëm). Një si jerm pranvere ishte...

- Jo, nuk ka qenë vetëm jerm pranvere, - e kundërshtoi me gjongël Dunjeçka.

Motrën e pa vëmendshëm, i përqendruar, por as e dëgjoi e as e kuptoi ç'tha. Ashtu i përhumbur u çua, iu afrua të ëmës, e puthi dhe u kthye prapë në vendin e mëparshëm.

- Edhe tani vazhdon ta duash! - tha me ndjenjë Pulheria Aleksandrovna.

- Cilën? Atë? Edhe tani? Ah, po... Për atë vajzën e kini fjalën? Jo! Tani ajo i përket asaj bote... Të shkuara të harruara.

Përsëri e kaloi shikimin nga një i pranishëm te tjetri.

- Ja, edhe ju... si të jeni qindra kilometra larg më dukeni... Po më mirë t'i lëmë këto... As pyetje s'keni përse më bëni! - shtoi i mërzitur dhe çukiti thonjtë mendueshëm.

- Këtë dhomë nuk e ke gjë fare, Rodia, si qivur duket! - tha befas Pulheria Aleksandrovna, duke e ndërprerë heshtjen munduese. - Më plaçin sytë në nuk ka qënë kjo musëndër ajo që të ka kallur mërzitinë.

- Dhoma?... - e pyeti i hutuar Raskolnikovi. - S'e ke keq, edhe ajo

ka bërë të vetën... Ju, mama, sapo shprehët një mendim të çuditshëm! - i tha dhe qeshi nën buzë.

Nuk kaloi shumë dhe kjo shoqëri njerëzish të dashur, qëndrimi me prindin dhe motrën që s'i kishte parë tre vjet, kjo bisedë e përzemërt familjare, kur vetë ai nuk dinte çfarë të thoshte, iu bënë të padurueshme. Në kokë e çponte si turjelë një mendim, të cilit i duhej dhënë këmbë domosdo sot. U gëzua, kur e ndjeu që kishte gjetur një rrugëzgjidhje për të.

- Dunja, më dëgjo pak! - iu drejtua me ton serioz dhe thatë. - Për gjithë sa ndodhi dje, të kërkoj ndjesë, por e quaj për detyrë të ta kujtoj edhe rjëherë, që nga thelbi i asaj që të thashë nuk heq dorë: o unë, o Lluzhini! Unë qofsha i poshtër kurse ti jo, ti nuk duhet të jesh e tillë! Një nga ne të dy zgjidh: u martove me Lluzhinin, nuk je më motra ime!

- Rodia! Rodia! Prapë atë avaz, të mbrëmshmin? - thirri pikë vreri Pulheria Aleksandrovna. - E ç'është kjo punë me ty: rri-rri dhe e quan veten të poshtër! S'e dëgjoj dot! Edhe mbrëmë po kështu bëre! Çudi e madhe!...

- Vëlla! - i tha e vendosur dhe po ashtu thatë motra. - Gabohesh, kur mendon që jam duke bërë theror veten për dikë tjetër. Po martohem se kështu dua vetë, ngaqë më është e vështirë jeta, dhe, kuptohet, do më vinte mirë, nëse me këtë që po bëj, do t'u sillja dobi të afërmve. Kjo e fundit, në vendimin që mora, nuk është kryesore.

"Gënjen! - e përforcoi edhe një herë në kokën e tij mendimin tanimë të ngulitur Raskolnikovi. - S'e lë krenaria ta pranojë! O karaktere të dobët! Dashurojnë si të urrenin! Sa urrejtje kam... për të gjithë!...".

- Po martohem me Pjotër Petroviçin, - vazhdoi Dunjeçka, - sepse nga dy të këqija zgjodha më të voglën. Jam e vendosur t'i kryej me ndershmëri detyrimet, kurrë nuk do ta mashtroj... Pse qeshe ashtu?

Dunja u ndez nga indinjata.

- Detyrimet? - përsëriti ky shpotitës.

- Në atë masë sa do më kërkohet. E di ç'kërkon nga unë Pjotër Petroviçi. E di që veten e çmon jashtë mase, shpresoj se do më çmojë edhe mua.. E pse qesh ashtu?

- Po ti pse u skuqe dhe nuk po gjen dot vend ku të futesh? Kjo që

thua është gënjeshtër, je duke folur me kryeneçësinë e gruas, do si e si të ngulësh këmbë në tënden... Ti nuk ke si e respekton Pjotër Petroviçin, e njoha atë njeri, fola vetë me të. Ti vetëm po e shet veten për para, domethënë, je duke bërë poshtërsi, dhe gëzohem shumë që të skuqet faqja nga kjo që bën.

- Nuk është e vërtetë, nuk jam duke gënjyer! - thirri Dunjeçka, duke e humbur gjakftohtësinë. - Nuk kam për t'u martuar, pa qenë më parë e bindur që mund ta respektoj. Dhe, për fatin tim të mirë, këtë bindje mund ta krijoj qysh sot! Një e tillë lidhje martesore nuk është poshtërsi. Është krejt e pashpirt nga ana jote të flasësh kështu me mua. E pse je duke më kërkuar heroizëm, kur ti vetë, ndoshta, nuk e ke? Kjo që bën, s'është veçse përdhunim i tjetrit! Se unë edhe në jam duke marrë me qafë dikë, jam duke marrë veten time! E ç'më sheh ashtu? Rodia, shpirt!...

- O Zot! E bëri që t'i bjerë të fikët! - thirri Pulheria Aleksandrovna.

- Jo, jo... asgjë... nuk kam gjë!... Vetëm se m'u morën pak mendtë. Ja, po më kalon... Po, hm... Çfarë desha të them? Hë, desha të pyes: si kështu do t'u bindke sot në mund ta respektoke apo jo? Në të çmoka apo jo? Kështu u shprehe, më duket? Sot sikur the? Mos ndoshta nuk e dëgjova mirë?...

- Mama, tregoja vëllait letrën e Pjotër Petroviçit, - tha Dunjeçka.

Pulheria Aleksandrovna me duart që i dridheshin nxori letrën dhe ia zgjati të birit. Ky e mori, e pa me kureshtje, por para se ta hapte i hodhi një shikim të habituri Dunjeçkës.

- Çudi, - nëpërdhëmbi ngadalë, si i fandaksur nga një mendim i ri. - Po mua ç'më duhet? E ç'ne tërë këto britma e nerva? Dunja, martohu me kë të duash!

E tha si t'i fliste vetes, por me zë të lartë, dhe për disa çaste nuk ia ndau shikimin motrës. Dukej që ishte para një detyre të re.

E shpalosi letrën pa e fshirë nga fytyra shprehjen e habisë së çartur, pastaj e lexoi ngadalë, i përqendruar si rrallë herë. E lexoi dy herë. Pulheria Aleksandrovna ia ndiqte me shqetësim çdo lëvizje e grimasë. Të gjithë prisnin të ndodhte diçka e veçantë.

- Kjo letër më habit! - tha pasi u mendua një hop, duke iu kthyer së ëmës, por pa iu drejtuar ndonjërit në veçanti. - Njeri me shkollë, avokat, frazë e spërdredhur, e stërholluar, por është shkruar me dorë

analfabeti.

Të gjithë luajtën vendit, asnjë nuk e priste një të tillë replikë.

- Po ata, gjithë sa janë, kështu shkruajnë, - vuri në dukje Razumihini.

- Pse e paske lexuar ti?

- Po.

- Ia dhamë ne ta lexonte, Rodia... Deshëm të dinim ç'mendonte, - foli e hutuar Pulheria Aleksandrovna.

- Gjuhë gjyqesh, - ia preu fjalën Razumihini. - Aktet gjyqësore kështu shkruhen.

- Gjyqësore? Hë! Po! Po! Gjyqësore... Jo aq analfabet, por dhe jo aq letrar... gjuhë zyrash!

- Pjotër Petroviçi s'e fsheh që ka mësuar pa patur përkrahjen e askujt, se ka çarë në jetë me forcat e veta, - vuri në dukje Avdotia Romanovna, disi e fyer nga kjo mënyrë tjetërsoj e të folurit të vëllait.

- E po, në mburrét, domethënë se ka me se. Më duket se u lëndove, motër, që nga tërë ajo letër, vetëm këtë vërejtje bëra, me vete thua që enkas e bëra, për të të lënduar. Aspak! Mënyra si është shkruar letra më solli ndërmend diçka që nuk lidhet fare me ty. Ka një fjali aty: "Të gjitha pasojat do rëndojnë mbi ju". Thoni ç'të doni, por shpreh shumë ajo fjali, për më tepër që pas pak vjen edhe kërcënimi: do t'ia mbathë, me të më parë mua. Do kuptuar kështu: për ju të dyja pas kësaj as që do të dijë më! Si thoni, a mund të fyhesh nga kjo shprehje e Lluzhinit njëlloj si po të kishte dalë nga goja e këtij (tregoi në drejtim të Razumihinit) apo e Zosimovit?

- Jo, - iu përgjig shkurt Dunjeçka e gjallëruar. - Edhe unë e vura re është thënë me një naivitet të dukshëm, s'qenka nga ata që ia thonë penës! Shumë mirë fole, Rodia, nuk e prisja këtë arsyetim nga ti.

- Po është shprehur siç shprehen në gjyqe, ndaj dhe i ka dalë diçka e pagdhëndur. Veç nuk kam si të mos vë në dukje një shprehje tjetër që, për mendimin tim, është shpifje... shpifje e ligë. Paratë ia dhashë në dorë vejushës së sëmurë dhe të dëshpëruar, deri në makth, dhe nuk e bëra "me preteksin e përdorimit për varrimin e të atit" por vetëm për varrimin; ia dhashë jo "vajzës së përdalë", siç thuhet në letër, (atë vetëm mbrëmë e pashë për herë të parë), por ia dhashë në dorë vejushës. Duket açik që zotëria ngutet të më fëlliq, do të na hedhë njërin kundër tjetrit. Edhe këtu, ashtu si në gjyqe, tendenca

shfaqet lakuriq dhe me një ngut prej naivi. Duket si në pëllëmbë të dorës njeriu. Nuk mund të them që të çmon shumë, Dunjeçka. Duhet ta dish këtë.

Dunjeçka nuk i ktheu përgjigje; tanimë e kishte ndarë mendjen; priste vetëm mbrëmjen.

- Rodia, po ti ç'mendim ke për të gjitha këto? - e pyeti Pulheria Aleksandrovna, e shqetësuar edhe më tepër se mbrëmë nga ky ton serioz dhe cytës me të cilin u fol.

- Ç'mendim kam?

- Po ja, Pjotër Petroviçi shkruan që ti të mos jesh në atë takim, ndryshe do të largohet... Ti si... do vish?

- Këtë nuk e vendos unë. Nëse kjo kërkesë nuk ju fyen, ty dhe Dunjën, bëni si dini. Unë do bëj ashtu si të jetë më mirë për ju.

- Dunja e ka vendosur, kurse unë nuk jam plotësisht njëmendje me të, - nxitoi ta shpallë Pulheria Aleksandrovna.

- Dua të të lutem, Rodia, të të lutem përulësisht, që të jesh patjetër në takim! - thirri Dunja. - Si thua, do vish?

- Do vij.

- Edhe juve ju lutem të jeni tek ne në ora tetë, - iu drejtua Razumihinit. - Mamaja dhe unë ju ftojmë të jeni në atë takim.

- Shumë mirë, Dunjeçka. Ja, si e vendosëm, kështu dhe do bëhet! - shtoi Pulheria Alaksandrovna. - Kështu le të bëhet. Ma lehtësuat barrën; s'më pëlqejnë dredhat dhe shtirjet; më mirë të vërtetën drejt në sy... Zemërohu apo mos u zemëro, puna jote, Pjotër Petroviç!

IV

Në këtë kohë u hap ngadalë dera dhe në dhomë, duke parë me droje, hyri një vajzë. Të gjithë kthyen sytë, kurreshtarë dhe të habitur. Raskolnikovi nuk e njohu dot menjëherë; ishte Sonja Semionovna Marmelladova. E kishte parë vetëm mbrëmë, por në disa çaste e rrethana dhe me një të tillë veshje, që tani nuk ishte e lehtë ta njihte. Ishte e veshur si gjithë vajzat e varfëra, dukej fare miturake, lëvizjet i bënte të matura dhe të kujdesshme, fytyrën e kishte të çelur, por si të trembur. Kishte veshur një fustan të rëndomtë, ombrellën, ashtu si

dje, e mbante ndër duar. E befasuar nga gjindja që kishte mbushur dhomën, jo thjesht u hutua, por e humbi toruan, u mrrudh e u mpak; si fëmijët e vegjël, madje u duk sikur donte të largohej.

- Ah!... Jeni ju... - i tha Raskolnikovi krejt i habitur nga kjo ardhje, por edhe i turbulluar disi.

Iu kujtua që edhe mamaja edhe motra diç dinin nga letra e Lluzhinit, ishin në dijeni të vashës "ruajna Zot!". E kishte hedhur poshtë shpifjen e Lluzhinit, që gjoja kësaj i qënkan dhënë paratë, u kishte thënë se e kishte parë për herë të parë atë vajzë, kur, do ti, kjo vjen vetë. Veç shprehjen, me të cilën ai e kishte përkufizuar, nuk e kishte mohuar. Tani që po e shihte në këtë mjedis, vuri re që kjo qënie e poshtëruar dukej aq shumë e përulur, saqë ndjeu mëshirë për të. Kur vajza dha të kuptonte që ishte gati të largohej, diç iu rrëkëllye përbrenda.

- Nuk ju prisja të vinit, - u ngut t'i thoshte, duke i bërë shenjë të mos largohej. - Kini mirësinë, uluni. Ju ka dërguar Katerina Ivanovna? Jo, jo, aty, ja, këtu uluni...

Kur hyri Sonja, Razumihini, që rrinte në njërën nga tri karriget që kishte dhoma, që ngritur për t'i hapur rrugë vajzës. Në fillim Raskolnikovi i tregoi cepin e kanapesë, ku kishte qenë ulur Zosimovi, por sakaq i thirri mendjes dhe vendi iu duk si shumë intim, kanapeja shërbente si shtrat, ndaj nxitoi t'i tregonte në drejtim të vendit ku qe ulur Razumihini.

- Ti ulu këtu, - i tha shokut.

Sonja u ul thuajse duke u dridhur nga frika dhe pa me ndrojtje zonjat. Dukej sheshit që s'po arrinte dot ta kuptonte si mundi të qëndronte në shoqërinë e tyre. I pa e turpëruar, u çua pak dhe ju drejtua Raskolnikovit.

- Erdha vetëm për një njoftim, të më falni për shqetësimin. Më dërgoi Katerina Ivanovna, ju lutet shumë të vini nesër në varrim... në kishën e Mitrofanisë... pastaj te ne... në drekën e përmortshme... Do ta nderoni... Më porositi që t'u lutem.

- Do vij patjetër... patjetër do vij! - iu përgjegj Raskolnikovi, të cilit po ashtu iu mbajt goja. - Po uluni, ju lutem...ndoshta keni ngut... por sidoqoftë, kini mirësinë,... rrini qoftë edhe dy minuta.

Përsëri i tregoi karrigen. Sonja u ul përsëri, pa e druajtur, e

mrrudhur, e përhumbur gratë dhe u nemit.

Fytyra e zbehtë e Raskolnikovit u bë lulëkuqe, sytë iu ndezën, nëpër trup i shkuan të dridhura.

- Mama, - tha me zë të sigurt dhe të fortë. - Është Sonja Semionovna Marmelladova, e bija e zotërisë fatkeq që e shtypi dje karroca, ju fola për të...

Pulheria Aleksandrovna e pa Sonjën dhe puliti sytë. E ndjeu zërin e sigurt e të fortë të Rodies, por nuk mundi t'ia heqë vetes këtë kënaqësi. Dunjeçka ia nguli sytë dhe po e shihte me një dyshim të pafshehur të gjorën vajzë. Sonja, kur dëgjoi prezantimin, i ngriti përsëri sytë, por u turbullua më keq se herën e parë.

- Desha t'ju pyes, - iu drejtua sakaq Raskolnikovi, - mos keni patur ndonjë shqetësim nga ata të policisë?

- Jo, nuk kemi patur... Se arsyeja e vdekjes është e qartë... Vetëm komshinjtë s'po na lënë rehat!

- Pse? Ç'kanë?

- Po e mbani shumë kufomën, na thonë... Është vapë... era... Në mbrëmje do ta çojmë në kishën e varrezave, nesër do ta varrosin. Katerina Ivanovna në fillim nuk deshi, por tani u bind, që nuk ka si rri më aty.

- Do e çokeni sot?

- Ajo ju lutet të na nderoni me ardhjen tuaj nesër dhe nga varrimi të na urdhëroni në drekën e përmortshme.

- Do bëka drekë?

- Po. Vetëm meze do çojë. Më tha t'ju falënderoj edhe njëherë për ndihmën që na dhatë... Do gjendeshim fare keq, as për varrimin nuk kishim.

Edhe buzët, edhe mjekra iu drodhën, por duke bërë një sforcim të madh e mbajti dënesën dhe uli sytë. Raskolnikovi ndiqte çdo lëvizje të vajzës. Fytyrën e kishte të hequr, pak më të gjatë sa duhet, me një hundë majuce, thuajse të parregullt, nuk kishe si ta quaje të mirkë por sytë i kishte aq të kthjellët, fare të tejdukshëm, kur i gjallëroheshin, fytyra i merrte një shprehje mirësie dhe dëlirësie të paanë. Ishte e pamundur mos të të bënin për vete. Ishte tetëmbëdhjetë vjeçe, por dukej fare fëmijë, miturake e tregonin sidomos lëvizjet që bënte.

- Po si do t'ia dalë mbanë Katerina Ivanovna me ato pak para? Po

shtroka edhe drekë? - e pyeti Raskolnikovi, duke bërë çmos që ta mbante të ndezur bisedën.

- Arkivolin ia porositëm nga më të thjeshtët... Çdo gjë e thjeshtë do jetë... Ne me Katerina Ivanovnën i bëmë llogari shpenzimet, mbetën edhe pak për drekën... Katerina Ivanovna do shumë që të shtrohet drekë... Ju e njihni atë... i do këto.

- Po, po! E kuptoj... Sigurisht. E pse e shihni ashtu dhomën time? Ja dhe mamaja tha aty pari që ngjan me një arkivol!

- Gjithë sa kishit, na i dhatë neve! - tha me zë të ulët, gati me pështpërimë të ngutur, Sonjeçka dhe përsëri uli sytë. Iu drodhën përsëri buzët dhe mjekra. Që kur kishte shkelur në prag, e kishte pikëlluar pamja mjerane e kësaj dhome varfanjakësh, fjalët që shqiptoi i dolën vetiu nga zemra. Ra heshtje. Sytë e Dunjeçkës u kthjelluan, kurse Pulheria Aleksandrovna e pa me dashamirësi.

- Rodia, - i tha duke u ngritur. - Shihemi në drekë... Shkojmë Dunjeçka... Bëje mirë të dilje pak shëtitje, Rodia, pastaj të pushoje pak, të rrije pak shtrirë dhe, shiko, eja sa më parë... Kam frikë se të lodhëm me vizitën tonë.

- Po, po. Do vij, mama, - iu përgjegj ky me ngut dhe u çua. - Do mbaroj edhe një punë...

- Pse as drekë nuk do hani bashkë? - thirri i habitur Razumihini, duke parë nga Raskolnikovi. - Ç'thua kështu?

- Do vij, do vij! Patjetër do vij... Kurse ti rri dhe një minutë. Nuk ju duhet më ky juve, kështu, moj mama? Apo po prish punë?

- Ah! Jo! Jo! Veç edhe ju, Dimitri Prokofiç, do vini të hani drekë bashkë me ne! Kini mirësinë të na nderoni me ardhjen tuaj!

- Ju lutem, ejani! - i tha Dunja.

Razumihini iu përkul përulësisht dhe fytyra i shkëlqeu nga kënaqësia. Për disa çaste që të gjithë u ndien të pasigurt, dhe disi të hutuar.

- Lamtumirë, Rodia! Desha të them mirupafshim, nuk më pëlqen fare kjo "lamtumirë"!...

Pulheria Aleksandrovna donte t'i përkulej edhe Sonjës, por ja që nuk i doli ashtu si duhej, ndaj u ngut të largohej sa më parë.

Ndërsa Avdotia Romanovna, si duke pritur radhën, kur kaloi pas të ëmës, iu përkul me mirësjellje, e pa qetë dhe vëmendshëm, duke e

çuar përshëndetjen deri në fund. Sonjeçka u skuq, iu përkul e hutuar, si e shkalur, një si ngërç ia përshkoi fytyrën; iu duk sikur hoqi nga vetja një barrë të rëndë.

- Dunja! Lamtumirë! - i thirri së motrës Raskolnikovi, kur gratë tanimë ishin te shkallët. - Harrove të më japësh dorën!

- Ta dhashë! Si s'ta dhashë? - iu përgjegj Dunja dhe e pa dashamire, duke u kthyer paksa nga ai.

- S'ka gjë, ma jep prapë!

Ia shtrëgoi fort gishtat; Dunjeçka i buzëqeshi, u skuq nga kënaqësia, e hoqi shpejt e shpejt dorën dhe shkoi pas të ëmës e lumtur.

- Sa mirë që iken! - i tha Sonjës, kur u kthye në dhomë. - Të vdekurve u ndrit shpirti në atë botë, kurse të gjallët duan të rrojnë! Mirë them? Pse nuk është kështu? Hë nuk është kështu?

Sonja shihte me habi fytyrën e përndritur dhe të lumturuar të djaloshit, e pa disa kohë, pa thënë asnjë fjalë. Gjithë sa i kishte treguar i ndjeri atë për këtë djalë, iu kujtua deri në hollësi...

- O Zot, Dunjeçka! - tha tepër e tronditur Pulheria Aleksandrovna me të dalë në rrugë. - Bëmë mirë që ikëm, më mirë kështu... Hë, si thua, a mund të shkonte në mendje dje në vagon që kështu do të ndodhte?

- Po të thashë, moj mama, se është ende shumë i sëmurë! Ajo duket! Ndoshta edhe meraku për ne është një nga arsyet që e çoi në këtë gjendje! Duhet qenë zemërgjerë, vetëm kështu mund t'i falen shumë gjëra.

- Ndërsa ti nuk u tregove zemërgjerë! - iu kthye me ashk Pulheria Aleksandrovna. - Ju shihja të dyve: sa shumë që ngjani dhe jo vetëm në pamje, ju edhe shpirtin njëlloj e keni. Ja, të dy jeni të pikëlluar, rrini të vrenjtur, por edhe gjaknxehtë njëlloj jeni, jeni kryelartë të dy, por edhe zemërbardhë... Jo, Rodia nuk është egoist! Kur mendoj se ç'do të ndodhë sonte atje te ne, akull ndjej në kraharor e sidomos në zemër.

- Mos e prish gjakun, mama! Do ndodh ajo që duhet të ndodhë.

- Dunjeçka, po mendo, moj bijë, se në ç'gjendje jemi. Ku do të futemi, në rast se Pjotër Petroviçi s'pranon? - i doli pa dashje së gjorës nënë.

- E ç'vlerë do të ketë ai pas gjithë kësaj dhe asaj që mund të ndodhë! - ia preu shkurt, por me ndjenjë Dunjeçka.

- Bëmë mirë që ikëm, - përsëriti Pulheria Aleksandrovna, duke dhënë të kuptojë që i rrinte mendja tek i biri. - Se për ku donte të shkonte; le të ecë pak, të ajroset... Të merret fryma në atë birucë; se këtu edhe në rrugë është njëlloj si në dhomë... O Zot! Ç'qytet! Bëj mënjanë se mos të shtypin, diç janë duke mbartur.. qenka piano... Asaj vajzës ia kam shumë frikën...

- Cilës vajzë, moj mama?

- Asaj Sonja Semionovnës, që qëndroi atje...

- E përse?

- Seç kam një si parandjenjë jo të mirë, Dunjeçka! Kur e pashë të hynte, as vete s'e di pse m'u duk që ajo është kryesore në këtë mes.

- Aspak nuk është kryesore! - ia ktheu e bija e indinjuar. - E ç'janë këto parandjenja, moj mama? E ka njohur vetëm dje, kur hyri mezi e shqoi kush ishte.

- Ke për ta parë!... S'më pëlqeu fare ardhja e saj. Sa shumë që u trondita; m'i nguli syte, ca sy që... mezi u mbajta në karrige... Të kujtohet ç'fjalë shkruante për të Pjotër Petroviçi? Kurse ai na e prezantoi fare pa gjë të keq dhe me çfarë fjalësh pa?... Sidomos ty.. Pra del që diçka ka mes tyre...

- I ka shkrepur dhe ka shkruar? Po pse për ne pak kanë folur bota? Po për të shkruar pak kanë shkruar? Mos i harrove? Jam e sigurt që është vajzë përsëmbari, ato që thuhen gjepura janë...

- Dhëntë Zoti të jetë kështu si thua!

- Ndërsa Pjotër Petroviçi është thashethemexhi i regjur, - i vuri kapak muhabetit Dunjeçka.

Pulheria Aleksandrovna nuk u ndie më.

- Ja se ç'punë kam me ty... - i tha Raskolnikovi Razumihinit, duke e çuar te dritarja.

- T'i them Katerina Ivanovnës që do vini?... - foli shpejt e shpejt Sonja duke u përkulur që të dilte.

- Një minutë, Sonja Semionovna, nuk kemi sekrete nga ju, nuk na pengoni. Vetëm dy fjalë kemi ne të dy, - tha dhe iu drejtua përsëri Razumihinit. - Ti e njeh atë... si i thonë... Porfiri Petroviçin?

- Si s'e njoh! Biem dhe fi[illegible]se si është puna? - e pyeti me kërshëri të madhe.

- Çështjen e vrasjes së fajdexheshës... ashtu the dje... ai është duke ndjekur? Kështu?

- Po, ai. E çfarë? - Razumihini shqeu sytë.

- I ka marrë në pyetje penglënësit... Edhe unë kam lënë peng, gjëra të vogla vërtet, një unazë të motrës dhe orën e argjendtë të babait. Gjithsej pesë-gjashtë rubla kam marrë, por për mua ato sende janë të çmuara, janë të shtrenjta, i kam kujtim nga babai e motra. Nuk dua të humbasin, sidomos ora. Kam qenë tërë këtë kohë me zemër të ngrirë se mos më pyeste nëna ku i kam. Është gjëja e vetme e çmuar që më ka mbetur nga babai. Nëna dhe ne të tjerët do bëheshim keq po të humbnin... Ti ç'më thua, si t'ia bëj? E di që duhet dhënë emri në polici, po a nuk do qe më mirë t'i drejtoheshim Porfirit të na ndihmonte? Ti si mendon? Që ta mbyllim sa më shpejt këtë mesele. Ja, kur të shtrohemi të hamë darkë, mamaja me siguri ka për të më pyetur.

- Them të mos vemi në polici, por drejt e te Porfiri! - tha i pushtuar nga entuziazmi Razumihini. - Sa më gëzove! Shkojmë tani! Dy hapa rrugë janë, ndoshta e gjejmë...

- Mirë thua, shkojmë!

- Do gëzohet shumë, kur të na shohë! Ke për të parë! Ç'nuk i kam folur për ty... Ja, edhe mbrëmë i tregova. Shkojmë! E paske njohur plakën? Domethënë si s'ka më mirë po na shkojnë punët!... Ah! Po Sonja Ivanovna?

- Sonja Semionovna, - e korrigjoi Raskolnikovi, - Sonja Semionovna, njihuni, ky është një shok imi, Razumihini. Është njeri i mirë..

- Meqë duhet të dilni... - filloi të thotë Sonja, pa parë fare nga Razumihini dhe nga kjo u trubullua edhe më.

- Shkojmë, - tha i vendosur Raskolnikovi. - Do kthej sot nga ju. Sonja Semionovna, vetëm më thoni, ku jeni me banesë?

Nuk po i mbahej goja, por ishte duke u ngutur, i shmangej shikimit të vajzës, Sonja i dha adresën dhe u skuq u bë flakë. Dolën të tre.

- Nuk e mbyllke derën? - e pyeti Razumihini, që doli para tij.

- Nuk e mbyll! Kam dy vjet që dua të ble një dryn dhe s'më bëhet që s'më bëhet mbarë, - sqaroi i shkujdesur. - Janë të lumtur ata që

nuk kanë ç'të mbyllin në kyç! Kështu apo jo? - iu drejtua me të qeshur Sonjës.

Te hyrja ndalën.

- Ju e kini këtej rrugën, Sonja Semionovna? Po nuk ju pyeta, si ma gjetët shtëpinë? - i foli si për të thënë diçka. Nuk po arrinte që nuk po arrinte dot t'ia shihte ata sy të kaltër, aq të kthjellët e të dëlirë.

- Po ju ia thatë Poleçkës adresën.

- Polja? Ah, po!.. Poleçka! Vogëlushja.... motra juaj është? Ia dhashë adresën?

- Paskeni harruar?

- Jo, më kujtohet... Nuk e kam harruar.

- Kam dëgjuar të fliste për ju dhe i ndjeri baba... Vetëm emrin nuk jua dija, se as ai nuk ua dinte... Dje mora vesh kush jeni... Erdha këtu dhe pyeta: ku banon Raskolnikovi? Ma treguan disa kalamaj ku banoni... Lamtumirë... Do ia them të gjitha Katerina Ivanovnës.

Dukej tepër e gëzuar që po ikte, çapiti kokë ulur, me ngutje, që të mos e shihnin më, ja, sa të merrte kthesën, edhe nja njëzet metra donte, pastaj do të mbetej vetëm me mendimet dhe ndjenjat që e kishin vërshuar: të sillte në mendje ato që i kishin thënë dhe si ia kishin thënë, të ndërmendte çdo fjalëzë të shqiptuar, çdo shikim, çdo imtësi. Kurrë ndonjëherë nuk kishte provuar diçka të tillë. Një botë e re si pa u ndier hyri dhe zuri vend në shpirtin e saj. Iu kujtua Raskolnikovi, i tha se do t'i vinte për vizitë, madje sot, ndoshta në mëngjes, ku i dihet, që tani!

- Vetëm sot mos eja, të lutem, sot jo! - mërmëriti me zemër të ngrirë, me një përgjërim të pazakontë në atë belbëzimë, siç bëjnë foshnjat e trëmbura. - o Zot! Tek unë... në atë dhomë... ka për të parë... O Zot!

Në gjëndjen që ishte, nuk kishte si vinte re që një zotëri i panjohur ishte duke e ndjekur hap pas hapi. Kur kishte dëgjuar fjalët e Sonjës: "Ku banon zoti Raskolnikov?" - e kishte parë me shumë vëmendje personin, me të cilin po bisedonte Sonja, pa edhe shtëpinë dhe e kishte fiksuar mirë. Tërë kjo nuk zgjati më shumë se një çast, u bë në ecje e sipër, pa tërhequr me asgjë vëmendjen. Vetëm kur i qe afruar kthesës së rrugës, e kishte ngadalësuar hapin, për të pritur Sonjën, e kishte kuptuar që ishin duke u ndarë dhe kjo do kthehej në shtëpi.

"Po në ç'shtëpi vallë? Se ku e kam parë këtë fytyrë! - tha me vete. - Pa t'i shkoj pas, ku do hyjë?..."

Në bërrylin e rrugës i panjohuri u hodh në anën tjetër të saj, ktheu kokën dhe pa që Sonja po ecte pak prapa tij pa dyshuar për asgjë. Ngadalësoi hapin, e la të shkonte përpara dhe e ndoqi pas.

Ishte një burrë në të pesëdhjetat, me shtat më të lartë se mesatari, shpatullan dhe truplidhur, por paksa i kërrusur. Ishte veshur shik, mbahej për bukuri. Në dorë kishte një bastun të modës, të cilin e përplaste pas çdo hapi që hidhte, dorezat i kishte borë të bardha. Fytyrën e kishte të gjerë, me nofulla të forta, të këndshme dhe të freskët; dukej që nuk ishte petërburgas. Flokët i kishte të dëndur, të verdhë, vetëm aty-këtu të thinjur, ndërsa mjekrën fshesë e kishte edhe më të verdhë se flokët. Kishte sy të kaltër, që shihnin ftohtë, mendueshëm, po që të çponin si turjelë; buzët i kishte bojë alle. Në përgjithësi mbahej për merak, dukej më i ri nga ç'ishte.

Kur Sonja doli në anën e kanalit, të dy u gjendën në trotuar. Të panjohurit i ra në sy që ishte e menduar dhe e shpërqendruar. Hyri në portën e shtëpisë ku banonte në ecje e sipër, ai hyri fill pas saj si pa gjë të keq. Në oborrin e shtëpisë Sonja mori djathtas, drejt qoshes, ku fillonin shkallët për në dhomën e saj. "Pa shih!" - tha me vete zotëria i panjohur dhe ngjiti shkallët pas saj. Vetëm tani vajza e vuri re. Kaloi nëpër korridorin e katit të tretë, ndaĥ te dera, ku ishte shkruar me shkumës: "Kapernaumov, rrobaqebës". "Pa shih!" - përsëriti zotëria, i habitur nga kjo përputhje e çuditshme. I ra ziles së derës pranë.

- Te Kapernaumovi banoni? - e pyeti dhe i buzëqeshi. - Më ka qepur një jelek. Unë banoj këtu pranë, te zonja Reslih, Gertruda Karllovna. Qënkemi komshinj!

Sonja e pa drejt në sy.

- Qënkemi fqinj,- përsëriti i gëzuar. - Kam tri ditë që kam ardhur. E po, mirupafshim!

Sonja nuk iu përgjegj; u hap dera e apartamentit nëntë dhe ajo hyri pa u ndier. Ndjeu edhe turp e ndrojtje, por ndjeu edhe një si frikë...

Rrugës për te Porfiri, Razumihini ecte vrulltas, i shtyrë nga një vendosmëri dhe entuziazëm i dukshëm.

- Shumë bukur! Gjë e mirë është kjo që po bëjmë! Të gëzon! - përsëriste me vete.

"E ç'e gëzoka këtë?" - tha me vete Raskolnikovi.

- Nuk e kam ditur që edhe ti paske lënë plaçka peng te ajo plakë. Ke kohë që e bën këtë punë? Kur ke qenë për herë të fundit?

"Sa i trashë dhe sa naiv që tregohet, zavalli!".

- Kur?... - e ngadalësoi hapin Raskolnikovi, duke u sforcuar të ndërmendte ditën. - Nja tri ditë të shkuara, më duket. Nuk kam ndërmend ta laj detyrimin, - shtoi me një pamje të merakosuri për sendet e lëna peng. - Kam me vete gjithsej një rubël.. pas atij jermit të mallkuar që m'i shkundi fare xhepat!

Fjalët për jermin i tha me ton sa më bindës.

- Po, po, po! - foli nguturazi Razumihini. - E qartë tani përse atëherë... paske qenë në merak... Edhe në jerm i përmende unazat dhe zinxhirët... Po, po!... Tani çdo gjë është e qartë.. fare e qartë...

"Domethënë e paskan patur atë mendim! Ky njeri për mua vë dorën në zjarr, por ama sa s'po fluturon nga gëzimi që *u sqarua* kjo anë e unazave dhe e zinxhirëve të përmendur në jerm! Gozhdë në kokë u paska ndenjur".

- Si thua, do ta gjejmë aty? - e pyeti me zë të lartë.

- Do ta gjejmë se s'bën! - iu përgjigj prerë Razumihini. - Është djalë për kokën e djalit, do ta shohësh vetë! Është ca fuckë, domethënë njeri i shoqërisë së lartë, por ama i zgjuar te zoti! Tip dyshuesi është, nuk para i beson tjetrit, edhe si cinik po s'e ka shokun... I pëlqen të luaj si macja me miun me tjetrin... Veç, zanatin e njeh mirë... Vitin që shkoi i ra në gjurmë një vrasjeje, të cilën të gjithë e kishin shpallur të pamundur për t'u gjetur. Më ka pyetur disa herë për ty, më ka thënë se ka shumë dëshirë të njihet.

- E pse dashka aq shumë të njihet?

- Si të them... për shkak të sëmundjes, i kam folur për ty... Dëgjon i përqendruar. Kur i tregova që je aq i këputur, saqë as shkollën nuk ke me se ta vazhdosh, e di ç'më tha? "Sa keq". Edhe tregimet e Zametovit kanë bërë të vetën... Rodia, mbrëmë, ashtu i dehur siç isha, llapa ca si shumë... kam frikë mos i ke marrë afër zemrës ato që të thashë...

- Lidhur me çfarë? Që më mbajnë për të çmendur? Kushedi e

vërtetë mund të jetë...

Tha kështu dhe qeshi i sforcuar.

- Po, po!... Domethënë, jo! Gjithë sa llapa, gjepura janë, m'u zgjidh gjuha nga pija.

- E pse sikletose aq? S'më pëlqen fare ky qëndrimi yt! - i bërtiti Raskolnikovi, duke u shtirë si shumë i inatosur.

- E di, e di! E qartë. Të kuptoj drejt. S'di ku të futem nga turpi...

- Në është kështu, atëherë ta lemë këtë temë!

Heshtën. Razumihini e ndiente veten në qiellin e shtatë, Raskolnikovi e shihte me neveri. Ishte shumë i shqetësuar nga ato që kishte dëgjuar për Porfirin.

"Me atë duhet kujdes i madh! - tha me vete i merakosur. - Domethënë sa më natyrshëm, të flasësh vetvetiu. Asnjë sforcim. Sidoqoftë, do parë e do bërë. Nuk e di po veproj mirë, apo keq që po shkoj. Mos po vete si breshka te nallbani? Kjo e shkretë zemër sa s'po më del nga kraharori, nuk është shenjë e mirë!...".

- Ja, erdhëm. Në këtë shtëpinë bojë gri banon, - tha Razumihini.

"Kryesorja e kryesoreve është ta pikas në di gjë që kam qenë dje në apartamentin e asaj shtrigës,... dhe pyeta për gjakun. Këtë më duhet ta hetoj para hapave të mëtejshëm, ta mësoj nga fytyra e tij. Qeni qepën të hajë, por për të marrë vesh do ta marrë!...".

- E di? - iu drejtua Razumihinit me një buzagaz dhelparaku. - Po vë re që sot sikur je gdhirë në një gjendje disi të pazakontë. Hë? E vërtetë është?

- Ti për ç'gjendje e ke fjalën? Unë si gjithmonë jam! - iu karfos Razumihini.

- Mos u fshih, duket ajo. Më rrije në karrige pak më parë si nuk të kam parë ndonjëherë, vetëm në cep dhe si ndër ethe. Hovje ashtu kot së koti. Mbaheshe serioz, kur befas fytyra, të shprehte ëmbëlsi të çuditshme. Një fytyrë të ikte një të vinte; pale pastaj kur të ftuan për drekë, u skuqe u bëre flakë..

- Ç'ne, gënjen!... E pse ma thua këtë?

- Po ti pse fshihesh? E ç'më sille si ndonjë vajzë e padalë? Ja edhe tani u skuqe për ibret!

- Sa i poshtër je!

- Ç'të gjeti, Romeo! Do më shohësh ç'kam për të punuar sot atje,

ha-ha-ha! Do gajaset mamaja... po edhe dikush tjetër...

- Dëgjo, dëgjo këtu! S'bëhet shaka me këto punë... - iu hodh Razumihini që po e humbiste fare toruan dhe po dridhej nga tmerri. - E ç'ke për t'i treguar? Unë, or vëlla... Sa i poshtër që je!

- Lulëkuq je bërë në fytyrë! Dhe s'të shkon fare, mor Romeo dymetrosh... Pa shih si je larë e rregulluar sot, edhe thonjtë i paske pastruar! Nuk mbahet mend kur e ke bërë për herë të fundit. Qënke lyer edhe me krem, mbake erë kolonjë. Pa afrohu pak!

- I poshtër!

Raskolnikovi u shkri së qeshuri, dukej sikur nuk po e përmbante dot veten: me të qeshurën në fytyrë e kaluan pragun e apartamentit të Porfiri Petroviçit. I duhej shumë kjo Raskolnikovit: në dhomë duhet ta kishin dëgjuar që këta të dy hynë duke u gajasur.

- Mos të shpëton ndonjë fjalë këtu?... T'i bëj përshesh turinjtë! - i tha me pështpërimë si prej të tërbuari Razumihini, duke e tundur e shkundur Raskolnikovin nga supet.

V

Ky hyri në dhomë me pamjen e njeriut që bën sforcime titanike për ta mbajtur të qeshurën. Pas tij me një fytyrë të shprishur nga egërsia dhe tërbimi, i kuq flakë, me ca lëvizje lloshi, hyri Razumihini. Kishte një pamje tepër qesharake dhe kjo e përligjte plotësisht gajasjen e Raskolnikovit. Ende pa u prezantuar Raskolnikovi iu përkul të zotit të shtëpisë, që qëndronte në mes të dhomës dhe po e shihte me një shprehje pyetëse të fytyrës, pastaj i zgjati dorën, duke vazhduar të ruante pamjen e njeriut që sforcohet jashtëzakonisht shumë për ta përmbajtur të qeshurën, sa të paktën të shqiptonte nja dy-tri fjalë për të qenë, që ta bënte të ditur kush ishte, por, kur po e merrte veten në dorë, dhe po i jepte fytyrës një pamje sa më serioze për të thënë fjalët e duhura, si pa dashje pa nga Razumihini dhe s'u përmbajt dot: shpërthimi i të qeshurës doli aq e rrëmbyer dhe e fortë, saqë ia kaloi të mëparshmes. Egërsia e vulosur në fytyrën e Razumihinit pas kësaj kukurisme "dashamire" e bëri tepër të hareshme atmosferën duke i dhënë një natyrshmëri të përsosur.

- Dreqi të marrtë! - ulëriu ky dhe me dorën që kishte ngritur lart pa dashje goditi tryezën e vogël të rrumbullaktë me gotën e çajit të posapirë. Gota u rrëzua me rrapëllimë në dysheme.

- Po tryeza e gota ç'faj kanë? E pse u dashka dëmtuar kështu? - thirri gëzueshëm Porfiri Petroviçi.

I vendosur në qendër të skenës, Raskolnikovi mezi i dha fund të qeshurës. Dora i kishte mbetur në dorën e të zotit të shtëpisë, por duke respektuar masën, zgjodhi çastin e duhur dhe e hoqi në mënyrë të natyrshme. Razumihini, i shastisur përfundimisht nga rrapëllima e tryezës së rrokullisur dhe gotës së thyer, ia kishte ngulur shikimin coprave, pastaj imitoi pështymën dhe iu afrua dritares, ku qëndroi me shpinë ndaj të tjerëve, duke parë i vrenjtur si reja e zezë në dritare, me sytë që nuk shquanin asgjë. Porfiri Petroviçi qeshte dhe ia kishte ënda të qeshte, por dukej sheshit që priste shpjegimin. Në qoshe, në një karrige rrinte Zametovi, që, kur pa të hynin mysafirët, ishte ngritur t'i përshëndeste, fytyrën ia përshkonte një buzëqeshje e lehtë, por që gjithë ç'po ndodhte e shihte me një farë mosbesimi, ngaqë s'po kuptonte dot gjë prej gjëje. Madje mund të thuash që nuk para e ndiente mirë veten. Qënia këtu e Zametovit e tronditi paksa Raskolnikovin, nuk ishte i përgatitur për këtë.

"Edhe me të duhet qenë jo më pak i kujdesshëm!" - tha me vete Raskolnikovi.

- Më falni, ju lutem, - shqiptoi sa më s'bëhet i turbulluar, madje i turpëruar. - Raskolnikov...

- S'ka përse. Hytë aq po aq këndshëm!.. Po ky tjetri, si, as për të përshëndetur nuk paska ndër mend? - tha Porfiri Petroviçi, duke treguar me kokë Razumihinin.

- Ende s'e kam kuptuar përse u tërbua kështu... Kur po vinim, e quajta Romeo, sepse sot ky ngjan me Romeon, dhe ia vërtetova këtë, asgjë tjetër...

- Je i poshtër ti! - qe përgjigja e Razumihinit nga vendi te dritarja.

- Ka arsye të fortë, domethënë, që për një fjalë të vetme të tërbohet kësisoj, - qeshi Profiri.

- Qepe ti hetues!... Vafshi në djall që të gjithë!... - iu kthye Razumihini duke qeshur e duke rrezatuar ngazëllim. Si të mos kishte ndodhur gjë, iu afrua Profiri Petroviçit. - T'i lemë këto! Kaqola jeni,

dihet ajo! T'i kthehemi punëve. Ky këtu është miku im, Rodion Romanoviç Raskolnikovi. Emër i dëgjuar nga ju, ka dëshirë të njihet më nga afër dhe ka edhe një punë të vogël. Po ti, Zametov, nga mbive këtu? Qënkeni bërë miq? Që kur kështu?

"Po kjo ç'na qënka?" - e pyeti veten i shqetësuar Raskolnikovi.

Zametovi dha disa shenja turbullimi, por jo kushedi çfarë.

- Po ja, pas asaj gostisë te ti mbetëm miq, - i tha shpenguar.

- Domethënë ju paska ecur: javën që shkoi m'u lutët si perëndisë që t'i thosha një fjalë për ju Porfirit, kurse tani edhe pa mua ju paska ngjitur muhabeti... Na jep nga një cigare!

Porfiri Petroviçi kishte veshur një rrobëdëshambër të ri, këmishën e kishte akull, në këmbë kishte pantofla. Ishte një burrë tridhjetë e pesë vjeç, me shtat më të vogël se mesatari, i ngjallur, madje edhe me pak bark; ishte i pa rruar, baseta e mustaqe nuk kishte, flokët i kishte të prera kare, kokën e madhe e të rrumbullt, që vinte edhe më e trashë në zverk. Fytyrën buçkane si hëna e plotë me hundën e vogël majuce e kishte të zbehtë si të përhimtë, por qe tip i gjallë, madje edhe shpotitës. Do të dukej disi babaxhan, po të mos ishte shprehja e veçantë në sytë e veshur me një rrezëllim uji, e cila dukej e zhdukej nga kapsallitja e pandërprerë e qerpikëve thuajse të bardhë. Shikimi i këtyre syve nuk harmonizonte aspak me tiparet e fytyrës e as me shprehjen e saj; në të parat kishte diçka prej gruaje, në të dytat shprehej seriozitet dhe depërtim.

Me të dëgjuar fjalët "ka edhe një punë të vogël", e luti mysafirin të ulej në divan, vetë u ul në cepin tjetër të tij dhe ia nguli shikimin në pritje të asaj që do t'i parashtronin. E bëri me vëmendje të sforcuar qe aq shumë të step e të shtang, kur të duhet të hysh në bisedë pune me një të panjohur për një çështje që, sipas tyre, nuk është dhe aq me peshë sa të meritojë vëmëndjen që po tregohet. Por Raskolnikovi shkurt dhe shumë saktë e qartë ia bëri të ditur thelbin e çështjes dhe mbeti i kënaqur nga vetja. Ndërkohë iu dha mundësia për ta vrojtuar mirë Porfirin. As ky nuk ia shqiti sytë gjatë kohës që po i tregonte. Razumihini, që ishte ulur përkarshi, në anën tjetër të tryezës, ndiqte me vëmendje të madhe dhe me një pjesëmarrje të pafshehur shtjellimin e çështjes, duke e kaluar shikimin sa te njëri te tjetri, madje sikur ishte duke e tepruar ca...

"Është i trashë!" - e shau me vete Raskolnikovi.

- Duhet vënë në dijeni policia, - i tha me ton zyrtar Porfiri. - Madje duhej ta kishit bërë tanimë, me të marrë vesh lajmin e vrasjes, duhej të kishit njoftuar! Deklaratën duhet t'ia drejtoni hetuesit të çështjes, të theksoni që sendet e lëna peng janë tuajat dhe dëshironi t'i ktheni... Jua thonë atje ç'duhet shkruar...

- Puna është se tani për tani, - tha duke u munduar të tregohej sa më i turbulluar dhe si i zënë ngushtë Raskolnikovi, - nuk më gjenden aq para... nuk kam as për të shlyer detyrimin, një detyrim aq të vockël. Desha vetëm t'ju vë në dijeni që ato sende janë të miat dhe, kur të kem mundësi...

- Kjo s'ka asnjë rëndësi, - iu përgjigj Porfiri Petroviçi, që e priti ftohtë shpjegimin për mundësitë financiare. - Po të dëshironi mund të më drejtoheni thjesht mua, domethënë të më bëni të ditur që këto e këto sende janë të miat, prandaj ju lutem...

- Ta shkruaj në një letër të çfardoshme? - nxitoi të ndërhyjë Raskolnikovi, duke i mëshuar edhe këtë herë anës financiare të çështjes.

- E pse jo, në letër fare të zakonshme shkruajeni! - i tha Porfiri Petroviçi dhe nuk mundi dot ta përmbajë buzëqeshjen ironike; kapsalliti sytë i habitur, por i bëri edhe një shenjë duke i shkelur syrin. Ndoshta kjo vetëm iu duk Raskolnikovit, se edhe në ishte bërë, kishte zgjatur vetëm një çast. Raskolnikovi bënte be me vete, që e kishte vënë re shkeljen e syrit, por përse e kishte bërë, një dreq e dinte...

"Qënka në dijeni!" - i vetëtiu sakaq në mendje.

- Të më falni që ju bezdisa me një vogëlimë si kjo, - i tha disi i hutuar. - Pengun e kam lënë për pesë rubla, por më është tepër i shtrenjtë, e kam kujtim nga të mitë, dhe, të them të drejtën, kur mora vesh ç'ndodhi, u trëmba...

- Ja përse kërcyet ashtu mbrëmë, kur më shpëtoi goja e i thashë Zosimovit që Porfiri është duke i marrë në pyetje pengëlënësit! - ndërhyri Razumihini me një paramendim të qartë.

Kjo nuk durohej. Ktheu nga ai kokën dhe e shitoi me shkrepëtimë të syve të inatosur. Por në çast e mblodhi veten.

- Paske qejf të më tallësh, vëllaçko! - iu drejtua me një iritim të sajuar me shkathtësi. - E pranoj që po tregohem ca si shumë i mera-

kosur sy teje për disa vogëlima si këto, veç s'ke si më quan as egoist e as zhvatës; ato sende për mua nuk janë pa gjë. Të thashë: ora e argjendtë, e cila nuk ka ndonjë vlerë kushedi çfarë, është i vetmi kujtim që më ka mbetur nga babai. Ti qesh sa herë të kesh qejf, por më erdhi nëna, - iu drejtua shpejt e shpejt Porfirit, - dhe sikur ta marrë vesh, - iu kthye përsëri Razumihinit, duke u përpjekur që zëri t'i dilte sa më i dridhur, - që orën s'e kam më, ta them unë, do dëshpërohej sa më s'bëhet! Është grua!

- Po nuk e thashë për këtë, përkundrazi! - thirri Razumihini i hidhëruar.

"Mirë doli? Natyrshëm? Nuk e zmadhova, vallë? - tha i drithëruar me vete Raskolnikovi. - E ç'm'u desh që e shtova atë: "Është grua!".

- Paska ardhur mamaja, thatë? - e pyeti Porfiri Petroviçi.

- Po, ka ardhur.

- Kur kështu?

- Mbrëmë.

Porfiri heshti si duke shtirë diçka në mendje.

- Sendet që keni lënë peng nuk kanë si humbasin, - e siguroi me zë të qetë dhe të ftohtë. - Kam kohë që e pres ardhjen tuaj në polici.

Ndërkaq fare natyrshëm i afroi tavllën e duhanit Razumihinit, që pa pikën e kujdesit po e lëshonte në qilim hirin e duhanit. Raskolnikovi u drodh, por Porfiri bëri sikur nuk pa gjë; dukej shumë i merakosur për atë hirin e duhanit.

- Si the? Po e prisje? Pse e ditke që paska lënë peng sende? - thirri Razumihini.

Porfiri Petroviçi iu drejtua vetëm Raskolnikovit.

- Që të dyja, si unaza ashtu edhe ora, ishin të mbështjella me letër dhe me kalem ishte shkruar emri juaj, data dhe muaji kur i kishte marrë.

- Sa mirë që i vini re gjërat? - qeshi me njëfarë ngurrimi Raskolnikovi, duke e parë drejt e në sy. Veç nuk iu durua pa shtuar. - E thashë se pengjet nuk kanë qenë të paktë... S'është e lehtë t'i mbash mend të gjithë... Kurse ju, ja që të gjithë i mbakeni mend... dhe...

"Marrëzi! Ç'm'u desh kjo që thashë! Shumë keq!".

- Po tanimë dihen thuajse të gjithë ata që kanë lënë pengje, vetëm ju vonuat të paraqiteni, - iu përgjegj Porfiri me një nuancë ironie në

zë, që nuk mund ta vije re lehtë.

- S'para kam qenë mirë me shëndet.

- Kam dëgjuar edhe për këtë. Më kanë thënë që keni qenë shumë i tronditur... Ja edhe tani i zbehtë jeni!

- Jo, tani jo! Përkundrazi, tani e ndiej fare mirë veten... - i tha ashpër dhe jo pa ligësi Raskolnikovi, duke e ndërruar kështu krejtësisht mënyrën e deritanishme të të folurit. Zjente nga inati, nuk po mundte dot ta ndrydhte përbrenda. "Në inat e sipër do ta humbas kontrollin mbi veten, do më shpëtoj ndonjë gjë, - tha me vete. - E përse më torturojnë kështu!..."

- Nuk ka qenë mirë me shëndet, - e përforcoi mendimin e shokut Razumihini. - Deri dje ka qenë në jerm... ka folur përçart... E di, Porfiri, me të ikur unë me Zosimovin mbrëmë, u vesh dhe doli, në mes të natës, nga sytë këmbët shkoi, e qartë, nuk ka qenë në vete, e bëri si në kllapi, e merr me mendje? Rast i jashtëzakonshëm!

- Fare në kllapi të ketë qenë? Çudi e madhe! - tundi sa andej këtej kryet Porfiri, ashtu siç bëjnë gratë.

- Gjepura thotë! Mos i besoni! Por edhe kështu duket ajo që ju nuk i besoni! - i tha Raskolnikovi i inatosur. Por Porfiri Petroviçi sikur nuk i dëgjoi fare këto fjalë të çuditshme.

- E si mund të dilje, po të mos ishe në jerm? - u nxeh Razumihini. - Se ja, të pyes: përse dole? Për ç'arsye? Pse dole ashtu vjedhurazi? Thuaj, ishe apo nuk ishe në vete? Tani që rreziku kaloi, mund ta them copë atë që mendoj.

- Ma prunë në majë të hundës mbrëmë këta, - iu drejtua vrulltas Raskolnikovi Porfirit me një buzëqeshje provokuese, madje më tepër se kaq, prej harbuti. - Dola për të gjetur një dhomë tjetër, ku mund të fshihesha nga këta, dhe mora me vete edhe shumë para. Ja, zoti Zametov i pa me sytë e tij. Si ju duka dje, zoti Zametov, me mendje të kthjellët apo në jerm, na e zgjidhni ju këtë nyje!

Kishte pamjen e njeriut që do t'i hidhet për t'i vënë duart në fyt tjetrit, aq shumë nuk po i pëlqenin si shikimi, ashtu edhe heshtja e çuditshme që ky ruante.

- Për mendimin tim, folët me mendje në kokë, madje me dhelpëri, vetëm se ishit shumë i irrituar, - vuri në dukje Zametovi.

- Kurse sot më tha Nikodhim Fomiçi, - shtoi Porfiri Petroviçi, - se

ju kishte takuar natën vonë në apartamentin e një nëpunësi që e paska shtypur karroca.

- Po ja, të marrim qoftë edhe punën e këtij nëpunësi të shtypur, - e kapi fillin e bisedës Razumihini. - Pse a nuk flet për çmenduri edhe ky rast? Paratë e fundit që kishte ia dha vejushës për varrimin. Dhe ia dha të gjitha. Ke dëshirë ta ndihmosh, jepi pesëmbëdhjetë apo dhjetë rubla, ama lër edhe për veten tënde. Gjithë sa iu ndodhën, njëzet e pesë rubla ia dha si pa gjë të keq burri i botës!

- E ku e di ti, kushedi kam rënë në ndonjë thesar... Pse kot u tregova bujar? Ja, zoti Zametov e di që kam rënë në para të madhe. Më falni ju lutem, - iu drejtua pastaj me buzë të dridhura Porfirit, - që po ju bezdis me këto hidh e pritje. Se ju bezdisëm, me siguri që ju bezdisëm...

- Jo, jo! Aspak! Për-ku-ndra-zi! Sikur ta dinit sa shumë që më interesoni?! Ju shoh dhe ju dëgjoj me kërshëri të pazakontë. T'ju them të drejtën, jam shumë i gëzuar që, më në fund, patët mirësinë të ma bënit këtë vizitë...

- Po na gostit me çaj makar! Na është tharë gurmazi! - u ankua Razumihini.

- Ide e mrekullueshme! Besoj që të gjithë s'jeni kundër. Mos do hash diçka, para se të pish çajin.

- Hiqmu qafe!

Porfiri Petroviçi doli për të porositur çajin.

Mendimet si një ciklon i vërtetë i vërtiteshin në kokë. Ishte tepër i eksituar. "As që e çajnë fare kokën për tjetrin, i thonë copë gjërat! Kur s'më njeh kush jam, me ç'të drejtë paske folur për mua me Nikodhim Fomiçin? Pra, vazhdokan të tyren! Më ndjekërkan hap pas hapi si një lukuni qensh! Ta hedhin këlbazën mu në fytyrë pa gjë të keq! - arsyetonte me vete dhe dridhej nga tërbimi. - Ç'ke ndërmend të bësh, bëje veç mos luaj me tjetrin si macja me miun! Nuk të nderon kjo sjellje, Porfiri Petroviç! Ama tek unë nuk të shkon! Në e mbusha top mendjen, m'u këtu jua zbraz të tëra, që ta shihni sa shumë ju përbuz, ju neveris... - Mezi po mbushej me frymë. - Po në gabofsha? Po në qoftë ky vetëm mirazh? Kushedi më duket ngaqë nuk kam përvojë në kësi punësh, ngaqë s'e duroj dot këtë rol të ndyrë që më duhet të luaj. Mos ndoshta kurrfarë gracke nuk ka. Fjalë të zakonshme po thuhen, por edhe që ka diçka, ka! Ja, pse tha: *"Tek ajo"*? Po

Zametovi përse e theksoi që i paskam folur me *dinakëri*? Po toni me të cilin po më flasin, a nuk ka dhe ai domethënien e vet?... Nga ana tjetër, ja, edhe Razumihini këtu është asgjë të këtillë nuk po vë re. Po ç'të flasësh për të, ky dallkauk naiv gjithmonë çdo gjë në rregull e ka!... S'm'u ndanë që s'mu ndanë këto të flamosura të dridhura!.. Po Porfiri si, ma shkeli syrin apo nuk ma shkeli? Gjepur është, e ç'i hynte në punë? Mos e bëjnë që të më ngrejnë nervat, apo tërë këto më duken mua? Ndoshta e dinë. Ja edhe Zametovi po më flet ndryshe. Paska ndërruar mendje gjatë natës. E parandjeva që kështu do të ndodhte! Hiqet si i shtëpisë, kur vetëm sot paska shkelur për herë të parë këtu; ndërsa Porfiri nuk e mbaka për mysafir, sillet pateklif, i rri dhe me shpinë. Çështja ime i ka afruar, me siguri. Pres kokën, që para se të hynim, për mua ishin duke biseduar! Po që isha përsëri në atë apartament a e dinë? Me siguri që po!... Kur u thashë se dola për të gjetur një dhomë tjetër, s'i vunë fare rëndësi... ndërsa unë këtë enkas e bëra... do më nevojitet! Në jerm e sipër dola domethënë. Ha-ha-ha! E ditka gjithçka që më ndodhi mbrëmë! Po ja, ardhjen e mamasë nuk e dinte... Shtriga, edhe datën e paska shënuar me kalem! Jo, jo, nuk do t'u dorëzohem! Fakte nuk kanë, shkojnë me hamendje... Edhe në e dinë që kam shkuar në apartamentin e plakës, kjo nuk përbën fakt. Ka qenë mirazh, gjendje jermi; di unë si të flas me ta... Po a e dinë që isha mbrëmë në shtëpinë e plakës? Nuk shkulem që këtej pa e shkoqitur mirë këtë! Se unë ndaj edhe erdha... kurse të inatosurit, po ky është fakt! Sa shumë që nxehem! S'e përmbaj fare veten! Po, kush e di, kjo nuk është dhe aq keq! E kam nga sëmundja, domethënë... Është duke më tatuar pulsin... Kërkon të më çorodis... Pse erdha fare!..."

Kjo rrjedhë e fuqishme arsyetimesh ia përshkoi me shpejtësi rrufeje mendjen.

Porfiri Petroviçi u kthye shpejt. Dukej më i gjallëruar.

- Nga ajo e mbrëmshmja e kam plumb kokën... Jam fare i shkrehur, - tha me ton krejt tjetër, duke parë nga Razumihini dhe duke qeshur.

- Si u ndatë? Se ju lash në kulmin e debatit. Kush fitoi?

- Kuptohet që askush. U futëm në të thella.

- E di, Rodia, për ç'debatuam? A ka apo nuk ka krime? Degë më degë u hodhëm!

- Një problem i zakonshëm social është, - tha i shpenguar Raskolnikovi.

- Nuk u shtrua kështu çështja, - sqaroi Porfiri.

- Ashtu është, nuk u tha tamam kështu, - pranoi Razumihini duke u ngutur dhe nxehur në të njëjtën kohë, siç e kishte zakon. Ja dëgjo dhe ti, Rodion, pastaj thuaj ç'mendon. Se mend u kacafytëm mbrëmë, mezi prisja që të vije edhe ti... U përmend pikëpamja e socialistëve, e kush nuk e di atë: krimi është protestë kundër parregullsive sociale; vetëm kaq, asnjë argument tjetër nuk pranohet, as dhe një...

- Gënjen! - thirri Porfiri Petroviçi. Ishte gjallëruar së tepërmi, qeshte dhe cyste Razumihinin.

- Asgjë tjetër s'pranohet! - e ndërpreu me ashk Razumihini. - Kështu është! Në s'beson, të sjell librat e tyre; kudo vetëm e vetëm pohohet që është mjedisi ai që e çon tjetrin në krim!... Nuk njohin argument tjetër. Nisur nga ky mendim, bëjnë përfundimin: në u normalizoftë shoqëria, marrin fund krimet. Natyra e njeriut përjashtohet kryekëput! Sipas tyre, nuk është njerëzimi me zhvillimin e tij historik, të gjallë, ai që shndërrohet në shoqëri normale, por, përkundrazi, është sistemi social, pjellë e ca përllogaritjeve matematike, ai që e rregulloka njerëzimin, e bëka më të drejtë, pa cene. Sipas tyre, kjo ndodh jashtë çdo procesi të gjallë, pa kaluar nëpër një rrugë të caktuar historike! Ata ndaj dhe s'e duan historinë: "Shëmtia dhe idiotizmi e kanë mbytur!" - dëgjon nga goja e tyre. Nuk e kanë përzemër procesin e gjallë të jetës, nuk u duhet shpirti i gjallë, sepse ai vetëm kërkon, vetëm dyshon, nuk i nënshtrohet ligjeve të mekanikës, është frymë e vjetër. Le të qelbë era e coftinës, le të jetë i bërë prej gome, por kryesore është të mos ketë jetë, të mos ketë vullnet, të mos ngrejë krye e të mos protesojë! Dhe del që tërë puna përqendrohet në mënyrën e vendosjes së tullave, të ndërtimit të koridoreve dhe të dhomave, në ngritjen e karabinasë. Bukur fort! Karabinaja është gati, ndërsa ata që do hyjnë nuk janë gati, u mungon jeta, s'e kanë kaluar procesin jetësor! Vetëm me logjikë nuk superohet natyra njerëzore! Se logjika më së shumti parashikon tre raste, ndërkohë që ata janë miliona! S'ke si e mbledh gjithçka në një fokus, në çështjen e komoditetit! Kjo do të thotë t'i thjeshtëzosh gjërat, t'i servirësh aq të qarta, saqë as për të menduar nuk ka nevojë fare! Kjo është kryesore:

të mos ketë nevojë për të menduar! Tërë fshehtësia jetësore përmblidhet kësisoj në dy fije letre!

- Mori të tatëpjetën ky dhe s'ka burrë ta mbajë! - tha me të qeshur Porfiri Petroviçi. - E merrni dot me mendje? - iu kthye Raskolnikovit. - Mbrëmë, të mbledhur në një dhomë, gjashtë zëra në një kohë buçisnin, kuptohet, gotat e hedhura bënin të vetën. Hë, e merni dot me mendje këtë? E ke gabim që e mohon: mjedisi do të thotë shumë në kriminalitet, kjo vërtetohet kollaj me fakte.

- Edhe unë e di që do të thotë shumë, por ti më parë m'u përgjigj kësaj: një dyzetvjeçar përdhunon një vajzë dhjetë vjeçe. Kush e shtyu për këtë, mjedisi?

- Në një farë kuptimi dhe mjedisi, - me një seriozitet të çuditshëm iu përgjegj Porfiri. - Një krim si ky fare mirë mund ta shpjegosh me mjedisin.

Razumihini sa s'po çmendej nga zemërimi.

- Do të ta vërtetoj, - ulëriti ky, - që qepallat e bardha ti i ke ngaqë Ivani i Madh ka qenë dymetrosh, dhe ta vërtetoj me saktësi, madje në një këndshikim përparimtar, liberal! Vëmë bast që e bëj?

- Vëmë! Pa të shohim si e vërteton!

- Shtiret ky djall me brirë! - thirri Razumihini, brofi dhe tundi dorën. - Hë, ia vlen të merresh me këtë njeri? Dhe e bën enkas, nuk e njeh ti këtë, Rodion! Ja edhe mbrëmë kështu bëri: mbajti anën e atyre, që t'u hidhte hi syve! E ç'nuk këputi mbrëmë! Ata po fërkonin duart! Është nga ata ky që edhe dy javë rresht mund t'i bjerë fyellit në një vrimë! Vitin që shkoi ra telef duke na e mbushur mendjen që do bëhej murg, dy javë këtë avaz përsëriste. S'ka shumë që hapi llaf se do martohej, se çdo gjë e kishte gati për kurorë, madje qepi edhe kostumin e dhëndërisë. E po, e uruam nga zemra. Kur as nuse as gjë! Vetëm mirazh!

- Prapë gënjeve! Kostumin kam kohë që e kam qepur. Ja që më shkrepi t'ju qorrolleps!

- Vërtet që ju pëlqeka të shtireni? - e pyeti si pateklif Raskolnikovi.

- E pse jo? Prisni, edhe juve kam për t'ua hedhur! Ha-ha-ha! Ja se çfarë... Nga kjo bisedë që sapo bëmë, m'u kujtua një artikulli juaj për krimet, nuk më kujtohet titulli i plotë. E kam lexuar dy muaj më parë në njërin nga periodikët.

- Artikull? Në ç'periodik? - e pyeti i habitur Raskolnikovi. - Kam shkruar diçka para gjashtë muajsh, kur i ndërpreva studimet, por e dhashë për botim në "Fjalën e përjavshme" që u mbyll.

- Nuk u mbyll, por u bashkua me "Fjalën periodike" dhe para dy muajsh jua botuan shkrimin. Nuk e ditkeni?

Raskolnikovi vërtet nuk e dinte.

- Më falni, por ju për atë shkrim duhet të kërkoni honorarin! Çudi me ju! Rroni aq i vetmuar. Edhe gjërat që lidhen drejtpërdrejt me ju nuk i dini! Këtë nuk kini si ta mohoni...

- Të lumtë Rodka! As unë nuk e kam ditur! - thirri i gëzuar Razumihini. - Do ta gjej dhe do ta jap ta shohësh. Dy muaj më parë the? Po data nuk të kujtohet? Nejse, e gjej! Dhe nuk ndihet fare ky!...

- Po ju nga e morët vesh, që artikulli është imi? E kam firmosur vetëm me gërmat e fillimit të emrit dhe të mbiemrit!

- Rastësisht e mora vesh para disa ditësh. Më tha redaktori, një i njohuri im... Më bëri shumë përshtypje ai shkrim.

- Me ç'më kujtohet, kam shkruar për gjëndjen psikologjike të kriminelit para krimit dhe gjatë kohës së krimit..

- Dhe ngulmoni që akti i kryerjes së krimit gjithmonë shoqërohet nga një gjëndje e sëmurë e atij që e kryen... Mendim tepër origjinal! Por, t'ju them të drejtën, më shumë më tërhoqi vëmendjen një mendim që e kini shprehur në mbyllje të shkrimit, atë e kini thënë rrëshqanthi, jo dhe shumë qartë... Në ju kujtohet, pohoni se disa njerëz, të cilët jo se munden, por kanë të drejtë të bëjnë prapësi dhe krime, se për ta, madje, as ligj si të tillë nuk paska që t'i dënojë...

Raskolnikovi përdrodhi buzët nga ky shtrëmbërim i qëllimshëm dhe i paramenduar i idesë që kishte shprehur.

- Si? Ç'qenka kjo kështu? E drejtë për të bërë krime? Po si? Nga që ua paska marrë shpirtin "mjedisi"? - me një frikë të dukshme në fytyrë pyeti Razumihini.

- Jo, jo! - e kundërshtoi Porfiri. - Puna është se në atë artikull njerëzit ndahen në "të zakonshëm" dhe "të jashtëzakonshëm". Të zakonshmit duhet të rrojnë të përkorë, ata nuk kanë të drejtë të shkelin ligjet, si të zakonshëm që janë kurse të jashtëzakonshmit janë ata që paskan të drejtë të bëjnë krime, të shkelin ligjet, se ata janë të jashtëzakonshëm! Kështu jeni shprehur, në mos gabohem?

- Si qënka kjo? Nuk ka mundësi të jetë kështu? - belbëzoi i çoroditur Razumihini.

Raskolnikovi përsëri buzëqeshi kithët. E nuhati si qëndronte puna, e kuptoi ku donte të dilte bashkëfolësi. E mbante mend mirë atë shkrim, vendosi t'i përgjigjej grishjes.

- Nuk është thënë tamam ashtu në artikull, - e kundërshtoi thjesht dhe me dinjitet. - Ju vetëm përafërsisht e shtjelluat mendimin tim, s'i thatë plot gjëra, por që ka diçka të vërtetë në atë që thatë, ka... (I jepte kënaqësi pranimi i vërtetësisë së atij shkrimi). Unë nuk ngul këmbë që të jashtëzakonshmit duhet domosdo të bëjnë prapësi e deri krime, siç thatë ju. Një pohim të tillë thjesht nuk kishin për ta pranuar. Unë vetëm lë të nënkuptohet që njeriu i jashtëzakonshëm ka të drejtë... domethënë jo se ka të drejtë zyrtarisht, por vetë në veten e tij ka të drejtë t'ia lejojë vetëdijes së vet të kapërcejë... disa pengesa, veç vetëm në ato raste, kur vënia në jetë e idesë (ndonjëherë shpëtimtare, ndoshta, edhe për mbarë njerëzimin) e kërkon një gjë të tillë. Patët nderin të vinit në dukje që shkrimi nuk qënka i qartë; jam gati t'ua shpjegoj, kuptohet, me sa mundem. Ndoshta nuk gaboj, po të them që ju këtë e dëshironi, të më falni, në mos qoftë kështu... Për mendimin tim, nëse zbulimet e Keplerovit dhe të Njutonit, për ndonjë arsye nuk do t'u bëheshin të ditura njerëzve, pa sakrifikim për këtë të ndonjë jete njeriu, madje edhe të dhjetë e një qind jetëve, të cilat i pengonin këto zbulime, apo orvateshin t'i pengonin, ky sakrifikim ishte i nevojshëm. Them se Njutoni jo thjesht do të kishte të drejtë ta bënte një gjë të tillë, por ishte detyrë e tij që ta bënte medoemos. Zbulimet madhështore duhej t'i bëheshin të ditura njerëzimit! Nga kjo nuk do nxjerrë aspak përfundimi që Njutoni paska patur të drejtë të vrasë këdo që i shkrepej, apo të grabisë këdo që i dilte përpara. Kam shprehur po ashtu mendimin se të gjithë ligjvënësit e botës, duke filluar me ata të lashtësisë dhe duke vazhduar me Likurgët, Solomonët, Muhametët, Napoleonët, etj., pra, që të gjithë këta do të shpalleshin kriminelë qoftë edhe për arsyen e thjeshtë që, duke nxjerrë një ligj të ri, hodhën poshtë një ligj të vjetër, të respektuar nga shoqëria, nga etërit pararendës dhe, sigurisht, nuk ngurruan as të derdhin gjak në ato raste (ndonjëherë krejt i pafajshëm, madje i mbushur me lavdi që e derdhnin për ruajtjen e ligjit të vjetër), kur ishte e domosdoshme.

Dihet, po ashtu, që pjesa më e madhe e këtyre veprimtarëve dhe ligjvënësve të njerëzimit kanë qenë gjakderdhës të tmerrshëm. Pra, dua të them, që jo vetëm njerëzit e mëdhenj, por edhe ata që fare pak dalin nga binarët, pra që fare pak janë të zotët të thonë diçka të re, duhet të jenë për nga natyra e tyre pak a shumë kriminelë. Se pyes, si do të mundnin ndryshe të çmëndeshin? E pra, të qëndronin në ta, s'kishin si, përsëri duke patur parasysh natyrën e tyre, dhe, për mendimin tim, e kanë për detyrë që të mos pajtohen me gjëndjen. Pra, deri këtu, siç e shihni, nuk është se u shpreh ndonjë mendim i ri. Kjo që dëgjuat është thënë e stërthënë... Sa për ndarjen e njerëzve në të zakonshëm e të jashtëzakonshëm, e pranoj, është diçka arbitrare, veç për shifra të sakta nuk pretendoj. Thelbit i besoj. Ja cili është: njerëzit në përputhje me ligjet e natyrës ndahen në përgjithësi në dy kategori: në të ulët (të zakonshëm), domethënë në lëndë që shërben për riprodhim të të tjerëve si ata vetë, dhe në njerëz me dhunti e talent, të zotë për të thënë *fjalën e re* në mjedisin ku jetojnë. Nëndarjet janë të panumërta, veç shënjat dalluese të kategorive janë të theksuara. Kategoria e parë janë njerëz me pikëpamje konservatore, të ngurta, këta rrojnë të nënshtruar dhe të bindur dhe u pëlqen të jenë të tillë, këtë destinacion kanë, asgjë poshtëruese në këtë mes nuk ka. Kategoria e dytë e shkel ligjin, bën shkatërrime apo ka prirje për të bërë, kjo varet nga rrethanat dhe zotësia e individit. Krimet e të tillëve kanë, sigurisht, karakter relativ; në të shumtën e herëve këta ngulmojnë përmes deklaratave gjithfarëshe në shkatërrimin e të tashmes në emër të më të mirës. Dhe në qoftë se për hir të idesë këtij i duhet të ecë mbi kufomat e të tjerëve, në vetëdijen e tij, ky, për mendimin tim, mund t'ia lejojë vetes të çajë përpara qoftë edhe me gjakderdhje. Sigurisht, kjo varet nga lloji i idesë dhe përmasat e saj, kjo duhet të theksohet. Në këtë kuptim kam shkruar për të drejtat e krimit. (Juve ju kujtohet që debati kishte karakter thjesht juridik). Sidoqoftë, asgjë shqetësuese këtu nuk ka: të zakonshmit kurrë nuk ua njohin këtë të drejtë, i pushkatojnë, i varin, duke përmbushur kështu destinacionin e tyre konservator, ama brezat pasardhës i vënë të ekzekutuarit në piedestal dhe u përulen me nderim. Kategoria e parë është zot i të sotmes, kategoria e dytë është zot i të ardhmes. Të parët ruajnë paqen dhe shumojnë njerëzimin, të dytët shtyjnë përpara botën,

e përcjellin atë te qëllimi. Si të parët, ashtu dhe të dytët kanë të drejtë të plotë për ekzistencë. Për mua, që të gjithë janë të barabartë dhe *vive la guerre éternelle*[1] deri në Jeruzalemin e Ri, kuptohet.

- Domethënë besokeni në Jeruzalemin e Ri?

- Besoj, - përsëriti Raskonikovi me zë të sigurt. Kur shqiptoi këtë, ashtu si edhe gjatë shpjegimit të gjatë që bëri, sytë i mbajti në tokë, shihte në një pikë të qilimit.

- Edh-e-e Zotit i besoni? Të më falni për kureshtjen.

- I besoj, - tha Raskolnikovi dhe ngriti sytë në drejtim të Porfirit.

- Edhe në ngjalljen e shën Llazarit besoni?

- Be-esoj. Po juve ç'ju duhet kjo?

- Besoni me tamam?

- Po, besoj.

- Jo, thjesht nga kureshtja ju pyes. Më falni. Po t'i kthehemi bisedës sonë: të jashtëzakonshmit, siç e quani ju, nuk është se i ekzekutojnë të gjithë, përkundrazi...

- Doni të thoni që janë pranuar që në të gjallë? Ashtu është, ka që ia dalin mbanë edhe përsëgjalli... dhe atëherë...

- Ata vetë fillojnë e vrasin?...

- Po, në është e nevojshme, dhe, në shumicën e rasteve, ka qenë. Vërejtja që bëni është shumë e zgjuar.

- Faleminderit. Edhe diçka: si t'i dallosh të jashtëzakonshmit nga të zakonshmit? Mos lindin me shënja të veçanta? Se kjo s'është e parëndësishme. Të më falni, por shqetësimi vjen nga nevoja e zbatimit në praktikë të kritereve, për shmangien e gabimeve dhe të keqkuptimeve; mos duhet përdorur ndonjë veshje e posaçme apo ndonjë damkë... Se ju edhe vetë e kuptoni, mund të fillojë e të "mënjanojë çdo pengese" tjetri, siç patët nderin të shpreheshit, atëherë...

- Kjo edhe mund të ndodhë. Vërejtja që bëni është më e zgjuar se ajo e mëparshmja...

- Faleminderit.

- S'ka përse. Ju edhe vetë e kuptoni që gabime mund të bëhen, kuptohet, nga kategoria e parë (ndoshta edhe termat nuk janë zgjedhur fort të përshtatshëm). Se edhe pse kanë lindur me prirjen

---

[1]) *Rroftë lufta e përjetshme (fr.)*

për të bërë një jetë të përkorë, këta, në shumicën e rasteve, hiqen për përparimtarë, "për shkatërrues" dhe "mbartës të së resë", dhe janë fare të sinqertë kur mendojnë kështu. Novatorët e vërtetë, si rregull, nuk i vënë re, madje dhe i përbuzin si të prapambetur. Por, për mendimin tim, rreziku nuk është kushedi sa i madh. Kur e tepërojnë zullumin, mund t'u jepet dajak, pasi u është treguar vendi. Dhe e dini, as ekzekutor nuk duhet, sepse ata vetë e kamxhikojnë veten. Gjithfarë pendesash sajojnë dhe bëhen shumë mësimdhënës për të tjerët. Ndaj s'keni pse merakoseni... Është e njohur kjo.

- E po, nga kjo anë më qetësuat disi, por ka edhe një kleçkë tjetër: a janë të shumtë ata që paskan të drejtë të shkojnë të tjerët në satër? Unë vetë përulem para misionit të tyre, ama të shkojnë mornica në rast se janë të shumtë. Ju si thoni?

- Për këtë nuk keni pse merakoseni, - tha Raskolnikovi pa e ndërruar tonin e bisedës. - Njerëz me mendime të reja, madje nga ata që të thonë diçka fare pak të re, ka jashtëzakonisht pak, dhe rregullsinë e dukjes së tyre në jetë e ka përcaktuar natyra vetë. Tani për tani kjo ligjësi ende nuk është njohur, por s'do vonojë të njihet. Moria e njerëzve ndaj dhe ekziston, që përmes sforcimesh, procesesh misterioze, të themi, duke i kryqëzuar llojet dhe speciet, të mund të lindë qoftë edhe në njëqind një njeriun deri diku të pavarur. Me pavarësi edhe më të plotë mund të lindë një në dhjetë mijë (e them vetëm për ilustrim). Gjenialitetet lindin një në miliona, kurse gjenitë e mëdhenj, kokat e njerëzimit, mund të shfaqen edhe një në shumë miliona njerëz. Pra, ligji, domosdo që ekziston, s'është punë rastësie kjo.

- Me gjithë mend i thoni tërë këto? - s'iu durua pa ndërhyrë Razumihinit. - Po e ënjtni njëri-tjetrin, hidhni e prisni ca romuze,. talleni me shoshoqin! Rodia, seriozisht i ke tërë këto që the?

Raskolnikovi ngriti kokën dhe e drejtoi për nga ai fytyrën dyllë të verdhë, të trishtë, dhe s'tha as dhe një fjalë. Razumihini u çudit nga shprehja shpotitëse dhe thumbuese, madje e inatosur dhe karfosëse e Porfirit.

- Në qoftë gjithë kjo vërtet serioze, atëherë... s'do mend, ke të drejtë, kur thua që kjo nuk është diçka e re, ama gjëja më origjinale në këtë që thua është që gjakderdhjen e pranon me vetëdije të plotë dhe me një fanatizëm të çuditshëm... Ky na qënka mendimi kryesor

që paske shprehur në atë artikull. Dhe kjo derdhje gjaku me vetëdije, të më falësh, është për mua më e tmerrshme, se lejimi zyrtar i gjakderdhjes me ligj.

- Drejt e the, më i tmerrshëm është, - e mbështeti Porfiri.

- Më duket se të tërhoqi ca si shumë fraza! E ke gabim! Do ta lexoj artikullin... S'besoj që mendon kështu! Do ta lexoj...

- Po në artikull kjo nuk është, aty janë vetëm disa hamendje.

- Kështu pra, - s'iu durua pa thënë Porfirit. - Tani m'u bë plotësisht e qartë ç'mendim paskeni për krimin, por të më falni për bezdinë (po ju shqetësoj dhe shumë, më vret ndërgjegja për këtë). Kur folët për rastet e përzierjes gabimisht të kategorive, më qetësuat disi por... më shqetëson problemi i rasteve që hasen në praktikë. Del që, me t'iu mbushur mendja dikujt që është Likurg apo Muhamet... kuptohet, i ardhshëm, vete e sulet që t'i mënjanojë pengesat... Se kjo rrugë do bërë, de! Është e gjatë, lypsen para... duhen mbledhur... kështu?

Zametovi u hodh përpjetë në qoshen ku rrinte. Raskolnikovi as që ia hodhi sytë.

- S'kam si të mos e pranoj, - tha i qetë, - që raste të tilla duhet të ketë. Ca lënokër dhe sqimëmëdhenj bjenë kollaj në këtë grep, sidomos të rinjtë.

- Hë, de! Po si kështu?

- Po ja, kështu! - shtrembëroi buzët Raskolnikovi. - Unë ç'faj kam në këtë mes? Kështu është dhe do të jetë! Ja, ky (tregoi në drejtim të Razumihinit) sapo më tha që e pranokam me vetëdije gjakderdhjen. E tha e çë pastaj? Shoqëria i ka marrë masat edhe kundër tyre; ka galerë, burgim, internim, procese gjyqësore. E pse u dashka shqetësuar? Gjejeni kriminelin...

- Po në e gjeçim?

- Sipas kokës festen!

- Po tregoheni shumë i arsyeshëm. Po ajo puna e vetëdijes? Asaj si i bëhet?

- Juve për të nuk ka pse u ha meraku.

- Nga pozitat e humanizmit, na ha!

- Kush e ka këtë vetëdije, le të vuajë nga brerja e saj! Për gabimin të pret ndëshkimi.

- Po ata vërtet gjenialët, si? - e pyeti Razumihini i vrenjtur. - Këta

nuk duhet ta vuajnë dënimin, madje as për gjakun e derdhur?

- Ç'hyn këtu ajo fjala: duhet? Nuk ka as lejim as ndalim. Le të vuajë në i vjen keq për viktimën. Vuajtja dhe dhimbja janë kurdoherë të domosdoshme për vetëdijen e plotë dhe ndjenjën e thellë. Njerëzit me të vërtetë të mëdhenj, për mendimin tim, duhet të përjetojnë në jetë trishtim të madh, - shtoi mendueshëm dhe jo me tonin në të cilën po zhvillohej biseda.

Ngriti sytë, pa përvuajtshëm të pranishmit, vuri buzën në gaz dhe mori kapelen. Ishte shumë më i qetë se atëherë, kur shkeli në këtë shtëpi, e ndiente edhe vetë këtë. U ngritën ta përcillnin.

- Bëni si të doni: në daçi më shani, në daçi zemërohuni, por s'më rrihet pa ju bërë edhe një pyetje, - iu drejtua Porfiri Petroviçi (si shumë po ju bezdis). - Desha të sqaroj ja se çfarë...

- Po ju dëgjoj! - i tha serioz, fare i zbehtë Raskolnikovi.

- Të them të drejtën, nuk di si ta formuloj që t'i bie pikës... Se është ca si lozonjare kjo e shkretë ide... është psikologjike... Kur e keni shkruar atë artikull... ma thotë mendja...që vetë ju... qoftë edhe njëçikëz është e pamundur... të mos e keni konsideruar veten njëri të "jashtëzakonshëm", i tillë që është duke thënë një fjalë të re, kuptohet, për mendimin tuaj... A është kështu?

- Ka shumë mundësi që të jetë kështu, - iu përgjigj me përbuzje Raskolnikovi.

Razumihini luajti vendit.

- Në qoftë kështu, mos vallë, për shkak të disa mossukseseve, vështirësive jetësore, por edhe për t'i dhënë një dorë mbarë njerëzimit, edhe ju jeni i vendosur të kaloni përmes pengesash... pra, të vrisnit dhe të grabisnit?

Dhe përsëri ia shkeli syrin e majtë e qeshi pa u ndier, njëlloj si pak më parë.

- Po ta kisha kaluar këtë pengesë, kuptohet, juve nuk do ju vija në dijeni, - i tha me kryelartësi dhe përbuzje.

- Jo, unë vetëm kështu, vetëm pyeta, desha ta kuptoja sa më plot artikullin tuaj, vetëm për sqarim ju pyeta.

"Është duke më folur me paturpësi indinjuese!" - tha me vete Raskolnikovi, që ziente përbrenda nga neveria dhe përbuzja.

- Më lejoni t'ju vë në dijeni, - iu kthye thatë, - që nuk e mbaj veten

as për Muhamet e as për Napoleon... as edhe me ndonjë tjetër që përafron me ta, ndaj dhe s'kam si ju kënaq me shpjegimet e mia.

- Lërini këto! E kush nuk e mban veten Napoleon tani te ne në Rusi? - shqiptoi me një familjaritet të tmerrshëm Porfiri. Edhe në zërin, me të cilin u thanë, kishte diçka të spikatur.

- Po ai që e shapllanisi me sëpatë javën e shkuar Alena Ivanovnën mos ka qenë ndonjë Napoleon i sotëm? - e lëshoi bombën Zametovi që nga qoshja ku ishte.

Raskolnikovi e pa drejt në sy heshturazi, pa ngurrimin më të vogël Porfirin. Razumihini u vrenjt si reja e zezë. Kishte ca kohë që po i dukej se diç do ndodhte. Hodhi sytë i inatosur rretherrotull. Në dhomë ra një minutë heshtje. Raskolnikovi bëri të dilte.

- Po ikni? - i foli me zë të butë Porfiri dhe i zgjati me shumë mirëdashje dorën. - U gëzova shumë qe u njohëm. Sa për lutjen, me të cilën m'u drejtuat, mos u bëni merak. Vetëm bëni kërkesën, siç u thashë. Do bënit mirë të paraqiteshit personalisht tek unë, qoftë edhe nesër. Do të jem rreth orës njëmbëdhjetë... do bisedojmë. Se si një nga të fundit që kini qenë *atje*, mund të na ndihmoni, - shtoi me një shprehje dashamiri në fytyrë.

- Dashkeni të më merrni në pyetje zyrtarisht dhe në mjedisin e përcaktuar për këtë? - e pyeti rreptë Raskolnikovi.

- Jo, ç'ne? Tani për tani kjo as duhet. Nuk më kuptuat, ç'desha t'ju them. Kam biseduar me të gjithë penglënësit, s'më ka shpëtuar as dhe një pa u pyetur... Kam grumbulluar një mori faktesh... ndërsa ju si i fundit që jeni... Hë, m'u kujtua ja se çfarë... për atë, Nikollain. Ti m'i hëngre veshët atëherë, - i foli me zë të gëzuar Razumihinit. - E di edhe vetë, fort mirë e di... - iu kthye përsëri Raskolnikovit, - që djali nuk ka të bëjë, por e do puna; edhe Mitjes i rash më qafë... Se ju duke ngjitur shkallët, të më falni, ju rreth orës tetë keni qenë?

- Po, rreth orës tetë, - iu përgjigj, por s'i erdhi mirë që e pohoi, mund edhe të mos e bënte.

- Duke ngjitur shkallët, nuk vutë re në katin e dytë, në apartamentin e hapur, ju kujtohet? Nuk patë dy punëtorë, apo njërin prej tyre. Kanë qenë duke lyer, ju nuk i patë? Për ta kjo është me shumë rëndësi.

- Bojaxhnj? Jo, nuk kam parë, - tha ngadalë dhe si duke gërmuar në kujtesë Raskolnikovi. Një shkulm makthi torturues e pushtoi të

tërin, donte të merrte vesh me çdo kusht për grackën që po i ngrinin. - Jo, jo! Nuk kam parë, mua as apartament të hapur nuk më zuri syri... Kurse në katin e katërt (i kishte rënë në të grackës dhe po e gëzonte fitorja), më kujtohet, që një nëpunës ishte duke boshatisur apartamentin... ai që ishte përkarshi apartamentit të Alena Ivanovnës... Kjo me kujtohet mirë. Disa ushtarë po nxirrnin një divan, u detyrova të shtrëngohem pas murit... Bojaxhinj nuk pashë. As apartament tjetër të hapur nuk pashë.

- E ç'thua kështu? - thirri Razumihini që sikur u përmend atë çast. - Bojaxhinjtë kanë qenë duke lyer ditën që u krye vrasja, ndërsa ky aty ka qenë tri ditë më parë. Ama pyetje bën dhe ti!

- Dreqi e marrtë! U ngatërrova! - i ra me pëllëmbë ballit Porfiri. - Më vjen vërdallë çdo gjë, s'po i jap dot këmbë kësaj të nëmure çështjeje! - iu kthye Raskolniovit si duke i kërkuar gjoja ndjesë. - E dini, ka shumë rëndësi të saktësohet në i pa kush bojaxhinjtë rreth orës tetë në atë apartament, ndaj dhe ju drejtova me pyetje që të na ndihmonit. Koka vërdallë më vjen. Më janë bërë çorbë në kokë gjërat.

- Duhet të tregoheni më i vëmendshëm, - i vuri në dukje me pamje zymtaku Raskolnikovi.

Fjalët e fundit qenë thënë në koridor. Porfiri Petroviçi i përcolli deri te dera me mirësjelljen e njeriut mikpritës. Në rrugë dolën me fytyra të nxira, të zhytur në mendime dhe disa kohë nuk këmbyen as dhe një fjalë. Raskolnikovi psherëtiu thellë.

VI

- Nuk më besohet! S'kam si e besoj! - përsëriste fare i çoroditur Razumihini, duke u përpjekur me të gjitha forcat t'i hidhte poshtë argumentet e Raskolnikovit. Gjendeshin pranë apartamentit ku prej kohësh po i prisnin Pulheria Alaksandrovna dhe Dunja. Razumihini pas çdo hapi që bënte, ndalte, nuk po dinte si ta shprehte indinjatën që për herë të parë sot kishin folur hapur për këtë çështje.

- Mos beso! - ia preu Raskolnikovi me një buzagaz të ftohtë dhe shpërfillës. - Ti kështu je, nuk vë re gjë prej gjëje, kurse unë e peshoj njëqind herë një fjalë para se ta nxjerrë nga goja.

- Se ti askujt nuk i beson, ndaj dhe e peshon asisoj... Ti saktë u shprehe... mënyra si fliste Porfiri s'kishte si mos të habiste, të indinjonte sidomos ai maskarai, Zametovi... Ke të drejtë, diç bluante përbrenda ai njeri... Po pse? Hë, përse?

- Gjatë natës i kishte ardhur mendje tjetër, dukej ajo.

- E pra, e kundërta duhet të ndodhte në u shkoka në mendje ky dyshim absurd: duhej të bënin çmos për ta fshehur me kujdes dyshimin, ta ngrinin mirë e mirë grackën dhe pastaj do të bije brenda. Tani s'kanë ç'të bëjnë!...

- Po të kishin patur fakte, fakte bindëse, apo makar edhe dyshim të faktuar po të kishin, atëherë do përpiqeshin të mos e nxirrnin kokën, duke shkuar me mendimin se me këtë mënyrë do t'i shumonin edhe më faktet (gjëja e parë që do bënin do më kishin bastisur shtëpinë). Po fakte ata nuk kanë, as dhe një, kanë vetëm hamendje, supozime, ndaj dhe orvaten të më befasojnë, sillen në mënyrë të paturpshme. Ju vjen edhe nga inati që nuk kanë makar edhe ndonjë fakt... Që është i zgjuar ai njeri, kjo duket... ndoshta donte të më trëmbte, të më linte të kuptoja që e dinte çdo gjë... Marifetçi i mbaruar qënka!... Më vjen ndoht, kur e kujtoj! Po më mirë e lëmë këtë bisedë.

- Të fyen burri i botës si pa gjë të keq! Të kuptoj drejt! Por... meqë jemi duke folur hapur, (dhe shyqyr që ia arritëm kësaj dite që jemi duke folur kështu, më bëhet shumë qejfi për këtë!) ja ku po ta them, këtë dyshim të tyre kam kohë që e kam nuhatur, si të them, e kam ndier, vetëm nga ca shënja e kam pikasur, por nuk e kuptoj përse duhet të jetë ky dyshim? Si guxojnë ta kenë? Mbi ç'bazë u ka lindur? S'më mbante vendi, kur e vura re. Pyes, me ç'të drejtë ca kokëdrutha zënë e marrin nëpërkëmbë dinjitetin e një studenti të varfër, të dërrmuar nga papasja dhe dëshpërimi, të sëmurë, në gjëndje jermi, por që ia di mirë çmimin vetes, rron me dinjitet, madje duron edhe kërcënimet për punë borxhesh, banon në një vrimë miu, pa dritë e pa ajër, pa vënë gjë në gojë disa ditë rresht? E si të mos bjerë të fikët, kur dëgjon diçka të llahtarshme? Me ç'të drejtë, nisur vetëm nga kjo, venë e ngrejnë një version të tërë? S'do mend që e kuptoj sa e padurueshme është. Rodia, të kisha qenë në vendin tënd, vetëm do qeshja e do gajasesha, do ua kisha hedhur këlbazën në fytyrë, do i bëja helaq dhe do ua kisha treguar bukur mirë vendin! Mos e çaj fare kokën!

Sikterisi!

"Nuk e ka keq ky!" - tha me vete Raskolnikovi.

- Mos ta çaj kokën, thua? Po ata nesër do më marrin në pyetje! - iu ankua. - Pse mos qënkam i detyruar t'u jap shpjegime? Mua edhe për të mbrëmshmen më vjen inat që e lashë veten të bie aq poshtë e të hyja në bisedë me Zametovin.

- Të dalë ku të dalë! Do shkoj që tani te Porfiri! Do ta vë përpara si njeriun tim që e kam: do ta detyroj të më hapet.. Ndërsa Zametovi...

"I ra në të, më në fund" - tha me vete Raskolnikovi.

- Pa prit! - thirri Razumihini, duke e shtrënguar nga krahu. - A s'më thua, ç'grackë sheh, që donte të ngrinte me ata bojaxhinjtë? The që edhe sikur t'i kishe parë, do thoshe që nuk i kishe parë. Se kush është ai që deponon kundër vetes, the.

- Po ja. Po të isha unë vrasësi, do t'u thosha që i pashë bojaxhinjtë, - i tha ngathët dhe me një neveri të hapur Raskolnikovi.

- E pse u dashka deponuar kundër vetes?

- Sepse vetëm ca leshko gjatë pyetjeve vetëm një gjë dinë, të mos hapen. Njeriu që është me mendje në kokë, s'ka si të mos i pranojë faktet që bëjnë mu; vetëm për shpjegimin e tyre gjen argumente të tjera nga ato të hetuesit, e fut në një hulli ngjarjesh të paramenduara dhe u jep një domethënie tjetër të dhënave, i ndriçon faktet në dritën që do! Porfiri, me siguri, këtë priste që unë të pohoja që i kisha parë, dhe sakaq të zija e të bëja shpjegimet e mia...

- Ashtu është, sepse nuk iu durua të thoshte që dy ditë para vrasjes aty s'kishte si të ishin bojaxhinjtë. Po të kishe thënë që i kishe parë, do dilte që kishe qenë aty ditën që u krye vrasja. Donte të të kapte në fjalë!

- Me atë mendje shkoi; unë po nuk do arrija dot ta kapja ku donte të dilte, do ngutesha me përgjigjen, do ta harroja faktin që kisha qenë dy ditë përpara vrasjes dhe bojaxhinjtë s'kishin si të ishin aty.

- E si mund të harrohej kjo?

- Fare kollaj! Me kësi grackash i qorollepsin njerëzit tinzarët, dinakët. Spekullojnë me dobësitë e atyre që marrin në pyetje. Porfiri duhet të jetë i hollë në kësi grackash.

- Qënka i poshtër! E tregoi veten...

Raskolnikovi s'e përmbajti dot të qeshurën. Vetë atij po i dukej

tepër e habitshme se me ç'zell i bëri këto shpjegime, në një kohë që biseda deri më tani kishte rrjedhur e zvargur dhe pa ngjyresa, plot e përplotë me neveri: kështu ia donte puna.

"Sikur po më shijojnë marifetet!" - i foli vetes.

E kapi një shqetësim, befas e ndjeu veten të tronditur, e pllakosi një mendim i çuditshëm. Shqetësimi sa vinte e rritej. Ishte te dera e apartamentit.

- Ti hyr, unë tani vij, - i tha shokut.

- Ku po shkon? Erdhëm!

- Kam një punë, pas një gjysmë ore vij... U thuaj edhe atyre.

- Po atëherë po vij dhe unë me ty.

- Ti si, mos ke bërë mendje të ma marrësh përfundimisht shpirtin? - iu hakërrua aq shumë i dëshpëruar, saqë Razumihini u dorëzua në vend. Qëndroi te parmakët e shkallëve dhe ndoqi me sy shokun që po largohej. Shtrëngoi grushtat dhe nofullat nga zemërimi dhe u betua heshturazi: qysh sot do ta merrte vesh nga Porfiri si qëndronte puna. Trokiti në derën e apartamentit për ta qetësuar Pulheria Aleksandrovnën që i priste e merakosur.

I djersitur dhe me frymëmarrjen e rënduar, Raskolnikovi ngjiti shkallët e hyrjes ku banonte, u fut në dhomën e tij dhe i vuri rezenë nga brenda. Shkoi në qoshen ku ishte e shqitur letra e murit, futi dorën dhe e kontrolloi mirë vendin. Nuk gjeti gjë, ndaj mori frymë i lehtësuar. Kur qëndronte para apartamentit të së ëmës, se përse i qe dukur që në atë vend mund të kishte mbetur ende diçka; po të gjendej nga ndokush, mund të shërbente si provë materiale kundër tij.

Qëndroi i menduar dhe një buzëqeshje e çuditshme, poshtëruese dhe jo aq e qartë i endej nëpër fytyrë. Mori kapelen dhe doli pa u ndier nga dhoma. Mendimet i kishte të trazuara, kur po zbriste shkallët dhe u gjend në rrugë.

- Ja, ky është! - tha me zë të lartë dikush; Raskolnikovi pa andej nga erdhi zëri.

Ishte rojtari, që po i fliste një të panjohur dhe po i tregonte për nga ai. Ishte një mesoburrë i veshur me dolloma të gjatë dhe zhiletë, ngjante si grua. Kokën e mbante të varur poshtë dhe ndaj ngjante si gërmuq. Fytyra e rrudhosur dhe e verdhë e tregonte mbi pesëdhjetë vjeç. Kishte nje shikim të zymtë e të egër njeriu të pakënaqur.

- Ç'është? - pyeti Raskolnikovi, duke iu afruar.

- Më pyeti për ju. Kur ju pashë, i tregova që jeni ju ai.

Rojtari kishte një si shqetësim, por jo dhe kushedi çfarë; s'kaloi shumë, ktheu krahët dhe hyri në koliben e tij. Raskolnikovi u turr pas të panjohurit, që ecte me hap të shtruar në anën tjetër të rrugës, sytë i mbante perdhe, dukej që diç mendonte. E arriti, por për një kohë eci disa hapa pas tij, pastaj iu afrua, e pa kush ishte; edhe ky e vuri re, e pa, por sytë vazhdoi t'i mbante përtokë. Ecën përbri njëri-tjetrit si ndonjë minutë, pa thënë asnjë fjalë.

- Mos më kërkuat? Më tha roja... - i foli i pari Raskolnikovi me zë të ulët.

Ky nuk iu përgjegj, nuk ktheu as kokën. Heshtje.

- E ç'domethënë kjo? E kërkoni tjetrin dhe pastaj heshtni? - zëri iu pre në mes, fjalët nuk po i dilnin të shkoqura.

Kësaj here i panjohuri ngriti sytë dhe e çpoi bashkëbiseduesin me shikimin ogurzi të syve të trishtë.

- Vrasës! - i tha me zë të ulët, por të qartë dhe të fortë.

Raskolnikovi vazhdoi të ecte përbri. Gjunjët iu prenë, trupin ia përshkuan mornica, zemra iu shtrëngua aq fort, sa mend i pushoi; pastaj i rrahu aq fort, saqë po i dukej se do t'i kërcente jashtë nga gjoksi. Ecën dhe nja njëqind hapa bri njëri-tjetrit pa folur.

I panjohuri nuk i ngriti sytë për ta parë.

- Ç'thoni kështu? Si... Kush është vrasës? - belbëzoi Raskolnikovi me zë të mekur.

- Ti je vrasës! - përsëriti me zë të sigurt, nxitës, shoqëruar nga një buzagaz plot me urrejtje dhe duke e parë ngultas Raskolnikovin e verdhë dyllë, me sytë e shuar. Gjendeshin pranë kryqëzimit. I panjohuri eci nëpër rrugën majtas, pa e kthyer më kokën. Raskolnikovi qëndroi në vend dhe e ndoqi me sy për një kohë të gjatë. Pasi bëri nja pesëdhjetë hapa, ky ktheu kokën dhe pa që Raskolnikovi qëndronte si i gozhduar në vend. Zor të shquhej, por Raskolnikovit iu duk sikur u zgërdhesh, duke shfrerë kështu urrejtjen për vdekje dhe ngadhnjimin e fitores.

Me kokën ulur, në gjëndje mos më keq, duke u dridhur si të ishte në të ftohtin polar, Raskolnikovi u kthye në musendrën e tij. Vuri kapelen mbi tryezë dhe qëndroi ashtu i përhumbur. Pastaj fuqiprerë

u shtri në kanape, u shtriq dhe rënkoi si i sëmurë, sytë i mbante të mbyllur. Ndënji kështu nja gjysmë ore.

Nga moria e mendimeve, që i vërtiteshin në kokë, asnjë nuk po arrinte dot ta kapte, vetëm copra mendimesh dukeshin e zhdukeshin sakaq, para syve i dilnin fytyra njerëzish, që i kishte parë në fëmijëri, që i kishte takuar vetëm njëherë, të cilët as dhe njëherë më parë nuk i kishte kujtuar. Iu kujtua bilardoja në pijetore dhe era e duhanit në mejhane, shkalla e errët, e rrëshqitshme dhe e papastër, tinguj këmbanash, që binin diku larg... Një ciklon i vërtetë mbresash ia trazonte kokën. Kishte që i pëlqenin, që donte t'i ndalte, por ato shuheshin aty për aty, ndërkohë kokën e kishte të rëndë plumb. Të dridhurat s'po i ndaheshin.

Dëgjoi hapat e shpejtë, të vrullshëm të Razumihinit, pastaj zërin: mbylli sytë dhe u shtir sikur po flinte. Razumihini hapi derën dhe disa çaste qëndroi te pragu, pastaj hyri pa u ndier në dhomë dhe iu afrua kanapesë. U dëgjua pëshpërima e Nastasisë:

- Mos e nga; le të flejë. Ha më vonë.

- Mirë thua, - ia mbështeti mendimin Razumihini.

Dolën dhe e mbyllën me kujdes derën. Kaloi dhe një gjysmë ore, Raskolnikovi i hapi sytë, vuri duart në krye dhe qëndroi pa lëvizur.

"Kush të jetë? Sikur mbiu nga dheu... Ç'mund të dijë, vallë? Me siguri që i ka parë të gjitha. Po ku të ketë qenë atëherë? E pse u kujtua tani të duket? S'ka patur si të më ketë parë! Hm.. - vazhdoi me zemër të ngrirë, duke vazhduar të dridhej si në ethe. - Po kutia me vathët që gjeti Nikollai pas derës? E pamundur qënka? Ja dhe provat! Aty ku s'e pandeh, gjenden! Një mizë fluturake të ka parë? Të duket e pamundur?".

I erdhi të pështirë nga vetja që u squll kështu.

"Duhej ta kisha ditur që kështu do të ndodhte, - tha me vete me një nënqeshje të hidhur. - Si guxova, duke e njohur mirë veten, të rrëmbej sëpatën dhe të derdh gjakun e tjetrit. Duhej ta dija ç'më priste. Dhe e kam ditur, fare mirë e kam ditur..." - belbëzoi i pushtuar nga makthi. I vinin në kokë edhe mendime të tilla:

"Jo, ata të gjithëpushtetshmit nuk janë bërë nga ky brum që jam bërë unë... Ata e kanë me pash lejen, marrin e shkretojnë Tylonin, bëjnë kasaphanë brenda në Paris, harrojnë që e kanë lënë ushtrinë në

Egjipt, sakrifikojnë gjysmë milion njerëz në fushatën e Rusisë dhe nga Vilna largohen me kalambure në gojë: këta pas vdekjes adhurohen, atyre çdo gjë u lejohet. Jo, ca të tillë nuk janë prej mishi, janë prej bronxi!".

Një mendim i beftë, anësor e bëri të qeshë.

"Napoleoni, piramidat, Vaterloja dhe plakaruqja gurruce, kërcure, që të ndjell krupën, fajdexhesha me baulen e kuqe nën krevat! E si ta honeps këtë qoftë edhe Porfiri Petroviçi!... S'ka se si! As parimet më elementare të estetikës nuk e lejojnë! Se pyes: a do të zhgërryhej, vallë, Napoleoni nën krevat për të marrë pengjet e plakaruqes? Poshtërsi!...".

I dukej që ishte duke folur përçart, e pushtoi një eufori e çuditshme, ndihej si ndër ethe.

"Tërë puna nuk është te plakaruqja, - thoshte me vete krejt i emocionuar. - Desha vetëm të hidhja hapin e parë... Se unë nuk vrava njeriun, vrava parimin, ja çfarë! Për të vrarë, e vrava, kurse për të dalë matanë, nuk po dal dot, mbeta në këtë anë... Pale pastaj që po del se edhe këtë nuk paskam ditur ta bëj!... Po ky teveqel Razumihini përse i telendisi ashtu socialistët? Njerëzit që punojnë, "lumturinë e përgjithshme" ndërtojnë... Jo, jeta më është dhënë vetëm një herë, nuk dua të qëndroj në pritje të "lumturisë së përgjithshme". "Vë një tullë në godinën e "lumturisë së përgjithshme" dhe ndihem i qetë". Ha-ha! E pse më lejuat? Edhe unë një jetë kam dhe e dua... Ah! Unë s'jam veçse një morr estetik, asgjë më tepër, - shtoi dhe qeshi i ndërliqur. - Ashtu është, morr jam!... Dukej që po kapej me keqdashje pas këtij mendimi, po e rrokaniste me të kokën, ishte ai vetë që po e hidhte e priste mendjen e tij. Sa kohë që jam duke e bezdisur hyjninë bamirëse, duke e bërë dëshmitare të veprimeve të mia që s'bëhen për veten time, por në emër të qëllimit të mahnitshëm! Ha-ha! Edhe ajo që respektova drejtësinë gjatë ekzekutimit, vura në bazë të veprimeve matematikën: nga të gjitha zgjodha atë më batallin, pasi e vrava, vendosa të marrë aq sa më duhej për hapin e parë (Pjesa tjetër le t'i shkonte manastirit sipas testamentit të plakaruqes! ha-ha!)... Ndaj dhe s'jam veçse morr e shkuar morrit! - mendoi kështu dhe kërcëlliti dhëmbët për tmerr. - Vetë unë jam më i ndyrë dhe më i poshtër se morri që vrava; e kam ditur që një ditë do t'ia thosha këtë vetes pasi

ta kisha vrarë! Po a ka gjë që të krahasohet me këtë tmerr? Ç'poshtërsi! Çfarë veprim banal! E kam kuptuar shumë keq "profetin", fjalët e thëna: "Kështu ka urdhëruar allahu, bindu, o roje "drithmëtar"! Me të drejtë ai "profeti" diku në mes të rrugës nxjerr një a-la-me-t baterie dhe e zbraz kundër të shtrembërit dhe të drejtit, fajtorit dhe jo fajtorit, pa denjuar madje as të shpjegohet! Ul kokën, o krimb dridhmëtar, dhe *mos dëshiro*, nuk është punë për ty! Kurse plakaruqes nuk kam për t'ia falur kurrën e kurrës!".

Flokët i ishin ngjitur nga djersa, buzët drithëruese i qenë tharë, i digjeshin, shikimin e ngrirë ia kishte ngulur tavanit.

"Mamaja, motra, sa shumë që i kam dashur! E përse tani ndjej urrejtje? Po, po! I urrej, i urrej me tërë qënien time, s'i duroj dot pranë! Pak më parë iu afrova mamasë dhe e putha, kjo është e vërtetë. Po në e marrtë vesh? Çdo të bëhet me mua? - tha dhe me sforcim të madh u orvat t'i davariste nga vetja makthin dhe angështinë që po ia zinin frymën. - Sa shumë që e urrej atë plakaruqe! Do ta kisha vrarë përsëri, po të ngjallej së vdekuri! E gjora Lizavetë! E ç'iu desh të hynte në atë çast? Veç çudi që për të kurrë nuk mendoj, sikur s'jam unë ai që e vrau! Lizaveta! Sonja! Të varfërat qënie, kokulura dhe me shikim të përkorë... Aq të dashura! As qajnë e as rënkojnë... S'ndihen! Janë gati të sakrifikohen!... Nuk bjenë në sy... Sonja, Sonja! Kokulura Sonjë!".

Ra në kllapi; iu duk shumë e çuditshme që s'i kujtohej se si ishte gjendur në rrugë. Ishte natë. Hëna e plotë shkëlqente për bukuri, por ajri ishte i rëndë, të zihej fryma. Njerëzit truma-truma çapiteshin nëpër rrugë, dyqanxhinjtë po ktheheshin në shtëpitë e tyre. Kutërbonte erë gëlqere, pluhuri dhe uji të ndenjur. Raskolnikovi ecte i zhytur në mendime. I kujtohej që kishte dalë nga dhoma për të shkuar diku, duhej ngutur, por se ku duhej të shkonte, e kishte harruar. Befas ndali dhe pa në anën tjetër të rrugës dikë që i bënte shenjë me dorë. Çau përmes rrugën dhe desh t'i afrohej, ndërsa ky si pa gjë të keq i ktheu shpinën, uli kokën dhe u shtir sikur nuk kishte qenë ai që i kishte bërë shenjë. Raskolnikovi iu qep pas. S'kishte bërë as dhjetë hapa dhe e njohu: ishte i panjohuri me atë dollomanë dhe kërrusjen karakteristike. Raskolnikovi e la të largohej pak, zemra i rrihte si çekan, kthyen në një bërryl, i panjohuri vazhdonte rrugën pa e kthyer kokën prapa. "A

e di vallë, që jam duke i shkuar pas?", - pyeti veten. I panjohuri hyri në portë dhe vuri re që i bëri përsëri me dorë. Pas pak u zhduk, domethënë se hyri në një nga hyrjet më të afërme. Raskolnikovi iu turr pas. Në hyrje dëgjoi ca hapa të shtruar që po ngjisnin shkallët; i njihte: ja dritarja e katit të parë, trishtushëm dhe e mbështjellë me një si fshehtësi depërtonte në të drita e hënës. Ja dhe kati i dytë. "Ky qënka apartamenti ku punonin bojaxhinjtë!" - tha me vete. Hapat e njeriut që ngjiste shkallët nuk dëgjoheshin më. "O ka ndaluar, o është fshehur diku!" - mendoi. Kati i tretë. "A të ngjitej më lart?" - pyeti veten. Heshtje varri, tmerr! Sidoqoftë vazhdoi. I vinte frikë nga zhurma e këmbëve të veta, errësirë e padurueshme! I panjohuri, me siguri, që ishte fshehur këtu në ndonjë qoshe. Dera e apartamentit ishte e hapur, qëndroi një hop në mëdyshje pastaj hyri. Në korridor ishte errësirë e plotë: ngadalë, në majë të gishtave hyri në dhomën e pritjes: drita e hënës llamburinte, çdo gjë ishte si atëherë, edhe divani, edhe pasqyra, edhe tablotë në korniza. Nga dritarja dukej hëna e madhe e rrumbullaktë, ngjyrë bakri të përflakur. "Nga hëna është tërë kjo heshtje! - tha me vete Raskolnikovi. - Tani do ta marr vesh si qëndron puna. "Priti ca, priti shumë dhe sa më qetë shihte hëna në dritare, aq më fortë i rrihte zemra. Befas u dëgjua një kërcitje e thatë, si të thyenin një shkarpë dhë përsëri ra heshtje. Një mizë u përplas në dritare duke u zhuzhatur, përpiqej të dilte jashtë. Syri i shkoi atje në qoshe, ndërmjet dollapit dhe dritares, pa të varur në mur një mantel. "Po ky ç'ne këtu?" - e pyeti veten. - Atëherë nuk ka qenë...". Iu afrua i shtyrë nga një parandjenjë që prapa tij fshihej dikush. E lëvizi ngadalë, pa të ulur në karrige plakaruqen; të skrupullosur, me kokën varur aq shumë në kraharuar, saqë s'i dukej fare fytyra, vetëm me hamendje e kuptoi që ishte ajo. "Paska frikë!" - tha me vete. Nxori ngadalë sëpatën nga laku nën sqetull dhe e qëlloi plakën në çaçkën e kokës, pastaj edhe njëherë. Por, o çudi, ajo nuk luajti vendit, si të ishte prej druri. U habit, u përkul që ta shihte më mirë, por ajo e uli edhe më kokën. U përkul thuajse deri në dysheme dhe që nga poshtë u orvat t'i shihte fytyrën; ngriu i lemerisur: plakaruqja rrinte ashtu e kërrusur dhe qeshte pa zë, kishte një të qeshur që s'kishte fund. E hante meraku vetëm për një gjë, që ky të mos e dëgjonte. Atë çast iu bë se edhe në dhomën e gjumit qeshnin e çuçurisnin. U bë si i çmendur: e qëllonte me sa

fuqi që kishte plakën, por pas çdo goditjeje të qeshurat dhe çuçurimat në dhomën e gjumit shtoheshin, bëheshin më të zëshme, ndërsa plaka dridhej nga të qeshurit e papërmbajtshëm. Donte t'ia mbathte, por koridori ishte plot me njerëz, dera e jashtme ishte e hapur, njerëz kishte edhe në shkallë, edhe poshtë te hyrja: të gjithë e shihnin dhe diç prisnin në heshtje!... Angështia ia kishte shtrënguar keqas zemrën, këmbët nuk po i bindeshin. Donte të bërtiste dhe... u zgjua.

U mbush me frymë, por, o çudi, vazhdonte të shihte ëndërr: dera e dhomës qe e hapur, në prag qëndronte një i panjohur që e shihte i përqendruar.

Raskolnikovi nuk arriti t'i hapte sa duhet sytë dhe i mbylli shpejt. Rrinte shtrirë pa lëvizur fare. "Mos jam duke parë ëndërr akoma?" - tha me vete. I hapi sytë aq sa të mund të shihte qoftë edhe turbull, i panjohuri vazhdonte të qëndronte te dera pa ia ndarë shikimin. E pa si kapërceu pragun, mbylli avash derën, iu afrua tryezës, qëndroi para tij si ndonjë minutë, pa ia shqitur për asnjë çast shikimin, dhe, ngadalë, pa zhurmë u ul në karrige, pranë kanapesë; kapelen e la në dysheme dhe me të dyja duart u mbështet mbi bastun, pastaj vuri mbi to dhe gushën. Dukej që e kishte ndarë mendjen të priste sa ta lypte nevoja. Sa mund të shquante përmes qepallave paksa të hapura, Raskolnikovi vuri re që mysafiri i paftuar ishte në moshë të thyer, por trupin e kishte të lidhur, kishte një mjekër të madhe, të verdhemë, thuajse të bardhë.

Kaluan kështu nja dhjetë minuta. Po binte mbrëmja, por ende dukej. Në dhomë kishte qetësi të plotë. As nga shkallët nuk vinte ndonjë zhurmë. Vetëm një mizë e madhe zhuzhiste, duke u përplasur fluturimthi në xhama. Më në fund, Raskolnikovi nuk duroi dot më, i dha përpjetë trupit dhe u ul në kanape.

- Po ju, ç'kërkoni këtu? - e pyeti të panjohurin.

- E dija që nuk po flinit, vetëm shtireshit që ishit në gjumë, - iu përgjegj me zë të çuditshëm i panjohuri dhe qeshi pateklif. - Arkadi Ivanoviç Svidrigajllov, më lejoni t'u paraqitem...

Pjesa e katërt

I

"Mos jam duke parë edhe tani ëndërr?" - tha me vete Raskolnikovi. Po e shihte me kërshëri dhe mosbesim mysafirin e papritur.

- Svidrigajllovi? Gjepura! Nuk ka mudnësi! - shqiptoi, më në fund, me zë të lartë, tepër i habitur.

Ndërsa mysafiri nuk e prishi fare terezinë.

- Ua bëj këtë vizitë i shtyrë nga dy arsye: desha t'u njihja, sepse kam kohë që dëgjoj të thuhen për ju fjalë nga më të mirat, dhe dua t'u kandis të bashkëpunojmë në një ndërmarrje në interes të motrës suaj, Avdotia Romanovnës. Se vetëm, pa rekomandimin tuaj, ndoshta as në oborr s'më pranon, për shkak të paragjykimeve, ndërsa me ndërhyrjen tuaj them se...

- As të mos ju shkojë në mendje! - ia preu shkurt Raskolnikovi.

- Se ato erdhën mbrëmë, kurse unë kam tri ditë këtu. Më dëgjoni se ç'dua t'ju them, Rodion Romanoviç. Nuk kam aspak ndërmend të përligjem për gjithë ç'ka ndodhi, më lejoni vetëm t'u siguroj që asgjë kriminale në veprimet e mia nuk ka patur, nëse i shohim gjërat esëll.

Raskolnikovi vazhdonte ta shihte në heshtje.

- I kam qenë vardisur vashës së pambrojtur, "e kam fyer, duke i rënë në qafë"... Kështu apo jo? (Po e pranoj që më parë këtë). Por edhe unë njeri si të gjithë njerëzit jam *et nihil humanum...*[1] pra edhe mua mund të më prishej mendja e të bija në dashuri. (S'jemi ne që i kemi në dorë ca punë si këto). Pra, ndodhia fort mirë mund të shpjegohet. Çështja duhet shtruar ndryshe: ç'jam unë, ndonjë xhahil apo viktimë? Duke i propozuar personit në fjalë të shkojmë në

[1]) *Asgjë njerëzore... (lat).*

Amerikë apo në Zvicër, kam ushqyer ndjenja nga më të nderuarat, kam menduar për lumturinë e ndërsjelltë. Se mendja është shërbëtore e ndjenjave, kështu apo jo? Isha unë ai që riskoja më shumë se kushdo tjetër...

- Nuk është aty puna, - e ndërpreu me neveri Raskolnikovi. - Për ju as që duan të dinë, pavarësisht në jeni apo nuk jeni me faj për gjithë sa ndodhi. Jua kanë thënë një herë e përgjithmonë; tani shkoni në punën tuaj...

Svidrigajllovi qeshi me të madhe.

- Qëndrokeni shkëmb në tuajën, domethënë, - nëpërdhëmbi. - Thashë të bëja një krahëmarrje, por, me ç'duket, nuk qënka e mundur!

- E megjithë këtë lojën jeni gati ta vazhdoni, me ç'po shoh?

- E ç'të keqe ka në këtë mes? - e pyeti shend e verë Svidrigajllovi. - Është një *honne guerre*[1], një krahëmarrje fare e lejueshme. Por s'më latë ta mbaroja mendimin. Çdo gjë do të kishte kaluar si s'ka më mirë, po të mos qe ndodhur rastësisht në kopsht Marfa Petrovna.

- Thonë që Marfa Petrovnën ju e çuat në atë botë, - e ndërpreu me harbutësi të pafshehur Raskolnikovi.

- Paskeni dëgjuar dhe ju? E si të mos dëgjonit?... Kësaj pyetjeje s'di ç'përgjigje t'i jap, ndonëse e kam qelibar ndërgjegjen. Se edhe përfundimet e autopsisë e vërtetuan hemorragjinë në tru, që i ndodhi gjatë banjës pas drekës së bollshme të shoqëruar edhe me një shishe verë. Kur po vija këtu, më mundonte dyshimi: mos isha unë ai që ia kisha shpejtuar fundin, duke e nervozuar dhe shqetësuar vazhdimisht me sjelljen time? Dhe e dini në ç'përfundim erdha? Kjo nuk qëndron!

Raskolnikovi qeshi me të madhe.

- E pse e paskeni vënë veten në siklet?

- Po ju pse qeshni? Vetëm nja dy herë i rashë me kamxhik, s'ju gjend as dhe një shenjë... Dhe, ju lutem, mos më merrni për cinik; e di, fare mirë e di, nuk bëra mirë, por ama e di edhe, dhe e di me saktësi, që Marfa Petrovna në thellësi të shpirtit ndihej e gëzuar që ushqeja atë pasion për motrën tuaj. Pasi u mor vesh çdo gjë, Marfa Petrovna nuk kishte me se merrej, kishte tri ditë që nuk shkonte në qytet se e kishte tepëruar zullumin me letrën që nuk la njeri pa ia

---

[1]) *Luftë e mirë (fr.)*

treguar (keni dëgjuar, besoj, për leximin e asaj letre). Kur, do ti, u gjendën për bela ato dy goditje kamxhiku! Pale pastaj, që dihet ajo, sa qejf që i kanë gratë të tilla "argëtime", ndonëse duken fort të indinjuara. E kujt nga ato nuk i kanë ndodhur raste të tilla?... Dhe në përgjithësi njeriut ia ka shumë po shumë ënda të ndihet i fyer, e keni vënë re këtë? Veçanërisht gratë, madje mund të thuash, që zbaviten kësisoj!

Raskolnikovit i shkrepi në mendje të ngrihej e të dilte, kështu do t'i jepte fund këtij takimi, por s'e la kërshëria e shoqëruar edhe nga një hesap.

- Ju pëlqekan kacafytjet? - tha kalimthi.

- Jo dhe shumë, - iu përgjegj i qetë Svidrigajllovi. - Ne me Marfa Petrovnën kurrë nuk jemi zënë, kemi jetuar në mirëkuptim, ka qenë e kënaqur nga unë. Gjatë shtatë vjetëve jetë bashkëshortore kam pas vënë dorë vetën dy herë (në mos zënçim ngoje një të tretë që mund merret edhe disi e dyshimtë). Hera e parë ka qenë dy muaj pas martesës, sapo kishim ardhur në fshat, dhe hera e dytë kjo e fundit. Mos më pandehni për xhahil? Mos më merrni për skllavopronar kokëngjeshur? He-he!... Meqë ra fjala, Rodion Romanoviç, a s'ju kujtohet vjete të shkuar si ia morën erzin një oborrtari. Ia harrova emrin. E pati rrahur paq gjermankën në vagonin e trenit. E kam fjalën për "ngjarjen e shëmtuar", për të cilën shkroi "Shekulli". (Ju kujtohen "Netët egjiptiane", leximet publike... sytë e zinj... Ah! Kohë e artë e rinisë!). E pra, për mendimin tim, zotëria që zhdëpi gjermankën, domosdo që nuk bëri mirë! Mirëpo ka ndër ne nga ato "gjermankat" shtrigane, që edhe ata që mbahen për modernë e të civilizuar, zor se do të mundnin ta përballonin një vështirësi të tillë. Atëherë asnjë nuk e pa çështjen në këtë kënd vështrimi, i cili, për mua, është nga më humanët! Po ju si thoni?

Dhe përsëri u shkreh në gaz. Raskolnikovi i ra pikës që ky njeri kishte ardhur me një vendim të caktuar dhe dukej që ishte nga ata, të cilët vendimet i bëjnë realitet.

- Thoni që nuk paskeni folur me njeri këto ditë? - e pyeti.

- Thaujse nuk kam folur. Po si, po habiteni që më shihni njeri aq të epshëm?

- Jo, nuk është kjo që më habit.

- Apo që nuk u fyeva nga vrazhdësia e pyetjeve tuaja? Po a ia vlen? Ashtu si qenë pyetjet, morët dhe përgjigjet... - shtoi me një babaxhanësi te çuditshme. - Se unë nuk kam ndonjë përfitim nga kjo që do ju parashtroj, - vazhdoi mendueshëm. - Ama është e drejta juaj të dyshoni, sepse sapo u shpreha që interesohem për motrën tuaj. Por, më besoni, po pëlcas nga mërzia, sidomos këto tri ditë këtu në Petërburg, ndaj dhe u gëzova shumë që ju gjeta... Mos t'u vijë keq, Rodion Romanoviç, që do t'ju them se edhe ju sesi më dukeni, disi i çuditshëm... Seç keni kështu... Po i lëmë këto, mos u vrenjtni! S'jam aq avdall sa mund të më pandehni.

Raskolnikovi e pa i pezmatuar.

- Ju, kushedi nuk jeni njeri avdall... - i tha. - Dukeni që i përkisni shoqërisë së zgjedhur, kur jua do puna, silleni si s'ka më mirë.

- S'para më ha meraku për opinionin e të tjerëve, - foli thatë por jo pa kryelartësi Svidrigajllovi. - E përse të mos tregohem gojëprishur, nëse ky kostum më shkon për shtat? Për më tepër që dhe prirjet për këtë nuk më mungojnë, - shtoi dhe përsëri qeshi me të madhe.

- Kam dëgjuar se kini shumë të njohur në qytet, nuk jeni nga ata që s'kanë lidhje. E ç'gjekeni interesante në shoqërinë time?

- Që kam të njohur, kjo është e vërtetë, - pohoi Svidrigajllovi, duke lënë mënjanë përgjigjen për çështjen kryesore. - Boll njerëz kam që mund t'i takoja. As veshja, as pasuria, asgjë nuk më mungon, por ja që më kanë ardhur në majë të hundës! Nuk u kam vajtur e pikë... Kurse këtu vij me një shpresë...

- Me ç'shpresë?

- Sa për klubet... Jo Dysotovi, jo debatet për përparimin, ata bëjnë edhe pa ne, - tha edhe kësaj here si duke mos e vënë re pyetjen kryesore. - E ç'na duhet të merremi me batakçillëqe?

- Pse, si, mos jeni marrë ndonjëherë?

- Nuk bën dot robi pa to. Para tetë vjetësh, kemi qenë një dorë, dhe ishim jo njerëz dosido, kishte edhe poetë e afaristë, mbaheshim për bukuri. Se te ne në Rusi, ata që i kanë ndrysur e ndrydhur, mbahen si rrallë kush, e keni vënë re këtë? Pastaj në fshat e lëshova veten... Që thoni ju, deshën të më rrasnin brenda për borxhe. Fati im, më doli përpara Marfa Petrovna, mori përsipër të m'i lante, tridhjetë mijë ishin... U martuam, shkuam në fshat, në çifligun e saj, më mbante si

ujët e pakët. Ishte pesë vjeçe më e madhe se unë... Linte kokën pas meje! Kuptohet, m'i lidhi duar e këmbë, as gëk e as mëk nuk bëja dot... një çik e më kërcënonte me dokumentin për borxhet. E dini si janë gratë...

- Po sikur të mos kishte qenë ai, do ia kishit treguar qejfin?

- S'di çfarë t'u them. Nuk para e çaja kokën për atë dokument. Puna ishte që vetë unë nuk kisha qejf për asgjë. Nja dy herë më tha të shkonim jashtë shtetit, se nuk ishte keq të shihje gjirin e Napolit, detin, kurse mua s'më ndahej që s'më ndahej mërzia... Pastaj, si shtëpia jote nuk ka! Tani ndryshon puna, edhe në Polin e Veriut të më thonë të vemi, vete... *j'ai le vin mauvais*[1]), pijen nuk e shoh dot me sy... E ç'më ka mbetur tjetër? Thonë që Bergu nga oborri i Jusupovit do niset me zebelinë, i duhet një bashkudhëtar me pagesë, e vërtetë të jetë?

- Do pranoni?

- Kush unë? Jo!.. Vetëm pyeta... - mërmëriti mendueshëm.

"A thua vërtet ta bënte?" - tha me vete Raskolnikovi.

- Jo, jo! Dokumenti i borxhit nuk më prishte punë, - iu kthye përsëri asaj teme Svidrigajllovi. - Mua vetë s'ma kishte ënda të largohesha nga fshati. Pastaj u mbush viti që për ditëlindjen Marfa Petrovna ma ktheu dokumentin dhe më dhuroi edhe një goxha shumë. Se pasuri ajo kishte: "Ja sa shumë besim që kam te ju, Arkadi Ivanoviç", - më tha. S'u besohet? Çifligun ia administroja si rrallë kush, cili nuk e dinte këtë! Edhe libra po nga më të mirët i porosisja. Në fillim Marfa Petrovna u gëzua, por s'kaloi shumë dhe u trëmb nga zhvillimi im.

- E ndjekeni thellë humbjen e Marfa Petrovnës, me ç'po shoh?

- Unë? Ndoshta... Desha t'ju pyes, a u besoni hijeve?

- Cilave?

- Të zakonshmeve.

- Pse ju u besoni?

- Jo; them se jo... *pour vous plaire*[2]). Domethënë, jo fare...

- Po si, u fanitën?

Svidrigajllovi e pa në një mënyrë të çuditshme.

- Marfa Petrovna më fanitet, - tha dhe u shtrembërua në fytyrë.

---

[1]) *I dehur bëhem i shëmtuar (fr.)*

[2]) *Për t'u dhënë juve kenaqësi (fr.)*

- Si kështu?

- Tri herë më është fanitur! Herën e parë ditën e varrimit, një orë pasi ishim kthyer nga varrezat, herën e dytë tri ditë pas vdekjes, kur isha duke ardhur për këtu, në stacionin Mallaja Vishira, herën e tretë në apartamentin ku banoj, isha vetëm.

- Po si, me tamam ju fanitet?

- Krejt, të trija herët. Shfaqet, bisedon dhe zhduket, gjithomë hyn e del nga dera, e dëgjon edhe kur hyn.

- Nuk e di përse, por e mendova që ju ka ndodhur diçka e tillë! - i tha papritur Raskolnikovi dhe po aty u habit që kishte qenë ai që i kishte nxjerrë nga goja këto fjalë. Dukej sllumë i tronditur.

- Ashtu? Pra, e paskeni provuar edhe ju? - e pyeti i habitur Svidrigajllovi. - Çudi! Mirë thashë, seç kemi të përbashkët ne të dy.

- Këtë ju nuk e keni thënë! - ia preu i ngrefosur Raskolnikovi.

- Nuk e paskam thënë?

- Jo.

- Më duket se jua thashë. Kur ju pashë të rrinit ashtu me sy mbyllur dhe shtireshit sikur flinit, thashë me vete: "Ky është!".

- Ç'doni të thoni me këtë: "Ky është?". Ç'flisni kështu?

- Ç'po flas? As vetë nuk e di... - pranoi sinqerisht dhe si duke u ngatërruar vetë me veten Svidrigajllovi.

Kaloi një minutë pa folur; shihnin me sy të shqyer shoshoqin.

- Gjepura janë këto që thoni! - tha i inatosur Raskolnikovi. - E ç'u thotë, kur u fanitet hija?

- Ç'më thotë? Gjëra fare të parëndësishme më thotë, dhe mos u habit po deshe; ja, kjo dhe m'i ngre nervat. Herën e parë (i lodhur siç isha pas varrimit, u tërhoqa në kabinet; isha vetëm, ndeza një cigare, rashë në mendime), hyri nga dera. "Nga telashet e ditës së sotme, Arkadi Ivanoviç, harruat të kurdisnit orën në dhomën e ngrënies", - më tha. Atë orë shtatë vjet rresht unë e kurdisja, kur harroja, ma kujtonte. Të nesërmen u nisa për këtu. Në stacionin Mallaja Vishira zbrita nga treni për të pirë një kafe; isha fare i dërrmuar, kur ç'të shoh, në karrigen tjetër rrinte ulur Marfa Petrovna, në dorë mbante letra bixhozi. "A t'u hedh një fall? Doni të dini ç'të mira ju presin?" - më pyeti. Nuk ia fal vetes që s'e lash ta bënte. Ika me vrap se u dëgjua sirena e trenit. Sot teksa po rrija ashtu i tulatur, pas drekës që më ra si

plumb në stomak, po pija një cigare, kur shoh hyri Marfa Petrovna: ishte e veshur dhe e stolisur me fustanin prej mëndafshi jeshil, të gjatë dhe me bisht. "Mirëdita, Arkadi Ivanoviç! Si ju duket ky fustan? S'e qep dot kushdo një të tillë..." U vërtit sa andej këtej. Ia pashë fustanin, pastaj ia qepa shikimin fytyrës. "E ç'është kjo me ju, Marfa Petrovna, - i thashë, - për ca vogëlsira mundoheni të vini tek unë". "Ah, mor burrë, as kaq nuk duron!". I them që ta ngacmoj pak: "Kam ndërmend të martohem, Marfa Petrovna". "E pse me kaq ngut? S'u nderon, që pa e varrosur mirë gruan, të sillni tjetrën në shtëpi. Pastaj të merrnit ndonjë për të qenë, hajde de, por e di mirë unë, gazi i botës do bëheni!". U ngrit dhe iku, vetëm zhurma e bishtit u dëgjua edhe pak më pas. Marrëzi po flas, apo jo?

- Po ju, kushedi, dhe gënjeni! - s'ia la pa thënë Raskolnikovi.

- Nuk e kam për zakon gënjeshtrën, - ia ktheu mendueshëm Svidrigajllovi pa dhënë shenjë se ia vrau veshin vrazhdësia e pyetjes.

- Po më përpara asnjë herë nuk ju janë fanitur hije?

- J-o-o! Vetëm një herë para shtatë vjetësh. Kam patur një shërbëtor që quhej Filka. Po e varrosnin, kur se si më erdhi dhe bërtita: "Filka, ke harruar çibukun!". Ndërkohë thashë me vete: "Ka për t'u hakmarrur". Para se të vdiste, i pata bërtitur dhe e pata sikterisur. "Si guxon, - i pata thënë një herë, - të më paraqitesh në kabinet me bërryla të grisur? Jashtë, mor maskara!". Iku, por s'erdhi më kurrë, vdiq. Nuk i pata treguar Marfa Petrovnës për ç'më kishte ndodhur. Desha të falja një meshë, por ndërrova mendje.

- Duhet të vizitoheni.

- Këtë edhe pa më thënë ju e di. Veç nga shëndeti nuk qahem. Ju pyeta, a i besoni hijeve?

- Jo! Dhe nuk kam përse! - iu përgjigj me ligësi në zë Raskolnikovi.

- Jo? Thatë jo? - e pyeti Svidrigajllovi dhe e pa ngultas. - Po sikur të arsyetonim ja kështu: "Hijet janë copëza, janë fragmente të botës tjetër, janë fillimi i saj. Një njeri i zakonshëm nuk ka përse i sheh, ai është një tokësor dhe pikë. Si i tillë ky duhet të bëjë vetëm jetën e këtushme... Po të sëmuret, po t'i prishet sado pak rendi i përditshëm i organizimit të jetës, krijohet mundësia e shfaqjes së botës tjetër; sa më i sëmurë njeriu, aq më të shumta janë pikat e takimit të tij me këtë botë, pastaj, kur vdes, kalon i tëri në atë botë!". Kam kohë që e

vras mendjen për këtë. Kush beson në jetën tjetër, e pranon menjëherë këtë logjikë.

- Unë nuk e besoj, - i tha Raskolnikovi.

Svidrigajllovi u zhyt në mendime.

- Po sikur aty të ketë vetëm merimanga dhe gjithfarësoj monstrash të tjera për llahtar? - pyeti papritur.

"Qënka i lojtur!" - tha me vete Raskolnikovi.

- Se ne përjetësinë e përfytyrojmë si të paarritshme, si diçka të madhe, të madhe... Po pse duhet të jetë e madhe? Po sikur atje të mos ketë veç një dhomë, si ato banjat e fshatit, tërë blozë e pezhishka merimangash në tavan? Ja dhe përjetësia!... Mua, ndonjëherë kështu më bëhet se është.

- Po si, asgjë më ngushëlluese dhe të mirë se kjo nuk përfytyrokeni? - me një emocion të dukshëm në zë e pyeti Raskolnikovi.

- Më të mirë? E ku i dihet, ndoshta kjo e këtushmja është e mirë, - iu përgjigj Svidrigajllovi me një buzagaz të papërcaktuar.

Një ftohtësi e akullt ia përshkoi trupin; Svidrigajllovi ngriti sytë dhe e pa sikur e çpoi, pastaj ia plasi gazit.

- Pa shih se ç'ndodhi, - thirri. - Para një gjysmë ore ne as që e njihnim njëri-tjetrin, madje mbaheshim për armiq se kemi në mes një çështje ende të pazgjidhur. E pra, e lamë mënjanë atë dhe u futëm në të thella. Mirë e kam po të them se gjeti tenxherja kapakun?

- Bënit mirë të hynit në temë e të shpjegonit qëllimin e kësaj vizite, jam me ngut... më duhet të dal... - i foli i nervozuar Raskolnikovi.

- Po ja, motra juaj, Avdotia Romanovna, është duke u martuar me Lluzhinin, kështu apo jo?

- S'keni pse e zini ngoje këtë çështje. Habitem si guxokeni edhe ta përmendni emrin e saj, në qofshi vërtet Svidrigajllovi.

- Po unë ndaj dhe erdha, që të flas me ju për të, e si i bëhet ndryshe?

- Mirë, por shpejt ama!

- Besoj se për zotin Lluzhin, farefis me time shoqe, tanimë keni mendimin tuaj. Nuk bën për Avdotia Romanovnën ai njeri! Po e sakrifikon veten me shumë shpirtmadhësi për hir të familjes. Kam dëgjuar që jeni kundër. Tani që ju njoha personalisht, them që kështu duhet të jetë.

- Po flisni me naivitet të çuditshëm; të më falni, por kam të drejtë

të plotë që ta quaj poshtërsi këtë që jeni duke bërë.

- Pandehni që nisem nga leverdia vetjake, kur flas kështu? Të me falni, Rodion Romanoviç, por po të qe kështu, nuk do jua kisha thënë aq hapur mendimin tim; nuk jam aq budalla. Pak më parë ju fola për veten si viktimë e dashurisë për Avdotia Romanovnën. Ja ku po ua them se tani nuk ndiej më asnjë dashuri për të; dhe nuk kam si të mos habitem, më parë kam ndier...

- E kishit nga jeta e amullтë dhe boshe që bënit, - e ndërpreu vrulltas Raskolnikovi.

- Edhe kjo qëndron, por kryesore është që motra juaj ka aq po aq shumë virtyte, saqë nuk kishte si të mos bënte përshtypje. Por, të shkuara të harruara, tani i shoh ndryshe gjërat.

- Keni shumë kohë që po i shihni me këtë sy të ri?

- Pjesërisht edhe më parë, por u binda përfundmisht ditën e tretë të qëndrimit këtu në Petërburg.

- Bënit mirë të hidheshit menjëherë në shtjellimin e çështjes, për të cilën keni ardhur; jam me ngut, duhet të dalë...

- Me kënaqësi. Para së gjithash i rregullova fëmijët te tezja e tyre; ajo është e pasur, por edhe ata jo më pak. Se ç'baba jam unë! Mora me vete ato që më la në testament Marfa Petrovna. S'janë pak. Të më falni për këtë hyrje, tani për çështjen. Kam ndër mend të bisedoj paraprakisht me zotin Lluzhin, sepse, ndër të tjera, ai ishte dhe shkaktari i grindjes sime me Marfa Petrovnën, pasi mora vesh që kishte qenë ajo që e kishte gatuar lidhjen e Lluzhinit me motrën tuaj. Dua të takohem edhe me Avdotia Romanovnën, sigurisht, me ndihmën tuaj, dhe në praninë tuaj, për t'ia bërë të qartë që nuk ka për t'i ardhur asnjë e mirë nga lidhja martesore me zotin LLuzhin, përkundrazi. Pastaj, pasi t'i kem kërkuar ndjesë për gjithë sa ndodhi, do t'i ofroj dhjetë mijë rubla, për t'ia lehtësuar ndërprerjen e marrëdhënieve me zotin Lluzhin, për çka jam i bindur që edhe ajo vetë nuk ka për të qenë kundër.

- Qënkeni vërtet i çmendur! - thirri Raskolnikovi jo aq i zemëruar; sa i habitur. - Si guxoni të flisni kështu?

- E dija që do bërtisnit, por edhe pse nuk jam paralli, këto dhjetë mijë rubla i kam hequr mënjanë; po nuk i pranoi Avdotia Romanovna, do i bëj rrush e kumbulla.. Se unë ndërgjegjen e kam llagar, po e bëj

jo i nisur nga ndonjë përfitim vetjak. Për këtë shumë shpejt do të bindeni si ju, ashtu dhe Avdotia Romanovna. E bëj për shqetësimet dhe telashet jo të pakta që i kam nxjerrë motrës suaj të nderuar; jam penduar sinqerisht për gjithë çka ndodhi dhe dëshiroj nga zemra që të paguaj për to, duke bërë diçka të dobishme për të: askush s'më ka privilegjuar që të bëj vetëm të këqija! Po ta bëja nisur nga interesi vetjak, nuk do t'i ofroja dhjetë mijë, sepse vetëm para pesë javësh i ofrova më tepër. Kam plane që shumë shpejt të martohem me një vashë, pra çdo dyshim për përfitimin tim bie. Theksoj se edhe pas martesës me Lluzhinin Avdotia Romanovna nuk ka për të patur aq para, veç... Mos u zemëroni, Rodion Romanoviç, bëni mirë t'i peshoni esëll gjërat.

Tërë këtë Svidrigajllovi e parashtroi me qetësi dhe gjakftohtësi të jashtëzakonshme.

- Mjaft me këto, - i tha Raskolnikovi. - Gjëja më e pakët që mund t'ju them është që jeni duke kuturisur ca si shumë!

- Aspak. Se del që në këtë botë njeriu njeriut keq mund t'i bëka, por për t'i bërë mirë e me këtë ta shlyej të keqen, qënka e pamundur, nuk paska asnjë të drejtë. E pse? Për shkak të disa formaliteteve boshe! Çudi vërtet! Po sikur të kisha vdekur dhe t'ia lija me testament, a do t'i merrte?

- E pse të mos i merrte?

- Kurse kështu, jo! Se dhjetë mijë rubla s'i thonë shaka! Sidoqoftë, do t'ju lutesha ta vinit në dijeni Avdotia Romanovnën për ç'ju fola.

- Jo, unë nuk kam për t'ia thënë.

- Atëherë do ia them vetë kur ta takoj, s'kam si bëj ndryshe, do ta shqetësoj.

- Po sikur t'ia them unë, nuk do kërkoni ta takoni?

- Nuk di ç'përgjigje t'ju jap. Do ma kishte shumë qejfi ta shihja edhe një herë.

- As mos e shpresoni këtë.

- Më vjen keq. Flisni kështu ngaqë nuk më njihni. Ku i dihet, ndoshta bëhemi tanët...

- Mendoni se do ia dilni mbanë?

- E pse jo? - tha Svidrigajllovi dhe vuri buzën në gaz, pastaj u çua dhe mori kapelen. - Kur ju pashë sot në mëngjes, nuk erdha me shpresë se do arrija diçka, më habiti shumë kjo pamja juaj...

- E ku më paskeni parë? - e pyeti i merakosur Raskolnikovi.

- Fare rastësisht... Më duket se ju ka ndodhur diçka e ngjashme me atë që më ndodhi dhe mua... Veç mos u sëkëlldisni, nuk jam nga ata që u qepen të tjerëve dhe ua sjell inatin në majë të hundës! Se unë edhe me ata më batakçinjtë kam ditur të merrem vesh... edhe me Marfa Petrovnën rrojta jo pak, por shtatë vjet, edhe me zebelinën bashkë me Bergun kushedi do ngrihem në ajrì.

- Mirë. Më lejoni t'ju pyes: po udhëtimin kur paskeni ndër mend ta nisni?

- Ç'udhëtim?

- Po ju pak më parë thatë se po bëheni gati për udhëtime... në kuptimin e gjerë të fjalës...

- Udhëtime?... Ah, po! Fola për udhëtime... Ah! Sikur ta dinit ç'pyetje jeni duke më bërë?... - thirri befas dhe qeshi si tuhaf njeri.

- E ku i dihet, mundet ta këmbej me martesë atë udhëtim; më kanë gjetur nuse.

- Ku, këtu?

- Po!

- Kaq shpejt?

- Kurse Avdotia Romanovnën kam shumë dëshirë ta takoj. E them seriozisht... E po, mirupafshim! Ah! Për pak sa s'harrova. I thoni motrës që në testamentin e Marfa Petrovnës i janë caktuar tri mijë rubla. Kjo është më se e vërtetë... testamentin ajo e pat shkruar një javë para se të vdiste, në praninë time... Pas një a dy javësh Avdotia Romanovna mund t'i tërheq ato para.

- Vërtet thoni?

- Vërtet. Ia bëni të ditur. E po, nderime. Kam zënë një apartament jo larg që këtej.

Kur ishte duke dalë, Svidrigajllovi mend u përplas te dera me Razumihinin.

II

Po afronte ora tetë. Nxituan për të qenë te mamaja dhe motra para Lluzhinit.

- Kush ishte ai? - e pyeti Razumihini, kur dolën në rrugë.

- Svidrigajllovi, çifligari që ka fyer time motër, kur punonte guvernante tek ai. E dëbuan për shkak të tij. Pastaj e shoqja, Marfa Petrovna, i kërkoi ndjesë Dunjës. Vdiq papritur. Për të folëm. As vetë nuk e di arsyen, por i trembem shumë këtij njeriu. Erdhi pasi e varrosi të shoqen. Njeri i çuditshëm, m'u duk se ishte i vendosur diç të bënte... di diçka të rëndësishme... Nuk duhet lënë t'i afrohet Dunjës... kjo është kryesore, më dëgjon?

- As t'i afrohet? Po ç'mund t'i bëka kështu? Që ma besove edhe mua këtë, të faleminderit... Do bëjmë çmos... E ku banon ky tip?

- Nuk e di.

- Pse s'e pyete? Ta kishe pyetur... Po, nejse, e marrim vesh.

- E pe mirë? - e pyeti Raskolnikovi.

- E pashë, si nuk e pashë...

- Fytyrën ia fiksove? E njeh po ta shohësh përsëri? - nguli këmbë në të vetën Raskolnikovi.

- Po. Kam kujtesë të mirë për fytyra.

Përsëri heshtën.

- Hm.. E ç'nuk ndodh... - mërmëriti Raskolnikovi. - Ku i dihet, ndoshta m'u duk...

- Çfarë t'u duk? S'po të kuptoj ku do të dalësh? - e pyeti shoku.

- Po ja, që të gjithë ju më mbani për të çmendur, - tha dhe shtrembëroi buzët. - Pak më parë edhe unë shkoja me mendje që isha çmendur, edhe ky njeri nuk m'u duk njeri, por hije.

- Ç'thua kështu?

- Ndoshta dhe jam vërtet i çmendur, tërë këto ditë sesi kam qenë, por ndoshta vetëm më duket...

- Ah, Rodia, me ç'po shoh, të paskan ngacmuar përsëri! E ç'donte që erdhi ky njeri? Çfarë të paska thënë?

Raskolnikovi nuk i ktheu përgjigje. Razumihini eci i menduar.

- Dëgjo ç'bëra, - i tha. - Erdha te ti, por po flije. Hëngra drekë dhe që aty drejt e te Porfiri. Zametovin e gjeta përsëri tek ai. Desha të bisedoja, por sikur nuk më dilnin fjalët, nuk thosha dot atë që dëshiroja. Ndërsa ata shtireshin sikur nuk kuptonin gjë prej gjëje, ama që ta ndienin ligsht veten, nuk e ndienin. E hoqa mënjanë Porfirin, i fola, por ende sikur s'po i delte koka muhabetit. Nuk po na puqeshin

mendimet. Ia vura grushtin nën mjekër dhe e paralajmërova që do ia thyeja turinjtë, e bëra me shaka, si fis që jemi. As dhe një fjalë nuk nxori, vetëm më shihte dhe heshtte. Pështyva dhe dola. Ja, kjo qe e tëra. Me Zametovin as që u përshëndeta. Kur po zbrisja shkallët, më erdhi një mendim: e pse rropatemi kështu? Sikur të të varej mbi kokë ndonjë rrezik, hajde de, domosdo diç do bënim, do ishim të detyruar.. Po kështu kot! Ti je dorëjashtë, e përse u dashka t'i lëpihemi? Se s'do jetë e largët dita, kur do qeshim e do gajasemi me ato pandehma të tyre... Do mbeten me gisht në gojë dhe e kemi ne radhën pastaj... Mos e vrit fare mendjen.

- Mirë thua! - ia mbështeti mendimin Raskolnikvi. - "Po nesër ç'do më thuash?" - tha me vete. Deri më tani asnjëherë nuk e kishte vrarë mendjen si do ta priste Razumihini lajmin e vrasjes. E pa drejt në sy. Nuk kishte pse e vriste mendjen për këtë vizitë që Razumihini i kishte bërë Porfirit, nuk e interesonte.

Në koridor u gjendën ballë për ballë me Lluzhinin. Ora ishte plot tetë, ky po kërkonte me sy numrin e apartamentit. Nuk e përshëndetën. U mënjanua paksa dhe la të hynin të parët djelmoshat, për mirsjellje, parapëlqeu të hynte pas tyre, pasi qe vonuar pak në koridor. Pulheria Aleksandrovna shpejtoi t'u dilte përpara. Dunja u përshëndet me të vëllanë. Pjotër Petroviçi iu përul grave, por në fytyrë i lexohej një fyerje e dyfishuar. Pa përreth i hutuar, si të mos kuptonte ç'po ngjiste. Edhe Pulheria Aleksandrovna s'po ia shqiste sytë e turbulluar. I ftoi të zinin vend rreth tryezës, ku ishte duke zjerë samovari. Dunja dhe Lluzhini u ulën përkundruall njëri-tjetrit. Razumihini u ul pranë Lluzhinit, kurse Raskolnikovi pranë të motrës.

Heshtje. Pjotër Petroviçi me ca lëvizje të avashta nxori nga xhepi shaminë e batistë, që e mbushi dhomën me erë të mirë, dhe shfryu hundët me pamjen e bamirësit të fyer, por që ka vendosur të kërkojë shpjegime deri në një. Në koridor i pat feksur mendimi të largohej pa u përshëndetur, ta dinin me kë kishin të bënin, por ndërroi mendje. Nuk i kishte për zemër paqartësitë, duheshin vënë pikat mbi i: në ishte shkelur urdhëri që u kishte dhënë, domethënë kishte arsye, nuk ishte keq ta dinte; sa për ndëshkimin, atë e kishte ai vetë në dorë, priste puna.

- Mirë udhëtuat? - iu drejtua me ton zyrtar Pulheria Aleksandrovnës.

- Lavdi Zotit, s'kemi pse qahemi, Pjotër Petroviç.

- Gëzohem! Po ju, Avdotia Romanovna, nuk ju lodhi rruga?

- Unë jam e re, duroj, kurse mamaja u lodh pak, iu përgjegj Dunjeçka.

- E po, helbete, janë të gjata këto rrugët tona, është pa anë e fund kjo e ashtuquajtra "mëma Rusi"... Dje, megjithë dëshirën e madhe, nuk munda dot t'ju prisja, por them se çdo gjë do t'u ketë shkuar mirë.

- Ah, Pjotër Petroviç, u gjendëm si peshku pa ujë. Po të mos na e kishte dërguar i madhi Zot Dimitri Prokofiçin, nuk do të kishim ditur nga t'ia mbanim. Jua prezantoj, Dimitri Prokofiç Razumihini.

- Posi, kam patur nderin të njihem,... dje, - belbëzoi Pjotër Petroviçi, duke parë në drejtim të këtij armiqësisht, me bisht të syrit. Pastaj heshti i vrenjtur. Se Pjotër Petroviçi sillej i tapinosur në shoqëri, veçanërisht në mjediset ku kërkohej mirësjellje dhe respekt i veçantë, por kur ky mjedis mungonte, bëhej i ngjashëm me një thes me miell. Përsëri heshtën. Raskolnikovi shihte në një pikë. Avdotia Romanovna enkas nuk donte ta ndërpriste heshtjen. Razumihini nuk dinte çfarë duhej thënë, kështu që Pulheria Aleksandrovna lëvizi e shqetësuar në karrige.

- E morët vesh, Marfa Petrovna vdiq, - tha, duke hedhur në lojë kartën e sigurt.

- Si jo! Më njoftuan menjëherë dhe mund t'ju them që Arkadi Ivanoviç Svidrigajllovi, fill pas varrimit, u nis për në Petërburg. Lajmi është i saktë.

- Në Petërburg? Qënka këtu? - u alarmua Dunjeçka dhe këmbeu shikim me të ëmën.

- Si urdhëroni dhe, kuptohet jo pa qëllim, po të kihet parasysh ngutja e këtij udhëtimi dhe rrethanat që e paraprinë.

- O Zot! Pse as këtu nuk do e lënë të qetë Dunjeçkën? - thirri Pulheria Aleksandrovna.

- Them që nuk ka arsye për t'u alarmuar, sigurisht, në nuk do jeni ju ata që do të dëshirojnë të japin e të marrin me të. Jam duke e ndjekur çështjen, fare shpejt do ta marr vesh ku banon...

- Ah, Pjotër Petroviç, as që mund ta merrni dot me mendje sa shumë që më trembët! - vazhdoi Pulheria Aleksandrovna. - E kam

parë vetëm dy herë atë njeri; tmerr e vetëm tmerr më kall! Jam e sigurt që ai u bë shkaktar për vdekjen e parakohshme të Marfa Petrovnës.

- Këtë përfundim nuk e nxjerr dot pa e faktuar. Nuk them, ka të ngjarë që ky njeri të ketë përshpjetuar fundin e saj, duke e vënë në përdorim fyerjen si ndikim i fuqishëm moral, për këtë që tani mund të thuhet me bindje. Nuk e di në është apo jo i pasur, ç'trashëgim i ka lënë Marfa Petrovna; do ta marr vesh në një të ardhme të afërt, por kam bindjen që këtu në Petërburg, qoftë edhe me ndopak para në xhep, do t'i kthehet përsëri huqeve të vjetra. Se është i pacipë, i mbytur në vese, s'e ka shokun për prapësira. Kam argumente të patundshme të pohoj që, Marfa Petrovna, e cila pati fatkeqësinë të bjerë në dashuri dhe t'i lajë borxhet para tetë vjetësh, i ka bërë edhe një shërbim tjetër; me interesimin e saj të drejtpërdrejtë e të palodhur u mbyll atëherë edhe një proces për disa krime të përbindshme, e priste Siberia për to. I tillë është, në doni ta dini.

- Ruajna Zot! - thirri Pulheria Aleksandrovna. Raskolnikovi po e dëgjonte tejet i përqendruar.

- E vërtetë të jetë që lidhur me këtë keni të dhëna të sakta? - e pyeti rreptë dhe jo pa habi Dunja.

- Po përsëris atë që ma ka besuar në fshehtësi të plotë Marfa Petrovna. Dua të them që nga këndshikimi juridik çështja në fjalë është e errët. Ka banuar, por më duket se banon edhe tani këtu, njëfarë Reslih, një e huaj, fajdexheshë, person i punëve të dyshimta. Me të ai ka patur dikur lidhje intime, por edhe misterioze. Te kjo banonte një gjiri i saj e largët, një shurdhmemece katërmbëdhjetëvjeçare, të cilën Reslih e urrente për vdekje dhe i kujtonte edhe krodhën e bukës. Një ditë prej ditësh e gjetën të mbytur në çardak. U gjykua si vetëvrasje. Me këtë procesi u mbyll, por s'vonoi të dalin dëshmitarë për fyerje të padëgjuara që i ishin bërë vajzës nga... Svidrigajllovi. Veç ishte një dëshmi e turbullt, atë e bënte një tjetër gjermane, një e hurit dhe e litarit, të cilës nuk ishte e lehtë t'i zije besë. Padi e re nuk u ngrit edhe falë zellit dhe parave të Marfa Petrovnës; mbeti thjesht një thashethem. Por një thashetheme kuptimplote. Ju, Avdotia Romanovna, duhet të keni dëgjuar të flitet për rastin me Filipin. Ka vdekur pas torturave të tmerrshme gjashtë vjet të shkuar, në kohën e bujkrobërisë.

- Përkundrazi, kam dëgjuar që ky Filipi kishte mbytur veten, - tha Dunja.

- Ashtu është, por ama në atë derexhe e çuan përndjekjet dhe fyerjet e zotit Svidrigajllov.

- Këtë nuk e di, - iu përgjigj thatë Dunja. - Kam dëgjuar të flitet ja se çfarë. Filipi na paska qenë tip nevrasteniku, një si biçim filozofi shtëpie, njeri i kënduar. Paska vrarë veten, ngaqë e tallnin nga të katër anët, nuk kam dëgjuar të ketë vrarë veten nga torturat e Svidrigajllovit. Kur kam qenë atje, me njerëzit silleshin mirë. Svidrigajllovin e donin dhe e nderonin, ndonëse është e vërtetë edhe ajo që e fajësonin për vetëvrasjen e Filipit.

- Po vë re qe orvateni ta përligjni atë njeri, Avdotia Romanovna, - vuri në dukje Lluzhini dhe u shtrembërua në një buzagaz dykuptimësh.

- Se ai njeri vërtet që i ka të rrallë shokët për dredhi e lajka me gratë, dhe viktimë e tyre ra edhe Marfa Petrovna, por ama që kjo vdiq në një mënyrë tepër të çuditshme, kjo kështu është. I tregova këto për t'ju ndihur juve dhe mamasë suaj të orientoheni si duhet në situatat e reja, se, sigurisht, që do të ndërmerrën orvatje për afrim nga ana e tij. Sa për mua, nuk kam as dyshimin më të vogël që shpejt a vonë ky njeri do përfundojë në burgun e borxheve. Marfa Petrovna kurrë nuk ka dashur t'i caktonte ndonjë pasuri dhe, në i ka lënë në testament, do të jetë ajo më e domosdoshmja, diçka vetëm sa për të thënë, e atij njeriu dorëshpuar nuk ka për t'i arrirë as për një vit.

- Mirë tani, Pjotër Petroviç, mjaft me zotin Svidrigajllov, - ndërhyri Dunja. - Më ndjell pikëllim biseda për të.

- Ishte tek unë Svidrigajllovi, - s'duroi dot më pa thënë Raskolnikovi.

Britma habije u dëgjuan nga të katër anët; të gjithë ia ngulën sytë. Edhe Pjotër Petroviçi u trondit nga ky lajm.

- Një orë e gjysëm më parë, kur isha duke fjetur, erdhi tek unë e më zgjoi; më tha kush ishte, - tregoi Raskolnikovi. - Dukej në humor të mirë, mbahej i shpenguar, kishte besim të patundur që do merreshim vesh. Më tha që donte të të takonte, Dunja, m'u lut të jem ndërmjetës. Vjen me një propozim. Më tha që Marfa Petrovna një javë para se të vdiste të paska lënë në testament tre mijë rubla, do t'i marrësh këto ditë.

- Na paska kujtuar perëndia! - thirri Pulheria Aleksandrovna dhe

bëri kryqin. - Falu për të Dunja, lutju për të Zotit!

- E vërtetë është, - nuk duroi dot pa e pohuar edhe Lluzhini.

- Po tjetër ç'të tha? - e nguti Dunjeçka.

- Më tha që vetë ai nuk është pasunar, çifligu i mbetet fëmijëve, që rrojnë te tezja. Paska zënë apartament jo larg dhomës sime, po ku tamam, nuk ma tha. As unë nuk e pyeta...

- E ç'paska ndërmend t'i propozojë Dunjeçkës? - e pyeti e trembur Pulheria Aleksandrovna. - Ta tha?

- Po, ma tha.

- Çfarë?

- Jua them më vonë. - Raskolnikovi heshti dhe mori gotën e çajit.

Pjotër Petroviçi nxori dhe pa orën.

- Më duhet t'u kthehem punëve, edhe juve nuk kam pse ju pengoj të bisedoni, - shtoi i pezmatuar dhe disi i shtangur. U çua të dilte.

- Rrini dhe pak, Pjotër Petroviç, - i tha Dunja. - Se ju na shkruanit që do ta kaloni me ne këtë mbrëmje dhe dëshironit të shpjegoheshit për diçka me mamanë.

- Ashtu është Avdotia Romanovna, - iu përgjigj, duke i mëshuar çdo fjale Pjotër Petroviçi dhe u ul, por kapelen vazhdoi ta mbante ndër duar. - Vërtet që desha të bisedoja për diçka me ju dhe me mamanë tuaj shumë të nderuar për një çështje mjaft të rëndësishme. Por, ashtu si vëllai juaj nuk mund të flasë me ju për propozimet e zotit Svidrigajllov, ashtu dhe unë nuk dëshiroj dhe nuk mundem të flasë... në praninë e të tjerëve... për ca çështje aq të rëndësishme. Për më tepër që kërkesa ime kapitale, këmbëngulëse mbeti e paplotësuar...

Lluzhini i dha fytyrës një pamje të helmtë dhe heshti ashtu i ngrirë.

- Kërkesa për të mos qenë në këtë takim tonin im vëlla nuk u plotësua vetëm me këmbënguljen time, - i tha Dunja. - Ju shkruanit që im vëlla ju paska fyer, kjo lypset shpjeguar dhe pas kësaj ju duhet të pajtoheni. Në është Rodia ai që ju ka fyer, është ai që duhet t'u kërkojë falje.

Pjotër Petroviçi u spërdrodh, u shtrydh dhe u ndrydh në karrigen ku ishte ulur.

- Ka ca fyerje, Avdotia Romanovna, që, pavarësisht nga vullneti i mirë, nuk harrohen lehtë. Se çdo gjë ka një kufi, kapërcimi i tij nuk është pa rreziqe; e kapton një herë dhe është e pamundur të kthehesh pas.

- Nuk e pata aty fjalën, Pjotër Petroviç, - e ndërpreu disi e ngutur pa mundur të përmbahej, Dunja. - Duhet të kuptoni mirë një gjë: e ardhmja e marrëdhënieve tona varet shumë nga fakti në arrini të shpjegoheni dhe t'i sheshoni moskuptimet një orë e më përpara. Se ja ku po jua them troç: s'kam si e shoh ndryshe këtë çështje. Nëse ju jam sado pak e shtrenjtë, pavarësisht nga vështirësitë, kjo çështje duhet medoemos të sqarohet sonte. E përsëris: në është fajtor im vëlla, do ju kërkoj ndjesë.

- Më çudit kjo mënyrë shtruarje e problemit, Avdotia Romanovna, - e kundërshtoi i nervozuar Lluzhini. - Duke ju çmuar dhe adhuruar, fare mirë mund të mos e keni për zemër aferinë me ndonjërin nga të afërmit tuaj. Duke ju kërkuar dorën, nuk kam përse e ngarkoj veten me detyrime për të bindur edhe të tjerët...

- Mjaft me zemëratë, Pjotër Petroviç! - e ndërpreu me një nuancë padurimi në zë Dunja. - Jini ai i mençuri dhe fisniku që ju konsideroj dhe do të desha të jeni gjithmonë. Ju kam dhënë fjalën, jam e fejuara juaj; kini besim tek unë. Jam aq e zonja sa të gjykoj me drejtësi! Që po marr mbi vete rolin e gjykatësit, le të jetë kjo një befasi e këndshme për ju, ashtu dhe për tim vëlla. Kur i thashë se duhet të ishte patjetër i pranishëm në këtë takim, nuk ia bëra të ditura pikësynimet që kisha. Në rast se ju nuk arrini të pajtoheni, e kuptoni edhe vetë, do më duhet të zgjedh: o ju, o ai. Nuk kam aspak dëshirë të gaboj në këtë zgjedhjen time! Po ju zgjodha ju, do më duhet t'i laj duart nga vëllai, po zgjodha vëllanë, do më duhet t'u lë lamtumirën juve. Kam nevojë t'ia qartësoj mirë vetes çështjen: a më është vëlla me të vërtetë, kurse juve a u jam vërtet e shtrenjtë, jeni apo nuk jeni bashëshorti im?

- Avdotia Romanovna, - shqiptoi me një fizionomi fare të shprishur Lluzhini. - Fjalët e thëna në adresën time janë tepër po tepër kuptimplote, madje do të thosha edhe fyese për vendin që më takon në marrëdhëniet me ju. S'po zë ngoje pastaj kundërvënien e çuditshme, fyese: o unë, o ai. Me ç'shoh, jeni duke ia lejuar vetes mundësinë e tërheqjes së fjalës së dhënë. Ju thoni: "O ai, o unë!". Me këtë më bëni të ditur sa pak vlekam për ju... Nuk kam si e lejoj një shtruarje të tillë të problemit që ka të bëjë me marrëdhëniet tona... me detyrimet tona të ndërsjellta.

- Si kështu? - mori flakë Dunja. - Jam duke e vënë interesin tuaj

përbri gjithçkaje që është për mua më e shtrenjtë në botë, që është jeta ime, dhe juve kjo ju fyeka? Thoni se po ju çmokam pak?

Raskolnikovi qeshi heshturazi, qeshi helmtë; Razumihinin s'po e mbante vendi, por Pjotër Petroviçi nuk e kundërshtoi atë që tha, veç sa vinte e bëhej më nervoz, por edhe më i kurdisur, i kishte qejf debatet, gjatë tyre e ndiente veten si s'ka më mirë.

- Dashuria për bashkudhëtarin e ardhshëm të jetës duhet të jetë më e fortë se dashuria për vëllanë, - i tha me tonin e mësimdhënësit. - S'kam si pajtohem me barazinë. Ndonëse jam shprehur ca prerë në atë letër, kur shkruaja që në praninë e vëllait tuaj nuk dëshiroj dhe nuk mund të them gjithë sa kam bërë mendje t'ju parashtroj, prapë se prapë them t'i drejtohem mamasë suaj të më shpjegojë një çështje me vlerë kapitale. Djali juaj, - iu drejtua sakaq Pulheria Aleksandrovnës, - dje, në praninë edhe të zotit Rasudkin (të më falni, ju kështu sikur e keni emrin, - iu përkul me mirësjellje Razumihinit), më fyeu, kur e shtrembëroi në një mënyrë krejt të pafalshme mendimin e shprehur nga unë se martesa me një vashë të varfër, qe e njeh hidhërimin dhe skamjen, është më me leverdi në kuptimin bashkëshortor se me një tjetër që ka notuar në mirëqënie e kënaqësi, sepse një e tillë bashkëshorte është më kokulur, më e dëgjueshme. Djali juaj me paramendim e zmadhoi domethënien e këtyre fjalëve dhe më akuzoi për synime keqdashëse. E bëri, me sa kuptova, i bazuar në letër-këmbimin që keni patur. Do të ndihesha i lumtur, Pulheria Aleksandrovna, nëse do të më bindnit për të kundërtën e kësaj, do të qetësohesha pa masë. Na e thoni, si jeni shprehur në atë letër?

- Nuk më kujtohen shprehjet, - tha e hutuar Pulheria Aleksandrovna. - Kam shkruar ashtu si e kam kuptuar. Ç'ju ka thënë Rodia, nuk e di... ndoshta edhe janë zmadhuar pak...

- Po pa nxitjen tuaj ai s'kishte pse e zmadhonte.

- Pjotër Petroviç! - iu drejtua me një dinjitet të shfaqur Pulheria Aleksandrovna. - Vetë qënia jonë këtu flet më së miri për atë që ne nuk i kemi marrë për të keq fjalët tuaja.

- Mirë e thatë, moj mama! - e miratoi Dunja.

- Del që edhe këtu unë e paskam fajin? - tha me zë të fyeri Lluzhini.

- Se ju, Pjotër Petroviç, për çdo gjë bëni me faj Rodionin, ndërsa në atë letrën e djeshme nuk thoshit as të vërtetën, - iu përvesh, duke

marrë zemër Pulheria Aleksandrovna

- Nuk më kujtohet të kem thënë ndonjë të pavërtetë.

- Shkruanit, - i tha me ton të prerë Raskolinikovi pa e parë në sy, - që ia dhashë paratë jo vejushës së përmortshme, por të bijës (që as e dija kush ishte) dhe e bëtë për të më vënë në sherr me të mitë. Prandaj dhe ishit shprehur me fjalët më të pahijshme për atë vajzë, që ju as e njihni. Kësaj s'ke si ia vë emrin ndryshe përveç se thashetheme dhe poshtërsi.

- Më falni zotëri, - iu drejtua duke u dridhur Lluzhini. - Kam shkruar aq sa m'u kërkua nga motra dhe mamaja tuaj: si e gjeta dhe ç'përshtypje pata nga takimi me ju. Në atë letër s'ka as dhe një rrenë, ju vërtet që i keni harxhuar paratë për atë familje, që, s'do mend, është fatkeqe, por që ka në gjirin e vet edhe persona, të cilët nuk meritojnë vëmendje.

- Kurse për mendimin tim, me marifetet tuaja ju as te gishti i këmbës s'i afroheni asaj vajze fatkeqe, kundër së cilës i vërvisni ata gurë.

- Pra, paskeni vendosur ta futni në shoqërinë e mamasë dhe të motrës suaj?

- E bëmë sot këtë, në dëshironi ta dini: e ula atë vajzë pranë mamasë dhe motrës.

- Rodia! - thirri Pulheria Aleksandrovna.

Dunjeçka u bë kuq në fytyrë; Razumihini u vrenjt; Lluzhini e peshoi me një shikim domethënës që nga koka deri te këmbët, shtrëmbëroi fytyrën në një buzagaz shpotitës dhe tallës.

- Po kësaj ç'i thonë, Avdotia Romanovna? - tha. - Si mund të kapërdihet një poshtërim si ky? Besoj se u sqaruan si s'ka më mirë çështjet.. Po largohem për të mos ua prishur gëzimin e takimit të shumëpritur me vëllanë dhe për t'i dhënë mundësi zhvillimit të mëtejshëm të bisedave sekrete (u çua dhe mori kapelen). Veç, para se të largohem, marr guximin t'ju them se kështu e tutje shpresoj të jem i mënjanuar nga ca takime si ky dhe të mos vihem para detyrash që kërkojnë kompromis. Kurse juve, e shumënderuara Pulheria Aleksandrovna, jua theksoj veçanërisht këtë kërkesë, sepse letra ime ju qe adresuar vetëm juve e askujt tjetër.

Pulheria Aleksandrovnën e fyen këto fjalë.

- Ç'është kjo kështu me ju, Pjotër Petroviç, sikur po na vini nën

urdhëra! Dunja ua bëri të qartë arsyen përse porosia juaj nuk u çua në vend, e bëri e nisur nga e mira. Kurse fjalët e letrës s'paskan qenë dëshirë, ato paskan qenë urdhër për ne. Ç'është kështu, mos vallë çdo dëshirë, e çfarëdo lloji qoftë, u dashka plotësuar si urdhër? Për mendimin tim, ju duhet të mateni mirë para se të thoni apo të bëni diçka lidhur me ne, duhet të jeni i kujdesshëm dhe mëshirëplotë, sepse ne braktisëm gjithçka dhe me besën tuaj erdhëm këtu, pra tanimë jemi thuajse nën pushtetin tuaj.

- Nuk bëni mirë që flisni kështu, Pulheria Aleksandrovna, sidomos tani kur ua bënë të ditur testamentin e Marfa Petrovnës për ato tremijë rublat. Me ç'po shoh, paskan qëlluar në çastin e duhur ato para, duket kjo nga toni me të cilin jeni duke folur, - i tha me inat e mllef.

- Kjo që thatë të bën vërtet të mendosh që të gjitha shpresat në marrëdhëniet me ne i paskeni varur në pafuqinë tonë! - i tha me zë që i dridhej nga inati Dunja.

- Tani, sidoqoftë, nuk mundem më t'i ushqej ato shpresa dhe nuk dëshiroj të bëhem pengesë për propozimet sekrete të Arkadi Ivanoviç Svidrigajllovit, i cili e paska ngarkuar vëllanë tuaj t'ua bëj të ditura, dhe që, me ç'po shoh, paskan për ju rëndësi kapitale, por dhe ju dhënkan kënaqësi.

- O Zot! - thirri Pulheria Aleksandrovna.

Razumihinin nuk po e mbante vendi.

- E pe si ta skuqi faqen, moj motër? - e pyeti Raskolnikovi.

- Po, Rodia! - pranoi Dunja. - Pjotër Petroviç, bëni mirë të na lini vetëm! - iu drejtua e verdhë dyllë në fytyrë nga zemërimi.

Dukej që Pjotër Petroviçi nuk ishte aspak i përgatitur për një fund të tillë. Kishte patur besim të patundur në pushtetin e padiskutueshëm që duhej të kishte mbi to; nuk i besohej që po ndahej kësisoj. U zbeh, buzët iu drodhën.

- Avdotia Romanovna, në dal nga kjo derë pas këtyre fjalëve, dijeni që s'kthehem më. Mendohuni mirë për pasojat! Kjo që ju thashë është fjala e fundit!

- Si, guxoni të më kërcënoni? - i bërtiti Dunja dhe brofi e inatosur.

- As që dua t'jua shoh bojën!...

- Si? Si thatë? - ulëriti Lluzhini, të cilit ende nuk po i besohej që gjithçka tanimë kishte marrë fund. Dukej që e kishte humbur fare

pusullën. - Kështu, domethënë? Ama është e drejta ime që të protestoj!

- Me ç'të drejtë i flisni sime bije në këtë gjuhë?! - iu bë krahë se bijës Pulheria Aleksandrovna. - E ç'protestë na qënka kjo? Ku e gjetkeni këtë të drejtë? Nuk kam për të pranuar kurrën e kurrës që ime bijë të martohet me një të tillë! Jashtë! S'duam t'ju shohim më bojën! Vetë e kemi fajin që u futëm në qorrsokak, faji më i madh bie mbi mua!...

- Por, Pulheria Aleksandrovna, - foli i çakërryer nga tërbimi Lluzhini, - mos harroni që më keni dhënë fjalën... dhe nga ai shkak qesh i detyruar të bëja edhe shpenzime...

Ky pretendim i fundit i shkonte aq shumë përshtat natyrës së Pjotër Petroviçit, saqë Raskolnikovi mehit në fytyrë nga indinjata dhe sforcimi torturues, për të mos i dhënë liri shpërthimit të saj, nuk duroi dot më dhe... qeshi me të madhe. Ndërkaq Pulheria Aleksandrovna iu vërsul e zemëruar.

- Shpenzime? E për ç'shpenzime e paskeni fjalën? Mos keni parasysh ato që paguat për transportin e sëndukut? Po sëndukun shoqëruesi i trenit e mori pa para! Pse ne ju paskemi shpenzuar? O Zot i madh! Ju deshët të na i lidhnit duart e këmbët, Pjotër Petroviç, e jo ne ju!

- Mjaft me këto mama! - iu lut Avdotia Romanovna. - Pjotër Petroviç, kini mirësinë të largoheni!

- Do iki, por kam edhe një fjalë për të thënë, të fundit, - nëpërdhëmbi pa mundur ta përmbante më veten. - Mamaja juaj më duket se harroi që pranova të martohem me ju pas tërë asaj gurguleje që kishte marrë dhenë dhe që e përbaltte mos më keq emrin tuaj. Duke e ngrënë me bukë turpin, duke e bërë faqen blozë sy botës, kam të drejtë të plotë të kërkoj shpagim, të paktën të falënderohem për gjithë sa bëra... Por paskam qenë i verbuar, vetëm tani m'u hapën sytë; po e shoh që paskam gabuar rëndë, kur shpërfilla asisoj opinionin e përgjithshëm...

- Po ky na qënka gjarpër me dy koka! - thirri Razumihini që kishte brofur nga karrigia i gatshëm për të vënë në vend nderin e cënuar të vashës.

- Qënkeni i poshtër dhe njeri i lig! - i tha Dunja.

- As edhe një fjalë më tepër! As edhe një kërcënim! - thirri Raskol-

nikovi, duke i dalë përpara Razumihinit; pastaj iu kthye Lluzhinit dhe ia përplasi mu në fytyrë:

- Zhdukuni që këtej, sa më shpejt më mirë! - ia tha me zë të ulët, por shkoqur dhe të vendosur. - As dhe një fjalë tjetër, ndryshe...

Pjotër Petroviçi e pa disa çaste me sy që i lëshonin xixa nga inati e tërbimi, me fytyrën e verdhë dyllë e të shtrembëruar nga zemërimi, pastaj u kthye e doli, duke mbartur me vete një urrejtje për vdekje, një ligësi që s'kishte anë e fund, kundër këtyre njerëzve, e veçanërisht kundër këtij Raskolnikovit. Atë dhe vetëm atë fajësonte për gjithë çka ndodhi. Nuk ka si të mos çuditesh që, duke zbritur shkallët, thoshte me vete, se, sido që të ishte, nuk është se e kishte humbur gjithçka, shkonte me shpresë t'i rregullonte punët përmes grave.

III

E pra, deri në çastet e fundit nuk besonte se ngjarjet do të rrokulliseshin kështu. Në mendje e zmadhonte sa mundej e si mundej ecurinë e tyre, por nuk mund ta besonte që dy varfanjake, pa asnjë mbrojtje, të çliroheshin aq kollaj nga pushteti i tij. Këtë bindje ia shumëfishonte mendjemadhësia dhe vetëbesimi, që në këtë rast do të ishte më e drejtë të quheshin vetëdashuri e verbër. I dalë nga hiçi, Pjotër Petroviçi ia kishte ushqyer sa më s'bëhet vetes fodullëkun dhe sqimën, mendjen e vet e çmonte jashtë mase, mbahej për tepër i aftë dhe, kur ishte vetëm, e ledhatonte sa i deshte qejfi vetes sedrën para pasqyrës, veten e pandehte për bukurosh. Veç, mbi gjithçka dhe çdo gjë vinte paratë e vëna me punë, por edhe me gjithfarësoj marifetesh: ishin këto që e barazonin me tërë ata që qëndronin mbi të.

Kur ndërmendi si ia kishte qokur Dunjës se kishte pranuar ta merrte pavarësisht nga nami i keq, Pjotër Petroviçi e qetësoi veten, duke e quajtur se e kishte bërë me vetëdije të plotë e me sinqeritet, ishte indinjuar që këto gra e treguan veten aq bukëshkala! E pra, kishte qenë fare e bindur sa të kota dhe absurde kishin qenë ato thashetheme, aq më tepër që vetë Marfa Petrovna i kishte përgënjeshtruar. Edhe tani ishte gati ta pranonte që e dinte sa të padrejta ishin, por e dinte mirë edhe vendimin e marrë për ta lartësuar Dunjën

në nivelin e vetes, lartësim të cilin mund ta bënte vetëm ai dhe këtë e quante heroizëm. Kur i pati vajtur për vizitë Raskolnikovit, zemra i gufonte nga ndjenja e bamirësisë, mezi priste që ta lajkatonin dhe ta mbulonin me komplimente. S'do mend që, duke zbritur shkallët, veten e ndiente thellësisht e padrejtësisht të fyer, madje të nëpërkëmbur.

Ndërsa Dunja i nevojitej; nuk kishte si hiqte dorë prej saj. Vite me radhë kishte ëndërruar për një martesë solide, por e kishte shtyrë nga dita në ditë, donte të grumbullonte sa më shumë para. Në thellësi të shpirtit kishte ëndërruar të martohej me një vashë të ndershme, por të varfër (domosdo të varfër), shumë të re, shumë të mirkë, fisnike dhe me shkollë, natyrë e përulur, madje e trëmbur, që ka parë jo pak fatkeqësi e mjerim në jetë, që do të qëndronte para tij si pulë, sepse do ta mbante për ëngjëllin shpëtimtar, do t'i përgjërohej e nënshtrohej në çdo gjë, do ta shihte e dëgjonte kurdoherë me gojën e hapur nga habia. Sa e sa skena e episode këndellëse kishte krijuar me imagjinatën e begatë, kur prehej në shtrat pas punëve! Dhe ëndrra e sa e sa viteve, më në fund, qe bërë realitet; bukuria, mendja dhe horizonti i Avdotia Romanovnës e kishin lënë pa mend; gjendja e mjerimit të saj të skajmë e kishte bërë me krahë. I kishte ecur edhe ngaqë kjo kishte qëlluar tepër krenare, vajzë me karakter, njeri zemërmirë, e edukuar dhe më shumë se ai vetë e zhvilluar. (E ndjeu që në takimet e para). Kjo krijesë do t'i nënshtrohej përjetë, do t'i qe falënderuese për heroizmin e bërë; ndërkohë që ai do të hiqej sundimtar mëshirëplotë në marrëdhëniet me të... Kishte ndodhur kështu, që pak para kësaj, pasi e kishte peshuar dhe matur mirë çdo gjë, kishte vendosur, më në fund, të ndërronte profil, të përfshihej në veprimtari të gjerë, e cila do t'i jepte dorë të ngjiste më lart shkallët e shoqërisë. Edhe kjo kishte qenë ëndërr tepër ngacmuese dhe e kahershme. Me një fjalë, kishte vendosur t'i maste forcat me Petërburgun! E dinte që nga gratë nxirreshin sa e sa përfitime: hiret e kësaj bukurosheje fisnike dhe të shkolluar s'do mend që do ta zbukuronin edhe atë, do tërhiqnin vëmendjen dhe do t'i siguronin brerorën e dëshiruar.. Por ja që u shëmb e u gremis gjithçka. I dukej sikur kishte rënë rrufeja dhe i kishte fshirë të gjitha! Pastaj, me atë mënyrën e vet ai atë e dashuronte! E dashuronte duke e parë veten në fronin e sundimtarit... Jo! Jo! Duhej venë në vend çdo gjë, duhej marrë në dorë situata dhe duhej shëruar;

kryesorja, i duhej treguar vendi atij kapadaiu, atij fyçke, shkaktarit të katastrofës. Solli në mendje Razumihinin, ndjeu një sëmbim në zemër atë çast, por ai shqetësim iu fashit sakaq. "E ku mund të barabitet me mua ai njeri!" - tha me vete. Kurse Svidrigajllovit ia kishte frikën... Telashe, telashe dhe jo të vogla e prisnin!...

- Unë, unë e kam fajin! - tha Dunja, duke e pushtuar në krahët e saj të ëmën dhe duke e puthur.- Ma prishën mendjen paratë që na ofroi, veç, të betohem, vëlla, kurrë nuk më ka shkuar në mendje që mund të ishte aq i padenjë ky njeri! Po ta kisha vënë re, nuk do ta kisha pranuar propozimin. Mos më bëj me faj!...

- Na shpëtoi Zoti, thuaj! I madhi Zot na shpëtoi! - mërmëriti Pulheria Aleksandrovna, por ishte ende e hutuar, s'po ia sqaronte dot vetes ç'kishte ndodhur.

Të gjithë ndiheshin të gëzuar, pas pesë minutash zunë të qeshnin. Vetëm Dunjeçka vazhdonte të ishte e zbehtë dhe herë pas here vrenjtte vetullat. Pulheria Aleksandrovnës as në mëndje nuk i kishte shkuar se mund ta gëzonte një ngjarje si kjo, përkundrazi, e quante për fatkeqësi. Ndërsa Razumuhini nuk dinte si ta shprehte entuziazmin; ende nuk guxonte ta nxirrte jashtë tërë dufin, por dridhej nga emocionet. I dukej sikur kishte shkarkuar një barrë të rëndë nga supet. Ja, iu dha mundësia për t'iu përkushtuar jetën, për t'iu shërbyer pa ngurrimin më të vogël. Të tjerave ku i dihej? Ca mendime kuturisëse që i vinin në mendje, i largonte i trembur, ia kishte frikën imagjinatës frelëshuar. Vetëm Raskolnikovi rrinte si më parë, tepër i zymtë dhe si i hutuar. Kishte qenë ai që më tepër se kushdo kishte ngulur këmbë në largimin e Lluzhinit, kurse tani më pak se kushdo tjetër po merrte pjesë në diskutime. Dunja pandehu mos ende ia ruante mërinë, kurse Pulheria Aleksandrovna e shihte me zemër të ngrirë.

- Po Svidrigajllovi ç'të tha? - e pyeti Dunja.

- E? Po! Po! Ç'të tha? - e pyeti edhe Pulheria Aleksandrovna.

Raskolnikovi ngriti kryet.

- Do me çdo kusht të të dhurojë dhjetë mijë rubla. Do edhe të takojë në praninë time.

- Ta takojë? Kurrën e kurrës! - thirri Pulheria Aleksandrovna. - E si guxoka t'i japë para?

Raskolnikovi u tregoi fare thatë bisedën që pati me Svidrigajllovin, duke u lënë mënjanë vetëm atë pjesë të saj që lidhej me hijen e Marfa Petrovnës; ndiente një neveri për çdo lloj bisede, përjashto ato për çështje të domosdoshme.

- Ti si iu përgjigje kërkesës së tij? - e pyeti Dunja.

- Në fillim i thashë se nuk kisha ndër mend të vija në dijeni; m'u përgjigj që atëherë vetë ai, si të mundej, do bënte çmos të të takonte. Më tha që nuk ndiente si më parë për ty, pasioni i dikurshëm i qënka shuar... Nuk do që të martohesh me Lluzhinin... Por, në përgjithësi, nuk para qe i shtruar në bisedë.

- Ti çfarë shpjegimi i jep tërë kësaj, Rodia? Si t'u duk ai ty?

- Të them të drejtën, nuk shoh në këtë asgjë të mirë. Të ofron dhjetë mijë dhe sakaq shton që nuk qënka paralli; thotë se i është mbushur mendja të shkojë diku dhe pas dhjetë minutash harron ç'kishte thënë. Më foli edhe për punë martese, i paskan gjetur nuse... Më duket që s'i ka të pastra synimet, por vetëm pohon që s'është marrosur deri në atë shkallë, sa të dojë ty të keqen. Kuptohet, paratë që të ka caktuar, nuk ia pranova. M'u duk çudan njeri... Shfaqi dhe simptoma çmendurie. Ndoshta gabohem, por më duket se ndiqte një plan të paramenduar dhe do të na qorrollepsë. Vdekja e Marfa Petrovnës, me ç'm'u duk, i paska lënë mbresa të thella...

- Iu prehtë shpirti në parajsë të ndjerës! - ndërhyri Pulheria Aleksandrovna. - Sa të jem gjallë, do t'i falem e do t'i lutem Zotit për të! Se ç'do bënim ne këtu, moj Dunja, pa ato para? Na i dërgoi dhuratë perëndia! Rodia, e di, sot në mëngjes vetëm tre rubla të krimbura na kishin mbetur, shpresat tek ora i kishim, thamë ta linim gjëkundi peng, vetëm që të mos i lypnim atij, të prisnim sa të na thoshte vetë.

Dunjën e habiti shumë ky propozim. Nuk po dinte çfarë shpjegimi t'i jepte.

- Bluan e ç'nuk bluan në kokë ai njeri! - nëpërdhëmbi me pështërimë dhe mornica i kaluan në trup. Raskolnikovit nuk i shpëtoi pa e vënë re këtë tmerr të vërtetë që e kishte pushtuar të motrën.

- Kështu qënka e shkruar, që do m'u dashka ta takoj dhe jo një herë atë njeri, - tha kjo mendueshëm.

- Do ta ndjek pas! - thirri i vendosur Razumihini. - S'do ta lë të më shpëtojë asgjë që bën. Rodia, besoj, nuk është kundër. Pak më parë

tha: "Kujdes motrën!". Po ju si, dakord jeni, Avdotia Romanovna?

Dunja vuri buzën në gaz dhe i zgjati dorën, por meraku nuk iu shqit nga fytyra. Pulheria Aleksandrovna e pa e përgjëruar; ato tremijë rublat nuk kishin qenë gjë e vogël, e bënin të ndihej e sigurtë.

Një çerek ore më pas po bisedonin sikur të mos kishte ndodhur gjë. Raskolnikovi nuk mori pjesë në biseden e tyre, por nuk la t'i shpëtonte as edhe një fjalë e thënë. Razumihini shpërtheu me një gojëtari të tillë, që më mirë prishej.

- E pse duhet të ikni? - u tha me një ndjenjë vetbesimi. - Ç'jetë është ajo që ju pret në provincë? Këtu jeni të gjithë bashkë, i duheni njëri-tjetrit, dëgjojeni fjalën time! Qoftë edhe për një kohë... Kurse mua, ju lutem, të më pranoni si mikun e shtëpisë; do sajojmë ndonjë gjë, keni për ta parë... Ja si i mendoj punët: kam një xhaxha (do ju njoh me të, është njeri i përkorë dhe tepër i nderuar), ky ka hequr mënjanë nja njëmijë rubla, vetë rron me pension, nuk shkon keq. Është viti i dytë që më lutet t'i vë në punë ato para, atij t'i jap gjashtë për qind. E bën se do të më ndihmojë. Vjet nuk ia mora, kurse këtë vit mezi që e kam pritur ardhjen e tij, kam vendosur t'ia marrë. Vini dhe ju një mijë nga paratë tuaja dhe do bëjmë goxha punë.

Dhe Razumihini shpalosi para tyre një alamet projekti për tregtimin e kulturuar dhe me leverdi të librave. Kishte kohë që ëndërronte për këtë se edhe gjuhë dinte, edhe përvoja e botuesit nuk i mungonte, kishte punuar për të tjerët. I kishte folur edhe Raskolnikovit për këtë.

- Pse ta lëmë të na shpëtojë nga dora rasti? - pyeti, duke i parë me sy të përshkënditur dëgjuesit. - Ajo, s'do mend, që lypset punë, por ne nuk do t'i kursejmë forcat... Të bëjmë botime fitimprurëse, kryesore është të dimë të zgjedhim. Puna do na mësojë. Kam dy vjet që punoj për të tjerët dhe diç kam mësuar nga ky zanat. Qysh tani ua kam vënë syrin nja tre librave; për botimin e tyre do të na duhen rreth njëqind rubla, kurse fitimi do t'i kalojë të pesëqindtat. Telashet e botimit i marr unë përsipër. Ta nisim një herë, pa puna vetë do na mësojë; nga e vogla do shkojmë tek e madhja. Sido që të jetë, sa për të rrojtur mirë do kemi.

Dunjës i vetëtinin sytë.

- Kjo që po thoni, më pëlqeu shumë, Dimitri Prokofiç, - i tha.

- Sa për mua, unë nga këto që thoni nuk marr vesh, - u përzie në

muhabet Pulheria Aleksandrovna. - Por, ndoshta del për hajër! Janë punë të Zotit! Mirë thoni, që duhet të qëndrojmë këtu, qoftë edhe njëfarë kohe...

Tha kështu dhe pa nga Rodia.

- Po ti, vëlla, ç'mendon për këtë? - e pyeti Dunja.

- Them që i ka vajtur mirë mendja, - iu përgjigj ky. - Për gjëra të mëdha është shpejt të ëndërrojmë, por pesë a gjashtë libra mund t'i botojmë, duke qenë të bindur që do shiten mirë. Edhe unë di një libër që mund të jetë me interes. Që Razumihini di t'u japë këmbë punëve, për këtë nuk kam as dyshimin më të vogël, është i shkathët... Këtu jemi, shohim e bëjmë.

- Urra!... - s'e përmbajti dot entuziazmin Razumihini. - Ju rrini këtu, kthehem shpejt. Në këtë godinë është një apartament me hyrje më vete, është edhe i mobiluar dhe me qira të arsyeshme. Ta zëmë hëpërhë. Orën që nesër e çoj unë te një fajdexhi dhe ua sjell paratë. Kryesorja është të jemi të gjithë bashkë dhe Rodia të rrojë me ju... Për ku kështu, Rodia?

- Pse po ikën, mor bir? - e pyeti e tronditur Pulheria Aleksandrovna.

- Tani që jemi duke i vënë në vijë punët!... - tha i habitur Razumihini.

Dunja i hodhi një shikim të habitur dhe e ndoqi me mosbesim çdo lëvizje të tij. Raskolnikovi vërtiste ndër duar kapelen dhe po bëhej gati të dilte.

- E ç'më shihni sikur jeni duke më përcjellë për në rrugën e fundit dhe po më jepni lamtumirën? - u tha me zë të ulët, të çuditshëm.

Provoi të vinte buzën në gaz, por nuk i doli.

- Ku i dihet, ndoshta, dhe për herë të fundit shihemi, - i shpëtoi pa dashur.

Mendimi i kishte lindur atij vetë, por as vetë s'e kuptoi si e shprehu me zë të lartë.

- Po ç'ke kështu, mor bir? - tha e merakosur e ëma.

- Ku po shkon, Rodia? - e pyeti me një zë të çuditshëm Dunja.

- Më duhet të dalë, - iu përgjigj ky turbull; dukej i pasigurt në atë që donte të thoshte, ndërkohë që në fytyrën bojë limoni i qe fiksuar një vendim i prerë.

- Desha t'ju them... e mendova kur po vija këtu... desha t'ju them ty mama... dhe ty Dunja... se për një kohë e mira e të mirave është që

ne të mos shihemi. Nuk jam mirë me shëndet, s'ndihem i qetë... Do vij vetë t'ju takoj, kur të më bëhet e mundur... Ju dua shumë, nuk do ju harroj.. Vetëm më lini ca kohë vetëm... kështu duhet. Kam kohë që e kam menduar këtë... Çdo gjë që të më ndodhë, qoftë edhe e keqja më e madhe, dua të jem vetëm... më mirë do ishte të më harronit fare!.. Mos pyesni njeri për mua... Po të duhet, vij vetë u takoj... ose ju dërgoj haber. Kushedi edhe ringjallja më pret... Kurse tani për tani do bënit mirë të hiqnit dorë nga dashuria për mua! Ndryshe do ju urrej për vdekje!... Këtë ju them... Lamtumirë!

- O Zot! Po kjo ç'është! - thirri e lebetitur Pulheria Aleksandrovna.

Nënë e bijë nuk dinin ç'të bënin, ishin të tmerruara, edhe Razumihini po ashtu.

- Rodia! Rodia! Pajtohu me ne, do jemi si më parë! - klithi si e prishur mendsh e gjora nënë.

Raskolnikovi u kthye për nga dera dhe doli ngadalë. Dunja e ndoqi pas.

- Vëlla, ç'po i punon kështu mamasë? - foli me pështpërimë që s'kishte si të mos bënte të rrëqetheshe dhe e zhbiroi ngultas tepër e indinjuar nga kjo sjellje e tij.

Ky e pa me një dhimbje të papërshkrueshme drejt në sy.

- Po unë do vij, do vij! - belbëzoi me gjysmë zëri, aspak i vetëdijshëm për atë që po thoshte dhe doli.

- Je egoist ti, je i pashpirt dhe i keq! - i thirri nga pas Dunja.

- I çme-ndu-r është, jo i pashpirt! Ka lojtur! Si nuk e kuptokeni këtë? Ju po tregoheni e pashpirt pas gjithë kësaj që po shihni! - i tha me pështpërimë të shpejtë në vesh Razumihini Dunjës dhe ia shtrëngoi fort dorën.

- Tani vij! - tha duke iu drejtuar Pulheria Aleksandrovnës dhe doli me vrap.

Raskolnikovi po e priste në fund të koridorit.

- E dija që do vije me vrap, - i tha. - Kthehu dhe rri me to... Shkoju edhe nesër... gjithmonë shkoju. Edhe unë, ndoshta, mund të vij... Po pata mundësi, do vij. Lamtumirë!

Iku pa i dhënë dorën.

- Po ku po shkon? Ç'bën kështu? Ç'ke kështu? Po pse sjellje i thua kësaj ti?... - belbëzoi Razumihini mendjeprishur.

Raskolnikovi ndaloi përsëri.

- Qoftë hera e fundit! Mos më pyet më për asgjë! Nuk kam çfarë përgjigje të të jap... As tek unë mos eja. Do vij këtu, ndoshta. Kurse për to kujdesu!... Më kuptove?

Qëndronin nën llambën e korridorit; u panë heshturazi; Razumihinit i mbeti përgjithmonë në kujtesë ai shikim... Ishte një shikim sysh të ndezur, xixëllues, përshkënditës, ai shikim depërtoi thellë në shpirtin e shokut, Razumihini u rrëqeth. Një si hije e çuditshme u var ndërmjet tyre, ishte një ogur i keq, diçka e tmerrshme, aq shumë e kuptueshme nga të dy... Razumihinit i ra çehreja e vdekjes.

- E kuptove tani?... - i tha Raskolnikovi dhe shtrembëroi si në ngërç fytyrën. - Kthehu tani dhe kujdesu për to, - i tha dhe u largua.

Nuk po ndalem të përshkruaj ç'ndodhi atë mbrëmje në apartamentin e Pulheria Alksandrovnës, kur Razumihini u kthye te gratë; si u mundua t'i qetësonte, si u përpoq t'i bindte që Rodia kishte nevojë të pushonte pas sëmundjes, se iu betua që do të vinte, madje çdo ditë; se Raskolnikovi vetëm i kishte nervat e prishura, nuk duhej ngacmuar e rënduar; u dha fjalën, që, ai, Razumihini, do përkujdesej për të, do t'i çonte një konsultë mjekësore... Që nga ajo mbrëmje Razumihini u bë për to djalë dhe vëlla.

IV

Raskolnikovi mori rrugën e kanalit që të shpinte në dhomën e Sonjës. Ishte një godinë trekatëshe, e vjetër, e gjelbër. Iu drejtua një rojeje për adresën, por mori përgjigje të papërcaktuar. Hyrja ishte në një qoshe të errët, ngjiti shkallët dhe qëndroi në errësirë për të vendosur ku duhej të trokiste, kur befas e kapi dikush nga krahu.

- Kush jeni? - e pyeti një zë i trembur gruaje.

- Te ju po vija, - iu përgjegj Raskolnikovi dhe hyri në korridorin e ngushtë, të ndriçuar nga një qiri.

- Qënkeni ju! Sa shumë u trëmba! - i tha me zë të shuar Sonja.

- Kjo këtu është dhoma juaj?

Duke mos e parë në fytyrë, Raskolnikovi hyri në dhomë. Pas pak iu afrua Sonja me një qiri në dorë, dukej e hutuar, por edhe disi e

trembur nga kjo ardhje e tij aq e beftë në këtë orë. Të zbehtit e fytyrës ia la vendin një të kuqi të ndezur, sytë iu mbushën me lot. Ndjente edhe neveri, edhe turp, por njëherit edhe kënaqësi. Raskolnikovi i ktheu krahët dhe u ul në karrigen pranë tryezës. Ndërkohë mundi t'i hidhte një sy dhomës. Ishte e madhe, por tavanin e kishte të ulët, në faqen e majtë të murit ishte një derë e mbyllur që të çonte te Kapernaumovët; përkundruall, në murin e djathtë, ishte një derë tjetër që nuk përdorej, ajo të çonte në një apartament tjetër. Dhoma ku banonte Sonja ishte e ndërmjetme dhe kishte formën e një katërkëndëshi të parregullt, të gjymtë. Faqja e murit me tri dritare, që dilnin në kanal, e përshkonte tërthor dhomën, duke formuar një qoshe me murin tjetër, i cili vinte nga thellësia; edhe qoshja tjetër ishte e çrregullt, e shëmtuar. Në këtë dhomë nuk kishte kurrfare mobiljesh; krevati ishte në qoshe, pranë tij, më afër derës, ishte një komo. Pranë derës, që të çonte në apartamentin e të zotëve të shtëpisë, ishte një tryezë e mbuluar me sofrabrez, pranë tryezës kishte karrige. Asgjë tjetër. Letra e mureve ishte e zverdhur nga vitet, vende-vende ishe e grisur, ndërsa në një qoshe ishte fare e nxirë nga lagështia.

Sonja e shihte heshturazi mysafirin, që me aq kureshtje dhe vëmendje po kqyrte çdo gjë, i sëmboi në zemër, i shkuan të dridhura: po i dukej vetja si para gjykatësit që ka në dorë fatin e tjetrit.

- Erdha pak vonë... Duhet të ketë shkuar nja njëmbëdhjetë, - i tha pa i ngritur sytë.

- Kaq është, - belbëzoi Sonja, - Po, po! - shtoi nxitimthi si të kapej pas kësaj tape shpëtimi. - Sapo ra njëmbëdhjetë herë ora e të zotëve të shtëpisë... E dëgjova mirë.

- Jam te ju për herë të fundit, - mërmëriti Raskolnikovi si reja e zezë në fytyrë, - edhe pse është hera e parë që vij. Ndoshta s'kemi për t'ju parë më...

- Do shkoni gjëkund?

- Nuk e di... Nesër do ta marr vesh...

- Po te Katerina Ivanovna nuk do vini? - e pyeti vajza me zë të dridhur.

- Nuk e di. Nesër në mëngjes... sqarohet çdo gjë. Po nuk është këtu puna, dua t'u them diçka...

Ngriti sytë e përvuajtur që shihnin përhumbur dhe u kujtua që

vetë ishte ulur, kurse ajo qëndronte në këmbë para tij.

- Po uluni, - i tha me një zë tjetërsoj: të butë, ledhatues, thuajse të dhimsur. E pa i përmalluar.

- Sa e dobët që jeni! Sa dorë të vockël që keni! Ju duken damarët. Gishtat i keni të hollë, si te të vdekurit.

Ia mori dorën. Sonja vuri paksa buzën në gaz.

- Unë kështu kam qenë gjithmonë, - i tha.

- Edhe kur rronit në shtëpi?

- Po.

- S'do mend ajo! - shqiptoi prerë: edhe shprehja e fytyrës, edhe tingëllimi i zërit përsëri ndërruan. Pa edhe njëherë rreth e rrotull.

- Këtë dhomë e keni zënë me qira?

- Po...

- Kurse të zotët e shtëpisë banojnë atje? - tregoi në drejtim të derës.

- Edhe ata një dhomë si kjo kanë?

- Po, vetëm një dhomë kanë.

- Të isha unë do kisha frikë të flija vetëm në këtë dhomë, - i tha i murrëtyer.

- Të zotët e shtëpisë janë njerëz të mirë, më duan, - i tha Sonja që ende nuk e kishte marrë si duhet veten. - Edhe mobiljet, dhe çdo gjë.. e tyre është. Janë njerëz të mirë, edhe fëmijët e tyre vijnë shpesh këtu tek unë...

- Mos është ai belbacaku?

- Po... I mbahet pak goja dhe çalon. E shoqja po ashtu... Sesi i thotë fjalët... Po është shpirtmirë. Kanë shtatë fëmijë... Belbacak është vetëm i madhi, të tjerët jo... vetëm se janë të sëmurë... Po ju nga i njihkeni? - shtoi e habitur.

- Më ka folur babai juaj për ta. Edhe për ju më ka folur... shumë... Edhe për rastin që dolët në orën gjashtë dhe u kthyet në nëntë më ka folur, më ka treguar edhe për Katerina Ivanovnën që qëndronte në gjunjë para krevatit tuaj...

Sonja u turbullua keq.

- Sot më doli përpara, - belbëzoi e pasigurt.

- Kush?

- Babai. Isha duke ecur në rrugë, ishte ora dhjetë, ndërsa ai ecte

para meje. Ai ishte... Desha të shkoja t'i tregoja Katerina Ivanovnës.

- Po shëtisnit?

- Po, - tha me zë të mekur Sonja dhe uli kokën e turpëruar.

- Katerina Ivanovna nuk ju ka trajtuar aq mirë...

- Jo. Pse? Ç'ne? Kush ju ka thënë? - foli e frikësuar Sonja dhe e pa drejt e në sy.

- Domethënë që e doni?

- Atë? Si jo! - iu përgjigj dhe vuri duart në kraharor njërën mbi tjetrën duke e parë e pikëlluar. - Ah!... Sikur ta dinit... Si fëmijë është... kurdoherë me mendje të prishur e sheh... nga vuajtjet. Po sa e mençur ka qenë... sa zemërmirë... sa e dashur! Ju atë nuk e njihni... ah!

Këto fjalë i tha tejet e dëshpëruar, i tha në makth, duke u dridhur e lebetitur, duke thyer duart. Faqet e zbehta përsëri u skuqën, sytë i shprehnin vuajtje pa fund. Duket që e kishin cytur aty ku s'mbante; ndiente një dëshirë të papërmbajtur për t'u shprehur, për ta zbrazur marazin mundues. Një *bashkëvuajtje e paanë*, në mund të shpreheshim kështu, i qe vulosur në çdo tipar të fytyrës.

- Kurrë s'më ka rrahur! Kush ju paska thënë? Zot i madh! Më paska rrahur!... Po edhe në më ka rrahur, çë pastaj? Ju e dini si është puna? Është aq po aq fatkeqe... nuk tregohet dot me fjalë!.. Pastaj është dhe e sëmurë. I pëlqen drejtësia në çdo gjë, as me mend s'mund ta merrni sa e pastër është. Beson si askush te drejtësia, kudo e në çdo gjë e kërkon. Asaj çdo gjë mund t'i bësh, edhe shpirtin mund t'ia marrësh, por kurrë s'e detyron dot të bëjë diçka të padrejtë... Si fëmijë është... S'gjen në botë njeri më të drejtë se ajo!...

- Po ju si keni bërë mendje të jetoni?

Sonja e pa si ta priste prej tij përgjigjen.

- Tani vetëm juve ju kanë. Edhe më parë shpresat te ju i mbanin, se i ndieri për të kthyer ndonjë gotë juve jua zgjaste dorën. Ju si mendoni?

- S'di ç'të them, - iu përgjegj e pikëlluar Sonja.

- Aty ku janë do rrinë?

- Nuk e di. Po s'kanë ku venë. Sot dëgjova pronaren t'u thoshte të dilnin dhe Katerina Ivanovna iu përgjegj qe s'kishte për të qëndruar më as edhe një minutë.

- E pse paska marrë flakë ashtu? Ç'i duhen trimëritë? Mos i mban te ti shpresat?

- Ah, mos flisni kështu!... Ne s'kemi të ndarë, rrojmë bashkë, - tha përsëri dhe trupin ia përshkuan të dridhura nervozizmi, ngjante me kanarinën e trëmbur nga një ngacmim bezdisës. - E ku bën dot gjë vetëm ajo? Hë, si thoni, a bën dot vetëm? - e pyeti e nervozuar. - Ta shihnit sa shumë që ka qarë sot! Nuk është hiç mirë nga nervat. Ju si thoni? Herë e sheh tepër të merakosur për varrimin, për drekën e përmortshme, bëhet copë që të jetë çdo gjë si duhet; herë e pushton makthi, thyen gishtat nga dëshpërimi, kollitet gjak, qan, zë e përplas kokën pas murit. Duket që s'është në vete. Pastaj qetësohet dhe të tëra shpresat i mban te ju, ju quan ëngjëllin shpëtimtar; thotë se do t'i bëjë hall ca para dhe do të niset për në qytetin e lindjes, bashkë me mua, do ngrejë një pension për vajza dhe mua do më caktojë kujdestare, thotë se për ne do nisë kështu një jetë e re, e bukur. Më përqafon, më puth, më thotë fjalë të mira dhe tërë këtë e beson me gjithë mend! Hë? Si? A të bën zemra ta qortosh pas kësaj? Tërë ditën e ditës lau, pastroi, rregulloi plaçkat dhe govatën e lau për merak dhe pas kësaj u palos në shtrat si i vdekur. Sot në mëngjes ne të dyja ku nuk shkuam për t'i blerë këpucë vajzave me paratë e mbetura, se janë zbathur, por paratë nuk na arritën; zgjodhi një palë këpucë shumë të bukura, se shije ajo ka; u shkreh në vaj mu në dyqan, kur e pa që nuk na dolën paratë... të këputej shpirti kur e shihje.

- E qartë... Kjo është arsyeja që pranuat të bëni këtë jetë! - vuri në dukje me hidhërim të madh Raskolnikovi.

- Po pse juve nuk u dhimbset? Hë, nuk u dhimbset? - thirri e ndërkryer Sonja. - Se unë e di, paratë e fundit që kishit i dhatë!... Po nuk i dini të gjitha. Javën që shkoi e kam bërë një herë të qajë. E pashpirtë jam treguar! Dhe s'është hera e parë... Kur e kujtoj, mu në zemër më pikon.

Sonja s'po gjente vend të futej nga dëshpërimi i madh që i ndollën kujtimet.

- Ju qënkeni treguar e pashpirtë?

- Unë, ja unë! Kthehem në shtëpi dhe i ndieri më thotë: "Më lexo, Sonja, se po më hapet koka nga dhimbja, ja libri". Ia kishte marrë Lebezjatnikovit, banon këtu pranë; mban ca libra që shkule së qeshuri. Kurse unë i them: "Më duhet të dalë". Nuk desha t'i lexoj. Vajta tek ata për t'i treguar jakat Katerina Ivanovnës; m'i kishte dhënë për t'i

qepur Lizaveta, një shitëse; ishin jaka të mira, të reja, me azhur. Katerina Ivanovnës i pëlqyen shumë, e vuri njërën në qafë dhe u pa në pasqyrë. "Ma fal këtë, Sonja, të lutem!" - më thotë. Mirë ta merrte, por me ç'rast do ta vishte? Donte vetëm të kujtonte të kaluarën. U drodh e u spërdrodh para pasqyrës, por që nuk i duhej ajo jakë, kjo dihej, se as fustan për të qenë nuk kishte, sa vite u bënë që nuk ble asgjë të re. Kurrë nuk i lutet kujt për diçka, s'e lë sedra. Ty ta jep edhe gjënë e fundit, për të kërkuar s'të kërkon. Kurse kësaj here ia pati shumë ënda atë jakë! Ndërsa unë i kthehem dhe i them: "E ç'e doni, Katerina Ivanovna?". Nuk arrita ta mbaroj fjalën, më pa si asnjëherë më parë, dukej që u lëndua keq në sedër. Më pa në një të tillë mënyrë, që më këputi shpirtin. Nuk i erdhi keq që i kundërshtova jakën, i erdhi keq që nuk u tregova e gatshme t'i bëja qejfin! E kuptova mirë këtë. Ah! Me çfarë kënaqësie do t'ia ktheja tani atë jakë; me çfarë kënaqësie do t'i tërhiqja ato të shkreta fjalë!... Ah! Po fluturoi zogu, s'e kap dot! Po ndoshta kjo juve as që ju duhet!

- Pse e paskeni njohur Lizavetën?

- Po... Pse edhe ju e paskeni njohur? - jo pa habi e pyeti Sonja.

- Katerina Ivanovna është shumë e sëmurë, s'duhet ta ketë të gjatë, - e ndërroi temën e bisedës Raskolnikovi, duke e lënë pa përgjigje pyetjen.

- Oh! Jo! Jo dhe jo! - tha Sonja dhe ashtu vetiu ia kapi të dyja duart, si duke ju lutur që një gjë e tillë të mos ndodhte.

- Do të ishte më mirë të vdiste.

- Jo, jo. Nuk do ishte mirë! Përkundrazi! - tha dhe e pa e trëmbur dhe e lebetitur.

- Po fëmijët ku do venë, përveç se te ju?

- Këtë nuk e di! - thirri Sonja tej mase e dëshpëruar dhe rrëmbeu kokën me të dyja duart. Dukej që një mendim i tillë e kishte tmerruar jo një herë, kurse Raskolnikovi vetëm sa ia rrëmoi plagën.

- Po sikur të ndodhë kështu: ju sëmureni dhe shtroheni në spital. Atëhere si i bëhet? - këmbënguli pa më të voglën mëshirë.

- Ç'thoni kështu? Kjo s'është e mundur! - tha e trëmbur Sonja dhe fytura iu shpërfytyrua nga një ngërç i lemerishëm.

- E pse nuk qënka e mundur? - vazhdoi Raskolnikovi me një buzagaz të hidhtë. - E ku i dihet njeriut? Atëherë ku do futen fëmijët?

Do dalin në rrugë të madhe, ajo do kollitet gjak, do lypë, do ta përplasë edhe më fort kokën pas murit, ndërsa fëmijët do lebetiten. Kjo do bjerë pa ndjenja, do ta shtrojnë në spital, aty do vdesë, kurse fëmijët...

- Oh, jo! Këtë i plotmëshirshmi Zot nuk ka për ta lejuar! - i doli si gulçimë nga kraharori Sonjës. E shihte me përgjërimë e lutje, me krahët e kryqëzuar si të ishte ai që e kishte në dorë çdo gjë.

Raskolnikovi u çua dhe eci nëpër dhomë. Kaloi një minutë. Sonja qëndronte me kokën varur dhe me krahët lëshuar poshtë; tërë qënia e saj shprehte një pikëllim që s'kishte fund.

- Po ndopak para për ditën e zezë nuk keni hequr mënjanë? - e pyeti pasi ndali para saj.

- Jo, - mërmëriti Sonja.

- E qartë që jo. Po ke provuar të heqësh? - shtoi dhe vuri buzën në gaz.

- Kam provuar.

- Dhe nuk ke mundur! E qartë! As që duhej pyetur për këtë.

Përsëri eci nëpër dhomë. Kaloi kështu edhe një minutë tjetër.

- Nuk arrin dot të sigurosh të ardhura çdo ditë!

Sonja e ndjeu veten të mbuluar nga turpi, fytyra i mori bojën e vishnjës.

- Jo, - mërmëriti me një sforcim mundues.

- Edhe Poleçka, me sa duket, kështu ka për të bërë! - i tha befas.

- Jo, jo! S'ka përse! Jo! - nëpërdhëmbi e dëshpëruar dhe e tronditur, si ta kishin plagosur me thikë. - Zoti nuk ka për ta lejuar një tmerr të tillë!...

- Për të tjerët e ka lejuar ama!

- Jo, jo! Do ta mëshirojë i madhi Zot! - përsëriti fare e fandaksur.

- Po kush e di, ndoshta edhe Zot nuk ka! - ia ktheu me një si keqdashje dhe ngazëllim ligësie Raskolnikovi, qeshi dhe e pa drejt në sy.

Fytyra e Sonjës u transformua në çast, iu drodhën muskujt e fytyrës si në ngërç. E pa qortueshëm, diç deshi t'i thoshte, por nuk iu hap goja dhe u shkreh në dënesa të hidhura, duke e mbuluar fytyrën me duar.

- Thatë që Katerina Ivanovna nuk qënka në vete; po edhe ju nuk jeni më mirë, - i tha pas një heshtjeje të shkurtër.

Kaluan nja pesë minuta. Raskolnikovi vazhdonte ecejaket nëpër dhomë, nuk i fliste dhe as nuk shihte në drejtim të saj. Më në fund, iu afrua, me sy të përshkënditur që shprehnin dhimsuri i mori duart, pastaj e përqafoi dhe e pa drejt në fytyrën e përlotur. E shikoi pa i shprehur ndjenjë, me sy të skuqur, depërtues, buzët i dridheshin nga nervozizmi. Befas u përkul, ra në gjunjë para saj dhe i puthi këmbën. Sonja u largua e lebetitur, si para ndonjë të çmenduri. Dhe vërtet, tërë qënia e tij për këtë fliste.

- Ç'bëni? Ç'bëni kështu? Po unë!... - belbëzonte Sonja e verdhë dyllë; zemra mend po i kërcente jashtë kraharorit, mezi po mbushej me frymë.

Raskolnikovi u çua sakaq.

- Të përulem jo ty, por vuajtjes njerëzore, - shqiptoi si i prishur mendsh dhe u largua për te dritarja. - Dëgjo këtu! - shtoi kur u kthye pas një minute. - Pak më parë i thashë njërit që më fyeu se nuk të vinte ty as te gishti i këmbës... I thashë se time motre i bëra nder, kur e ula sot pranë teje.

- Ah! E pse ia thatë! Dhe në prani të saj? - e pyeti e tronditur Sonja, - Të rrike me mua qenka nder?! Po unë jam... e përdalë, jam gjynahqare e madhe, shumë e madhe! Ah! Pse e thatë?

- Nuk pata parasysh as të përdalën e as gjynahqaren, por vuajtjen e pashëmbullt tënden! Por që je gjynahqare e madhe, kjo kështu është, - shtoi me zë ngjadhnjyesi. - Dhe ja ku po ta them: je e tillë, sepse kot së koti e ke vrarë veten, ua ke dorëzuar të tjerëve. Pse a nuk është gjynah kjo që ke bërë? Si të mos të shkojnë mornica kur e sheh se në ç'pisllëk rron, sa shumë që e urren jetën që je duke bërë, ndërkohë që je e bindur se askënd nuk shpëton me këtë që bën! A s'më thua, - iu kthye i çakërryer, - si bashkëjetokan brenda teje ky turp e kjo poshtërsi me ndjenjat e shenjta që fsheh në gji? Se më e drejtë, njëqind herë më e drejtë do të kishte qenë të hidheshe në ujë dhe t'i jepje fund një herë e mirë gjithçkaje!

- Po me ata ç'do të bëhej? - e pyeti me zë të mekur Sonja, duke e parë e përvuajtur, por pa shprehur as habinë më të vogël për ato që dëgjoi. Raskolnikovi e pa i habitur.

E kishte lexuar gjithçka në atë shikim të saj. Pra, edhe asaj i paska gëluar në mendje një mendim i tillë. Ndoshta jo një herë i ka vajtur

mendja në çaste dëshpërimi të pangushëllueshëm dhe aq seriozisht i ka peshuar gjërat, saqë tani nuk u habit fare nga fjalët e tij. Ajo madje as thelbin e egër e të pashpirt të atyre fjalëve nuk e vuri re (kuptimin e atij qortimi dhe të veçantën e atij shikimi ajo, sigurisht, që nuk e kishte vënë re). Këtë Raskolnikovi e kuptoi menjëherë. Veç e mori me mendje ç'dhimbje të padurueshme i ka shkaktuar dhe i shkakton gjendja e turpshme dhe poshtëruese në të cilën ndodhet. "Po ç'qënka vallë ajo forcë që e paska penguar dhe e pengon t'i jap fund një herë e përgjithmonë kësaj gjendjeje?" - e pyeti veten. Vetëm tani e kuptoi sa shumë e lëndonte gjendja mjerane e vocërrakëve dhe dëshpërimi i jashtëzakonshëm i Katerina Ivanovnës që arrinte deri në çmenduri dhe e përplaste për llahtar kokën pas murit. Ndërkaq iu bë e qartë edhe kjo tjetra: edukata që kjo ka marrë dhe zhvillimi i saj i gjithanshëm s'kishte si pajtohej përgjithmonë me këtë gjendje. Veç e mundonte edhe pyetja: përse vallë ishte pajtuar deri më sot? Si nuk ishte çmendur, nëse për t'u mbytur kishte qenë e pafuqishme? Rasti i saj ishte vërtet i veçantë, por ajo që i ndodhi mund ta çonte në greminë që në hapat e para. Ç'forcë paska qenë ajo që e bëri këtë vajzë të mbijetonte? Mos ishte zvetënim ky i saj? Me sa dukej, turpi e digjte, por vetëm në sipërfaqe, kurse zvetënimi me tamam nuk i kishte depërtuar në zemër: këtë e shihte fare mirë, ajo nuk i fshihej...

"E presin këto tri rrugë, - tha me vete. - O të hidhet në kanal, o ta rrasin në çmendinë... o të zvetënohet megjithësej, t'i plaste cipa dhe t'i ngurtësohej zemra". Kjo e fundit iu duk më e pështira, por kishte natyrë skeptiku, ishte i ri në moshë, pra ishte i pamëshirshëm, ndaj dhe nuk kishte pse të mos e besonte që kjo rrugë e tretë të ishte më e mundshmja.

"A thua të ndodhë vërtet kështu? - vazhdoi të arsyetonte me vete. - A thua që një qënie e brishtë dhe e pafajshme një ditë prej ditësh të llapashitet mosmëkeq në gropën e gjirizit? A thua të ketë nisur zhytja dhe deri më sot vazhdon qëndresa vetëm e vetëm ngaqë rruga e nisur i duket tejet e pështirë? Jo s'ka si të jetë kështu! - e kundërshtoi veten. - Nga kanali e ka larguar mendimi i gjynahut për ata... Që nuk është çmendur ende.. E kush tha që nuk është çmendur? Pse në rregull është ajo? Pse a flet ashtu një njeri normal? Si mundet tjetri të qëndrojë pezull mbi atë gropë dhe të mbyllë sytë e të zërë veshët, kur dikush i

flet për rrezikun? Mos pret të ndodhë ndonjë çudi? Kjo e fundit duhet të jetë. Pse a nuk flasin për çmenduri të gjitha këto?".

Ky mendim i fundit i qe ngulitur keq në kokë. Ishte versioni që po i pëlqente më shumë nga të tjerët. Zuri ta shohë me këtë sy çdo veprim dhe arsyetim të saj.

- Domethënë i fale shumë Zotit, Sonja? - e pyeti.

Ajo heshti. Raskolnikovi ndali pranë saj në pritje të përgjigjes.

- E ç'do të isha unë pa Zotin? - pëshpëriti e nemitur, e pa shkarazi me sy të përshkënditur dhe ia shtrëngoi fort dorën.

"I paskam rënë në të!" - tha me vete Raskolnikovi.

- Po Zoti si ta shpërbleu zellin? - e cyti dhe qëndroi në pritje të arsyetimit të saj.

Sonja nuk iu përgjigj menjëherë, dukej disi e vështirësuar nga kjo pyetje. Kraharori i gufonte nga vrundulli i emocioneve.

- Mos më pyet për këtë! Nuk jeni i denjë që të dëgjoni përgjigjen!...

"Po, po! Qënka e vërtetë!" - tha me vete i siguruar në dyshimin që bluante përbrenda.

- I plotfuqishmi ma shpërblen! - pëshpëriti dhe uli sytë.

"Këtu dhe qënka fillimi i çmendurisë, ja shpjegimi i gjithçkaje!" - i tha vetes, pa ia ndarë sytë ndërkohë që kërshëria sa vinte i rritej.

E pa me keqardhje dhe dhimsuri të madhe atë fytyrë të zbehtë, të paktë, me tipare të parregullta, me sy të kaltër, të ëmbël, që hera herës përshkënditeshin nga një zjarr i pashuar ndjenjash, i pa atë trup imcak që i dridhej nga tronditja e zemërimi dhe gjithë më tepër po çuditej, s'po u zinte besë syve. "Është e gjymtuar! E gjymtuar për lemeri!" - tha me vete.

Mbi komo i zuri syri një libër. E kishte parë edhe kur ecejakte nëpër dhomë, po s'ia kishte tërhequr vëmendjen; tani zgjati dorën dhe e mori. Ishte "Dhiata e Re" e përkthyer rusisht. Ishte një libër i vjetër, tepër i përdorur, me kopertinë lëkure.

- Po këtë kush ta ka dhënë? - e pyeti; Sonja ndodhej nja tre hapa larg.

- Një e njohur.

- Kush?

- Lizaveta. E luta të ma sillte dhe ma solli.

"Çudi! Lizaveta!" - mendoi. Çdo gjë në këtë dhomë po e çudiste

me të veçantën e saj. E afroi librin te qiriri dhe zuri ta shfletonte.

- Po vendin ku flitet për Shën Llazarin e di? - e pyeti befas.

Sonja nuk i ngriti sytë nga dyshemeja dhe nuk iu përgjigj.

- Për ngjalljen e Shën Llazarit ku flitet? Ma gjej pak.

Sonja e pa me bisht të syrit.

- Ja aty... në ungjillin e katërt, - i tha me zë të prerë, pa iu afruar.

- Gjeje pak dhe ma lexo, - i tha dhe u ul në karrige, mbështeti bërrylat në tryezë, vuri kokën mes duarve dhe pa mënjanë i përqendruar në pritje të asaj që do dëgjonte.

Sonja iu afrua me hap të sigurt tryezës, s'i mbetej tjetër veç ta plotësonte këtë dëshirë të çuditshme të Raskolnikovit.

- Pse nuk e paskeni lexuar ndonjëherë? - e pyeti, duke qëndruar në anën tjetër të tryezës dhe duke e parë që poshtë vetullave. Zëri sa vinte e i bëhej më i fortë.

- E kam lexuar, por kohë më parë, kur isha në shkollë. Lexoje!

- Po në kishë nuk e paskeni dëgjuar?

- Nuk shkoj në kishë... Pse ti shkon?

- Jo-o-o! - belbëzoi Sonja.

- E kuptoj... As babanë nuk do vesh ta varrosësh? - i tha Raskolnikovi dhe u skërmit.

- Do vete. Edhe javën e shkuar isha... fala një përshpirtje.

- Për kë?

- Për Lizavetën. E vranë me sëpatë.

Nervat po i ngriheshin, po i hardalloseshin, po i merreshin mendtë.

- Paske patur miqësi me Lizavetën?

- Po... Ka qenë grua e drejtë... Vinte.. nganjëherë... fshehurazi... lexonim... dhe bisedonim. I vaftë shpirti në parajsë...

Seç kishin një tingëllimë të çuditshme këto fjalë; përsëri një tjetër zbulim: takime misterioze me Lizavetën, të gjymta të dyja.

"Edhe në mos qofsh, bëhesh i gjymtë këtu!" - tha me vete.

- Lexo! - i tha me zë të prerë prej të nervozuari.

Sonja ende nuk po e vendoste. I rrihte si çekan zemra. As vetë s'po e kuptonte përse nuk po i bëhej ta lexonte atë vend të ungjillit. Raskolnikovi e shihte dhe zemra i pikonte gjak për këtë "të çmendur fatkeqe".

- E ç'ju duhet ky lexim? Ju nuk besoni! - mërmëriti fare ultas, si

duke iu marrë fryma nga tallazet e emocioneve.

- Lexo! Kështu dua! - ngulmoi. - Se ti Lizavetës i ke lexuar.

Sonja shfletoi librin dhe gjeti vendin. I dridheshin duart, s'i arrinte zëri. Dy herë provoi të lexonte por nuk mundi të shqiptonte fjalët.

"Lëngonte prej kohësh Llazari nga Vithania..." - shqiptoi më në fund e sforcuar, por zëri iu pre siç pritet kur këputet teli i kitarës.

Deri në një farë mase Raskolnikovi e kuptonte përse Sonja nuk donte t'i lexonte pjesë nga ungjilli dhe, sa më i plotë bëhej kuptimi, aq më tepër i ngriheshin nervat dhe ngulte këmbë në të tijën. E dinte që për atë vajzë ky lexim ishte i vështirë, i duhej të shpaloste para tij atë që i ziente përbrenda. E dinte që ato ndjenja ndoshta dhe ishin fshehtësia më e madhe, të cilën vajza e ruante me fanatizëm, prej kohësh që nuk mbaheshim mend. Veç e kuptoi që, sado e mundimshme që ishte kjo për të, ia kishte fort ënda t'ia lexonte, patjetër atij e askujt tjetër, pikërisht atij, "pavarësisht nga ç'mund të ndodhë më vonë!..." Dëshirën ia lexoi në sytë, e pikasi në tronditjen që e kishte pushtuar dhe dukej që nuk po e përballonte dot. Më në fund, Sonja e mposhti tronditjen, e largoi spazmën, që ia bllokonte zërin, dhe vazhdoi leximin e kreut të njëmbëdhjetë të ungjillit sipas Joanit.

"U mblodhën judenjtë te Martha dhe Maria që t'i rënkonin për vëllanë. Martha, kur dëgjoi qe po vinte Jezusi, i doli përpara; Maria e priti në shtëpi. Dhe i tha Martha Jezusit: "O Zot! Po të ishit ndodhur këtu, nuk do më kishte vdekur vëllai. E di që ç't'i kërkosh perëndisë, ta plotëson!".

Ndali ngaqë e ndjeu se iu mblodh në grykë një komb, zëri po i dridhej dhe mend i këputej... E pa e turpëruar.

"Jezusi i thotë: "Do ngjallet yt vëlla". Martha i tha: "E di që do ngjallet ditën e ringjalljes, ditën e fundit". Jezusi i tha: "Jam unë ringjallja dhe jeta; kush më beson, edhe në vdektë, do ngjallet rishtaz. Kush rron dhe beson, nuk ka për të vdekur përgjithmonë. E beson këtë?" Dhe ajo i thotë:

(Duke u mbushur me frymë me zor, si pas një dhimbjeje, Sonja shkoqur dhe duke u mëshuar fjalëve, lexoi si të kishte qenë ajo vetë predikatore).

"Po, o Zot... E besoj që ti je Krishti, i biri i perëndisë, i dëguari i tij në tokë".

Deshi të ndalte përsëri, donte të ngrinte sytë që ta shihte, por e dhunoi veten, vazhdoi leximin. Raskolnikovi rrinte dhe e dëgjonte si i ngrirë, pa hedhur sytë në drejtim të saj, me bërryla mbështetur në tryezë.

"Maria, që erdhi aty ku ishte Jezusi, i ra në gjunjë dhe i tha: "O Zot! Po të ishe ti këtu, nuk do të kishte vdekur im vëlla". Jezusi, kur e pa të përlotur atë dhe judenjtë, që kishin ardhur t'i ngushëllonin motrat, u pikëllua dhe s'duroi dot. Dhe tha: "Ku e keni varrosur?". I thanë: "O Zot! Shko e shihe!". Jezusit iu mbushën sytë me lot. Atëherë judenjtë thanë: "Pa shihni sa e paska dashur!". Pati dhe nga ata që thanë: "Ky, që i solli dritën e syve të verbërit, a s'mundet, vallë, ta ngjallë së vdekuri?".

Raskolnikovi u kthye dhe e pa i tronditur: ashtu ishte! Vajza dridhej siç dridhet një i sëmurë nga ethet e forta. E pse të ndodhte kjo? Ajo i qe afruar vendit ku flitej për çudinë e padëgjuar, më të madhen që bëhej, dhe ngadhnjimi i triumfit i ishte transmetuar edhe atij, po i jepte gëzim, po e bënte më të fortë. Sonjës po i trazoheshin rreshtat e librit të shenjtë, i qe turbulluar shikimi, por e dinte përmendësh vendin që po lexonte. Kur shqiptoi: "... a s'mundet, vallë, ta ngjallë së vdekuri.." e uli zërin, e forcoi theksimin, për ta dhënë sa më të plotë dyshimin, qortimin dhe keqdashjen e atyre që nuk i besonin Jezusit, por që pas një minute, si të shituar nga rrufeja, do rrëzoheshin në tokë, do derdhnin lot pendimi dhe do t'i besonin... "Edhe ky, edhe ky, i verbër dhe pa besë, siç është, posa ta dëgjojë tani, do ta besojë! Po! Po! Ja! Tani!" - shkonte me shpresë vajza dhe priste e gëzuar.

"Jezusi me pikëllim në zemer i afrohet varrit. Ishte në shpellë, mbi varr që vënë një gur. Jezusi u thotë: "Largojeni gurin". Motra e të ndjerit, Martha, i thotë: "O Zot! Mban erë, ka katër ditë që rri shtrirë në këtë varr".

E shqiptoi fort dhe me ndalesa fjalën katër.

"Jezusi i thotë: "A s'të kam thënë që po të besosh, do ta shohësh lavdinë e Zotit?". E larguan gurin. Jezusi ngriti sytë nga qielli dhe tha: "O Atë, të faleminderit që po më dëgjon. E di që gjithmonë më dëgjon, por e thashë që ta dëgjojë njerëzia, që ta besojnë se je ti ai që më ke dërguar". E tha këtë dhe thirri me zë të lartë: "Llazar! Dil që aty.." Dhe doli i vdekuri *(E lexoi me zë të lartë, solemn, dridhej e*

mallëngjyer sikur ta kishte parë me sytë e saj!) i mbështjellë kokë e këmbë me qefinin e varrimit; edhe fytyrën e kishte të lidhur me shami. Jezusi u thotë: "Zgjidhjani shaminë, hiqjani qefinin, le te ecë".

Atëherë shumë nga judejtë, që kishin ardhur te Maria, dhe e panë ç'bëri Jezusi, i besuan atij.

Nuk vazhdoi, nuk mundte, e mbylli librin, u çua vrulltas nga karrigia.

- Kjo është shkruar për ngjalljen e Llazarit, - pëshpëriti me zë të dridhur, të ndërprerë, i ktheu krahët dhe qëndroi ashtu si e ngrirë, pa guxuar të kthehej nga ai. Të dridhurat s'po i rreshtnin. Bishti i qiririt ishte duke u shuar në tavullën e shtrembër dhe vetëm zbehtë ndriçonte vrasësin dhe të përdalën, aq shumë të afruar me njëri-tjetrin gjatë leximit të librit të përjetshëm. Kaluan pesë a më shumë minuta.

- Kam ardhur të bisedoj për diçka, - tha me zë të lartë i ngrysur Raskolnikovi; u çua dhe iu afrua Sonjës, kjo ngriti sytë dhe e pa pa thënë asnjë fjalë. Shikimi i tij i vrazhdë shprehte vendosmëri.

- E kam prerë mëndjen që, duke filluar nga dita e sotme, t'i ndërpres marrëdhëniet me të mitë!

- E pse? - e pyeti e habitur vajza. Takimi i djeshëm me nënën dhe motrën e tij i kishte lënë një mbresë të mirë, të pashlyeshme, por edhe disi të turbullt. Lajmi për prishjen me të afërmit e çmeriti.

- Tani vetëm ty të kam, - shtoi. - Shkojmë gjëkundi bashkë?... Për atë kam ardhur. Të dyve na kanë mallkuar, të dy dhe nisemi.

Sonjës iu përshkënditën sytë. "Duket që s'është në vete!" - mendoi.

- E ku të vemi? - e pyeti me frikë dhe pa dashje bëri pak prapa.

- Se mos e di se ku! Di vetëm që na pret e njëjta rrugë, këtë e di mirë. Qëllimet i kemi të njëjtë!

Vajza e shihte pa mundur të kuptonte domethënien e asaj që po dëgjonte. Veç dukej si dita me diell që ky njeri ishte tepër po tepër fatkeq.

- Po tua thoja të tjerëve, nuk do më kuptonin, kurse ti më kuptove, -i tha. - I duhemi njëri-tjetrit, ndaj dhe erdha.

- Nuk po të kuptoj... - belbëzoi Sonja.

- Do më kuptosh më vonë. Pse ti a nuk ke bërë të njëtën gjë? Edhe ti e ke kapërcyer cakun... kuturise ta kapërcesh. Vure dorë mbi veten, e more veten në qafë... more më qafë veten tënde e jo dikë tjetër, kjo njëlloj është. Fare mirë mund të jetoje ashtu si ta kishte ënda, kurse

kjo që ke nisur do të çojë në fund të keq... Do mbetesh vetëm dhe do çmendesh si unë. Ja, edhe tani si e çmendur dukesh; pra, një rrugë kemi të dy, bashkë do ta bëjmë! Shkojmë!

- Po pse? Pse flisni kështu? - nëpërdhëmbi Sonja e tronditur, por edhe e mbushur me maraz nga këto që po dëgjonte.

- Pse? Sepse nuk duhet ndenjur më kështu! Duhet parë esëll çdo gjë; s'kemi pse qajmë e lebetitemi si foshnjat, të rrojmë në mëshirën e Zotit! Ç'do të ndodhte, vallë, sikur, ja, nesër të shtronin në spital? Ajo nuk është në vete, veremlije po është, nuk e ka të gjatë. Atëherë me fëmijët ç'do të bëhej? Poleçkën a s'e pret vdekja? Pse a nuk ke parë nëpër qoshe fëmijë, nënat e të cilëve kërkojnë lëmoshë në rrugë të madhe? A e di në ç'mjedise rrojnë? Aty fëmijët nuk kanë si mbeten fëmijë! Edhe shtatëvjeçari i prishur është, merret me hajdutëri. E pra, fëmijët janë shëmbëllesa e Krishtit! "Ata janë mbretëria e Zotit!". Krishti ka urdhëruar që t'i duam dhe t'i mëshirojmë; janë e ardhmja e njerëzimit.

- Po ne ç'mund të bëjmë? - e pyeti Sonja dhe i shkuan lotët çurg, e pushtuar nga makthi dhe angështia.

- Si ç'mund të bëjmë? Ta thyejnë e ta bëjmë copë të keqen, ta zhdukim njëherë e përgjithmonë dhe vuajtjen ta marrim mbi veten tonë. Si? Nuk po e kupton ç'dua të them? Do ta kuptosh më vonë... Liria dhe pushteti; kryesor është pushteti! Mbi tërë këtë mizëri dhe milingonëri! Ja, ky është qëllimi! Mbaje mend këtë! Është porosia ime! Ndoshta, është hera e fundit që shihemi. Po nuk erdha nesër, do ta marrësh vesh si qëndron puna; mbaji mend mirë këto që të thashë. Me kalimin e viteve do jetë jeta ajo që do ta zbërthejë domethënien e tyre. Në erdha nesër, do ta them kush e vrau Lizavetën. Lamtumirë!

Sonja nuk po dinte ku të futej nga tmerri.

- Pse e ditkeni kush e ka vrarë? - e pyeti dhe e ndjeu si ju thanë e iu bënë dru duar e këmbë.

- E di dhe do ta them edhe ty... Vetëm ty! Ty të kam zgjedhur për të ta thënë. Nuk do të kërkoj ndjesë për ç'ka ndodhi, vetëm do të ta them. E kam vendosur; ty dhe vetëm ty do të hapem, E kam menduar që kur më foli babai për ty dhe Elizaveta ishte ende gjallë. Lamtumirë. Mos ma jep dorën. Nesër!

Doli. Sonja e ndoqi me sy siç ndjekin një të çmendur, por edhe

vetë ishte si e prishur nga fiqiri, e ndiente këtë. Koka po i vinte rrotull. "O Zot! Si kështu? E ditka kush e vrau Lizavetën? Po ato që tha, ç'kuptim të kenë, vallë? Tmerr!" - tha me vete e lebetitur. Veç atij mendimi të vërtetë që do t'i jepte në dorë çelësin për t'i kuptuar që të gjitha, nuk po i binte që nuk po i binte dot në të. "Duket, që duhet te jetë shumë fatkeq ky njeri!... I paska braktisur edhe nënën me motrën. E pse? Ç't'i ketë ndodhur, vallë? Ç'bluan në mëndje? Po tërë ato që tha, ç'ishin? Më puthi këmbën dhe pastaj m'i tha... po, po më tha... që nuk rron dot pa mua!... O Zot!".

Natën e kaloi si në jerm. Zgjohej, ulej në shtrat, qante, thyente duart dhe përsëri humbiste në kllapi; iu shfaq në ëndërr edhe Poleçka, edhe Katerina Ivanovna, edhe Lizaveta, edhe leximi i ungjillit, edhe ai... me fytyrën dyllë të verdhë, me sytë e skuqur dhe të përflakur... Ulet vrulltas, i puth këmbën, qan... O Zot!

Prapa derës, që të çonte te Reslihët, ishte një dhomëz boshe, që lëshohej me qira. Kishte edhe njoftime në vende të dukshme për këtë. Sonja prej kohësh e quante këtë dhomë të pabanuar. Ndërkaq, gjatë gjithë kohës së bisedës ndërmjet Sonjës dhe Raskolnikovit te dera e dhomës bosh rrinte i fshehur Svidrigajllovi dhe përgjonte. Pasi doli Raskolnikovi, qëndroi edhe pak, u mendua, hyri në dhomën tjetër në majë të gishtave, kjo ishte dhoma që kishte zënë me qira dhe ishte fqinje me dhomëzën e pa banuar; mori një karrige dhe pa u ndier e çoi te dera e dhomës së Sonjës. Biseda që sapo kishte dëgjuar i qe dukur tepër interesante dhe me leverdi, i kishte pëlqyer aq shumë, saqë herën tjetër, nesër, bie fjala, të mos e mundonte veten si sot, që e kishte dëgjuar në këmbë një orë të tërë, por të kishte komoditet, në mënyrë që edhe kënaqësia të ishte sa më e plotë në të gjitha drejtimet

V

Mëngjesin tjetër, plot në orën njëmbëdhjetë, Raskolnikovi erdhi në zyrën e policisë kriminale dhe kërkoi të takonte Porfiri Petroviçin. U habit që ia vonuan nja dhjetë minuta përgjigjen, sepse, sipas tij, duhej ta kishin marrë e ta kishin rrasur menjëherë brenda. Në dhomën e pritjes, ku i thanë të rrinte, hynin e dilnin gjithfarë njerëzish. Dhoma

fqinje ishte e sekretarisë, rrinin disa shkrues, të cilët, dukej ajo, as që donin t'ia dinin se kush ishte Raskolnikovi. Shihte me dyshim e shqetësim në po i afrohej ndonjë nga të policisë, por asgjë të tillë nuk kishte. Venin e vinin vetëm punonjës zyrash, të zënë me punët e tyre, të cilët as që ia shtinin sytë. Ndërkaq i qe ngulitur në mendje: në se njeriu i djeshëm, ajo fantazmë, që sikur kishte mbirë nga dheu, dinte gjithçka, pse a do ta linin vallë, atë, Raskolnikovin, të livadhiste kështu në qejf të tij? Pyeste veten: a i priste t'i vinin, apo ishte ai që do t'u paraqitej vetë? U bind që ose ai njeri nuk e kishte kallëzuar ende, ose... ose nuk ishte në dijeni të punëve, nuk kishte parë gjë (e nga ta kishte parë?). Dilte që e djeshmja s'ishte tjetër veçse vegim, hije, pjellë e fantazisë së ngacmuar dhe të sëmurë. Edhe dje, kur e torturonte veten me hamendjet dhe mëdyshjet që nuk kishin të sosur, i kishte ardhur një mendim i tillë, tani iu përforcua; duhej të ishte gati për përleshje të reja. I filluan të dridhurat, i vinte plasje, kur mendonte se kështu do dridhej edhe kur të ndodhej përpara Porfiri Petroviçit të urryer. Takimi me atë njeri i kallte datën: edhe pse të gjallë ta hante nuk ngopej; trëmbej se mos, nga urrejtja e tmerrshme që kishte, do ta tradhëtonte veten. I thirri mendjes, të dridhurat iu qetësuan, i tha vetes se duhej ruajtur gjakftohtësia, se duhej kundërshtuar në çdo pikë ai njeri, vendosi të heshtte sa më shumë që të ishte e mundur, vetëm ta dëgjonte i përqendruar dhe të ndiqte çdo lëvizje e gjest të tij, qoftë kësaj here të mos e lejonte veten të nxirrte krye irritimi i vazhdueshëm dhe nervozizmi që e mundonin aq shumë. E thirrën për te Porfiri Petroviçi.

E gjeti vetëm në zyrë. Ishte një dhomë as e vogël dhe as e madhe, me një tryezë shkrimi para një divani të veshur me ingilit, me një dollap, një etazher dhe disa karrige; orendi të zakonshme zyrash prej druri të verdhemë, të llakuar. Në murin karshi ishte një derë e mbyllur, pra, pas saj kishte një dhomë tjetër. Pasi la të kalonte Raskolnikovi, Porfiri Petroviçi e mbylli derën dhe u gjendën vetëm për vetëm. Ky iu drejtua me fjalë përshëndetjeje, duke e shfaqur hapur gëzimin që po e shihte në zyrën e tij; vetëm pas disa minutash Raskolnikovi i ra në sy një farë frenimi në sjelljen e tij, si ta kishte çoroditur dikush në ato që ishte duke bërë apo ta kishin kapur në ca intimitete të kryera fshehurazi.

- Ah, mor i nderuar, erdhët... në këto anët tona?... - i tha dhe i zgjati dorën. - Uluni, vëllaçko! Apo ndoshta nuk iu pëlqen t'u drejtohem me këto "i nderuar" dhe "vëllaçko". Kështu *tout court*[1]. Mos ma merrni për keq... Uluni, ja këtu, në divan.

Raskolnikovi u ul pa ia shqitur sytë.

Fjalët: "në këto anët tona", kërkimi i ndjesës për familjaritetin, shprehja e thënë frëngjisht: *"tout court"*, etj., etj., qenë përdorur me qëllim. "Për të zgjatur m'i zgjati të dyja duart, por s'më dha asnjërën për t'ia shtrënguar, i tërhoqi në çastin e duhur", - vuri re heshturazi, i mbushur me dyshime. Po e studionin shoshoqin, por me t'u ndeshur shikimet, i largonin me shpejtësi rrufeje.

- E solla lutjen për kthimin e orës... ja. Mirë është formuluar, apo ka nevojë të shkruhet përsëri?

- Çfarë? Letrën? Ah, po... s'ka asnjë problem, - foli shpejt e shpejt Porfiri Petroviçi, si të ishte me ngut; e mori dhe i hodhi një sy. - Në rregull, asgjë tjetër nuk nevojitet, - tha dhe e la mbi tryezë. Pas një minute, duke folur për diçka tjetër, e mori përsëri dhe e vuri në sirtar.

- Dje më duket se thatë që dëshironit të më pyesnit, siç e kërkon formaliteti i detyrës që kini, lidhur me njohjen që kam patur me të vrarën? - i tha Raskolnikovi dhe sakaq e qortoi veten për fjalën "më duket". "E pse më ha aq meraku për një fjalë", - i kaloi rrufeshëm në mendje qortimi tjetër.

Po e vinte re që ishte bërë shumë i ndjeshëm ngaqë kishte përballë Porfirin, vetëm pse këmbeu me të dy fjalë e dy shikime... ishte tepër e rrezikshme kjo: po i acaroheshin nervat, po i rriteshin emocionet. "Çështë kjo me mua? Do më shpëtojë ndonjë gjë!"... - mendoi me frikë.

- Po ju mos kini keq! Koha duron, duron koha! - mërmëriste Porfiri Petroviçi, duke u vërdallosur para tryezës pa ndonjë pikësynim të caktuar, pastaj duke iu afruar dritares dhe përsëri tryezës, gjithmonë duke iu shmangur shikimit studiues të Raskolnikovit, por edhe duke ndalur befas për ta parë atë drejt në sy. Tepër i çuditshëm po i dukej ky njeri topolak e rrumbullak, i ngjashëm me një top që rrokulliset nëpër dysheme nga një qoshe në tjetrën.

---

[1]) *Në intimitet (fr.)*

- Kemi kohë ne, këtu jemi... Pini duhan? Ja, merreni... - mërmëriste duke ia zgjatur mysafirit. - E dini, po ju pres këtu, ndërsa apartamentin, atë të shtetit, e kam ja këtu, prapa kësaj derës. Jam në kohë pushimi, por erdha për ca punë... Duheshin bërë disa korigjime... Një mrekulli e vërtetë është apartamenti i shtetit! Ju si thoni?

- Them se mrekulli është, - iu përgjigj Raskolnikovi, duke e vështruar thuajse me tallje.

- Mrekulli, mrekulli është, - përsëriste Porfiri Petroviçi si i zhytur në të thella. - Mirë thatë, mrekulli! - bërtiti dhe u gjend dy hapa pranë Raskolnikovit, e shigjetoi me ca sy të liq. Kjo përsëritje prej idioti e të njëjtës fjalë, fare banale në vetvete, jo vetëm që nuk kishte pse të bëhej me aq seriozitet, por binte në kundërshtim me sjelljen e folësit, sidomos me shikimin shigjetues e zhbirues që i kishte drejtuar mysafirit.

Kjo i hodhi benzinë zjarrit, që edhe kështu po i bubulonte në gji Raskolnikovit; nuk mundi ta shmangte shikimin tallës, aq të pakujdesshëm në ato çaste.

- E dini? - iu drejtua Porfiri Petroviçit me qesëndi, pa e fshehur edhe kënaqësinë që po ndjente. - Ka disa norma juridike të pranuara nga të gjithë: hetimi duhet nisur që larg e larg, nga vogëlsirat, por mund të fillohet edhe nga çështje me peshë, nga probleme serioze për atë që hetohet, bëhet si të thuash, që t'i japësh zemër, apo më mirë të themi, për t'i larguar mendjen të pandehurit, për t'ia vënë në gjumë vigjilencën; pastaj në mënyrë të befasishme ta qëllosh mu në çaçkën e kokës me pyetjen fatale; kështu është? Më sa di unë, në çdo doracak juridik e gjen këtë porosi.

- Pra, mendoni që edhe unë me këtë apartamentin e shtetit kështu jam duke vepruar?.. - i tha, picërroi sytë dhe i shkeli syrin e majtë; nëpër fytyrë i bredhëroi diçka kselhasëse dhe tinëzare në të njëjtën kohë, rrudhat e ballit iu sheshuan, bebëzat e syve iu ngushtuan, u hargalis nga një e qeshur nevrasteniku: e zgjatur, krupëndjellëse dhe e ligë. Gjatë tërë kësaj nuk ia shqiti as dhe për një çast shikimin Raskolnikovit. Edhe ky u bë gati të qeshte si me përdhunë, por kur e pa Porfirin që po gajasej mosmëkeq, u bë vishnje në fytyrë nga neveria, që edhe kështu po ia trazonte të përbrendëshmet; sakaq neveria ia la vendin vigjilencës: nuk qeshi, u vrenjt, e pa me urrejtje, pa lënë t'i

shpëtonte çdo lëvizje e këtij. Sidoqoftë, që të dy po tregoheshin të pakujdesshëm: Porfiri Petroviçi, si të thuash, ia përplasi tërë mllefin që kishte në fytyrë mysafirit, që po e shihte me urrejtje të pafshehur, ndërsa Raskolnikovi po i tregonte që s'para e çante kokën për këtë sfidë të hapur që po i bënte. Ky qëndrim e vuri Raskolnikovin para një detyre të re: e kuptoi që Porfiri e ndjente veten superior, diçka e re e kërcënonte, nga çasti në çast mund të binte në grackën që po i ngrinte; dukej sheshit që ky diç kishte në dorë, se çfarë, këtë nuk e dinte. Ishte e qartë që gjithçka bëhej me një pikësynim të caktuar...

Raskolnikovi e çoi llafin te çështja për të cilën kishte ardhur.

- Porfiri Petroviç, - iu drejtua i vendosur, por edhe mjaft i nervozuar. - Dje shprehët dëshirën për të më marrë në pyetje (i mëshoi enkas fjalës pyetje). Ja ku më keni, më pyesni, në mos më lejoni të largohem. S'kam shumë kohë, më pret një punë... më duhet të shkoj në varrimin e atij nëpunësit, që e shtypi karroca, për të cilin... jeni në dijeni, - e bëri këtë sqarim dhe u zemërua vetë me veten, ndaj dhe vijoi të flasë me nervozizëm. - Ka filluar të më bezdisë tërë ky dyshim që bie mbi mua, mjaft më... jam i sëmurë dhe më rëndon sa më s'bëhet... me një fjalë, - tha me të bërtitur, ngaqë e ndjeu se ishte krejt e panevojshme përmendja tani e sëmundjes, - me një fjalë, kini mirësinë o të më merrni në pyetje, o të më lejoni të largohem... Dhe ta bëni sipas të gjitha rregullave, ndryshe nuk ju lejoj! Lamtumirë!

- O Zot! Ç'thoni kështu! E për çfarë u dashka t'ju marrë në pyetje! - i tha ky përmes së qeshurës, duke e ndërruar si sustë qëndrimin. - Nuk keni pse shqetësoheni për asgjë! - i tha dhe u hodh ta ulte gjoja me forcë në vend. - Pret koha, duron koha! Gjepura, gjepura janë! Përkundrazi, ndihem shumë i gëzuar që urdhëruat te ne... Ju konsideroj mysafirin tim... Sa për këtë të flamosurën qeshje, të më falni, Rodion Romanoviç! Kështu më duket se ju quajnë. Më gajasët asisoj me mendjemprehtësinë që treguat, duke ma bërë atë vërejtje; ndodh kjo me mua, jam tip nevriku, s'përmbahem dot, hidhem e dridhem si një top llastiku... gaztor njeri!... Ju lutem, uluni, ndryshe do më duket se u zemëruat...

Gjatë tërë kësaj tirade të gjatë, Raskolnikovi heshti, por nuk i shpëtoi pa mbikqyrur as edhe një lëvizje a gjest i hetuesit. Ndërkohë në fytyrë i qe mbrehur shprehja e zemëratës. Bëri si bëri dhe u ul.

- Dua t'ju tregoj ja se çfarë për veten time, Rodion Romanoviç, në mënyrë që t'ju shpjegohen më së miri disa nga tiparet e karakterit tim. - Ndërkohë vazhdonte ecejaket nëpër dhomë, duke u munduar ta shmangte kryqëzimin e shikimeve me mysafirin. - Bëj jetë beqari vetmitar, askush s'më njeh, nuk i përkas shoqërisë së lartë, aq më tepër që kam marrë fund megjithsej, e kemi në gjak këtë. Kam vënë re, Rodion Romanoviç, se te ne në Rusi, sidomos këtu në mjediset petërburgase, dy njerëz të mençur, jo shumë të njohur me njëri-tjetrin, por që e respektojnë bajagi shoshoqin, ja, si ne të dy, mund të rrinë gju më gju edhe një gjysmë ore dhe të mos e gjejnë që të mos e gjejnë dot temën e bisedës. Shtrydhen e mblidhen, përtypen e kapërdihen dhe hiç! Se njerëzia për ç'nuk bisedojnë.. Ata të shoqerisë së lartë, *c'est de rigueur*[1]), e kanë temën e tyre të bisedës, kurse ca të shtresës së mesmes, si puna jonë, rrinë si mbi gjëmba, nuk u del fjala nga goja, janë të thellë në mendime domethënë. E pse ndodh kështu? Mos vallë ngaqë u mungojnë interesat shoqërore, apo janë tepër të ndershëm dhe nuk duan ta mashtrojnë shoshoqin; ja këtë nuk e di! Ju si thoni, përse? Po lëreni atë të shkretë kapele se më duket sikur do ngriheni e do ikni! S'më pëlqen t'ju shoh kështu... Jam aq po aq i gëzuar që erdhët...

Raskolnikovi e la kapelen, por vazhdoi të ruajë heshtjen dhe ta dëgjojë serioze i vrenjtur dërdëllitjen boshe dhe të çakërdisur të Porfirit. "Po si, vërtet që beson se po më largon vëmendjen me këtë dërdëllitje prej budallai, ky?" - pyeti veten.

- T'u gostisja me një kafe, por s'ma lejon vendi, të rrimë si miq për kënaqësinë e ndërsjelltë, - vazhdoi Porfiri. - Detyrat e shërbimit... ju lutem, vëllaçko, të mos m'i merrni për keq këto ecejaket, as që më shkon më mendje që t'ju fyej... më kallin frikën, këto lëvizjet sikur ma largojnë pak mendjen, i kam të domosdoshme. Pastaj bëj jetë sedentare dhe mezi pres të më jepet rasti të shpihem pak! Kam bërë mendje të merrem me gjimnastikë, thonë që edhe zyrtarët e lartë kërcejnë me litar... e rekomandoka shkenca. Sa për detyrën e këtushme, hetimet e më the të thashë... Ju, mor vëlla, sapo ma kujtuat atë punën e të pyeturit... Ja ku po jua them, Rodion Romanoviç, ndodh

[1]) *Kështu është bërë zakon (fr.)*

dhe jo rrallë, që marrja në pyetje më shumë e çorodit hetuesin, sesa i jep diçka... Ju vetë me tepër mendjemprehtësi sapo e bëtë këtë vërejtje (Raskolnikovi nuk po vinte re ndonjë çudi në këtë mes). Ngatërrohesh! Me këmbët e tua ngatërrohesh! Mos e nga pastaj monotoninë, si tingujt e daulles! Është duke u përgatitur reforma, neve edhe emrin kanë për të na i ndryshuar! He! He! Sa për normat juridike, për të cilat patët ndërin të flisnit atypari, jam plotësisht i një mendjeje me ju. Edhe muzhiku më i humbur e di që ia fillojnë që larg e larg, e pastaj drejt e mu në çaçkë, me sa u ha krahu. He! He! He! Ashtu pandehët se isha duke bërë me apartamentin e shtetit.. He! He!... Për shpotitës s'e keni shokun! Po nejse, fjala ndjell fjalën... Edhe formalitetet ndonjëherë nuk vlejnë... Më mirë kështu: urtë e butë e plot tigani! S'ka për se ia lidh duart hetuesit. Hetimi është art... He! He!

Porfiri Petroviçi ndali si për të marrë pak frymë. Kur ishte duke vrapuar nëpër dhomë, Raskolnikovi vuri re që dy herë e kishte ndalur hapin para derës dhe kishte mbajtur vesh... "Mos po pret dikë ky?" - mendoi.

- Dhe keni plotësisht të drejtë, - e kapi përsëri fillin e bisedës, duke parë i çelur dhe i ngazëlluar nga Raskolnikovi. (Ky u drodh dhe mori masat e duhura).- Që flisni ashtu për formalitetet në veprimet gjyqësore, keni të drejtë. Mirë bëtë që i përqeshët. He! He! Këto mënyrat tona (disa prej tyre, sigurisht) psikologjike bëhen qesharake dhe të padobishme, po qe se i ngushton në ca korniza formale. Nëse dyshoj për dikë, si i ngarkuar për këtë detyrë që jam... Ju për jurist mësoni, Rodion Romanoviç?

- Po, kam ndjekur fakultetin juridik.

- Po ju sjell një shembull, ndoshta ju vlen për punën tuaj të ardhshme. Veç mos pandehni që po marr përsipër t'ju mësoj, ju jeni dhe autor shkrimesh për kriminalistikën! Vetëm për muhabet po ju flas. E pra, dyshoj për dikë, e përse duhet ta shqetësoj tjetrin para kohe, qoftë edhe në paça fakte! Ka raste kur duhet marrë masa e arrestit, po ka dhe raste që nuk duhet privuar tjetri nga e drejta për të shëtitur i lirë! He! He! Nuk po më kuptoni, me ç'po shoh! Po në e arrestofsha para kohe, domethënë se i kam dhënë si të thuash, një mbështetje morale. He! He! Po qeshni, hë (Raskonikovi as që kishte

në mendje të qeshte; rrinte me dhëmbët shtrënguar, pa ia shqitur sytë e skuqur Porfirit). Duhet parë njeriu, nuk shkon për të gjithë e njëjta praktikë. Ju mund të më kundërshtoni, duke më thënë se lipsen fakte dhe vetëm fakte. Por jam hetues, jam njeri i dobët, do të dëshiroja të kisha një përfytyrim matematik për hetimin, të gjeja një fakt të tillë, që tjetri nuk ka nga luan. Ja, si një e një bëjnë dy. Po ta arrestosh tjetrin para kohe, edhe në qofsh i bindur qe është ai, ia heq vetes nga dora mjetin për zbulime të mëtejshme. Sepse kështu ky mblidhet në guackën e vet, e sheh që e kanë arrestuar. I janë trëmbur për kijamet sulmit të befasishëm ata të Sevastopolit, por kur mësuan se kundërshtari zgjodhi rrethimin, u gëzuan, thanë se të paktën dy muaj kohë iu shtuan! Po qeshni, hë? S'ju besohet? Edhe ju keni të drejtë në atë mënyrën tuaj, se rastet janë të pjesshme, por ama si çështje duhet parë; mënyra të përgjithshme në jurisprudencë nuk ekzistojnë, çdo krim ka fizionominë e vet. Dhe, e dini, ka raste që të gajasesh. Po ta mbash dikushin në mbikqyrje të pandërprerë, pa e shqetësuar, por duke i dhënë të dijë që ti diç di apo të paktën për diç dyshon, jua them unë, domosdo do të turbullohet, diç do bëjë, me siguri matematike kjo, ose do paraqitet vetë në hetuesi. Kjo ngjet edhe me muzhikun e pagdhëndur, pale pastaj me qytetarin e civilizuar e të zgjuar. Ka rëndësi të dihet në ç'drejtim është zhvilluar individi i caktuar. Po nervat? Ato si, i harruat? Sot kush nuk vuan nga ato, të dobësuara e të strepëcuara i kanë! Po vrer, sa shumë vrer që ka në ta? Në kësi rastesh vreri është mirierë e vërtetë! E pse duhet të më shqetësojë fakti që filan njeri endet nëpër qytet i lirë? Le të shëtisë deri sa t'i vijë dita, t'i mblidhet litari! Nuk ka ku vete! Mund t'ia mbathë jashtë shtetit, mund të thoni. Polaku e bën këtë, kurse ky toni jo! Pastaj e kam nën mbikqyrje, i kam marrë masat. Të fshihet në humbëtirat tona nuk i leverdis, e përpin muzhiku me gjithsej, më mirë galera se humbëtira! Kryesorja, ai psikologjikisht nuk ka si ia mbath! He! He! Shprehje kjo! E keni parë fluturën si i afrohet flakës së qiririt? Ja ashtu ka për t'u vërtitur rreth e qark meje. Liria do t'i pështiroset, do ta mundin limontia dhe mendimet, do ngatërrohet vetë me veten, do bjerë në rrjetë! Dhe do na e mësojë edhe neve ligjin e matematikës se një e një bëjnë dy. Do sorollatet nga do sorollatet dhe hop, në dorën time do bjerë! Unë po di si e shtrëngoj. He! He! Nuk besoni që kështu

është?

Raskolnikovi nuk nxori asnjë fjalë; i verdhë dyllë nuk ia shqiste sytë Porfirit.

"Mësim të mirë më dha! - tha me vete. - Dhe jo me taktikën e djeshme, duke lojtur si macja me miun. Po ma thotë qartë, nuk paska ndër mend të përdorë forcën! Por, më kot, mor byrazer, kërkon të më trembësh, të më marrësh krahët! Asnjë fakt nuk ke në dorë, as ai njeriu i mbrëmshëm nuk ekziston! Kërkon të më çoroditësh, të më irritosh, të më prishësh mendjen dhe pastaj të më shtjesh në dorë. Por me mua nuk të shkon! Mos i ke bërë hesapet të spekullosh me nervat e mia të dobta, të sëmura? Nuk ka për të dalë ai hesap që ke bërë. Po të shohim ç'masa paske marrë?".

I mblodhi të gjitha forcat për t'i bërë ballë katastrofës që e priste. Duke e dëgjuar, jo një herë i kishte lindur dëshira për t'ia hedhur thonjtë në fyt këtij njeriu. Dhe ia kishte frikën vetes, ndoshta nuk e përmbante dot inatin. Zemra i rrihte si çekan, buzët i kishte të thara shkrumb, në çipet e buzëve i kishte dalë shkumë. Kishte vendosur të mos e hapte gojën, që t'ia ngrinte nervat kundërshtarit; pastaj ku i dihet se ç'mund t'i shpëtonte.

- E shoh që nuk besoni se kështu është, ju duken përralla këto që po them, - vazhdoi Porfiri dhe u zgërdhi i kënaqur, pa i ndërprerë ecejaket. - Se unë edhe pamjen të tillë e kam, i bëj për të qeshur ata që më shohin; bufon dukem, hiç më pak! Veç një gjë do jua them troç; ju pëlqen të dukeni mendjemprehtë, të gjykoni për çështje abstrakte, në shembullin e rinisë së sotme, që ne pleqve nuk na vë fare në hesap. Po, jua them unë, punët i bëni si strategët austriakë në kabinetet e tyre; i kishin përpunuar për bukuri të gjitha rastet e kapjes rob të Napoleonit, por ama fushat e betejës s'ua vërtetonin. E shoh që ju bëjnë të qeshni këto që them, Rodion Romanoviç, thoni me vete si guxon ky civil të sjellë shembuj nga sfera ushtarake. Po ja që ndiej dobësi për çështje ushtarake! S'do ishte keq të shërbeja në ushtri. Se Napoleon nuk do bëhesha, por majorin do ta arrija! He! He! Dhe tani, i dashur, dua të parashtroj të vërtetën e kulluar për atë që quhet *rast i veçantë*. Realiteti dhe natyra nuk janë gjëra pa rëndësi, ato ndonjëherë edhe përllogaritjet më esëll i flakin tej! Dëgjoni plakun, Rodion Romanoviç, ju flas me gjithë mend (Kur tha këtë tridhjet-

epesëvjeçari Porfiri Petroviçi sesi u plak vërtet; edhe zëri i ndryshoi, edhe trupi iu kërrus). Kështu e kam zakon, u flas hapur njerëzve. Ja, ju si thoni, jam apo nuk jam i çiltër? Mua vetë më duket se po. A s'po ju duket që jua bëj me dije këto taktika pa kurrfarë shperblimi? He! He! Po le t'i kthehemi bisedës sonë. Mendjemprehtësia, që thoni ju, për mendimin tim, është tipar i mrekullueshëm, është dhunti e natyrës, është lezeti i saj; ç'nuk mund të arrijë ai që e ka. Hetuesi i gjorë, i dhënë i tëri pas hipotezës, nuk ka si ia di vlerën! Por rinia mendjehollë për këtë aq që do t'ia dijë. "I merr me sulm kalatë" (siç na e zë veshi gjithandej këtë mendjemprehtësi për ta patur zili). Ta zëmë që dikush gënjen, gënjen *incognito* dhe ia arrin ta bëjë shkëlqyeshëm, me një dinakëri të stërholluar: ja dhe triumfi, shijo frytet e mendjemprehtësisë sate, por do ti, në çastin më interesant, në mënyrën më skandaloze i bie të fikët. Domosdo, bën të sajën sëmundja, zagushia, por sidoqoftë, shenjë është. Gënjeshtrën e sajoi të përsosur, por natyrën njerëzore nuk e pati parasysh! Ja si bie brenda tjetri! I dalldisur pas asaj të shkrete mendjemprehtësie zë e tall tjetrin, atë që e dyshon, zverdhet enkas, si duke u tallur, por ja që zverdhja i ndodh ca si tepër natyrshëm, ngjan si shumë me të vërtetën, ja dhe shënja e dytë. Ia hedh tjetrit një herë, tërë natën e natës ky i gjorë mendohet e thellohet mirazi, se është nga ata që nuk ia shkon kollaj ujtë nën rrogoz, ja dhe shënja e tretë. Hidhet ca si shumë, do t'u dalë punëve përpara, vete aty ku nuk i kërkohet, flet për gjëra, që për të është më mirë të heshtë, sajon gjithfarësoj alegorish. He! He! Vjen vetë e të pyet: përse nuk më rrasin brenda! He! He! Dhe i ndodh atij mendjemprehtit, psikologut dhe letrarit kjo! Natyra është pasqyrë, pasqyrë e pastër! Shihe në të veten dhe nxirr mësime! E pse u zverdhët kështu? Ju iku fytyra fare! Mos e keni nga zagushia? Ta hapim dritaren?

- Mos u shqetësoni, ju lutem, - thirri Raskolnikovi dhe ia plasi të qeshurit. - Nuk keni pse shqetësoheni!

Porfiri i qëndroi përkarshi. Priti pak dhe ia plasi gazit. Raskolnikovi u çua dhe e ndërpreu në vend të qeshurën histerike.

- Porfiri Petroviç! - i tha me zë të lartë, ndonëse mezi po qëndronte në këmbë. - E shoh që dyshoni, dyshoni për vrasjen e plakës dhe të motrës së saj, Lizavetës. Ja ku po ju them, më ka ardhur në majë të hundës e gjithë kjo! Në është në detyrën tuaj të më ndiqni, bëjeni; në

duhet të më arrestoni, më arrestoni, por të zgërdhiheni kështu dhe të më torturoni nuk jua lejoj.

Buzët iu drodhën, sytë iu ndezën, iu egërsuan, zëri deri më tani i përmbajtur, tingëlloi fuqishëm.

- Nuk jua lejoj! - ulëriti dhe me sa fuqi që kishte përplasi grushtin mbi tryezë. - E dëgjuat, Porfiri Petroviç? Nuk jua lejoj!

- O Zot! Po kjo ç'qe kështu? Përsëri? - thirri, me sa dukej, serizisht i trëmbur Porfiri Petroviçi. - Rodion Romanoviç! I nderuar! Ç'patët?

- Nuk jua lejoj! - përsëriti Raskolnikovi.

- Po ngadalë, mor djalë! Do na dëgjojnë, do vijnë! Ç'do t'u themi pastaj? Thirrini mendjes! - pëshpëriste i tmerruar Porfiri Petroviçi duke ia afruar fytyrën te fytyra dhe duke gulçuar.

- Nuk jua lejoj, jo! - vazhdoi të thotë mekanikisht Raskolnikovi, tani me pëshpërimë.

Porfiri shkoi me vrap dhe hapi dritaren.

- Ajri i pastër ju bën mirë! Mos doni pak ujë? Duket ajo, çaste krize janë... - Shkoi me vrap te dera për të porositur pak ujë, por vuri re që kana me ujë ishte aty në qoshe.

- Pini pak, - i pëshpëriti. - Qetësohuni. - Porfiri Petroviçi dukej me gjithë mend i trëmbur, e bënte çdo gjë aq natyrshëm, saqë Raskolnikovi s'po u besonte syve. Ujë nuk piu.

- Rodion Romanoviç! Xhan i vëllait! S'bën kështu! Me këto nerva kam frikë se do të përfundoni në çmendinë! Ah! Po pini, pini pak, ju bën mirë.

U detyrua ta marrë gotën, por kur po e afronte te buzët,e mblodhi veten dhe e ktheu përsëri në tryezë pa pirë.

- Po, po! Gjëndje krize kaluat, jo më pak! Do t'u kthehet sëmundja në vazhdofshi kështu! - belbëzonte me një pjesëmarrje miqësore Porfiri Petroviçi që s'ia hiqte vetes pamjen e të merakosurit. - O Zot! Po ju nuk kujdeseni fare për shëndetin? Dhe më erdhi Dimitri Prokofiçi. E pranoj, jam ca i hidhur me njerëzit, s'para sillem mirë... M'u vërsul, që thoni ju, burri i botës, gati sa s'm'i vuri thonjtë në grykë!... Nuk dija ç'përgjigje t'i jepja! S'kishte burrë ta mbante, zavallin! Mos e keni dërguar gjë ju tek unë? Po uluni, rrini dhe pak.

- Jo, për të dërguar nuk e kam dërguar, e di që do vinte, por përse nuk më tha, - iu përgjigj prerë Raskolnikovi.

- E paskeni ditur, domethënë?

- Po; pse ç'të keqe paska?

- Po ja, jam duke u njohur, Rodion Romanoviç, me gjithafrë bëmash tuajat. E di që donit të zinit një dhomë të re dhe në mes të natës u ngritët e dolët për ta gjetur, i ratë edhe ziles se apartamentit të plakës, aty pyetët edhe për gjakun, edhe bojaxhinjtë, edhe rojtarët e shtëpisë i çoroditët me thëniet tuaja. E kuptoj, e keni nga humori i keq... por në vazhdofshi kështu, do përfundoni në çmendinë! Për atë Zot që është një! Seç ju mundon një gulç i brendshëm, e keni nga fyerjet e panumërta, nga fati i hidhur, por edhe nga ne të policisë; nuk ju zë vendi vend; merakoseni si për t'ia zënë gojën njerëzve, doni t'i jepni fund sa më shpejt telasheve, jua kanë sjellë në majë të hundës me gjithfarë idiotësish, me ca dyshime e më the të thashë... kështu, apo jo? Mirë po flas? Se ju jo vetëm veten, por edhe Razumihinin po e bezdisni, ju dhe vetë e dini, e ka zemrën flori ai njeri! Jeni i sëmurë, kurse ai është i dhimsur, ja ku po i ngjitet dhe atij kjo sëmundja juaj!.. Po uluni, qetësohuni se ju ka ikur fare fytyra.

Raskolnikovi u ul, të dridhurat po i kalonin, por trupin sikur ia digjnin flakët. Krejt i mahnitur dëgjonte me vëmendje Porfirin, që dukej se po kujdesej për të. Nuk i besonte asgjëje që thoshte e bënte ky njeri, por në brendësi të zemrës ia kishte qejfi ta besonte. E kishin befasuar fjalët për apartamentin e plakës, për gjakun. "Pra, e ditka!" - mendoi.

- Në praktikën gjyqësore njihet një i tillë rasti, me një të sëmurë, - vazhdoi të tregojë Porfiri. - Është rast psikologjik. Dikush ia veshi vetes një akt vrasjeje. E tregoi veten mjeshtër në sajimin e ndodhisë: edhe alucionestisë, edhe fakte sillte, jepte të dhëna për rethanat, i ngatërronte dhe i çorodiste ata të drejtësisë. Kishte qenë fare pa dashje shkaktar i vrasjes, u dëshpërua pa masë, kur ia thanë këtë, se ia kishte ngulur keq vetes mendimin që ishte ai vrasësi! Senati i dha pafajësi, e la kondicionel. Ja, pra, ku mund ta çojë të gjorin njeri fantazia dhe fiksasioni; se nerva janë, durojnë durojnë dhe të lënë! Pa vjen një çast, kur edhe dritarja ta bën me dorë, të thërret kambanarja atje në majë, të hidhesh kokëposhtë. Se edhe kjo është diçka hamgjitëse... E pra, Rodion Romanoviç, ju s'para po ia varni shumë sëmundjes! S'do bënit keq të kështilloheshit me ndonjë mjek të mirë, se i jeni qepur atij

barkalecit dhe hiç më tutje. Po jua merr shpirtin përçarti... si në jerm i bëni punët!...

Raskolnikovit i erdhi vërdallë zyra me gjithë ç'kishte brenda.

"Ky, ndoshta, edhe tani duke gënjyer është! - iu përçua në mendje vetëtimthi. - E pamundur, e pamundur të duket!" - e largonte me kokëfortësi këtë pandehmë; e parashikonte tërbimin që e priste, po të vërtetohej që ky njeri nuk gënjente, atëherë kishte për t'u çmendur me të vërtetë.

- Po ai imi nuk është jerm, çdo gjë e kam bërë me vetëdije të plotë, - i tha me një vendosmëri të patundur, pasi thirri në ndihmë të gjitha forcat e vullnetit. - E vërtetë, e vërtetë ka qenë çdo gjë! Dëgjuat!

- Po, e degjova! E qartë! Ju edhe dje po kështu thatë, që nuk ishit në jerm... Por, e-eh!... Rodion Romanoviç, o njeri i mirë, po të marrim qoftë edhe këtë rrethanë. Po të kishit qenë vrasësi, apo i përzier në vrasje, a do kishit ngulur këmbë aq shumë që tërë ç'keni bërë këto tri-katër ditët e fundit nuk i keni bërë duke qenë në jerm? Dhe të kembëngulnit me një theksim të veçantë! Hë si, a mund të ndodhte kështu?... Po të ndiheshit fajtor, do ngulmonit sa do ngjirreshit që keni qenë në jerm! A nuk është kështu?

Raskolnikovit nuk i shpëtoi nuanca e qesëndisë që futi në këtë pyetje Porfiri Petroviçi. U tërhoq prapa në divan dhe u shty me shpinë pas mbështetëses, donte sado pak t'i largohej Porfirit, që ishte përkulur dhe ngultas, heshturazi, por edhe i hutuar e shihte drejt në sy.

- Ose të marrim rastin e Razumihinit; ai si, me kokë të tij erdhi dje të më qortonte asisoj, apo ishte dërguar nga ju? Jua do puna të pohoni që erdhi dje me kokë të tij, kurse ai tha që edhe ju e paskeni shtyrë të vinte!

Raskolnikovi këtë nuk e kishte bërë. Mornicat i kaluan nëpër trup.

- Gënjeshtra i keni të gjitha! - i tha edhe një herë, por ngadalë dhe me zë të shuar nga dhimbja e brendshme që e mundonte keqas. - Doni me çdo kusht të më mbushni mendjen që jeni në dijeni të lojës, që, sipas jush, qënkam duke lojtur! - i tha dhe i tërhoqi vetes vërejtjen që nuk ishte duke e peshuar si duhet çdo fjalë para se ta nxirrte. - Ju doni të më trëmbni, ja çfarë, ose thjesht jeni duke u tallur me mua...

Shikimin ia mbante të qepur, një zemëratë dhe urrejtje ferri ia përshkonte atë shikim.

- Gënjeshtra, gënjeshtra i keni të gjitha! - thirri. - Ju më mirë se kushdo tjetër e dini që dredhia më e mirë e kriminelit është të mos e fshehë atë që nuk mund të fshihet. Nuk ju besoj!

- Dredharak i madh qënkeni! - qeshi me qesëndi Porfiri. - S'u mbrehkan qetë me ju! Ju paska vënë për fund monomania. S'më besoni, domethënë? Ndërsa unë ju them që më besoni, tre çerekët e asaj që jua thashë e besuat; do arrij t'ju bëj të besoni edhe çerekun e mbetur, sepse ju dua sinqerisht, ju dua të mirën.

Raskolnikovit iu drodhën buzët.

- Për fjalë të nderit, që ju dua! - vazhdoi, duke e kapur miqësisht nga krahu, pak më sipër bërrylit. - Dëgjomëni mua; kini kujdes shëndetin. Për më tepër që ju paskan ardhur të shtëpisë, edhe për ta duhet menduar. Duhet t'i gëzoni e t'i lumturoni, kurse ju vetëm po i trëmbni.

- Po juve kjo ç'u hyn në qese? Nga e ditkeni? E ç'është tërë ky interesim për mua? Jeni duke më ndjekur, domethënë.

- O Zot! Po ju vetë ma thatë në apartamentin tim! Ju as vetë nuk e dini ç'thoni në nervozizëm e sipër! Edhe zoti Razumihin, Dimitri Prokofiçi, ç'nuk më tregoi mbrëmë. Po ju s'më latë të mbaroj; desha të them, se edhe pse s'ju mungon mendjemprehtësia, sqima e tepërt ju ka bërë të humbisni shikimin esëll të gjërave. Se ja, të marrim si shembull vajtjen në apartamentin e plakës. Ky përbën fakt (dhe nuk është fakt i vogël). Me të unë si hetues ju lidh duar e këmbë! Po të kisha qoftë dhe një fije dyshimi, pse kjo do ishte sjellja ime me ju? Në fillim do ju dëgjoja, për të fshehur nga ju çdo shkëndijë dyshimi, s'do ju vija në dijeni të atyre që di, do ju vija në gjumë dhe... Bam! Do ju befasoja: "Po ju, i nderuar zotëri, ç'paskeni kërkuar në shtëpinë e viktimës në ora njëmbëdhjetë të natës? Po ziles pse i paskeni rënë? Po për gjakun pse pyetët? Po rojtarët e shtëpisë përse i gënjyet?" Ja kështu duhet të veproja, nëse kisha qoftë edhe një fije dyshimi. Deponimet do t'i kërkoja me rrugë juridike, pa do ju kontrolloja banesën, por mund edhe t'ju arrestoja... Pra, nuk kam ndonjë dyshim, ndaj dhe nuk ua bëra të tëra këto. Ndërsa ju nuk po tregoheni aspak i mënçur, nuk doni që nuk doni ta kuptoni.

Raskolnikovi u rrëqeth dhe Porfiri Petroviçi s'kishte si të mos e vinte re.

- Të tëra gënjeshtra janë! - thirri. - Nuk e di ku doni të dilni, por që gënjeni, gënjeni.

- Unë gënjej? - e pyeti Porfiri i nxehur por duke ruajtur tonin ironik të njeriut që i pëlqen humori; dukej që s'e hante fare meraku lidhur me mendimin që kishte për të Raskolnikovi. - Unë gënjej, hë?... Po kjo sjellja ime, si? Mos harroni që jam hetues. Ua tregova të gjitha, ju dhashë në dorë armë për t'u mbrojtur, ju yshta idenë e sëmundjes. A s'është kështu? He! He! He! Nuk rri dot pa ju thënë që këto mjete psikologjike dhe dredha nuk pijnë ujë para gjyqtarëve, madje janë thikë me dy presa. "Jo po kam qenë sëmurë, në jerm, jo po më është dukur, etj., etj". Por ama, përse, or xhani i vëllait, pikërisht ca të tilla gjëra të janë dukur e fanitur e jo të tjera? Pyetje që qëndron! He! He! He!

Raskolnikovi e peshoi nga koka deri te këmbët me sy krenari.

- Shkurt llafet, - iu drejtua i vendosur dhe me zë të lartë, duke u çuar, që donte s'donte do ta shtynte paksa Porfirin, ndryshe s'kishte si çohej, - shkurt llafet, dua të di: a më merrni përfundimisht të çliruar nga dyshimet, apo jo? Ma thoni troç dhe prerë, një orë e më përpara, ja tani!

- Kështu, domethënë! - thirri Porfiri i kënaqur, duke e parë me dinakëri, por edhe pa e prishur gjakun. - E pse ju dashka ta dini? Juve askush nuk ju ka shqetësuar. Fëmijë po e tregoni veten: ma jep që ma jep zjarrin në dorë, thoni! E ç'është ky merak? Pse? He! He!

- Jua përsëris, - i tha Raskolnikovi, - Nuk e duroj dot këtë gjendje...

- Po ç'gjendje? - e ndërpreu Porfiri.

- Mos më flisni me këtë gjuhë! Nuk jua lejoj! Ja ku po jua them! - tha dhe përplasi përsëri grushtin.

- Jo kështu, jo! Do na dëgjojnë. Jua përsëris: duhet t'ju dhimbset vetja. Nuk bëj shaka, - i foli me pëshpërimë Porfiri, por kësaj here në fytyrë nuk iu duk ajo shprehja e gruas së trëmbur, përkundrazi, e urdhëronte me vetulla të mbledhura, pa më të voglin qëndrim dykuptimësh. Tëre kjo zgjati vetëm në çast. Raskolnikovi, që në fillim mori të ngrehur, e la mënjanë zemërimin dhe iu bind urdhërit për të folur me zë të ulët.

- Nuk lejoj njeri të më torturoj! - pëshpëriti ashtu si dhe pak më parë, duke e ndier me dhimbje dhe urrejtje që nuk kishte si të mos i

bindej atij urdhëri; kjo ia shtoi tërbimin. - Më arrestoni, ma bastisni dhomën, por ama ashtu si janë ligjet, mos lozni me mua si macja me miun.

- Sa për ligjet të mos ju hajë meraku, - e ndërpreu Porfiri dhe buzagazi i pështirë prej dinaku iu duk përsëri. - Ju ftova të më vinit siç vihet te miku, siç e ftojnë dikë në shtëpi.

- Nuk më duhet miqësia juaj! Dëgjuat? Më mirë po iki. Ç'ke në mendje të bësh, bëje, po deshe më arresto.

Mori kapelen dhe iu drejtua derës.

- Po surprizën si, nuk paskeni dëshirë ta shihni? - qeshi me cinizëm e tallje Porfiri, duke e kapur përsëri pak më lartë bërrylit, për të mos e lejuar të dilte. Mend fluturonte nga gëzimi që ia kishte dalë mbanë ta çonte në atë shkallë çorodie Raskolnikovin.

- E ç'suprizë na qënka? -e pyeti dhe ndaloi, duke e parë me frikë Porfirin.

- Ja, pas derës po na pret! He! He! He! (I tregoi me dorë nga dera e mbyllur që të çonte në dhomën tjetër.) - E kam mbyllur me kyç që të mos ikte.

- Kush është! Ku? Çfarë? - Raskolnikovi iu afrua derës dhe donte ta hapte, por ishte e mbyllur.

- Është e mbyllur. Jà kyçi.

I zgjati kyçin që e nxori nga xhepi.

- Gënjen! - ulëriri Raskolnikovi, pa mundur më të përmbahej. - Gënjen, mor hafije e mallkuar! - Në këtë e sipër iu sul Porfirit që tanimë ishte larguar nga dera dhe s'ia bënte tërt syri.

- E kuptoj, s'kam si të mos e kuptoj gjendjen tuaj! - i tha.

- E bëni për të më ngritur nervat, shkoni me shpresë se do e tradhëtoj veten.

- E ku të shkoj më tej ajo tradhëtia e vetes? Jeni në një të tillë frenezie, që zor të përshkruhet! Vetëm mos bërtisni, ndryshe do thërres njerëzit!

- Gënjen, asgjë nuk ke aty! Thirri njerëzit! E di që jam i sëmurë dhe ndaj më ngacmon nervat, shpreson të arrish diçka përmes kësaj! Ju faktet më tregoni, faktet. Hë, ku i keni? Jeni kapur pas ca hamendësimeve të pështira dhe mbaheni fort pas tyre. Pas atyre që ju tha Zametovi jeni kapur... Ma njohe karakterin, provove të më nxirrje

nga binarët, pastaj të më befasoje me ca priftërinj e deputetë. Hë, si? Mos je duke i pritur? Ku janë? Nxirri, de!

- Ju për ç'deputetë e keni fjalën? Ç'nuk shpif i gjori njeri! E ku merrni vesh ju, mor djalë, nga këto punë?... Sa për veprimet sipas ligjit, ato do t'i keni!... - tha kështu dhe vuri veshin të dëgjonte ç'bëhej prapa derës.

Dhe vërtet, që andej u dëgjua një zhurmë.

- Po vijnë, ë? - thirri Raskolnikovi. - Çove njeri që t'i thërriste?... Po i prisje me demek! Bjeri, bjeri këtu që të gjithë: edhe deputetë, edhe dëshmitarë, kë të duash bjerë... Hë, de! Gati jam! Gati!

Por ndodhi diçka e çuditshme; diçka aq shumë e papritur për një ecuri të rëndomtë ngjarjesh, që, sigurisht, as Raskolnikovi, por as vetë Porfiri Petroviçi këtë farë zgjidhjeje s'kishin si e prisnin.

VI

Më vonë, kur e kujtonte këtë çast, i dilte parasysh zhurma që ndihej pas derës dhe që sa vinte e rritej, dera që u hap pak.

- Ç'është kështu? - bërtiti Porfiri Petroviç. - Ju pata thënë...

Nuk iu përgjigj njeri, por dukej që prapa derës ishin disa që shtyheshin.

- Ç'bëhet, more aty? - pyeti i inatosur Porfiri Petroviçi.

- Sollën të arrestuarin, Nikollain, - iu përgjigj një zë.

- Jo tani! Largohuni! Prisni! Ç'është kjo rrëmujë? - thirri dhe u sul drejt derës.

- Po ky... - deshi të thoshte po ai zë, por nuk vazhdoi.

Të shtyrat u shndërruan në përleshje, pastaj dikush arriti të shkëputet dhe mehit në fytyrë hyri në dhomë.

Kishte një pamje të çuditshme, shihte para vetes, por asgjë nuk shquante. Shikimi i shprehte vendosmëri që nuk harmonizonte aspak me atë pamje njeriu të lemerisur, si të ishin duke e çuar në litar. Buzët e zhuritura dhe shkumës të bardha i dridheshin.

Ishte i ri në moshë, ishte veshur siç vishet hallku, kishte trup mesatar, të hollë, flokët i kishte të qethura anësh dhe të lëna tufë në caçkë, tiparet e fytyrës i kishte të holla. Roja, që nuk kishte dashur ta

linte, iu derdh nga pas dhe e pushtoi nga shpatullat, por Nikollai me një lëvizje të vendosur u çlirua dhe vazhdoi të afrohej.

Në derë futën kokën disa kureshtarë, ndonjë kuturisi të hynte. Tërë kjo u bë me një shpejtësi të habitshme.

- Jashtë! Jo tani! prit, kur të thërrasin!... Ç'ma sollën para kohe? - Nëpërdhëmbte e shfrynte i inatosur mos më keq, por edhe disi i çoroditur Porfiri Petroviçi. Nikollai pa pritur u lëshua në gjunjë.

- Ç'bën ashtu? - ulëriti Porfiri i befasuar.

- Unë jam fajtori! Më kandisi qoftëlargu! Unë e vrava! - tha me drithmë në zë, duke gulçuar e duke u mbushur me vështirësi me fryme, por me zë të lartë të njeriut të vendosur.

Ra heshtja që zgjati nja dhjetë sekonda, të gjithë qëndronin të shtangur nga habia, madje edhe roja zuri të zbythej drejt derës.

- Ç'thua kështu? - i bërtiti Porfiri Petroviçi, që i pari e mposhti atë gjëndje shtangieje.

- Unë... i vrava... - përsëriti Nikollai.

- Si ti?... Ç'thua kështu?... Cilin paske vrarë?...

Dukej sheshit që Porfiri Petroviçi e kishte humbur fare toruan.

Nikollai heshti një hop, pastaj tha:

- Alena Ivanovnën dhe të motrën, Lizaveta Ivanovnën unë... i vrava...me sëpatë. M'u errësua mendja... - shtoi dhe përsëri heshti. Tërë këtë kohë vazhdonte të rrinte në gjunjë.

Porfiri Petroviçi qëndroi disa çaste i menduar, pastaj u bëri shenjë atyre që ishin dyndur te dera të largoheshin. Këta u zhdukën dhe dera u mbyll. Hodhi shpejt e shpejt shikimin në qoshen ku qe strukur Raskolnikovi dhe shihte me sy të shqyer, fare i fandaksur Nikollain, bëri t'i afrohej, por befas ndali, e peshoi me sy nga koka deri te këmbët, u kthye vrulltas për nga Nikollai, e pa si të donte ta përpinte, u kthye përsëri nga Raskolnikovi dhe, më në fund, iu sul i xhindosur Nikollait.

- E ç'hyre kështu si i lojtur; as aq mendje nuk ke sa të durosh të hysh kur të thërrasin! - i bërtiti. - Kush të pyeti, more, që përgjigje? Por meqë hyre, hajt, fol, ti je vrasësi?

- Unë jam... e pranoj me gojën time... - tha shkoqur dhe i vendosur Nikollai.

- E-eh! Po me se e vrave? Hë, fol!

- Me sëpatë. E kisha fshehur.

- Ngutet zavalli! Vetëm ishe?...

- Po, vetëm. Mitja nuk ka asnjë faj, nuk ka gisht në këtë punë.

- Po mos u ngut të flasësh për Mitjen. E-eh!

- Po shkallët si, me vrap i zbrite? Juve ju panë të dy rojtarët e shtëpisë.

- E bëra për të humbur gjurmët, me Mitjen prandaj vrapova... - foli me ngut si të thoshte ndonjë mësim të mësuar që më parë.

- Duket ajo! Nuk po thotë të vërtetën! - mërmëriti si duke folur me vete Porfiri dhe ia qepi shikimin depërtues Raskolnikovit.

Ishte kaq i zënë me Nikollain dhe e kishte humbur aq keq toruan, saqë kishte harruar fare që aty ishte Raskolnikovi. Kur e pa tani, u turbullua...

- Rodion Romanoviç, i nderuar! Më falni! - tha dhe u derdh për nga ai. - Nuk duhej të ndodhte kështu... Ju nuk kini më punë, ju lutem... Se edhe unë vetë po habitem... Çudi e madhe është kjo...

E kapi nga krahu dhe e tërhoqi drejt derës.

- Nuk e prisnit, domethënë! - i tha Raskolnikovi, i cili edhe vetë nuk po e kuptonte arsyen e kësaj që ndodhi, por ama tanimë i kishte ardhur zemra në vend, ishte shkrifur.

- Po as ju, mor byrazer, nuk e prisnit! Ja si ju dridhen duart.

- Po edhe ju po dridheni, Porfiri Petroviç!

- Po, edhe unë; nuk e prisja!

Ndalën te dera. Porfirit s'po i pritej që ky të largohej.

- Po puna e surprizës, si? A nuk do ma bëni? - ia përplasi në fytyrë Raskolnikovi.

- Për të folur, flet, por, ama, dhëmbët të sokëllijnë! He! He! E keni në majë të gojës shpotinë!

- Të mirë u pafshim!

- Si të bëj emër Zoti! Janë punët e Zotit këto! - mërmëriti Porfiri Petroviçi dhe turinjtë iu shtrembëruan nga një palo buzëqeshje.

Kur po kalonte para zyrave, vuri re që të gjithë kishin ngritur kokën dhe po e shihnin. Në dhomën e pritjes, mes njerëzve që prisnin radhën, i zuri syri dy rojtarët që kishte takuar atëherë. Nuk i kishte zbritur mirë shkallët, kur dëgjoi zërin e Porfiri Petroviçit që po e thërriste. U kthye dhe e pa që po vraponte ta kapte.

- Edhe një fjalë, Rodion Romanoviç, e kam fjalën tek ajo si të bëjë

emër Zoti... Rregullat e duan që t'ju marrë në pyetje... Do shihemi përsëri, ja se çfarë...

Qëndroi para tij me trupin gargi dhe me buzën në gaz.

- Kështu, de! - shtoi.

Dukej që donte të thoshte dhe diçka tjetër, por nuk po i dilte që nuk po i dilte nga goja.

- Për çka ndodhi, ju kërkoj falje, Porfiri Petroviç. U nxeha cazë atje në zyrë... - i tha krejt i qetësuar dhe iu duk vetja si me flatra, ndjente një dëshirë satanike për t'ia fërkuar mirë e mirë me limon turiçkat këtij njeriu!

- Nuk ka gjë, jo! - ia ktheu gëzueshëm Porfiri Petroviçi. - Se edhe unë... helm e kam atë të shkretë gjuhë! Por ama më pas pendohem! Vërtet që pendohem! Do shihemi përsëri! Në bëftë emër i madhi Zot, do shihemi shumë bile!

- Dhe do ta njohim përfiundimisht shoshoqin? - jo pa shpoti e pyeti Raskolnikovi.

- Po, po! Do ta njohim përfundimisht shoshoqin! - i mbajti ison Porfiri dhe e pa me sy të picërruar e dashakeqë. - Po shkoni në ditëlindje, apo jo?

- Jo, në varrim.

- Ah, po! Në varrim! Dhe kujdes shëndetin, shëndetin kujdes...

- Ndërsa unë nuk di ç't'ju uroj! - s'e la pa përgjigje Raskolnikovi që tanimë kishte filluar të zbriste shkallët, por që u kthye përsëri nga Porfiri. - Ju uroj sukses, veç dhe vetë e shihni ç'detyrë qesharake që keni!

- E pse qesharake? - e mprehu sakaq dëgjimin ky, që po ashtu i kishte kthyer krahët dhe po kthehej në zyrë.

- Po ja, mjeranin Nikollai e paskeni torturuar dhe munduar në atë farë feje psikologjikisht, me ato mënyrat tuaja, saqë u detyrua ta pranonte. Natë e dite ia paskeni mbufatur trutë me nxitje: "Ti je vrasësi! Ti je vrasësi!...". Tani që e pranoi, do ketë një avaz tjetër, do t'ia merrni shpirtin duke i yshtur: "Gënjen! Nuk je vrasësi! Ti nuk mund të jesh vrasësi! Nuk je duke thënë fjalët e tua!" E si të mos e quash qesharake një detyrë të tillë?

- He! He! He! E paskeni ngulitur mirë në mendje atë që sapo i thashë Nikollait: "Nuk jeni duke thënë fjalët e tua!"

- E pse të mos e ngulis?

- He! He! Mendjemprehtë jeni! Shumë mendjehollë! S'ju shpëton asgjë! Brisk e keni atë të shkretë gjuhë! Ju pelqen shumë shpotia! He! Thonë se ndër shkrimtarët tanë Gogoli e ka të zhvilluar në shkallën më të lartë këtë lloj gjuhe!...

- Po, Gogoli.

- Ashtu, pra, Gogoli... Takim të këndshëm...

Raskolnikovi u kthye drejt e në dhomën e tij. Ndjente një raskapitje dhe këputje aq të madhe, nervat i kishte aq të acaruara, fare të çaprashitura, saqë nja një gjysëm ore mezi e mori veten; rrinte ulur në divan. Nuk mendonte fare për fatin e Nikollait, ishte shumë i befasuar nga kjo rrjedhë që morën ngjarjet; dukej sheshit që kishte ndodhur diçka e çuditshme, e pashpjegueshme. Pranimi ishte fakt, veç dhe ç'do ta pasonte, e kishte të qartë: gënjeshtra i ka këmbët e shkurtëra! Do t'i ktheheshin pa një, pa dy! Kur ndërmendi në vija të trasha skenën me Porfiri Petroviçin te shkallët, s'kishte si të mos i dridhej zemra nga tmerri. Sigurisht, nuk ishte në dijeni të drakulakeve të tij, s'mund t'i parashikonte hesapet që ky njeri kishte bërë, por disa gjëra tanimë i kishte të qarta dhe ishte i vetëdijshëm për pasojat e pritshme. Edhe pak dhe mund ta kishte zbuluar veten; Porfiri, duke ia njohur karakterin, po vepronte i vendosur. E dinte që me qëndrimin e mbajtur e kishte kompromentuar veten, por fakte kundër tij ende nuk kishte, çdo gjë ishte relative. A thua të kishte në dorë ndonjë gjë të rëndësishme ai njeri? Vërtet vdekjeprurëse mund të ishte për të surpriza që i kishte përgatitur Porfiri Petroviçi? Po sikur t'i kishte ardhur fundi?

Hetuesi i kishte folur me karta të hapura (kështu të paktën i dukej Raskolnikovit), po të kishte më, do t'ia kishte bërë të ditur. Po ai njeriu i djeshëm, si? Ku humbi ashtu? Në ka në dorë diçka konkrete, kjo patjetër lidhet me atë njeri!...

Rrinte ulur në divan me kokën varur, mbështetur mbi duar, me bërryla mbi gjunjë. Të dridhurat s'po i largoheshin. Më në fund u ngrit, mori kapelen dhe u zgjat të hapte derën. Thoshte me vete që të paktën kjo e sotmja kishte për të qenë një ditë e qetë. Iu ngroh pakëz zemra; iu kujtua se duhej nxituar për te Katerina Ivanovna. Në varrim, ishte e qartë, ishte vonuar, por në drekën e përshpirtjes arrinte, atje

do të shihte Sonjën. Qëndroi i menduar dhe një buzagaz të dëshpëruari ia përshkoi fytyrën.

- Sot! Sot! - ia përforcoi mendimin vetes. - Kështu duhet!

Po bëhej gati të dilte, kur vuri re që dera po hapej vetë. U drodh nga befasia dhe bëri prapa. Dera u hap ngadalë dhe pa zhurmë, pastaj u duk njeriu: ishte ai i djeshmi, sikur kishte dalë nga dheu.

Qëndroi në prag, e pa Raskolnikovin drejt në sy, bëri një hap për në dhomë. Ishte njëlloj si dje: po ajo paraqitje, po ajo veshje, veç shprehja e fytyrës dhe e shikimit nuk ishin të djeshmet. E shihte si gjynahqar, qëndronte krahëlëshuar, psherëtiu. Po të kishte vënë pëllëmbën e dorës në faqe dhe po të anonte pak kryet, do të ngjante tëpkë si grua.

- Ç'dëshironi? - e pyeti Raskolnikovi, të cilit i kishte vajtur gjaku në fund të këmbëve.

Njeriu nuk iu përgjegj, vetëm iu përkul deri në tokë; e preku tokën me myhyrin e dorës së djathtë.

- Ç'është kjo kështu? - thirri Raskolnikovi.

- Ju kërkoj ndjesë! - shqiptoi me zë të ulët njeriu.

- Për çfarë?

- Për mendimet e liga.

Ia kishin qepur shikimin shoshoqit.

- Më ka tronditur shumë atëherë ardhja juaj; kushedi i dehur ishit; bojaxhinjtë i kishit pyetur për punën e gjakut; më erdhi plasje që ju lanë të iknit, ju morën për të dehur. Dhe aq shumë u dëshpërova, sa s'po gjeja dot prehje, gjumi natën nuk më zinte. Jua gjeta adresën, erdha e pyeta kush jeni...

- Kush erdhi? - e ndërpreu Raskolnikovi, duke ndërmendur diçka.

- Unë erdha, domethënë ju kam fyer.

- Ju i asaj shtëpisë atje jeni?

- Po, isha bashkë me ata atë natë, s'ju kujtohem? Aty pranë kemi dyqanin, jemi zejtarë peliçesh...

Raskolnikovit i doli para syve skena te hyrja e apartamentit te plakës, tri ditë pas ngjarjes, iu kujtua që përveç rojtarëve, ishin edhe disa qytetarë, kishte edhe gra. Iu ndërmend zëri që tha ta çonin në polici, i kujtohej fytyra e atij njeriu, iu kujtua gjithashtu që i kishte kthyer përgjigje.

Ja dhe fundi i atij tmerri çmeritës që kishte provuar dje. Për pak sa s'e kishte marrë në qafë veten nga kjo rrethanë fare mizerabël. Pra, Porfiri nuk kishte në dorë as dhe një fakt kundër tij! Mbetej vetëm përçarti dhe psikologjizmi me dy presa, konkrete asgjë nuk ka! E ç'mund t'i bëjnë? Ç'akuza mund t'i ngrejnë? As për të arrestuar nuk kanë si e arrestojnë...

- Ju ia paskeni thënë Porfirit... që kisha ardhur tek apartamenti i plakës? - e pyeti i pushtuar sakaq nga një ide e re.

- Cilit Porfiri?

- Hetueist të policisë.

- Po, unë. Rojtarët e kaluan në heshtje, kurse unë vajta e i tregova.

- Sot?

- Pak para se të vinit ju. Ato që biseduat, i dëgjova prapa derës, ua mori shpirtin.

- Del që ju paskeni qenë ajo "surpriza"? Po si ju ndodhi? Të më falni për pyetjen.

- Po ja, rojtarët nuk donin të paraqiteshin e të njoftonin, është vonë, thanë, do ndizet me inat. I vajta të nesërmen, por nuk e gjeta, sot më lejuan të hyja. I tregova ç'ndodhi atë natë; vente e vinte nëpër dhomë, rrihte gjoksin me grusht: "Ç'paskeni bërë, mor cuba? Pse nuk erdhët? Do t'ia kishe hedhur në vend prangat!". Doli, thirri dikë, diç pëshpëritën në një qoshe; pastaj m'u kthye përsëri, më pyeste e më shante, varavingat nëpër dhomë nuk i pushoi, edhe gjoksit vazhdonte t'i binte me grusht. E njoftuan për ardhjen tuaj, më tha të prisja prapa derës, vetë me dorën e tij ma solli karrigen, asnjë zhurmë, më porositi. Derën e mbylli me kyç. "Do më duhesh! - më tha. - Do të lajmëroj unë, kur duhet të hysh!".

- Po Nikollain, e mori në pyetje, kur ishit ju?

- Jo. Pasi ju lëshoi ju, më lëshoi edhe mua. Nikollain e mbajti.

Zejtari u përkul përsëri dhe përsëri preku tokën me mëhyrin e dorës së djathtë.

- Për ligësinë që tregova dhe për spiunimin që bëra, të më falni.

- Qofsh i falur nga i madhi Zot! - ia ktheu Raskolnikovi. Zejtari u përkul edhe një herë, por kësaj radhe lehtë, u kthye ngadalë dhe doli nga dhoma.

"Thikë me dy presa janë këto që po më ndodhin!" - tha me vete

dhe me hap të sigurt, disi i shpenguar nga makthi dhe emocionet, duke u mbushur lirisht me frymë, doli nga dhoma.

"Do të ndeshemi mor zoti hetues!" - nëpërdhëmbi, në trup i kaluan mornica, të dridhura nevrastenie. Doli dhe zbriti shkallët. I vinte inat me veten, i skuqej faqja nga marazi për "shpirtvogëlsinë" që kishte treguar.

Pjesa e pestë

I

Kur u zgjua në mëngjesin e ditës tjetër, pas bisedës me Dunjeçkën dhe Pulheria Aleksandovnën, Pjotër Petroviçi zu t'i shihte me një sy tjetër marrëdhëniet me to. Atë që i ndodhi mbrëmjen e shkuar tani po e shihte si diçka reale, aspak jo të pamundur. Brenga e sedrës së sëmbuar i rëndonte plumb në zemër; u çua vrulltas nga shtrati, e pa veten në pasqyrë, nëse i kishte vërshuar jashtë tërë vreri dhe mllefi që i zjente përbrenda, u bind që çdo gjë në paraqitjen e jashtme ishte si s'kishte më mirë, dhjami ia kishte shtruar lëkurën dhe fryrë tiparet, ngjyra qumësht e bardhë e lëkurës e tregonte më të ri nga ç'ishte, shprehja fisnike nuk i ishte cënuar; tha me vete se fare lehtë mund të gjente një nuse tjetër, madje edhe më të mirkë, por aty për aty i thirri mendjes, pështyu inatçor, çka shkaktoi buzagazin qesëndisës të shokut të dhomës Andre Semionoviç Lebezjatnikovit. Pjotër Petroviçi këtë e pikasi dhe ia ruajti në xhep; dinte ai si ia kërkonte e me çfarë çmimi ia merrte shpagimin. I mbante në xhep edhe sa e sa fyerje të tjera, të shkaktuara kohët e fundit. E qortoi veten që qe treguar i pakujdesshëm dhe i kishte treguar, madje, edhe hollësi për atë që i ndodhi mbrëmë. Ishte ndodhur bosh, e pat rrëmbyer pasioni... Mëngjesi e priti me shumë terse: në Senat seç kishte një ngatërresë me çështjen që ndiqte me aq përkushtim, ia ngriti keq nervat edhe pronari i apartamentit që po gatiste për dasmën, gjermani i mallkuar jo vetëm që po ia merrte shpirtin, duke kërkuar deri në një respektimin e kontratës, por i shtoi edhe detyrimin e pakuptimtë për mobiljet, të cilat ende nuk i kishte blerë. "Po pse m'u sosën, vallë, të gjitha shpresat? Pse a nuk duhet ndërmarrë edhe një tjetër tentativë pajtimi?" - tha me vete. I theri në zemër, kur mendoi se do qe i detyruar të hiqte dorë nga Dunjeçka. E

ndjente veten si rrallë herë keq, po të gjente ndonjë mënyrë për ta hequr qafe Raskolnikovin, Pjotër Petroviçi nuk do ngurronte ta vinte në jetë.

"Sa gabim bëra që nuk u dhashë ndopak para! E ç'më hipi tërë kjo kopraci! Punë pa mëndje kjo imja! Thashë t'i lija në ditë të hallit, të katandiseshin në atë farë feje, që të më shihnin si shpëtimtarin, ashtu siç shohin perëndinë. Kurse ato... Ptu!... Po t'i kisha dhënë nja një mijë e pesëqind rubla, për pajën dhe në formë dhuratash, ndryshe do t'i kisha patur tani punët... Do rriteshin detyrimet, do forcoheshin lidhjet. S'do mundnin të më kundërshtonin aq lehtë. Se të m'i kthenin, s'kishin si, të largoheshin pa m'i kthyer, nuk do t'ia lejonin vetes. "Si ta zbojmë, kur është treguar aq bujar me ne", - do thoshin. Hm!... U ndodha bosh! Kërciti inatçor dhëmbët, me gjuhën e vogël e quajti veten dritëshkurtër... Kujdes, nuk duhej ta dëgjonte kush.

Kur u kthye në dhomë pas punëve të ditës, përbrenda po i gërricnin macet. Ia larguan pak mendjen përgatitjet që po bëheshin për drekën e përshpirtjes në dhomën e Katerina Ivanovnës. Iu kujtua që e kishin ftuar edhe atë. Tani ende nuk ishin kthyer nga varrimi, për ta përgatitur sa më mirë tryezën, kujdesej vetë zonja Lipevehzel. Iu afrua dhe e pyeti, kjo i tha që ishin të ftuar thuajse të gjithë qiraxhinjtë, ndër ta edhe ai me Lebezjatnikovin, pavarësisht nga zënia që ky i fundit kishte patur me Katerina Ivanovnën. Pjotër Petroviçin mezi e prisnin, binte të ishte i shquari i tryezës. Edhe ajo Amali Ivanovna, kishte qenë e ftuar, pavarësisht nga grindjet dhe kacafytjet e vazhdueshme që kishte patur me qiraxheshën. Përgatitjen e drekës po e bënte me kënaqësi, kishte veshur rrobe të reja, por edhe duke respektuar ditën e përmortshme. Tërë qënia e saj rrezatonte krenari. Atë çast Pjotër Petroviçit i lindi një mendim: u kthye në dhomë, domethënë në atë të Lebezjatnikovit. Puna ishte se ndër të ftuarit i zuri veshi edhe emrin e Raskolnikovit.

Atë ditë Andre Semionoviç Lebezjatnikovi nuk kishte dalë fare nga dhoma. Pjotër Petroviçi ishte në ca marrëdhënie të çuditshme me këtë njeri: e përbuzte dhe e urrente, por edhe ia kishte frikën. Qe strehuar tek ai jo vetëm për të kursyer, kjo, sigurisht, që ishte arsyeja kryesore, por edhe ngaqë për këtë djalosh kishte dëgjuar të flitej si për një progresist me ndikim të fuqishëm në disa qarqe të caktuara.

Lajmi e kishte tronditur. Prej disa kohësh se përse u trëmbej këtyre rretheve, që, të tëra i dinin dhe të tëra i përbuznin, i sikterisnin: ç'është e vërtetë, ishte një frikë e papërcaktuar. Në provincë nuk kishte si e kristalizonte realisht përfytyrimin për rrethe të tilla; kishte dëgjuar për ca progresistë, nihilistë, anarkistë e gjithfarë istësh të tjerë petërburgas, por, ashtu si shumëkush, i zmadhonte dhe i frynte jashtë reales mendimet dhe bëmat e tyre. I trëmbej sidomos prirjes demaskuese të tyre, ia cyste keq nervat kjo prirje. Meraku iu rrit sidomos kur po bëheshin orvajtjet për t'u transferuar në Petërburg. Ishte i trëmbur, siç trëmben fëmijët. Në fillim të karrierës, atje në provincë, ishte njohur me dy nga këta demaskues, njerëz me peshë, këta e kishin mbajtur afër. Njëri qe përzier në një skandal, kurse tjetri ishte ngatërruar në ca telashe edhe më serioze. E pati vënë vath në vesh këtë dhe e kishte prerë mendjen, që me të ardhur në Petërburg, do ta nuhaste mirë se ç'përfaqësonin progresistët; t'u dilte punëve përpara dhe, po ta shihte të udhës, të afrohej me këta "përfaqësues të brezit të ri". Shpresat i kishte mbajtur te njohja që kishte patur dikur me Andre Semionoviçin; kur shkoi atëherë te Raskolnikovi, kishte arritur ta përvetësonte aftësinë për të perifrazuar ca fraza tepër të rrahura...

Shumë shpejt u bind që Andre Semionoviçi ishte një njeri shpirtvogël dhe fare mediokër, i rëndomtë. E pavarësisht nga kjo, e kuptoi që shqetësimi dhe meraku i mbetën. Për doktrinën dhe sistemin që fliste Andre Semionoviçi as që donte të dinte, kishte disa pikësynime të vetat, kur e zhbironte si i vinin punët, ç'forca kishin këta njerëz. Donte të bindej në u duhej patur frika dhe në ç'shkallë, a do t'i vërsuleshin në rast se ai vetë do ndërmerrte ndonjë veprim, ç'veprime i kishin më për zemër dhe, kryesorja, ç'duhej të bënte që t'ua merrte anën, si t'ua shkonte ujët nën rrogoz, nëse vërtet ishin të fuqishëm; duhej apo nuk duhej bërë diçka e tillë, a i jepte dorë karrierës...

Andre Semionoviçi ishte një ngordhalaq që vuante nga stërkungulli, një shkurtabiq kullash që të çudiste me verdhësinë e flokëve, me ca baseta si qofte, me të cilat mburrej shumë. I dhimbnin gjithmonë sytë. Ishte natyrë zemërbuti, por fliste me vetëbesim të çuditshëm që kufizonte me fodullëkun, kjo e bënte të dukej qesharak, sepse ishte xhuxh njeri. Amalia Ivanovna e nderonte shumë: nuk pinte dhe qiranë e paguante në rregull. Ishte nga ata çapaçulët dështakë, të cilët me

rastin më të parë iu bashkëngjiten legjioneve të meraklinjve për idetë e modës, këta i banalizojnë ato, i shndërrojnë në karikatura, ndonëse u qëndrojnë besnikë, u shërbejnë me sinqeritet e përkushtim.

Ndonëse ishte njeri zemërmirë, Lebezjatnikovit kishte disa kohë që i qe bërë i padurueshëm Pjotër Petroviçi e përsëri vazhdonte t'i bënte strehë. Edhe tjetri po këto ndjenja provonte. Lebezjatnikovit i kishte rënë era që Pjotër Petroviçi donte t'ia hidhte. "Nuk është njeri për të qënë", - thoshte me vete. Provoi t'i shtjellonte sistemin e Furiesë dhe teorinë e Darvinit, por mysafiri, sidomos kohët e fundit, e dëgjonte me rezervë dhe mezi gjente rastin që ta vinte në lojë, madje edhe ta shante. I kishte rënë hiles që Lebezjatnikovi nuk kishte lidhje me njerëz të rëndësishëm, se ishte i trashë dhe leshko, vetëm përsëriste mekanikisht ato që qarkullonin andej-këndej, madje dhe këtë nuk e bënte si duhej. "E ç'demaskues mund të jetë një i tillë?" - thoshte me vete. Kur dëgjonte ta mburrnin, Pjotër Petroviçi shkrihej nga kënaqësia, por heshtte dhe nuk ndihej përsërgjalli kur Lebezjatnikovi i bënte thirrje të ndihmonte në krijimin e "komunës" në rrugën "Meshanskaja", apo e porosiste të mos e pengonte Dunjeçkën të zinte dashnor që muajin e parë të martesës, apo të mos i pagëzonte fëmijët, etj., etj. Lavdërimet që i bëheshin Pjotër Petroviçit i pranonte, kurse ato, me të cilat nuk ishte dakord, i kalonte në heshtje.

Pjotër Petroviçi u ul të numëronte paratë që i kishte tërhequr atë mëngjes, Andre Semionoviçi, që kurdoherë i kishte bosh xhepat, vente e vinte nëpër dhomë, i shkëlqenin sytë kur i shihte, por shtirej moskokëçarës. Pjotër Petroviçi nuk kishte si besonte kurrsesi që Andre Semionoviçi mund t'i shihte shpërfillës paratë, kurse ky, nga ana e vet, mendonte i pezmatuar që miku i tij vërtet ashtu mendonte dhe i bëhej qejfi që po ia guduliste pakëz nervat, duke i rreshtuar mënge mbi tryezë tufat me kartmonedha, duke ia qokur nulitetin, por edhe duke ia vënë gardhin te thana.

Andre Semionoviçi me pasion e zell po i shtjellonte mysafirit problemet që vetë i kishte më për zemër rreth temës: "Komuna e re në veprim". Vërejtjet dhe kundërshtimet e Pjotër Petroviçit, të shoqëruara nga qësendia dhe shpotia, "humani" Andre Semionoviç i mori për rrjedhojë të humorit të keq pas ndodhisë së mbrëmshme te Raskolnikovët dhe mezi priste që ky t'i hapej edhe në këtë temë, kishte

edhe ai për t'i thënë diçka progresive, parimore, e, ku i dihej, ndoshta dhe e ngushëllonte sado pak "mikun e nderuar", duke kontribuar kështu në zhvillimin e tij të mëtejshëm.

- Po dreka që po shtron vejusha, ç'është? - e pyeti befas Pjotër Petroviçi, duke ia ndërprerë arsyetimet në vendin më delikat.

- Sikur nuk e dini, ju tregova dje dhe jua parashtrova edhe mendimin që kam lidhur me këto zakone... Ju ka ftuar edhe ju. Fola dje me të.

- Nuk e prisja që kjo bibë t'i shpenzonte ato pak para që mori nga ai marroku, Raskolnikovi, për këtë drekë... U habita kur pashë të shtronin dhe pije e më the të thashë... Një dreq e merr vesh ç'bëhet! - Këtë e shtoi me synimin për të dalë diku. - Si? Thatë që më ka ftuar edhe mua? Nuk kam ndër mend të vete. E ç'ne? Dje i fola, ashtu kalimthi, për mundësitë e një asistence sociale, si vejushë me bonjakë të mitur që është. Them që prandaj më ka ftuar! He! He!

- As unë nuk kam ndër mend t'i vete, - tha Lebezjatnikovi.

- S'keni sy e faqe! Me duart e tuaja i fundosët! S'ka si të mos ju vras ndërgjegja! He! He! He!

- Kush i paska fundosur? Cilin? - u kreshpërua i kuq flakë në fytyrë Lebezjatnikovi.

- Ju, po kush! Katerina Ivanovnën! Nja një muaj të shkuar! Dje ma treguan. Bindjet e kanë fajin, ja si katandiset i gjori njeri prej tyre... Çështja femëror... He! He! He!

Uli kokën dhe vazhdoi të numërojë paratë.

- Gënjeshtra, shpifje janë... - thirri Lebezjatnikovi që sikur i ra tavani kur dëgjoi ato fjalë. - Nuk është aspak e vërtetë, ju kanë gënjyer, thashetheme janë! Unë vetëm sa u mbrojta, asgjë më tepër... Ajo m'u sul me thonjë dhe më gërrici fytyrën, më shkuli basetat... Gjithsecili ka të drejtë të mbrohet, të verë në vend nderin... Kërkënd nuk kam si e lejoj që të më dhunojë! Jam kundër dhunës në parim, jam kundër prepotencës e despotizmit. Pse ju si thoni: ta bëja sehir? Vetëm sa e largova nga vetja dhe kaq.

- He-he-he! - vazhdoi të qeshte me ligësi Lluzhini.

- E shoh që doni të m'i ngrini nervat, ngaqë ju gërricin macet përbrenda. Asnjë lidhje nuk ka ajo që më ndodhi me problemin femëror. I kuptoni dhe i gjykoni mirë gjërat. Për mendimin tim, meqë

pranohet që gruaja është e barabartë me burrin, duke përfshirë edhe forcën fizike (se kështu thonë, de!) duhet që edhe ky rast si i tillë të shihet. Vetëm më pas u thellova dhe arrita në përfundimin që në shoqërinë e ardhshme nuk do të ketë më kacafytje, rrahjet si të këtilla vetvetiu do ta humbin kuptimin. Pra, as barazinë nuk kemi pse e kërkojmë. Nuk jam aq i trashë sa më pandeh! Kurse për të shkuar nuk dua për një arsye tjetër: edhe pështpëritjet janë paragjykime si të tjerat. Por me të parë, me të bërë, mund edhe të vete... Për gallatë! Ç'e do që nuk do të jetë prifti, po të kishte qenë, do shkoja pa një pa dy...

- Kësaj i thonë të hash bukën e të përmbysësh kupën!

- Do shkoja në shënjë proteste! Me qëllime dobiprurëse do t'i jepja dorë progresit, zhvillimit. Hidhet fara për filiza të rinj. Nuk kanë pse fyhen, fare shpejt do bindeshin që e bëra për të mirën e tyre. Se ja, folën e ç'nuk thanë për Terebjovën (ajo tani është anëtare e komunës), që iku nga familja dhe zuri të jetojë jetën e saj... që i shkroi prindërve se s'donte të rronte e rrethuar nga paragjykime, donte të lidhej me martesë qytetare. E qortuan për qëndrimin e prerë që mbajti, se duhej sjellë me takt. Për mendimin tim, takti s'ka punë fare këtu, në duhet protestuar sa më ashpër më mirë. Ato që thonë gjepura janë. Ose Varenci që jetoi shtatë vjet me të shoqin dhe pastaj e braktisi së bashku me dy fëmijët. Në letrën qe i bënte shkruante: "E kuptova që nuk mund të jem e lumtur me ju. S'mund t'jua fal që më keni gënjyer, duke ma fshehur që ekzistoka një tjetër ndërtim shoqëror, ai i komunës. E mësova nga një shpirtmirë, atij dhe iu dhashë, së bashku do ta ndërtojmë komunën. Jua them troç: e gjej të pandershme t'ju mashtroj. Bëni si të doni. Mos shpresoni më në kthimin tim. Qofshi i lumtur!" Hë, po për këtë ç'thua?

- Terebjova mos është ajo që e ka të tretën martesë qytetare këtë të tanishmen?

- Me tamam e ka të dytën, po le ta ketë makar të katërmbëdhjetën, gjepura janë të gjitha! Më vjen keq që nuk i kam prindët, se po t'i kisha, nuk do rrija pa ua veshur me protestën time... E kush jam unë? "Një ashkël e flakur tej jam!"

- Vetëm do habisje dynjanë! He! He! Po, nejse, qoftë ashtu si thoni ju... Pa dëgjoni këtu njëherë; të bijën e të ndjerit nëpunës e njihni? Ju pyes për atë përcëllaken aguridhe! E vërtetë është ajo që flasin bota

për të?

- E pastaj? Për mendimin tim, ajo e saj është një gjendje normale e gruas, *Distinguons!*[1] Gjendja e asaj vajze në shoqërinë e sotme nuk është diçka normale, sepse kjo shoqëri është e përdhunuar, në shoqërinë e ardhme po, sepse ajo është e lirë. Veç edhe tani ajo e gëzon një të drejtë: vuajtjen! Këtë kapital nuk ia diskuton kush! Në shoqërinë e ardhshme ai është i panevojshëm, çështja do zerë vendin që i takon, legjitim dhe normal. Veprimet e Sonja Semionovnës, për mendimin tim, janë mishërim i protestës energjike kundër rendit shoqëror dhe për këtë e respektoj thellësisht, ma gëzon syrin kur e shoh.

- Më kanë thënë që për shkakun tuaj janë duke e zbuar.

Lebezjatnikovin e xhindosën këto fjalë.

- Shpifje, shpifje janë të gjitha! - ulëriti. - S'është e vërtetë! E trilloi me imagjinatën e saj Katerina Ivanovna, si nevrike që është. Unë vetëm desha ta zhvillojë, t'i fus në shpirt protestën..: Vetë ka thënë që s'ka si qëndron më këtu.

- Deshët ta futnit në komunë?

- E shoh që paskeni qejf të talleni, veç po e bëni pa lezet! Në komunë role si ky i saj mungojnë dhe do të mungojnë; madje ajo ndaj dhe po ngrihet, që të mos ketë më role të tillë. Në komunë ky rol do ta ndryshojë thelbin e vet, ajo që tani është marrëzi, atje ka për të qënë mishërim mençurie; ajo që është e panatyrshme në rrethanat ekzistuese, atje do jetë në vendin e vet. Çdo gjë përcaktohet nga rrethanat dhe mjedisi ku rron dhe vepron njeriu. Rrethanat përcaktojnë gjithçka, njeriu është asgjë. Ne me Sonja Semionovnën qysh tani jemi miq të mirë, as në mendje nuk i shkon të më quaj poshtëruesin e as armikun e vet. Po. Po përpiqem ta afroj me komunën, veç mbi një tjetër bazë. E shoh që po qeshni! Ka mendime se duhet shtrirë platforma e veprimtarisë së komunës, kemi bërë, por duhet bërë edhe më shumë për krijimin e bindjeve, duke e fuqizuar mohimin. Sikur të ngrihej nga varri Dobrolubovi, do të hyja në një debat të gjatë me të, kurse Belinskin do ta hidhja me këmbë përpjetë! Tani për tani jam duke e zhvilluar Sonja Semionovnën. Ka një natyrë të mrekullueshme!

- Po si, a përfitoni ndopak nga ajo natyra e saj e mrekullueshme?

---

[1]) *Do të dallojmë (fr.).*

He-he!

- Jo, jo! Përkundrazi!

- Ama të besova që e the këtë? He! He!

- E pse më duhet ta fsheh, në është ashtu si pandehni ju? Me mua ajo tregohet e turpshme, madje e trëmbur.

- Dhe ju domosdo që po e zhvilloni... He! He! Po i mbushni mendjen që turpërimi është gjepur?...

- Aspak! Aspak! Sa i trashë që po tregoheni! Më falni t'ju pyes, a e kuptoni domethënien e fjalës zhvillim? O Zot! Sa larg kuptimit që duhet të jeni... Ne këmbëngulim që gruaja duhet të jetë e lirë. Për mua turpi dhe ndrojtja janë në vetvete të padobishme, janë thjesht paragjykime. Në marrëdhëniet me të, unë si turpin, si ndrojtjen i pranoj, sepse ky është vullneti i saj, është një e drejtë e saj që unë e respektoj. S'do mend, po të më thoshte: "Dua të jesh imi!" - do më gëzonte suksesi, si vajzë ajo më pëlqen, por deri më sot askush nuk është sjellë me të me aq mirësjellje e respekt, nuk ia ka çmuar dhuntitë si unë... Shpresoj dhe pres, vetëm kaq!

- Po bëjini ndonjë dhuratë. Jam i sigurtë që kjo nuk ju ka shkuar në mendje.

- Po më detyroni t'jua përsëris: ju gjë prej gjëje nuk kuptoni! Vërtet që gjendja e saj është mos më keq, por çështja shtrohet ndryshe. Duket qartë që e përbuzni, e merrni të veçuar faktin, e zhvishni tjetrin nga mundësia për ta parë një çështje nga këndvështrimi human. Ju as që mund ta kuptoni ç'natyrë ka. Për një gjë vetëm më vjen keq; kohët e fundit ka filluar të largohet nga librat, pastaj edhe pse është e vendosur dhe ka energji për të protestuar, ka filluar të japë shenja të mungesës së pavarësisë, është duke mohuar pak për të arritur të shkëputet përfundimisht nga paragjykimet dhe... marrëzitë. Por ca gjëra i kupton shkëlqyeshëm, bie fjala puthjen e dorës së gruas nga burri e quan fyerje, sepse thekson pabarazinë. Kemi bërë goxha debate në këtë temë, ia nxora në pah thelbin e çështjes. Edhe për bashkimin e punëtorëve francezë më dëgjoi me vëmendje. Tani jam duke i shpjeguar çështjen e hyrjes dhe të daljes së lirë të njerëzve në dhomat e shoshoqit në shoqërinë e ardhshme.

- Po kjo ç'na qenka?

- Po zien debati këto kohët e fundit: ka apo nuk ka të drejtë anëtari

i komunës të hyjë te tjetri në dhomë, grua apo burrë qoftë, në çdo orë të ditës e të natës... U vendos që ka...

- Po si, ajo apo ai në këtë kohë mund të merren me plotësimin e atyre kërkesave? He!

Adre Semionoviçi u inatos.

- Vetëm një avaz dini, aty u rri mendja, te plotësimi i atyre kërkesave... - i bërtiti dhe e pa tërë urretje. - Më vjen të pëlcas që kur e shtjellova çështjen e sistemit, ju zura ngoje edhe probleme që lidhen me plotësimin e ketyre të mallkuarave kërkesa. Është më delikatja dhe ca si ju i bjenë fyellit në një vrimë! Tfu! Po ja, po ju pyes juve, Pjotër Petroviç: "Ç'gjeni vallë të turpshme dhe të përbuzshme në gropat e gjirizit? Unë i pari jam gati t'i pastroj. Dhe jo se po bëj vetmohim, e shoh si punë të fisshme, të dobishme për shoqërinë, punë si gjithë të tjerat, në doni ta dini, që qëndron edhe më lartë se veprimtaria e Rafaelit dhe e Pushkinit, sepse është më dobiprurëse.

- Po, është edhe më fisnike! Më fisnike është! He! He!

- Ç'domethënë më fisnike? Nuk e kuptoj këtë përcaktim, kur është fjala për veprimtarine e njeriut. Përcaktime si këto, "më fisnike", "më e lartësuar" gjepura janë të gjitha! Kanë të bëjnë me paragjykimet që i urrej. Çdo gjë e dobishme për njerëzimin është dhe fisnike. Për mua ekziston vetëm një fjalë: e dobishme dhe kaq! Zgërdhihuni sa të keni qejf, por kjo kështu është!

Pjotër Petroviçi u gajas. E mbaroi numërimin e parave, i futi në xhep, por la dhe mbi tryezë. Çështja e "gropave të gjirizit" jo njëherë kishte qënë mollë sherrti ndërmjet tyre. Absurditeti vinte e theksohej ngaqë Andre Semionoviçi, nxehej me gjithë mend, ndërkohë që Lluzhini gajasej dhe fërkonte duart i kënaqur: sot po orvatej ta xhindoste fare.

- Jua flakëritën ca të ngrohta mbrëmë dhe doni ta nxirrni inatin te të tjerët, - ia përplasi më në fund Lebezjatnikovi i kuq flakë në fytyrë. E vinte shumë theksin në fjalët "pavarësi" dhe "shpirt proteste", por deri më tani nuk kishte guxuar t'i kundërvihej kësisoj Pjotër Petroviçit, ruante një farë distance me të, mbeturinë e marrëdhënieve të dikurshme.

- Bënit mirë të më tregonit se, - e ndërpreu me mendjemadhësi Pjotër Petroviçi, - ajo vasha a ju siguron që, po ta ftonit të vinte këtu, do ua dëgjonte fjalën? Më duket se u kthyen nga varrezat... Më duhet

të bisedoj me të.

- Për çfarë? - e pyeti i habitur Lebezjatnikovi.

- Kështu e kam një punë. O sot, o nesër do iki që këtu, desha t'i them dy fjalë... Dhe ju lutem të mos largoheshit gjatë kohës që do të jem duke biseduar. E ku i dihet ç'mund të flasin...

- Nuk kanë përse. Edhe unë ashtu kot ju pyeta. Në ju dashka, e thërresim. S'ka ndonjë zor. Po shkoj. Mos kini keq, nuk do ju pengoj.

Nuk kishin kaluar as pesë minuta dhe Lebezjatnikovi u kthye bashkë me Sonjën. Në fytyrë i qe fiksuar habia, mbahej e druajtur si zakonisht. Ishte një zakon që i kishte mbetur që nga fëmijëria. Pjotër Petroviçi i doli përpara "tërë mirësjellje" e "delikatesë", por edhe me një familjaritet të pafshehur, që fort mirë, sipas mendimit të tij, i shkonte një personi të nderuar dhe aq mirë të mbajtur siç ishte ai, në raport me një qënie njomëzake dhe në një farë kuptimi interesante, siç ishte ajo. Nxitoi "t'i jepte zemër", e uli në tryezë përkarshi vetes. Sonja e kaloi shikimin rreth e rrotull, pa Lebezjatnikovin, paratë mbi tryezë dhe i ngriti sytë në drejtim të Pjotër Petroviçit. Që nga ky çast nuk ia ndau më shikimin. Lebezjatnikovi iu drejtua derës, por Pjotër Petroviçi e ndali dhe e pyeti me pështpërimë:

- Raskolnikovi aty ishte?

- Ishte. E pse? Tani sapo erdhi, e pashë. Ç'e do?

- Ju lutem të qëndroni këtu me ne, mos më lini vetëm për vetëm me këtë... Dy fjalë do t'i them, ndërsa njerëzia kushedi ç'mund të mendojnë. Nuk dua që Raskolnikovi t'ua çojë lajmin atyre atje. Më kuptoni?

- Ju kuptoj, - iu përgjigj ky. - Është një e drejta juaj. Në u dashka, po rri. Veç, për mendimin tim, po e tepëroni me përkujdesjen. Sidoqoftë, qëndrimi im këtu është një e drejta juaj.

Pjotër Petroviçi zuri vend në divan, përkundruall Sonjës, e vështroi për disa çaste i qetë dhe sakaq mori pamjen e njeriut solid e serioz, madje disi edhe të rreptë. "Mos të të shkojë as në mendje, moj çupëzë!" - desh t'i jepte të kuptonte. Sonja u turbullua edhe më.

- Sonja Semionovna, ju lutem t'i transmetoni mamasë suaj fjalët e mia për mospjesëmarrjen... Se Katerina Ivanovna nëna juaj është? Në këmbë të nënës e keni?... - Zëri dhe shprehja, me të cilën u thanë këto fjalë, flisnin për synime nga më dashamiret të folësit.

- Po, në këmbë të nënës e kam, - u ngut të shpjegojë si me frikë Sonja.

- E pra, kërkojini ndjesë nga ana ime, që për shkak të disa rrethanave, të cilat nuk i kisha në dorë unë vetë, u detyrova të mos marrë pjesë në hidhërimin tuaj, duke u shtruar në drekën e përmortshme.

- Po vete t'ia them... që tani... - dhe Sonja u çua për të çuar në vend porosinë.

- Nuk kam mbaruar, - e mbajti Pjotër Petroviçi dhe nënqeshi kur e pa sa e paditur dhe e ngutur po tregohej. - Pak më njohkeni, Sonja Semionovna, në pandehët që ju shqetësova vetëm për një gjë aq pak të rëndësishme, aq më tepër që ju detyrova të vinit edhe këtu. Kam edhe diçka tjetër për t'ju thënë.

Sonja u ul, kartmonedha kaltëroshe, vetëtitëse ia lëbyri sytë, i hoqi shpejt dhe ia drejtoi Pjotër Petroviçit, iu duk turp e marre t'ia ngulte shikimin parave në atë gjëndjen e saj. Në fillim e nguli shikimin në gjyslykët e florinjtë të Pjotër Petroviçit, pastaj e kaloi te myhyri i bukur e i madh, me gur të verdhë, në gishtin e mezit, por e largoi vrulltas dhe nuk po dinte ku ta shpinte, bëri si bëri dhe ia qepi përsëri syve të tij. Pas një heshtjeje kuptimplote, ky vazhdoi:

- Ashtu kalimthi këmbeva dje dy fjalë me Katerina Ivanovnën. Janë më se të mjaftueshme për të kuptuar gjedjen e kundërnatyrshme në të cilën ndodhet, në mund të shpreheshim kështu.

- Po... të kundërnatyrshme, - nxitoi ta përforcojë Sonja.

- Të shpreheshim më thjesht e më kuptueshëm: të sëmurë.

- Po... të sëmurë.

- E pra, ndjenja humane dhe-e-e, si të thuash, mëshira, më shtynë t'i isha i dobishëm në ca çaste fatkeqësie si këto. Me sa di, kjo familje fare e këputur, i mban shpresat vetëm te ju...

- Më lejoni t'ju pyes, - i drejtua Sonja që brofi sakaq. - Mos keni qënë ju që i keni folur për punë pensioni? Më tha që kishit marrë përsipër të interesoheshit... E vërtetë është?

- Aspak! Vetëm sa e preka çështjen e ndihmës së përkohshme, të një farë asistence për vejushën e nëpunësit të vdekur, por, ku i dihet, në pranohet. Se, me sa jam në dijeni, prindi juaj nuk kishte plotësuar afatin e shërbimit, kurse këto kohët e fundit nuk ka shërbyer fare.

Ndaj dhe shpresat janë të vagullta, madje, po ta shohim me tamam çështjen, ato mungojnë krejtësisht... Ndërsa del që i paska varur të gjitha shpresat te pensioni, he, he, he! Zonja e shkathët!

- Po, te pensioni... Është e mirë ajo dhe ndaj i beson të mirës... nga kjo i vjen... Na falni! - i tha dhe përsëri u ngrit për t'u larguar.

- Po ju nuk më dëgjuat deri në fund.

- Vërtet, nuk ju dëgjova, - mërmëriti Sonja.

- Uluni, pra.

Sonja u hutua fare, u ul e shastitur.

- I njohur me gjendjen në të cilën ndodheni, i mbushur me mëshirën për vocërrakët, do të dëshiroja, siç e thashë, t'u isha i dobishëm, sigurisht, brenda mundësive të mia. Them se mund të shpallet një fushatë ndihme, të bëhet një llotari... ose diçka si këto, siç veprojnë rëndom në kësi rastesh të afërmit, por edhe të tjerë, duke dashur të ndihmojnë dikë. Këtë desha t'u them, ndaj dhe ju thirra.

- Mirë... Zoti ju bekoftë, - belbëzoi Sonja, duke e parë drejt në sy Pjotër Petroviçin.

- Gjë që bëhet... por për këtë më vonë... ndonëse mund të fillojmë edhe qysh sot. Në mbrëmje shihemi, e ndajmë përfundimisht llafin dhe i përvishemi punëve. Të jeni këtu rreth orës shtatë. Them se edhe Andre Semionoviçi do bashkëpunojë me ne? Veç nuk duhet harruar një rrethanë e rëndësishme, ndaj dhe ju shqetësova, Sonja Semionovna. Për mendimin tim, paratë e mbledhura nuk duhet të bjenë në dorë te Katerina Ivanovnës, e kemi tanimë një mësim, ja si i keqpërdori, duke shtruar këtë drekë. Se ajo nuk ka as për të ngrënë nesër, s'po flasim për veshmbathjen, dhe vete e ble rum, vodka, përgatiten meze dhe nxirret edhe kafe. I hodha kalimthi një sy asaj drekës. Tepërime janë. Më e mira e të mirave do ishte që mjeraneja vejushë të mos ishte fare në dijeni të parave. Duhet ta dini vetëm ju. Mirë them?

- Nuk e di. Ajo vetëm sot bëri kështu... është hera e parë. Donte shumë po shumë që ta nderonte kujtimin e atit tonë... Është shumë e mënçur ajo... Po ju si të doni... ju jemi shumë mirënjohës... Zoti jua shpërbleftë... Jetimët...

Sonja nuk mundi të vazhdonte, e mbytën dënesat.

- Ja, këtë shumë të vogël, me sa kam mundësi, jua jap për vejushën. Ju lutem vetëm për një gjë: emri im të mos përmendet, kur t'ia jepni.

I ndodhur vetë para disa detyrimesh të kushtueshme, nuk munda më tepër.

Pjotër Petroviçi i zgjati Sonjës një kartmonedhë dhjetërubëlshe, pasi e hekurosi me dorë mirë e mirë paraprakisht. Sonja e mori flakë në fytyrë, u çua për të satën herë brenda aq pak çastesh, diç belbëzoi dhe iu përkul nguturazi. Pjotër Petroviçi me një pamje solemne e përcolli deri te dera. Vajza doli nga ajo dhomë tepër e emocionuar dhe e vrarë shpirtërisht, shkoi te Katerina Ivanovna me një brengë të madhe në zemër.

Tërë këtë kohë, Andre Semionoviçi herë pati qëndruar te dritarja, herë pati bërë ecejake nëpër dhomë; kur doli Sonja, iu afrua Pjotër Petroviçit dhe me një pompë të pazakontë i zgjati dorën.

- I pashë dhe i dëgjova të gjitha, - i tha. - Akt i lartë fisnikërie, desha të them, akt humanitar! Bëtë çmos që t'i shmangnit falënderimet, e vura re! Edhe pse në parim nuk mundem ta mbështes bamirësinë private, sepse ajo jo vetëm që nuk e çrrënjos të keqen, por e ushqen atë, prapë se prapë, nuk kam si të mos e pranoj se aktin që bëtë e miratoj plotësisht! Po, po, më pëlqeu jashtëzakonisht shumë.

- Gjepura, gjepura janë të gjitha! - belbëzoi i vetëkënaqur Pjotër Petroviçi, por edhe i tronditur. Nuk ia ndante dot sytë Lebezjatnikovit.

- Jo, nuk janë gjepura! Një njeri i fyer dhe i vrarë shpirtërisht nga gjithë ç'u ndodhi mbrëmë, por që gjen forca dhe mendon kështu edhe për të tjerët. Ky njeri... edhe pse me mirësjelljen e tij bën gabime sociale, prapë se prapë meriton respekt. E papritur është kjo për mua, sepse konceptet tuaja... ju janë pengesë! Mossuksesi i djeshëm ju pezmatoi tej mase! - thirri Andre Semionoviçi. - E përse ju qënka aq e domosdoshme ajo martesë ligjore? Pse e kërkoni me aq ngulm sanksionin martesor? Në doni më rrihni, por jam shumë i gëzuar që nuk u ngjiz ajo lidhje martesore, që jeni i lirë, që mund t'i shërbeni ende njerëzimit.

- Ia kam frikën martesës suaj qytetare, them se mos më vënë brirë, mos rris fëmijët e tjetër kujt, - iu përgjigj Pjotër Petroviçi për të mos mbetur pa thënë diçka.

- Fëmijët? Zotë ngoje fëmijët? - u rrëqeth Andre Simionoviçi. U bë gati të hidhej në sulm si kali kur dëgjon borijen. - Ata përbëjnë një problem social të klasit të parë, ashtu është, por do të marrë zgjidhjen

e merituar. Ka disa që i mohojnë fëmijët, duke mohuar familjen. Do t'i kthehemi përsëri kësaj çështjeje. Fjalën e kishim tek ata brirët. Po jua them, është thembra e Akilit kjo për mua, ndonëse si shprehje duhet fshirë nga fjalori i së ardhmes. Pyes: ç'domethënë brirë? Gjepura! Është martesa qytetare ajo që i zhduk natyrshëm. Ata janë korigjim i martesave të ligjshme, janë protestë kundër tyre, pra s'kanë si të jenë poshtëruese. Në u lidhsha ndonjëherë me martesë të ligjshme (po e pranojmë për një çast një të tillë absurditet), do më bëhej zemra mal, në do i mbaja këta brirë aq shumë të mallkuar. Do t'i thosha sime shoqeje: "Zemër moj, deri më sot të kam dashur, tani vetëm të respektoj, sepse munde dhe dite të protestosh!" Po qeshni, hë? Ju vjen ngaqë nuk gjeni në veten tuaj forca për të flakur tej paragjykimet! E kuptoj që të vjen plasje kur të mashtrojnë në atë që ke me ligj, por kjo është vetëm rrjedhojë e poshtër e një fakti të poshtër; të dy palët ndihen të fyer. Po të bëhej hapur, siç ka për të ndodhur në martesën qytetare, atëherë brirët si të tillë nuk kanë për të ekzistuar, janë diçka e pakuptimtë, e humbasin madje edhe emrin. Duke vepruar e lirë, bashkëshortja ju demonstron respektin e thellë që ka, ju sheh të pazotin për ta kundërshtuar lumturinë e saj, ju gjen aq shumë të zhvilluar, saqë nuk hakmerreni për burrin e ri, me të cilin është në lidhje. Sa për mua, unë vetëm ëndërroj që në rast martese, qoftë kjo ligjore apo qytetare, t'ia sjell time shoqeje me dorën time dashnorin, në kaloftë shumë kohë dhe ajo vetë nuk e ka gjetur. "Zemër, - do t'i thosha. - Të dua sa më s'bëhet, por akoma më tepër dua të më respektosh!" Hë, si ju duket kjo që thashë? Mirë e kam?...

Gjatë tërë kohës që e dëgjonte, Pjotër Petroviçi nuk pushoi së qeshuri dhe së zgërdhiri. Kjo nuk kishte si të mos i binte në sy Lebezjatnikovit. U ul, u zhyt në të thella, duke fërkuar duart, tejet i emocionuar. Domethënien e atij qëndrimi të mikut të nderuar mundi ta kuptojë deri në fund vetëm më vonë...

II

Zor të përcaktohen me saktësi shkaqet që e shtyn Katerina Ivanovnën ta shtronte këtë drekë. I shkuan më shumë se dhjetë rubla.

Ndoshta ngaqë e ndiente veten të detyruar para të ndjerit, ndoshta për t'ia bërë të ditur gjindjes se "nuk ishte më keq se të tjerët, përkundrazi, ishte ku e ku më mirë se ata", ndaj askush të mos guxonte të mbahej me të madh para saj. Por kushedi nxori krye edhe krenaria e varfanjakëve, që, kur është fjala për ca rituale publike, bien telef, harxhojnë edhe kopejkun e fundit për t'u dukur "jo më keq se të tjerët", që të mos përgojohen. Ndoshta dëshironte që pikërisht në një të tillë kohe, kur i dukej vetja krejt në zgrip, pa ndihmë e përkrahje, t'ua përplaste në surrat këtyre "qiraxhinjve të liq", se ajo jo vetëm e dinte ç'është rrojtja, të priturat e të përcjellat, se ishte lindur e rritur në derë të mirë, madje aristokratike, por ja që pati një fat perrupi; se aspak nuk i takonte të lante lëveret natën, t'i qepte e t'i arnonte, të lante vetë edhe dyshemetë. Ka raste, kur shkulme krenarie dhe sqime të pa rrëfyer i rrëmbejnë me gjithësej varfanjakët dhe i trondisin aq keq, saqë u errësohen sytë dhe për asgjë tjetër nuk duan t'ia dinë. Shtoi kësaj edhe natyrën e Katerina Ivanovnës, që nuk ishte e lehtë ta tulasje: mund ta dërrmoje me rrethanat, por t'ia nënshtroje vullnetin, t'ia ktheje mendjen ishte e pamundur. Shtoji gjithë kësaj edhe atë që vinte në dukje Sonja: kishte filluar t'i errësohej mendja. Dhe nuk ishte aq larg së vërtetës. Edhe veremi e nxit çmendurinë.

Pije të llojlloshme nuk kishte, por për të pirë po, ndonëse cilësia linte për të dëshiruar. Edhe gatimet modeste nuk mungonin, tryeza ishte plot; prisnin në gatishmëri edhe dy samovarët për çajin. Pazarin Katerina Ivanovna e bëri vetë, e ndihmuar nga polaku hallexhi, që ra telef për të treguar zellin dhe gatishmërinë. I thërriste "zonjë e nderuar", i drejtohej vend e pa vend aq sa iu mërzit keq Katerina Ivanovnës. Kjo e kishte për zakon ta lante e ta lyente tjetrin, ta mburrte e ta lajkatonte aq shumë, saqë këtij t'i skuqeshin faqet, dhe tërë këtë e bënte me zemër të çiltër, veç edhe zhgënjehej nga tjetri aq vrullshëm, saqë zinte dhe e sikteriste mos më keq, kur i dilte nga zemra. I pëlqente humori dhe përzemërsia, e rrethuar nga mjerimi, siç qe e detyruar të rronte, kërkonte me gjongël e kokëfortësi që njerëzit të jetonin ne paqe e gëzime; çdo prishje e ekuilibrit jetësor, edhe mossuksesi më i vogël e bënte të tërbohej nga zemërimi; mallkonte fatin, shante e truante këdo që i dilte përpara, dhe puna arrinte deri aty sa zinte e përplaste kokën pas murit. Amelia Ivanovnës i gufoi shpirti nga

respekti dhe konsiderata për Katerina Ivanovnën për këtë që kishte menduar të bënte; me gjithë zemër iu përvesh punëve për ta ndihmuar, vetë Katerina Ivanovna e la të parën në çdo gjë. E qetë shkoi në varrim. Dhe përgatitjet kishin qënë ashtu si duhet: tryeza qe shtruar me të gjitha të mirat, vërtet që servisi ishte ca laragan, e kishin marrë te komshinjtë, por çdo gjë qe në vendin e vet. Kur u kthyen nga varrimi, Amalia Ivanovna u doli përpara e veshur dhe e rregulluar si për zi, krenare për atë që kishte bërë. Kjo nuk i pëlqeu Katerina Ivanovnës. "Sikur ne të tjerët nuk ditkemi të shtrojmë tryeza, vetëm ajo dikta" - tha me vete. Edhe veshja kreko s'i pëlqeu. "Mos na e mban ca si përpjetë hundën kjo nemce, mos do të tregojë që është ajo pronaria, vetëm nga mëshira u jep dorën ca varfanjakëve? Nga mëshira! Nuk e di zavallja që im atë ka qenë kolonel, guvernator thuaj. Shtronte gosti edhe për dyzet veta dhe ndonjë si Amalia Ivanovna as te dera nuk e qaste..." Veç sot e kishte bërë top mendjen të mos i shfaqte ndjenjat, ndonëse i vlonte përbrenda dëshira që t'ia tregonte vendin. Sidoqoftë, i qëndroi ftohtë. Edhe një tjetër rrethanë ia kishte ngritur nervat: në varrim përveç polakut nuk kishte vajtur asnjë nga qiraxhinjtë, edhe në drekë erdhën më të parëndësishmit e më të këputurit, me një paraqitje mos më keq. Më të moshuarit dhe më solidët mungonin. Pjotër Petroviç Lluzhini, më i shquari ndër ta, nuk kishte begenisur t'i vinte, e pra dje kujt nuk i kishte folur për të, e kishte cilësuar më fisnikun dhe më shpirtmadhin, njeri me pasuri dhe emër, mik me burrin e parë, njeriun që kishte hyrë e dalë në shtëpinë e babait dhe i kishte dhënë fjalën se do bënte çmos t'i siguronte një pension. Në përgjithësi, kur ngrinte dhe ulte dikë, Katerina Ivanovna nuk e bënte nisur nga ndonjë përfitim, e bënte sepse kështu ia thoshte zemra. Shembullin e Lluzhinit e kishte ndjekur edhe ai çapaçuli, Lebezjatnikovi. "Çoç i duket vetja zavallit. E ftuan vetëm nga mëshira, dhe vetëm sepse banon në një dhomë me Pjotër Petroviçin, s'kishe si të mos e ftoje", - bluante në kokën e saj Katerina Ivanovna. As zonja plakë me të bijën lëneshë nuk po dukeshin, kishin pak kohë që banonin këtu, ishin ankuar edhe nga zhurma e britmat në dhomën e Marmelladovëve, sidomos kur i ndjeri kthehej në shtëpi i dehur, ia kishte thënë Amalia Ivanovna në ato çastet shpërthyese, kur e kërcënonte se do t'ia flakte jashtë leckat. "Shqetësoni komshinjtë fisnikë, të cilëve

nuk u vini as te gishti i këmbës", - u pati thënë. Katerina Ivanovna enkas e kishte ftuar, për më tepër që kur ndesheshin rastësisht gjëkundi, kjo i kthente krahët. "Ta dijë: mendojmë, ndjejmë, dhe sillemi ku e ku më me fisnikëri se ajo!" - pat thënë me vete. As ai barkmadhi, nënkoloneli në lirim nuk e begenisi, ndonëse i thanë që as deri këtu nuk mund të ecte. Ishin të pranishëm polaku që u rropat për përgatitjen e drekës, një nëpunës nurzi që kutërbonte një orë larg, një plakaruq i shurdhët dhe thuajse i verbër, një kapter në lirim që qeshte sikur gugaste dhe që, o çudi, nuk kishte veshur as jelek, ishte edhe një që zuri vend pa u përshëndetur me Katerina Ivanovnën, edhe një që as nuk ishte veshur fare, por kishte hyrë ashtu me rrobë-dhome. Amalia Ivanovna dhe polaku bënë si bënë dhe e përcollën. Polaku kishte sjellë dy bashkatdhetarë që kërkush nuk i kishte parë ndonjëherë. Mysafirët ia ngritën sa më s'bëhet nervat Katerina Ivanovnës. "E pse gjithë kjo përgatitje?" - tha me vete. Fëmijët i veçuan në një qoshe mbi sënduk, porositën Poleçkën të përkujdesej: t'i ushqente, t'i qetësonte, t'u fshinte buzët "si fëmijëve të fisnikëve". Donte s'donte Katerina Ivanovna u detyrua t'i priste me një solemnitet të dyfishuar, duke i parë rreptë, sidomos disa, duke bërë me faj për gjithë këtë Amalia Ivanovnën. Më në fund zunë vendet.

Raskolnikovi arriti, kur sapo ishin kthyer nga varrezat. Katerina Ivanovna mend fluturonte nga gëzimi kur e pa; ishte i vetmi "mysafir me shkollë" dhe u ishte bërë e ditur të gjithëve nga zonja e kësaj shtëpie, që "priste ta emëronin pedagog universiteti". Ky i kërkoi ndjesë terë mirësjellje që nuk kishte patur mundësi të merrte pjesë në varrim. E mori dhe e uli pranë vetes, përkarshi kishte zenë vend Amalia Ivanovna. Merakosej që të gjithë të kishin për të ngrënë e për të pirë, kolla vazhdonte t'ia merrte frymën, por kryesore ishte ai, ndaj sajdia e posaçme iu përkushtua vetëm atij. Rrinte-rrinte dhe me pëshpërimë tepër të përzemërt, madje intime, i fliste për drekën, që nuk i doli ashtu si e kishte menduar, tallte e përqeshte ngushëlluesit, thumbonte pa mëshirë pronaren.

- Kjo kukumjaçka e ka të gjithë fajin! - i tha duke treguar në drejtim të Amalia Ivanovnës. - I ra hiles që për të jemi duke folur, ndaj dhe i dolën asisoj kokërdhokët. Ha! Ha! Khi! Khi! Khi! E shihni si është veshur? E rren mendja që ka bërë një bamirësi të pazakontë, i duket

që në parajsë do vejë nga kjo që bëri! E porosita të ftonte njerëzit më të përshtatshëm, kurse ajo, si për inat, ja ç'mblodhi, ca syqytë e tekahytë! As që i njohim se kush janë disa prej tyre! Rrinë si gurë varri dhe as gëk, as mëk!... "Zotërinj, po merrni, de merrni, byreku është i mirë! - u thirri që nga vendi. - Dhe pini nga pak, për ndjesë të kryefamiljarit!" Shihni, shihni! U çua, po më bën shënjë, do të përshëndetet. Duket që janë me barkun bosh, të zinjtë! Për të ngrënë le të hanë, mirë t'u bëjë, veç zhurmë e potere s'dua. Kam frikë mos na humbasin takëmet e argjendta, hajde ta dëgjosh pastaj kukumjaçkën! Edhe kjo na duhet! "Amalia Ivanovna, - iu kthye sakaq kësaj. - Në i vjedhshin ato takëme, unë nuk përgjigjem! He-he-he!" - Qeshi, duke iu dridhur tërë trupi nga shkulmet e nervozizmit. Dhe përsëri iu kthye vrulltas Raskolnikovit. - Më vrafshin mua në kuptoi gjë, është e trashë! Kukumjaçkë, ma!

E qeshura histerike ia linte vendin kollës së thatë, gërricëse; në shami iu dukën njolla gjaku, ballin ia mbuluan bula djerse. Ia tregoi shaminë Raskolnikovit, u mbush përsëri me frymë dhe i pështëriste tërë pasion, madje me zjarr edhe më të madh.

- E porosita të thërriste zonjën me të bijën që banojnë me një mur me ne, më kupton? Lypsej takt e delikatesë për këtë, i duheshin prekur telat e zemrës, po ku merr vesh kjo nga këto! Nuk erdhën; helbete, çoç u duket vetja. "Jam vejushë majori", - thotë. Ka ardhur të trokasë në dyert e zyrave për punë të pensionit, po t'ua dojë puna, ato edhe fustanet i ngrejnë! Në të pesëdhjetat është gruaja e botës, por zanatin s'e ka lënë, lyhet e ngjyhet, që amam o Zot! Po Sonja ku është? Ku të ketë shkuar? Hë, ja tek qënka! Po ku je, moj vajzë? Edhe në një ditë si kjo nuk di të mbahesh! Rodion Romanoviç, uleni pranë vetes. Ky këtu është vendi yt, Sonjeçka! Merr ç'të kesh qejf! Po fëmijëve u dhamë, ata si, në rregull janë? Poleçka, kini për të ngrënë ju aty? Khi-khi-khi! Rrini mirë! Ti Kolja dhe ti Lena mos i tundni ashtu këmbët... hani si fëmijë nga familje fisnike që jeni! Doje të thoshe gjë ti Sonja?

Kjo iu afrua dhe zuri t'i tregonte që Pjotër Petroviçi i kërkonte ndjesë për mungesën; i foli me zë të lartë, që ta dëgjonin të gjithë. Zgjodhi shprehjet më të spikatura, tonin sa më serioz; që para se të vinte këtu i pati menduar dhe formuluar në mendjen e saj. I tha se do të vinte menjëherë sapo të çlirohej nga disa punë të ngutshme që

kishte, do bisedonte me të kokë më kokë dhe do përcaktonin planin për të ardhmen.

Sonja e bëri enkas, sepse e dinte që ledhatimi i sedrës së sëmurë do ta qetësonte së tepërmi Katerina Ivanovnën. U ul pranë Raskolnikovit, e përshëndeti me kokë dhe e pa shkarazi me kërshëri. Dukej e hutuar dhe e tronditur, ndonëse Katerina Ivanovnën e shihte drejt në sy për t'ia bërë qejfin. Nuk ishin veshur me të zeza, sepse nuk kishin rrobe.

Katerina Ivanovna po me zë të lartë e pyeti si ishte me shëndet, ndërsa, gjoja me fshehtësi, por me një pëshpërimë aq të lartë, sa që e dëgjuan të gjithë, iu drejtua Raskolnikovit: "Do të ishte vërtet e çuditshme, që një njeri aq i respektuar si Pjotër Petroviçi të gjendej në këtë shoqëri të pazakontë".

- Ndaj dhe ju jam aq shumë falënderuese, Rodion Romanoviç! Ju nuk e përbuzët bukën tonë, mjedisi ku gjendemi! - i tha me zë të lartë. - S'kam dyshim që janë ndjenjat e veçanta të miqësisë me të ndjerin ato që ju shtynë ta mbanit fjalën.

U vërviti një shikim shqiponje të pranishmëve, i ndali sytë te plakaruqi i shurdhët dhe i verbër dhe e pyeti: "Mos doni pak mish të pjekur? Po për të pirë, po pini?" Ky nuk foli, nuk mori vesh ç'i thanë, vetëm pa përreth me gojën hapur nga habia dhe me këtë i bëri për të qeshur të tjerët.

- E kush na e bëri peshqesh këtë dordolec! - mërmëriti e nervozuar, por me zë të lartë tha: - Gjithmonë kam patur besim te Pjotër Petroviçi. Ha bukë veç ai njeri! S'ngjan me langashët që sorollaten lart e poshtë, e që në këtë shtëpi ka shumë. Në shtëpinë e tim eti këta nuk do t'i pranonin as shërbëtorë, ndërsa i ndjeri im shoq i sajdiste sepse ishte shpirtmirë.

- Vërtet, ashtu, por ama e tepronte me atë të shkretë vodkë. - thirri që nga vendi i tij kapteri në lirim dhe ktheu me fund gotën e dymbëdhjetë.

- E ka patur atë dobësi, - u kap nga llafi Katerina Ivanovna, por ama si njeri me zemër s'e kishte shokun! Fisnik njeri dhe familjar i rrallë. E kishte këtë të keqe: u zinte shumë besë njerëzve dhe me kë nuk shtrohej të pinte. E dini, Rodion Romanoviç? Në xhep i gjetëm një kurabi, nuk i harronte gostimat për kalamajtë!

- Kurabi? - e pyeti kapteri në lirim.

Katerina Ivanovna nuk denjoi t'i jepte përgjigje. Psherëtiu.

- Ndonjë mund të ngrihet e të thotë që jam treguar si shumë e rreptë me të, - vazhdoi. - Po ja që nuk është ashtu! Më ka respektuar dhe shumë! Zemërflori njeri ishte! Më këputej shpirti, kur e shihja. M'i ngulte sytë që nga qoshja e vet, doja ta ledhatoja se më dhimsej, por i thosha vetes: "E ledhaton, kurse ai drejt në mejhane!" Vetëm rreptësia e përmblidhte disi atë njeri.

- Po, i ndodhte, e vërshonin dhe e fundosnin mendimet e liga! - mërmëriti kapteri dhe e ktheu edhe një herë tjetër gotën plot.

- E ç'mendime e derte nuk ka njeriu në këtë botë, - e mbështeti Katerina Ivanovna.

Njollat e kuqe në fytyrë dhe në qafë sa vinin e i theksoheshin, gjoksi i ngrihej dhe i ulej nga shpirra që s'e linte të mbushej me frymë, tendosja nervore kishte arritur kulmin. Kishte nga ata që kjo gjëndje e saj po u pëlqente, zunë ta ndërsenin kapterin.

- Po a s'na thoni... për kë e patët fjalën, kur thatë ashtu?... Po, nejse, nejse! I lëmë këto. Zoti qoftë me ju! - dhe përsëri e ktheu me fund.

Raskolnikovi i shihte dhe i dëgjonte me përbuzje. Mori vetëm sa për përshpirtje, nën ngulmin edhe të Katerina Ivanovnës. Ndiqte çdo lëvizje të Sonjës: dukej e shqetësuar dhe në hall, kjo drekë nuk kishte për t'u mbyllur pa sherr, Katerina Ivanovna sa vinte e bëhej më e pa përmbajtur. Sonjës i kishte rënë në vesh që zonjat qiraxhesha nuk e kishin pranuar ftesën e Katerina Ivanovnës për shkak të saj. E kishte dëgjuar me veshët e saj Amalia Ivanovnën të thoshte, duke cituar fjalën e tyre: "Pse kishte sy e faqe t'i ulte përbri asaj të përdale?" Kishte frikë mos i kishte rënë në vesh edhe Katerina Ivanovnës dhe fyerja e Sonjës ishte për të edhe më e rëndë se fyerja e vetes... Dhe ja, dikush nga cepi i largët i tryezës i dërgoi Sonjës një pjatë me dy copa buke në formë zemre, të përshkuara nga një shigjetë. Katerina Ivanovna nuk duroi dot pa thënë se ai që e kishte dërguar është "hajvan i dehur". Ndërkohë Amalia Ivanovna, e prekur nga qëndrimi hundë-përpjetë i Katerina Ivanovnës, si gjoja pa të keq tregoi se: "Karli i farmacisë po kthehej natën në pajton, karrocieri u mat ta vriste. Karli iu lut e iu fal si perëndisë, edhe duart ia puthi, edhe lotët rrëke, ia

çpoi tejetej e ia plagosi zemrën, ky nuk e vrau." Katerina Ivanovna shtrëmbëroi turiçkat, e pa me bisht të syrit, me qësëndi. Kjo u bë bishë, i tha që i ati në Berlin është njeri me peshë, kur ecën duart në xhep i mban, të gjithë i heqin kapelen. Katerina Ivanovna ia plasi gazit, të qeshurit histerik sakaq u këmbye nga kolla e thatë, mbytëse, Amalia Ivanovna mblodhi forcat e fundit për ta mbajtur veten e të mos i vinte duart në fyt në një ditë si kjo.

- Pa shih, bufeshka! - i tha Katerina Ivanovna me pështpërimë Raskolnikovit. - Krekoset, apo nuk krekoset! Dhe me atë gjuhën shatra-patra të gjermanes! Khi! Khi! E kini vënë re, Rodion Romanoviç, këta të huajtë petërburgas, sidomos gjermanët, janë më të trashë se ne rusët! Dhe e gënjen mendja, të gjorën, sikur tregon bukur! Të vjen të plasësh! Edhe kapteri sarahosh ka mendje më tepër se ajo! E sheh si rri? Diç është duke bluar në mendjen e saj të tarallakes. Po pëlcet e bën bof nga marazi! Ha! Ha!

Pasi u hargalis dhe u shkumëzua duke u tallur me gjermanen, i tregoi Raskolnikovit se, po të siguronte pensionin, do ngrinte në qytetin e lindjes një pension femëror dhe u fut në hollësi të tilla, saqë nuk la pa përmendur edhe fletën e lavdërimit që kishte marrë kur kishte mbaruar shkollën, e mbante për dëshmi të sigurt të aftësive të pakufizuara që kishte. E kishte fshehur në gji, e nxori, ua tregoi dhe lejoi me kënaqësi që ta kalonin dorë më dorë, madje, edhe ata që ishin dehur dhe nuk dinin ku ishin. Aty *en tous lettres*[1]) thuhej që Katerina Ivanovna ishte e bija e kolonelit, kështilltar oborri. Ia nisi një tregimi të hollësishëm për jetën si në parajsë në qytetin T., për mësuesit e gjimnazit, të cilët linin kokën për të, u ndal posaçërisht në tregimin për francezin Mango, ky i bënte mësime private në frëngjisht, dhe shkonte me shpresë ta punësonte në pensionin që do ngrinte, me një pagesë të arsyeshme. Sonjën do ta merrte me vete, do ta bënte kujdestare. U dëgjua një kukurismë në anën tjetër të tryezës; Katerina Ivanovna pa me shpërfillje dhe shtoi se Sonja Semionovna, me aftësitë që ka, do të jetë krahu i saj i djathtë; ia ledhatoi faqen, pastaj e puthi dy herë me tërë zjarrin e shpirtit. Sonja u bë lulëkuqe në fytyrë, ndërsa Katerina Ivanovna u përlot dhe shpegoi që "është një marroke me

[1]) *E zeza mbi të bardhë (fr.).*

nerva të shkrehura, dhe, meqë edhe mezetë mbaruan, mirë do ishte të nxirrnin çajin".

Amalia Ivanovna e fyer që në tërë këtë drekë nuk iu dha mundësi as të hapte gojën, shfrytëzoi rastin e pauzës së shkurtër dhe iu drejtua Katerina Ivanovnës me një këshillë tejet të dobishme: Të përkujdesej posaçërisht për pastërtinë e të linjtave të çupave, duhej të emëronte për këtë detyrë një zonjë të fisme, dhe të hapte sytë që natën të mos lexoheshin romane. Katerina Ivanovna, që mezi po qëndronte në karrige ngaqë po i merreshin mendtë, ia preu shkurt: "Mos fol gjepura!" Amalia Ivanovna kaq donte që të merrte flakë; i tha se e bëri për të mirën e saj, ajo dhe qiranë, që nuk ia ka paguar, nuk ia ka zënë ndonjëherë ngoje po për të mirën e saj. Katerina Ivanovna ia ktheu që edhe mbrëmë, kur rrinte i shtrirë i ndjeri, nuk la t'i shpëtonte rasti pa ia kujtuar. Amalia Ivanovna i qoku edhe punën e atyre dy qiraxheshave zonja që nuk e begenisën të vinin në përshpirtje, sepse ishin gra fisnike; Katerina Ivanovna iu kthye e i tha që s'merrte vesh fare nga ajo punë si e huaj që është; Amalia Ivanovna ia kujtoi përsëri që i ati është njeri fisnik e me peshë në shoqëri, mbahet siç i ka hije zotërisë, me kokën lart e me duar në xhepa. Në zjarr e sipër kërceu nga karrigia dhe ua demonstroi të gjithëve ç'pamje që ka, u dëgjuan të qeshura e britma qesëndisëse, disa i jepnin zemër për ta ndërsyer më keq, duke parandjerë kënaqësinë që do përftonin nga kacafytja e pashmangshme e të dyja grave. Katerina Ivanovna nuk la pa ia përplasur në fytyrë që kjo ndoshta as e bija e atij që mban për baba nuk është, por kushedi e kujt pijaniku, dhe ndoshta as që e ka njohur të atin se vetëm thotë që është Ivanovna, po ku i dihet, mos ia pa kush dokumentin! Pastaj edhe vetë kjo ndoshta kuzhiniere ka qënë. Amalia Ivanovna s'po gjente vend ku të futej nga turpi, gulçonte dhe ofshante, bërtiste dhe çirrej. I tha që vetë ajo nuk e dinte se bijë e kujt ishte. Atëhere Katerina Ivanovna, dyllë në fytyrë, me kokën të varur mbi kraharorin kockë e lëkurë që i tallazej për lemeri nga gulçi dhe shpirra, u çua në këmbë dhe i tha, se po të guxonte të vinte në një kandar prindin e saj fisnik me atë të sajin, do t'ia shkulte cullufet dhe do t'ia jepte në dorë. Amalia Ivanovna e la vendin në tryezë dhe eci nëpër dhomë, duke ulëritur se këtu ishte ajo zonjë, se po të donte, e nxirrte për krahu jashtë Katerina Ivanovnën, që guxonte ta fyente asisoj, u

turr drejt tryezës për të mbledhur servisin e shtrenjtë. Zhurma dhe poterja u ngritën në kupë të qiellit, fëmijët u lebetitën të tmerruar. Sonja u sul të mbante Katerina Ivanovnën, por, kur Amalia Ivanovna i kujtoi gjendjen e sotme të vajzës, Katerina Ivanovna i dha të shtymën Sonjës për të vënë në jetë atë që tha lidhur me cullufet. Atë çast u hap dera dhe në dhomë ia behu Pjotër Petroviç Lluzhini. Kaloi shikimin e rreptë dhe të përqendruar nëpër dhomë, i ngrirë si statujë. Katerina Ivanovna u derdh për tek ai.

III

- Pjotër Petroviç! - i thirri. - M'u bëni krahë! Thuajini kësaj marrokeje që nuk është aspak e hijshme t'u biesh në qafë njerëzve fisnikë, të cilët i ka pllakosur fatkeqësia... Se ka dhe gjyq... Do vete t'i ankohem guvernatorit... Do më shohë mirë pastaj! Keni qënë mik me tim atë, vini dorën në zemër për këta jetimë!

- Po dale, zonjë! Jo kështu, zonjë!... - bëri ta mbronte Pjotër Petroviçi. - Atin tuaj, këtë ju fort mirë e dini, as që kam patur nderin ta njoh... (Dikush qeshi me të madhe.) Dhe as që dëshiroj të përzihem me këto gërr-vërret tuaja pa mbarim me Amalia Ivanovnën. Erdha të sqarohem për një çështje me thjeshtrën tuaj... Sonja... Ivanovnën. Kështu, më duket, quhet?

Në këtë e sipër hyri në dhomë dhe iu drejtua Sonjës.

Katerina Ivanovna shtangu nga ky poshtërim i pa dëgjuar. Si guxoi ky njeri ta shkelë kësisoj nderin e familjes së saj? Se, pasi e kishte sajuar dhe selitur me imagjinatën e saj, miqësinë e tij me të atin e mbante tanimë për diçka të vërtetë. E habiti sidomos toni me të cilin u thanë këto fjalë: sa përbuzës, aq dhe kërcënues. Të gjithë po prisnin në heshtje ç'do ndodhte. Raskolnikovi i hapi rrugë Sonjës që të dilte, Pjotër Petroviçi bëri sikur nuk e vuri re qënien e atij aty. Atë çast te dera ia befi Lebezjatnikovi; nuk hyri, por i pa me kërshëri të pranishmit.

- Të më falni që hyra kështu! - tha Pjotër Petroviçi, duke mos iu drejtuar konkretisht ndonjërit. - Çështja, për të cilën kam ardhur, është e një rëndësie të posaçme, le ta dëgjojnë të gjithë... Amalia Ivanovna, si pronare që jeni, ju lutem përulësisht të më dëgjoni me

vëmendje lidhur me ato që do them. Menjëherë pas daljes së Sonja Ivanovnës nga dhoma e mikut tim Andre Semionoviçit, vura re që ishte zhdukur një kartmonedhë njëqindrubëlshe. Në dini të na thoni diçka lidhur me këtë, ju lutem ta bëni para gjithë këtyre dëshmitarëve dhe me kaq e mbyllim këtë çështje. Ndryshe do marrë masat e duhura dhe prisni pasojat e tyre pastaj!

Asnjë nuk pipëtiu. Edhe fëmijët kishin pushuar së qari. Sonja e verdhë dyllë qëndronte para Lluzhinit dhe s'po mundej t'i përgjigjej. Dukej që as po e kuptonte se për çfarë bëhej fjalë.

- Hë, si? Ç'do na thoni? - e pyeti sugjestionues Lluzhini dhe ia nguli shikimin depërtues.

- Ku di gjë unë?... Unë s'di gjë... - mezi nxori një zë të mekur Sonja.

- Po si nuk e ditkeni? - përsëriti dhe qëndroi në pritje të përgjigjes.

- Mendohuni mirë, zonjushë! - i tha me të rreptë, por edhe si duke e këshilluar. - Mendohuni, ju lë pak kohë për këtë! Se unë, me tërë këtë përvojë që kam, po të mos isha qindpërqind i sigurt, kuptohet, nuk do ta bëja këtë hap me aq risk... nuk do ju akuzoja... Se në u vërtetoftë ky gabim, vihem para përgjegjësisë penale... E di fort mirë këtë. Sot për nevoja vetjake, tërhoqa shumën prej tremijë rublash. I numërova në dhomë, dëshmitar kam Andre Semionoviçin. Dymijë e treqind rubla i futa në portofol, të cilin e vura në xhepin e brendshëm të xhaketës. Mbi tryezë mbetën edhe pesëqind rubla, çeqe, ndërsa treqind rubla ishin kartmonedha njëqindrubëlshe. Atë çast hytë ju (ju kisha thirrur unë), ishit tepër e tronditur dhe e shqetësuar, tri herë u ngritët të iknit, edhe pse biseda për të cilën ju pata ftuar ende nuk ishte bërë. Andre Semionoviçi fare mirë mund t'i vërtetojë fjalët e mia. Ju fola për mundësinë e organizimit të ndonjë llotarie në ndihmë të jetimëve, apo diçka tjetër bamirëse. Më falënderuat, madje u përlotët (po jua përmend që t'ua rikujtoj, por edhe të kuptoni që kujtesën e kam të mirë). Pastaj mora nga tryeza një kartmonedhë dhjetërubëlshe dhe ua dhashë si ndihmë për familjen fatkeqe. E pa edhe Andre Semionoviçi. Ju përcolla deri te dera dhe vura re që shqetësimi juaj mbeti po ai i pari. Biseduam me Andre Semionoviçin si nja dhjetë minuta pas kësaj, ky doli, u ktheva përsëri te tryeza për të përfunduar numërimin dhe për t'i vënë në xhepa të tjerë, siç e kisha menduar. Për habinë time të madhe, mungonte një kartë-

monedhë njëqindrubëlshe. Si më mësoni: të dyshoj të Andre Semionoviçi, gjë që nuk kam si e bëj, gabim në numërim po nuk kam bërë, apo duke parë turbullimin dhe shqetësimin tuaj të vazhdueshëm, ngutjen për t'u larguar dhe faktin që tërë kohën i mbajtët duart mbi tryezë, por edhe duke ditur gjendjen tejet të mjeruar, në të cilën ndodheni, që, domosdo, s'ka si të mos shoqërohet me ca vese, jo pa tmerr e lebeti, si të thuash, dhe, s'do mend edhe kundër vullnetit tim, jam i detyruar të hedh dyshim mbi ju; e pranoj, diçka e pashpirt është, por nuk ke si të thuash që nuk është e drejtë. Ama, edhe pse jam plotësisht i bindur, gjej në akuzën time edhe një si risk. E mora ndër sy dhe vendosa t'jua bëj! Dhe e bëj i shtyrë, e dini nga çfarë? Ngaqë u treguat mosmirënjohëse. Ju thirra për t'ju ndihmuar me sa më hante xhepi, kurse ju ma shpërblyet asisoj. S'mund të lihet pa u ndëshkuar ky akt! Si mik i vërtetë (se mik më të mirë se unë në këto çaste nuk mund të gjeni) ju lutem, t'i thërrisni mendjes! Ndryshe do tregohem i pamëshirshëm! Hë ç'më thoni tani?

- Po unë nuk mora gjë!... - mezi nxori nga goja, e tmerruar Sonja. - Më dhatë dhjetë rubla, ja ku i keni, merrini. - Me duar të dridhura nxori shaminë, gjeti nyjen ku i kishte mbledhur ato dhjetë rubla, e zgjidhi dhe ia zgjati Lluzhinit.

- Kurse që morët njëqind rubla nuk doni ta pranoni? - e pyeti qortueshëm dhe e pa ngultas; dhjetë rublat nuk ia zuri me dorë.

Sonja pa përreth e shastisur. Po e shihnin dhjetra sy të shqyer, të rreptë, të vrenjtur, po edhe tallës e urrejtës. Pa nga Raskolnikovi... Ky qëndronte mbështetur pas murit, me krahët të kryqëzuar në kraharor dhe e shihte me sy të ndezur, përshkënditës.

- O Zot! Po kjo ç'është? - i doli një rënkim nga zemra Sonjës.

- Amalia Ivanovna, duhet vënë në dijeni policia, ju lutem përulësisht, dërgoni të thërrasin rojen e shtëpisë, - me zë të butë, madje disi ledhatues, tha Lluzhini.

- Zot i madh! Doli fjala ime që e tillë është kjo! - tha duke tundur krahët pronarja.

- Domethënë ju e paskeni ditur që e tillë është? - u kap pas fjalës së kësaj Lluzhini. - Pra, paskeni të dhëna që keni arritur në një të tillë përfundim! Ju lutem t'i mbani mend mirë këto fjalë, të thëna në praninë e sa e sa dëshmitarëve.

Ata që e dëgjuan, filluan të flasin, të këmbejnë mendime.

- Si-i-i? - ulëriti Katerina Ivanovna që u duk se vetëm tani u përmend nga ajo gjendje shoku në të cilën kishte rënë. U lëshua drejt Lluzhinit. - Si?! E akuzokeni për vjedhje? Sonjën, more faqezi? Ah, të poshtër! Ah, mor lapërdharë! - E tërhoqi Sonjën për nga vetja dhe shtërngoi fort në krahët kockë e lëkurë.

- Sonja! Si pranove t'ia marrësh ato dhjetë rubla! Budallaqe u tregove! M'i jep këtu! Na! Ja ku i ke paratë.

Ia rrëmbeu paratë Sonjës, i mblodhi shuk, ia hodhi në surrat Lluzhinit. Shuka e qëlloi në sy Lluzhinin, pastaj ra në dysheme. Amalia Ivanovna u hodh t'i ngrinte. Pjotër Petroviçi ulëriti:

- Mbajeni këtë të çmendur!

Në derë futën kokën disa të tjerë, ndër ta edhe zonjat qiraxhesha.

- Si? E çmendur? Unë qënkam e çmendur? Idiot! - e sikterisi e çakërryer Katerina Ivanovna. - Jashtë që këtej! Kush? Sonja t'i ketë marrë, more i poshtër? Sonja qënka hajdute? Po ajo ku t'i jap tjetrit, more derdimen! - dhe Katerina Ivanovna u shkreh në një të qeshur sarkastik. - Ç'thotë ky kështu? - tha, duke iu drejtuar të pranishmëve. - Po ti si? Edhe ti ashtu thua? - iu kthye pronares, kur e pa. - E paske ditur që e tillë qënka ë? Ti moj turimace e paske ditur? Po, Sonja erdhi e u ul këtu pa shkuar gjetiu... Kontrollojeni atëherë? Në i paska vjedhur, domethënë se i ka me vete... Ama po nuk i gjete, gjej vend të futesh, mor dordolec! Deri te cari do vete të ankohem! Që sot do nisem, ndër këmbë do t'i bie! Do më kuptojë! E pe ashtu të përkorë dhe, o burra! Po kush të lë pa? Ke të bësh me mua këtu! Do të më shohësh!... Hajde, kontrolloje! Kontrolloje, të thashë!

Fare e çakërdisur, Katerina Ivanovna e tundte dhe e shkundte me sa fuqi që kishte nga krahu Lluzhinin, e tërhiqte për nga Sonja që ta kontrollonte.

- Gati jam. Për sa thashë, përgjigjem. Veç largohuni, zonjë! E shoh që jeni e shkathët... Po jo kështu!... Kontrolli duhet bërë në prani të policisë... Po edhe pa të, se dëshmitarë ka... Gati jam, veç ajo nuk është punë burrash... Sikur të na ndihmonte Amalia Ivanovna...

- Kë të doni caktoni! - thirri Katerina Ivanovna. - Sonja, pa tregoja xhepat, t'i shohin të gjithë... Hapi sytë, more, ka gjë? Ja edhe xhepi tjetër! He, ka?

Në inat e sipër Katerina Ivanovna ia zhvati xhepat Sonjës, nga xhepi i dytë kërceu jashtë një letër e mbledhur më tetësh, e cila, pasi përshkoi një hark, ra te këmbët e Pjotër Petroviçit. E panë të gjithë, u dëgjuan edhe britma. Pjotër Petroviçi u përkul, e ngriti me skandali, vetëm me dy gishta, dhe, pasi e shpalosi, ia tregoi të gjithëve. Ishte një kartmonedhë njëqindrubëlshe. E rrotulloi ne ajër dorën me të në majë të gishtave.

- Hajdute! Jashtë! Policinë! Thirrni policinë! - ulëriti si e çmendur Amalia Ivanovna. - Të zhduken, të zhduken sa më parë që këtej! Në Siberi, atje e kanë vendin këto!

Britma habie u dëgjuan nga të katër anët. Raskolnikovi ndiqte i heshtur çdo lëvizje të Sonjës, hera-herës e kalonte shikimin edhe te Lluzhini. Sonja qëndronte si e shkalur, por befas bërtiti dhe tundi krahët.

- Nuk i kam marrë unë! Nuk e di nga dolën! - Kjo britmë dëshpërimi dhe indinjate të thellë të këputste shpirtin. Tha kështu dhe u ngjesh pas Katerina Ivanovnës, që e shtrëngoi fort në gji.

- Sonja, Sonja! Unë nuk e besoj! Nuk e besoj dhe pikë! - thirri, ndonëse fakti ishte kokëfortë. Dridhej si ndër ethe dhe e shtrëngonte gjithnjë më fort Sonjën në gji, zuri ta puthte, siç puthin fëmijët. - E pamundur! Marrëzira janë të gjitha! E nga ta dini ju ç'zemër të pastër që ka! O Zot! Ç'bëhet kështu! Po ajo edhe rrobet e trupit i shet, në u dashtë, dhe këtë s'e bën! Ku gjen vajzë si Sonja! Po ajo edhe në rrugë të madhe prandaj doli, që të mbajë më frymë camërdhokët! Ah, mor i ndjeri burrë? A e sheh ç'bëhet? Po ju pse nuk flisni? Pse nuk i dilni zot vajzës? Rodion Romanoviç! Pse heshtni? Mos vallë e besoni? Po ju të gjithë sa jeni as te gishti i këmbës nuk i vini! O Zot! Vër dorë ti!

Lebetija dhe lotët rrëke të Katerina Ivanovnës bënë përshtypje te të pranishmit. Të shkonin mornica, kur e shihje ashtu, të këputste shpirtin me ato që bënte e thoshte, sidomos me thirrjen për mbrojtje. Sido që të ishte, Pjotër Petroviçi s'vonoi ta shprehte keqardhjen e tij.

- Zonjë, zonjë! - iu drejtua me zë të mallëngjyer. - Po kjo që ndodhi nuk ka të bëjë fare me ju. Askush nuk ju akuzoi për bashkëpunim, për më tepër që ju vetë ia nxorët paratë nga xhepi, pra ju asgjë nuk keni ditur! Më lejoni t'ju shpreh keqardhjen time të thellë, nëse ka qënë varfëria ajo që e shtyu Sonja Semionovnën!... Bëri gabim që

nuk deshi ta pranonte! Po e qartë: s'e linte turpi! Ndoshta e ka për herë të parë... Veç, përse duhej lënë vetja të binte aq poshtë? Zotërinj! - iu drejtua sakaq të pranishmëve. - Më vjen keq dhe jam thellësisht i prekur, ndonëse, siç e patë, më fyen... Ju bëftë mësim, zonjushë, kjo që ju ndodhi! E mbyllim këtë çështje me kaq!

Pjotër Petroviçi e kaloi me vrik shikimin te Raskolnikovi, dhe, po me vrik e largoi, por shikimet u ndeshën. Ai i Raskolnikovit fliste shumë: s'ngopej ta hante të gjallë! Ndërkohë Katerina Ivanovna e shtrëngonte në gji dhe e puthte si fëmijë Sonjën. Edhe fëmijët e rrethuan Sonjën nga të katër anët, ndërsa Poleçka, edhe pse s'i kuptonte të gjitha, s'pushonte së derdhuri lot. E shtrëngonte Sonjën me krahët e hollë dhe kokën e kishte fshehur në supin e saj.

- Çfarë poshtërsie! Poshtërsi e padëgjuar! - kumboi befas një zë që erdhi nga dera e hapur.

Pjotër Petroviçi u kthye vetëtimthi andej.

- Çfarë poshtërsie! - përsëriti Lebezjatnikovi, duke e parë drejt e në sy.

Pjotër Petroviçit i dolën djersë të ftohta në ballë. Lebezjatnikovi hyri me hap të sigurt në dhomë.

- Patët guximin të më bënit edhe dëshmitarin tuaj? - i tha, duke iu afruar.

- Ç'janë këto që thoni, Andre Semionoviç? Ju për kë e kini fjalën? - mërmëriti Pjotër Petroviçi.

- Për ju e kam. Shpifje janë të gjitha ato që u thanë, - iu përgjigj me zë të sigurt, duke ia ngulur shikimin prej miopi. Dridhej nga indinjata dhe emocionet. Ra heshtja. Lluzhini sikur e humbi për një çast toruan.

- Në e keni me mua... - belbëzoi, duke iu mbajtur goja, - do të bënit mirë t'i thërrisnit më parë mendjes e t'i vinit gishtin kokës!

- Unë i kam thirrur, kurse ju... jeni batakçi! Ç'poshtërsi, hë! I dëgjova të gjitha dhe nuk fola, sepse doja të dija ku donit të dilnit. Se, të them të drejtën, kjo që jeni duke bërë më duket e palogjikshme... E ç'u duhej tërë kjo? Nuk po mundem ta kuptoj!

- E ç'paskam bërë, sipas jush? Flakini tej, më në fund, ato hamendjet tuaja qesharake! Apo mos jeni i dehur?

- Ju, si i poshtër që jeni, kushedi edhe deheni, kurse unë kurrë. Se është kundër bindjeve të mia. Po ky vetë, me dorën e tij, ia futi në

xhep atë njëqind rubëlshe Sonja Semionovnës, e pashë me sytë e mi; jam gati të dëshmoj për këtë kudo që të jetë nevoja. Betohem për këtë! Ai, ai vetë ia futi në xhep... - përsëriti Lebezjatnikovi duke iu drejtuar atyre që ishin në dhomë.

- Mos paskeni lojtur gjë? Po jo, ju jeni fare kalama! - bërtiti Lluzhini. - Po ajo vetë e pranoi, që, përveç atyre dhjetë rublave, s'kishte para të tjera me vete. E si ia paskam futur në xhep ato njëqind rubla?

- Ju pashë me sytë e mi, kur e bëtë! - s'po përmbahej më Lebezjatnikovi. - Edhe pse është kundër bindjeve të mia, jam gati të betohem para gjyqit, që ju pashë me sytë e mi kur e bëtë! Kurse unë budallai pandeha se e bëtë nga zemërgjerësia! Kur po dilte dhe i shtrënguat dorën, me dorën e majtë ia futët pa u ndier në xhep. E pashë, me këta sy e pashë!

Lluzhini u bë mehit në fytyrë.

-E ç'thoni, more! Gënjeshtra janë të tëra! - ulëriti i handakosur Pjotër Petroviçi. - E si më paskeni parë që nga dritarja ku ishit? Ju është dukur... Se ju edhe për të parë nuk shihni mirë. Përçart po flisni!

- Jo, nuk m'u duk! E pashë mirë! Pastaj vura re që, kur morët kartmonedhën dhjetërubëlshe, morët edhe njëqindrubëlshen (isha afër dhe e pashë mirë). E palosët dhe e futët në pëllëmbë. Kur u çuat, e kaluat nga dora e djathtë në të majtën, për pak sa nuk ju ra nga dora; atëherë zura të dyshoj. Thashë me vete: "Dashka ta bëjë fshehtas meje këtë sevap". Kuptohet, zura të ndjek me vëmendje të shumëfishuar çdo lëvizje që bënit, ju pashë kur ia futët në xhep. Jam gati të betohem ku të doni!

Lebezjatnikovi mezi mbushej me frymë. U dëgjuan zëra habie e dyshimi, por edhe disa thirrje kërcënimi. Pjotër Petroviçin e rrethuan nga të katër anët. Katerina Ivanovna u sul për te Lebezjatnikovi.

- Andre Semionoviç! Gabimi ka qënë imi! Dilini zot vajzës! Është jetime! Ju dërgoi Zoti me të madh të tij!

Pa ditur ç'ishte duke bërë, i ra në gjunjë.

- Marrëzi! - thirri i tërbuar Lluzhini. - Marrëzi janë këto që thoni! Del që ia paskam futur enkas në xhep! E pse? Ç'më duhej të ngatërrohesha me këmbët e mia?

- Ja këtë psenë nuk po mundem dot ta kuptoj! Po atë që thashë, s'e luan as topi! Dhe dëgjo këtu, more i poshtër! Më shkrepi ky dyshim

pikërisht atëherë kur ju afrova që t'u falënderoj dhe t'ju shtrëngoja dorën. E pse ia futët fshehur në xhep? Sepse e dinit që nuk do pranonte lëmoshë, apo donit t'i bënit një surprizë? Se nuk janë të pakët ata që kësisoj e gallavisin lëmoshën fyese për tjetrin. Pastaj më shkoi mendja se donit ta vinit në provë. Nuk e quajta të arsyeshme t'ju vija në dijeni të këtyre dyshimeve të mia. Thashë me vete: po sikur Sonja Semionovna t'i humbiste ato para, ngaqë nuk e dinte që i kishte? Erdha pikërisht për këtë, që t'ia thosha. Ngela i habitur nga këto që më zunë sytë dhe më dëgjuan veshët këtu. Po pse a mund t'i kisha tërë këto mendime, po të mos ju kisha parë si ia futët ato para në xhep?

Iu prenë fuqitë, djersët i shkonin çurg; pastaj nuk para kishte shprehje dhe sikletosej kur fliste. Veç ajo që tha bëri përshtypje të jashtëzakonshme. Dhe e tha çdo gjë me aq zjarr e bindje, sa e besuan. Pjotër Petroviçi e kuptoi që i kishte pisk punët.

- Këto që thatë nuk përbëjnë fakte! - ulëriti. - Ngjajnë si ca ëndrra me sy hapur!... Ja ku po jua them: jeni duke gënjyer, duke shpifur dhe e di arsyen: nuk u pajtova me bindjet tuaja të shfrenuara antisociale, antifetare, antishoqërore. Ja se çfarë!

Por dobia nuk qe e madhe. Përkundrazi, u dëgjuan të qeshura, zëra kundërshtimi nga të katër anët.

- Ja se ku paske dashur të dalësh, more! - thirri Lebezjatnikovi. - Thirreni që tani policinë, jam gati t'i them këto që dëgjuat ju këtu edhe atje. Vetëm një gjë nuk po arrij ta kuptoj: ç'e shtyu, vallë, ta bënte këtë?

- Mund t'ua shpjegoj unë arsyen, këtu edhe përpara drejtësisë - tha Raskolnikovi me zë të sigurt dhe bëri dy hapa përpara.

Dukej i qetë dhe i vendosur. Kur e panë, u bindën që e dinte dhe mezi prisnin fundin e kësaj skene të llahtarshme.

- Tani e kam të qartë, - theksoi. - Qysh në fillim dyshova për poshtërsi, i shtyrë nga disa rrethana të caktuara, për të cilat do ju flas. Kurse ju, Andre Semionoviç, me deponimin tuaj aq shumë të çmuar ma bëtë të qartë çdo gjë. Ja si qëndron puna: ky zotëria këtu (tregoi me kokë nga Lluzhini) donte të fejohej me motrën time. Para tri ditësh më erdhi në dhomë, u zumë, e dëbova. Kam dëshmitarë për këtë. Është Jago ky!... Nuk e kam ditur që banonte këtu te ju, Andre Semionoviç. Më pa, kur i dhashë bashkëshortes së mikut tim, zotit

Marmelladov, pak të holla për varrimin. I shkroi letër nënës sime, ku me shprehje nga më poshtërueset zinte ngojë emrin e Sonja Semionovnës, duke shpifur për marrëdhëniet e mia me të. Qëllimi ishte i qartë: donte të më vinte në grindje me nënën dhe me motrën, duke më quajtur dorëlëshuar dhe hovardar, njeri pa mendje në kokë, që i shpenzoi paratë e fundit të tyre, të mbledhura me aq mundim, për qëllime të prapshta. Dje, në prani të nënës dhe të motrës, në sy të këtij ua vura në vend të vërtetën, ua bëra të qartë se paratë ia kisha dhënë Katerina Ivanovnës e jo Sonja Semionovnës, se me Sonja Semionovnën nuk njiheshim. U thashë se Pjotër Petroviçi me ato "meritat" e tij as te gishti i këmbës nuk i vinte Sonja Semionovnës. Kur më pyeti në do ta ulja Sonja Semionovnën pranë motrës, iu përgjigja se tanimë e kisha bërë këtë në mëngjes. I inatosur që as mamaja e as motra nuk pranuan të zemëroheshin me mua, siç ua kërkonte ky, nxori nga goja lapërdhitë e dynjasë për t'i fyer. E zbuan si të padenjë. Kjo ndodhi mbrëmë. Tani ju lutem të më dëgjoni me vëmëndje: sikur të arrinte ta poshtëronte aq mizorisht Sonja Semionovnën, do të mundte t'u tregonte si motrës ashtu edhe nënës sa të drejtë kishte patur, kur u kishte folur ashtu, pra ishte inatosur me të drejtë me mua. Kështu ka bërë hesap se mund të vinte në vend dinjitetin e humbur sy tyre, ndoshta edhe të fitonte zemrën e tyre. Nga ana tjetër, do të hakmerrej paq me mua, sepse e di që nderi dhe lumturia e Sonja Semionovnës janë për mua të shtrenjta. Ja si qëndron puna! Kjo është arsyeja, s'ka tjetër!

- Tregimi i Raskolnikovit u ndërpre jo një herë nga thirrjet e habisë dhe të zemërimit të atyre që po e dëgjonin. Zëri i tij i shtruar, siguria e argumentit dhe serioziteti me të cilin foli bënë përshtypje dhe ndikuan në dobi të tij.

- Kështu, de! E qartë tani! - thirri Lebezjatnikovi i entuziazmuar. - Ja ç'na qënka! Me të shkelur në derë Sonja Semionovna, më pyeti me zë të ulët: Raskolnikovi aty është? Pra, ia donte puna që të ishit.

Lluzhini heshtte, por buzagazi i kithtë shprehte përbuzje. I kishte ikur fytyra fare, dukej që mendonte i tendosur si të dilte nga kjo gjendje. Fare mirë mund të merrte e të largohej, por në rrethanat e krijuara nuk do të ishte kaq e lehtë, pastaj kjo donte të thoshte pajtim me ato që u thanë. Shumëkush ishte i dehur, mund t'i ndodhte edhe

ndonjë incident. Sidomos kapteri në lirim çirrej e tundte krahët, kërkonte të merreshin masa aspak të këndshme për Lluzhinin. Por kishte edhe që nuk kishin pirë, aty ishin mbledhur thuajse gjithë banorët e shtëpisë. Më të indinjuar dukeshin polakët, thërrisnin dhe e kërcënonin në gjuhën e tyre. Sonja i dëgjonte e tendosur, por dukej që s'po arrinte dot të kuptonte deri në fund ç'po ndodhte, ngjante me atë që sapo është përmendur pas alivanit. S'ia shqiste sytë Raskolnikovit e bindur që ishte i vetmi, i cili mund ta mbronte. Katerina Ivanovna mezi mbushej me frymë, dukej fare e kapitur, ndërsa Amalia Ivanovna dukej si e shushatur. Një gjë kuptohej mirë: Pjotër Petroviçi kishte rënë brenda me këmbët e veta. Unaza njerëzore erdhi u ngushtua rreth Lluzhinit, por ky vazhdonte të mbahej serbes. Kur pa që nuk i shkoi e tija, iu kthye harbutërisë së paturpshme.

- Më falni, zotërinj! Pa prisni pak! Mos shtyni kështu! Hapeni rrugën! - tha, duke çarë grumbullin. - Lërini kërcënimet, nuk jam nga ata që trëmben, kam parë edhe ca më trima se ju... Do përgjigjeni, zotërinj, që me dhunë po e mbroni aktin kriminal. Vjedhësin e kapa dhe çështjen do ta ndjek penalisht! Se ata të gjyqit nuk janë të dehur, as sarahoshëve s'kanë për t'u besuar, po as të pafeve... Më lejoni!

- Nga sytë, këmbët! Qafën thefsh! S'dua ta shoh më bojën! E ç'nuk bëra për ta zhvilluar e ftilluar këtë njeri... Dy javë rashë telef! - thirri fare i çakërryer Lebezjatnikovi.

- Po unë vetë kërkova të largohem... Ju më mbajtët. Veç ja ku po jua them: jeni fare budallë! Shëroni sytë nga sklepat, atë bëni! Hapuni, zotërinj!

Bëri të çante grumbullin, por kapteri nuk dëshironte që ky i poshtër të largohej pa u ndëshkuar: rrëmbeu gotën dhe e vërviti në drejtim të Pjotër Petroviçit, nuk qëlloi në shënjë, gota u përplas mbi Amalia Ivanovnën. Kjo vuri kujën, ndërkohë që kapteri humbi ekuilibrin dhe u plandos nën tryezë. Pjotër Petroviçi sakaq rrëshqiti pa u vënë re, u kyç në dhomën e Lebezjatnikovit dhe pas një gjysmë ore u zhduk.

Sonja ishte e vetëdijshme, që me karakterin që kishte, fare lehtë mund ta merrte nëpër këmbë kushdo, pale pastaj për ta fyer pa u ndëshkuar, veç shkonte me bindjen që e keqja mund të shmangej, duke u treguar kokulur, e përkorë dhe e kujdesshme. Zhgënjimi që provoi sot ishte i llahtarshëm. Sigurisht, me durim e gjakftohtësi mund

ta kalonte edhe këtë fatkeqësi, por shuplaka kishte qënë tepër e rëndë, fyerja e tmerrshme i rëndonte plumb në zemër. Nderi i ishte vënë në vend, por fyerja e padëgjuar dhe pafuqia për t'iu kundërvënë së keqes e mundonin shumë. Nuk po duronte dot më, doli me vrap nga dhoma. As Amalia Ivanovna, pas asaj gotës, nuk kishte si qëndronte më aty, por para se të largohej, iu vërsul Katerina Ivanovnës, të cilën e mbante për shkaktare të kësaj katrahure.

- Mblidhni leckat dhe marsh që këtej! - i tha dhe u turr që ta bënte atë që tha. Si fantazmë u ngrit nga shtrati Katerina Ivanovna, ku ishte pështetur pak sa për të mbledhur forcat, se nuk po qëndronte dot më, dhe iu vërsul të kacafytej, por forcat kishin qënë të pabarabarta. Amalia Ivanovna i dha të shtymën dhe e flaku tej si ndonjë pupël.

- Si? Nuk ju mjaftoi ajo shpifje prej satanaje, por po na bëka potere edhe kjo tani? Ditën e varrimit të burrit po më kërkon të dalë nga dhoma? Dhe pas gjithë asaj sajdie që i bëmë? Po ku të mbytemi, moj? O Zot! Nuk paska fije drejtësie në këtë botë jallane! Po kë do mbroke, o perëndi, në mos jo këta jetimër? Po do më shihni! Ka edhe gjyq për këto punë. Do më shohësh, moj pjellë e keqe! Poleçka, rri këtu me fëmijët, kthehem shpejt! Ta shohim një herë, ka apo nuk ka drejtësi në këtë botë!

Hodhi në kokë shallin, që e kishte nga kohët që nuk mbaheshin mend, për të cilin i pati folur dikur Raskolnikovit edhe i ndjeri Marmelladov, çau përmes njerëzve që s'po ia ndanin sytë, dhe, me rënkime e dënesa, me ofshama e lebetitje doli në rrugë, pa e ditur as vetë se ku mund të shkohej për të gjetur ndopak drejtësi. Poleçka u struk bashkë me fëmijët në një qoshe, duke u dridhur dhe duke i shtrënguar bonjakët në krahët e saj si cingla. Amalia Ivanovna hynte e dilte nëpër dhoma, diç llomostiste, por vetë fliste vetë dëgjonte; flakte e hidhte sa andej këtej ç'i dilte përpara, shtynte e sikteriste këdo që i përballej. Qiraxhinjtë nuk po dinin ç'të bënin, vinin vërdallë dhe flisnin kodra pas bregut. Kishte edhe nga ata që ia morën këngës.

"E kam radhën unë tani! - tha me vete Raskolnikovi. - Do ta shohim, Sonja Semionovna, ç'do të thoni lidhur me këtë punën time!".

Doli dhe mori rrugën që të çonte në dhomën e Sonjës.

IV

Në mbrojtje të Sonjës, Raskolnikovi u tregua nja avokat i zoti dhe i shkathët, ndonëse mbi shpatulla mbante atë barrë të tmerrshme vuajtjeje. I jepte kënaqësi ky ndryshim ndijimesh, që shumëfishohej nga ngrohtësia që ndiente për Sonjën. Me zemër të ngrirë mendonte për takimin e pritshëm me të: e kishte vendosur, do t'ia tregonte punën e vrasjes së Lizavetës. Kur i kishte thënë vetes: "Po tani ç'do të thoni, Sonja Semionovna?" - ndodhej ende nën ndikimin e ngadhënjimit mbi Lluzhinin, ndërsa tani që po i afrohej shtëpisë se Kapernaumovit, iu prenë duar e këmbë, u ligështua mosmëkeq. Qëndroi para derës dhe i bëri vetes pyetjen: "A po bëj mirë që po i tregoj për vrasjen e Lizavetës?" Ishte një pyetje e çuditshme, sepse e ndiente fare mirë, që jo vetëm nuk kishte si të mos i tregonte, por nuk duhej vonuar as një minutë. Arsyen nuk e dinte, por qe i bindur që nuk kishte si të mos ia thoshte; pafuqia para një të tillë domosdoshmërie e mundonte. Hapi derën, i vendosur që t'i jepte fund një gjendjeje të tillë, dhe kërkoi me sy Sonjën. E pa të mbështetur me bërryla në tryezë, me kokën në mes të pëllëmbëve; me ta parë, u çua dhe bëri disa hapa në drejtim të tij.

- Si do të kisha bërë pa ju! - mërmëriti. Dukej që mezi priste t'ia thoshte këto fjalë.

Raskolnikovi u ul në karrigen nga ku sapo ishte ngritur ajo. Sonja qëndroi në këmbë dy hapa më tej, njëlloj si dje.

- Hë, Sonja! - tha dhe e ndjeu si iu drodh zëri. - E kuptuat? Tërë akuza e atij maskarai qe bazuar "në gjendjen shoqërore dhe veset bashkudhëtare të saj". E kuptuat këtë?

Një vuajtje e thellë u pasqyrua në fytyrën e vajzës.

- Mos ma kujtoni atë tmerr! - foli prerë. - Edhe ato që hoqëm, më se të mjaftueshme janë.

Qeshi paksa, e trëmbur mos nuk i pëlqeu vërejtja që bëri.

- Budallaqe u tregova që u ngrita e ika. E ç'po ndodh atje? Desha të kthehesha, por ju pata dhënë fjalën, ndaj ju prita.

Raskolnikovi i tregoi për Amalia Ivanonvnën që po i zbonte nga dhoma, dhe për Katerina Ivanovnën që kishte ikur si e çartur "për të gjetur drejtësi!".

- O Zot! - thirri Sonja. - Shkojmë!

Rrëmbeu trikon.

- Ju vetëm për ata mendoni! - iu ankua Raskolnikovi disi i irrituar. - Rrini dhe me mua pak!

- Po... Katerina Ivanovna?...

- Mos kini merak, zëre se e keni këtu, - ia ktheu tërë hundë e buzë. - Po nuk ju gjeti, do ju bëjë me faj.

Sonja me një pavendosmëri munduese u ul në karrige. Raskolnikovi qëndroi i heshtur me sytë përtokë.

- Po e zëmë se Lluzhini nuk donte të shkonte aq larg, por po të donte mund t'ju fuste në burg, mund edhe t'ju çonin në Siberi e ku ta di unë. Ishte fat për ju që u gjenda unë dhe Lebezjatnikovi...

- Po, - i tha vajza me zë të shuar. - Po! - përsëriti e hutuar dhe e trëmbur.

- Ama edhe unë mund të mos isha, kurse Lebezjatnikovi fare rastësisht ktheu aty.

Sonja nuk foli.

- Po sikur t'ju dënonin? Atëhere, si? Ju kujtohet ç'ju fola dje?

Sonja vazhdoi të heshtte. Raskolnikovi priti pak.

- Mendova se do më thoshit përsëri: "Mos ma kujtoni atë tmerr!" - qeshi si me përdhunë. - Përsëri po heshtni? - e pyeti pas një minute. - Do të doja të bisedoja për diçka me ju. Ja, do të doja të dija ç'zgjidhje do i jepnit ju një "çështjeje", siç do të shprehej Lebezjatnikovi. (E ndjente që po fillonte të ngatërrohej). Ju flas seriozisht! Se ja, Sonja, ta zëmë se qysh më parë ishit në dijeni të keqdashjes dhe të prapësisë së Lluzhinit, e dinit që ky ishte një fund i pashmangshëm tuaji, i Katerina Ivanovnës dhe i fëmijëve. (Për veten tuaj ju mendoni në fund, madje s'e vini veten në hesap!) Poleçka po... nuk do kishte rrugë tjetër! E pra, u gjendët para kësaj "çështjeje": të rrojë e të trashëgojë një i tillë si Lluzhini, duke vazhduar të bëjë poshtërsi e mizori, apo të vdesë Katerina Ivanovna bashkë me fëmijët? Ju vetë ç'zgjidhje do t'i jepnit kësaj "çështjeje"? Kush nga të dy duhej të vdiste?

Sonja e pa e shqetësuar, diç ndjeu në këtë pyetje të tmerrshme, në mënyrën si u bë. E kuptoi që me këtë pyetje Raskolnikovi rrihte larg.

- E dija që do ma bënit këtë pyetje, - tha dhe e pa hetueshëm.

- Ashtu qoftë, por m'u përgjigjni, ju ç'zgjidhje do t'i jepnit?

- E pse pyesni për gjëra të pamundura? - ia ktheu Sonja me neveri.

- Pra, më mirë të rrojë Lluzhini dhe të vazhdojë lapërdhitë e panumëruara? Kështu?

- Nuk jam unë ajo që duhet t'u jap këmbë punëve të Zotit! E pse më pyesni për gjëra që nuk duhen pyetur? E ç'rëndësi paska zgjidhja që do t'i jepja unë asaj "çështjeje", për të cilën më pyesni? E kush më paska ngarkuar në rolin e gjyqtarit?

- Po në t'u ngatërrofshin nëpër këmbë punët e Zotit? Atëherë si t'ia bësh? Ç'zgjidhje t'i japësh! - belbëzoi i zymtë.

- Pse nuk ma thoni troç, ç'kërkoni nga unë? - thirri me dhimbje Sonja. - S'po mundem ta kuptoj, ku doni të dilni? Mos paskeni ardhur të m'i shtoni vuajtjet?

Nuk e mbajti dot më veten, u shkreh në vaj. Ai e shihte i pikëlluar dhe fare i drobitur. Kaluan kështu nja pesë minuta.

- Ke të drejtë, Sonja, - foli me zë të ulët, të ngrohtë. - Dje të dhashë fjalën që do të vija të kërkoja ndjesë dhe ashtu e fillova... Ndërsa ato që të thashë lidhur me Lluzhinin, më takojnë mua... Erdha të të kërkoj falje.

Deshi t'i buzëqeshte, por e pengoi një si fuqiprerje dhe mëdyshje. Ktheu kokën dhe mbuloi fytyrën me duar.

O çudi! Një ndjenjë e ngjashme me urrejtjen ia përqethi atë çast zemrën e brengosur. U habit dhe u tremb nga kjo, ngriti kokën dhe e pa drejt në sy: shikimi iu ndesh me sytë e shqetësuar, të përvuajtur dhe lutës të Sonjës; ishin të mbushur me dashuri. Urrejtja iu terratis, si të ishte hije. Gabimisht njërën ndjenjë e kishte marrë për tjetrën. Pra, çasti i volitshëm kishte arritur.

E mbuloi përsëri fytyrën me duar, e vari kokën poshtë. I verdhë dyllë u çua nga karrigia, pa nga Sonja dhe, pa thënë asnjë fjalë, u ul në shtratin e saj.

Çasti që po kalonte ngjante tmerrësisht shumë me atë, kur qëndronte para plakës, pasi e kishte hequr sëpatën nga laku, e mbante të shtrënguar pas trupit dhe i kishte thënë vetes: "O tani, o kurrë!"

- Ç'po ju ndodh kështu? - e pyeti Sonja që ia ndiqte me frikë lëvizjet.

Nuk ishte në gjendje t'i përgjigjej, s'e kishte menduar kështu rrëfimin, as vetë nuk po e kuptonte ç'po i ndodhte. Sonja iu afrua, u ul në shtrat dhe qëndroi në pritje, pa ia shqitur sytë. Tendosja nervore

ishte në kulm, s'durohej më dot jo. Raskolnikovni ngriti kryet, i ktheu fytyrën dyllë të vërdhë, buzët iu shtrëmbëruan si nga një dhimbje e pazakontë, duke dashur diç të shqiptonin. Sonja e ndiqte me zemër të ngrirë.

- Por ç'keni kështu, - e pyeti përsëri e vrerosur dhe u mënjanua paksa.

- Nuk kam gjë, mos u trëmb... Se si më erdhi! Kot ashtu!... - pëshpëriti me pamjen e njeriut të ndodhur në fatkeqësi, por që nuk di nga t'ia mbajë. - E përse duhet të të vë në siklet?... - shtoi dhe e pa ngultas. - Përse? Ja çfarë s'po arrij ta kuptoj.

Para një çerek ore nuk ia kishte bërë këtë pyetje vetes, tani po ia bënte fuqiprerë. Dridhej i tëri, dukej që s'ishte fare në vete.

- Ç'dhimbje të madhe jeni duke përballuar! - i tha me keqardhje Sonja.

- Gjepura! Dëgjo si është puna, Sonja! (Se përse vuri buzën në gaz, por i doli diçka e sajuar, pa jetë). Të kujtohet ç'të thashë dje? Të thashë që do të të tregoja diçka kur të vija...

Sonja e shihte e tronditur në pritje të tregimit.

- ... do të tregoja... kush e vrau... Lizavetën.

Sonjës i shkuan të dridhura.

- Ja, erdha dhe tani do ta them.

- Ashtu vërtet. Dje, kur po dilnit.. - belbëzoi ultas dhe me vështirësi ajo. - E nga e ditkeni? - e pyeti shpejt e shpejt.

Mezi merrte frymë, fytyra iu zbeh, trupi i dridhej.

- E di.

Ajo heshti.

- Mos e gjetën? - pyeti e drojtur.

- Jo, nuk e kanë gjetur.

- Atëherë nga e ditkeni? - e pyeti me zë fare të shuar vajza dhe përsëri ra heshtja. Ai e pa në sy.

- Gjeje vetë. - Nëpërdhëmbi me buzagazin e shtrëmbëruar e të çuditshëm.

Vajza nuk po e mblidhte dot veten, dridhej e lebetitur.

- Po... ju... po më kallni... datën! Pse më trëmbni! - i tha me një buzagaz të pafajshëm fëmije.

- Domethënë... jam mik i tij... meqë e di... - vazhdoi Raskolnikovi

pa ia larguar shikimin. - Nuk donte... të vriste... Lizavetën... E vrau... rastësisht. Vajti për të vrarë plakën... kur ishte vetëm... Atë kohë hyri Lizaveta... e vrau... edhe atë...

Kaloi një minutë e lemerishme heshtjeje. U panë sy ndër sy.

- Pra, nuk po e gjen dot kush? - e pyeti me ndjenjën e atij që është duke u hedhur nga kambanarja.

- Jo-o-o! - mezi shqiptoi Sonja.

- Pa më vështro mirë!

Sakaq një ndjenjë tanimë e njohur ia kallkanosi zemrën; shihte vajzën dhe iu bë se ishte duke parë Lizavetën. Ia mbante mend mirë shprehjen e fytyrës, kur iu afrua me sëpatë në dorë, ndërkohë që ajo zbythej për nga muri, me duart e zgjatura përpara dhe me tmerrin fëmijëror që i kishte ngrirë në fytyrë, gati të vinte kujën. Edhe Sonja ashtu po e shihte: po aq e pafuqishme, me po atë tmerr, me dorën e majtë të shtrirë përpara, duke u çuar nga krevati, për t'u larguar prej tij dhe duke e parë me sy të ngrirë. Lemeria e saj iu transmetua atij. Raskonikovi po e shihte me një buzëqeshje fëmijërore.

- Tani e gjete kush? - e pyeti me pëshpërimë.

- O Zot! - rënkoi vajza dhe ra fuqiprerë përmbys në jastëk. Atypëraty i dha trupit përpjetë, iu afrua, ia kapi të dyja duart, ia shtrëngoi fort, si në mors dhe përsëri ia nguli atë shikim të ngrirë që shprehte makth. Përpiqej të gjente qoftë edhe një fije shprese të fundit nga e cila të mund të kapej. Por shpresa nuk kishte; ishte e qartë: vrasësi ishte ai! Edhe më pas, kur i ndërmendte këto çaste, i dilnin djersë të ftohta; çuditej që kishte arritur ta kuptonte menjëherë, që s'kishte asnjë dyshim. Asnjë parandjenjë nuk kishte patur, e megjithatë asnjë dyshim nuk kishte.

- Mjaft me këto, Sonja. Mos më torturo kështu! - iu lut përvuajtshëm.

Nuk kishte menduar t'ia thoshte kështu, por kështu doli. Sonja u ngrit si e lojtur, eci deri në mes të dhomës, duke thyer duart, u kthye përsëri, iu ul pranë, thuajse ngjitur. U rrëqeth si t'ia kishin shigjetuar tejetej zemrën, brofi dhe u lëshua pranë tij në gjunjë.

- Ç'paskeni bërë! Ç'paskeni bërë kështu! - i tha me përgjërim, u ngrit, iu hodh në qafë, e shtrëngoi fort në krahët e saj.

Raskolnikovi u largua me vërtik dhe e pa me një buzëqeshje te

trishtë.

- Vajzë e çuditshme, ti Sonja! Po më përqafon dhe po më puth, pasi të tregova atë tmerr! Ti as vetë nuk e di, ç'je duke bërë!

- Nuk gjendet, jo, nuk gjendet dot njeri më fatkeq se ti në mbarë botën! - thirri ajo e dëshpëruar në kulm, pa ia vënë veshin vërejtjes që ky sapo i bëri. U shkreh në dënesa, ngashërimet ia përshkuan trupin.

Një ndjenjë e fuqishme, e panjohur ia vërshoi shpirtin, ia shkriu kallkanosjen kapitëse. Raskolnikovi iu dha me ëndje kësaj ndjenje; dy pika të mëdha loti iu rrokullisën nëpër faqe, iu mblodhën në mjekër.

- Nuk do më braktisësh tani që e more vesh? - i tha, duke e parë me shpresë.

- Jo! Jo! Kurrë! Asnjëherë! - thirri Sonja. - Prapa teje edhe në fund të botës do të shkoj! O Zot! Sa shumë fatkeqe jam... Po pse nuk u njohëm më parë! Zot i madh!

- Po ja, u njohëm...

- Tani! Po si t'ia bëjmë tani?... Bashkë, bashkë do jemi! - përsëriti si e fandaksur dhe u hodh që ta përqafonte. - Kudo që të të çojnë, do të të ndjek prapa! - Raskolnikovi u drodh nga këto fjalë, në fytyrë iu duk përsëri buzagazi i urrejtjes dhe i përbuzjes, i njeriut kryeneç.

- Po unë kushedi nuk dua që të më çojnë gjëkundi! - i tha.

Sonja e pa drejt në sy.

Pas atij tërbimi të çmendur, pas mëshirës përvëluese për fatkeqin, i feksi përsëri në mendje imazhi i tmerrshëm i vrasjes. Zëri i tjetërsuar, me të cilin i foli, i ndërmendi vrasësin. E pa e çmeritur dhe e alarmuar. Asgjë nuk dinte, nuk e dinte as si, as çfarë e as përse ishte bërë vrasja. Tani këto pyetje e vërshuan në çast. Dhe përsëri dyshimi: "Si, ai të jetë vrasësi? Po a është e mundur, vallë?"

- Po kjo! Po ç'jam duke bërë? - nëpërdhëmbi fare e handakosur, duke e detyruar veten ta mblidhte mendjen. - Po si... një si ju... vendosi të bëjë një gjë të tillë? Ç'është kjo kështu?! E përse?

- Për ta grabitur. Tani mjaft me këtë, Sonja! - i tha i kapitur dhe shumë i nervozuar.

Sonja qëndroi para tij e shtangur; befas shpërtheu:

- Të ka shtyrë uria... edhe për të ndihmuar mamanë... Kështu?

- Jo! Jo! - mërmëriti, i ktheu krahët dhe vari kryet në gjoks. - Jo se isha i uritur, as ngaqë desha të ndihmoja kënd... edhe pse të dyja

qenë... Por nuk janë ato arsyeja... Mos më torturo kështu, Sonja!

Ajo tundi krahët.

- S'më besohet ende të jetë e vërtetë! O Zot! Si është e mundur! S'ka njeri që ta besojë! Po si kështu: i jepni tjetrit gjënë e fundit që keni, kurse thoni që e vratë për ta grabitur! Ah!... - thirri papritur. - Po Katerina Ivanovnës nga ato para i dhatë? Nga ato?... O Zot!

- Jo, Sonja! - e ndërpreu vrulltas. - Nuk ishin nga ato! Ji e qetë! M'i pat dërguar mamaja: isha i sëmurë kur i mora, siç i mora ia dhashë Katerina Ivanovnës... Më ka parë Razumihini. Ishin të miat!

Sonja e dëgjonte fare e shastisur, përpiqej me të gjitha forcat ta kuptonte.

- Kurse ato para... Po unë as për të ditur nuk e di në kishte apo nuk kishte para... - shtoi me zë të shuar, i zhytur në mendime. - Ia hoqa qesenë që kishte në qafë... por as që e hapa të shihja ç'kishte, nuk arrita... Kurse sendet qenë ca zinxhirë e karfica, ashtu bashkë i futa nën një gur të madh në rrugën B... Atje janë edhe tani...

Sonja e dëgjonte e përqendruar.

- Po si kështu?... Thatë për ta grabitur, kurse për të marrë asgjë nuk paskeni marrë? - e pyeti me ngutje, duke u kapur si i mbyturi pas fijes së kashtës.

- Nuk e di... Ende nuk e kam vendosur në do t'i marrë, apo jo! - nëpërdhëmbi i menduar dhe sakaq vuri buzën në gaz. - Çfarë idiotësie që thashë!

Sonjës i shkrepi një mendim: "Mos është çmendur?" Veç e flaku tej; nuk duhej të ishte e vërtetë, ishte diçka tjetër. Por çfarë? Asgjë s'po arrinte të kuptonte.

- E di, Sonja, - i tha me një frymëzim. - E di si është puna? Po t'i kisha therur, ngaqë isha i pangrënë, do ta ndjeja veten... të lumtur! Ta dish mirë këtë! Po ty as që të hyn në punë ky pendimi im për atë çka bëra! Asnjë përfitim nuk ke. Ah, Sonja! Sa gabim bëra që erdha! E ç'e mirë të vjen ty nga ky triumf prej budallai mbi mua?

Vajza diç donte t'i thoshte, por heshti.

- Edhe dje ndaj të thirra të vish me mua, sepse vetëm ti më ke mbetur!

- Për ku më thirre? - e pyeti kjo me droje.

- Jo për të vrarë dikë, apo për ta grabitur! Mos ki keq! - qeshi helm

e vrer. - Jemi të ndryshëm ne të dy... E di, Sonja, vetëm tani munda ta kuptoj me tamam, se për ku të thirra dje. Kur ta thashë dje, as vetë s'e dija. Të mos më lësh vetëm, ja përse të thirra. Nuk do më lësh, Sonja?

Ajo i shtrëngoi duart.

"E pse, pse ia thashë? Ç'm'u desh!" - e qortoi veten Raskolnikovi në kulmin e dëshpërimit dhe e pa i vrerosur.

- E di që pret shpjegime, por ç'mund të të them? S'ke si më kupton... vetëm vuajtja ka për t'u shuar... E shoh, s'pushon së qari dhe së përqafuari. E pse e bën? Nga shkaku im që s'e mbajta dot vuajtjen brenda vetes, por e ndava me tjetrin. "Vuaj edhe ti me mua, kështu do ta kem më të lehtë". E si mund ta duash një të tillë maskara?

- Po pse ti vetë mos po vuan më pak nga kjo? - e pyeti ajo si në makth.

Përsëri i vërshuan ndjenjat dhe shpirti iu zbut.

- Sonja, mos e harro këtë: jam i lig unë! Prandaj më kanë ndodhur këto prapësi! Të kishte qenë tjetërkush, nuk do hapej kësisoj, kurse unë e bëra, ngaqë jam frikacak... dhe i poshtër... Po t'i lemë këto. Duhet biseduar.

U zhyt në mendime.

- Sa shumë që ndryshojmë nga njëri-tjetri! - thirri. - Si nata me ditën! Ç'm'u desh që erdha! S'do t'ia fal kurrë vetes këtë që bëra!

- E pse? Bëre mirë që erdhe! - iu përgjërua vajza. - Bëre mirë që ma the.

- Se ajo ashtu ishte, - i tha mendueshëm, duke e parë me dhëmbje e brengë. - Desha të bëhem Napoleon, ndaj dhe e vrava... A më kupton?

- Jo-o-o! - i tha me naivitet vajza. - Po ti vazhdo... më trego... Do ta kuptoj. Do i bluaj në mendje gjithë sa do të më thuash dhe do ta kuptoj.

- E mirë! Do ta shohim!

Heshti i menduar.

- Po ja, një ditë prej ditësh e pyeta veten: sikur të ishte gjendur në vendin tim Napoleoni dhe të mos kishte si ta niste karrierën, të mos kishte as Tulonin, as Egjiptin, as Monblanin, por të kishte përpara syve një plakaruqe qyqare e shpirtkazëm, të cilën duhet ta zhdukësh e t'i marrësh paratë që ka në sëndyk (kuptohet, nisur nga synimi që të

mund të nisësh karrierën), a do ta bënte, vallë, në rast se nuk kishte rrugëdalje tjetër? Edhe pse nuk është aspak monumentale dhe është diçka mëkatërore! E vrava për një kohë të gjatë mendjen dhe e ndjeva veten të turpëruar, kur arrita në përfundimin që Napoleonit as që do i bëhej vonë që nuk na qënka diçka monumentale... Ndoshta as që kishte për ta kuptuar se ç'paskej në këtë mes për të menduar! Për të të ndjellë krupën! Në nuk kishte rrugëdalje tjetër, do t'ia kishte vënë thonjtë në fyt! E flaka tej mëdyshjen... i lashë mënjanë lëkundjet në shembullin e atij autoriteti! Ja, kjo ka qënë e gjitha!... Të duket qesharake kjo që të tregova? Ashtu është, por ama kështu ka qënë...

Sonjës ajo që i tha nuk i qe dukur aspak qesharake.

- Më flisni hapur, jo përmes shembujve... - i tha e tulatur me një zë fare të shuar.

U kthye nga vajza, e pa i trishtuar, i mori dorën.

- Ke të drejtë, Sonja. Gjepura janë ato që thashë, llafe janë e asgjë tjetër! Ti e di që mamaja nuk ka as dhe një dyshkë, motra është e detyruar të duroj poshtërimet që i bëhen guvernantes, shpresat i mbanin tek unë. Si student nuk siguroja aq sa më duhej për të jetuar, u detyrova ta braktis shkollën. Vetëm pas dhjetë-dymbëdhjetë vjetëve, në rastin më të mirë, mund të shpresoja të bëhesha mësues apo nëpunës me rrogë që s'do t'i kalonte të njëmijë e pesëqind rublat (fliste si të përsëriste një mësim të mësuar përmendësh.) Nëna po do ishte plakur dhe rreshkur nga hallet, motra... me të mund të ndodhte diçka edhe më e rëndë... E përse duhej pritur e duruar me përulësi e nënshtrim ndaj fatit? Për t'i varrosur ato fatkeqe dhe për të bërë fatkeqe edhe gruan me fëmijët që do të lindin? E preva mendjen: do shtija në dorë paratë e plakës fajdexheshë, do t'i vija në punë dhe s'do t'i zgjasja dorën mamasë e motrës për të mbaruar universitetin, do mëkëmbesha, do ta nisja rrugën e jetës me kokën lart... Ja, kjo... kjo është e gjitha. S'do mend ajo, që e vrava plakën, nuk bëra mirë... Kjo është e gjitha.

Me mundim të madh e çoi deri në fund rrëfimin, koka iu var në kraharor.

- Jo! Nuk duhet të ketë qenë kjo! - mërmëriti në kulmin e dëshpërimit Sonja.

- Ty ashtu të duket, kurse unë të tregova të vërtetën.

- Po ç'e vërtetë na qënka kjo! O Zot!

- Sonja, po unë vetëm një morr vrava! Askujt nuk i duhej! Të kallte krupën, kur e shihje! Ishte edhe dëmprurëse!

- Ç'thua? Njeriu na qënka morr?

- E di këtë... Nejse, nuk kam të drejtë! Ti mirë e the. Shkaqet janë të tjera, krejt të tjera! Nuk kam folur me kërkënd për këtë... Po më çahet koka nga dhimbja...

Sytë i çonin xixa, siç ndodh kur ke ethe. Zuri të fliste përçart, një e qeshur e çuditshme i bredhëronte nëpër fytyrë. Gjendja tejet e eksituar po ia linte vendin pafuqisë. Sonja e ndjente sa shumë që vuante. Gjëra të çuditshme i kishte thënë, për t'i kuptuar, ajo i kishte kuptuar, por... "Si kështu? Si! O Zot!" Nuk po gjente vend ku të futej.

- Jo, Sonja! S'është kjo! - tha pasi ngriti vrulltas kokën si i rrëmbyer nga shtjella e fuqishme e mendimeve. - Më mirë thuaji vetes që s'jam veçse një ziliqar dhe lakmitar i pashoq, njeri i poshtër dhe keqbërës, gjakatar dhe i çmendur... (Mua kështu më quan shumëkush). Se ja, të thashë që nuk kisha të holla për të vazhduar shkollën, por ama mamaja më dërgoi, mund të kullundrisesha në një farë mënyre, edhe vetë diçka mund të nxirrja. Razumihini kështu bën. Por isha ligështuar keq, nuk doja! Ligështuar, ja fjala që duhet! U mbylla brenda katër mureve, ti e di atë musëndër! Se tavani i ulët dhe ngushtësia e dhomës ta ndrydhin edhe shpirtin edhe mendjen. Sa shumë që e urreja atë vrimë! Por edhe për të ikur, nuk ikja! Nuk dilja nga ajo musëndër me ditë të tëra; as për të ngrënë nuk më vinte ndërmend. Po të më sillte diçka Nastasia, mirë, s'më sillte, nuk tundesha vendit, dhe e di, nga inati nuk luaja. Qirinj nuk kisha, rrija në errësirë! Të punoja për të blerë, nuk doja! Duhej mësuar, kurse librat i shita, mbi fletoret, që janë mbi tryezë, ka një gisht pluhur! Më pëlqente vetëm të rrija shtrirë, të mendohesha! Edhe ëndrra shihja, ca ëndrra të llahtarshme, të çuditshme! Më faniteshin edhe hije!... I thirra mendjes dhe pyeta veten: e pse sillem si idiot, kur e di që edhe të tjerët kështu rrojnë, ndërsa unë nuk kam synime të jem më i mirë se ata? I thashë vetes, Sonja, se po të prisja të bëheshin të gjithë të mençur, do më kishte dalë bari një pëllëmbë... Ama që t'i bëja njerëzit të ndryshonin, këtë s'kisha si e arrija! Ky është ligj! Pra duhej qëndruar mbi të tjerët! E kuptova, Sonja, se kush e ka të fortë mendjen dhe vullnetin, ai është zot, ai ngrihet mbi të tjerët! Kush guxon shumë, ai dhe ka të drejtë!

Kështu ka qënë dhe kështu do të jetë, Sonja. Vetëm ai që është i verbër, nuk e sheh këtë!

Fliste dhe ndiqte me vëmendje në po e kuptonte Sonja? Ethet po e tundnin, ndjente një si entuziazëm të zymtë. (Sa shumë kohë që nuk kishte folur me njeri për këtë!) Sonja e kuptoi që tërë ky rrëfim qe bërë tanimë besim dhe ligj për të.

- Isha i bindur, Sonja, që i pushtetshëm bëhet vetëm ai që kuturis ta rrëmbej pushtetin. Tërë puna është të guxosh! Më shkrepi një mendim që nuk e ka patur kush në botë! Askush! Po si nuk ka guxuar deri më sot ndokush ta flakë tej këtë absurditet? E pra, guxova dhe vrava... Vetëm ketë dëshirë kisha, Sonja, të guxoja! Ja arsyeja.

- O, mjaft, mjaft tani! - thirri Sonja dhe tundi krahët e dëshpëruar. - I je shmangur rrugës së Zotit! Ai dhe të dërgoi dënimin, të hodhi në krahët e Qoftëlargut!...

- Domethënë, Sonja, kur rrija ashtu në errësirë dhe rëkëlleja në mendjen time si i fandaksur tërë ato mendime, paska qenë Qoftëlargu ai që më nxiste? Kështu?

- Mjaft me këto! Nuk duhet as menduar e as folur kundër Zotit! Asgjë nuk po arrini të kuptoni!

- Po pse? E di dhe vetë që ishte Qoftëlargu ai që më prishte mendjen dhe më shtynte, - i tha. - Edhe vetë e kam shkuar jo një herë në mendje diçka të tillë, por më kishte ardhur në majë të hundës! Desha ta nisja gjithçka nga e para, t'i harroja të mëparshmet. I pata menduar të gjitha dhe shkova me mendjen top! Kjo më mori në qafë! Fort mirë e kam ditur që, kur i bëra vetes pyetjen: a kam të drejtë të zotëroj pushtet, domethënë se nuk kisha të drejtë. Apo kur pyesja veten: a është njeriu morr, domethënë ai nuk ishte morr, se i tillë është vetëm për atë që nuk i bën këto pyetje, por vepron, vetëm vepron! Nëse e torturoja veten me ditë të tëra në do ta bënte apo jo Napoleoni, domethënë nuk isha Napoleon! Veç ishte kjo për mua një torturë e padurueshme, desha ta shkund nga supet këtë barrë, vendosa të vrisja. Sonja, pa ndonjë shkak, vetëm për vete! Nuk u nisa nga dëshira për të ndihmuar mamanë e motrën, as për t'u shndërruar në bamirës të njerëzisë. E vrava vetëm për veten time. Në se do bëhesha paskëtaj bamirës, apo do t'i kapja të tjerët në pezhishkën time dhe do t'ua pija gjakun, kjo për mua, në ato çaste, nuk kishte fare rëndësi. Nuk e bëra

ngaqë më duheshin para, Sonja! Tani më është kthjelluar çdo gjë në kokë! Atëhere më duhej t'ia bëja të qartë vetes: ç'isha, vallë, njeri apo morr! A isha i zoti që të kapërceja pragun, apo më mungonte guximi? Kush isha: bëzhdil apo njeri që kërkon të drejtën e tij!

- Ç'të drejtë? Të drejtën për të vrarë? - e kundërshtoi Sonja.

- Ah, moj Sonja! - thirri i nervozuar, deshi t'i kundërshtonte, por parapëlqeu të heshtte me shprehjen e përbuzjes në fytyrë. - Do të bëje mirë të mos ma shtoje dëshpërimin. Ja si qëndron puna: për të shtyrë më shtyu Qoftëlargu, por po ai ma bëri të qartë që nuk kisha të drejtë, sepse jam morr si gjithë të tjerët! Më talli sa deshi e si deshi dhe, ja, tani ku më ke! Hapja derën mikut! Se po të mos isha morr, a do kisha ardhur, vallë? Se të thashë, edhe tek ajo plakaruqe kur shkova, vetëm për këtë shkova: të provoja veten kush jam! Mos e harro këtë!

- Dhe e vratë! E latë në vend!

- Po, ama si e vrava pa? Pse ashtu vrasin? Pse ashtu shkojnë për të vrarë si shkova unë atëherë? Do ta tregoj ndonjëherë si shkova. Po pse, mos vrava plakaruqen unë? Unë veten time vrava!... E vrava një herë e përgjithmonë... Plakaruqen e vrau Djalli. Qoftëlargu e jo unë! Po mjaft me këtë, Sonja. Më ler të qetë tani... - thirri në kulmin e dëshpërimit.

Mbështeti bërrylat në gjunjë dhe e mbërtheu kokën me të dyja duart si në morsë.

- Ç'vuajtje e tmerrshme kjo juaja! - rënkoi nga thellësia e shpirtit Sonja.

- Si t'ia bëj tani, më thuaj? - e pyeti pasi ngriti me vërtik kokën dhe e pa me një shprehje makthi e mundimi të pafund.

- Si t'ia bëni? - i tha ajo dhe brofi, sytë iu rrëmbushën me lot dhe i lëshuan shkrepëtima. - Pa ngrihuni! (E kapi nga supet; ai u ngrit duke e parë i mahnitur.) Shko, që tani shko, e qëndro në udhëkryqe, përkulu e puth tokën, që e profanove dhe e përlyeve asisoj, pastaj përulju botës mbarë, në të katër anët e saj, shqipto me zë të lartë, që ta dëgjojnë të gjithë: "Unë e vrava!" Atëherë Zoti do ta dhurojë përsëri jetën! Hë, do shkosh? - e pyeti, duke u dridhur e duke e parë e shpërfytyruar, siç i ndodh atyre që u bie sëmundja e tokës; pastaj e kapi nga të dyja duart, ia shtrëngoi fort dhe e përzhiti me zjarrin e syve të saj.

Raskolnikovi po e shihte i mahnitur, krejt i befasuar nga ky

entuziazëm përdëllimi të paanë.

- Më dashke të mirën! Dashke të përfundoj në galerë! - i tha vrenjtur.

- Duhet marrë vuajtja e mëkatit, duhet larë gjynahu i bërë, ja ç'duhet bërë!

- Jo, nuk kam për të shkuar, Sonja!

- Po si do jetosh atëherë? - e pyeti. - Pse rrohet kështu? Si do t'i dalësh përpara mamasë? (Po me ato ç'do bëhet? Ç'i pret ato pas kësaj?) Po ç'jam duke thënë! Ti u ndave prej tyre! Ti ato i braktise! O Zot! - Rënkoi me dëshpërim të madh. - Po ti këto dhe vetë i di! Po pse a rrohet duke mos qenë njeri? Si do vejë kjo puna jote?

- Mos u trego fëmijë, Sonja! - i tha me zë të ulët. - E përse qënkam fajtor para atyre? E pse m'u dashka t'u paraqitem? E çfarë t'ju them? Hije, vegim e asgjë tjetër nuk është kjo!... Rrojnë e trashëgojnë me mijëra njerëz në këtë botë, çdo ditë ua marrin shpirtin të tjerëve dhe këtë e quajnë bamirësi... Batakçinj e të poshtër janë... Jo, nuk kam ndër mend t'u dorëzohem. E ç't'u them? T'u tregoj se i vrava për paratë që nuk i përvetësova? Që i fsheha nën gur? - e pyeti me një buzagaz të vrerët. - Po ata do tallen, do më vënë në lojë... Ata nuk janë të denjë ta kuptojnë këtë! E pse u dashka t'u shkoj? Jo! Nuk kam për t'u shkuar! Mos u trego fëmijë, Sonja!

- Do vuash! Do të vrasë ndërgjegja për atë që bëre! - i tha vajza e vrerosur, duke ia zgjatur krahët me lutje.

- E ku i dihet, - i tha mendueshëm me zë të trishtuar. - Kushedi mundet të jem ende njeri e jo morr, ndoshta u nguta në vlerësimin që i bëra vetes... Nuk kam për të hequr dorë nga lufta...

Buzët e shtrëmbëruara dhe të fryra i shprehën vetëkënaqësi.

- Të pret mundim i madh! Tërë jetën nuk do të ndalet!

- Do mësohem... - nëpërdhëmbi i trishtuar dhe i menduar. - Pa dëgjo, - iu drejtua pas pak. - Mjaft qave. Të flasim se ç'duhet të bëjmë. Erdha të të them që janë duke më ndjekur...

- Ah! - thirri Sonja.

- E ç'pate kështu? Ti vetë më mësove që ta pranoj galerën, kur, ja, u trëmbe! Por nuk më kapin dot! Do përleshem fytafyt, s'kanë ç'të më bëjnë! Nuk kanë fakte! Dje qesh në rrezik të madh, thashë se mora fund, por sot punët janë në rregull. Akuzat që më bëhen fare

mirë mund t'i kthej në dobinë time, më kupton? Dhe do t'ia arrij... E kam të qartë ç'duhet bërë. Ama që një ditë do më rrasin brenda, kjo do të ndodhë! Po të mos kishte rastisur diçka e papritur sot, që sot do më rrasnin. Po s'ka gjë. Mundet edhe të më mbajnë për një kohë, por do detyrohen të më nxjerrin, nuk kanë fakte!... Këtë ta thashë që ta dish. Mamanë dhe motrën do mundohem t'i bind që ata të policisë nuk kanë të drejtë, nuk dua që ato të trëmben. Motra, për fat, është e siguruar me të holla. Po bashkë me të edhe mamaja... Ja, kjo është e gjitha. Ji e kujdesshme, sido që të venë punët. Po në burg a do më vish?

- Do të vij! Do të vij!

Rrinin pranë e pranë të sëkëlldisur dhe të pikëlluar, si të flakur në breg pas furtunës. E shihte Sonjën dhe e ndjente që zemrën e kishte plot me dashuri për të; po e çudiste tjetra: sa e rëndë dhe e dhimbshme është për të dashuria e Sonjës; po ndiente dhimbje e brengë që e dashuronin aq shumë njëri-tjetrin. Ishte ndjenjë sa e çuditshme aq dhe e tmerrshme kjo e tyre.

Kur ishte duke ardhur këtu, e pati të qartë që vetëm tek ajo i kishte të gjitha shpresat, vetëm përmes saj ishte rrugëdalja; kishte vendosur t'i ndante me të vuajtjet, ta lehtësonte veten. Kurse tani, që zemra e njerit u derdh në zemrën e tjetrit, u bind që u bë edhe më fatkeq se më parë.

- Sonja, - i tha, - më mirë mos eja, kur të më kenë futur brenda.

Sonja nuk u përgjigj. Vetëm qante. Kaluan kështu disa minuta.

- Ke kryq? - e pyeti befas. U duk që vetëm tani iu kujtua.

Ai nuk e kuptoi pyetjen.

- Nuk ke! E sheh, nuk ke! Na, merre, është prej dru qiparizi. Kam dhe një tjetër, prej bakri. Është i Lizavetës. I kemi këmbyer: ajo më fali kryqin, unë i fala një ikonëzë medalion. Do mbaj kryqin e Lizavetës. Ti mba këtë. E ke nga unë... nga unë! Se ne të dy bashkë do t'i kalojmë të gjitha vuajtjet, të dy do t'i mbajmë kryqet!

- Ma jep! - i tha Raskolnikovi. Nuk donte t'ia prishte qejfin. Por në çast e tërhoqi dorën.

- Jo tani, Sonja! Më vonë... - shtoi që ta qetësonte.

- Po, po! Mirë thoni! Më vonë... - iu përgjigj tërë ndjenjë. - Kur të vuash dënimin, atëherë merre. Do vish këtu, do ta var në qafë me

dorën time, do t'i falemi e do t'i lutemi të dy Zotit dhe do nisemi.

U dëgjuan tri të trokitura në derë.

- Sonja Semionovna! Mund të hyj? - zëri që pyeti ishte i njohur, i përzemërt.

Sonja vrapoi drejt derës e trëmbur. Në derë u duk fytyra kullashe e zotit Lebezjatnikov.

V

Lebezjatnikovi ishte tepër i alarmuar.

- Më falni, Sonja Semionovna... Sa mirë që ju gjeta, - iu drejtua sakaq Raskolnikovit. - E dija që këtu do ishit... domethënë, jo se dija, por mendova... Katerina Ivanovna është çmendur fare. - Iu kthye përsëri Sonjës pa u kujdesur për t'ia thënë me takt.

Sonja thirri e trëmbur.

- Desha të them që duket si e çmendur... Nuk dinim ç'të bënim. U kthye fare e dërrmuar, do ta kenë zbuar, ndoshta edhe e kanë keqtrajtuar... Kishte qenë te zoti Semion Zahariçi, s'e kishte gjetur në shtëpi, kishte qenë për darkë tek një gjeneral, shok i tij... E kishte mbajtur te ky frymën, kishte kërkuar ta ngrinin nga tryeza Semion Zahariçin. E kishin zbuar, por më parë jo vetëm që e paska sharë, por edhe e paska qëlluar me një objekt të fortë, kështu thotë. Ua tregon me një lloj guximi njerëzve, edhe Amalia Ivanovnës ia tregoi. Vazhdon të thotë se do dilte në rrugë e do t'i binte organetit, ndërsa fëmijët do kërcenin e do këndonin. Do mblidhte para. Edhe nën driraret e gjeneralit do t'i binte. "Ta shohin, si jemi katandisur! Ja edhe fëmijët fisnikë të nëpunësit me merita". Fëmijët i rreh dhe i frikëson, Lenën e mëson të këndojë, Koljan të hedh valle; grisi ca rreckurina dhe thotë se do të japë shfaqje; vetë do marrë një legen që ta përdorë në vend të daulles. Asnjë nuk dëgjon. Nuk më duket mirë...

Tregimi i Lebezjatnikovit nuk do të kishte të sosur, por Sonja, që po e dëgjonte e lemeritur, rrëmbeu kapelen dhe doli me vrap nga dhoma. Raskolnikovi i shkoi pas dhe Lebezjatnikovi pas tyre.

- Ka luajtur! - ia përsëriti Raskolnikovit, kur dolën në rrugë. - Nuk desha ta trëmb Sonja Semionovnën që nuk ia thashë troç! I vjen edhe

nga veremi... Po unë nga mjekësia, për fat të keq, nuk marr vesh. Desha ta qetësoj, por nuk ma vari fare.

- Mos i thatë gjë që i vjen nga tuberkulozi?

- Jo! Desha të të them se po t'i flasësh tjetrit me logjikë e ta bindësh, qetësohet. Pse mos keni bindjen që nuk qetësohet?

- Do ishte fare e lehtë jeta atëherë! - iu përgjigj Raskolnikovi.

- Domosdo, Katerina Ivanovna nuk e ka aspak të lehtë ta kuptojë, por, a keni dëgjuar, në Paris janë duke u bërë prova të suksesshme lidhur me shërimin e të çmendurve me anë të bindjes, të logjikës së fortë. Ka qenë një profesor i dëgjuar, tani ka vdekur. Thotë se çmenduria s'qenka veçse lajthitje, çrregullime të rënda nuk paska, vetëm një shikim i gabuar i sendeve na qenka. Vetëm se paska përdorur edhe dushin e kjo ia vë në pikëpyetje arritjet.

Raskolnikovi kishte kohë që nuk po e dëgjonte. Kur arriti te shtëpia ku banonte, e përshëndeti me kokë Lebezjatnikovin dhe ngjiti shkallët. Lebezjatnikovi, si të qe përmendur, pa përreth dhe shkoi më tej.

Hapi derën dhe qëndroi në mes të dhomës musëndër, pastaj pyeti veten: "E pse ishte kthyer?" Nga oborri vinin të trokitura, sikur ngulnin gozhdë. Iu afrua dritares, pa në majë të gishtave, s'dukej njeri. Në driraret karshi kishin varur lëveret... Sa herë e kishte parë atë pamje! U ul në kanape.

Rrallëherë e kishte ndjerë veten aq të vetmuar si tani. Përsëri ndjeu një si dalldi dhe urrejtje për Sonjën, ishte tanimë plotësisht i bindur që e pati bërë edhe më fatkeqe. "E ç'mu deshën lotët e saj? E përse duhet ta marrë në qafë? Ç'poshtërsi jam duke bërë!"

- Do t'i përballoj të gjitha vetë, nuk ka pse vjen në internim me mua. - mërmëriti.

Pas pesë minutash ngriti kokën dhe pa përreth në një buzagaz tjetërsoj. I shkrepi një mendim i çuditshëm: "Ku i dihet, në galerë mund të jetë më mirë..."

As vetë s'e dinte sa kohë ndënji ashtu, me ato mendime lesheli në kokë. Befas u hap dera dhe hyri Avdotja Romanovna. E pa që nga pragu ashtu siç e kishte parë ai pak më parë Sonjën, pastaj hyri dhe u ul në karrige karshi tij. Ai e pa heshturazi, fare mospërfillës.

- Nuk do rri shumë, - i tha. Ishte e menduar, por jo e zemëruar. Po e shihte e qetë dhe dashamire. Kishte ardhur, sepse e donte.

- E di si është puna, ma tregoi Dimitri Prokofiçi. Dyshojnë për gjëra të rënda, madje janë duke të ndjekur... po të bien në qafë... Dimitri Prokofiçi më tha që s'të kërcënon asnjë rrezik, më kot i merr gjërat afër zemrës. Unë të kuptoj: je i indijuar dhe i nervozuar e kjo mund të të kushtojë shtrenjtë. Kësaj ia kam frikën! Që na braktise asisoj, nuk kam si të fajësoj, të kërkoj falje që të kundërshtova. E di që po të më kishte ndodhur mua, ashtu do të veproja. Mamasë nuk do t'i tregoj, por për ty do t'i flas vazhdimisht, do ta qetësoj, duke i thënë se do kthehesh së shpejti. Mos u bëj merak për të, mos e mundo, eja në të rrallë, mos harro që është nënë! Erdha të të them se, në të nevojitet ndihma ime... tërë jeta ime... më bëj zë, këtu më ke. Lamtumirë!

U çua vrulltas dhe iu drejtua derës.

- Dunja, - e thirri Raskolnikovi, që ishte ngritur dhe i ishte afruar. - Razumihini, Dimitri Prokofiçi, është njeri shumë i mirë.

Dunjën e mbuloi një i kuq i lehtë.

- E çfarë? - e pyeti pas një çasti.

- Është njeri për të qenë, është punëtor dhe i ndershëm, di dhe të dashurojë më gjithë shpirt... Lamtumirë, Dunja.

Dunja u ndez në fytyrë dhe i tha e tronditur:

- Po pse, mos jemi duke u ndarë përgjithmonë? E ç'janë këto amanete që je duke më lënë?

- Sidoqoftë, lamtumirë...

- I ktheu krahët dhe iu afrua dritares. Dunja qëndroi edhe pak, e pa e shqetësuar dhe i foli e tronditur.

Nuk ia kishte fshehur ndjenjën; kishte patur një çast, kur mezi ishte përmbajtur t'i afrohej e ta përqafonte fort; t'i kërkonte ndjesë dhe bile edhe t'i tregonte si ishte puna, por nuk vendosi as t'i jepte dorën.

"Më pas do t'i shkonin mornica, kur ta kujtonte që e kisha përqafuar", - mendoi. "A do ia dalë dot mbanë kjo vajzë? - e pyeti veten i menduar. - Jo, nuk kishte për t'ia dalë. Njerëz si kjo nuk munden..." - që përgjigja që i dha vetë dhe atë çast mendja i shkoi te Sonja.

Nga dritarja hynte freskun mbrëmësor. Mori kapelen dhe doli.

Donte ta largonte mendjen nga kjo gjendje e sëmurë, në të cilën

qe ndodhur tërë këtë ditë, por s'e kishte të lehtë. Nuk e kishte zënë përfundimisht shtratin, vetëm e vetëm ngaqë s'i ndahej për asnjë çast alarmi i brendshëm, veç e ndjente që kjo s'kishte si të zgjaste shumë.

U end nëpër rrugë. Ishte nën peshën e pandashme të një pikëllimi të thellë, jo se e mundonte ndonjë dhimbje përvëluese, por ishte një pikëllim gërryes, i pandashëm ky i tij. Në orët e mbrëmjes kjo gjendje shprehej edhe më thekshëm.

- Kur je në këtë gjendje, duhet patur frikë nga marrëzitë; jo më te Sonja, por edhe te Dunja shkon e hapesh, - mërmëriti i mbushur me urrejtje.

Dëgjoi ta thërresin, ishte Lebezjatnikovi.

- Isha te ju; po ju kërkoj! Atë që e tha e bëri! Bashkë me fëmijët doli në rrugë, mezi e gjetëm me Sonja Semionovnën. Vetë i binte një tigani, fëmijët i detyronte të hidhnin valle. Qanin e lebetiteshin. Njerëzia i shkonte pas. Shkojmë.

- Po Sonja ku është? - e pyeti i shqetësuar Raskolnikovi dhe eci pas tij.

- Nuk di ç'të bëj! Katerina Ivanovnën s'ka burrë ta përmbajë! Ju thashë, është çmendur! Do t'i çojnë në polici. Edhe kjo u duhet!

I gjetën të rrethuar nga një tokicë njerëzish. Që larg dëgjohej zëri i ngjirrur dhe i çakërryer i Katerina Ivanovnës. Pamja e tyre nuk kishte si të mos tërhiqte vëmendjen e kalimtarëve. Me atë fustan të vjetër dhe me shallin stërgjyshor të hedhur krahëve, me kapalen prej kashte të zhubravitur dhe me flokët e shprishur që i binin në fytyrë, pale pastaj ashtu e fandaksur dhe gjysmake siç ishte, Katerina Ivanovna nuk kishte si të mos tërhiqte vëmendjen. Mezi qëndronte, shihte e zalisur, dukej që s'ishte fare në vete. Fytyra, por edhe tërë qenia i shprehnin vuajtje të pafund! Veç as nervozizmi e as urrejtja e mëparshmes s'ishin larguar. U vërsulej fëmijëve, i kërcënonte dhe i trëmbte, u mësonte ç'duhej të bënin sy njerëzve, i tundte dhe i shkundte si e lojtur nga fiqiri, i rrihte... Pas kësaj u kthehej njerëzve, shihte ndonjë të veshur si më mirë, i sulej, ia shpjegonte arsyen e gjendjes ku e kishin katandisur, atë dhe fëmijët "nga derë fisnike, aristokrate, thuaj!" Po t'i zinte veshi ndonjë kukurismë apo fjalë shpotitëse, turrej si allçake dhe e vinte përpara me të shara e mallkime. Kishte që qeshnin, por më shumë tundnin kryet. Tigan, siç kishte thënë

Lebezjatnikovi, nuk kishte, ritmin e mbante duke përplasur pëllëmbët, edhe vetë këndonte bashkë me fëmijët. U qahej dëgjuesve për hallet që e kishin pllakosur, qante e dëneste. Koljen dhe Lenën e kishte veshur, siç.vishen ata që këndojnë në rrugë. Djali mbante në kokë një çallmë për të imituar turkun, Lena kishte veshur një skufje të kuqe, të zbukuruar me pendë, të ruajtuara që nga koha e gjyshes, Poleçka kishte veshjen e përditshme. E shihte të ëmën me droje, i qëndronte pranë, mezi i mbante lotët, e kuptonte që nuk ishte në vete. Njerëzit e trëmbnin dhe i kallnin datën. Sonja i përsëriste për të satën herë që duhej të kthehej në shtëpi. Po pse dëgjonte kjo!

- Pusho, Sonja! Lermë! - i bërtiste duke iu marrë fryma dhe duke u kollitur. - Ta thashë njëherë që s'kthehem më te gjermanka! Le ta shohin në ç'derexhe janë katandisur fëmijët fisnikë të atit që ka shërbyer tërë jetën dhe vdiq në krye të detyrës! (E kishte trilluar me fantazinë e saj një të tillë versioni dhe tanimë i besonte verbërisht.) Le të na shohë edhe gjeneral vërdhoma! E me se do rrojmë! Mjaft ta morëm ty shpirtin! Ah, Rodion Romanoviç, ju qënkeni? Mbushjani mendjen kësaj budallaqeje që punë më të mënçur se kjo që jam duke bërë, nuk ka. Të gjithëve u ra në sy që jemi nga derë fisnike, të katandisur në këtë varfëri! Kurse atë palo gjeneral kanë për ta shkarkuar nga detyra, keni për ta parë! Në e pafsha.carin, do t'i bije në gjunjë, do t'i tregoj fëmijët. "Mëshirë për fëmijët!" - do t'i them. Lena! *"Tenez-vouz droite!"*[1] Kolja, kërce! Pse qan? Lëri këto! Mos ki frikë, mor teveqel! Hë, ç'të bëj me këta, Rodion Romanoviç! Sa të trashë që janë! S'marrin vesh fare nga këto punë!...

Me lot në sy i tregoi fëmijët që s'pushonin së dënesuri. Raskolnikovi u orvat ta bindte të kthehej në shtëpi, e preku edhe në sedër, duke i thënë që s'i kishte hije të endeshin rrugëve, në një kohë kur po bëhej gati të hapte pensionin e vajzave.

- Pensionin? Qiqra në hell! - qeshi tërë inat dhe sakaq e mbyti kolla. - Lamtumirë, o fantazi! M'i kthyen krahët të gjithë! Nga gjenerali e patëm këtë të keqe! Por edhe unë ia punova, ia vesha me takëmet e bojës, e qëllova dhe ia mbatha. Të poshtërit! Do t'i dal vetë zot fëmijëve, s'kam pse ia shtrij kujt dorën. Poleçka sa mblodhe deri tani?

---

[1]) *Mbaje trupin drejt. (fr.)*

Vetëm dy kopejka? Ah të poshtrit! Store ua ka qejfi të shohin, kurse dorën në xhep s'e fusin! Po ky tutkun, ç'm'i zbardh ata dhëmbë ashtu? (Tregoi në drejtim të njërit nga turma). Kolja nuk ia thotë fare! Poleçka, më fol vetëm frëngjisht, *parlez moi français*[1]. Ato që të kam mësuar, thuaj. Se duhet treguar që jemi derë fisnike, me edukatë. Ndalëm për të përgatitur pak këngën e vallen dhe që këtu drejt e në Prospektin e Nevës. Aty ka nga të shoqërisë së lartë, do t'u bjemë në sy. Po duhen kënduar këngë të fisme e jo tralala e trilili. Ja, këndoni frëngjisht atë, *"Cinq sous"*[2]. Duhet t'u dëgjojnë të binden që dini frëngjisht, domethënë që jemi oborrtarë; kështu do ju dhimbseni më shumë. Ose më mirë *"Malborough s'en va-t-en guerre"*, këngë për të mitur, këndohej shumë në familjet aristokrate, kur i vinin foshnjat në gjumë.

Malborough s'en va-t-en guerre,
Ne sait quand reviendra...[3]

këndoi vetë, por atypëraty heshti. - Kolia, pa hidh një valle, duart në bel, fillo, kurse ti Lena vërtitu në anën tjetër, unë dhe Poleçka do këndojmë dhe do përplasim pëllëmbët.

Cinq sous, cinq sous,
Pour monter notre mènage...[4]

Khi-khi-khi (Mend u mbyt nga kolla). Rregulloje fustanin, Poleçka, të kanë rënë supet, - i bëri vërejtje. - Kryesorja të mbahemi si na ka hije, ta shohin që jeni fëmijë oborrtarësh. Ti e ke fajin, Sonja, ngule këmbë që t'ia shkurtonim fustanin, pa shih sa keq që duket! Po pse qani kështu! Po ky ushtari ç'kërkon?

---

[1]) *më fol frëngjisht. (fr.)*

[2]) *Pesë su (fr.).*

[3]) *Malburgu shkoi në luftë,*
Nuk dihet se kur do kthehet.

[4]) *Pesë su, pesë su*
Për të ngritur katandinë.

Duke çarë mespërmes turmën, po u afrohej një polic. Në këtë kohë një njeri me uniformë zyrtari i dha tre rubla Poleçkës, duke e parë me dhimsuri e keqardhje. Katerina Ivanovna iu përkul tërë solemnitet dhe me një mirësjellje të stërholluar e falënderoi.

- Ju bëftë dita një mijë, mor zotëri mëshirëplotë! - i tha me krenari e dinjitet. - Arsyet që na shtynë... E sheh, Poleçka, ka edhe njerëz fisnikë e me zemër, i ndihmojnë ata të sërës së tyre të ndodhur në fatkeqësi. Kurse gjenerali përtypte ushqimin dhe bezdisej derdimeni, po e shqetësonin, de... Po ky ushtar ç'na u qep kështu! Ndihmë! - thirri. - Po ç'ke me ne, more!

- Nuk lejohet të endeni kështu rrugëve... Mos bëni paudhësi! - i hoqi vërejtjen polici.

- Nuk jemi duke i bërë keq kujt! Ty ç'të duhet ç'bëjmë?

- Ku banoni?

- Unë sot varrosa burrin!

- Mirë, mirë! Shkojmë e bisedojmë atje. S'është mirë të përflitemi në rrugë... Nuk qënkeni as mirë me shëndet...

- Zotëri! I nderuar zotëri! Ç'thoni ashtu! Do shkojmë në Prospektin e Nevës tani!.... Sonja! Sonja! Po kjo ku humbi kështu? Po qaka! Kolia! Lena! Po ku jeni?

Fëmijët të llahtarisur nga sytë e turmës, nga veprimet e çmendura të së jëmës, tani edhe nga pamja e policit të kapur dorë më dorë ia therën vrapit. Katerina Ivanovna u turr t'i kapte me britmat e dënesa. Ishte një pamje e lemerishme, mjerane, rrëqethëse! Sonja dhe Poleçka i ndoqën pas.

- Ktheji, ktheji, Sonja! Sa të trashë që janë! Dhe sa mosmirënjohës!... Polia, kapi moj! Po unë për ju!...

U pengua dhe u rrëzua.

- Oh! Oh! U vrava! U dërrmova! O Zot! - thërriste.

U mblodhën njerëzia. Të parët e arritën Raskolnikovi me Lebezjatnikovi. Iu afrua dhe nëpunësi, edhe polici, që mërmëriste: "Ah, sa keq!" Tundi dorën, duke parashikuar telashe.

- Largohuni! Largohuni! - thirri, kur pa që u mblodhën njerëz.

- Po vdes! - tha dikush.

- Lojti mendsh! - vuri në dukje një tjetër.

- Zoti i ruajtë! - tha një grua dhe bëri kryqin. - Fëmijët i kapën, ja

ku po i sjellin... çamarokët.

Katerina Ivanovnën e ngritën dhe panë që gjaku i rridhte nga goja e jo nga ndonjë plagë.

- E ka nga veremi, - i pëshpëriti nëpunësi Raskolnikovit dhe Lebezjatnikovit. - Në ju shtypë gjoksi, kështu u teptis gjaku këtyre... Kështu i ndodhi edhe një fqinjit tim... S'ke ç'i bën! S'e ka të gjatë.

- Ja shtëpia ime! Ta ngrehim e ta çojmë atje! Thërrisni mjekun! - tha Sonja.

Katerina Ivanovnën e ngritën dhe e shtrinë në dhomën e Sonjës thuajse pa ndjenja. Hemoragjia i vazhdonte, por zuri të përmendej. Erdhën dhe të zotët e shtëpisë. Kapernaumovët, burri shëmtaraq dhe gungaç, me flokët drizë e sytë e çakërryer, dhe gruaja e trembur mosmëkeq, bashkë me fëmijët. Mes grumbullit të njerëzve u duk edhe Svidrigajllovi. Raskolnikovi e pa i habitur.

Katerina Ivanovna po qetësohej, gjaku i ndaloi. Ia nguli sytë e përvuajtur dhe të trubulluar nga dhimbja Sonjës, që po ia fshinte djersët e ballit, pastaj kërkoi ta ngrinin. E ulën në shtrat dhe e mbajtën nga të dyja anët.

- Fëmijët ku janë? - pyeti e pikëlluar me zë të shuar. - I kape, Polja? Sa budallenj që jeni!... Pse ikët ashtu me vrap!...

Buzët ia mbulonte një shtresë gjaku i tharë. Kaloi shikimin nëpër dhomë dhe tha:

- Ja si qënka kjo banesa jote! Hera e parë që vij! Të kemi rënë në qafë, Sonja! Polja, Lena, Kolja ejani këtu! Ja ku i ke, Sonja! Merri! Unë kaq e pata! Më lini të vdes tani...

E shtrinë ngadalë dhe ia vunë kokën në jastëk

- Prifti! S'ka nevojë. S'i kemi të tepërta paratë! Gjynahe nuk kam... Edhe në paça, Zoti m'i fal edhe pa priftin. E di ç'kam hequr. Nëse nuk m'i fal, le të mos m'i falë!

Ra në kllapi, i filloi përçartja. Kohë mbas kohe përmendej, ua kalonte shikimin njerëzve, por përsëri humbte ndjenjat. Mezi mbushej me frymë, një si shpirrë i gurgullonte në gurmaz.

- I them: "Lartmadhëri", - shqiptonte me vështirësi të madhe, - Amalia Ludvigovna është kjo?... Ah! Lena, Kolja, duart në bel, filloni një, dy! Më shpejt! Përplasni fort këmbët! Ashtu, mor bir...

Du hast Diamanten und Perlen...[1]

Ah! S'më kujtohet! Ja, kjo do kënduar...

Du hast die schönsten Augen,
Mädchen, was willst du mehr?[2]

Po kështu është *Was willst du mehr;* kështu. Ose

Atë ditë përvëlimë, në fushat e Dagistanit...

Sa shumë, sa shumë që e kam dashur këtë romancë! Poleçka, yt atë, kur ishim të fejuar, e këndonte... Ah! Ç'ditë të lumtura! Sikur ta këndonim edhe njëherë! Po si vazhdon? E kam harruar! Ma kujtoni, de! - Dukej tepër e preokupuar, provoi madje të ngrihej... Pas një sforcimi të jashtëzakonshëm, me zë të ngjirur, të mekur, shqiptoi, duke e shoqëruar me një frikë të tmerrshme që i kishte ngrirë në fytyrë:

Atë ditë përvëlimë, në fushat e Dagistanit...
Me plumbin në zemër!...

Lartmadhëri! - thirri dhe u la në lot. - T'u vijë keq për jetimët! Ia njihja meritat Semion Zaharaçit, aristokrat mund ta quash... - U drodh për llahtar, u përmend dhe pa me sy të zgurdulluar, njohu Sonjën... - Sonja! Sonja! - bëlbëzoi me afsh, e përkëdheli, dukej e habitur që e kishte pranë. - Sonja! Shpirt! Edhe ti këtu?...

E ngritën përsëri.

- Ja dhe fundi! Lamtumirë! Hallemadhe po vdes... pa parë ditë të mirë me sy! Po iki! - tha me sforcim të madh dhe u lëshua pa ndjenja në jastëk. Ndënji pa lëvizur për një farë kohe, pastaj i dha kokës prapa, fytyra e verdhë, pa jetë iu var, goja iu hap dhe iu shtrembërua në

---

[1]) *Ke diamante dhe perla... (gjerm.).*

[2]) *Sytë i ke një mrekulli,*
Ç'të duhet tjetër, vajzë? (gjerm.)

grahmat e fundit, iu drodh trupi si në ngërç, iu shtrinë këmbët dhe i doli nga kraharori një psherëtimë e thellë. Dha shpirt.

Sonja i ra përsipër, e pushtoi dhe mbeti ashtu me kokën në kraharorin e tharë të të ndjerës. Poleçka ia pushtoi këmbët, zuri t'ia puthë, duke qarë e ulëritur. Kolia dhe Lena, që ende nuk e kishin kuptuar ç'ndodhi, por që e parandjenin se kishte ndodhur diçka e tmerrshme, u shtrënguan pas shoshoqit dhe ia plasën të qarit.

Si u ndodh "Fleta e lavdërimit" pranë jastëkut, një Zot e di. Raskolnikovi e pa. U tërhoq te dritarja, iu afrua Lebezjatnikovi.

- Vdiq! - i tha ky.

- Rodion Romanoviç! Kam dy fjalë të vlefshme për ju. - Ishte Svidrigajllovi që po ashtu i ishte afruar dritares. Lebezjatnikovi u tërhoq mënjanë, që t'i linte vetëm.

- Shpenzimet e varrimit i marr unë përsipër. Po të isha shumë i pasur, edhe më shumë do bëja. Vocërrakët t'i strehojmë në ndonjë jetimore, të jetë nga më të mirat. Secilit do i caktoj nga njëmijë e pesëqind rubla, që Sonja Semionovna të mos i ketë barrë. Edhe atë kam menduar ta nxjerrë nga kjo vrimë, është vajzë për të qenë! I tregoni Avdotia Romanovnës si jam duke i shpenzuar ato dhjetë mijë rublat.

- E ku doni të dilni me këtë bamirësi? - e pyet Raskolnikovi.

- Nuk i besoni kollaj tjetrit, e di! - qeshi Svidrigajllovi. - Të kam thënë që ato dhjetë mijë rubla i kam të tepërta... E bëj për shpirtin... Nuk e besoni? Se nuk ishte "morr", de, po ishte njeri! (tregoi me gisht drejt së ndjerës) Jo si plakaruqja fajdexheshë! Hë si, "më mirë të rrojë Lluzhini dhe të bëjë poshtërsi pas poshtërsie, apo të vdiste kjo?" Po të mos i japësh dorën, "Poleçka... atë rrugë do të ndjekë..."

I tha këto me pamjen e kodoshit dhe i shkeli syrin pa e fshehur shpotinë dhe dhelpërinë. Raskolnikovi u zverdh dhe u kallkanos, u zmbraps dhe e pa si të donte ta përpinte të gjallë. E nga i dinte ky këto shprehje?

- Ç'janë këto? - pëshpëriti me zor të madh me buzët që i dridheshin.

- Po ja, këtu prapa murit kam një dhomëzë, e kam zënë me qira te Reslihët, është një e njohura ime e vjetër, besnike.

- Ju?

- Unë, - vijoi Svidrigajllovi, duke u kuluvarur nga të qeshurit e

pazëshëm. - Jua them me dorë në zemër si burri burrit, Rodion Romanoviç, që më keni habitur e turbuluar pa masë, por më keni zgjuar edhe kureshtjen. Ju thashë që do takoheshim, ja dhe u takuam. Do më shihni e do bindeni vetë sa shumë i palosshëm që jam!... Me mua nuk ia çon keq...

Pjesa e gjashtë

I

Raskolnikovi po përjetonte një periudhë kohe të çuditshme: i dukej vetja si i zhytur në mjegull, rronte në një vetmi të plotë. Më pas, kur e sillte në mendje atë kohë, i thoshte vetes se kishte qenë me vetëdije disi të errësuar. Kjo gjendje i zgjati deri ditën e katastrofës përfundimtare. Sidoqoftë, pat mësuar jo pak gjëra të reja për veten, duke ia vënë veshin dhe peshuar me kujdes gjithë sa flitej për personin e tij. Ndonjëherë i ngatërroheshin në kujtesë ngjarjet dhe shkakpasojat e tyre jo gjithmonë i kishte të qarta; kishte dhe jo pak situata që i pati stisur me fantazinë e vet. Jo rrallë e kaplonte shqetësimi lemeritës deri frika, por i rastiste dhe ta kalonte kohën në apati të plotë, rrjedhojë e tronditjes dhe e llahtarisë të sapo provuar. E ndiente veten si i sëmuri para agonisë, të cilit s'i mbetet tjetër vetëm se të prehet në krahët e shpërfilljes. Me vetëdije i shmangej qartësimit të gjendjes, sidomos e pengonin faktet që prisnin shpjegim; sa shumë i gëzuar do ishte po të arrinte të çlirohej prej tyre! I qëndronin si xhebrahili mbi kokë!

E mundonte veçanërisht shumë qënia këtu e Svidrigajllovit; mund të thuash që tërë kohën vetëm për të medonte. Pas shpjegimit në dhomën e Sonjës, iu çorodit mosmëkeq rrjedha e zakonshme e mendimeve. E megjithatë nuk po ngutej me sqarimin e çështjes. Kur rrinte vetëm në ndonjë mejhane të humbur diku në një qoshe të largët të qytetit, pa e ditur as vetë se si qe ndodhur aty, mendja i shkonte te Svidrigajllovi. "Duhet biseduar dhe duhet rënë në ujdi sa më shpejt më mirë me atë njeri!" - thoshte me vete. Madje, një ditë iu bë sikur pikërisht në një humbëtirë të tillë i kishte lënë takim. Një herë tjetër, kur e kishte zënë gjumi në ca shkurre dhe qe zgjuar vetëm para se të agonte, pa e ditur as vetë si i kishte ndodhur diçka e tillë, iu kujtua që

e kishte takuar nja dy herë në apartamentin e Sonjës, por nuk ia kishte zënë ngoje çështjen. Svidrigajllovi i kishte thënë që i kishte rregulluar për bukuri kalamajtë, e kishin ndihmuar ca të njohur, por edhe paratë që u pat caktuar e kishin bërë punën e tyre, i kishte folur edhe për Sonjën dhe e kishte mbyllur bisedën me fjalët: "Do të vij këto ditë në dhomë, dua të këshillohem për diçka, të bisedojmë për ca punë..." Qenë takuar në shkallë, Svidrigajllovi e kishte parë hetueshëm dhe me zë të ulët e kishte pyetur:

- E ç'më rrini kështu, Rodion Romanoviç, sikur ju janë mbytur gjemitë? Po më shihni e më dëgjoni, por sikur nuk po kuptoni ç'ju them. Shkunduni, de! Do flasim, po ja që jemi deri në fyt me punë, me tonën, por edhe me të të tjerëve... Eh, Rodion Romanoviç, nuk bën dot pa ajër i shkreti njeri! Do ajër... ajër! Para së gjithash ajër!

Qe mënjanuar pak që të linte të kalonin prifti me dhjakun, do falnin përshpëritjen. E bënin dy herë në ditë, ishte porosi e Svidrigajllovit. Ky zbriti shkallët, kurse Raskolnikovi hyri fill pas priftit dhe dhjakut në dhomën e Sonjës.

Qëndroi te dera. Filloi përshpirtja e trishtë, e shtruar, solemne. Në vetëdije vdekja i shoqërohej nga një ndjenjë mistike, e rëndë, sfilitëse, i vinte që nga fëmijëria e largët, kishte kohë që nuk kishte dëgjuar përshpirtje. Pastaj të bënte të zije kryet me dorë dhe t'ia mbathje me lemeri pamja e fëmijëve që e kishin rrethuar kufomën; qëndronin në gjunjë te qivuri. Poleçka tërë kohën qante. Prapa tyre, me kokën varur në kraharor, qante pa u ndier Sonja. "Tërë këto ditë as më ka parë e as më ka folur!" - tha me vete. Dielli ndriçonte me bujari dhomën, tymi i temianit përhapej shtëllunga-shtëllunga, prifti mërmëriste lutjen: "Ndije Zot shpirtin!" Pas shërbesës, Raskolnikovi iu afrua Sonjës, kjo ia mori të dyja duart dhe ia pështeti kryet në sup. E habiti ky gjest. Si? As pikë neverie e krupe nuk kishte për të? Ishte vetëm një përulësi deri në pafundësi kjo e saj! Të paktën kështu e kuptoi në ato çaste. Pa i thënë as dhe një fjalë shoshoqit, pasi shtrënguan duart, u ndanë. U ndie keq. Do ta quante veten më të lumturin e botës sikur ta surdisnin diku larg dhe ta linin vetëm! Po ja që kohët e fundit, ndonëse thuajse tërë kohën rrinte vetëm, nuk e ndiente veten të vetmuar. Zgjidhte enkas vende pa njerëz, një herë që futur edhe në një korije, por sa më i vetmuar vendi, aq më pranë e

ndiente praninë e diçkaje jo dhe aq frikësuese, sesa shqetësuese, bezdisëse, nxitonte të kthehej në qytet, të përzihej me turmën në rrugë apo në ndonjë pazar. Kjo e lehtësonte, vetja i dukej më pak i vetmuar. Në një tavernë dikush këndonte; ndënji një orë të tërë duke e dëgjuar me kënaqësi, por edhe këtu e mbyti pezmi. "Rri këtu, madje dëgjoj dhe këngë; pse a më ka hije?" - mendoi. E ndjente që kishte një gjë, e cila priste zgjidhje të menjëhershme, por se ç'ishte, nuk e konkretizonte dot. "Është ku e ku më mirë përleshja... Porfiri... Svidrigajllovi... Sa më shpejt më mirë! Po! Po!" Sakaq mendimi për Dunjën dhe mamanë e bëri t'i kalojnë të dridhura, e kapi paniku. Tërë këto i qenë rrëkëllyer në mendje pikërisht atë natë që kishte fjetur jashtë, në ca shkurre. Qe kthyer në shtëpi me ethe; fjeti disa orë dhe ethet i kaluan.

Iu kujtua që sot do bëhej varrimi i Katerina Ivanovnës, u gëzua që nuk mori pjesë. Nastasia i solli diçka për të ngrënë, e hëngri me oreks; iu kthjelluan mendimet, u qetësua. Edhe vetë u habit nga tërë ajo frikë. U hap dera dhe hyri Razumihini.

- Për bukuri qënke! - i tha dhe u ul në karrige. Dukej sheshit që ishte në merak. Fliste i indinjuar, por pa e ngritur zërin dhe pa u ngutur. Dukej që donte t'i thoshte diçka të rëndësishme. - Dëgjo këtu! - filloi me zë të fortë. - S'po e marr dot vesh ç'po ndodh! Mos pandeh që kam ardhur të të marrë në pyetje. S'ka ç'më duhet! Edhe po të m'i hapje ja, tani, sekretet e tua, as që do ta çaja kokën, do ngrihesha e do ikja. Dua të di vetëm këtë: a është e vërtetë që je i çmendur? Qarkullon një mendim i tillë, në ca qarqe të caktuara. Të them të drejtën, jam një nga ata, se që je duke bërë veprime të marri, këtë kushdo e vë re, pse i pakët është qëndrimi që je duke mbajtur ndaj prindit, vetëm shpirtkazma e xhahili apo i çmenduri mund ta bënte atë që bëre. E pra, dua ta di...

- Ke kohë që i ke parë?

- Nga ato po vij. Pse nuk ke shkuar? Ku humbet kështu me orë e ditë të tëra, xhanëm? Jot ëmë zuri shtratin pas asaj që bëre! Donte të vinte të shihte, po s'e la Avdotia Romanovna. "Se në është i sëmurë, kush tjetër përveç nënës duhet t'i gjendet te koka?" - tha. Deshëm s'deshëm, e prumë, nuk lihej vetëm. Deri te dera jote e mbajtëm me gariet. Hymë, nuk ishe... Ja, këtu u ul. Ndenji pesë minuta, ne i qëndruam pranë, heshtëm. U çua e tha: "Me që qenka në gjendje të

dalë, domethënë nuk qënka aq keq! Nënën e paska harruar! S'është aspak e hijshme për të t'i rrijë te pragu i derës kërcure dhe ta presë të kthehet!" - tha. U kthye në dhomën e saj dhe zuri shtratin, e mbytën ethet. "E shoh, - tha. - Për atë të vetën gjen kohë!" E kishte fjalën për Sonja Semionovnën, për nusen a për dashnoren tënde. Shkova tek ajo për të marrë vesh si qëndronte puna. Ç'të shoh: arkivoli në mes të dhomës, fëmijët rreth tij qajnë. Sonja Semionovna po u provonte rrobat e zisë. Ti nuk ishe. I kërkova ndjesë dhe dola. Ia tregova Avdotia Romanovnës. Del që nuk e paska ajo fajin, mbetet vetëm një: çmenduria. Po të shoh me sa ëndje po e përtyp atë copë mishi, po ha si të mos kesh vënë gjë në gojë tri ditë. Dihet ajo, edhe të lojturit hanë, por edhe pse s'e ke hapur ende gojën për të më thënë ndonjë gjë, dukesh... nuk je i çmendur! Vë bast për këtë. Seç fsheh ti! S'më duhet të vras mendjen çfarë, por s'po më rrihej pa ta thënë... Erdha për ta zbrazur zemërimin që më zien përbrenda... Tani e di ç'duhet bërë!

- Po hë, ma thuaj dhe mua...

- Ty kjo s'ka ç'të duhet.

- Si? Mos do jepesh pas dehjes!

- E nga e more këtë?

- Kështu them...

Razumihini heshti.

- Ke qenë kurdoherë i arsyeshëm, kurrë nuk ke bërë marrëzi. Kurse unë edhe pas dehjes mund të jepem. Lamtumirë! - i tha prerë dhe u çua të dilte.

- Ka nja dy ditë që folëm për ty me motrën.

- Për mua?... E ku e paske takuar? - shtangu dhe i ra çehreja e verdhë. Dukej që zemra po i rrihte fort.

- Ishte këtu, biseduam.

- Ajo!

- Po, ajo.

- E ç'paskeni biseduar? Dua të them... për mua?

- I thashë që je njeri i mirë, je punëtor dhe i ndershëm. Që ke rënë në dashuri, këtë nuk ia thashë, ajo e di.

- E ditka?

- Po, e di. Sido që të ndodhë, do jesh ëngjëlli shpëtimtar i tyre. T'i kam dorëzuar, Razumihin! Flas kështu sepse e shoh që e do dhe i

besoj plotësisht pastërtisë së zemrës sate. E di po ashtu që edhe ajo mund të të dojë, ndoshta tanimë të do... E ke ti vetë në dorë të vëndosësh: në duhet apo nuk duhet dhënë pas dehjes...

- Rodka!... Dëgjo... Po... nejse! Pse ti ç'paske ndër mend të bësh?... Në do ta mbash në fshehtësi, mbaje! Veç unë... ta di... sekretin. Gjepura e trille sajon pa fund me imagjinatën tënde... Sa për njeri, s'e ke shokun! Kjo kështu është!

- Mirë, mirë, po sekretet dhe të fshehtat tani s'ke si i mëson. Lërja kohës t'i zbulojë... Dje një person e di ç'më tha? Njeriu, më tha, ka nevojë për ajër! Dua të vete ta pyes, ç'kupton ai me këtë?

Razumihini rrinte i menduar, dukej që diç po shtinte në mendje.

"Ashtu është, komplotist politik është ky! Po përjeton çaste të një hopi të rëndësishëm që kërkon të bëjë! S'ka si të jetë ndryshe... Dunja këtë e di..." - i shkoi në mendje.

- Domethënë ardhka te ti Avdotia Romanovna!... - i tha si nëpërdhëmbë. - Pra qënke duke shkuar të takosh atë personin që të paska thënë se duhet më shumë ajër... Domethënë letra me të u lidhka!...

- Ç'letër?

- Ajo që mori sot dhe që e tronditi aq shumë. Kur i thashë të njoftonim edhe ty, m'u lut më mirë të heshtnim... Më tha edhe se, ndoshta, do ndaheshim së shpejti... Më falënderoi për ato që paskam bërë. Kur dola, e mbylli derën me çelës.

- Pse, paska marrë letër? - e pyeti mundueshëm Raskolnikovi.

- Po, ka marrë. Nuk e paske ditur?

Qëndruan për një kohë të heshtur.

- Lamtumirë, Rodion. Për një kohë, or byrazer, kam menduar... Po nejse, lamtumirë! Kurse për të dehur, nuk kam për t'u dehur. Nuk kam përse...

Hapi derën, hodhi edhe hapin që të dilte, por ndali dhe, duke parë mënjanë, tha:

- E di, puna e vrasjes, së plakës, që Porfiri... U gjet vrasësi, e pranoi me gojën e tij, po edhe dëshmi bindëse ka... Njëri nga bojaxhinjtë kishte qenë. Të kujtohet që i pata marrë në mbrojtje? Del që atë skenë hargalisjeje dhe hareje të shfrenuar, britmash dhe ndjekjeje të shoshoqit, e paskan sajuar për të fshehur gjurmët. Çfarë guximi! Çfarë

zemre që paska patur, qeni! E pranoi me gojën e vet. Ma la dopjo gjashtën në dorë! As më pak e as më shumë, por mjeshtër të mbaruar e tregoi veten ky Nikollai! Ka edhe të tillë! Që e pranon vetë, kjo e bën edhe më të besueshme fajësinë. Mbeta me gisht në gojë si jurist!...

- E kush ta paska thënë këtë? Pse të ardhka aq inat? Po për të interesuar pse të interesoka aq shumë? - me një tronditje të dukshme e pyeti Raskolnikovi.

- Ç'pyetje që bën dhe ti! E si s'më interesoka? Për të thënë, më tha Porfiri... fill e për pe ma tregoi...

- Porfiri?

- Po, Porfiri.

- Po ai vetë, si? - e pyeti i trëmbur Raskolnikovi.

- Hollësisht ma tregoi... psikologjikisht ma argumentoi, me atë mënyrën e tij...

- Mirë, mirë, po vetë ai... si?

- Në rregull! Lamtumirë tani! Një herë tjetër do të tregoj edhe diçka, tani jam me ngut, kam një punë... Se... pata menduar... edhe... Po një herë tjetër për këtë! Dhe për t'u dehur, s'kam nevojë, më dehe ti me këto që më the. Vërtet si i dehur ndihem. Rodka! Pas pak këtu më ke.

Doli.

"S'ka më asnjë dyshim: është komplotist politik ky! - e preu mendjen Razumihini, duke zbritur ngadalë shkallët. - Edhe të motrën e paska përzier, se Avdotia Romanovna është grua me karakter! Qenkan takuar... Edhe ajo duket që seç fsheh... Nga fjalët që thotë, nga heshtja që mban, nga sjellja e saj duket kjo!... E si ta shpjegosh ndryshe tërë këtë katrahurë të tyre? Hm! Kurse unë... O Zot! Po si ia lejova vetes, xhanëm! Jam me faj para tyre? Mënyra si më foli ashtu në koridor, ajo më vuri në dyshim! Ptu! Mendim i poshtër!... I lumtë Nikollait që e paska bërë si burrat! Tani e qartë çdo gjë: edhe sjellja në universitet, edhe sëmundja e tanishme, zymtia e ngahershme, që të gjitha kanë shpjegimin e duhur! Po letra ç'të jetë? Nga kush i erdhi? Kam një dyshim, po do t'i zhbirojmë që të gjitha..."

I sëmboi në zemër, kur kujtoi Dunjeçkën. Doli me vrap në rrugë.

Pasi iku Razumihini, Raskolnikovi provoi të ecejakte nëpër dhomë, por s'ia lejoi ngushtica, ndaj dhe u ul në kanape. Ndihej i përtërirë:

luftë, përsëri luftë! Ja dhe rrugëdalja!...

S'po e duronte më atë errësim të mendjes: skena te Porfiri nuk kishte dalë si e dëshironte hetuesi, e kishte vënë në mëdyshje këtë dredharak; skena te Sonja i doli jo ashtu si e kishte pas përfytyryar ai vetë. I qenë prerë forcat, e kuptoi që në një të tillë brengë s'kishte si jetonte! Pale pastaj Svidrigajllovi! Ky e shqetësonte më shumë, e priste një luftë jo e vogël me të. Ndërsa puna e Porfirit ishte veç! Vetë ia paska shpjeguar Razumihinit, e paska besuar! (Skena me Nikollain te Profiri i dilte para syve krejt e gjallë, në përgjithësi s'para mbante mend). Se, domosdo, u shoqërua me tendosje të tërbuar, por edhe nga bindja që nuk do ishte Nikollai ai që do t'ia zgjidhte litarin.

E pra, edhe Razumihini paska dyshuar! Skena te shkallët e paska bërë të veten! Dhe e paska mbajtur frymën te Porfiri... Po Porfiri përse e paska fryrë asisoj? Ka një plan. Vërtet që këto ditë nuk është ndier, por kjo nuk është gjë e mirë... Mori kapelen dhe doli. Ishte hera e parë prej sa e sa kohësh që i shihte gjërat dhe e bënte çdo veprim me vetëdije të plotë e qartësi mendore. "I duhet dhënë fund çështjes së Svidrigajllovit! Me siguri që më pret t'i vete". Një valë urrejtjeje satanike ia përshkoi qënien, fare lehtë mund ta vriste atë njeri, ashtu si edhe Porfirin! E ndjeu që në mos tani, më pas pa ngurruar mund ta bënte. "Shohim e bëjmë!" - tha me vete.

Hapi derën dhe po bëhej gati të zbriste shkallët, kur i doli përpara Porfiri. Iu prenë këmbët, por vetëm një çast. Edhe vetë u habit, nuk e çuditi aspak ardhja e këtij njeriu, por as nuk e trëmbi. U drodh dhe sakaq mendoi: "Më së fundi? Ndoshta, zgjidhet përfundimisht çështja!.... Si po afrohej pa? Si mace! Mos donte ta përgjonte?"

- Prisni miq, Rodion Romanoviç? - i thirri duke qeshur. - Kam dashur t'ju vija më parë, thashë me vete, e pse të mos ju bëj një vizitë? Qënkeni nisur për diku... Nuk do ju pengoj. Vetëm sa të pi këtë cigare.

- Uluni, Porfir Petroviç, ju lutem! - e ftoi Raskolnikovi me zë të shtruar dhe në mënyrë aq dashamirëse, saqë dhe vetë u habit. Sigurisht, që bëri sforcimet e fundit. Se njeriu e duron për një gjysmë ore kërcënimin vdekjeprurës të cubit, madje edhe kur ky i vë thikën në fyt, edhe tmerrin e përballon. U ul përkarshi dhe syri nuk iu tut. Porfiri picërroi sytë dhe ndezi një cigare tjetër. "Fol, pse s'flet! Ç'pret, fol!" - këtë sikur donte të thoshte tërë qënia e Raskolnikovit.

II

- E sheh këtë cigare? - foli, më në fund, Porfiri Petroviç, pasi e kishte shuar. - Helm e shkuar helmit është, por ja që nuk e lë dot. Kolla po kollë, mezi mbushem me frymë, këlbaza po këlbazë! Jam ca frikacak; i shkova për vizitë mjekut B., çdo të sëmuri nga një gjysmë ore vizite i binte, më pa me kujdes; qeshi, pastaj më tha: "Është mirë ta lini duhanin. Mushkëritë ju kanë marrë dëmtim!" Po hajde lëre pa? Me se ta zëvendësosh këtë të shkretë? Për të pirë, nuk pi, kjo më pengon. Po, Rodion Romanoviç, në këtë botë çdo gjë relative qënka.

"Avazin e Mukës ky!" - tha me vete Raskolnikovi dhe e pa me neveri. Iu kujtua takimi i fundit, ç'provoi atëherë, iu përsërit e përforcuar.

- Ju bëra një vizitë edhe tri ditë të shkuara, në mbrëmje, por ju nuk e dini! - vijoi Porfiri Petroviç, duke e kaluar shikimin nëpër dhomë. - Hyra edhe në këtë dhomëz. Shoh, dera e hapur, prita pak, por as shërbëtorja e askush nuk po dukej, ika. Nuk e mbyllkeni me kyç derën?

Raskolnikovi u nxi. Porfiri ia hetoi mendimet.

- Më duhet të shpjegohem me ju, Rodion Romanoviç, ndaj dhe erdha, - i foli me buzën në gaz dhe ia çiku si me familjaritet gjurin, por pas një hopi fytyra i mori seriozitetin e parë, dukej i preokupuar dhe i trishtë; kjo s'kishte si të mos e habiste Raskolnikovin, nuk ia kishte parë ndonjëherë këtë shprehje fytyre, madje as që i shkonte në mendje që ky mund ta kishte. - Ngjarje e çuditshme ishte ajo që përjetuam, Rodion Romanoviç... Kushedi jam edhe me faj para jush, e ndiej edhe vetë! Shumë nerva keni harxhuar, tronditje të mëdha keni kaluar, veç edhe unë kam qenë i tronditur. Pa le që edhe sjellja nuk para ka qenë shumë fisnike. Se ne jemi fisnikë, para së gjithash jemi fisnikë... Arsyet dihen...

"Për cilin më pandeh ky?" - e pyeti veten Raskolnikovi, duke e ngritur kokën dhe duke e parë drejt në sy.

- E vrava dhe jo pak mendjen dhe kam ardhur t'ju them që e mira e të mirave është të tregohemi të sinqertë me shoshoqin! - i tha Porfiri dhe uli sytë për të mos e turbulluar bashkëfolësin, duke i lënë të kuptonte që hiqte dorë nga taktika e befasimeve dhe e kurtheve. - T'i

lemë mënjanë dyshimet, lavdi Zotit, nyjen gordiane na e zgjidhi Nikollai, se nuk po dija ç'udhë t'ju jepja punëve. E vërtetë është që zanatçiu priste ne dhomën tjetër, më vonë erdhi te ju dhe ua tregoi të gjitha; nuk kisha caktuar njeri t'u ndiqte. Mund të pyesni përse? S'më shkoi në mendje! Se unë kisha të tjera plane në kokë, desha ta hetoja çështjen me rrugë të tjera. Jeni shumë nevrastenik dhe i ndjeshëm, Rodion Romanoviç. Sigurisht, nuk shkoja me mendjen që do më hapeshit që në takimin e parë, kjo ndodh, nëse ke arritur t'ia shterosh durimin tjetrit, por, sidoqoftë, rrallë. Thosha me vete: sikur vetëm një fije, fare të hollë, të mundja te kapja, pastaj dija unë si e lidhja me duar dhe këmbë, s'më mjaftonte vetëm psikologjia. Se, në qoftë dikush në faj, diçka ka për të dalë në sipërfaqe, e pse jo, edhe për arritje përfundimtare mund të shpresosh. Hesapet i pata bërë, duke u nisur nga karakteri juaj, Rodion Romanoviç.

- E përse m'i thoni tani të gjitha këto? - mërmëriti Raskolnikovi, pa e menduar mirë pyetjen ("E pse ma thotë mos vërtet më mban për fajtor?" - pyeti edhe sakaq veten).

- Pse jua them? Erdha të shpjegohem, e quaj se është detyrë. Dua të jeni në dijeni të gjithçkaje, sepse jo pak vuajte ju kam shkaktuar, Rodion Romanoviç. Nuk jam ndonjë xhahil shpirtkazmë. E di ç'do të thotë t'ia vësh tjetrit atë damkë, sidomos një tipi të irritueshëm dhe krenar. Se për ju kam mendimin për njeri fisnik e zemërmirë, ndonëse nuk i ndaj bindjet për shumë probleme. Nuk ma ka ënda të veproj duke ju mashtruar, duke dredhuar. Që kur ju njoha, ndjeva një simpati për ju. E di që mund edhe të qeshni me këto që them, se ju që në takimin e parë u mbushët me neveri e përbuzje për mua, ndaj dhe dua t'ua shkul njëherë e përgjithmonë këtë mendim që keni; dua t'ju bind që jam njeri me zemër e ndërgjegje. Po ju flas sinqerisht!

Porfiri Petroviçi heshti i mbushur me dinjitet. Raskolnikovi ndjeu t'i vërshonte përbrenda një frikë e re. Mendimi që Porfiri po e shpallte të pafajshëm, i kallte datën.

- Them se nuk është nevoja ta nisim tregimin nga fillimi, - vazhdoi Porfiri. - Zërat e parë ishin vetëm zëra... nga kush dolën dhe si edhe kjo e tepërt është të thuhet. Mua fare rastësisht më shkoi mendja te ju. Por edhe për këtë nuk kemi ç'flasim. Veç, për të qenë i sinqertë, po ju them se qesh unë ai që u hodha i pari në sulm: verifikova gjurmët,

ndoqa rrjedhën e ngjarjeve, ashtu si veprohet gjithmonë në kësi rastesh. Papo ndodhi dhe ajo skena në polici, dëgjova dhe një person, i cili edhe pse nuk ishte në dijeni, bëri disa deponime me peshë. I pata në dorë ca të dhëna, ama nga njëqind lepuj nuk mund të bësh një kalë; nga njëqind dyshime nuk ke si nxjerr një fakt. Kështu thotë mendja, por pasionet flasin me gjuhë tjetër dhe hetuesi është njeri. Pa m'u ndërmend edhe artikulli, kemi biseduar për të. Ju cingrisa pak, por e bëra nga nevoja e vazhdimit të hetimeve. Ju mungon fare durimi, jeni disi edhe i sëmurë, Rodion Romanoviç! Se që ishit kryelartë, serioz, njeri që ndien shumë... këtë e kisha ditur. Edhe artikullin në netët pa gjumë, në gjendje frenezie e keni shkruar, në çaste entuziazmi, me zemër që ju përpëlitej e keni shkruar... Por sa të shumtë janë rreziqet që mbart ai entuziazëm sidomos kur bëhet fjalë për rininë! Atëherë desha t'ju provokoja, ndërsa tani ja ku po jua them se më pëlqeu shumë ajo sprovë e parë e penës suaj. Tym e mjegull, tinguj kitare në mugëtirë! Gjepura dhe fantazira ishin ato që shkruanit, por i përshkonte sinqeriteti rinor, krenaria e çiltërsia e qelibartë rinore, në të spikat kuturisja e dëshpërimit; është një shkrim i zymtë ai, por është i mirë. E lexova atëherë dhe e lashë mënjanë. Thashë me vete: "Nuk ka për t'u ndalur me kaq ky njeri!" E si të mos i jepesha me mish e me shpirt çështjes që e pasoi? E kam fjalën për hetimet, nuk jam duke pohuar gjë. Si hetues që jam, nuk më ka hije t'u jepem pasioneve. E kam Nikollain, ky është fakt! Veç ma kompromenton keq psikologjinë, e ajo lufton për jetë a vdekje në këtë rast. Më pyesni: përse jam duke jua thënë këto? Që të mos më akuzoni për keqdashje, ndaj jua them! Se unë edhe kontroll ju bëra! Hë! Hë! Kur ishit shtrirë, kur ishit i sëmurë jua bëra... Jo zyrtarisht e jo unë vetë, por për të kontrolluar ju kontrollova dhe tepër të imët ua bëra atë kontroll. Por *umsonst!*[1]) Prita, mendova: do vijë, do dorëzohet vetë, në qoftë me faj! Ndonjë tjetër edhe nuk dorëzohet, kurse ky po! Zoti Razumihini diç ju nëpërdhëmbi. Ishim ne që i bëmë në mënyrë të atillë punët, që ky ju nëpërdhëmbi... e bëmë që t'ju trondiste; enkas e përhapëm atë lajm; kurse zoti Razumihin është nga ata që s'e ruan dot përbrenda indinjatën. Sa për zotin Zametov ky ngeli fare pa mend

[1]) *Më kot (gjerm.)*

nga guximi dhe çiltërsia me të cilat i folët, ia thatë copë: "Unë e vrava!" Kokëkrisje e paparë ishte kjo juaja! "Në qoftë fajtor, - thashë me vete, - qënka luftëtar i çartur!" Ju prisja të më vinit. Se ajo e shkretë psikologji thikë me dy presa është... Ju solli perëndia si me porosi; zemra më rrihte si çekan. Ç'ju shtyu, vallë, të vinit? Po të qeshurit? Po të mos e kisha paramendimin, nuk kisha për ta kuptuar ç'fshihej pas tij. Kësaj i thonë të jesh në formë! Po zoti Razumihin, hë? Po puna e gurit, nën të cilën janë fshehur sendet e marra, për çka i folët Zametovit, po analiza dhe debati rreth artikullit... Arrita të gjejë ca shtylla, pas të cilave përplasa kokën dhe i thirra mendjes! "Vetëm ai fund i fillit më lypset!" - thashë me vete. Një mijë rubla nga xhepi isha gati të jepja vetëm e vetëm që t'u shihja si ecët pa thënë as dhe një fjalë përpara njeriut që ju kishte quajtur vrasës, pa pyetur ku e kishte fjalën. Po të dridhurat e papërmbajtshme, po zilja në jerm, pse pak janë tërë këto? E pra, Rodion Romanoviç, nuk keni pse habiteni që provuam të bëjmë atë farë shakaje! E pse erdhët pikërisht në atë minutë? Po të mos na ishte futur në mes Nikollai, ju kujtohet... gjëmim në ditë me diell ishte ajo e tij... Por, ama, unë, unë si e prita, vetë patët nderin ta shihnit: nuk u zura besë fjalëve të tij! Kur ikët dhe ai zuri të hapet shtruar, u binda qe kisha të drejtë! E preva mendjen: nuk është Nikollai!

- Razumihini sapo më tha që ju edhe tani Nikollain akuzoni...

Iu mblodh një lëmsh në grykë, s'e mbaroi dot frazën. E kishte dëgjuar me zemrën akull këtë tregim, kështu u ndodh atyre që e nuhatin se po u afrohet fundi. Nuk e besonte, i trëmbej këtij supozimi. Në shprehjet dykuptimëshe vazhdonte të qëmtonte mendimet më të sakta, më të konsoliduara të folësit.

- Zoti Razumihin! - thirri Porfiri i gëzuar që po i drejtoheshin me një të tillë pyetje. - He! He! He! Po si mund të hiqej qafe ndryshe ai njeri! I treti është i tepërt në kësi rastesh. Një fytyrë i vjen e një fytyrë i shkon, sa herë që më takon. E ç'ta përziejmë në këto punë... Mos doni ta dini si e kuptoj veprimin e Nikollait? Pikësëpari kemi të bëjmë me një buzëqumësht po aq frikaman, sa dhe artist hesapi... S'ka asnjë faj, por, duke qënë shpirt i ndershëm dhe me fantazi, vete e bën atë që bëri. Do këngë, ta këndon, do valle, ia merr, do përrallë, ta tregon dhe aq bukur sa mblidhet njerëzia për ta dëgjuar; fëmijë e shkuar

fëmijës është. As për plaçkën që vodhi s'dinte ç'të thoshte: jo e gjeta në tokë, jo e kam të vjedhur... Po këtë e dini? I përket besimit të vjetër, dy vite më parë paska jetuar te një plak i besimit të vjetër, me bekimin e tij qënka larguar. Ma tha vetë, por edhe të tjerët e pohuan. Donte t'ia mbathte makar edhe në shkretëtirë! Djalë i zellshëm, natën i falet Zotit, librat e shenjtë nuk i heq nga dora. "Janë libra të vërtetë" - më tha. Petërburgu ia paska çaprashitur mendjen, veçanërisht femrat, por edhe pija ka bërë të vetën. Porositë e shenjta i paskan fluturuar nga koka! Një shkrimtar që banon këtu afër e dashka me shpirt, i vajtka dendur, kur ja dhe ky rasti... U trëmb; provoi të varte veten, t'ia mbathte, se, helbete, ç'nuk flitet në popull për gjykatën e burgjet. U kall datën fjala gjyq! E po, sigurisht, solli në mendje mësimet e plakut të besimit të vjetër, biblën. E dini, Rodion Romanoviç, ç'do të thotë për sa ci ky "të vuash dënimin"? Jo për dikë tjetër të vuash, por për veten tënde! Vuajtje do të thotë pranim, pranim para pushtetarëve! E dini, kam njohur një të dënuar të përkorë, i cili lexonte biblën tërë natën, u ënjt së lexuari, iu bë shpirti gomar, arriti puna deri aty sa i ra komandantit të burgut me tullë dhe e bëri kot, e mori shënjën nja një gjysmë mètri larg, nuk u nis për ta dëmtuar, vetëm për të vuajtur dënimin e bëri... Se dënimi në kësi rastesh është i rëndë. Dyshoj që dhe Nikollai "dënimin dëshiron të vuaj". Kam dhe fakte, që ai nuk i di. Ju si nuk jeni njëmendje me mua? Ka për të më treguar vetë, do hapet... E dua shumë atë djalë, jam duke e studjuar. E dini? He! He! He! Disa pyetjeve iu përgjigj me goxha logjikë, pra ishte i përgatitur për to, disa të tjerave fare keq, binte me këmbët e veta brenda... Jo, Rodion Romanoviç, nuk është vepër e Nikollait ajo. Është diçka e stërholluar, e zymtë, e mbështetur në ca argumente e arsyetime bashkëkohore, e kryer nga njeri me zemër të tallazitur dhe mendje të turbulluar, nga njeri që citon frazën se gjaku "të freskon"! Veprime si këto vijnë nga ëndrrat e shkaktuara prej librave, i kryejnë zemrat e ndezura nga teoritë, është vendim i marrë për domosdonë e hapit të parë, njëlloj si ai që merret kur hidhemi nga kambanarja, kur rrokullisemi nga rrëpira malore, kur shkohet jo me këmbët e tua. Derën harroi ta mbyllte, kurse për të vrarë i vrau dhe dy me një frymë... sipas teorisë. Vrau, por paratë nuk dinte si t'i merrte, ato që mori i fshehu nën gur. E torturoi si në ferr zilja që binte dhe ai strukej prapa

derës, por më pas si në jerm vajti dhe e provoi përsëri atë drithërimë... Ta zemë se e bëri duke qenë i sëmurë, por ja dhe diçka tjetër; për të vrarë e vrau, ndërsa veten e mban për njeri të ndershëm, i përbuz dhe i shpërfill të tjerët, sorollatet rrugëve me pamjen e ëngjëllit të zbehtë... Jo. S'ka gisht Nikollai në këtë vrasje! Kështu, pra, Rodion Romanoviç!

Këto fjalë të fundit, pas gjithë atij ligjërimi predikues, tingëlluan fare të papritura, Raskolnikovin e mundonin ca të dridhura të forta, kishte shtangur i pafuqishëm.

- Atëherë... kush... na qënka... vrasësi? - i doli si gulçim i papërmbajtshëm nga kraharori. Porfiri Petroviçi mbështeti fort shpatullat pas shpinës së karriges, aq shumë e habiti kjo pyetje e papritur.

- Si kush na qënka vrasësi? - përsëriti si të mos i besonte asaj që i dëgjuan veshët. - Ju jeni, Rodion Romanoviç! Ju i vratë! - i tha me pështërimë, por krejt i bindur.

Raskonikovi brofi, qëndroi një çast, pastaj u ul përsëri pa thënë as dhe një fjalë. Dridhje të shpejta, të llahtarshme ia përshkuan fytyrën.

- Ja, buza zuri t'u dridhet njëlloj si atëherë, - mërmëriti Porfiri Petroviçi si duke i qarë hallin. - Më duket se s'më kuptuat si duhet, Rodion Romanoviç, - shtoi pas një heshtjeje, - ndaj dhe u habit aq shumë. Jam duke u parashtruar dijenitë e mia rreth kësaj çështjeje, dua t'i kemi sahanët pa kapakë ne të dy.

- Nuk i vrava unë! - bëlbëzoi Raskolnikovi si ndonjë fëmijë e trëmbur, që sapo e kapën me presh në dorë.

- Ju i vratë dhe askush tjetër, Rodion Romanoviç, - i tha rreptë dhe me bindje të plotë Porfiri.

Pasoi një heshtje e llahtarshme dhe zgjati jo pak, nja dhjetë minuta. Raskolnikovi rrinte i mbështetur me bërryla në tryezë, gishtat i kishte futur në flokë, Porfiri e shihte dhe priste i heshtur, Raskolnikovi u shkund dhe e pa me përbuzje.

- Avazin e vjetër ju, Porfiri Petroviç! Nuk hiqni që nuk hiqni dot dorë nga marifetet tuaja! Si nuk iu pështirosën, xhanëm?

- Lërini këto! Po të kishte dëshmitarë, ndryshonte puna, por ne jemi këtu vetëm, kokë më kokë. Po e shihni që nuk kam ardhur t'u ndjek, siç ndjek macja miun. Në e pranoni tani apo jo, kjo për mua nuk ka asnjë rëndësi. Veç jua përsëris, jam plotësisht i bindur.

- Atëherë cila qënka arsyeja e ardhjes? - e pyeti i inatosur

Raskolnikovi. - Jua përsëris: në më mbani për fajtor, përse nuk më arrestoni?

- Po ju përgjigjem: së pari, sepse nuk më leverdis!

- Si kështu, nuk ju leverdiska? Po të jeni i bindur, jeni i detyruar...

- E ç'del nga ajo që jam i detyruar? Po këto tani për tani s'janë tjetër veç hamendje të miat. Nuk dua t'ju fut brenda edhe për një arsye tjetër: kështu do qetësoheshit. Edhe vetë e dini, meqë e kërkoni! Se ja, do ju ballafaqoja me zejtarin. Do ta pyesnit: "Mos jeni i dehur? E kush më paska parë me ty? Të ndoqa pas sepse të mora për të dehur, pra i dehur paske qenë!" Ç'mund të thosha pas kësaj? Ajo që thoni ju qëndron më fort se akuza që ju bëhet, është vetëm një moment psikologjik ai që ju ndodhi, dhe ajo e shkretë psikoligjie është thikë me dy presa. Asgjë konkrete nuk kam në dorë kundër jush! Se për t'ju arrestuar do ju arrestoj, prandaj dhe kam ardhur (diçka aspak njerëzore është), desha t'ua bëj të ditur që më parë këtë, por ja ku po jua përsëris (edhe kjo nuk është aspak njerëzore) që nuk kam asnjë leverdi! Së dyti, erdha.

- Hë, po së dyti? - e pyeti Raskolnikovi që mezi po mbushej me frymë.

- Sepse siç ju thashë, e ndiej për detyrë të shpjegohem. Nuk dua të më cilësoni të pashpirt, për më tepër që ushqej një simpati për ju, në doni besoni, në s'doni mos besoni! I nisur nga të gjitha këto, kam ardhur t'u bëj një propozim konkret: të paraqiteni në polici me pendesën e fajtorit! Është me leverdi për ju dhe për mua. E shkarkojmë nga shpatullat këtë barrë.

Raskolnikovi u mendua disa çaste.

- Dëgjo këtu, Porfiri Petroviç. Sapo e pranuat që të dhënat janë vetëm çaste psikologjie, ndërsa tani u futët në matematikë. Po sikur të gabonit?

- Jo nuk gabohem, Rodion Romanoviç. E mbaj fort në dorë një fije, ma ka dërguar Zoti! Kurdoherë e kam patur...

- E ç'fije na qënka?

- Nuk jua them, Rodion Romanoviç. Aq më tepër që nuk kam më të drejtë ta shtyj ndjekjen e çështjes. Do ju arrestoj. Vendimi është i formës së prerë, kur ju fola ashtu, e bëra nga kujdesi për ju.

Raskolnikovi u ngërdhesh me ligësi.

- Kjo që po bëni nuk është thjesht qesharake, është e paturpshme! Edhe sikur të jem fajtor (gjë që s'e them kurrën e kurrës), e përse u dashka të paraqitem me pendim për fajin? Se ju me gojën tuaj e thatë që arrestimi do t'më qetësoka!

- Eh, Rodion Romanoviç, nuk është koha të kapeni pas fjalëve. Ndoshta ajo që ju thashë edhe nuk qëndron. Diçka teorike është, e ç'autoritet jam unë në teori? Për më tepër që përsëri diç jam duke fshehur... Jam i detyruar, nuk kam si jua them të gjitha... Leverdinë ju fort mirë e kuptoni, do keni lehtësim! Do paraqiteni në një kohë, kur ai tjetri e pranoi me gojën e tij fajësinë! Kurse unë ju betohem para Zotit që do bëj çmos ta rregulloj çdo gjë në një të tillë mënyrë, që paraqitja juaj të dalë diçka fare e papritur. Psikologjisë i heqim vizë, i flakim tej dyshimet, krimin do ta paraqesim çast errësimi, se, t'ju them të drejtën, ai errësim ka qenë. Jam njeri i ndershëm, Rodion Romanoviç, fjalën e dhënë e mbaj.

Raskolnikovi nuk nxori asnjë fjalë, qëndronte i trishtuar, me kokën varur, pastaj vuri buzën në gaz, dukej tejet i pezmatuar.

- Nuk është nevoja! - nëpërdhëmbi si të mos fshihte asgjë nga Porfiri. - Nuk ia vlen barra qiranë! Nuk më duhet lehtësimi juaj!

- Ja kësaj përgjigje ia pata frikën! - foli me ndjenjë e gjoja natyrshmëri Porfiri. - Nuk paskeni nevojë për lehtësim?

Raskolnikovi e pa në mënyrë kuptimplote.

- Mos e nëpërkëmbni kështu jetën, more djalë! - vazhdoi Porfiri. - E keni të gjatë rrugën; si kështu nuk paskeni nevojë! Po ju flet goja para medjes, Rodion Romanoviç.

- Ashtu?

- Ju profet nuk jeni! Mos e lini t'ju shpëtojë nga dora ky rast! Jua dërgoi peshqesh Zoti! Nuk kini për të ndënjur mot e jetë brenda...

- Pra, do paskam lehtësim... - qeshi trishtueshëm Raskolnikovi.

- Mos po të duket që po tregohesh shpirtvogël? Je i ri, jetën e ke përpara!

- S'më bëhet vonë për asgjë! - pëshpëriti me përbuzje Raskolnikovi, duke dhënë të kuptohej që s'donte të fliste më rreth kësaj çështjeje. U çua si të donte të dilte për diku, por përsëri u ul më pamjen e njeriut tepër të dëshpëruar.

- S'po më besoni; pandehni se po orvatem t'jua prish mendjen në

mënyrën më vulgare? Nuk e njihni jetën. Shpikët një teori dhe ju vjen turp që u doli bllof! Që përfundoi me poshtërsi, kjo është e vërtetë, veç ju nuk jeni i poshtër e i pashpresë. Nuk është se i bluajtët për një kohë të gjatë mendimet tuaja, i ratë shkurt. Se jeni një nga ata, që edhe sikur zorrët t'ju nxjerrin, xhelatin do ta shihnit me buzën në gaz, po të kishit brenda vetes të fortë besimin. Keni keq sa ta gjeni, me ta gjetur rroni si s'ka më mirë! Duhet para së gjithash të ndryshoni ajër; pastaj vuajtja nuk është dhe aq e keqe, duhet vuajtur! Nikollai, ndoshta, ka të drejtë që është duke e kërkuar vuajtjen. E di që s'doni të besoni, por mos i shihni gjërat me përbuzje e shpoti, jepjuni tërësisht jetës, lërini mënjanë filozofimet, jeta ju nxjerr vetë atje ku duhet! Ajo do ju mëkëmbë! Si e tek, nuk di t'ju them, veç kam besim se jeni djalë i ri dhe jetën e keni përpara! E di që këto që ju them ju duken vetëm fjalë, ca shtampa e klishe, por, ndoshta, do ju hyjnë në punë! Mirë dhe kaq që vetëm atë plakaruqen vratë! Të ishit i bukosur përfundimisht, mund të kryenit veprime një milion herë më të shëmtuara! Duhet falënderuar Zoti që e mbyllët me kaq! Duhet hapur zemra, pa frikë e ndrojtje duhet bërë! Nuk duhet patur frikë nga ndëshkimi! E hodhët atë hap, mbahuni tani. E kërkon drejtësia pendimin, bëjeni! Jeta vetë do ju mësojë dhe do jua kthejë dashurinë! Ju duhet ajër, ajër me çdo kusht!

Raskolnikovi u rrëqeth.

- Po ju kush na qënkeni kështu? Ç'profeci na qënkan këto tuajat? Nga ç'lartësi qetësie të madhërishme jeni duke më profetizuar?

- Kush jam? Njeri që kam marrë fund me gjithsej jam! Që ndien dhe dhimsurohet, që diç dëshiron, por ja që s'e arrin dot! Ndryshon puna juaj, jua ka gatitur Zoti jetën! (Ama, ku i dihet, ndoshta mjegull është, mundet edhe të davaritet e të mos ngelë gjë prej gjëje). E çë, në kalofshi në një tjetër kategori njerëzish? Me këtë zemër që keni, nuk është se u dhimbset rehatia. E çë, nëse për një kohë të gjatë nuk do bini në sy? Puna s'është te koha, është te ju vetë. Në u bëfshi diell, kanë për t'ju parë të gjithë, veç dielli para së gjithash duhet të jetë diell! E pse qeshni ashtu, ngaqë po ju paraqitem Shiler? Dhe vë bast në nuk ju shkon në mendje se dua t'u fërkoj krahët! Ku i dihet, ndoshta edhe kjo qëndron. He! He! He! Po ju, Rodion Romanoviç, fjalëve të mia mos u besoni; e di, nuk jam pa huqe, por aq sa i poshtër aq dhe i

ndershëm jam, më duket se këtë mund ta gjykoni!

- Kur keni bërë mendje të më arrestoni!

- Mund t'u lë nja dy ditë të shëtisni. Mendohuni mirë. Mos harroni t'i faleni Zotit! Ju leverdis dhe ju leverdis shumë!

- Po sikur t'ia mbath? - duke u shtrëmbëruar në një mënyrë të çuditshme e pyeti Raskolnikovi.

- Nuk do t'ia mbathni. Muzhiku po, ndonjë sektant i modës, lake i mendimit të huaj po, puna juaj ndryshon. Ju nuk i besoni më teorisë suaj, ç'do të merrni me vete, në ia mbathshi? Ç'ju duhet arratisja? Arratia ka boll poshtërim dhe mundim, ndërsa juve ju duhet jetë e qetë, e përcaktuar mirë, me ajër. Edhe në ia mbathshi, përsëri do ktheheni. Nuk bëni dot pa ne! Do ju mbajmë nja tre muaj prapa hekurave dhe vetë do vini pastaj për ta pranuar fajësinë. Jam i bindur që edhe punën e vuajtjes do ta keni menduar; tani fjalën time s'e beson, atëherë do ta besoni, vetë keni për të ardhur në këto përfundime. Se vuajtja, Rodion Romanoviç është gjë e madhe. Mos më shihni mua që jam kështu i dhjamur, asaj unë nuk ia kam nevojën, ama fort mirë e di, mos guxoni të qeshni, në vuajtje fshihet ideja! Nikollai ka të drejtë. Ju nuk keni për t'ia mbathur, Rodion Romanoviç.

Raskolnikovi u çua dhe mori kapelen. U ngrit edhe Porfir Petroviçi.

- Do dilni shëtitje? Kohë e bukur sonte, veç në mos pastë shtrëngatë... Po edhe ajo s'është keq, e freskon motin.

- Ju, Porfiri Petroviç, mos t'u rrejë mendja se jam duke e pranuar akuzën tuaj, - iu drejtua Raskolnikovi serioz dhe me zë të prerë. - Jeni njeri i çuditshëm! Ju dëgjova deri në fund vetëm nga kërshëria. Asgjë nga ato që thoni nuk e pranoj. Dijeni mirë këtë!

- E di, e di! Po pse dridheni kështu? Mos u shqetësoni, pëllumbth! Do bëhet ashtu si doni. Shëtisni ndopak, por jo shumë. Kam edhe një lutje, - shtoi me zë të ulët. - Është vërtet delikate, por e rëndësishme. Në qoftë se, sido që të venë punët, domethënë (ndonëse nuk e besoj këtë, e quaj që nuk keni për të vajtur deri në atë pikë), e pra, nëse gjatë këtyre dyzetë a pesëdhjetë orëve ju lind dëshira t'i jepni fund ndryshe punëve, në ndonjë mënyrë fantastike, si, bie fjala, të vini dorë mbi veten, (një hamendje fare absurde kjo imja, të më falni për këtë) mos harroni të shkruani dy fjalë, që të jenë bindëse. Dhe më kujtoni aty edhe mua; diçka fisnike do të ishte! Lamtumirë, tani! Mendime të

mira, fillesa të reja!

Porfiri doli paksa i kërrusur dhe duke e shmangur Raskolnikovin. Ky iu afrua dritares dhe tejet i nervozuar priti kohën, kur, sipas tij, Profiri duhej të dilte në rrugë dhe do largohej. Pastaj doli me ngut nga dhoma.

III

Ngutej për te Svidrigajllovi. E me ç'shpresë shkonte? As vetë nuk e dinte. Seç fshihej brenda këtij njeriu një pushtet mbi të. Që kur e kishte ndier forcën e atij pushteti, e kishte humbur qetësinë. Duhej ta takonte sa ma parë.

E mundonte sidomos një pyetje: të kishte shkuar vallë Svidrigajllovi te Porfiri? Sipas tij, jo. E ktheu dhe e përktheu në mendje takimin e fundit me Porfirin, i dilte që të mos kishte shkuar. Po a do të shkonte? Mendja i thoshte që tani nuk kishte për të shkuar. Arsyen pse, nuk dinte si ta shpjegonte, por edhe në rast se e dinte, nuk ishte koha të merrej me kësi shpjegimesh. Edhe e mundonte pyetja, edhe nuk ia kishte ngenë të merrej. Se edhe për fatin e vet në këto çaste kujdesej pak e në një mënyrë të vagullt. E mundonte diçka tjetër ku e ku më e rëndësishme, logjika tani i punonte shumë më mirë se më parë, pavarësisht nga kapitja e përgjithshme, sidomos morale.

A ia vlente në kushtet e krijuara ta humbiste kohën duke u marrë me kapërcimin e ca vështirësive mizerabël? A ia vlente të rropatej për ta ndaluar Svidrigajllovin të mos shkonte te Porfiri? Dhe, në përgjithësi, a ia vlente të merrej me Svidrigajllovin?

I kishin ardhur në majë të hundës të gjitha këto!

E prapë se prapë po ngutej për te Svidrigajllovi. Mos shkonte me shpresë të dëgjonte ndonjë lajm të ri, të merrte ndonjë udhëzim, të gjente ndonje rrugëdalje? Se kush është duke u mbytur, kapet edhe nga një fija e kashtës! Ku i dihej, ndoshta ishte fati ai që po e bashkonte me atë njeri. Po kushedi thjesht nga dëshpërimi e bënte, ndoshta as që duhej shkuar, i duhej drejtuar ndonjë tjetri, Po kujt, Sonjës? E pse? Që ta bënte të derdhte lot? Pastaj Sonja ishte për vuajtjen e dënimit, madje edhe të më të pamëshirshmit! Kishte përpara dy rrugë:

o të sajën, o të tijën. Sidomos në këto rrethana nuk kishte si e takonte. Pra, duhej provuar fati duke u takuar me Svidrigajllovin. Aq më tepër që një zë i brendshëm i thoshte se prej disa kohësh i qe i nevojshëm këtij njeriu.

Po ç'mund të kishte ndërmjet tyre të përbashkët? As edhe keqbërja nuk ishte e tillë. Për më tepër që nuk e honepste fare këtë njeri, dukej që ishte deri në fyt me vese, ishte tinëzar dhe mashtrues, ndoshta dhe i lig. E ç'nuk kishte dëgjuar të flitej për të! Ishte e vërtetë që u qe gjendur fëmijëve të Katerina Ivanovnës, por ku i dihej në ç'qafë dëshironte të dilte? Se ky njeri thurte e shthurte pa mbarim plane e projekte.

E ngacmonte për tmerr edhe një mendim tjetër; ndonëse bënte çmos ta largonte nga mendja; ishte tepër po tepër i rëndë ai mendim! Svidrigajllovi po i vinte vërdallë, as tani s'po i ndahej, ishte në dijeni të fshehtësisë, e ndiente që diç bluante në veten e tij kundër Dunjës. Ishte thuajse i bindur për këtë! Po sikur, duke fituar pushtet mbi të pasi iu bë e njohur e fshehta, të orvatej ta hidhte kundër Dunjës? E mundonte shumë ky mendim, po e luante mendsh. Atëhere do ishte i detyruar t'ia bënte të ditur të fshehtën Dunjës, pas kësaj do të parapëlqente dorëzimin në polici për të shmangur ndonjë hap të pakujdesshëm të saj. Po letra? Ajo që mori Dunja sot në mëngjes? (Mos vallë nga Lluzhini?) Roje sogjetar ishte Razumihini, por ky shumë gjëra nuk i dinte. Mos i duhet thënë gjithçka edhe Razumihinit? Iu mbush trupi me mornica, kur e mëndoi.

Sido që të ishte, Svidrigajllovi duhej takuar një orë e më përpara. Veç po të guxonte të intrigonte kundër Dunjës, atëherë... Ishte aq i dërrmuar sa i ra shkurt: "Do ta vras!" Qëndroi në mes të rrugës dhe pa përreth. Ku ishte kështu? Nja tridhjet hapa më tej i zuri syri një pijetore, ishte plot e përplot me klientë. Dëgjoheshin tinguj orkestre, zëra këngëtarësh dhe zhurmë e zallahi, klithma grash. Tha me vete të kthehej andej nga kishte ardhur, kur në njërën nga dritaret i zuri syri Svidrigajllovin. Ishte ulur në një tryezë vetëm, thithte një çibuk. Shtangu nga habia. Edhe Svidrigajllovi e kishte parë dhe ishte duke e vrojtuar tinëz, heshturazi; Raskolnikovit iu duk se donte t'i fshihej, kjo e habiti. U shtir sikur nuk e kishte vënë re, qëndroi brinjazi dhe bënte sikur shihte diku larg, ndërkohë që me bisht të syrit ia hetonte të gjitha lëvizjet. Zemra i rrihte fort. Svidrigajllovi hoqi çibukun nga

goja, largoi karrigen që të ngrihej, por e kuptoi që Raskolnikovi po ia ndiqte lëvizjet. Po ndodhte ajo që kishte ndodhur me Raskolnikovin në dhomë, kur bënte sikur flinte. Një shprehje dhelpërake iu duk në sytë dhe sakaq iu përhap nëpër fytyrë Svidrigajllovit. Qeshi me të madhe.

- Ejani këtu, po të doni! Ja ku jam, - i thirri që nga dritarja.

Raskolnikovi i shkoi.

E gjeti në një dhomëzë anësore, një dritare e së cilës shihte sallën e madhe me nja njëzet tryeza, ku ishin shtruar me pije e aheng nëpunës, tregtarë dhe gjithfarë njerëzish të tjerë. Dëgjoheshin edhe kërcitjet e gurëve të bilardos në dhomën tjetër. Në tryezën e Svidrigajllovit ishte një shishe shampanjë e nisur, dhe një gotë e mbushur përgjysmë. Aty afër qëndronte një djalë me organeto në sup dhe një vajzë tetëmbëdhjetëvjeçare e shëndetshme dhe faqekuqe, veshur me një fund vijavija dhe një kapele trioleze e ca fjongo anësh, që ishte duke kënduar një këngë lakejsh me një kontralto të ngjirrur.

- Mjaft tani! - e ndërpreu Svidrigajllovi, kur hyri Raskolnikovi.

Vajza e ndërpreu këngën dhe qëndroi në pritje.

- Hej, Filip! Na sill një gotë! - thirri Svidrigajllovi.

- Nuk do pi! - ia preu Raskolnikovi.

- Si të doni, e porosita për këtë. Pije, Katja! Po e mbyllim me kaq për sot. Shko tani! - Ia mbushi gotën plot me verë dhe i zgjati një kartëmonedhë. Katja e ktheu me fund, i mori paratë, ia puthi dorën. Svidrigajllovi ia lejoi, duke e parë serioz. Pas kësaj doli nga dhoma bashkë me djalin. Nuk kishte as një javë këtu në Petërburg dhe këta të pijetores e mbanin për të vetin. Svidrigajllovi mbyllej me ditë të tëra në atë dhomëz, ndonëse pijetorja ishte e pistë, nga të dorës së fundit.

- Për te ju isha nisur, - i tha Raskolnikovi. - Nuk e prisja t'ju gjeja këtu. Çudi që ju gjeta.

- Po, ashtu është, çudi!

- Ndoshta është një rastësi.

- Habitet i shkreti njeri me ca si ju: s'i emërojnë që s'i emërojnë gjërat me emrin e tyre. Kjo tani është një çudi dhe ju s'doni ta thoni. Thoni: "Ndoshta është një rastësi!" Sa shumë që i trëmbem mendimeve vetjake, as me mend nuk mund ta merrni! Nuk e kam te ju

fjalën. Ju e keni mendimin tuaj personal dhe nuk i trëmbeni aspak, e shprehni, ndaj dhe ma keni ngacmuar kureshtjen.

- Me asgjë tjetër?

- Po pse kjo pak ju duket? Është më se e mjaftueshme!

Dukej që kishte ardhur në qejf, por vetëm pakëz, kishte pirë vetëm një gjysmë gote shampanjë.

- Më duket se erdhët tek unë para se ta merrnit vesh që e kam apo jo mendimin tim, që jam "i aftë ta kem", - siç shpreheni ju, - vuri në dukje Raskolnikovi.

- Tjetër qe ajo atëherë. Lidhur me "çudinë", mund t'ju them se këto dy-tri ditët e fundit ju ka vënë përfund gjumi. Me gojën time ua kam bërë të ditur këtë pijetore, asnjë "çudi" nuk ka në këtë mes, prandaj dhe erdhët drejt e këtu. Jua kam pas thënë qartë rrugën, vendndodhjen, orën kur mund të më gjeni. Ju kujtohet?

- Jo, nuk më kujtohet, - tha i habitur Raskolnikovi.

- Dy herë jua kam përsëritur. Adresa ju është ngulitur mekanikisht në mendje, ndaj dhe erdhët po mekanikisht. Pa qenë i vetëdijshëm, i ratë në të adresës. Kur ua thashë, nuk isha i bindur që më kishit kuptuar. Si shumë e ekspozoni veten, Rodion Romanoviç! Ja dhe diçka: e di që në Petërburg nuk janë të paktë ata që flasin me vete duke ecur. Se një qytet gjysmë i çmendur është ky! Sikur të kishin shkencëtarë të mirëfilltë: mjekë, filozofë, juristë, do të mund të bënin studime tepër të vlefshme këtu në Petërburg, secili në lëmin e vet. Rrallëkund gjen aq shumë ndikime të zymta, të fuqishme, por të çuditshme mbi shpirtin e njeriut si në Petërburg! Qoftë edhe ndikimi i klimës ç'peshë ka. Por Petërburgu është qëndra administrative e Rusisë dhe kjo specifikë s'ka si të mos pasqyrohet te të gjithë. Po ç'ta zgjasim, e lëmë këtë muhabet. Ju kam vrojtuar dhe jo një herë. Nga shtëpia dilni me kryet lart, pas nja njëzet hapash e vajisni kokën mbi kraharor, duart i vini pas shpine, për të parë shihni, por asgjë nuk shquani, as përpara e as anësh, pastaj luani buzët, flisni me vete; madje u ndodh ta çlironi njërin krah dhe të deklamoni: ndaloni dhe qëndroni si i ngrirë për një kohë të gjatë. S'bëni mirë. Mundet që, përveç meje, të jetë duke u parë edhe ndonjë tjetër. Nuk është mirë për ju. Sa për mua, bëni si të doni, por ju vetë e kuptoni, jua them se ju dua të mirën!

- Pse e dini që më ndjekin? - e pyeti Raskolnikovi duke e parë me

kërshëri.

- Jo nuk e di, - iu përgjegj disi i habitur nga pyetja Svidrigajllovi.

- Në qoftë kështu, atëherë nuk kemi pse flasim për mua, - mërmëriti i zymtë.

- Po mirë, nuk flasim.

- Nuk po kuptoj një gjë: në vini këtu për të pirë, madje dhe mua më paskeni ftuar dy herë, si shpjegohet që kur ju pashë nga dritarja deshët të fshiheshit, m'u bë sikur donit të iknit. E vura re mirë këtë.

- He! He! He! Po ju, kur erdha atëhere pse rrinit me sy mbyllur dhe shtireshit sikur ishit duke fjetur? Edhe unë atëherë e vura re mirë!

- Kam patur arsye... ju këtë... e dini tanimë.

- Edhe unë kam arsye, veç ju ato nuk keni për t'i mësuar.

Raskolnikovi vuri bërrylin e majtë mbi tryezë, mbështeti mbi pëllëmbë kokën dhe ia qepi shikimin Svidrigajllovit. Ia kqyri mirë e mirë fytyrën, që edhe më parë e kishte habitur. Dhe kishte përse: ngjante me një maskë: lëkura ishte e bardhë, faqet të kuqe, buzët të kuqe, mjekra ishte e bardhë, flokët po ashtu me fije të thinjura. Sytë i kishte të kaltër të çelur, shikimin plumb të rëndë, të palëvizshëm. Seç kishte diçka tmerrësisht të pakëndshme në këtë fytyrë si të thuash edhe njomëzake edhe bukuroshe, sidoqë nuk e kishte moshën. Ishte veshur shik, me një kostum të lehtë veror, veçanërisht binte në sy këmisha borë e bardhë, e mbajtur për merak. Në gisht kishte një unazë të madhe me një gur të madh xhevahiri.

- Mos më duhet të vras mendjen edhe për marifetet tuaja? - ia ktheu prerë Raskolnikovi, që po ngutej të dilte aty ku donte pa e zgjatur më tej muhabetin. - Se ju, kushedi dhe jeni njeriu më i rrezikshëm për mua, por ama s'ma ka fare qejfi të shtirem. Do jua vërtetoj që nuk më dhimset aq fort lëkura sa pandehni. Erdha këtu që t'u them se, nëse keni ende mendimet e dikurshme për time motër, dhe shkoni me mendjen të shfrytëzoni rastin që ju dha, do ju vras para se të më nisin për në galerë. Këtë që po them, e bëj: ju e dini. Nëse diç doni të më thoni (e kam vënë re kohët e fundit që e keni këtë dëshirë), ma thoni tani, për mua koha është flori, vonesa mund ta shvleftësojë atë thënie.

- E pse tërë ky ngut? - e pyeti Svidrigajllovi duke e parë i

përqendruar.

- Në jetë gjithsecili ka hapin e vet, - ia ktheu i vrenjtur dhe me padurim Raskolnikovi.

- Vetë më kërkuat që të jem i çiltër dhe pyetjes së parë që ju bëra, po refuzoni t'i përgjigjeni, - tha Svidrigajllovi me buzën në gaz. - Se përse ju duket që kam disa syime, më shihni me dyshim. Është krejt e kuptueshme kjo për gjendjen në të cilën ndodheni. Veç dijeni; megjithëse dua të merremi vesh, nuk kam për të marrë mundimin t'ua largoj dyshimin. Nuk ia vlen, ngaqë nuk kam ndonjë gjë të veçantë për t'ju thënë.

- Atëherë përse ju qënkam dashur? Tërë këto kohë keni bërë si kini bërë dhe më jeni vërdallisur!

- E kam bërë nga kureshtja, më ka tërhequr vëmendjen gjendja fantastike në të cilën ndodheni, kjo është arsyeja. Pastaj jeni vëllai i vajzës që më ka bërë për vete, kam dëgjuar të flitet shumë për ju, kam arritur në përfundimin që ju shkon shumë fjala tek ajo. E pse pak ju duket kjo? He! He! Por pyetja që më bëtë është disi e koklavitur dhe s'e kam të lehtë t'i përgjigjem. Ja, erdhët këtu për të më thënë diçka të re, kështu apo jo? - e pyeti Svidrigajllovi me një buzagaz djallëzor.

- E pra, edhe unë tërë kohën për ju kam menduar, thosha me vete se diç duhet të më thoni, diç keni për të më huajtur! Ja se çfarë tyxharësh jemi ne të dy.

- E ç'u dashka t'ju huaj?

- Si t'ua them? Mos e di unë se çfarë? Veçse vetë po e shihni në ç'pijetore jam duke e kaluar kohën, si jam duke u argëtuar, dua të them, ç'kënaqësi është kjo që jam duke fituar, por ja që duhet ndënjur diku! Edhe e gjora Katje... E patë? Të kisha qenë ndonjë grykës, hajde de! Po ja që as grykës nuk jam. (Ciku me gisht tryezën në qoshe ku në një pjatë ishte një biftek me patate thuajse fare i pa trazuar.) Po ju a keni ngrënë? Mos më shihni mua, mua as vera nuk po më shkon poshtë, nuk ma qas! Pi nganjëherë shampanjë, por më dhëmb koka pas gotës së parë. Tani i piva disa gllënjka, vetëm sepse më duhet të shkoj në një vend; e bëra për të ardhur pak në qejf. Edhe në ju fsheha shikimit tuaj atypari, ndaj e bëra që të mos më pengonit. (Nxori orën e xhepit dhe e pa). Kam nja një orë kohë, mund ta kalojmë bashkë. Sikur të bëja ndonjë punë, sikur të administroja çifligun, të shërbeja

oficer, të punoja fotograf, gazetar, hajde de, po kështu, rri zavalli njeri dhe as punë e as zanat! Mërzitet. Thashë: ka për të më njoftuar ndonjë gjë të re, ndaj dhe ju bëra zë.

- Ju pyes: kush jeni dhe përse keni ardhur këtu?

- Kush jam unë? Po ju fare mirë e dini, jam oborrtar, dy vjet kam shërbyer në kavaleri, pastaj u sorollata për një kohë nëpër Petërburg, u martova me Marta Petrovnën dhe rrojta me të në fshat. Ja, kjo është biografia imë!

- Më ngjan se jeni kumarxhi!

- Ç'ne? Batakçi po, por jo kumarxhi.

- Batakçi?

- Po, më ka ndodhur të jem.

- Ju kanë zhdëpur ndonjë herë?

- Ka ndodhur. Po ju pse më pyesni?

- Domethënë se mund ta thërrisnit në duel grindavecin... Zanat i mirë, të shkrifton dhe jo pak!

- Nuk kam si ju kundërshtoj, se edhe për filozofime s'para më vjen ndorësh. T'ju them të drejtën, këtu kam ardhur më shumë për punë grash.

- Pa e varrosur mirë Marta Petrovnën?

- E po, - vuri buzën në gaz Svigrigajllovi, dukej që e bëri nga sikleti. - Mos shihni ndonjë gjë të keqe në këtë mes?

- Po më pyesni, në shoh apo jo ndonjë gjë të keqe në korrupsion?

- Në korrupsion? Po kjo nga na doli? Le të flasim më shtruar, në fillim për punën e grave, se ju e dini, më pëlqen të llomotis ca. E përse m'u dashka të përmbahem? Përse u dashkan shmangur gratë, nëse më pëlqejnë? Se edhe kështu diç bën, të duket se je i zënë.

- Del që të gjitha shpresat te korrupsioni i paskeni varur?

- Por makar edhe në qoftë kështu. U kapët pas tij dhe ngulni këmbë si mushka! Se aty, sidoqoftë, ka diçka të përhershme që i ka rrënjët në natyrën njerëzore, që nuk është trill i fantazisë e nuk të përvëlon si thëngjill i futur në gjakun e njeriut. Atë me vite të tëra nuk arrin dot ta shuash! Pse si, në njëfarë kuptimi, korrupsioni a nuk është punë?

- E ç'kënaqësi na qënka? Sëmundje është dhe madje e rrezikshme!

- Ja ku dolët! I njëmendje me ju jam: diçka e keqe është si çdo gjë që e kapërcen masën, veç për një njeri kjo është kështu, ndërsa për

një tjetër, jo. Pastaj e bëj çdo gjë me masë, me karar. Ajo vërtet qe poshtërsi është, por s'ke ç'i bën! Po të mos gjendej ky argëtim, ku i dihej, mundej që dhe vetes t'ia hiqja. E di që njeriu i ndershëm duhet të jetojë në mërziti, por...

- Po pse a mund t'ia hiqnit ju vetes?

- Dëgjoni këtu! - iu drejtua me neveri në zë Svidrigajllovi. - Kini mirësinë të mos flisni me mua për gjëra të tilla. - E tha me ngut dhe pa e shoqëruar me atë teatralizmin karakteristik. Madje edhe shprehja e fytyrës i kishte ndryshuar, kur e tha. - Dobësitë e mia i pranoj, veç vdekjen mos ma zini ngoje, e kam frikë, s'dua të ma kujtoni. E dini, ne një farë mase jam dhe mistik njeri!

- A! Hija e Marta Petrovnës! Po si, a vazhdon t'ju fanitet?

- Mos ma kujtoni! Këtu në Petërburg nuk më është bërë më, larg qoftë! - thirri i nervozuar dhe i trëmbur. - Më vjen keq që më duhet ta ndërpresë këtë bisedë tonën, diç desha t'ju bëj të ditur.

- Po si, mos jeni duke shkuar te ndonjë grua?

- Po. Një rastësi qe... Por nuk e pata aty fjalën.

- Desha t'u pyes: mizerabiliteti i këtij mjedisi a nuk ju neverit? E paskeni humbur forcën që duhej t'ju ndalonte.

- Pretendokeni edhe për forcë! He! He! He! Më kënaqët me këtë që thatë, Rodion Romanoviç! E kam parashikuar që kështu do më thoshit. E dija që do futeshit në shpjegime rreth korrupsionit dhe estetikës... Shiler e shkruar Shilerit jeni, jeni idealist i kulluar! S'ka si të jetë ndryshe, përkundrazi, sikur të mos ishte kështu, duhej habitur... Sa keq që më sosi kjo e shkretë kohë! Tip më vete jeni! Po si, ju pëlqen Shileri? Mua për vete më pëlqen dhe shumë bile.

- Erë e veri njeri qënkeni, - vuri në dukje me pështirosje Raskolnikovi.

- Jo! Jo! - u zgërdhesh Svidrigajllovi. - Po, nejse, qoftë ashtu si thatë ju. E përse të mos jem i tillë, kur askujt nuk i bëj keq? Shtatë vjet jetova me Marta Petrovnën, ndërsa tani që hasa me një mendëtar si ju, dhe jo thjesht të mençur, por edhe tepër kërshërindjellës, po ndjej një kënaqësi të veçantë, se dhe gota e verës bëri punën e vet, më ra në kokë ajo e shkretë! Ka dhe një rrethanë tjetër që më bëri të më zgjidhet kësisoj gjuha... por për këtë më mirë po hesht. E ku shkoni kështu? - e pyeti i frikësuar Svidrigajllovi.

Raskolnikovi u përgatit të ngrihej; e ndjeu keq veten, si në zagushi,

ne këtë dhomëzë. Nuk i erdhi aspak mirë që gjendej aty. U bind që Svidrigajllovi nuk ishte veçse një keqbërës i rëndomtë, i paskrupull.

- Po rrini dhe pak, pse u ngritët? - iu lut Svidrigajllovi. - Porositni makar një çaj. Ju jap fjalën që nuk do llap më gjepura! Nuk do ju flas me për veten! Diç dua t'ju tregoj. "Më shpëtoi", po të shprehem në gjuhën tuaj, një grua! Ja, kjo është përgjigja për pyetjen e parë. E ajo grua është motra juaj. A mund t'ua tregoj si? Dëshironi? Kështu edhe kohën e vrasim.

- Mirë, tregoni, por shpresoj që...

- Mos kini merak! Se Avdotia Romanovna, madje edhe një njeriu të prishur e të lig, siç jam unë, i ngjall vetëm respekt dhe respekt të thellë.

IV

- E dini, se jua kam thënë vetë, që kam ndënjur në burg për borxhe. Shuma ishte e madhe, nuk kisha kurrfarë garancie për shlyerje. Më shpëtoi Marta Petrovna, sepse nuk ka fund çmenduria e grave në dashuri. Ishte grua e ndershme dhe jo pa mendje ne kokë (ndonëse nuk kishte kurrfarë shkolle). E pra, ajo grua fisnike i shkeli me këmbë thashethemet dhe shpotitë, e pranoi nënshkrimin me mua të një kontrate, së cilës iu përmbajt deri në një gjatë martesës. Ishte më e madhe se unë, u tregova aq i ndershëm sa t'ia bëja të qartë paraprakisht që s'kisha si i qëndroja besnik. U tërbua kur e dëgjoi, veç ai sinqeritet brutal i pëlqeu. "Nuk do të më gënjejë, ndaj dhe ma tha troç", - tha me vete. Për gratë xheloze sinqeriteti është diçka e dorës së parë. U derdhën rrëke lotësh, dhe çështja u mbyll me një si kontratë gojore: nuk do ta braktisja, do isha bashkëshort i denjë, pa lejën e saj nuk do largohesha asnjëherë nga çifligu, nuk do kisha dashnore të përhershme, do më lejonte të takohesha me vajzat fshatare, por vetëm me pëlqimin paraprak të saj, veç, nuk duhej as në mendje të dashuroja ndonjë të sërës sonë, nëse do kisha fatkeqësinë të bija viktimë e një të tillë pasioni, duhej ta vija në dijeni menjëherë Marta Petrovnën. Për pikën e fundit foli ashtu kalimthi: ishte grua e mençur dhe s'kishte si të mos më çmonte ndryshe veçse si njeri lapërdhar dhe i prishur, që

nuk kisha si bija seriozisht në dashuri. Por gruaja e mençur dhe gruaja xheloze janë dy gjëra të ndryshme, këtu dhe fshihej e keqja. Të gjykosh si duhet për tjetrin duhet më parë të heqësh dorë nga paragjykimet, nuk duhet të nisesh nga kuti, me të cilin matin njerëzit e rëndomtë. Është e drejta ime që të shpresoj shumë në mendimin që keni për mua. Ndoshta ju kanë rënë në vesh gjithfarë thëniesh për Marta Petrovnën, e kanë pas cilësuar grua qesharake dhe tuhafe. Dobësi e të meta ajo ka patur dhe jo pak, veç jua them sinqerisht, që më vjen jashtëzakonisht keq që kam qenë shkaktar i sa e sa brengave të saj. Por kjo që thashë duket si *orasion funèbre*[1] i burrit të dhimsur për gruan e dhimsur. Kur plaste ndonjë grindje, parapëlqeja heshtjen, dhe kjo sjellje prej zotërie më voliste e asaj i pëlqente, shkonte në të mirë të marrëdhënieve tona. Ndodhte që dhe krenohej me këtë sjelljen timen. Ama motrën tuaj nuk e duroi dot. Si ndodhi që pranoi të merrte për guvernante një të tillë bukuroshe! Ndoshta ngaqë Marta Petrovna ishte natyrë e furishme, e prekshme, ku i dihet, mundet që ajo vetë të ketë provuar ndjenja dashurie për të. Përsa më përket mua, unë menjëherë e kuptova që do t'i kisha pisk punët, e preva mendjen të mos i ngrija kurrë sytë në drejtim të saj; në doni më bësoni, në s'doni mos më besoni! Dhe e dini? Ishte vetë Marta Petrovna ajo që bëri hapin e parë të afrimit tonë dhe puna shkoi deri aty saqë zuri të zemërohej që isha duke ruajtur një heshtje të plotë ndaj gjithë atyre fjalëve dashamire që thuheshin në adresë të Avdotia Romanovnës. Nuk po mundja dot ta kuptoja se ku donte të dilte. S'kisha as më të voglin dyshim që për mua ia kishte treguar të gjitha; e kishte këtë huq: i nxirrte jashtë derës të fshehtat familjare. S'kishte si e linte t'i shpëtonte pa u shfrytëzuar një rast aq i volitshëm! Madje mund t'ju them se nuk duhet të kenë bërë tjetër veç për këtë kanë folur. Avdotia Romanovna duhet të ishte në dijeni të bëmave të zymta dhe misterioze që m'i veshnin mua... Vë bast që edhe ju keni dëgjuar për to.

- Ashtu është, Lluzhini ju ka pas bërë me faj dhe për vdekjen e atij fëmijës. Kështu është apo jo?

- Kini mirësinë të mos m'i zini ngoje këto poshtërsi! - tha tërë neveri e pështirosje Svidrigajllovi. - Nëse dëshironi të dini të vërtetën

[1]) *Fjala e lamtumirës (fr.).*

për tërë këto gjë e gjëza, jua them ndonjëherë, kurse tani...

- Edhe për një shërbëtorin tuaj në fshat flisnin, thonë që jeni ju ai që jeni bërë sebep...

- Ju lutem, mjaft me këto! - e ndërpreu me padurim Svidrigajllovi.

- Mos është fjala për shërbëtorin që u fanitej pas vdekjes duke ju mbushur çibukun me duhan? Ju vetë ma keni thënë, - ngulmoi me kokëfortësi Raskolnikovi, duke ia cytur nervat gjithë më tepër.

Svidrigajllovi e pa drejt në sy. Raskolnikovi vuri re vetëtimën e një ligësie demoniane dhe të një urrejtjeje për vdekje në sytë e tij, por s'e dha veten dhe shtoi me mirësjellje:

- Po, ai është. Po e shoh që ju interesokan ca gjepura si këto, e ndiej për detyrë që në rastin e parë, t'jua shuaj kureshtjen. Se thashë de, dikujt iu dukërkam i rrethuar nga brerore romantike! Dhe vetë e kuptoni sa shumë që i detyrohem Marta Petrovnës për gjithë sa i shfreu kundër meje motrës suaj! Nuk kam si gjykoj për përshtypjen që i bëri, por sido që të ishte, për mua qe e dobishme. Ndonëse më neveriste ngaqë endesha tërë kohën i errët dhe me pamjen e një njeriu të pangushëllueshëm, i erdhi keq për mua. Dhe kur në zemrën e vashës përvidhet mëshira, dashuria nuk mënon të nxjerrë krye. Se do t'ia ketë ënda "ta shpëtojë" atë fatkeq, ta sjellë në vete, ta ringjallë! Dëshiron t'i zgjasë dorën për t'u hedhur në veprime fisnike, në bëma jetëdhënëse... E pashë që zoçka po i afrohej grackës, mora masat që të mos më shpëtonte. E shoh që u vrenjtët, Rodion Romanoviç. Nuk ndodhi gjë prej gjëje, vogëlsira qenë të gjitha. (Dreq o punë, sa shumë verë që kam pirë). E dini, gjithmonë kam ndier keqardhje që motra juaj nuk pati fatin e mirë të lindte, të themi, në shekullin e dytë a të tretë të erës sonë në ndonjë familje princësh, me peshë në shoqëri, diku në Azinë e Vogël. Do të kishte qenë një nga ato që kanë pranuar të martirizohen, sigurisht do të qëndronte me buzën në gaz, kur të shihte si do t'ia vinin në kraharor hekurin e skuqur, do të ishte një nga ato që do të kuturisnin të merrnin rrugën për ta çarë mespërmes shkretëtirën, do rronte aty nja tridhjetë vjet, duke u ushqyer me rrënjë, por duke u ngazëllyer nga shkulmet e entuziazmit të pafund dhe nga fanitjet e llahtarshme që do t'i vinin. Se ajo rron vetëm me një dëshirë: të martirizohet për dikë, në mos pastaj merre e hidhe nga dritarja. Më ka ardhur në vesh emri i njëfarë Razumihini. Më folën si për njeri

me mendje në kokë, ndonjë seminarist ka të ngjarë të jetë, mirë është të bëhet tutor i sat motre. Që e kam njohur, kjo më bën nder. Ndërsa në ca çaste të atilla, ju dhe vetë e kuptoni, njeriu bëhet mendjelehtë, por edhe budallallepset; s'ka si u shpëton gabimeve. Po pse është kaq e mirë? S'e bëj veten me faj; më vunë përfund ca shkulme turbulluese e lakmie. Po ndaj kujt pa! Avdotia Romanovna është tepër e arsyeshme dhe tej mase përdëllimtare (Këtë s'e luan topi: është tejet e arsyeshme, e ka si sëmundje, ndonëse është edhe shumë e mënçur). Banonte në çiflig një vashë, quhej Parasha; ishte një syzezë e vetullzezë e mirkë, por s'e kisha pas vënë re. Nuk pranoi, vuri kujen, e mori vesh i madh e i vogël. Avdotia Romanovna gjeti rastin dhe m'u afrua në kopsht, me lot në sy më kërkoi ta lija të qetë vajzën. Ishte hera e parë që shiheshim vetëm për vetëm. Kuptohet, i thashë se e kisha për nder t'ia plotësoja dëshirën, u shtira i penduar dhe i prekur në sedër dhe, dua të them, se ia dola mbanë për bukuri. Nisën kësisoj bisedat në fshehtësi, moralizmat dhe nasihatet pa fund, lutjet dhe përgjërimet (O Zot çfarë përgjërimesh!), deri edhe te lotët shkoi puna, aq afër zemrës e kishte marrë atë që i kishte ndodhur Parashës. Unë po domosdo që fajësova fatin, jetën e shthurur që kisha bërë, dhe vura në përdorim një mjet krejt të sigurt në marrëdhëniet me gratë: lajkat. S'ka zemër gruaje që të mos zgërlaqet para tyre. Nuk është e le të të tregohesh zemërçiltër me të tjerët. Makar një fije falsiteti të pikasë, shëmbet çdo gjë si kështjellë rëre. Prit skandalin pastaj. Kurse lajkat, edhe në qofshin fund e krye false, janë gjithmonë mikluese, dëgjohen me ëndje. Sado të trasha që të jenë, gjysma prapë se prapë do të duken të besueshme. Dhe nga ky rregull nuk bëjnë përjashtim as shtresat më të larta të shoqërisë, pale pastaj ato të rëndomtat. Edhe murgeshës së Vestës ia prish mendjen me lajka. Shkrihem gazit kur ndërmend si arrita të qorrolleps një shenjtëreshë, e cila këtej i falej e i përgjërohej bashkëshortit, dhe andej rronte vetëm për të bërë të mira. Sa shumë zbavitëse që ishte dhe sa e kollajtë! E pra, në atë mënyrën e vet, kjo nuk ishte pa vyrtyte. Taktika që ndoqa ishte kjo: ia ngrita në qiell vyrtytet, e lajkatova sa munda e si munda, me të arritur t'i marr ndonjë shikim apo shtrëngim të lehtë dore, i përdorja lumë fjalët e qortimit të vetes që isha duke e dhunuar, se nuk ishte ajo vetë që po m'i falte, por isha unë ai që po e detyroja; nuk kisha si të siguroja

gjë prej gjëje, po të mos kisha qenë i mbytur deri në fyt nga mëkatet, se vetë ajo ishte aq ëngjëllore, saqë nuk kishte si e vinte re intrigën që po i thurja, nëse diç po pranonte, këtë e bënte pa u menduar, pa ditur asgjë, etj., etj. Me një fjalë, e arrita atë që desha, ndërsa zonjëza ruajti deri në fund bindjen e shfajësimit të vetes, të arsyes së fortë dhe të të qënit në lartësinë e detyrimeve para vetes, bashkëshortit dhe shoqërisë, se fare rastësisht që gjendur në krahët e vesit. Ta shihje sa shumë u zemërua, kur një ditë prej ditëve i thashë që e kishte lakmuar kënaqësinë epshore njëlloj si unë! E gjora Marta Petrovna, vdiste për një çikë lajka! Po të kisha dashur, fare lehtë mund ta kisha kaluar çifligun në emrin tim që në të gjallë të saj (Po u dënda duke pirë verë dhe duke llapur.) Shpresoj të mos pezmatoheni po t'ju them se këtë mjet aq të sprovuar e përdora edhe në marrëdhëniet me Avdotia Romanovnën. Veç u tregova i trashë, u nguta dhe e prisha çdo gjë me dorën time. Avdotia Romanovna edhe më parë (madje njëherë veçanërisht shumë) nuk i kishte pëlqyer shprehja e syve të mi! Gjithë më tepër, pa kurrfarë kujdesi nga ana ime, në ta shkrepëtinin ca xixa që e trëmbnin, arriti një kohë që iu bënë të padurueshëm. Ç'i do llafet, nuk më eci! S'kaloi shumë kohë dhe bëra edhe një marrëzi tjetër: ia vura në lojë moralizimet dhe nasihatet që i kishte aq për zemër. Doli edhe njëherë në skenë Parasha, u bë një katrahurë e vërtetë. Të kishit qenë t'ia shihnit ata sy të përshkënditur dhe flakërues! Mos më shihni ashtu, vërtet që jam i dehur, por ju betohem që po ju them të vërtetën. Sa e sa herë e kam parë në ëndërr, deri edhe fëshfërima e fustanit më është fanitur. Thashë se nuk do gjeja forca ta kapërceja atë ndjenjë! Edhe vetë po habitesha me atë që provoja. E dija që duhej bërë çmos për t'u pajtuar, por ishte e pamundur. E dini çfarë ndërmora? E dini si mund ta katandisë robin furia e zemërimit? Dëgjomëni mua: mos bëni asgjë në zemërim e sipër, Rodion Romanoviç. Duke e ditur që Avdotia Romanovna është fare e këputur (të me falni, nuk desha të them këtë... por a nuk është njëlloj nëse edhe kështu del thelbi), domethënë që rronte me djersën e ballit, duke patur mbi shpatulla mamanë edhe ju (dreq o punë, përsëri u shtrëmbëruat në fytyrë), vendosa t'i ofroj para (nja tridhjetëmijë rubla isha në gjendje t'ia jepja në dorë), për të ardhur me mua në Petërburg. Kuptohet që iu betova për dashurinë e sinqertë që

ushqeja, për pasionin që nuk do të shuhej kurrë, etj., etj. Dhe, e dini, të më kishte thënë atëherë: there Marta Petrovnën, martohu me mua, do ta bëja në vend! Por bashkudhëtare qe vetëm katastrofa, këtë ju dhe vetë e dini. S'është e vështirë të merret me mendje indinjata dhe tërbimi, kur mora vesh që Marta Petrovna se nga e psonisi këtë Lluzhinin dhe martesa pritej të bëhej nga dita në ditë. E pra, unë të njëjtën gjë i pata propozuar. Kështu apo jo? Të njëjtën! Po vë re që po më dëgjoni goxha i përqendruar... tip më vete jeni!

Svidrigajllovi përplasi me forcë grushtin mbi tryezë, u skuq në fytyrë. Dukej që pija e kishte bërë të vetën, vendosi ta shfrytëzonte rastin. Dyshonte shumë te ky njeri.

- Pas gjithë kësaj që treguat, u binda që edhe këtu ndaj paskeni ardhur, për motrën time, - ia tha copë që t'ia ngacmonte edhe më shumë nervat.

- Po kjo ç'më qënka? - thirri Svidrigajllovi që i ra hilesë. - Po jua thashë, de, që motra juaj nuk më sheh dot me sy.

- Këtë dhe unë e di, por nuk është aty puna.

- Pse edhe ju këtë bindje paskeni? (I picërroi sytë dhe u zgërdhesh me tallje.) Keni të drejtë, nuk më do, veç mos e vini dorën në zjarr, kur është fjala për marrëdhëniet ndërmjet burrit dhe gruas dhe dashnorit e dashnores. Se në to mbetet kurdoherë një qoshk i pandriçuar; ç'fshihet në atë qoshe, e dinë vetëm ata të dy. Jeni i sigurt që Avdotia Romanovna më neverit?

- Disa fjalë e shprehje që sapo përdorët, më shtyjnë të mendoj që nuk paskeni hequr dorë nga Dunja, kuptohet, në kuptimin e keq të fjalës.

- Si? A thua të më kenë shpëtuar të tilla fjalë e shprehje? - me një naivitet të shtirë e pyeti Svidrigajllovi, pa e çarë kokën për epitetin që i vuri folësi synimeve të tij.

- Po, ju shpëtuan. E ç'ka këtu?

- Asgjë. Nuk jam unë ai që duhet të kem frikë, jeni ju! Juve ju shkon shtatë nga unë, *cher ami*[1]) Po t'i lëmë këto, e shoh që jam i dehur, mundet edhe të lajthis. Hej! Filip, hiqeni verën! Më sillni pak ujë.

E rrëmbeu shishen dhe e flaku nga dritarja. Filipi i solli ujë.

---

[1]) *I dashur mik (fr.).*

- Gjepura janë që të gjitha, - tha Svidrigajllovi, duke e lagur peshqirin dhe duke e vënë në kokë. - Mund t'ju vë me shpatulla pas murit vetëm me një fjalë dhe t'jua flak tej dyshimet tinëzare. E dini që po martohem?

- Ma keni thënë një herë.

- Jua paskam thënë? Harrova. Veç me tamam nuk duhet t'jua kem thënë, se as nusen nuk e kisha parë, vetëm kisha bërë mendje të martohem. Tani e njoh kush është, po të mos kisha ca punë që nuk presin, do ju merrja me vete e do ju çoja atje, më lypset këshilla juaj. Tani më duhet të iki. Do ju tregoj, se kjo martesa ime është me nishan... Po ju për ku? Ku po shkoni?

- Nuk po shkoj gjëkundi.

- Nuk po ikni? Do ju çoj ta shihni, por jo tani! Njiheni me Rislihët? Ata ma rregulluan. Më duhet që të kaloj kohën, se jam njeri i zymtë. Nuk i bëj kujt dëm, por vetëm strukem në ndonjë qoshe dhe as gëk e as mëk, më ndodh të mos takohem me njeri edhe tri ditë rresht. Rislihët i kanë bërë mirë hesapët, ata dhe më gjetën nusen. Edhe në m'u mërzittë, s'ka gjë, mund ta braktis kur të dua. I ati, një plak invalid, paska tre vjet që është i paralizuar, e shoqja qënka grua e mençur. Djali u shërbeka diku në një gubernë, nuk i dërgoka as dhe një kopejkë edhe bija e martuar nuk dashka t'ia ditka fare për prindët. Paska një mbesollë, pas pak mbushka gjashtëmbëdhjetë vjeçët, dashkan ta martojnë me mùa. Shkuam. Nuk i bëhej vonë që jam pesëdhjet vjeç, kryesorja është që jam çifligar i pasur. Pse a nuk është joshës si rast? Ha! Ha! Të më shihje si jepja e merrja me ata matufër! Edhe të paguaje ia vlente... Hyri çupa, u ul, fustani mbi gjunjë, gonxhe e pa çelur! Shend e verë, buzët lulëkuqe, të fryra, shkëlqente si agu mëngjesor! (Kuptohet që ia kishin bërë të ditur punën.) Nuk e di shijen tënde për punë grash, por fytyra e miturakëve, sytë e tyre fëmijërorë, ndrojtja e ngahershme dhe piklat e lotit në qerpikë nuk kanë të krahasuar me asnjë bukuri tjetër. E pra, vajza ishte për kokën e vajzës. Ishte flokëverdhë, baluket i kishte mbi ballë, trupin e hajthëm dhe nazik, këmbët për merak... U njohëm. U thashë se isha me ngut, më prisnin ca punë, pas tri ditësh e shpallëm fejesën. Kur i vete, e ul në prehër dhe ashtu e mbaj tërë kohën... Çelet si trëndafil në agim, s'i lë vend pa ia puthur! Plakoshi bën ç'bën dhe i përsërit se jam burri i saj. Qejf,

or qejf! Kjo kohë fejese është më e mirë se martesa. *La nature et la vèritè!*[1]) - i thonë fjalës. Ha! Ha! Ha! E kam takuar nja dy herë, nuk është pa mendje. M'i ngul ndonjëherë sytë ashtu fshehur, sikur të fshik me hekur të skuqur! Si Madona e Rafaelit e ka fytyrën. Se Madona Sikstine ka një fytyrë fantastike, ka fytyrë prej sakateje të trishtë, a nuk ju ka rënë në sy kjo? Diçka e tillë. Të nesërmen e lidhjes së fjalës, i çova një varëse me gurë xhevahiri dhe një kuti të madhe tualeti për merak, të punuar në argjend; ç'nuk kishte brenda në të. Iu ndez fytyra dhe i shkrepëtinë sytë kur i pa. Njëmijë e pesëqind rubla bënë. Pasi u larguan njerëzit e shtëpisë, ndenjëm vetëm për vetëm. E ula në prehër, por e bëra pak rrëmbimthi. E skuq u bë flakë, i digjej si prush fytyra, pika loti iu dukën në sy; nuk deshi ta jepte veten, por digjej përbrenda. S'kaloi shumë dhe m'u hodh në qafë, më pushtoi me krahët njomëzakë, më puthi, m'u betua se do ishte e bindur, do më qëndronte besnike, do më bënte të lumtur, do më përkushtonte jetën, do bënte çmos që ta meritonte respektin tim. "Tjetër mua nuk më duhet, as dhurata nuk më duhen!" - më tha. Hë, si thoni, a s'të errësohen sytë e s'të merren mendtë kur e mban në prehër këtë ëngjëllushe faqekuqe me pikat e lotit në qerpikë që të thotë kësi fjalësh? Joshëse është! Ju si thoni? Ia vlen të merresh... Do ta shihni dhe do më jepni hak. Por tani jo...

- Domethënë qënka hendeku i viteve shkaktari i epsheve? Ju si vërtet që keni bërë mendje të martoheni me të?

- E pse jo! Gjithësecili mendon për vete: *më i gëzuar se të gjithë është ai që arrin ta gënjejë veten.* Ha! Ha! Po kjo kështu, juve vetëm për punë të virtytshme ju punon mendja! Mëshirë për mua mëkatarin! He! He!

- Sidoqoftë, fëmijët e Katerina Ivanovnës i strehuat... Keni arsyet tuaja për këtë... tani e kuptova.

- I dua fëmijët dhe i dua shumë, - qeshi Svidrigajllovi. - Mundem t'u tregoj diçka lidhur me këtë. Ditët e para të qëndrimit në Petërburg, vajta e vizitova vendet ku kisha qenë dikur, u takova me miqtë e dashamirët. S'kam si rroj pa ta. Kur isha në çifligun e Marta Petrovnës, nuk më hiqeshin nga mendja kujtimet misterioze për vendet dhe

---

[1]) *Natyrshmëri dhe sinqeritet! (fr.)*

njerëzit e këtushëm, dhe me të drejtë, ke ç'kujton. Gjeta edhe të rinj me shkollë që po shuhen si qiriri bashkë me ëndrrat dhe shpresat e shumta, të fandaksur nga gjithfarë teorish. Çifutët e fshehin paranë, njerëzia s'di nga t'ia mbajë. E kam njohur këtë klimë, nuk paska ndryshuar fare. Me rastisi të gjendesha në një mbrëmje vallëzimi, lesheli hesapi! (Më pëlqejnë rrëmujat, më gëzon orgjia.) Vura re që punët ishin më të ngatërruara se atëherë në kohën time. Helbete, përparimi bën të vetën... Shoh një trembëdhjetëvjeçare, të stolisur si kukull, duke kërcyer me një mësues danci. E ëma rrinte pas murit dhe e ndiqte me sy. Vajza nuk dinte ku të futej, e ndiente veten të fyer, tërë kohën qante. Kavalieri për asgjë nuk donte t'ia dinte, e rrotullonte dhe e përdridhte me sa mundej, njerëzia në sallë gajasej së qeshuri. Më pëlqen t'i shoh njerëzit në kësi rastesh, më pëlqyen britmat: "Ashtu, de, ashtu! S'kanë punë fëmijët këtu!". S'më hante fare meraku në duheshin apo nuk duheshin sjellë fëmijët këtu. Iu afrova së ëmës dhe i thashë që këta njerëz qënkan ca injorantë që nuk ditkan të dallojnë të virtutshmen e të respektojnë të merituarën. I thashë se mund ta ndihmoja dhe e ftova për një çaj në dhomën time. I hipa në pajton. Më tha se e kishte për nder që po e sajdisja, se ishte pa një grosh, se kishte ardhur për të përfunduar disa punë. I ofrova të holla dhe shërbimin tim. I premtova që diç do bëja edhe për edukimin e së bijës. E priti me gëzim të madh dhe u bëmë miq... Hë, si, doni të shkojmë? Veç jo tani.

- Lëri këto rrëfenja të ndyra prej njeriu të poshtër dhe të zvetënuar.

- Ja Shileri, Shileri foli përsëri. *Ou va-t-elle la virtu se nicher*[1]. E dini, enkas jam duke ju treguar ca shkrepëtima si këto që të dëgjoj reagimet tuaja! Qejf, or qejf!

- E di që ju dukem qesharak, - nëpërdhëmbi me mllef Raskolnikovi.

Svidrigajllovi u gajas, thirri Filipin, i pagoi për verën dhe u ngrit.

- Lakmova ca. *Assez causè*[2] - tha. - Qejf, or qejf!

- E pse jo! - thirri Raskolnikovi, duke u çuar. - Një i lerosur që llapashitet në llumin e korrupsionit, s'ka si të mos ndihet i kënaqur mes fëlliqësish, për më tepër në praninë e një njeriu si unë, që

---

[1]) *E ku nuk fshihet virtyti! (fr.)*

[2]) *Mjaft llapëm! (fr.)*

ndodhem në disa rrethana...

- Në qoftë kështu, - ia ktheu me njëfarë habie Svidrigajllovi, - në qoftë kështu, del që edhe ju qënkeni një cinik që nuk ju gjendet shoku. Se ju për të çmuar dini të çmoni, por edhe për të bërë dini, madje bëni me mjeshtëri... Por i lemë këto... Më vjen keq që nuk kam asnjë mundësi të qëndroj më tej me ju. Veç mos u largoni këtej... Më prisni këtu.

Svidrigajllovi doli vrullshëm. Raskolnikovi i shkoi pas. Nuk dukej se ishte kushedi sa i dehur, për më tepër që sa vinte e kthjellohej. Dukej tej mase i preokupuar, ajo që e shqetësonte ishte shumë e rëndësishme, ecte i vrenjtur. Sakaq ndërroi qëndrim ndaj Raskolnikovit: u bë më harbut dhe shthuranik, tallës dhe shpërfillës. Ky e pikasi këtë qëndrim dhe u alarmua. Dyshonte shumë te ky njeri, vendosi të mos e lëshonte nga sytë.

Dolën në trotuar.

- Ju e keni rrugën majtas, kurse unë djathtas, apo ndoshta e kundërta. Sidoqoftë, *adieu, mon plaisir*[1]). Na prifte e mbara!

Mori nga e djathta.

V

Raskolnikovi e ndoqi pas.

- Po kjo, ç'është, - iu drejtua Svidrigajllovi. - Më duket se të thashë...

- Nuk të shqitem, jo.

- Si-i-i!

Ndalën dhe ia ngulën sytë shoshoqit, si të donin të mateshin.

- Nga tërë ato kallzime prej të dehuri, - i shpjegoi Raskolnikovi, - arrita në përfundimin që jo vetëm s'keni hequr dorë nga planet e poshtra kundër time motre, por, përkundrazi, jeni duke i vënë në jetë. E di që këtë mëngjes mori një letër. Juve nuk po ju zë vendi vend... Ajo dihet, që ashtu në rrugë e sipër edhe mund ta bënit hall një nuse, por kjo asgjë nuk do të thotë. Dua ta shoh çdo gjë me sytë e mi.

Po ta pyeste ndokush në ato çaste Raskolnikovin se ç'ishin ato që

---

[1]) *Lamtumirë, gëzim! (fr.)*

donte t'i shihte me sytë e tij, zor se do mundte ta thoshte.

- Ja ç'na qënka! Mos doni të thërras policinë?

- Thirreni.

Përsëri u panë sy ndër sy si atypari. Fytyra e Svidrigajllovit ndryshoi me një shpejtësi të çuditshme. Pasi u bind që Raskolnikovi as që deshi t'ia dinte për kërcënimin, u shtir si i gëzuar dhe i foli me përzemërsi.

- E pra, enkas nuk jua zura ngoje çështjen dhe pse më bren përbrenda kureshtja. Thashë, t'ia them një herë tjetër; por ja që ju edhe të vdekurin që është i vdekur nuk e lini pa e gudulisur... Më duhet të kthehem për një minutë në shtëpi që të marr ca para, do ta mbyll me kyç dhomën dhe këtë mbrëmje kam bërë mendje ta kaloj në ishull. S'keni arsye të më qepeni pas.

- Po vij me ju për të takuar Sonja Semionovnën, do t'i kërkoj ndjesë që s'munda të shkoja në varrim.

- Ju e dini që nuk keni për ta gjetur në dhomë. Ka shkuar me fëmijët te një zonjë, është një e njohura ime e vjetër, merret me jetimoret. Kur ia dhashë në dorë pagesën për tre muaj për fëmijët, iu prish mendja, kur shtova dhe jo pak edhe për vetë jetimoren, dhe i tregova edhe për Sonja Semionovnën, atëherë punët rrodhën si në vaj. U trondit dhe u pataks, u tregua e gatshme të takohej e të bisedonte vetë me të.

- Sido që të jetë, po kthehem ta shoh.

- Por desha ta di: ju dukem i dyshimtë sepse as dhe një herë nuk jua kam zënë ngoje çështjen, që ju intereson. Kështu apo jo? Vë bast që kështu është! Ja dhe të mirat e delikatesës...

- E kush na qënka delikat, ai që përgjon të tjerët prapa derës!

- Ja për çfarë ju haka meraku! - tha duke qeshur Svidrigajllovi. - Do të ishte vërtet e çuditshme po ta kishit kaluar në heshtje këtë çështje, po të mos ma kishit bërë këtë vërejtje... Ha! Ha! Diç dhe kuptova nga ato që i treguat... vetë ju, me gojën tuaj... Sonja Semionovnës. Se vetëm një leshko mund të mos e kuptonte! A nuk merrni mundimin të ma shpjegoni si qëndron puna? Të më falni për kureshtjen...

- Po ju s'kishit si dëgjonit gjë... Këto që thoni gënjeshtra janë e asgjë tjetër.

- Nuk e kam këtu fjalën, jo! (Ndonëse, të them të drejtën, edhe diç

më zuri veshi.) Ofshamat dhe psherëtimat e shpirtit janë puna juaj! Se Shileri orë e çast nxjerr krye te ju... Edhe ajo që thatë: mos përgjoni prapa derës, nuk është puna tuaj. Në është ashtu siç ma zuri veshi, shkoni atje ku duhet dhe thoni që nuk ju doli praktikisht ajo që kishit menduar teorikisht! Në mendofshi se prapa derës nuk duhet përgjuar, por plakat mund t'i batërdisësh si të ta dojë qejfi, atëherë mbathjani më mirë në Amerikë! Keni ende kohë... Po ju flas sinqerisht. Nuk keni para? Ju jap unë sa për udhë.

- As që më shkon në mendje një gjë e tillë, - ia ktheu Raskolnikovi me neveri.

- E kuptoj, ama s'keni pse flisni ashtu. Fort mirë e kuptoj që ju mundon shumë ana morale e qytetare e çështjes. Dëgjomëni mua, lërini në punën e vetë, s'kanë ç'ju duhen tani. He! He! Edhe qytetar, edhe njeri! Duhej peshuar më parë kjo, duhej menduar mirë para se t'i hynit punëve! S'e bëtë, hiqjani vetes atëherë! Nuk ua ka qejfi?

- Po e shoh që doni të më inatosni, dhe e bëni për të më hequr qafe.

- Erdhëm, hyni, kini mirësinë. Ja dhe dhoma e Sonja Semionovnës, e shihni, nuk ka njeri. S'ju besohet? Pyesni Kapernaumovët, atyre ua lë çelsin. Ja ku doli e shoqja, është ca e rëndë nga veshët. Ka dalë dhe s'ka për t'u kthyer deri vonë. Tani shkojmë tek unë, se kështu thatë që donit të vinit. Zonja Reslih nuk qënka në shtëpi. Tërë ditën të zënë me punë e sheh atë njeri, por nuk është grua e keqe, dëgjomëni mua... Po të tregoheni i zgjuar, mund t'ju hyjë në punë... Paratë i mora, dalim tani. S'kemi pse e humbasim kotsëkoti kohën. Po shkoj në ishujt, mos dëshironi të vini me mua? Nuk doni? Kot e keni, shkojmë... Po fillon shiu...

Svidrigajllovi zuri një pajton. Raskolnikovi tha me vete se dyshimet, të paktën në ato çaste, ishin të padrejta. Pa i thënë asnjë fjalë, çapiti në drejtimin e kundërt me atë që të shpinte në Sheshin e Senës. Po ta kishte kthyer makar edhe një herë kokën pas, do vinte re që Svidrigajllovi, pasi eci nja njëqind hapa, i dha karrocierit hakun dhe u gjend në trotuar. Nuk e pa. Ktheu në bërrylin e rrugës me një shprehje neverie në fytyrë. E pra, i kishte varur shpresat e shpëtimit te një monstër e përbindësh si ky! Veç kishte bërë një vlerësim paksa të shpejtuar të situatës, të shpejtuar dhe mendjelehtë. Se në këtë sjellje

e qëndrim të Svidrigajllovit s'kishte si të mos vije re origjinalitet e fshehtësi. Lidhur me marrëdhëniet e tij me të motrën, Raskolnikovi vazhdonte t'i përmbahej bindjes që ky njeri nuk kishte për ta lënë të qetë. Çdo gjë do ta kontrollonte dhe mbikqyrte. Sa shumë që e mundonte kjo!

S'vonoi të zhytej në mendime, siç i ndodhte gjithmonë kur ishte vetëm. Ndali te parmakët e urës dhe po shihte ujin. Pranë iu gjend Avdotia Romanovna. Motra ishte hera e parë që e ndeshte në rrugë, shtangu e habitur dhe e trëmbur. Nuk po dinte ç'të bënte: t'i thërriste apo të mos i thërriste. Atë çast asaj i zuri syri Svidrigajllovin, që po ecte në anën tjetër të urës. Iu duk i rrethuar nga një e fshehtë kërshërindjellëse, ecte duke u ruajtur nga Raskolnikovi. E kishte parë Dunjën dhe po i bënte ca shënja, që, siç i kuptoi kjo, donin të thoshin të mos i bëzante vëllait, por të shkonte tek ai.

Ashtu bëri.

- Shkojmë, - i pëshpëriti Svidrigajllovi, kur iu afrua. - Nuk dua të na shoh Rodion Romanoviçi! Ishim bashkë, mezi u çlirova prej tij. Është në dijeni të letrës dhe diç dyshon. Mos i keni treguar gjë ju? Se kush tjetër mund t'ia ketë thënë?

- Prapa atij qoshku atje nuk na sheh dot, - i tha Dunja. - Më tej nuk kam për të bërë as dhe një hap. Flisni, ç'kini për të folur.

- Nuk janë punë që bëhen në rrugë! Pastaj duhet dëgjuar ç'do thotë Sonja Semionovna, pale pastaj që dua t'ju njoh edhe me disa dokumente. Se në mos pranofshi të vini tek unë, heq dorë fare nga çdo lloj shpjegimi. E quaj të nevojshme t'ju them se jam në dijeni të plotë të asaj të fshehte që aq shumë e mundon vëllanë tuaj.

Dunja qëndroi e pavendosur, e pa hetueshëm.

- E pse të keni frikë? - e pyeti ai qetë. - Qyteti nuk është fshat, pale pastaj që edhe atje e pësova unë e jo ju.

- Po Sonja Semionovnën e keni paralajmëruar?

- Jo. As që e di në është apo jo këtë çast në dhomë, them se duhet te jetë. Sot e varrosi thjeshtrën, s'ka si largohet nga shtëpia. Kam vendosur të mos i hapem kujt tani për tani; edhe që ua bëra të ditur juve, nuk bëra mirë... Pakujdesia më e vogël është baraz me spiunllëkun. Ja dhe shtëpia ku banoj, roja më njeh, po më përshëndet; më sheh të shoqëruar me një zonjë, jua ka fiksuar mirë fytyrën, ja një

plus për ju që ju shkon mendja për keq. Të më falni për këto që po ju them... Me dhomën e Sonja Semionovnës na ndan vetëm muri, tërë kati banohet nga qiraxhinj. Nuk keni përse të trëmbeni! Pse kaq i tmerrshëm qënkam?

Fytyra iu shtrëmbërua nga një buzagaz njeriu të lënduar, zemra zuri t'i rrahë me furi, mezi mbushej me frymë. Dhe që fliste me zë të lartë, këtë e bënte për të mposhtur emocionet. Dunja tërë këto nuk i vuri re fare. Ishin të një natyre të veçantë. E kishte prekur shumë ky qëndrimi i saj, frika që po shfaqte hapur pre tij.

- E di që jeni i paskrupull, por frikë nuk kam! Shkojmë! - i tha prerë, në dukje e qetë, por fytyrën e kishte limon të verdhë.

Svidrigajllovi ndali para derës së Sonjës.

- Duhet marrë vesh në është apo nuk është aty. Nuk qënka. Sa keq. Por nuk ka për t'u vonuar. Duhet të ketë shkuar në një vend për punën e jetimëve. Kam ndihmuar edhe unë. Po të mos kthehet pas dhjetë minutash, do t'i them të vijë tek ju më vonë. Kjo është dera e dhomave të mia, ajo tjetra është e pronares, zonjës Reslih. Tani shihni këtu: kjo derë e dhomës sime të gjumit të çoń në dy dhoma të tjera të pa banuara nga askush, hyni e shihini mirë.

Dhomat që kishte pajtuar Svidrigajllovi ishin të mëdha e të mobiluara. Dunjeçka i pa me dyshim, por s'vuri re asgjë të veçantë si në mobilim, ashtu dhe në vendosjen e tyre. Nuk i ra në sy që dhomat fqinje me to ishin të pabanuara. Hyrja për në to nuk ishte nga korridori, por nga dhomat e të zonjës së shtëpisë. Në dhomën e tij të gjumit Svidrigajllovi hapi një derë, të mbyllur me kyç dhe i tregoi Dunjës një dhomë bosh. Dunjeçka qëndroi në prag pa e kuptuar përse e ftonin ta shihte, por Svidrigajllovi nuk vonoi t'ia shpjegonte:

- E shihni këtë dhomën këtu, që është e mbyllur me çelës? - i tha. - Po atë karrigen aty e shihni? Është e vetme në këto dhoma. E kam sjellë unë nga dhomat e mia, e bëra që të dëgjoja ulur. Tryezës së Sonja Semionovnës i bie të ndodhet pikërisht pas kësaj dere. Vajza qe ulur aty dhe bisedonte me Rodion Romanoviçin, ndërsa unë qesh ulur në këtë karrige dhe dëgjoja. Dy orë rresht vazhdoi biseda e tyre dhe po aq qëndrimi im këtu. I dëgjova të gjitha dhe e mora vesh ç'thanë...

- Paskeni përgjuar, domethënë?

- Po. Kthehemi tani në dhomat e mia, këtu nuk ke as ku rri.

U kthyen në dhomën e pritjes. Svidrigajllovi e ftoi vajzën të ulej. Vetë qëndroi në cepin më të largët të dhomës, por sytë i shkëndijonin të njëjtën flakë e kjo kishte kohë që po e trëmbte vajzën. Ndonëse bënte përpjekje titanike për ta ruajtur gjakftohtësinë, s'e mposhtte dot rrëqethjen dhe përsëri i hodhi një sy dyshues dhomës. Ky veçim dhe kjo vetmi e vunë në merak. Donte ta pyeste të paktën në ishte aty zonja e shtëpisë, por krenaria dhe miresjellja nuk po ia lejonin ta bënte. Shqetësimi s'vonoi të shndërrohej në ankth, por edhe kureshtja për të marrë vesh ç'dinte ky njeri po e brente keqaz.

- Ja letra juaj, - foli vajza dhe e vuri mbi tryezë. - A është e mundur kjo që më shkruani? Më lini të kuptoj që im vëlla paska kryer një krim. S'keni pse dredhoni, duket qartë në letër. Se unë edhe para këtij zbulimit tuaj diç kam dëgjuar të flitet, por është aq absurde!... As që i besoj fare të thënave! I kam krejt të qarta synimet e atij që i përhap. Nuk keni as dhe një provë bindëse! Hë, flisni pra? Veç që më parë ju them se nuk ju besoj...

Dunjeçkës i qe tronditur siguria dhe faqet iu skuqën nga emocioni.

- Në dyshokeni aq shumë, si pranuat të vinit vetëm tek unë? Mos e bëtë nisur vetëm nga kureshtja?

- Mos më torturoni... flisni, de, flisni!

- Nuk ju dija aq të guximshme! Thashë me vete se do t'i luteshit zotit Razumihin t'ju shoqëronte, por u binda që nuk ka ardhur dhe as që së largu nuk ju ndoqi. Ju dhimbset Rodion Romanoviçi? Ju jeni e shenjtë, vetëm për të tjerët mendoni... Po ç't'ju trgoj për vëllanë? Ju më mirë se kushdo tjetër e njihni. Vetë po e shihni!...

- Ju në opinionin që keni krijuar për të e mbështesni akuzën?

- Jo, jo në opinion, por fjalët që dëgjova të dalin nga goja e vetë Rodion Romanoviçit. Dy mbrëmje e jo më pak i ka kaluar këtu me Sonja Semionovnën. Jua tregova ku qenë ulur. Iu rrëfye vajzës. Është vrasës. Ka çuar në atë botë një fajdexheshë plakë, tek e cila kishte lënë sende peng. Disa minuta më pas, motra e viktimës, një shitëse ambulante e quajtur Elizaveta, hyri rastësisht dhe ai e vrau edhe atë. I vrau me një sëpatë që kishte marrë me vete. E bëri për të vjedhur dhe vodhi, mori edhe para, edhe arturina. Ja, këtë i tregoi Sonja Semionovnës. Është e vetmja që e di, por me krimin nuk ka lidhje. Përkundrazi, kur dëgjonte ç'kishte ndodhur, dukej po aq e trëmbur

sa dhe ju tani. Qetësohuni, nuk kam në mendje të vete të kallzoj.

- E pamundur! Është e pamundur! - bëlbëzonin buzët e mavijosura të Dunjeçkës. - Kjo është e pamundur! S'kishte pse e bënte këtë krim, nuk kishte asnjë arsye!... Gënjeshtër është, fund e krye gënjeshtër!

- Vjedhja e motivon vrasjen. Ka rrëmbyer arturina, para. Vërtet nuk i ka përdorur, por i ka fshehur nën një gur; aty gjenden ende. Nuk guxoi t'i përdorë.

- Po kjo ç'të jetë? Si është e mundur që të ketë patur mendime të tilla në kokë? - thirri vajza dhe u ngrit vrullshëm. - Ja, ju e njihni, e keni parë, si, ngjan me hajdutët ai?

Ishte duke ju lutur Svidrigajllovit, e kishte harruar frikën që pati ndjerë pak më parë.

- Janë ca të koklavitura punët, Avdotia Romanovna. Një hajdut vete e vjedh, e di që është i poshtër dhe po bën poshtërsi. Kurse unë kam dëgjuar për një njeri fisnik që shkoi e theu drynin e portës së dikujt, dhe me vete thoshte se kishte bërë diçka fisnike! Siç nuk e besuat ju, as unë nuk kisha për ta besuar, po të më kishte thënë kush, por ja që e dëgjova me veshët e mi... Sonja Semionovnës i bëri të ditur edhe arsyen që e shtyu ta bënte. As ajo në fillim nuk po u besonte veshëve, por s'kaloi shumë dhe u bind që kishte qenë e vërtetë. Me gojën e vet e pranoi!

- E për ç'arsye... ta ketë bërë?

- Është histori e gjatë kjo, Avdotia Romanovna. Si t'ju them, përzihet në këtë mes edhe një si teori: keqbërjen ndaj një individi e pranon, po qe se qëllimi është i mirë. E keqja është një, punët e mira janë njëqind! Se fyese e poshtëruese është për një djalosh si ai, me dinjitet e sedër të pazakontë, të verë re që karriera dhe ardhmëria do të kishin qënë tjetërsoj po të kishte patur në xhep nja tremijë rubla, ndërsa ai ato s'i ka. Shto këtu edhe ngacmimet nga uria, nga dhoma musëndër, nga gjendja shoqërore e nëpërkëmbur, pa zënë ngoje mënyrën se si rrojnë motra e nëna. Por mbi tërë këto lartësohet krenaria dhe sqima, të cilat edhe në prireshin për nga e mira, prapë se prapë... Nuk e bëj me faj, as mos e shkoni në mendje, nuk është puna ime. Pastaj kam dëgjuar të flitet edhe për një si teori, sipas së cilës ligjet nuk veprokan me forcë të barabartë për të gjithë, paska disa të veçantë, që ua diktokan të tjerëve ligjet. S'ke ç'thua, *une thèorie*

comme une autre[1]. Ia paska marrë mendjen Napoleoni, ideja se gjenialitetet e paskan shpërfillur të keqen unikale, paskan çarë përpara pa e vënë re atë. Me sa duket, veten e mban për gjenial, sidoqoftë, për një kohë ia ka pas ushqyer vetes këtë mendim. E ka torturuar, por po vazhdon ta mundojë edhe sot e kësaj dite fakti që idenë paska ditur ta formulojë, por për ta vënë në jetë s'ka mundur e s'po mundet dot. Pra del që nuk qënka njeri gjenial. Kuptohet sa poshtëruese që është kjo për një krenar dhe sqimatar, e sidomos në këtë shekullin tonë!...

- Po vrasja e ndërgjegjes? Me ç'po shoh, ju ia mohoni krejtësisht ekzistencën e normave morale këtij njeriu? Pse pa to është ai?

- Gjithçka iu turbullua dhe iu errësua, Avdotia Romanovna. Veç mund të thuash se edhe më parë nuk duhet të ketë qenë qelibar në këtë drejtim. Se te ne në Rusi njerëzit në përgjithësi janë të gjerë, ashtu si toka që banojnë; janë ca si shumë të dhënë pas fantazisë, iu pëlqejnë çrregullimet, por është fatkeqësi të jesh i gjerë, pa qenë gjenial aq sa duhet. Ju kujtohet sa shumë i kemi pas rrahur këto probleme mbrëmjeve në tarracë pas darke? Ju për këtë gjerësi dhe më keni qortuar. Ku i dihet, ndoshta i kemi thënë këto njëkohësisht me të, kur ai rrinte shtrirë në kanapenë e tij. Në shoqërinë tonë të njerëzve të shkolluar s'para gjen amanete të shenjta, Avdotia Romanovna. Njëri i gjen në libra, një tjetër i nxjerr nga shkrimet e vjetra, veç shprehen në formë sentencash, duken si skufjet që s'i kanë farë hije njeriut të shoqërisë së lartë. Po mjaft llafet, mendimet e mia për këtë problem ju i dini tanimë, unë kërrkënd nuk akuzoj. Bëj jetë parazitare dhe asaj do t'i qëndroj deri në fund besnik. E kemi thënë dhe stërthënë këtë! Madje kam patur lumturinë t'u interesoj dhe juve me këto gjykime të miat... Po ç'keni kështu, jeni dyllë në fytyrë, Avdotia Romanovna.

- Jam në dijeni të teorisë së tij. Ia lexova shkrimin që paska botuar në një revistë, për njerëzit të cilëve u lejokërka gjithçka... Ma dha Razumihini.

- Aha, zoti Razumihin? Shoku i vëllait tuaj? Pse paska botuar një të tillë shkrimi domethënë? S'e kam ditur. Jam kureshtar ta lexoj! Po ku jeni duke shkuar, Avdotia Romanovna.

---

[1]) *Teori si të gjitha të tjerat (fr.).*

- Më duhet të shihem me Sonja Semionovnën... - iu përgjigj kjo me zë të shuar. - Ndoshta është kthyer. Më duhet të bisedoj me të sa më parë, më mirë... Le të...

Avdotia Romanovnës i mbeti fjala në grykë, s'po mbushej dot me frymë.

- Sonja Semionovna nuk ka për t'u kthyer deri në mbrëmje vonë. Se duhet të kishte ardhur: meqë nuk erdhi, vjen shumë vonë.

- Po më gënjeni! E shoh që po më gënjeni!... Dhe tërë ato që thatë gënjeshtra janë... Nuk i besoj as edhe një fjalës suaj... As edhe një! - thirri Dunjeçka e leberitur e duke e humbur kontrollin mbi veten. U lëshua fuqiprerë në karrigen që i afroi në çast Svidrigajllovi.

- Avdotia Romanovna, ç'është kjo kështu? Ejani në vete! Pini pak ujë...

I hodhi disa spërkla në fytyre. Dunjeçka u drodh dhe erdhi në vete.

- E patët nga tronditja e madhe, - nëpërdhëmbi Svidrigajllovi i vrenjtur. - Avdotia Romanovna, po qetësohuni, ju lutem! Mos harroni që vëllai juaj është i rrethuar nga miq, do ta shpëtojmë. Po të doni, e nisim jashtë shtetit. Para unë kam, brenda tri ditëve i sigurojmë një biletë. Sa për krimin e kryer, do ta shlyejë me mijëra punë të mira që ka për të bërë. Qetësohuni, de! Po mund të bëhet njeri i madh. Si jeni tani?

- Njeri më i keq se ju s'gjendet! Tërë kohën jeni duke u tallur. Lermëni ju thashë...

- Po ku jeni duke shkuar? Ç'bëni kështu?

- Tek ai. Ku është? E dini ku gjendet? Po derën pse e paskeni mbyllur me kyç? Ç'është kjo? Ku e keni kyçin?

- E mbylla se nuk duhej të dëgjohej jashtë ajo që po thoshim. Unë nuk po tallem. Po pse a mund të dilet jashtë në këtë gjendjen tuaj? Mos keni bërë mendje ta merrni në qafë? E dini që janë duke e ndjekur dhe tanimë kanë rënë në gjurmë? Do prishni punë me këtë që doni të bëni! Ishim bashkë, tani sapo fola me të, ka shpresa për ta shpëtuar... Uluni, mos i merrni me rrëmbim punët, duhet menduar mirë çdo gjë. Ndaj dhe ju solla këtu, që ta pleqëronim kokë më kokë çështjen, ta kthejmë mbarë e prapë. Uluni de, uluni!

- Po si ta shpëtojmë? A është e mundur, vallë?

Dunja u ul. Svidrigajllovi iu ul pranë.

- Jeni ju ajo që e keni në dorë shpëtimin e vëllait! Vetëm ju! - i t. me mërmërimë, duke e parë me sytë e përshkënditur dhe duke mos mundur t'i shkoqiste si duhet fjalët nga emocionet e fuqishme.

Dunja, kur e pa në atë gjendje, u zmbraps e tmerruar. Svidrigajllovi dridhej dhe nuk dinte ç'të bënte.

- Një fjalë... vetëm një fjalë juaja... dhe çdo gjë rregullohet! Mundem ta shpëtoj: kam para dhe miq... E nis që tani, edhe për vete gjej pasaportë... edhe për ju gjej... Gati janë të ma bëjnë... Ç'ju duhet, vallë, ai Razumihini? Edhe unë ju dashuroj... më shumë se çdo gjë në botë!... Më lejoni makar t'ju puth vetëm çipin e fustanit, ma bëni këtë nder... Më urdhëroni ç't'ju dojë e bardha e zemrës, ja ku më keni, gati jam të bëhem baltë e të më shkelë këmba juaj! Besimi juaj do të jetë dhe imi! Mos më shihni ashtu... S'mund ta duroj atë shikim.

Dukej që nuk ishte në të, as vetë nuk dinte ç'po thoshte. Dunja u sul drejt derës.

- Hapeni! Hapeni! - thirri, duke kërkuar ndihmën e dikujt dhe duke u përpjekur diç të bënte me duar. - Ndihmë! Hapeni! S'paska njeri këtu?

Svidrigajllovi u çua dhe iu afrua me një buzagaz të kthtë, të ligë në buzët që i dridheshin.

- Nuk ka asnjë njeri në shtëpi, - i pëshpëriti me zë të dridhur e të mekët. - Kot e keni që bërtisni, veten tuaj e mundoni dhe e drobitni.

- Po kyçin, kyçin ku e keni? Hapeni derën, o i poshtër!

- Nuk e di ku e kam vënë.

- Dashkeni të më dhunoni, hë? - ulëriti Dunja e verdhë si kufomë dhe u tërhoq për nga qoshku më i largët i dhomës. Rrëmbeu karrigen, që ishte më pranë, e nxori para vetes për t'u mbrojtur. Nuk thirri për ndihmë, por vetëm ia nguli sytë e lebetitur dhe zuri të ndiqte çdo lëvizje të tij. Svidrigajllovi ngriu ashtu siç ishte në qoshen tjetër të dhomës. Kishte mundur ta merrte në dorë veten, së paku ashtu dukej, por në fytyrën pa jetë i qe vulosur grahma e vdekjes, buzagazi i kthtë dhe shprehja e ligësisë i kishin ngrirë në fytyrë.

- Thatë: "Dashkeni të më dhunoni?" E pra, në qoftë kështu, s'do mend që i kam marrë të gjitha masat: Sonja Semionovna ka shkuar për ca punë, Kapernaumovët e kanë apartamentin pas pesë dhomash

të mbyllura me kyç, jam dy herë më i fortë fizikisht se ju... Pastaj nuk keni si t'ia doni të keqen vëllait! Kush ta dëgjojë, nuk ka për t'ju besuar, e ç'i duhej një vashe të shkonte fillikat në dhomën e një beqari?... Ngado që ta kthesh, dilni e humbur, dhunimin nuk keni si ta vërtetoni.

- I poshtër! - nëpërdhëmbi Dunja e çakërryer.

- Ju keni mendjen tuaj, kjo që ju thashë, është një hamendja ime. Kurse bindja e vërtetë është që kemi të bëjmë me një dhunim!... Është poshtërsi! Them se asnjë njollë nuk do ju mbeste në ndërgjegje po ta bënit për të shpëtuar vëllanë... Iu nënshtruat rrethanave dhe kaq! Thirrini mirë mendjes: keni në duart tuaja fatin e vëllait dhe të nënës. Kurse mua do më keni skllavin tuaj të bindur në jetë të jetëve... Si thoni? Po ju pres!...

Svidrigajllovi u ul në divan nja tetë hapa larg Dunjës. Kjo e kuptoi që ishte krejt i vendosur: ia njihte mirë kokën.

Befas, me një lëvizje të shpejtë, nxori nga xhepi revolverin, ia hoqi siguresën dhe e mbështeti dorën, në të cilën mbante armën, mbi tryezë. Svidrigajllovi brofi.

- Aha! Kështu, hë? - thirri i pataksur dhe u ngërdhesh dashakeq. - Do flasim ndryshe, domethënë... Ma lehtësuat manovrën, Avdotia Romanovna. E ku e paskeni marrë atë armë? Mos ua ka dhënë zoti Razumihin? Ou! Po ai është revolveri im! S'lash vend pa e kërkuar atëherë... Ato mësimet e qitjes, që kam pasur nderin t'u jepja, ja ku po ju hyjnë në punë...

- Nuk është yti, është i Marta Petrovnës, mor vrasës! Se ti asgjë nuk ke patur tënden në atë shtëpi! E mora, kur u binda që deri në ç'poshtërsi je i zoti të shkosh. Në m'u afrosh qoftë edhe një hap, do qëlloj!

Dunja kishte pamjen e një të fandaksure. Pistoletën e kishte gati për zjarr.

- Po vëllait si do t'i vejë filli? Ju pyes kështu, nga kërshëria! - i foli me mllef, por pa luajtur nga vendi Svidrigajllovi.

- Guxo ta spiunosh, në ta mbajti! Mos lëviz, të thashë! Mos m'u afro! Do të vras! E meriton, vrasës je, ti e helmove tët shoqe!...

- Jeni e sigurt që e paskam helmuar Marta Petrovnën?

- Jam! Ma ke thënë me gojën tënde! Vetë ti më ke treguar për helmin... vetë ke shkuar ta merrje... Kjo kështu është... I poshtër je!

- Dhe në qoftë ashtu si thua, për ty e bëra... Ti je shkaktarja!

- Gënjen!... Unë gjithmonë të kam urryer... gjithmonë!

- Ah! Avdotia Romanovna! Po si kështu, e paskeni harruar si më afroheshit e më përgjëroheshit në ato çaste bisedash e debatesh të flakta? Në sytë tuaj i lexoja që të gjitha... Ju kujtohet nata me hënë, kënga e bilbilit...

- Gënjen! (Në sytë e Dunjës shkrepëtinë xixa tërbimi). Gënjen! Shpifje janë këto që thoni!...

- Po gënjej, hë? Po ta zëmë se është kështu. Ta zëmë se gënjekam... E di, grave s'është mirë t'u kujtohen ca të tilla minuta. (Shtrëmbëroi buzët si duke qeshur). E di që paske bërë mendje të vrasësh një goxha përbindësh, vrite!

Dunja ngriti ngadalë pistoletën dhe mehit në fytyrë, me buzët e zbehta e drithmëtare, me sytë e shqyer e të përflakur qëndroi para tij, duke pritur e matur mirë çdo lëvizje që ky mund të bënte. Svidrigajllovi kurrë nuk e kishte parë aq të mrekullueshme! Zjarri që i buiste nga sytë, po e përzhiste, zemra po i dhimbte dhe po i rënkonte. Bëri një hap përpara, u dëgjua një e shtënë. Plumbi i fshiku flokët dhe bëri rikoshetë në mur. Ndali dhe qeshi pa u ndier.

- Më pickoi një grerëz... Mu në lule të ballit ma mbajte... Po ky ç'qënka? Gjak? - Nxorri shaminë dhe e fshiu. Plumbi vetëm sa ia kishte përqethur paksa ballin. Dunja uli dorën me revolverin pa ia ndarë shikimin. Nuk dukej e trëmbur, ishte më tepër e hutuar. As vetë s'kishte mundur ta kuptonte ç'kishte ndodhur.

- Nuk qëlluat në shenjë! Provojeni përsëri... - i tha Svidrigajllovi me zë të shuar, duke vazhduar të zgërdheshej i vrenjtur. - Po ama mundem edhe t'ju çarmatos pa arritur dot të qëlloni për herë të dytë!

Dunjeçka u drodh nga këto fjalë, ngriti përsëri revolen, u bë gati të hiqte këmbëzën dhe e paralajmëroi:

- Mos guxoni të më afroheni! Do ju qëlloj... do t'ju vras!

- Domosdo, në largësinë e tre hapave s'ke si të mos e vrasësh tjetrin... Veç, në mos më vrafshi dot... - sytë i lëshuan flakë, bëri dhe një hap tjetër drejt saj.

Dunjeçka e hoqi këmbëzën, por kësaj radhe nuk i shkrepi.

- Nuk e paskeni mbushur si duhet! Veç, e shoh, keni ende fishekë. Pse nuk qëlloni, po ju pres.

I qe afruar fare, e shihte me një vendosmëri prej marroku. Vajza e kuptoi që ky më mirë pranonte të vdiste, sesa ta linte të largohej. "Në qëllofsha, s'do mend që kam për ta lënë shakull në vend" - tha me vete.

E flaku tej revolen.

- E hodhe! - Bëlbëzoi si i shkalur Svidrigajllovi duke u mbushur me frymë. Sikur ia hoqën me dorë makthin që i rëndonte në zemër, nuk ishte thjesht barra e rëndë e paravdekjes, ishte diçka tjetër edhe më pikëllimndjellëse ajo që ia kishte ndrydhur keq zemrën, tani s'kishte si e përcaktonte me saktësi.

Iu afrua Dunjës dhe i hodhi dorën në bel. Kjo s'e kundërshtoi, por po dridhej si gjethi në erë dhe e shihte me përgjërim. Ai bëri t'i thoshte diçka, por nuk mundi dhe vetëm sa iu shtrëmbëruan buzët. S'mundi të nxjerrë as dhe një fjalë.

- Lermë të iki, - i tha Dunja me lutje në zë.

Svidrigajllovi u drodh, i qe drejtuar me "ti" si dikur.

- Domethënë, nuk më dashke? - e pyeti me zë të ulët.

Dunja pohoi me tundjen e kokës.

- Dhe... nuk mundesh?... Kurrë nuk do më duash? - i pështëriti me një trishtim të papërshkrueshëm.

- Kurrë! - iu përgjigj Dunja.

Minuta që pasoi ishte një minutë e tmerrshme, në shpirtin e Svidrigajllovit po zhvillohej një luftë motivesh për jetë a vdekje. E hoqi ngadalë dorën, ktheu krahët dhe eci drejt dritares me hap të shpejtë. Kaluan kështu dhe disa çaste.

- Ja kyçi! (E nxorri nga xhepi i djathtë i xhaketës dhe e la mbi tryezë, prapa vetes, pa e parë në fytyrë vajzën.) - Merreni dhe largohuni!

Vazhdoi të qëndronte me shpinë dhe të shihte vetëm në dritare.

Dunja iu afrua tryezës, e mori çelësin.

- Largohuni! Ikni! - përsëriti Svidrigajllovi, duke parë vetëm në dritare. Në këto gulçima u dëgjua një rënkim vuajtjeje të tmerrshme.

Dunja e kuptoi domethënien. Rrëmbeu çelësin dhe vrapoi për nga dera, e hapi me duart që i dridheshin dhe doli rrëmbimthi nga dhoma. S'kaloi as minuta dhe, ashtu pa mend siç ishte, u gjend në buzë të kanalit, me vrap shkoi drejt urës.

Svidrigajllovi qëndroi te dritarja edhe nja tri minuta, pastaj u kthye ngadalë, hodhi sytë rreth e rrotull dhe kaloi ngadalë pëllëmbën nëpër ball. Një buzagaz i çuditshëm ia shprishi fytyrën, ishte një buzagaz i dobët, i trishtë, i pikëllimtë, i cili fliste më së miri për gjendjen pa rrugëdalje në të cilën ndodhej. Gjaku i mpiksur, por ende i pa tharë, ia fëlliqi dorën, e pa me inat, pastaj lagu peshqirin dhe fshiu mirë e mirë ballin. Sytë i shkuan te revolveri që kishte flakur Dunja. E ngriti, e ktheu dhe e përkëdheli në dorë. Ishte një revolver i vogël xhepi, me tri mbushje, kishin mbetur pa u shkrehur edhe dy. Mund të përdorej. Qëndroi një hop i menduar, e futi në xhep, mori kapelen dhe doli.

VI

Atë mbrëmje deri në orën dhjetë e kaloi nëpër pijetore e taverna. Gjeti diku Katjen, që i këndoi këngën e lakenjve, ku thuhej se një i poshtër dhe despot e kishte puthur Katjen me forcë.

Svidrigajllovi e dehu me verë edhe Katjen edhe djalin që i binte organetos, por edhe disa nëpunës e shkrues. Këta të fundit i kishte sajdisur vetëm ngaqë kishin qëlluar hundështrembër: njërit i shkonte hunda majtas, tjetrit djathtas. E morën dhe e çuan në një lulishte që vetëm emrin e kishte të tillë; qenë disa gëmusha dhe në mes një bredh hollak tre vjeçar, aty ishte një pijetore ku mund të porosisje çaj, kishte disa karrige e tryeza jeshile. Klientët i argëtonte një këngëtar i ardhur nga Mynihu, një derdimen hundëkuq. Nuk u mor vesh arsyeja përse shkruesit u ngatërruan me ca shkrues të tjerë dhe plasi sherri. Svidrigajllovin e caktuan arbitër. U mundua t'i ulte gjakrat, por nuk mundi, bëri ç'bëri dhe e pagoi çmimin e plaçkës së humbur, që doli se ishte shkaku i kacafytjes. Ora po shkonte dhjetë. Vetë nuk vuri verë në gojë, kishte porositur vetëm një gotë çaj. Ishte një mbrëmje e zymtë, me vrenjtësira dhe zagushi. Moti erdh e u keqësua, u dëgjuan bubullima, nisi një shi i dendur, si litarë. I lagur i bërë qull, mezi mbërriti deri në dhomë, u mbyll me kyç, hapi sirtarin, nxorri paratë, grisi disa letra dhe tha të zhvishte rrobat e lagura, por pa në dritare, vuri re që shiu vazhdonte të binte si me shtëmba, ndërroi mendje dhe doli ashtu i lagur siç ishte. Trokiti te Sonja, e gjeti të rrethuar nga të katër

camërdhokët e Kapernaumovit. Sonja u kishte nxjerrë çaj. Svidrigajllovin e priti heshturazi, por e pa me respekt e habi që ishte ashtu qull pa e pyetur për arsyen. Fëmijët, kur e panë të hynte, ia therën vrapit mjaft të frikësuar.

Svidrigajllovi zuri vend në tryezë dhe e ftoi edhe Sonjën t'i ulej pranë. Kjo u bind e druajtur pa nxjerrë as dhe një fjalë.

- Ka të ngjarë të nisem për në Amerikë, - nisi t'i thotë. - Ndoshta është hera e fundit që shihemi, ndaj dua t'ju lë një porosi. E takuat atë zonjën? E di ç'ju ka thënë, mos ma tregoni. (Sonja bëri një lëvizje të papërcaktuar dhe u skuq.) Kështu e kanë ato... Sa për motrat e vëllanë mos u bëni merak, janë të siguruar, kam paguar, çdo gjë e kam bërë me dokument. Do bënit mirë ta ruanit kopjen, s'i dihet si venë punët. Kurse këto merrini, do t'ju duhen. Ja dhe tre kambjale trepërqindëshe nga njëmijë rubla secili, gjithësej tremijë. Tani t'i japim fjalën njëri-tjetrit që, përveç nesh, të mos e dijë kush tjetër, edhe në dëgjofshi gjëkafshë për mua. Do ju duhen, se të rroni siç keni rrojtur deri më tani, Sonja Semionovna, nuk është mirë.

- Po tregoheni aq i mëshirshëm! Për jetimët u kujdesët si prind, për të ndierën po... - tha me ngut Sonja. - Nëse nuk ju kam falënderuar sa duhet e si duhet, mos e merrni për...

- O, lërini këto...

- Kurse këto para, Arkadi Ivanoviç, nuk më duhen, ju faleminderit për bujarinë.... Do bëj si do bëj.... Ju faleminderit!

- E kam prerë mendjen, këto para janë për ju, e mbyllim këtë muhabet, nuk kam kohë... Do t'ju duhen. Se Rodion Romanoviçi dy rrugë ka: ose t'ia heqë vetes, ose të përfundojë në galerë. (Sonja e pa e vrejtur dhe u rrëqeth.) Mos kini keq, jam në dijeni të punëve, ma ka treguar çdo gjë me gojën e tij. Po ju mos u merakosni, nuk jam nga ata që llapin, nuk kam për t'i treguar kujt. Mirë e mësuat atëherë, ta pranonte me gojën e vet. Do t'i voliste diçka e tillë. E pret Vladimirku, ju po pas tij. Kështu apo jo? Ju duhen këto para, për të ju duhen. Kur jua jap juve, është njëlloj si t'ia jepja atij. Pastaj mos harroni që i keni dhënë fjalën Amalia Ivanovnës se do t'ia shlyeni borxhin, e përse ia ngarkoni vetes tërë këto detyrime! As që e keni menduar si do t'ia dilni mbanë. Për atë detyrim ju s'keni asnjë punë. Në ju pyetshin për mua nesër o pasnesër (dhe domosdo që kanë për t'ju pyetur), mos

tregoni për takimin tonë, për të hollat. Mirupafshim, pra. (U ngrit të dilte.) Rodion Romanoviçit bëjini të falura. Paratë bënit mirë t'i mbanit përkohësisht te Razumihini. E njihni? S'është i keq... Çojani nesër... ose kur të jetë koha e duhur... Deri atëherë i fshihni mirë...

Edhe Sonja ishte ngritur dhe po e shihte me frikë. Diç donte t'i thoshte, për diçka donte ta pyeste, por as po guxonte dhe as po dinte si t'ia niste.

- Po si... si po dilni në këtë kiamet?

- Të marrësh rrugën për në Amerikë dhe të kesh frikë nga shiu, s'para shkon, apo jo? He! He! Lamtumirë, moj xhankë! Paçi jetë të gjatë, ju duheni të tjerëve. Hë, zotit Razumihin i bëni të falura nga unë...

Doli, duke e lënë Sonjën krejt të shastisur, të trëmbur dhe të habitur, me një dyshim të madh në zemër.

Më pas u mor vesh se po atë natë, rreth orës dymbëdhjetë, Svidrigajllovi kishte bërë edhe një vizitë tjetër të çuditshme, ndonëse shiu vazhdonte të binte si me vedra. Kishte qenë te prindët e nuses në Ishullin Vasilevsk. Mezi ia kishin hapur derën, kur e panë, ishin pataksur nga habia. Po ta donte puna, Arkadi Ivanoviçi dinte të paraqitej në një mënyrë sa më të këndshme, ndaj dhe pandehma e parë, afërmendsh e prindërve të nuses se mos kishte hedhur ndoca gota të tepërta, u zhduk si vesa para diellit. Sollën aty edhe prindin paralitik; mamaja e dhimbsur dhe namuzlije e nuses s'duroi dot pa i bërë disa pyetje. (Kurrë nuk i bënte pyetjet drejt për drejt, në fillim vinte në punë buzëqeshjet dhe fërkimin e duarve, pastaj, kur i vinte radha çastit për të pyetur, të themi, për ditën e dasmës, e hidhte fjalën te Parisi dhe jeta mondane, më pas kalonte në tregimin për zakonet e ishullit Vasilevsk). Në një kohë tjetër kjo krahëmarrje do dëgjohej me respekt, por këtë herë Arkadi Ivanoviçi u tregua si tepër i padurueshëm dhe ia preu shkurt: donte të shihej me nusen edhe pse e kishin paralajmëruar, kur kishte shkelur në derë, që kishte rënë të flinte. Kuptohet, nusen ia sollën. Arkadi Ivanoviçi i tha se për një kohë ia donte puna të largohej nga Petërburgu, i solli pesëmbëdhjetë mijë rubla argjend dhe kambiale, i lutet t'ia pranojë si dhuratë, kishte kohë që kishte bërë mendje t'ia jepte para martesës. Ndonjë lidhje logjike ndërmjet dhuratës dhe largimit të beftë, kuptohet, që nuk kishte, siç

s'kishe si përligjje këtë ardhje në orë aq të vontë, në këtë mot me shi, por çdo gjë shkoi si në vaj. Madje edhe ofshamat e psherëtimat, pyetjet e rastit dhe meraket sesi u tkurrën e u mpakën, ndërkohë që falënderimet dhe mirënjohja u shprehën bujshëm dhe u përforcuan edhe me lotët që u dukën në sytë e mamasë së dhimsur. Arkadi Ivanoviç u ngrit, puthi nusen, pastaj ia ledhatoi faqkën, i dha fjalën se do kthehej sa më parë dhe, kur vuri re në ata sy fëmijëror një kërshëri dhe pyetje memece, u mendua pak, e puthi edhe njëherë dhe e sëmboi mu në zemër mendimi që kjo dhuratë do të mbyllej sakaq me kyç në sëndukun e nënës së djegur. Doli duke i lënë që të gjithë tejet të prekur, por edhe po aq të habitur. Ndërkohë mamaka me një pëshpërimë të nxituar e davariti ndonjë moskuptim të rastit, theksoi se Arkadi Ivanoviçi ishte njeri i madh, që merrej me punë të mëdha, që vetëm një Zot e di ç'i gëlon në mendje: ja dhe tani, i shkrepi në kokë dhe erdhi, ua dhuroi ato para, pra s'kishin pse habiteshin. Që u erdhi në atë farë rrebeshi i lagur e i bërë qull, kjo s'qe diçka e mirë, ama anglezët, të cilët shquhen për kësi befasish marramendëse, as që e çajnë kokën se ç'do të thonë të tjerët. Ku i dihej, ndoshta donte t'ua bënte të ditur që s'ia bën bef syri nga asgjë... Kryesore, theksoi, është të mos i hapemi kujt, paratë t'i mblojmë në vend të sigurt, me kyç, shyqyr që Fedosja nuk pa gjë, ishte në kuzhinë në atë çast, dhe edhe më kryesore është të bëjmë kujdes që të mos i vejë në vesh asaj Reslih, se telendare që s'e ka shoqen është. Kuvenduan kështu të mbledhur kokë më kokë deri në ora dy pas mesnate. Nusja shkoi të flinte pa u ndier, dukej që ishte e trishtuar.

Në këtë kohë Svidrigajllovi ishte duke kaluar urën që të çonte në qëndër të qytetit. Shiu kishte pushuar, por të priste murlani. Të ftohtët i kishte hyrë në palcë. Ndali te parmakët dhe pa me kërshëri ujrat e zinj të Nevës së Vogël. Pastaj doli në rrugën kryesore dhe eci me hap të shpejtë si ndonja gjysmë ore. Në fund të rrugës i doli përpara hoteli, të cilit ia kishte vënë syrin kur kishte kaluar pak më parë. Ishte një godinë prej druri dhe, me sa i kujtohej, quhej "Adrianopojë". Edhe në këtë orë të vontë kishte dritë dhe gjallëri. Hyri dhe i pranoi të zinte dhomën e vetme që kishte mbetur e pazënë, një dhomë në fund të korridorit, nën shkallë. Ishte fare e vogël dhe e ulët, pa ajër, por tjetër nuk kishte. Hotelieri qëndroi në pritje të përgjigjes.

- Po çaj keni? - e pyeti Svidrigajllovi.
- E bëjmë në çast.
- Tjetër ç'keni për të ngrënë?
- Kemi rosto viçi, kemi dhe vodkë.
- Sill një rosto dhe çaj.
- Tjetër gjë nuk doni? - e pyeti i habitur hotelieri.
- Jo, nuk dua!

Hotelieri u largua i zhgënjyer

"Nuk më duket i keq si vend... - tha me vete Svidrigajllovi. - Pamja që kam të kujton njeriun që është duke u kthyer nga ndonjë lokal nate dhe rrugës i ka ndodhur diçka. Jam kureshtar ta di ç'njerëz janë klientët që e kanë zënë?"

Ndezi qiririn dhe pa me kujdes dhomëzën. Ishte aq e ulët, saqë i cikte koka në tavan. Kishte një dritare, në mes ishte shtrati i qelbur, mënjanë ishte një tryezë e lyer me bojë vaji dhe karrigia, vend të lirë nuk kishte. Muret ruanin gjurmët e dërrasave nga të cilat ishin bërë, veshja ishte shqyer dhe rjepur, qe e mbuluar nga pluhuri dhe blanat. Njëra anë e murit dhe e tavanit ishte e prerë, siç ndodh në musëndrat, mbi të ishin shkallët. Svidrigajllovi e vuri qiririn në tryezë, u ul në krevat dhe u zhyt në mendime. Një pështërimë e çuditshme, që hera herës kalonte në britmë, ia tërhoqi vëmendjen. Vinte nga dhoma fqinje. Mbajti vesh: dikush dikë e qortonte me zë ankimtari, tjetri nuk ndihej. Svidrigajllovi u çua, pa kureshtar murin ndarës dhe sytë iu ndalën te një e çarë. Iu afrua dhe pa matanë. Në një dhomë pak më të madhe se kjo e tij rrinin dy njerëz: njëri ishte kaçurrels, fytyrëkuq, pa xhaketë, që qëndronte para tjetrit në pozën e oratorit dhe i binte gjoksit me grusht, duke qortuar tjetrin, një rjepacuk mjeran dhe që, sipas folësit, nuk kishte as titull e as emër, dhe nëse e mbante pranë, këtë e bënte nga zemërgjerësia. Tjetri rrinte ulur në karrige me kryet vajisur në kraharor, me pamjen e njeriut që do të teshtijë, por nuk mundet. Në të rrallë i ngrinte kryet dhe shihte me sy të turbullt si të dashit dhe dukej që s'po i binte dot në të asaj që po i thoshin. Bishtuku i qiririt digjej në tryezë, pranë tij qëndronte një garafë vodke bosh, dy gota, bukë dhe ca kastravecë turshi. Pasi i pa të gjitha këto, Svidrigajllovi u tërhoq pa u ndier dhe u ul përsëri në krevat.

U kthye hotelieri me roston dhe gotën e çajit, e pyeti edhe njëherë

në donte gjëkafsh tjetër, por, kur dëgjoi përgjigje mohuese, u largua. Svidrigajllovi e piu çajin me gllënjka të mëdha, që të ngrohej ndopak, kurse roston nuk e zuri me dorë. Po e zinin ethet. Hoqi pallton dhe xhaketën dhe u mbulua me jorgan. I vinte plasje që s'po e ndiente mirë veten. "Më duhej të isha mirë!" - tha me vete dhe u skërmit. Dhoma ishte e paajrosur, qiriri ndriçonte zbehtë, nga oborri hynte ulërima e erës, diku në një qoshe dëgjohej gërvima e miut, ndërsa dhoma kutërbonte era minj dhe era lëkurë. Rrinte shtrirë dhe mendimet palë-palë shtresëzoheshin njëri mbi tjetrin. U përpoq t'i ndalte në një çështje. "Kopshti duhet të jetë fare afër, - tha me vete. - Këta që fëshfërijnë drurë janë, më kall datën zhurma që bëjnë natën me erë, edhe errësira më shqetëson". Iu kujtua parku "Petrovski", pastaj buzëlumi i Nevës së Vogël, pamja e zezë e ujit, i shkuan mornica. "Uji kurrë nuk më ka pëlqyer, madje as në pejsazhe, - tha me vete dhe përsëri u skërmit. - Në rrethanat që ndodhem, as që duhej të çaja kokën për estetikën dhe komfortin, por ja që më shkrepëtijnë në mendje ca mendime si këta, të çuditshëm. Se edhe egërsira e zgjedh mirë vendin para se të prehet përgjithmonë... Po të isha kthyer në Petrovsk, do më mbyste fare errësira dhe të ftohtit! E pra, kam nevojë për ndjime të këndshme... Po qiririn pse nuk e shuaj? (I fryjti dhe e shoi.) "S'po ndihen më këta të dhomës fqinje... - tha, pasi pa edhe njëherë në të çarën e murit. - Hë, tani le të urdhërojë Marta Petrovna: errësira po errësirë, vendi po si me porosi, pale pastaj çasti që është aq i zgjedhur... E pra, nuk vjen..."

Iu kujtua që një orë para se të provonte ta shtinte në dorë Dunjeçkën, e kishte porositur Raskolnikovin t'ia linte Razumihinit të përkujdesej. "E thashë për të ngacmuar veten. Raskolnikovi e pikasi! Qerrata i madh është ky Raskolnikovi! Ç'nuk bluan brenda vetes ai njeri! Tani është i shqetësuar vetëm për një gjë: si të dalë pa u lagur nga katrahura që bëri, i dhimset ca si shumë lëkura; ama në shpëtoftë, qindin do t'u punojë të tjerëve... Janë të poshtër këta tipa... Po kokën ngrëntë, mua ç'më duhet".

Po e kapiste gjumi. Para syve i qëndronte Dunjeçka, të dridhura të forta ia përshkonin trupin. "E ç'më duhet? Mund të çohet mendja në diçka tjetër... Çudi dhe qesharake është, por ja që kurrë ndonjëherë në jetën time as kam urryer e as jam hakmarrë! As debatet nuk më

3rj0n1xx

kanë pëlqyer, nuk jam nxehur kurrë ndonjëherë, edhe kjo nuk është gjë e mirë. Sa shumë që i premtova Dunjës, do më kishte hequr për hunde, po të kishte pranuar, por nuk pranoi..." Heshti dhe shtrëngoi dhëmbët. Përsëri i doli para syve Dunjeçka, ashtu si në çastin kur hoqi këmbëzën dhe e qëlloi drejt në ballë. Kishte shtangur nga tmerri, fare lehtë mund t'i afrohej dhe ta përfshinte, s'kishte për t'u mbrojtur dot, por i qe dhimbsur në ato çaste, i kishte pikuar mu në zemër.... "Dreq o punë! Përsëri tek ajo më shkoi mendja! Mjaft më!"

Të dridhurat po i kalonin. Iu bë sikur diç po lëvrinte nën jorgan, i kaloi nëpër këmbë, nëpër krahë... U drodh nga lebetia. "Mos është mi? - mendoi. - Lashë mbi tryezë roston..." Nuk donte të zbulohej, të çohej, të mërdhihte, por ajo diçka përsëri lëvriu. E flaku tej jorganin, ndezi qiririn. Duke u dridhur nga të ftohtit, pa shtratin, s'kishte gjë: shkundi jorganin, mbi çarçaf ra miu. U hodh ta kapte, miu nuk kërceu nga shtrati, po i bënte dredha, i rrëshqiti nga gishtat, u fut nën jastëk; atë çast ndjeu që diç i kërceu në kraharor, i lëvriu nëpër këmishë, u rrëqeth e u lebetit sakaq u zgjua... Në dhomë ishte errësirë e plotë, rrinte shtrirë në krevat, i mbuluar dhe i puthitur me jorgan. Në dritare vazhdonte të ulërinte era. "Çfarë ndyrësie!?" - pëshpëriti.

U çua dhe u ul në një cep të shtratit me shpinë nga dritarja. "Më mirë të mos fle fare!?" - tha me vete. Nga dritarja frynte, i hynë të dridhurat. Pa luajtur nga vendi, u mbështoll mirë e mirë me jorgan, qiririn nuk e ndezi. Nuk kishte dëshirë të mendonte për gjë, por copëra mendimesh e kujtimesh s'e linin të qetë. E mundi një dremkë e lehtë. Kjo klimë dhe ky mjedis të ishin shkaktarët, por sidoqoftë u gjend i rrethuar nga lule, në një vend të mrekullueshëm, të ngrohtë, të këndshëm. Veten e pa në një vilë të tipit anglez, të rrethuar nga postate me lule të një bukurie të rrallë. Edhe muret anësore qenë të mbuluara nga liane të harlisura, nga trëndafila shumëngjyrësh. Shkallët plot dritë e freski qenë të shtruara me qilim të shtrenjtë, në parmakët kishte vazo kineze mahnitëse. I bënë përshtypje sidomos lulet e bardha të narcisit, që rriteshin në ca vazo të mëdha në parvazët e dritareve, i pëlqeu aroma dehëse që lëshonin. Nuk ia kishte ënda të largohej, ndaj ngjiti shkallët dhe u gjend në një sallë me tavan të lartë, ku gjithashtu kishte shumë lule. Dyshemeja qe e mbuluar me bar të njomë, dritaret ishin të hapura, ndërsa në mes të sallës, në disa tryeza

të mbuluara me sofrabeze prej atllasi të bardhë qëndronte një arkivol. Ishte i mbështjellë me tafta të bardhë, i zbukuruar me thekë e kordonë po të bardhë. Lule të çdo lloji e rrethonin nga të katër anët. Në të, po e mbuluar nga lule, rrinte shtrirë një vajzë e veshur me fustan të bardhë nusërie, me krahët e palosur nën kraharor që ngjanin si të skalitur në mermer. Flokët e derdhur mbi jastëk, të verdhë e të bukur, ishin të lagur. Një kurorë trëndafilash ia mbulonte ballin. Profili i ngrirë i fytyrës gjithashtu dukej si i skalitur në mermer; buzagazi, që i kishte ngrirë në fytyrë, ishte fare fëmijëror, aq i pikëlluar dhe ankimtar. Svidrigajllovi e njohu vashën. Nuk kishte as ikonë e as qirinj, nuk dëgjoheshin psalme e lutje: ishte e mbytur... Sapo i kishte nisur të katërmbëdhjetat, por zemrën e kishte të thyer e të copëtuar, kishte vënë dorë mbi veten, ngaqë e kishin fyer, e kishin përdhosur mosmëkeq atë zemër të brishtë e të pafajshme, ia kishin mbuluar me turp shpirtin engjëllor, pasi kishte mbetur pa u vënë re dhe i qe nëpërkëmbur ajo britmë e pafajshme makthi, atë natë të errët dhe me erë të lagësht...

Svidrigajllovi u përmend, u çua, iu afrua dritares. Gjeti me dorë rezenë dhe e hapi. Era u fut furishëm dhe ia fshikulloi fytyrën dhe gjoksin. Nën dritare, me sa dukej, kishte një lulishte dhe tryeza ka hahej e pihej. Tani era e fortë sillte deri aty piklat e shiut që ishin mbi drurët dhe mbi shkurret, në vendet ku qenë orenditë, dukeshin vetëm njolla të errëta. Svidrigajllovi u pështet me bërryla në parvazin e dritares dhe qëndroi ashtu nja pesë minuta. U dëgjua një e shtënë topi, pastaj një tjetër. "Lajmërojnë për rrezikun e përmbytjes, - tha me vete. - Në mëngjes do të jenë të përmbytur katet përdhese, minjtë do dalin nga bodrumet, njerëzit, të lagur e të drobitur, do t'i çojnë plaçkat në katet e sipërme... Sa do jetë ora vallë?" Një orë muri u dëgjua të binte tri herë. "Pas një ore fiks! S'kam ç'pres! Po shkoj drejt e në Petrovsk: do t'i vë syrin ndonjë gëmushe, sa më të madhe dhe sa më të lagur. "U largua nga dritarja, ndezi qiririn, veshi trikon, xhaketën, pallton, kapelen dhe doli me qiriun në dorë në korridor për të gjetur hotelierin që nuk dihej ku mund të ishte kumbisur. "Kjo është koha më e përshtatshme!" - tha me vete.

Eci nëpër korridorin e gjatë të errët, i doli përpara një vajzë pesë-vjeçare veshur me zhele që i kullonin ujë, që dridhej dhe qante. Nuk u trëmb, kur e pa, sytë e zinj i shprehnin vetëm habi. Pushoi së qari,

por gati ishte t'ia niste përsëri. Fytyrën e kishte të zbehtë, të munduar, të ftohtit i kishte hyrë në palcë. "Si u gjend këtu në këtë orë?... Del që tërë natën e natës të mos ketë mbyllur sy!" - mendoi Svidrigajllovi. Zuri ta pyeste, vajza mori zemër dhe i foli duke dënesur disa fjalë: nuk kthehej dot në shtëpi nga firka e mamasë, kishte thyer një gotë. Me sa dukej, e ëma ishte një nga këto të hotelit, vajzën nuk e donte. E tmerruar për vdekje, kjo ishte fshehur prapa dollapit dhe tani nuk po dinte nga t'ia mbante. E mori për dore, e çoi në dhomë, i zhveshi rrobat dhe e shtriu në krevat. Vajzën e zuri gjumit në çast. Ky përsëri u zhyt ne mendime. "Ja që ngeca! - tha me vete i rënduar nga një ndjenjë e keqe. - Dreq o punë!" Mori qiririn dhe doli për ta gjetur me çdo kusht hotelierin, t'i paguante hakun dhe të largohej. "Ah, moj vajzë!" - tha me vete qortueshëm, por para se të dilte, e pa edhe një herë në po flinte apo jo. Ngriti pak jorganin, faqet ia kishte mbuluar të kuqtë e çelur, blana-blana. "Qënka veremlije" - tha me vete. Ngjante me të kuqtë e njerëzve që u japin të kthejnë me fund një gotë të madhe me pije alkoolike. Buzët i kishte të thara, të plasura. Iu duk sikur po i dridheshin qerpikët e gjatë, të zinj dhe pas tyre ishin duke e parë një palë sy të zinj, pra vajza nuk po flinte, shtirej sikur flinte. Ja ku i lëvizi dhe buzët, duke formuar një buzagaz të lehtë, iu drodhën pak. S'kaloi minuta dhe vajza zuri të qeshë, diçka harbute, aspak fëmijërore spikati në atë të qeshur, i cili nuk ngjante fare me një të qeshur fëmije; shprehte diçka të keqe, tregonte zvetënim dhe prishje. Ishte fytyra e vajzës që shitet. I hapi të dy sytë që po e shihnin me zjarr dhe epsh të fshehur, po e thërrisnin, po i qeshnin... Kishte diçka krupëndjellëse dhe të lemeritshme në tërë këtë qënie mjerane. "Si kështu! Vajza pesëvjeçare! - belbëzoi Svidrigajllovi. - Ç'të jetë, vallë? Po kjo kështu?" Vajza u kthye nga ai me fytyrën që i digjej, zgjati drejt tij krahët që ta përqafonte... "O e mallkuar!" - thirri i tmerruar Svidrigajllovi, duke e çuar dorën mbi të... dhe atë çast u përmend.

Ishte shtrirë në shtrat, i mbuluar me jorgan, qiriri i shuar ishte në tryezë, në dritare kishte zbardhur drita.

"S'po më hiqen ëndrrat e këqia!" - bëlbëzoi. I dha përpjetë trupit, e flaku tej jorganin, ndjeu një kapitje të përgjithshme. Moti ishte me mjergull: ora ishte pesë e mëngjesit, e kishte mundur gjumi. Veshi xhaketën dhe pallton e lagur, gjeti me dorë revolen në xhep, e nxori

dhe e bëri gati, nxori edhe bllokun dhe diç shkroi në të me gërma të mëdha. E lexoi dhe qëndroi mbështetur në tryezë i menduar. Edhe revolen, edhe bllokun i vuri pranë e pranë te bërryli. Ca miza ishin ulur në ushqimin e pafilluar, i pa i vrenjtur dhe bëri ta kapë njërën. Kur e kuptoi ç'po bënte, u rrëqeth, brofi dhe doli nga dhoma. Pas një minute ishte në rrugë.

Qyteti ishte zhytur në mjergullën bojë qumështi. Svidrigajllovi mori drejtimin përpara për nga Neva e Vogël, përfytyroi ujrat e rrëmbyeshëm pas rrebeshit të mbrëmshëm, drurët dhe kaçubet e lagura, madje edhe atë gëmushën gjetheshumë... Donte ta largonte mendjen, ndaj zuri të kqyrte shtëpitë. S'i doli përpara asnjë kalimtar, asnjë pajton, vetëm shtëpi me grila të mbyllura. Lagështia dhe të ftohtit e mundonin shumë. Në fund të një ure u gjend para një shtëpie të madhe prej guri. Një qen i lagur, i zgërlaqur, me bisht ndër shalë, kaloi rrugën. Një i dehur ishte shtrirë në trotuar me fytyrën në asfalt. E pa dhe shkoi më tej. Mbi shtëpinë e gurtë i shkuan sytë te vendroja e lartë: "E pse duhet të shkoj te gëmusha gjetheshumë në lulishten "Petrovski", më mirë këtu, është edhe një dëshmitar zyrtar..." - tha me vete.

Para derës së mbyllur qëndronte një rojtar shkurtabiq, i mbështjellë me një kapotë ushtarake. Pa i përgjumur Svidrigajllovin që po i afrohej. Qënien ia përshkonte ai pikëllim ankimtar, i vulosur që kur s'mbahej mend në fytyrën e çdo çifuti. Rojes nuk iu duk aspak normale që një njeri jo i dehur qëndronte aty pranë, ia kishte qepur shikimin dhe s'po fliste.

- Pse keni ardhur? - i foli pa lëvizur nga vendi.
- Ashtu kot. Mirëmëngjes! - u përshëndet Svidrigajllovi.
- Nuk lejohet ndalimi...
- Po nisem për larg.
- Për larg?
- Për në Amerikë...
- E, në Amerikë...

Svidrigajllovi nxori revolverin dhe i hoqi siguresën. Roja ngriti vetullat i habitur.

- Nuk e keni zgjedhur mirë vendin për kësi shakash!
- E pse s'e paskam zgjedhur mirë?
- Sepse ky i këtushmi nuk është i tillë.

kush jam unë?

- Pa ma trego pak, moj mama.

Raskonikovi mori revistën dhe i hodhi një sy të shpejtë shkrimit. Ajo që lexoi, binte ndesh me gjëndjen në të cilën ndodhej, por nuk ndjeu kurrfarë dëshire për të shfrehur, siç ndodh rëndom me autorët, kur njihen me shkrimet e botuara, pa zënë ngoje pastaj njëzetvjeçarët. Vetëm u ngrys dhe një pikëllim i paanë ia gllabëroi zemrën. Ndërmendi luftën e tmerrshme të motiveve që kishte përjetuar kohët e fundit; me neveri dhe zemëratë e vërviti mbi tryezë revistën.

- Se unë, Rodia, edhe pse nuk para marr vesh shumë nga bota, mund të them se nuk ka për të qenë e largët dita, që ti do bëhesh një nga të parët e kësaj bote, në mos më i dituri i saj. Si guxuan të të marrin për të çmendur? Ha-ha-ha! Ndoshta s'fola mirë, por kështu sikur ma zuri veshi. Ca krimba mjeranë janë, e ku marrin vesh nga bota!... Çuditem që edhe Dunja zuri t'u besonte! Yt atë, ndjesë pastë, dy herë pat dërguar shkrime në revistë; njëherë ca vargje, pastaj një novelë. (E kam ruajtur fletoren, do ta tregoj, kur të vish, iu luta të ma linte ta kopjoja me dorën time dhe më la) - Sa shumë që kemi dashur të botoheshin, por ja që nuk ia botuan... Rodia, para gjashtë ditësh, kur të pashë aq keq të veshur, më pikoi mu në zemër, s'po të flas pastaj për jetën që bën, për ushqimin që ha... Tani jam më e qetë se u binda që, po të duash, me mendjen dhe talentin që ke, në çast e ndryshon çdo gjë. E kam të qartë tani: ti vetë nuk u kushton vëmendje këtyre gjërave, ngaqë je i zënë me punë ku e ku më te mëdha...

- Po Dunja ku është, moj mama?

- Nuk e di. Del shumë kohët e fundit, unë vetëm rri këtu. I faleminderit Dimitri Prokofiçit, s'më harron, vjen e më tregon për ty. Të do me shpirt dhe të respekton, duket ajo. Edhe për tët motër nuk është se qahem, por ja që kemi karaktere të ndryshëm ne me të. Seç ka, e shoh të rrethuar me ca fshehtësi, kurse mua më pëlqen që enët të jenë pa kapakë... E di që është e mënçur dhe na do, si mua ashtu edhe ty, por se si venë këto punët tona, këtë nuk e di... Ma bëre qefin që erdhe, mor bir! Dunjën nuk e di ku është, por me të ardhur, do t'i tregoj. "Yt vëlla erdhi, kurse ti se nga bredh!" - do t'i them. Ti, Rodia, për mua mos u bëj merak: në mundsh, eja, në s'mundsh, mos eja... Unë pres. E di që më do, kjo më mjafton. Ja, do t'i lexoj dhe rilexoj

këto që ke shkruar, në më ardhsh në të rrallë, mirë edhe kjo më mjafton. Sa mirë bëre që erdhe, e di, për të më hequr merakun mua erdhe...

Pulheria Aleksandrovna nuk i përmbajti dot lotët.

- Përsëri unë budallaqja! Mos ia merr për të keq kësaj nëne teveqele. Rodia... Po si po rri kështu! - thirri dhe u çua vrulltas. - E kam gati kafenë dhe s'po ta nxjerr! Ah! Mendje, mendje! Erdha!

- Jo s'është nevoja, moj mama. Nuk dua! Më duhet të shkoj. Erdha vetëm për pak. Më dëgjo se ç'do të them...

Pulheria Aleksandrovna iu afrua me zemër të ngrirë.

- Mama! Në ju thënçin një mirë të zeza per mua, në më pllakosshin mënxyrat e dynjasë, a do vazhdonit të më doni si tani? - e pyeti çiltër, pa u thelluar në atë qe po bënte, pa e peshuar domethënien e atyre fjalëve.

- Rodia! Rodia! Ç'thua kështu? Ç'të paska ndodhur, mor bir? E si ta nxuri goja të më pyesësh për këtë? Kurrë, askujt nuk kam për t'i besuar, në më thëntë ndonjë gjë të keqe për ty! Do ta nxjerr jashtë, kushdo që të jetë...

- Mama! Erdha të them se gjithmonë ju kam dashur... Sa mirë që ju gjeta vetëm... që as Dunja nuk është... - shtoi. - Mundet edhe të jeni fatkeqe, por dijeni që gjithmonë ju kam dashur, edhe tani ju dua, më shumë se veten ju dua... Në ju është dukur që u tregova zemërgur dhe s'ju kam dashur, gaboheni. Tërë jetën do t'ju dua! Nga kjo duhet ta filloja...

Pulheria Aleksandrovna e pushtoi fort, e shtrëngoi në kraharor, pika të mëdha loti iu rrokullisën nëpër faqe.

- Ç'po ngjet kështu me ty, Rodia, nuk po e marr vesh! Kam pandehur që po të bezdisnin, tani po e shoh që të kërcënon një mënxyrë e llahtarshme, ndaj je aq i pikëlluar.. Ka kohë që e ndiej këtë. Më fal që të fola kështu, te ti më rri mendja, s'më zë gjumi natën! Edhe jot motër mbrëmë s'ka qenë fare në të, më foli për ty, por gjë prej gjëje nuk kuptova. S'më mbante vendi tërë mëngjesin, seç kisha një si vilani dhe ja ku më doli! Ku po shkon kështu, Rodia? Mos po nise për diku?

- Po.

- E kam ditur. Më merr me vete, në të duhem! Edhe Dunja vjen, të do me shpirt, edhe Sonja Semionovna vjen. Na ndihmon Dimitri Prokofiçi të nisemi të gjithë bashkë... Po për ku ke ndërmend të

shkosh?

- Lamtumirë, nënoke.

- Po si, që tani? - thirri sikur ishte duke e humbur përgjithmonë.

- Nuk rri dot më, jam me ngut

- Po unë a mund të vij me ty?

- Jo! Vetëm bini në gjunjë dhe lutjuni Zotit për mua. Lutjen tuaj perëndia e dëgjon.

- Dale të të bekoj, të të bëj kryqin! Ja kështu! O Zot! Po ç'është kjo kështu?

Po, po, ishte shumë, shumë i gëzuar që nuk kishte gjetur njeri tjetër në shtëpi, që ju dha rasti të rrinte pak vetëm për vetëm me të ëmën. Për herë të parë gjatë kësaj kohe të tmerrshme iu zbut pak zemra. I ra në gjunjë, zuri t'i puthte këmbët, pastaj, të përqafuar fort, derdhën lot të hidhur. Ajo s'po habitej e as po e pyeste më. Kishte kohë që e kishte nuhatur që me të birin seç po ndodhte, tani ishte çasti vendimtar.

- Rodia, shpirti im, i vetmi im! - belbëzonte duke dënesur. - Ja, si atëherë që ke qënë i vogël je edhe tani: si atëherë m'u afrove, më puthe. Atëherë ti na ngushëlloje, si mua edhe tët atë, me praninë tënde... Pale pastaj kur mbetëm vetëm. Sa herë kemi qarë, ja kështu, të përqafuar, mbi varrin e tët eti... Kam kohë që qaj, sepse zemra e nënës e ndien të keqen. Kur të pashë atëherë, m'u drodh shpirti, zemra. Rodia, po ti nuk do nisesh menjëherë? Kështu, apo jo?

- Jo.

- Do vish përsëri?

- Po... do vij.

- Rodia, mos ma merr për keq, por a mund të ma thuash se përt u je duke u nisur?

- Për në vende të largëta.

- Po shkon me punë, me shërbim?

- Për ç'të sjell Zoti! Vetëm mos harroni të luteni për mua.

Raskolnikovi u bë gati të dilte, por e ëma e kapi fort nga krahët dhe e përpiu me një shikim të dëshpëruar. Fytyra iu transformua nga lemeria.

- Mjaft tani, moj mama! - i tha i penduar që kishte vendosur të vinte.

- Jo përgjithmonë, ë? Nesër do vish, do vish!

- Po, po! Do vij. Lamtumirë.

Më në fund, u çlirua nga krahët e saj.

Ishte një ditë e freskët, pa re. Raskolnikovi u drejtua me hap të shpejtë për në dhomë. Donte t'i mbaronte punët para se të perëndonte dielli dhe nuk ia kishte ënda ta takonte njeri. Kur po ngjiste shkallët, vuri re se Nastasia po e shihte ngultas. "Mos po më pret kush lart?" - mendoi. I erdhi për të vjellë, kur i tha vetes se mund të ishte Porfiri. Hapi derën dhe pa Dunjeçkën. Rrinte e zhytur në mendime, dukej që kishte kohë që po e priste. Qëndroi te pragu, kjo u hodh përpjetë dhe e pa e trembur, por edhe e pikëlluar. Raskolnikovi e kuptoi që i dinte të gjitha.

- Te hyj apo të iki? - e pyeti me mëdyshje.

- Tërë ditën e ditës të kam pritur te Sonja Semionovna: thashë që domosdo do ktheje.

Raskolnikovi hyri dhe u lëshua fuqiprerë në karrige.

- S'po qëndroj më dot në këmbë, Dunja. M'u prenë fare fuqitë... E pra, do të desha që këtë kohë të mbetur ta kisha në dorë veten për çdo gjë.

E pa me dyshim.

- Ku ishe natën e shkuar?

- Nuk më kujtohet mirë se ku. Di vetëm që doja të merrja një vendim të fundit dhe u enda tërë kohën buzë Nevës, këtë e mbaj mend mirë. Desha t'u jepja fund njëherë e përgjithmonë... punëve... por nuk më mjaftoi guximi. - bëlbëzoi dhe e pa përsëri me dyshim motrën.

- Lavdi Zotit! Kësaj ia kisha frikën... si unë ashtu dhe Sonja Semionovna. Domethënë nuk e ke humbur besimin te jeta... Lavdi të madhit Zot!

Raskolnikovi u skërmit i pikëlluar.

- Nuk është tamam ashtu... Isha te mamaja, ndenjëm të përqafuar dhe qamë. Nuk është se kam besim te jeta... Nënës iu luta t'i falet për mua Zotit. Nuk e di si do t'i vej filli kësaj punës sime, Dunjeçka. Gjë prej gjëje nuk po mundem të kuptoj...

- Paske qenë te mamaja? I tregove? - e pyeti Dunja e trëmbur.

- Jo, nuk i tregova... por ajo vetë i kishte kuptuar shumë gjëra. Të paska dëgjuar, kur paske folur në gjumë. Në mos plotësisht,

përafërsisht është në dijeni. Ndoshta nuk bëra mirë që shkova, por as vetë nuk e di se ç'më shtyu. Jam njeri i poshtër unë, Dunja...

- Veten e quan të poshtër, por ama je gati ta vuash dënimin! Kështu, apo jo!

- Po. Dhe, e di, për të mënjanuar turpin, mendova të mbytem. Veç në çastin e fundit thashë: nëse e kam mbajtur veten për të fuqishëm, nuk kam pse i trëmbem tani turpit. Punë krenarie është kjo, është punë sedre, kështu apo jo?

- Po, po! Punë krenarie është.

Një si flakë ia ndriçoi nga brenda sytë e shuar, iu ledhatua sedra që paska mundur ta ruajë krenarinë.

- A nuk të duket, moj motër, se nuk ma mbajti nga uji, ndaj dhe nuk u mbyta? - e pyeti me një buzagaz të kithtë, duke e parë në fytyrë.

- Mjaft me këto Rodia! - gulçoi e vrerosur Dunja.

Heshtën nja dy minuta. Raskolnikovi rrinte kokulur dhe shihte dyshemenë. Dunjeçka qe ulur në skajin tjetër të tryezës dhe e shihte e pikëlluar. Atë çast Raskolnikovi brofi.

- Më duhet të shkoj, duhet të dorëzohem, ndonëse as vetë nuk e di përse...

Pika të mëdha loti rrodhën nga sytë e Dunjës.

- Ti po qan, motër... A mundesh të ma zgjatësh pak dorën?

- Mos vallë dyshon për këtë?

Iu afrua dhe e përqafoi fort të vëllanë.

- Pse si, që je duke shkuar ti vetë për të vuajtur dënimin, a nuk je duke e shlyer gjysmën e krimit? - i tha dhe e përqafoi fort, e puthi fort dhe e mbajti ashtu të shtërnguar në krahët e saj.

- Të krimit the! Të ç'krimi? - thirri si i fandaksur nga tërbimi i beftë. - Pse ngaqë vrava një fajdexheshë gjakpirëse dhe të pështirë, ngaqë ia shtypa kokën një morri dëmprurës, ngaqë çova në atë botë një plakaruqe që s'i duhej askujt dhe për vrasjen e së cilës i falen njeriut dyzet gjynahe, sepse ua merrte shpirtin çik e nga një çik hallexhinjve, paskam bërë krim? As mendoj e as dua ta vuaj për këtë dënimin. Ç'është kjo kështu që nga të katër anët vetëm e dëgjoj të më thonë: "Krim! Krim!" Tani po e kuptoj me tamam kotësinë e shpirt-vogëlsisë sime, tani që vendosa ta ha me bukë turpin... Vendimin për ta vuajtur dënimin e mora ngaqë jam i poshtër dhe i pazoti, e mora

ndoshta edhe ngaqë më leverdis, siç pandeh ai... i policisë... Porfiri.

- Vëlla! Ç'janë këto që thua? Po gjaku i derdhur, si? - thirri në kulmin e dëshpërimit Dunja.

- Atë e derdhin të gjithë! - klithi si i çartur Raskolnikovi. - Është derdhur dhe po vazhdon të derdhet si ujëvarë, si shampanjë, po derdhet në mbarë botën, dhe për këtë i kurorëzojnë në Kapitole, u vënë nofkën e bamirësve të njerëzimit... Shih mirë përreth, dhe ke për t'u bindur që jam duke të thënë të vërtetën... U kam dashur vetëm të mirën njerëzve, do të kisha bërë sa e sa të mira për ta në këmbim të kësaj marrëzie të vetme, të cilën, madje, as të tillë nuk ke si e quan; lajthitje është, sepse si ide nuk është pa gjë. Tani që dështoi duket e tillë... (Dështimet kurdoherë duken lajthitje!) Synimi im ishte ta vija veten në një pozicion të pavarur, u orvata të hidhja hapin e parë, të siguroja mjetet e duhura, pastaj çdo gjë do fshihej nga dobia e pamatë që do t'u vinte njerëzve... Por ja që dështova që në hapin e parë dhe dështova ngaqë jam njeri i poshtër! Ja, kjo është e gjitha! Me shikimin tuaj të kësaj çështjeje nuk jam në një mendje... Po t'ia kisha dalë mbanë, do më prisnin dafinat; tani që dështova, lakun në fyt!

- Jo, jo! Nuk është ashtu! Ç'je duke thënë, vëlla?

- A-a-a! Nuk e zgjodha të përshtatshme formën? Nuk është diçka estetike? Veç ja që s'arrij dot ta kuptoj, përse të batërdisurit e njerëzve me bomba na qënka formë më e mirë, më estetike? Frika para jo estetikes dhe është shënjë e parë e pafuqisë. Kurrë ndonjëherë nuk e kam parë të manifestohet aq qartë sa tani!... Më shumë se kaq nuk kam si e kuptoj se ajo që bëra na qënka krim!...

Fytyrën dyllë e verdhë ia mbuloi një përflakje irritimi. Fjalët e fundit i shqiptoi kur shikimi iu kryqëzua me atë të Dunjës. Sa shumë vuajtje që shprehte ai i saj! Kjo dhe e solli në vete. E mori me mendje sa shumë fatkeqe i kishte bërë gratë që e donin aq shumë...

- Dunja! Shpirte! Në qofsha me faj, të më falësh! (Ndonëse s'ke si më fal, në qofsha fajtor!) Lamtumirë! S'kemi pse flasim më gjatë për këtë! Po shkoj! Mos më ndiq pas, të lutem shumë... Shko dhe qëndroi pranë mamasë... Të lutem shumë për këtë! Është lutja ime e fundit... Mos e lerë kurrë vetëm. Kur u ndamë, ishte tepër e alarmuar... Kam frikë se nuk ka për ta duruar këtë hidhërim... O do vdesë, o do çmendet! Mos e lër vetëm. Edhe Razumihini ka për t'u qëndruar pranë, e luta

unë... Mos qani për mua: do mundohem të tregohem edhe burrëror, edhe i nderŝhëm, ndonëse jam vrasës... Ku i dihet, ndoshta ke për të ma dëgjuar ndonjëherë emrin. Nuk kam për t'jua skuqur faqen, do më shihni... Tani, mirupafshim! - Nxitoi t'i japë fund ligjërimit, kur vuri re një shprehje të çuditshme në sytë e Dunjës. - Po pse qan? Mos po ndahemi përgjithmonë!... Pa dale! Për pak sa s'harrova!...

Iu afrua tryezës, mori një libër të trashë, të pluhurosur, e hapi dhe nxori që andej një portret të vogël të bërë me akuarel në fildish. Ishte portreti i së bijës së pronares, i asaj vajze te çuditshme që kishte dashur të mbyllej në manastir. E pa nja një minutë, e puthi dhe ia dorëzoi Dunjeçkës.

- Me të, vetëm me të i kam folur që të gjtha këto, - tha mendueshëm. - Nuk m'i miratonte këto mendime, si dhe ti... Më mirë që nuk është gjallë... Kryesorja, çdo gjë ka për t'u bërë më mirë, ka për t'u ndarë në dy gjysma! - thirri befas, duke u gjendur përsëri nën pushtetin e pikëllimit të pamatë. - Po a jam i përgatitur, vallë, për këtë që po bëj? A po dorëzohem me hirin tim? Dëgjoj të më thonë që qënka sprovë për mua... E ç'më lypsen ca sprova të pakuptimta? Mos vallë do ta ndiej më mirë veten pas asaj galere njëzetvjeçare? Mos do jem më mirë i dërrmuar nga mendimet e shumta, nga idiotizmat e panumërta dhe nga pafuqia e pleqërisë? E ç'më duhet jeta atëherë?... Pse po e pranoj këtë të ardhme? Ah! E di dhe vetë që i poshtër jam, kur pranova të qëndroja mbi Nevë deri në agun e kësaj dite dhe u ktheva këtu...

Dolën të dy bashkë. Dunja s'e kishte të lehtë këtë ndarje me vëllanë se e donte me shpirt!... U larguan nga njëri-tjetri nja pesëdhjetë metra dhe ajo ktheu kokën që ta shihte. Te bërryli i rrugës ktheu kokën edhe ai. Këmbyen për të fundit herë shikime. Raskolnikovi tundi vrulltas dorën, duke dashur t'i bënte shenjë të ikte, dhe vetë ktheu në qoshe.

"Më mbyti nervozizmi, s'ka si të jetë ndryshe! - tha me vete, duke u ndier me turp për shënjën që i bëri ashtu me dorë. - Po ama edhe ato përse të më duan aq shumë, në qoftë se nuk e meritokam!... Sa mirë do kishte qenë, sikur të isha fillikat, të mos më donte kush dhe të mos doja njeri. Nuk do ndodhnin të gjitha këto... Vallë a do më qetohet dhe përdëllehet zemra në këto dhjetë pesëmbëdhjetë vjet, saqë në çdo hap që do bëj të mund ta thërras veten cub të penduar!

Po, se ndaj dhe po më nisin në këtë rrugë... Ja varavinga i sheh njerëzit nga mëngjesi në darkë nëpër rrugë, secili prej tyre është i poshtër dhe cub, pale pastaj që është edhe idiot i kulluar! Ama, provo t'i bësh bisht dënimit dhe ke për ta parë si do shkumëzohen e do çirren, do gulçojnë nga indinjata zemërimmadhe! Sa shumë që i urrej!...

Aty për aty e pyeti veten: "Po a do t'më ndodh, vallë, të jem i përkorë para tyre e sy tyre, dhe të jem i tillë me bindje?... E pse të mos më ndodhë? Ndryshe s'ka si të jetë! Po, vallë, a s'të katandisin përibret njëzet vjet zgjedhe të tmerrshme? Uji e laton gurin... E pse do më duhet të jetoj pas asaj kohe? Përse po shkoj, kur fort mirë e di që kështu ka për të më ndodhur dhe jo ndryshe!..."

Ishte hera e njëqindtë që po ia bënte vetes këtë pyetje sidomos nga mbrëmja e djeshme dhe... prapë se prapë shkoi.

VIII

Kishte ngrysur, kur erdhi te Sonja. Kjo e kishte pritur tërë ditën bashkë me Dunjën, që i kishte vajtur që në mëngjes, pas fjalëve të Svidrigajllovit: "Sonja i di të gjitha".

Nuk po futemi në hollësi të bisedës që u zhvillua ndërmjet tyre, në lotët lumë që derdhën. Dunja u ngushëllua dhe u qetësua shumë, kur mësoi që vëllai nuk do ishte vetëm: Sonja kishte qenë njeriu i parë të cilit Raskolnikovi i ishte hapur, atë kishte zgjedhur për më të besuarën, ajo dhe do t'i shkonte pas ku ta çonte fati. Dunja nuk e pyeti për këtë, por e kuptoi që kështu do të ndodhte. E shihte me adhurim e përgjërim atë vajzë; Sonja sa nuk u shkreh në vaj, aq shumë e preku ky qëndrim i Dunjës; veten e quante të padenjë as ta shihte drejt në sy. Përshtypja e parë, kur Dunja e sajdisi dhe e përshëndeti në atë takim te vëllai, tani u bë më e fortë, kështu e tutje do ta ruante si gjë të shenjtë kujtimin për këtë vajzë të mrekullueshme, të paarritshme prej saj.

Nga padurimi, Dunjeçka e la vetëm Sonjën dhe shkoi ta priste vëllanë në dhomën e tij. Fill vetëm, Sonja mend çmendej nga meraku për fatin e Raskolnikovit; ku i dihej, ky mund edhe të vinte dorë mbi veten... Edhe Dunja ia kishte frikën. Sa kishin qenë bashkë, kishin bërë çmos ta qetësonin njëra-tjetrën, ta bindnin që diçka e tillë ishte

e pamundur, tani që mbeti vetëm, mendja i shkonte vetëm tek e keqja. I kujtoheshin fjalët e Svidrigajllovit se Raskolnikovin e prisnin vetëm dy rrugë: o Vladimirka, o... Ia njihte mirë krenarinë, sedrën, mosbesimin. "A mundet, vallë, që vetëm shpirtvogëlsia dhe frika nga vdekja ta bëjnë të mos vërë dorë mbi veten?" - mendoi e çoroditur dhe e dëshpëruar.

Po perëndonte. Sonja shihte trishtueshëm nga dritarja, muri përkarshi shkëlqente nga perëndimi i përflakur. Pikërisht atëhere, kur krijoi bindje të plotë për mundësinë e vdekjes së fatkeqit, ai hyri në dhomë.

Nga kraharori i doli një britmë gëzimi, por kur e pa sa i trishtuar ishte, e mbuloi të verdhtë.

- Ja dhe unë! - iu drejtua, duke vënë buzën në gaz. - Erdha për kryqin; ti këtë deshe, apo jo! Po pse dukesh aq e trembur?

Sonja e shihte si e handakosur. Iu duk tejet i çuditshëm ai zë, i shkuan mornica nëpër trup, por sakaq e kuptoi që ai zë ishte i shtirë. Kur i foli ashtu, nuk e pa drejt në sy, por mënjanë.

- I peshova mirë gjërat dhe më del me leverdi kështu. Ka disa rrethana... Po t'i lemë këto! E di çfarë m'i ngre nervat? Mendimi që disa syfete të pështira, kur do më kenë përfund, do nisin e do më bëjnë ca pyetje prej budallai, të cilave do s'do do t'më duhet t'u përgjigjem. Kanë për të më treguar me gisht... Pthu! E di, kam vendosur të mos i dorëzohem Porfirit, s'e honeps dot atë njeri. Do vete e do t'ia tregoj të gjitha Porohut, një të njohurit tim, do mbetet me gojë hapur, do patakset... Duhet bërë çdo gjë me gjakftohtësi, se kohët e fundit jam bërë si tepër hidhnak. Ja, tani iu hakërrova sime motre atje në rrugë, dhe e di pse, sepse m'i nguli sytë e nuk po shqitej vendit... Xhahil e shkuar xhahilit u tregova... Jam katandisur mosmëkeq. Po t'i lëmë këto. Kryqet ku i ke?

Dukej që nuk ishte në vete. As qëndronte e as shihte dot në një vend, dukej që mendimet e vërshonin pa i lënë radhë shoshoqit; fliste kodra pas bregut, i dridheshin duart.

Sonja nxori e heshtur kryqet, njërin prej dru qiparisi dhe tjetrin prej bakri; bëri kryqin, ia bëri edhe atij, dhe ia vari në qafë atë prej dru qiparisi.

- Pra po e pranoj dënimin! He-he! Si të paskëshim vuajtur pak

deri më sot!... Këtë të drunjtin ta kanë falur besimtarët, kështu më ke thënë, i bakërti është kryqi i Lizavetës, atë e mbajte për vete. Pa ma trego, i tillë ishte edhe ai që kishte atëherë në qafë... Ishte edhe një tjetër me ikonëzën e Shën Mërisë, ishte prej argjendi, atë ia hodha në kraharor plakës. Ja atë të kisha ta varja tani në qafë... E di, Sonja, përse kam ardhur? Që të të them se po shkoj atje... Vetëm kaq! (Kam pandehur se do të të flisja më shumë.) Se ti kështu doje, apo jo? Që unë të veja e të paraqitesha me vullnetin tim... Do t'më dënojnë, do më burgosin, do bëhet çdo gjë ashtu si doje ti.. Po pse po qan? Si ato! Më pikon në zemër, kur ju shoh!...

"Po kjo kështu? E kush jam unë për të? Nuk flet, por vetëm qan, njëlloj si mamaja dhe Dunja. Do më jetë në këmbë të dados!"

- Bëj kryqin! Qoftë një herë lutju Zotit! - iu përgjërua me zë të dridhur Sonja.

- Do t'i lutem, sa të duash! Dhe me gjithë zemër, Sonja, me gjithë zemër...

Donte t'i thoshte edhe diçka tjetër, por heshti.

Bëri disa herë kryqin. Sonja hodhi në kokë shaminë gjelbëroshe, të strepsur, me sa dukej, atë, për të cilën i pat folur dikur Marmelladovi, duke e quajtur "të familjes".

Po e ndiente që e kishte humbur torruan, rrinte fare i shastisur. Sidomos po e habiste Sonja me përgatitjet e saj për të dalë bashkë me të.

- Po ti për ku kështu? Jo, jo! S'është nevoja! Nuk ke ku shkon! - Këto fjalë ia tha me pamje e zë prej zemëraku dhe iu afrua derës. - E përse duhen këto përcjellje?... - bëlbëzoi dhe doli.

Sonja qëndronte si e shkalur në mes të dhomës. Raskolnikovi as nuk u përshëndet me vajzën, harroi! Një dyshim i hidhur ia mbushi cit zemrën.

"Po a duhet bërë kjo që jam duke bërë? - e pyeti veten, kur po zbriste shkallët. - Mos është më e udhës t'i them vetes ndal dhe të merrem me masat për rregullimin e punëve?..."

E megjithatë shkoi. I tha prerë vetes që s'duheshin bërë më të tilla pyetje. Kur po ecte në rrugë, iu kujtua që nuk ishte përshëndetur me Sonjën, që ajo kishte mbetur e shtangur nga habia, me atë shaminë gjelbëroshe në kokë. Sakaq i feksi një mendim: "Po pse i vajta, vallë?

I thashë që kisha një punë, por ç'punë ishte? E ç'ishte nevoja të ktheja vetëm për t'i thënë që po shkoja!... Po a e dashuroj atë vajzë! Del qe jo, sepse e zbova, ashtu siç zbojmë një qen... Po pse për punë të kryqit u ktheva?... Sa poshtë kam rënë!... Më duhej të shihja lotët e saj, frikën e saj, të shihja si dridhej e i dhimbte zemra, si i copëtohej!... Duhej ngecur pas diçkaje, duhej vonuar sado pak, duhej qëndruar pranë ndonjerit! Kjo ishte e tëra. Dhe pata guximin ta shpresoja këtë! Ç'njeri i zvetënuar që po tregohem, sa poshtë kam rënë, sa i ndyrë po tregohem"?!

U çapit buzë lumit; nuk i kishte mbetur edhe shumë rrugë. Kur arriti te ura, ndali pak dhe mori rrugën që të çonte në Sheshin Sena. Përpinte me sy çdo gjë që i dilte përpara, majtas dhe djathtas, por pa u përqendruar në asgjë të veçantë. Pas një jave apo pas një muaji kanë për të më hipur në karron e të dënuarve dhe do t'më çojnë po nëpër këtë urë. Me ç'sy do ta shoh atëherë, vallë? Ja, këtë tabelë që është këtu, si kam për ta lexuar atëherë? Është shkruar fjala "shoqëria"... Duhet fiksuar dhe mbajtur mend gërma "o". Si do më duket, vallë, pas një muaji? Ç'mendime e ndjenja do të provoj atëherë?... Fare cikërima do të më duken përkujdesjet e sotme... Sidoqoftë, në një farë mënyre kërshërindjellëse është!... (Ha-ha-ha! Për çfarë më ha meraku!) Fëmijë po e tregoj veten... Ptu! E si shtyhen njerëzit! Ky trashaluqi këtu gjerman duhet të jetë... Më shtyu, por a e di vallë se cilin shtyu? Gruaja me fëmijën hopa kërkon lëmoshë, çudi! Me sa duket, më quan shumë më të lumtur se veten... T'i fal ndonjë gjë, më paskan mbetur pesë kopejka... Merri nënoke!"

- Zoti të ruajtë! - u dëgjua zëri përgjërimtar i lypëses.

Doli në Sheshin e Senës. Nuk i vinte mirë të shtyhej e të përplasej me njerëzit, por shkoi pikërisht atje, ku kishte më shumë njerëz. Ç'nuk do të jepte për të qenë vetëm, por fort mirë e dinte që as dhe një minutë nuk mundej të qëndronte vetëm. Diku mes njerëzish po hargalisej një i dehur, bënte të hidhte valle, por i merreshin këmbët. E kishin rrethuar nga të katër anët, iu afrua edhe Raskolnikovi, e pa disa minuta në heshtje, pastaj u shkri së qeshuri. Pas një minute e harroi fare, ndonëse sytë vazhdonte t'i mbante të mbërthyera tek ai. U largua dhe as vetë s'po e dinte se ku ndodhej. Kur arriti në mes të sheshit, i erdhi në kokë një mendim, një shqetësim, një ndijim i vetëm.

Iu kujtuan fjalët e Sonjës: "Dil në një udhëkryq, përulju njerëzve, puthe tokën, se edhe para saj je në gjynah, pastaj thuaj me zë të plotë: Jam vrasës!" U drodh, kur iu kujtuan këto fjalë, dhe aq shumë iu ligështua zemra, aq keq po e mbyste trishtimi, saqë iu dha me mish e me shpirt këtij mendimi të ri, siç vjen një krizë epilepsie. Mjaftoi një shkëndi, që t'i ndizej zjarri në gji! Iu zbut dhe iu squll shpirti, lotët zunë t'i shkonin çurg. Ashtu siç ishte, u lëshua në tokë...

Ra në gjunjë në mes të sheshit, u përkul deri në tokë, e puthi me ngazëllim e përkushtim, ndonëse ishte e përbaltur. Pastaj u çua dhe përsëri u përkul...

- Paska lakmuar, birçja! - nëpërdhëmbi aty pranë një djalë i ri.

U dëgjuan të qeshura.

- Po u niska për në Jeruzalem ky, o vëllezër, qënka duke u lënë lamtumirën fëmijëve, atdheut, botës mbarë, po u bëka temena njerëzve, po e puthka me nderim kryeqytetin, Sankt-Petërburgun! - u përzie në bisedë një zanatçi i dehur i bërë tapë.

- Qënka dhe djalë i ri, zavalli! - i vuri kapak një i tretë.

- Nga fisnikët duhet të jetë! - foli dikush me zë njeriu të mbajtur.

- E ku shquhen këta se nga janë!...

Këto hidhepritje të njerëzve sikur e përmbajtën Raskolnikovin të shqiptonte fjalët: "Jam vrasës!" I dëgjoi fare i qetë dhe pa parë as majtas e djathtas mori rrugën për në zyrat e policisë. Rrugës i shkuan sytë te një qënie për të e shtrenjtë, por kjo s'e habiti fare, e dinte që nuk kishte si të ishte ndryshe. Edhe kur kshte rënë në gjunjë e qe përkulur deri në tokë ia kishte zënë syri Sonjën... Kjo qëndronte e fshehur pas një barake druri, pra ishte duke e shoqëruar në këtë rrugë aq pikëllimtare!... E kuptoi që nuk kishte për t'iu ndarë më, do shkonte pas tij makar edhe në fund të botës... ku ta degdiste fati! Një ndjenjë e re ia mbushi plot e përplot zemrën... por ja ku arriti te vendi fatal...

Me hap të sigurt hyri në oborr, duhej ngjitur në katin e tretë. I dukej e largët minuta fatale, i bëhej sikur ende kishte dhe jo pak kokë, pra mund të mendonte e të stërmundonte akoma...

Si atëherë shkallët qenë të mbuluara nga plehrat, edhe dyert e dhomave po si atëherë ishin të hapura, si atëherë të çponte hundën era e gjellës që gatuhej diku. Këmbët i dridheshin, i kishte si të drurosura, por vazhdonte të ecte. Ndali vetëm pak që të mund të

mbushej me frymë, të mblidhte veten, që kur të paraqitej, të paraqitej si njeri. "E pse, kujt i duhej një gjë e tillë? - e pyeti në atë çast veten. - Nëse duhet kthyer gota me helm, mos vallë ka rëndësi si është? Sa më e fëlliqur, aq më e mirë. - I doli para syve fytyra e Ilia Petroviç Porohut. - Po pse këtij do t'iu paraqitkam? A nuk do ishte më mirë t'i shkoja ndonjë tjetri? E pse të mos shkoj t'ia tregoj Nikodim Fomiçit? Mos do qe më mirë t'i shkoja në shtëpi? Ndryshon puna... Jo, jo! Te Porohu do vete! Në u dashka pirë gota e helmit, duhet kthyer deri në fund!..."

Me zemër të ngrirë e hapi derën e zyrës, nuk kishte shumë njerëz. Roja nuk i kushtoi kurrfarë vëmendje. Kaloi në dhomën tjetër. "Ku i dihet, unë edhe mund të mos flas!" - i vezulloi atë çast. Njëri nga shkruesit po shkruante, tjetri, që ishte në qoshe, po rrinte. Zametovi nuk ishte aty, kuptohet, as Nikodim Fomiçi nuk ishte.

- Nuk paska njeri? - e pyeti Raskolnikovi shkruesin që ishte më pranë.

- Ju cilin kërkoni?

- A-a-a! Na ishte seç na ishte, na ishte njëherë një... si në përrallë... në cilën, e kam harruar! Nde-ri-met to-na! - thirri një zë i njohur.

Raskolnikovi u rrëqeth. Para tij qëndronte Porohu dora vetë! Kishte hyrë nga dera e tretë. "Vetë fati e solli, - mendoi Raskolnikovi. - Ky më duhet!"

- Ç'e mirë ju solli? - e pyeti i habitur Porohu. (Ishte në humor të mirë madje disi në qejf.) - Në keni ndonjë punë... më gjetët rastësisht... Po, sidoqoftë, me se mund t'ju jem i dobishëm? Të më falni... emrin... si e keni?

- Raskolnikov.

- Ah, po! Raskolnikov! Mos pandehni që ju kam harruar! S'jam nga ata.. Radion Ro... Rodinoviç... kështu; apo jo?

- Rodion Romanoviç.

- Po, po! Rodion Romanoviç! Kështu desha të them. Kam pyetur për ju. Se, t'ju them të drejtën, më ka ardhur keq që u ndamë ashtu.. Më kanë folur fjalë të mira për ju... Qënkeni duke bërë hapat e para të letrarit apo të shkencëtarit... O Zot! Po kush është ai letrar që nuk ka bërë numra në fillimet e veta! Si unë ashtu dhe ime shoqe kemi respekt për letërsinë, gruaja lë kokën pas saj... Të jetë fisnik njeriu, se

të tjerat: talentin, dijet, mendjen, madje edhe gjenialitetin e arrin... Kapelja, e ç'do të thotë ajo? Atë shkon te Cimermanët dhe e ble, kurse atë që ruhet nën të, që mbrohet prej saj, asaj si t'ia bësh, ajo nuk blihet dot... Të them të drejtën, kam dashur të vij për t'u sqaruar, por kam pas menduar që ju... Po nejse, ç'të flasim për këtë. Më thanë që ju ka ardhur prindi?

- Po, më ka ardhur mamaja dhe motra.

- Kam patur nderin dhe lumturinë të njihem me motrën tuaj, është vajzë e shkolluar, e mrekullueshme. T'ju them të drejtën, më ka ardhur keq që u përfolëm ca atëherë, në gjaknxehtësi e sipër ka qenë. Të fiktit u bë shkaktar që ju pashë ashtu me dyshim, por më pas u sqarua për bukuri gjithçka! Se veazhdësia dhe fanatizmi bëjnë të tyren, de! E kuptoj indinjatën tuaj... Mos keni ndërmend të ndërroni vendbanimin me rastin e ardhjes së prindit?

- Jo, erdha kot... Erdha te pyes... Thashë mos gjeja këtu Zametovin.

- Ah, po! Jeni bërë miq... Kam dëgjuar... Nuk është këtu dhe nuk ka për të qenë më këtu Aleksandër Grigorieviçi. Ka ikur, dje u përshëndoshëm... U grind dhe u përfol me të tërë! Nuk u soll mirë... Erë e veri është ai djalë, ku rafsha mos u vrafsha është. Dukej shpresëdhënës, por ja që nuk doli... Dëshiron të japë provime, kurse këtu ndër ne, përveç fjalëve e bujës, tjetër nuk ka! Nuk është as si ju, po as si miku juaj, Razumihini! Ju keni dell shkencëtari, mossuksesi nuk ju thyen kollaj! Për ju tërë këto bukuri të jetës, mund të thuash, *nihil est*[1]), ju jeni tip asketi, murgu, jeremie!... Për ju letra e pena janë kryesoret dhe, domosdo, pranë tyre, edhe libri, studimet shkencore. Ato janë të shenjta... Kurse për mua janë kujtimet e Livingstonit; mos i keni lexuar gjë?

- Jo-o-o!...

- Jini i çiltër me mua, mos u druani për asgjë, sikur flisni me veten tuaj më flisni... Se shërbimi është shërbim, kurse... jo, mos pandehni që do them miqësia? Nuk i ratë në të! Jo miqësia, por ndjenjat e qytetarit dhe të njeriut, ndjenjat e humanizmit dhe të dashurisë për fuqiplotin janë kryesoret. Fare mirë mund të jem person zyrtar, por ama qytetarin dhe njeriun jam i detyruar t'i respektoj, t'i ndiej në

[1]) *Nuk janë asgjë (lat.)*

veten time dhe të jem i përgjegjshëm... Sapo më pyetët për Zametovin. Po ju them se ai njeri bëri ca paudhësi në ca lokale të dyshimta, ku kishte pirë shampanjë, por edhe vodkë... Hë, ç'i thua një të tillë tipi! Sa për mua, unë, si të thuash, jam djegur, jam viktimë i besnikërisë dhe i ndjenjave të larta, ama e ruaj postin dhe punën e nderuar. Kam grua e fëmijë. E kryej me ndërgjegje detyrën e qytetarit dhe të njeriut, ndërsa ai kush është, më lejoni t'ju pyes? Ju flas si njeriut të fisnikëruar nga shkollimi: a s'janë ca si shumë ato "zoçkat" flokëprera që po na zënë sytë këto kohët e fundit?

Raskolnikovi ngriti vetullat lart, që donin të thoshin pyetje. Këto fjalë të Ilia Petroviçit i tingëlluan në shumicën dërrmuese si tinguj bosh, por disa fare mirë po i kuptonte dhe po priste ku donte të dilte bashkëfolësi, ç'fund do të kishte kjo bisedë.

- E kam fjalën për vashëzat flokëprera, - vijoi Ilia Petroviçi i ardhur në formë. - I quajta "zoçka", dhe them se i kam rënë pikës. He-he! Deri në akademitë po orvaten të depërtojnë, i përkushtohen madje edhe anatomisë... Ja, më thoni, në u sëmursha, a vihet, vallë, t'i kërkohet ndihmë një të tillë "zoçke"? He! He!

Qeshi mjaft i kënaqur nga mendjemprehtësia që ishte duke demonstruar.

- Ta zemë që vjen nga etja e pamatë për dijet; bukur fort, veç mos e keqpërdor! E përse duhen fyer fisnikët, siç bëri ai faqeziu Zametov? Me ç'të drejtë i fyen? A nuk e shihni sa shumë vetëvrasje janë shpifur? I bën rrush e kumbulla gjithë sa ka tjetri dhe pastaj vete e ia heq vetes, qofshin të rinj apo të moshuar, vajza apo djemë. Ja dhe sot na njoftuan për një zotëri që kishte ardhur para ca kohe në kryeqytet. Nill Pavliç! Si e kishte emrin ai që vrau veten?

- Svidrigajllov! - me zë të lartë, por me shpërfillje të plotë iu përgjigj një zë nga dhoma tjetër.

Raskolnikovi u drodh.

- Mos njiheshit gjë?

- Po... Ka ardhur këtu para pak kohe...

- Po, para pak kohe... I paska vdekur gruaja, njeri me sjellje të dyshimtë paska qenë... Vetëvrasje e çuditshme!... Ka shkruar disa fjalë në një blloknot, thotë se po e bën me mendjen esëll, nuk bën njeri me faj... Thonë se ishte krimth me para. Po ju nga e paskeni njohur?

- E njoh... Ime motër ka qenë guvernante në shtëpinë e tij.

- Ashtu, de! Pra, diç mund edhe të na thoni për të. Nuk kishit dyshuar gjë?

- Dje kam qenë me të.... Piu goxha verë... Nuk e kam ditur që do t'i ndodhte kjo...

Raskolnikovit sikur i ra përsipër diçka e rëndë dhe e shtypi.

- Po ju pse u zverdhët kështu? Mos ju erdhi nga ajri i rëndë?

- Më duhet të iki. - bëlbëzoi. - Më falni për shqetësimin.

- E ç'janë këto fjalë? Si të doni! Veç takimi ma shtoi kënaqësinë.

Ilia Petroviçi i zgjati dorën.

- Desha vetëm... të takoja Zametovin...

- E qartë, e qartë... më kënaqët me ardhjen tuaj!

- Edhe unë... po ashtu... gëzohem... Mirupafshim! - i buzëqeshi Raskolnikovi.

Doli. I merreshin këmbët, i vinte bota vërdallë. As vetë nuk po e kuptonte se ku gjendej. Zbriti shkallët duke u mbajtur fort pas parmakëve. Iu duk që një rojtar shtëpie, me regjistër ndër duar, e shty, një qen kuisi në katin përdhes, një grua e qëlloi me gur. Në oborr i vajti syri te Sonja, ishte e verdhë dyllë, po e shihte si e fandaksur. Ndali para saj. Ia nguli sytë fytyrës, aty pa një vuajtje të pafund e anë, lexoi një dhimbje që zor të shprehet, pa një makth që nuk durohej. Një buzëqeshje e kithtë njeriu të përhumbur iu duk në fytyrën e shpërfytyruar, u skërmit dhe u kthye andej nga kishte ardhur...

Ilia Petroviçin e gjeti të zhytur në ca shkresurina; para tij qëndronte rojtari që e kishte shtyrë te shkallët.

- A-a-a! U kthyet! Mos keni harruar gjë?... Po ç'keni kështu?

Raskolnikovi me buzët e mavijosura, të ngrira, me shikimin prej njeriu të përhumbur iu afrua ngadalë, u mbështet me të dyja duart mbi tryezë, provoi t'i thoshte diçka, por nuk mundi... Nga goja iu shkëputën vetëm disa tinguj pa lidhje.

- Mos nuk jeni mirë?... Uluni pak! Sillni një gotë ujë!

Raskolnikovi u lëshua në karrige, sytë nuk i hoqi nga fytyra e Ilia Petroviçit, që, nga ana e tij, po e shihte tejet i habitur. U panë për një kohë sy ndër sy, qëndruan në pritje. Sollën gotën me ujë.

- Jam unë... - filloi të thotë Raskolnikovi.

- Pini pak ujë.

- Jam unë ai që e vrau atëherë plakën fajdexheshë dhe motrën e saj, Lizavetën; unë i vrava dhe i grabita...

Ilia Petroviçi shtangu në vend me gojën hapur. U mblodhën njerëz.

Raskolnikovi e përsëriti deponimin...

Epilog

I

Siberi. Në bregun e një lumi shtratëgjerë, të shkretë ngrihet një qytet, një nga qendrat administrative të Rusisë; në mes të tij është një kështjellë, në të është një burg. Aty ka nëntë muaj që vuan dënimin i burgosuri i shkallës së dytë Rodion Raskolnikovi. Nga koha e krimit kanë kaluar një vit e gjysmë.

Procesi gjyqësor qe zhvilluar pa ndonjë vështirësi. Krimineli kishte përsëritur disa herë me qartësi e përpikmëri të madhe aktin e vrasjes, pa e lehtësuar në asgjë veten, pa shtrembëruar asnjë fakt, pa lënë pa rrëfyer deri në hollësitë më të vogla. Shpjegoi si u gjend ndër duar plakës pakoja me pllakën metalike brenda, si ia kishte marrë çelësat viktimës, kujtoi edhe disa nga objektet që kishin qenë në sënduk, bëri të qartë arsyen e vrasjes së Lizavetës, tregoi për Kohun, për trokitjet, për studentin, për bisedën që kishin zhvilluar prapa derës, si kishe zbritur me vrap shkallët, kishte dëgjuar britmat dhe hargalisjen e Nikollës e të Mitkës, si qe fshehur në apartamentin bosh, ç'kishte bërë kur qe kthyer në dhomën e tij dhe, më në fund, u kishte thënë saktë vendndodhjen e gurit, nën të cilin kishte fshehur gjithë sa kishte marrë te plaka. Pra, çështja ishte krejt e qartë. Veçanërisht rrethana e fundit i kishte lënë të habitur si hetuesit, ashtu edhe gjyqtarët e çështjes: jo vetëm që nuk kishte përfituar nga grabitja, por as që dinte se ç'përfaqësonin sendet e grabitura. U qe dukur, madje, e pabesueshme që të mos e kishte hapur qesenë për të parë ç'kishte brenda. (Kishte patur treqind e shtatëdhjetë rubla argjend dhe tri dykopejkëshe; nga qëndrimi nën gur paratë që kishin qenë përsipër qenë prishur.) U munduan shumë të merrnin vesh arsyen, u dukej që vetëm në këtë pikë i pandehuri gënjente, ndërsa në të gjithë të tjerat ishte

treguar i çiltër dhe i saktë. Më në fund, disa (të krahut psikologjik) e pranuan një të tillë mundësie, por shpjeguan që krimi nuk kishte si të ndodhte ndryshe, përveç se në rrethanat e një çmendurie të përkohshme të kriminelit, që krimi nuk ka qenë i shoqëruar me synime të grabitjes për përfitim. U kapën pas teorisë së re për çmendurinë e përkohshme, së cilës dendur kishin filluar t'i drejtoheshin gjithandej. Për më tepër që ipohindrinë e të akuzuarit e pohonin që të gjithë dëshmitarët: meku Zosimov, pronarja e shtëpisë, shërbëtorja. Qe bërë përfundimi që Raskolnikovi nuk ngjante me kriminelët e zakonshëm, diç kishte tjetër soj në këtë mes... Si për inat të mbrojtjes, i pandehuri nuk bënte as përpjekjen më të vogël për t'u përligjur. Pyetjes: ç'e kishin shtyrë ta bënte këtë vrasje, i qe përgjigjur qartë e me një saktësi të çuditshme se kishte qenë gjendja mjerane, në të cilën jetonte, varfëria e skajme, dëshira për të hedhur hapat e para të sigurta në rrugën e jetës, duke patur të paktën nja tremijë rubla në xhep, të cilat mendonte se do t'ia gjente plakës fajdexheshë. Krimin e kishte kryer i nisur nga motive të dobëta, i irrituar në kulm nga papasja dhe mossuksesi. Pyetjes: ç'e kishte shtyrë të paraqitej vetë në polici, i qe përgjigjur: pendimi i thellë. Këto shpjegime trupit gjykues iu dukën si shumë të trasha...

Dënimin, sidoqoftë, ia kishin zbutur falë këtij qëndrimi. Vrasësi jo vetëm që nuk përpiqej të përligjej, por, përkundrazi, e akuzonte për fajin vetë veten. Edhe rrethanat e çuditshme, tepër të veçanta, në të cilat ishte kryer krimi, po ashtu u morën paraqysh. S'u la jashtë vëmendjes gjendja e keqe shëndetësore. Që nuk kishte përfituar nga grabitja, u interpretua si pendim, por edhe rrjedhojë e gjendjes depresive shëndetësore në çastin e krimit. Rrethana e vrasjes së padëshiruar të Lizavetës u konsiderua një tjetër argument i kësaj gjëndjeje, sidomos dera e hapur gjatë kryerjes së vrasjes. Më në fund, edhe paraqitja në polici pikërisht në ato çaste, kur çështja po futej në qorrsokak pas pranimit të fajit nga Nikollai dhe kur kundër tij jo vetëm që nuk kishte fakte të drejtpërdrejta, por as dyshim nuk kishte (Porfiri Petroviçi e kishte mbajtur fjalën e dhënë), të gjitha së bashku kishin ndikuar ne zbutjen e dënimit.

Pati edhe disa rrethana të tjera, fare të papritura, që e kishin lehtësuar të pandehurin. Ish-studenti Razumihin se ku kishte mbledhur ca

dokumente, në bazë të te cilave vërtetohej që vrasësi Raskolnikov, kur kishte qenë në universitet, si kishte mundur e sa kishte mundur e kishte ndihmuar një shokun e vet të sëmurë nga tuberkulozi, e kishte mbajtur me pekule për një kohë të gjatë. Pasi ky kishte vdekur, kishte shkuar tek i ati plak, e kishte ndihmuar të shtrohej në spital, dhe kur ky kishte vdekur qe përkujdesur për varrimin. Edhe pronarja, e ëma e së fejuarës së vdekur të Raskolnikovit, dëshmoi në dobi të të akuzuarit, duke treguar se si njëherë, kur kishte rënë zjarr në shtëpinë fqinje, ky kishte shpëtuar dy vogëlushë, duke vënë kokën në rrezik. U verifikua dhe u vërtetua nga shumë dëshmitarë. E dënuan si kriminal të shkallës së dytë, me tetë vjet punë të detyruar.

E ëma e Raskolnikovit zuri shtratin, kur procesi kundër të birit ende nuk kishte filluar. Dunja dhe Razumihini zgjodhën si më të përshtatshëm largimin e saj nga Petërburgu, gjatë kohës që vazhdonte gjyqi. Zgjodhën një qytet hekurudhor jo larg kryeqytetit, që të mund t'i ndiqnin seancat. Pulheria Aleksandrovna vuante nga një sëmundje nervore, e cila ngjante shumë me çmendurinë. Dunja kur qe kthyer pas takimit me vëllanë, e kishte gjetur të ëmën fare të sëmurë, ishte me temperaturë dhe fliste përçart. E lidhën që më parë fjalën me Razumihinin se ç'do t'i thoshin për Rodien: do nisej për rrugë të gjatë me porosi të dikujt, kjo rrugë ishte për të me përfitim të madh, do ta bënte njeri me emër. Ų çuditën që dhe kur ia thanë, por edhe më pas Pulheria Aleksandrovna nuk u bëri as dhe një pyetje, përkundrazi, vetë sajoi një histori të tërë lidhur me largimin e të birit, u tregoi me lot në sy se kishte ardhur tek ajo që të ndaheshin, linte të nënkuptohej që ishte në dijeni të disa të fshehtave që askush tjetër përveç saj nuk i dinte, thoshte që Rodia paskësh ca armiq për vdekje, nga të cilët i duhej të fshihej... Fliste me besim të pamundur për karrierën marramendëse që e priste, vetëm të shmangeshin këto rrethana armiqësore që ishin krijuar. Razumihini i thoshte me bindje që i biri do të bëhej burrë i shquar shteti, për këtë fliste më së miri artikulli që kishte botuar, fliste talenti i tij i rrallë. Artikullin s'e hiqte nga dora, ndonjëherë ua lexonte edhe me zë të lartë, kur flinte e vinte te koka, por që t'i pyeste se ku ndodhej atë çast Rodia, këtë nuk e bëri as dhe një herë. Kuptohet që as Dunja e as Razumihini nuk ia hapnin të parët fjalën. Zunë të trëmben nga kjo heshtje e saj, ajo madje nuk po i pyeste përse s'kishte

ndonjë letër prej tij, ndërkohë që kur kishte qenë në qytetin e lindjes, jetonte me shpresën e këtyre letrave. Dunja thoshte me zemër të ngrirë që e ëma e merrte me mendje fatin e tmerrshëm të të birit dhe nuk i pyeste nga frika mos i thoshin ndonjë gjë që s'mundte dot ta duronte. Dukej sheshit që Pulheria Aleksandrovna nuk ndihej mirë.

Nja dy herë ua pat zënë ngoje të birin, por kur përgjigjet që kishte marrë nuk e kënaqën, e pllakosi një heshtje e trishtë: dukej që e mundonin shumë dyshimet e llahtarshme. Rodia i pati thënë së motrës që mamaja i kishte dëgjuar ca fjalë nga goja e saj kur qe në gjendje jermi, në gjumë, pas takimit me Svidrigajllovin. Mos vallë ishte në dijeni të gjithçkaje? Rrinte-rrinte dhe shkundej nga ajo tulatje e përgjumje, fliste pa ndalim për Rodien e dashur, për të ardhmen e tij... Ia mbështesnin fjalën, e qetësonin, por ajo përsëri u kthehej fjalëve për të birin...

Dënimi u dha pesë muaj pas paraqitjes në polici. Razumihini i shkonte sa herë që i paraqitej rasti, Sonja po ashtu. Erdhi dita e ndarjes. Dunja e siguroi që kjo nuk ishte ndarje përgjithmonë, edhe Razumihini po ashtu. Si tip i vrullshëm dhe i çiltër që ishte, Razumihini iu betua se, pasi të kishte vënë ndopak para, do shkonin edhe ata pas tij në Siberi, në ato vende pak të banuara, ku me një kapital jo të madh mund të bëje goxha punë. Aty të gjithë bashkë do nisnin jetën e re. Ndarja qe e përmallshme, u përlotën të gjithë. Kohët e fundit Raskolnikovi rrinte i menduar, pyeste vetëm për të ëmën, shqetësohej vetëm për të. Dhe aq shumë, saqë Dunjën nuk kishte si të mos e vinte në merak. Me Sonjën fliste pak. Kjo i kishte bërë të gjitha përgatitjet për t'i shkuar pas, i hynë shumë në punë paratë që i la Svidrigajllovi, por nuk i kishte thënë asnjë fjalë. Kur po ndaheshin, vunë re se si po i lodronte në fytyrë një buzagaz i çuditshëm, duke dëgjuar të motrën dhe Razumihinin që i flisnin për të ardhmen e lumtur pas vuajtjes së dënimit. U tha se parandjente një fund të keq për të ëmën. Sonja u nis bashkë me të.

Dy muaj pas kësaj Dunja u martua me Razumihinin. Dasma kaloi e trishtë, pa ceremoni. Ndër të ftuarit ishte dhe Porfiri Petroviçi me Zosimovin. Veprimet që shoqëruan ato premtime të Razumihinit, e bindën Dunjën që ky do ta mbante fjalën e dhënë. Gjëja e parë që bëri ishte: iu kthye leksioneve të braktisura për të mbaruar univer-

sitetin. Pas kësaj do përgatiteshin për të jetuar në Siberi. Ndërkohë të gjitha shpresat i kishin varur te Sonja...

Pulheria Aleksandrovna i bekoi dhe u dha uratën, por pas kësaj gjendja shëndetësore erdhi e iu keqësua, e mbyti zymtia. Për t'i bërë qejfin, Razumihini i tregoi për studentin veremli dhe të atin, të cilëve u kishte ndihmuar Raskolnikovi, për fëmijët, të cilëve u kishte shpëtuar jetën. Gruan mendjeprishur tregimi e kishte entuziazmuar dhe eksituar jashtë mase; nuk kishte lënë njeri pa ia treguar. Dunja, që e shoqëronte ngado që vinte, s'dinte si ta përmbante e ta qetësonte. Më e keqja ishte se mund të gjendej ndonjë i njohur i Raskolnikovit, i cili mund t'i thoshte se e kishin arrestuar... Tërë kohën qante, fliste përçart. Një mëngjes u ngrit nga shtrati me fjalët se priste të kthehej këto ditë Rodia, vetë i kishte thënë që do të kthehej pas nëntë muajsh. Iu vu përgatitjeve të vrullshme për pritjen sa më të mirë të tij, rregulloi veçanërisht mirë dhomën ku mendonte se do flinte Rodia. (Ishte dhoma që flinte ajo vetë.) Lau dhe pastroi çdo gjë. Dunja ia ndiqte veprimet e alarmuar, por e ndihu në përgatitjet që bënte. Të nesërmen gdhiu e sëmurë shumë, me temperaturë të lartë. Vdiq pas dy javësh. Fjalët që pat thënë në përçartje e sipër të linte të kuptohej që dinte shumë më tepër për fatin e trishtuar të të birit sesa pandehnin.

Raskolnikovi e mori me vonesë lajmin e vdekjes, ndonëse letërkëmbimi me Petërburgun ishte i rregullt, meritë për këtë kishte Sonja. Dunjës dhe Razumihinit letrat e kësaj në fillim iu dukën të thata, por shpejt u bindën që njohuritë e përftuara prej tyre kishin qenë më se të mjaftueshme për krijimin e një përfytyrimi të plotë për fatin e vëllait fatkeq. U shkruante për jetën e përditshme, ua përshkruante me hollësi ç'bëhej në kampin e të dënuarve me punë të detyruar. Asnjë fjalë nuk shkruante për veten dhe për ndjenjat e saj, për fatin që e priste, për shpresat që ushqente. Vetëm fakte, vetëm të dhëna për të e fjalë që i kishte thënë ai, sidomos njoftime për shëndetin e tij. U shkruante hollësisht sidomos për porositë që i jepte, për dëshirat që kishte, ua përshkruante realisht gjendjen në të cilën ndodhej.

Pak gëzim i sillnin Dunjës dhe bashkëshortit të saj këto letra, sidomos kohët e para. U shkruante se ishte i zymtë, i heshtur, nuk e interesonte asgjë, pyeste vetëm për të ëmën. Pasi qe bindur që Raskolnikovi e merrte me mendje vdekjen e saj i kishte treguar, por

qe habitur shumë, kur kishte vënë re që lajmi s'e kishte tronditur kushedi sa, të paktën asaj kështu i ishte dukur. Sipas Sonjës, kjo vinte ngaqë ishte i thelluar tej mase në vetvete. Jetën e kampit Raskolnikovi e mori ashtu siç ishte, nuk ushqente shpresa mendjelehta (gjë që ndodh rëndom në kësi rastesh), asgjë nuk e kishte habitur në këtë mjedis. Dilte në punë, nuk i bënte bisht. Hante ç'i jepnin, por gatimi ishte aq i keq, saqë i mirëpriti prej saj ca para për të gatuar diçka veç, për të tjerat e kishte lutur të mos shqetësohej, përkujdesi i tepërt do ta bezdiste. Sonja ua përshkruante me hollësi fjetoret, shkruante se ishte ngushtësi e madhe, veç e kishte me të dëgjuar, vetë nuk kishte qenë. Raskolnikovin kjo nuk e dëshpëronte, e merrte jetën ashtu si i kishte ardhur. U shkruante se kohët e para jo vetëm që nuk e kishin gëzuar vizitat e saj, por e kishte ndier veten ligsht, kur kjo i vinte, s'kishte kaluar shumë dhe qe mësuar, tani i ishin bërë domosdoshmëri, mërzitej kur nuk i vinte, siç i kishte ndodhur disa herë, kur kishte qenë e sëmurë. Për ditë festash shiheshin në dhomën e posaçme, në ditë pune Sonja i shkonte atje ku punonte. Për vete u shkruante se ishte rregulluar jo keq, madje kishte arritur të zinte edhe miq, punonte rrobaqepëse dhe i ecte mbarë, në tërë qytetin e mbanin për më të mirën. Nuk u shkroi vetëm që përmes saj shefat përkujdeseshin për Raskolnikovin, e caktonin në punë nga më të mirat. Së fundi u erdhi ky lajm: (Dunja e pat nuhatur shqetësimin që fshihte në letrat e fundit Sonja) Raskolnikovi në kamp qëndronte veç të tjerëve, të dënuarit për këtë e shihnin shtrëmbër, nuk e donin, me asnjë nuk fliste dhe i kishte rënë çehre e verdhë. Në letrën e fundit Sonja u kishte shkruar se kishte zënë shtratin dhe e kishin shtruar në spitalin e burgut.

II

Kishte kohë që sëmundja po i bënte fole... Nuk e kishin vënë përfund as tmerret e jetës në kamp, as puna e detyruar, as ushqimi që s'ngjerohej, as koka e qethur tullë dhe as veshja e të burgosurit. E ç'ishin për të këto mundime e rropatje! Përkundrazi, dilte me kënaqësi në punë, e freskonte dhe e kthjellonte për bukuri gjumi i fortë pas punës kapitëse. Ushqimin as që e vinte në hesap, jeta e studentit e

kishte mësuar ta duronte urinë dhe kënaqej duke e shuar me çdo lloj ushqimi. Veshja ishte vërtet prej të burgosuri, por e kishte rregulluar që të dukej sa më mirë dhe ta mbante ngrohtë. Sa për prangat, me to u mësua aq shumë, saqë nuk i ndjente fare. As për kokën e qethur nuk e hante meraku, nëse i duhej të paraqitej para dikujt, kjo ishte Sonja, asaj nuk i druhej, ndaj dhe s'kishte pse merakosej.

Veç ishte diçka që e bënte vërtet me turp, madje edhe sy Sonjës, të cilën e pat munduar shumë me qëndrimin brutal dhe përbuzës që mbante. Ishte krenaria e nëpërkëmbur. Edhe sëmundja nga kjo i erdhi. Sa shumë do të lumturohej po të mundte të vetëakuzohej vetë veten! Do ta mposhtte me lehtësi edhe turpin, edhe sedrën e lënduar. Provoi disa herë ta nxirrte veten në bangon e të akuzuarit, por nuk e gjeti ndonjë faj të rëndë, përveç lajthitjeve në llogaritë e bëra. E pra, kjo mund t'i ndodhte shumëkujt. E torturonte mendimi që ai, Raskolnikovi, dështoi në mënyrë aq banale, që në hapin e parë, që ra viktimë e fatit dhe tani donte s'donte qe i detyruar të pajtohej me gjendjen, t'i nënshtrohej "absurditetit" të dënimit të marrë, nëse dëshironte sadopak ta qetësonte veten.

Shqetësimi nga mungesa e qëllimit dhe e synimit sot, por edhe në të ardhmen, rrjedhojë e dështimit që pati, s'i ndahej për asnjë çast. E çë pastaj që pas tetë vjetësh do të ishte vetëm tridhjetë vjeç? A mundej, vallë, t'ia fillonte nga e para? Ç'i duhej jeta pa pikësynime? Të rronte vetëm se duhej jetuar? Po ai sa e sa herë kishte qenë i gatshëm të jepte dhe jetën në emër të idesë, të shpresës, madje, edhe të fantazisë? Vegjetimi ishte i papranueshëm, kërkonte më shumë se kaq. I nisur pikërisht nga këto dëshira vetjake, e kishte mbajtur veten për njeri, të cilit i lejohej më shumë se kujtdo tjetër.

T'i kishte ofruar makar pendim ky i shkretë fat! Një pendim përvëlues, gërryes, torturues, të tillë që të çon në litar apo në zgjedhë. Do ta kishte pritur me gëzim e kënaqësi... Se edhe mundimi e lotët jetë janë! Po ja që nuk ndiente fare pendesë për krimin e kryer.

Vetëm nervozohej e dalldisej, kur kujtonte marrëzitë që kishte bërë, asgjë më tepër nuk provonte. Dhe nuk ishte hera e parë, kishte patur edhe më parë e jo pak veprime, të cilët e kishin inatosur, të marrë së bashku e kishin sjellë këtu në Siberi. I rrëkëlleu në mendjen e nxehur sa e sa herë bëmat e dikurshme, por nuk i gjente as prej të çmenduri

e as prej injoranti, siç i qenë dukur në ato kohë fatale para se të merrte vendimin.

"E ç'paska patur në ato mendime aq shumë të papranueshme në krahasim me tërë ato teori e pikëpamje që qarkullojnë me bollëk që prej kohësh kur është veselitur bota? Mjafton vetëm ta shohësh atë që mendoja unë me një shikim të pavarur, të gjerë, larg kuptimeve të rëndomta dhe kanë për t'u dukur jo aq... të çuditshme. O plangprishës rebel, përse ngece në mes të rrugës? Ju duket e papranueshme ajo që bëra, ngaqë është keqbërje... Por ç'do të thotë, keqbërje? Ndërgjegjen e kam të pastër. Sigurisht, u krye krim, u shkel një nen i ligjit, u derdh gjak, kjo kështu është; atëherë ja ku më keni, hiqmani kokën sipas nenit... Veç ama, të gjithë pushtetmbajtësit, që nuk e kanë trashëguar por kanë përdorur dhunën për ta patur pushtetin, duhen dënuar me vdekje, me t'u bërë të tillë. Po kjo as ka ndodhur e as nuk po ndodh, ndaj dhe del që e drejta është me ta. Kurse unë nuk munda dot ta kapërcej vështirësinë e parë, ndaj dhe më shpallën keqbërës..."

Vetëm në një pikë Raskolnikovi ishte i ndërgjegjshëm për gabimin: nuk duroi dot hapin e parë që bëri, kishte shkuar e ishte paraqitur në polici.

E mundonte edhe diçka tjetër: përse nuk kishte guxuar t'i jepte fund jetës? Aq e fortë paska qenë tek ai dëshira për të jetuar me çdo kusht? Ja, Svidrigajllovi e kishte mposhtur, ndonëse kishte aq shumë frikë nga vdekja!...

E mundonte shumë pendimi, e akuzonte veten se edhe atëherë, kur qëndronte në parmakët e urës, e kishte ndjerë fort mirë gënjeshtrën e madhe që fshihej në bindjet e tij. As që i shkonte në mendje, që pikërisht kjo parandjenjë dhe do të bëhej paralajmëtare e kthesës së ringjalljes së pritshme, do të ishte gur prove për shikimin dhe qëndrimin ndaj gjithçkaje të kësaj bote.

Më e shumta mund të pranonte vetëm një tundim instinkti, të cilin s'kishte si e përballonte, ndaj dhe do t'i nënshtrohej, kuptohet për shkak të dobësisë dhe mizerabilitetit të qënies së vetë. Shihte të dënuarit dhe habitej: sa shumë që e donin dhe dhimsuroheshin për jetën, sa shumë e çmonin! Madje po i dukej se këtu në kampin e punës së detyruar ajo ishte më e shtrenjtë, më e dhimsur se atje në liri. Sa shumë mundime e peripeci kalonin disa, veçanërisht ata që

kuturisnin të arratiseshin. Sa e shtrenjtë u ishte rrezja e diellit, pylli i gjelbër, kroi ujëftohtë. Për t'u takuar me ta ca të këtushëm ëndërronin siç ëndërrojnë takimin me të dashurën. Ajo hijeshi u shfaqet në ëndërr e zbukuruar edhe nga cicërimat e zogjve në gëmushat rreth e rrotull... Sa më shumë thellohej, aq më të pashpjegueshme i bëheshin sa e sa shëmbuj të jetës së këtushme.

Sigurisht, në jetën e të dënuarëve kishte shumë gjëra që s'i vinte re dhe as që denjonte t'i shihte. Rronte, si të thuash, me sy në tokë, i kallnin krupën, ndaj u shmangej kontakteve me ta. Por shumë dukuri të kësaj jete e habisnin dhe dashje pa dashje zuri t'ua vinte veshin. Veçanërisht e habiste honi që e ndante nga këta njerëz, i dukeshin njerëz të ardhur nga planete të tjerë. Ata e shihnin me urrejtje e keqdashje, ai ua kthente me të njëjtën monedhë. Arsyet i kishte të qarta, por kurrë më parë nuk kishte menduar që honi ndarës të ishte aq i thellë. Kishte në kamp edhe polakë, edhe të dënuar politikë. Këta hiqeshin për mendtarë, të dënuarit e tjerë i mbanin për xhahilë e injorantë. I përbuznin dhe i neverisnin. Raskolnikovi nuk mund ta bënte; e shihte që ishin shumë më të zgjuar se polakët fodullë. Ishte edhe një ish-oficer e dy seminaristë që po ashtu i përbuznin të dënuarit; Raskolnikovi shumë shpejt u bind që edhe këta e kishin shumë gabim.

Sido që të ishte, të dënuarit nuk e donin dhe as jepnin e as merrnin me të, madje kishin filluar ta urrenin. E përse vallë? Këtë nuk po arrinte ta kuptonte. E përbuznin, e tallnin dhe e vinin në lojë ca që ishin edhe më kriminelë se ai!...

- Je nga zotërinjtë! - i thoshin. - A të kishte hije të niseshe me sëpatën nën sqetull? Nuk është punë për zotërinjtë ajo që ke bërë!...

I erdhi radha të mbante kreshmë bashkë me fjetoren. Shkonte në kishë bashkë me të tjerët. Kur një herë u përfol me dikë, iu sulën nga të katër anët, i folën dhe e kërcënuan me një urrejtje për vdekje.

- Ik, mor antikrisht! - i thanë. - Ti nuk i beson Zotit! Pak e ke të të vrasin!...

Kurrë nuk kishte folur me njeri për Zotin, por ja që ishin gati ta çonin në atë botë si antikrisht! U mundua të ruante gjakftohtësinë dhe ta kalonte çdo gjë në heshtje, por nga turma u shkëput një i dënuar dhe zuri ta kërcënonte. Raskolnikovi mezi e përmbajti veten, por ama nuk u tremb. Fytyra i shprehte vetëm gjakftohtësi. Sakaq mbërriti

roja dhe i ndau, do kishte shkuar gjaku rrëke... Ç'të ishte vallë kjo? Nuk po arrinte dot ta kuptonte.

Krejt ndryshe qëndronte puna e Sonjës: e donin të gjithë dhe e donin shumë. Kjo asgjë nuk bënte për t'ua fituar zemrat, e shihnin në të rrallë, vetëm kur vinte në vendin e punës, për të takuar atë, por dinin gjithçka për të, madje dinin edhe ku banonte e me se merrej. E pra, Sonja para nuk u falte e as shërbime nuk u bënte. Vetëm për krishtlindje u solli byrekë e kuleçë. Ashtu vetvetiu ndërmjet tyre dhe Sonjës u krijuan marrëdhënie njerëzish të afërm: u shkruante letra, ua hidhte në postë, i besonin t'u merrte të hollat që u vinin nga të vetët. Kur e shihnin, hiqnin kapelen dhe i përkuleshin me respekt. "Shpirte moj, Sonja Semionovna, si nënë na je gjendur, e dhembshur dhe mëshirëplotë je!" - i thoshin këta njerëz të vrazhdë, të damkosur në jetë të jetëve. Kjo u buzëqeshte dhe ua kthente përshëndetjen. Sa shumë që ia çmonin buzëqeshjen! E ndiqnin me sy, kur largohej, e lavdëronin dhe ia quanin për virtyt edhe atë që ishte aq imcake.

Raskolnikovi ndënji në spital kreshmët dhe javën e madhe. I vinin në mendje ëndrrat dhe përçartjet që s'i qenë ndarë gjatë kohës që kishte qenë me temperaturë. I qe fanitur bota mbarë e dënuar të ishte viktimë e një lëngate të tmerrshme, të padëgjuar, që kishte ardhur nga Azia. Do vdisnin të gjithë, do mbeteshin vetëm të zgjedhurit. Se nga erdhën disa qënie mikroskopike, të cilat futeshin në trupin e njerëzve me mendje dhe vullnet të dhunuar; me t'u futur, i tërbonin dhe i çmendnin njerëzit... Veç kurrë më parë njerëzit nuk kishin qenë aq të mençur dhe të patundur në veprimet e tyre. Kurrë ndonjëherë nuk kishin qenë aq të palëkundur në dhënien e dënimeve, në nxjerrjen e përfundimeve shkencore, në manifestimin e bindjeve dhe të besimit të tyre. Vendbanime të tëra qytete të tëra, popuj të tërë rilindën dhe u çmenduruan. Endeshin si të fandaksur, s'po mundnin ta kuptonin shoku-shokun, secili i binte gjoksit dhe thoshte se vetëm ai e kuptonte të vërtetën, s'e duronte dot praninë e tjetrit. Nuk po merrej vesh, kush duhej nxjerrë para gjyqit e përse, cili duhej justifikuar e përse... E asgjësonin njëri-tjetrin me një ligësi të pakuptimtë. Niseshin hordhi për diku, por në rrugë e sipër asgjësonin njëri-tjetrin. Në qytet nuk rreshtnin së rëni kambanat, por kë thërrisnin e për ku, askush nuk e dinte, veç të gjithë dukeshin të alarmuar. I braktisën zejet dhe punët,

merreshin vetëm me dhënien e mendimeve, por gjuhë të përbashkët nuk gjenin. Në ndonjë vend kishte ndodhur të mblidheshin kokë më kokë, të binin për diçka në ujdi, por me të filluar një punë të re, i vërsuleshin tjetrit e fajësonin, kacafyteshin dhe vriteshin. Ranë zjarre që e bënin vendin shkrumb e hi, kudo pllakosi zija. Lëngata e përgjithshme po merrte përmasa katastrofike, mundën të shpëtonin vetëm pak të zgjedhur, të racës së kulluar, ata që ishin paracaktuar për zanafillën e sojit të ri njerëzor, të jetës së re, ata që do realizonin pastrimin e botës, veç kërkush, kërkund nuk po i shihte, nuk po ua dëgjonte zërin.

Raskolnikovin e mundonte një gjë: përse kësisoj ëndrrash gjenin njehonë në vetëdijën e tij, trishtohej shumë nga kjo. Kishte dy javë që s'po i shqiteshin nga mendja... Pas pashkëve të mëdha, ditët kishin qenë të buta, me diell, ditë të bukura pranvere; në fjetore kishin filluar t'i hapnin dritaret (të forcuara me hekura poshtë të cilave ecejaknin rojat). Sonja, gjatë kohës që kishte ndenjur në spital, kishte mundur t'i vinte vetëm dy herë: për të hyrë kërkohej leje e posaçme. Veç vazhdimisht e shihnin në oborrin e spitalit, nën dritaren e dhomës së tij. Zgjidhte kohën para perëndimit të diellit. Një herë Raskolnikovin e kishte mundur gjumi i drekës, u zgjua kur dielli po perëndonte; doli në dritare dhe atje tej te dera e spitalit i zunë sytë Sonjën. Dukej sikur dikë priste. Sikur ia shpuan tejetej zemrën me shigjetë, i sëmboi deri në dhimbje, u drodh dhe u largua nga dritarja. Ditën tjetër Sonja nuk u duk. Vuri re që mezi po e priste, s'po e mbante vendi nga padurimi. Ato ditë e nxorën nga spitali. Në kamp i thanë që Sonja Semionovna ishte e sëmurë, nuk dilte nga shtëpia. U bë merak, dërgoi të merrnin vesh ç'kishte, i thanë se nuk kishte ndonjë sëmundje me zarar. Për ta qetësuar, Sonja i dërgoi një pusullë të shkruar me kalem, i shkruante se ishte mirë, se kishte kaluar një të ftohtë të lehtë, dhe këto ditë do vinte ta takonte në punë. Kur po e lexonte, zemra i rrihte si çekan.

Ditët mbajtën të ngrohta dhe me diell. Niseshin për në punë herët, në ora gjashtë. Punonte me dy të tjerë në një furrë alabastre buzë lumit. Njëri nga të dënuarit, i shoqëruar nga roja, shkoi për të marrë veglat në kështjellë, tjetri zu të merrej me zjarrin e furrës. Raskolnikovi doli nga punishtja, në breg të lumit u ul në varricën me dru dhe e hodhi shikimin në hapësirën e gjerë të lumit. Nga bregu tjetër deri

tek ai vinte melodia e një kënge. Në stepën e gjerë, që llamburiste nga dielli, si pika të errëta dukeshin kasollet e ca endacakëve. Aty kishte liri, rronin të tjerë njerëz, atje sikur edhe koha kishte ndalur, sikur nuk kishte kaluar ende koha e Adamit. Raskolnikovi shihte mendueshëm, mendimet ia lëshonin vendin ëndërrimeve, ndjenjave; një pikëllim i thellë ia mbushi shpirtin, po i merrte frymën.

Atë çast iu gjend pranë Sonja. Nuk e kishte ndjerë si i qe afruar, si i qe ulur pranë. Ishte herët, ende ndihej fresku mëngjesor. Kishte veshur një triko të mbajtur, në kokë kishte hedhur një shami. Në fytyrë i dukeshin ende gjurmët e sëmundjes: dukej e hequr dhe e zbehtë. I buzëqeshi e gëzuar, dhe, si zakonisht, i zgjati dorën me ndrojtje.

Gjithmonë kështu bënte, ndonjëherë nuk ia zgjaste fare, nga frika mos ky ia shtynte tej me neveri. Se sa herë që e takonte, e gjente të pakënaqur dhe të zymtë, heshtte tërë kohën e qëndrimit të saj aty. I kishte ndodhur që vetëm e përshëndeste dhe largohej krejt i pikëlluar. Kësaj here duart e tyre nuk u shqitën, ai e pa shpejt e shpejt, kalimthi, nuk i tha asnjë fjalë dhe uli sytë për tokë. Ishin vetëm të dy. Pas pak u kthye roja.

Si ndodhi, as ai vetë nuk e dinte, por u gjend te këmbët e saj, duke ia përqafuar dhe puthur gjunjtë. Sonja u trëmb shumë, në fytyrë i ngriu tmerri. Brofi dhe, duke u dridhur, e pa ngultas: e kuptoi çdo gjë. Në sytë i buisi një lumturi e pafund... E kuptoi, nuk kishte më asnjë dyshim: e donte dhe e donte shumë. Kishte ardhur minuta e shumëpritur.

Donin diç t'i thoshin njëri-tjetrit, por nuk mundnin: sytë i kishin të mbushur me lot. Ishin të dobësuar, të zbehtë, por në fytyrat u shkëlqente agimi i së ardhmes, i ringjalljes së shumëpritur për jetën e re. I kishte ringjallur e përtërirë dashuria, nga zemra e njërit derdheshin currila të fuqishëm jete në zemrën e tjetrit.

Vendosën të prisnin e të duronin. Kishin edhe shtatë vjetë për të duruar, por sa shumë mundime dhe sa shumë lumturi që i priste përpara! Kryesorja, ai ishte ringjallur, ajo këtë e ndiente, nuk gabohej, vetëm për këtë çast jetonte, mezi e kishte pritur.

Atë mbrëmje, pasi kishin mbyllur derën e fjetores, Raskolnikovi rrinte shtrirë dhe mendonte për të. I dukej sikur të dënuarit, armiq të tij, po e shihnin me tjetër sy. U kishte hapur muhabet, përgjigjja e

Lënda


Pjesa e parë 5
Pjeas e dytë 76
Pjesa e tretë 165
Pjesa e katërt 238
Pjesa e pestë 306
Pjesa e gjashtë 364
Epilog 439



VEPRA ZGJEDHURE III



KRIM DHE NDËSHKIM



ISBN: 99927- 667- 4 - 3

Çmimi 600 Lekë